

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 20,21,22 DHE 25.07.2005**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 20,21,22 I 25.07.2005**

KORRIK-JULI

2005

R E N D I I D I T Ë S

Me 20 korrik:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare me 23-24 qershor dhe 6-7 korrik 2005,
2. Shqyrtimi i çështjes së personave të pagjetur,
3. Shqyrtimi i çështjes së sigurisë në Kosovë,

Me 21 korrik:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Procedurën Kontestimore,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Mbeturinat,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Procedurën Administrative,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimet e Shoqërisë Informatike,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Provimin e Jurispodencës,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mbrojtjen nga Zjarri,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Akreditim,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dizajnin Industrial,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ngrohjen Qendrore,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Trashëgiminë Kulturore të Kosovës,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Radio Televizionin e Kosovës,
17. Përgjigja gojore e Ministrit Qemajl Ahmeti në pyetjen e deputetit Gazmend Muhaxhiri lidhur me zbatimin e Ligjit për rrugët.

DNEVNI RED

Dana 20. jula:

1. Usvajanje zapisnika sa plenarnih sednica od 23-24.juna i 6-7.jula 2005,
2. Razmatranje pitanja nestalih lica,
3. Razmatranje pitanja bezbednosti na Kosovu,

Dana 21. jula:

4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o parničnom postupku,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o otpacima,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o obrazovanju i osposobljavanju odraslih,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o administrativnom postupku,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o uslugama informatičkog društva,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o pravosudnom ispitu,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti od požara,
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona o stručnom obrazovanju i osposobljavanju,
12. Prvo razmatranje Nacrta zakona o akreditiranju,
13. Prvo razmatranje Nacrta zakona o industrijskom dizajnu,
14. Prvo razmatranje Nacrta zakona o centralnom grejanju,
15. Prvo razmatranje Nacrta zakona o kulturnom nasledstvu Kosoava,
16. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Radio televiziji Kosova,
17. Usmeni odgovor Ministra Qemajl Ahmeti na pitanju poslanika Gazmend Muhaxheri u vezi sprovođenja Zakona o putevima.

AGENDA

On July 20th:

1. Approval of minutes from the Plenary Sessions Jun 23rd-24th and July 6th-7th, 2005,
2. Deliberation of issue on missing persons,
3. Deliberation of issue on security in Kosovo,

On July 21st:

4. Second reading of the Draft Law on Contentious Procedure,
5. Second reading of the Draft Law on Waste,
6. Second reading of the Draft Law on Adult Education and Training,
7. Second reading of the Draft Law on Administrative Procedure,
8. Second reading of the Draft Law on services of Informational Society,
9. First reading of the Draft Law on Bar Examination,
10. First reading of the Draft Law on Fire Protection,
1. First reading of the Draft Law on Vocational Education and Training,
2. First reading of the Draft Law on Accreditation,
3. First reading of the Draft Law on Industrial Design,
4. First reading of the Draft Law on Central Hitting,
5. First reading of the Draft Law on Cultural Heritage in Kosovo,
6. First reading of the Draft Law on Radio Television in Kosovo,
7. Aural answer of Minister Qemajl Ahmeti to the question presented by deputy Gazmend Muhaxheri related to implementation on Law on Roads.

T R A N S K R I P T
NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS
E MBAJTUR MË 20,21,22 DHE 25.07.2005

Seanca u mbajt në Sallën plenare të Kuvendit të Kosovës.
Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, Kryetar i Kuvendit të Kosovës
Bashkëkryesues: Xhezair Murati, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës

Seanca filloi punën në orën 10,00

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Mirëmëngjesi. Mirëseardhje të gjithë deputetëve të Parlamentit. Mirëseardhje kryeministrit të Kosovës, ministrave. Mirëseardhje komisionarit të policisë, z. Vitrup dhe kolonelit të Shërbimit Policor të Kosovës z. Sheremet Ahmeti.

Besoj që të gjitha materialet e dhura janë shpërndarë me kohë, prandaj shpresoj që janë plotësuar të gjitha kushtet që të fillojmë, 96 deputetë janë të pranishëm me shkrim, ju lutem vendosni të gjithë deputetët ajditë e juaja në mënyrë që ma lehtë të funksionojmë. Do të doja një lutje që të bëhet një ndërrim i pikave të rendit të ditës, në mënyrë që çështja e sigurisë të jetë pika e parë pas miratimit të procesverbalit e pastaj, d.m.th vetëm renditja të ndryshohet për shkak të kohës së kufizuar të shërbimeve të sigurisë në Kosovë, e besoj se keni mirëkuptim për këtë, unë në parim e kam dhënë pëlqimin. Ju faleminderit

1. Aprovimi i procesverbalit.

Në qoftë se dikush e ndien të nevojshme që edhe gojarisht të jap vërejtje.

Me që ka ardhur me vonesë, rendit të ditës i shtohet edhe pika 18 që ka të bëjë me shqyrtimin e interpelancës, lidhur me punën e Qeverisë.

Në qoftë se dikush ka të shtoj diçka.

DEPUTETI GANI KOCI, në emër të PDK-së

Z. kryetar ka kohë që po manipuloni me Kuvendin dhe ka kohë që po i shkelni Rregullat e punës së Kuvendit, dua t'ju përkujtoj rregullën 23, ku thuhet se: "Në fund të çdo seance kryetari i Kuvendit ose një anëtar tjetër i Kryesisë propozon rendin e ditës të seancës së ardhshme, ky propozim konsiderohet i miratuar vetëm në rast kur një ose më shumë grupe parlamentare, ose 5%, përkatësisht 6 deputet e kundërshtojnë këtë, kur ekziston një kundërshtim i tillë kryetari i Kuvendit paraqet propozim për miratim, nëse propozimi refuzohet Kryesia sa më parë që të jetë e mundshme paraqet propozimin e rishikuar që i nënshtrohet në të njëjtën mënyrë miratimit të Kuvendit". Vërejtja e tillë ju është dhënë

edhe nga monitoruesit e Kuvendit, në raportet e OSBE-së dhe në secilën prej tyre është vërejtje e parë kjo se ky Kuvend, gjegjësisht Kryesia e Kuvendit nuk respekton procedurat e miratimit të rendit të ditës dhe as vetë Kryesia nuk përpilon rendin e ditës dhe si e tillë ne si grup parlamentar konsiderojmë se është një vërejtje substanciale e rregullave të punës së Kuvendit dhe Kryesia e Kuvendit, gjegjësisht kryetari i Kuvendit vepron me dy kute në raste të njëjta. Dua të theksoj këtë se kohë më parë Grupi parlamentar i PDK-së pat kërkuar të debatohet për decentralizimin, kërkesa jonë që i plotëson të gjitha kriteret për diskutim, është refuzuar për arsye se nuk ka materiale bazë për t'u debatuar, pastaj kërkesa tjetër për formimin e një komisioni parlamentar hetimor për disa anëtar të kabinetit Qeveritar, përsëri që refuzuar se nuk ka dëshmi dhe se nuk është kompetencë e Kuvendit.

Kur ne kërkuam pas deklarimit të presidentit dhe kryeministrit se ishin të gatshëm të bisedojnë me Beogradin që të debatohet në Kuvend se mbi cilën strategji apo koncept do të bisedohet me Beogradin, nuk debatua me arsyetimin se nuk kemi material bazë mbi të cilin do të debatohej. Ne jemi të bindur se debati i vonuar për decentralizimin, po ashtu edhe ai për bisedimet do t'i dëmtojnë proceset politike në Kosovë, sidomos në bërjen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.

Sot në rendin e ditës kemi dy çështje mjaft të rëndësishme. Sigurinë dhe çështjen e të pagjeturve, për të cilën mungon dhe nuk ka material bazë mbi të cilin do të debatonim, po përmend fatin e të pagjeturve, rreth çështjes së tyre ekzistojnë 3 nivele, tri komisione që merren me të pagjeturit, dy prej të cilave veprojnë në kuadër të Qeverisë dhe kryeministri është dashur mbi bazë të punës që kanë bërë këto komisione të na paraqet një raport, material paraprak neve si deputet dhe mbi bazën e të cilit ne do të shqyrtonim dhe do të analizonim këtë çështje.

Po ashtu edhe për çështjen e sigurisë. Ne nuk kemi asnjë material bazë prej përgjegjësve dhe duhet të përmendim këtu një fakt me gjithë respektin që kam për njerëzit që merren me çështjen e sigurisë, këtu do të duhej të ishte përfaqësuesi i shtyllës së parë dhe jo z. Komisionar dhe përfaqësuesi i SHPK-së, sepse ne si deputet do të dëshironim që në nivelin politik ata të vijnë dhe të flasin, ndërsa këta merren me ekzekutivin. Me një rast ma herët kur kemi kërkuar që të debatohet për TMK-në janë dëgjuar zëra se nuk ka çka lyp uniforma këtu, gjegjësisht Agim Çeku që të vijë e të raportoj, prandaj për çështjen e sigurisë do të duhej të ishte këtu përfaqësuesi i shtyllës së parë që mbulon këtë sektor. I thash këto për të parë se për çështje përfaqësuesit të njëjta përdoren kute të ndryshme dhe standarde të dyfishta, tjetër për kërkesat e opozitës dhe krejt veprim tjetër për kërkesat e pozitës. Me këto diferencime primitive në një anë dhe diferencime banale në anën tjetër po tentoni që të na impononi bojkotin si mjet kundërshtie, por jo ne jemi të përgatitur dhe të gatshëm që të përballemi sa herë që e kërkon interesi i Kosovës dhe i qytetarëve të saj me çështje të tilla.

Për Grupin parlamentar të PDK-së, çështja e sigurisë dhe çështja e të pagjeturve janë dy çështje me peshë të madhe për të ardhmen e vendit, prandaj këtyre çështjeve t'u qasemi seriozisht sepse janë këto dy çështje shumë të rëndësishme, por konsiderojmë se çështja për të pagjeturit duhet dalluar nga çështja e sigurisë, është çështje që Qeveria i ka

komisionet që i thash më parë dhe ne nuk kemi material dhe nuk dom të dëgjojmë ekspozë të kryeministrit për këtë çështje, por duam të kemi material paraprak për të pagjeturit mbi bazën e punës të komisioneve adekuate që merren me këtë çështje.

Konsiderojmë si grup parlamentar në mungesë të këtyre dokumenteve, të këtyre raporteve, materialeve për çështjen e të pagjeturve, gjë që e dijë që ekzistojnë në Qeveri, çështja e të pagjeturve të shtyhet në një seancë tjetër dhe kryeministri të mos na del me fjalë të tij, por të paraqet përpara raport mbi të cilin ne do të mbështesim diskutimet dhe fjalimet tona.

Kjo është kërkesë e Grupit tonë parlamentar.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:

Zoti deputet, për komplimentet që mi bëni në vazhdimësi, për faktografi të seancës plenare. Këtë që e shtruat është e vërtetë që në fund të seancës, nuk e kontestoj, njëherë u janë dhënë përgjigjet që furnizimi i Parlamentit me materiale kryesisht vjen nga Qeveria, kjo çështje është diskutuar edhe në Kryesi, prandaj anës politike të juajës nuk kam çka t'i shtoj vetëm për këtë po ju them se faktografia është krejtësisht tjetër. Një çështje tjetër gjeneral lejtnant Agim Çekut, Kryesia i ka dërguar ftesë dhe nuk ka thënë Parlamenti, as kryetari i Parlamentit, as Kryesia si tërësi që nuk e duam uniformën, prandaj ju keni problem gjithmonë me faktografi, çështjet tjera nuk i kontestoj kërkoj të hyjmë në vendimmarrje, ju keni të drejtë si Grup parlamentar të kërkonit të hyjë në rend dite ose të hiqet diçka, prandaj dëgjojmë edhe grupet tjera dhe vendosim.

Nga LDK-ja, Alush Gashi

DEPUTETI ALUSH GASHI:

I nderuari z. Kryetar. Grupi parlamentar i LDK-së i është mirënjohës kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit për radhitje në rend të ditës për të pagjeturit. Ne e konsiderojmë se është një prej çështjeve më të dhimbshme dhe më të rëndësishme për shoqërinë Kosovare, e konsiderojmë se ky është një fillim i një debati në vazhdim. E konsiderojmë se zyra e kryeministrit me këshilltarët e vetë dhe me grupet punuese si dhe Komisioni adekuat i Kuvendit si edhe të gjitha institucionet tjera dhe qytetarët e Kosovës kanë bërë përpjekje në këtë çështje. Ne insistojmë në respektim të rregullores së punës dhe lusim që të mbetet kjo pikë e rendit të ditës si pika e dytë për debat. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DAC:

Ju lutem Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

I nderuari z. Kryetar, të nderuar deputet.

Grupi parlamentar i AAK-së ka kërkuar që të vihet në rend dite çështja e personave të pagjetur. Është një çështje urgjente për Kosovën dhe ftojme deputetët e Grupit parlamentar të PDK-së që të japin kontributin e tyre sot. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem përfaqësuesi i Orës, kush donë ta merr fjalën.

DEPUTETI NAZIM JASHARI

I nderuari z. Kryetar, të nderuar kolegë deputet.
Parimisht ne e përkrahim vërejtjen e deputetit z. Gani Koci. Ishte një vërejtje parimore se si po përgatiten seancat. Kuvendi i Kosovës po e përvetëson një mënyrë të punës siç e ka përvetësuar edhe Qeveria. Ne edhe si Kuvend po shkojmë drejt asaj që t'i përmbushim standardet duke i debatuar temat e mëdha, por në mënyrë të pa përgatitur krejtësisht, ashtu si edhe Qeveria që po i përmbush standardet, pra mendojmë se këto janë dy tema shumë të rëndësishme të cilat nuk është dashur që të futen në të njëjtën seancë. Vetëm për të pagjeturit Kuvendi ka mundur të debatoj një ditë të plotë dhe të mos e absorbojë tërë atë materie që e kemi përpara.

Sa i përket sigurisë, kjo është një çështje edhe më e pa trajtuar nga ky forum, kështu mendoj që është një mbledhje e përgatitur tepër për nguti, nonshallante e shtyrë përpara dhe që deputetët janë prurë para një akti të kryer që të debatojnë për çështjet për të cilat nuk është bërë asnjë përgatitje. Po ashtu edhe materialet të cilat do të duhej t'i kishim përpara nuk i kemi, por ne si Grup parlamentar do të marrim pjesë në punimet e këtij Kuvendi dhe do të punojmë konform bindjeve tona dhe konform interesit të qytetarëve që t'i paraqesim në mënyrë sa më të denjë ato interesa.

Në rast se nuk diskutohet edhe më tutje për procesverbalin, unë pata një vërejtje edhe për procesverbalin, në qoftë se hyhet në diskutim pastaj do ta marrë fjalën përsëri.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem edhe Grupi 6+ Mahir Jakxhillar

DEPUTETI MAHIR JAKXHILLAR

Ju faleminderit z. Kryetar edhe ne 6+ nuk kemi diçka të veçantë, po ashtu edhe ne jemi për vazhdimësinë e seancës dhe pajtohemi me këtë rend të ditës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, unë kërkoj tash që ta specifikojmë kërkesën e PDK-së. A ka PDK-ja propozim se çka të hiqet nga rendi i ditës në mënyrë që ta konkretizojmë dhe një nga një propozimet që të hyjmë në vendimmarrje në qoftë se insiston grupi parlamentar. Unë nuk kamë asnjë kërkesë por dua që ta respektoj rregulloren e punës.

DEPUTETI GANI KOCI

Unë thash që në fillim se çështja e të pagjeturve është një çështje shumë e rëndësishme për të cilën çështje Grupi parlamentar dhe ju e dini shumë mirë se PDK-ja edhe në mandatin e kaluar ka kërkuar që të futet në rendin e ditës, i keni procesverbalet e mandatit të kaluar, por keni kundërshtuar që të futet në rend dite kjo çështje, nuk jemi për atë që kjo çështje të mos jetë në rend të ditës por për këtë seancë, për këtë çështje kaq të rëndësishme deputetët janë të papërgatitur dhe unë them që Grupi parlamentar i PDK-së konsideron se nuk jemi të gatshëm që të dëgjojmë një ekspozitë të kryeministrit pa materiale që t'i kemi përpara për t'i analizuar, shqyrtuar dhe të debatojmë mbi bazën e tyre dhe kjo çështje të mbetet në një seancë tjetër të Kuvendit për të cilën ne do të jemi më të përgatitur që të bisedojmë për një çështje kaq të rëndësishme, kjo është kërkesa e parë. Kërkesa e dytë është kjo: Çështja e sigurisë, të vijë përfaqësuesi i shtyllës së parë që të raportoj këtu, mund të ketë edhe bashkëpunëtor si z. Komisionar dhe të SHPK-së, por përfaqësuesi i shtyllës së parë duhet të jetë në këtë seancë dhe të dëgjojmë ekspozitën e tij sepse ai është përgjegjësi kryesor për siguri në Kosovë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

E dëgjuam kërkesën e PDK-së që pika e rendit të ditës për të pagjeturit të mos hyjë në rend dite, kush është për atë propozim të PDK-së.

Votojmë: Ju faleminderit.

Kush është që të procedojmë sipas rendit të ditës, ju faleminderit shumica absolute janë për. 28 deputetë kanë kërkuar për arsytet që i tha z. Luzha sot të mos debatohet, pra kjo pikë mbetet në rendin e ditës dhe vazhdojmë me procesverbalin.

Kishte vërejtje gojore z. Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI

Të nderuar kolegë deputetë, i nderuari z. Kryetar. Lidhur me transkriptin që na është servuar këtu për seancat e 23 dhe 24 qershorit dhe 6 dhe 7 korrikut kamë një vërejtje parimore, për seancat e qershorit nuk do të kisha shtuar asgjë, mirëpo për seancat e korrikut ne kemi pasur edhe një seancë me 5 korrik, e kemi pasur në Kuvend znj. Medlin Olbrajt e cila e ka mbajtur një fjalë shumë përmbajtësore para këtij Kuvendi dhe po ashtu Kryetari i Kuvendit është paraqitur me një fjalë, kurse në transkript që e kemi ne përpara nuk i kemi të shënuara as fjalën e znj. Olbrajt as të kryetarit. Mendoj se është një lëshim, sepse çdo fjalë që flitet para foltores duhet të shënohet në transkriptet e Kuvendit. Po ashtu edhe me 7 korrik e kishim këtu dashamirin tonë nga Amerika z. Eliot Engel, i cili po ashtu e mbajti një fjalë rasti para këtij Kuvendi dhe po ashtu edhe ajo fjalë nuk është e regjistruar në transkriptin e Kuvendit. Mendoj që këto janë lëshime dhe dua ta di për çfarë arsye nuk janë të shënuara në transkriptet e Kuvendit. Mendoj se këto janë lëshime dhe nuk e di për çfarë arsye kanë ndodhur.

Po ashtu kamë një vërejtje me mënyrën se si është regjistruar votimi me rastin e votimit për kohëzgjatjen e fjalës së deputetëve. Ne i kemi shënimet për numrin e votuesve kundër, por nuk e kemi shënimin e votuesve për. Prandaj në bazë të transkriptit mbetet e paqartë se si ka mundur të ndodh që një votim në këtë Kuvend i cili është bërë nga këta deputet të merret pa votat për, janë 27 vota kundër, janë të pranishëm në sallë, nuk e di kush e ka interpretuar vendimin në mënyrën e tij të dëshiruar. Kuvendi nuk merr vendime me nënkuptim. Kuvendi merr vendime me votë, prandaj është dashur që të regjistrohen votat për, gishtat kanë qenë të ngritur 6 apo 7 gishta nuk di sa kanë qenë, kështu që kjo është dashur të regjistrohet gjithsesi në transkript. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë mendoj që kërkesa është e arsyeshme. Unë e di që transkripti është, prandaj t'u shpërndahet deputetëve. Për tjerat nuk kamë koment.

DEPUTETI BERAT LUZHA

Z. Kryetar, unë me 22 qershor kamë proceduar një pyetje parlamentare për ministrin e Punës dhe Mirëqenies sociale. Sipas rregullores në mbledhjen vijuese me 6 korrik ka qenë dashur të ipet përgjigja nga ministri, përkundrazi përgjigja nuk është dhënë, as në mbledhjen e 6 korrikut, as në mbledhjen e sotme, nuk është paraparë të futet në rend të ditës dhe nuk është dhënë asnjë shpjegim se çka u bë me atë pyetje parlamentare. Dua ta di që është një injorim total i Qeverisë ndaj Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Berat, unë mendoj që Parlamenti e mbështet kërkesën tuaj dhe e ftoj Qeverinë që t'i përmbahen rregullave dhe Rregullores, është përgjigje me shkrim apo me gojë është çështje e procedurave, prandaj po sa të arrijë do të procedohet, tash nuk është dhe po e marrim si vërejtje serioze.

Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës.

Shqyrtimi i çështjes së sigurisë në Kosovë me kërkesë të Kryesisë, fjalën e rastit për këtë e ka z. Vittrup, komisioner i policisë, foltorja është e juaja. Urdhëroni.

KAI VITTRUP, komisioner i policisë

Është transkriptuar nga përkthimi.

Z. kryeministër, ministra, deputet të nderuar, ju falënderoj për mundësinë që më dhatë që të vijë këtu dhe që të shtjelloj çështjen e sigurisë.

Para se të hyjë në diskutim në hollësi do të doja t'i theksoj disa gjëra. Nga një tetori 2004 Shërbimi Policor i Kosovës ka prirë ose ka udhëhequr, është bërë kalimi i kompetencave për 31 nga 33 stacione të policisë, d.m.th 31 stacione janë në mbikëqyre të SHPK-së, po

ashtu për 2 prej 6 rajoneve po ashtu janë bartur tek policët vendor. SHPK-ja, njësia për mbrojtje tani është duke i ofruar shërbimet e saja për zyrtarë të lartë, institucional, vendor dhe ndërkombëtar. Me 6 shtator të këtij viti do të festohet 6 vjetori i themelimit të SHPK-së. SHPK-ja e ka arritur një nivel të profesionalizmit që dukej i pamundur para 6 viteve. Duke ju falënderuar juve, angazhimit të institucioneve të ndryshme dhe vetë pjesëtarëve të Shërbimit. Jam mirënjohës për arritjen e deritanishme. Nëse i hedhim një vështrim gjendjes ekzistuese të sigurisë, mund të vëreni se gjatë muajve të fundit Shërbimi Policor i Kosovës dhe institucionet vendore lokale dhe qendrore kanë ndihmuar në mbrojtjen e veprimeve nga grupe të ndryshme kriminale duke shkaktuar edhe plagosjen e pjesëtarëve të policisë, duke përfshirë një polic ndërkombëtar, po ashtu janë marrë në shënjestër objekte të ndryshme, me që rast janë shfrytëzuar mjete shpërthyes, madje edhe në qendër të qytetit, gjë që do të mund të shpinte në vdekjen e qytetarëve.

Popullata vendore duket se nuk i mbështet grupet e paligjshme. Qëllimi i këtyre grupeve që të destabilizoj organizatat legjitime kosovare dhe ndërkombëtare para fillimit të negociatave për statusin përfundimtar të Kosovës. Kanë qenë rreth 20 incidente me peshë apo që kanë pasur peshë nga një janari e deri më tani. Në bazë të këtyre të dhënave mund të them se është vlerësim i imi se ambienti i përgjithshëm për sa i përket sigurisë është stabil në Kosovë. Mirëpo, më duhet të them se kërcënimi kundër agjencioneve për zbatimin e ligjit të SHPK-së dhe të policisë së UNMIK-ut do të merren me seriozitet. Janë krijuar disa grupe punuese për kryerjen e hetimeve për t'i parandaluar veprimet e atyre grupacioneve, veçanërisht njësia që merret me korrupsion duke hulumtuar rastet e korrupsionit si në nivel qendror, gjithashtu edhe në vendet tjera në përpjekje për t'i gjetur ata të cilët e keqpërdorin pozitën e tyre. Shërbimi është duke bërë çmos për t'i sjellur para drejtësisë ata kriminel. Bashkëpunimi është unisuar ndërmjet policëve vendor dhe organizmave ndërkombëtar, mirëpo nevojitet që popullata vendore dhe mediat t'i kyçen kësaj ndërmarrje duke mbështetur Shërbimin policor dhe duke raportuar çdo aktivitet të dyshimtë gjatë përpjekjes për t'i gjetur ata kriminel.

Dhe në mbështetje të vlerësimit tim do ta lexoj një komunikatë shtypi nga SHPK-ja dhe policia e UNMIK-ut që i është dërguar shtypit këtë mëngjes.

Të martën me 9 korrik 2005 policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja kanë kryer hulumtime në disa lokacione në rajonin e Prishtinës duke konfiskuar disa kompjuter dhe disa pajisje tjera të punës në përpjekje për të luftuar korrupsionin. Kjo është bërë me urdhrin e komisionarit të policisë Kai Vitro dhe ishte ndërmarrja e parë e këtij lloji që përpiqet të luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin, pritet të kryhen hetimet.

Pra kjo është komunikata për shtyp e cila komunikatë për herë të parë lexohet para Kuvendit. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit z. Komisionar. Më lejoni që para se të hapi debat një informatë. Në propozimi të Grupit parlamentar të LDK-së Kryesia e Kuvendit e ka radhitur në rend dite

debatin për çështje të sigurisë. Me qëllim të përgatitjes së një debati të frytshëm dhe konstruktiv, Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm z. Petersen, që në frymën e bashkëpunimit të ngushtë në mes UNMIK-ut dhe Kuvendit të Kosovës, përgjegjësit nga fusha e sigurisë para deputetëve të paraqesin informatë për gjendjen e sigurisë në Kosovë, prandaj e ftoj shefin e Grupit parlamentar të LDK-së z. Gashi që ta merr fjalën.

DEPUTETI ALUSH GASHI

I nderuari z. Kryetar, kryeministër dhe kabinet qeveritar, të çmuar zonja dhe zotërinj, ju vëzhgues dhe mysafir të nderuar. Duke shprehur respektin për të gjithë ju më lejoni të shtoj se jam shumë i privilegjuar t'ju drejtohem në emër të Grupit parlamentar të LDK-së i cili edhe kërkoj që çështja e sigurisë të debatohet në seancë plenare. Kërkesë e cila hasi në mbështetje dhe mirëkuptim edhe te të tjerët, me shpresë se debati edhe dialogu do të vazhdoj. Z. Kryetar, siguria në Kosovë nuk është fjalë magjike por përkushtim institucional i cili duhet të mbikëqyret nga Kuvendi. Lidhja Demokratike e Kosovës e ka synim shtetësinë e Kosovës, një Kosovë të pavarur dhe demokratike me barazi, prosperitet dhe siguri për të gjithë shtetasit e saj. Kosovë që do të zhvilloj raporte bilaterale dhe multilaterale me fqinjësi dhe më gjerë. Për të arritur këtë në mes tjerash Kosova duhet t'i ketë të gjitha institucionet e sigurisë si vendet tjera demokratike. Është koha e demistifikimit se çka duhet zhvilluar në lëmin e sigurisë, kur tani është një bërthamë e policisë. Përgjigja është se duhet zhvilluar e tërë spektrin civil dhe të uniformës, sistemin e zbulimit dhe kundërzbulimit, por duhet vazhduar edhe me ngritje të nivelit të policisë aktuale.

Kjo veprimtari është tejet serioze që të mbahet me kurse disa mujore dhe trajnime të kohëpaskohshme. Është lëmi e cila kërkon dituri multidisiplinare, e në dituri duhet investuar zonja dhe zotërinj, kështu që kërkojmë që sa më parë të themelohet academia e policisë dhe e sigurisë, natyrisht edhe me programe posuniversitare nga kjo lëmi. Sa i përket bartjes së kompetencave vendorëve kjo çështje është vonuar dhe banalizuar shumë. Se sa janë efikase organet tranzitore të sigurisë pa kompetenca të vendorëve më së miri mësohet nga raporti për Kosovën i përpiluar nga ambasadori Kai Aide në vitin 2004, me gjithë atë ndoshta nuk është e tepërt të ripërsëritet se duhet bërë transferim i plotë i të gjitha përgjegjësive. Ne angazhohemi dhe do të mirëpresim vazhdimin e raporteve korrekte të mbështetjes ndërkombëtare për zhvillim dhe të mbikëqyrjes eventuale si në vendet e tjera të tranzicionit.

Në vendet me demokraci të konsoliduar ashtu edhe tek ne, policia dhe shërbimet e policisë janë me rëndësi të posaçme. Andaj është i domosdoshëm institucionalizimi i transparencës dhe përgjegjësisë institucionale si dhe garantimi i qasjes së qytetarëve në shikim se si zhvillohet veprimtaria. Me zhvillim të demokracisë në Kosovë, dita ditës, qytetarët do të kërkojnë transparencë të plotë në veçanti për segmente të shoqërisë të cilat paguhen nga taksa të mbledhura nga qytetarët, siç është rasti me polici, mu për atë se keqpërdorimet në polici apo nga policia nuk janë vetëm çështje e brendshme e policisë, por edhe e qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre. Andaj Parlamenti, Qeveria, Gjyqësia dhe qytetarët kanë të drejtë dhe obligim t'i mbikëqyrin organet e sigurisë. Parlamenti miraton

ligje për polici dhe organe tjera të sigurisë si dhe përcakton dhe mbikëqyr buxhetin. Mbikëqyr punën e dëshmitë të mbyllura apo publike, në bazë të ankesave të qytetarëve, siç është rasti i torturës dhe sjelljeve tjera brutale në polici dhe burgje. Pra, monitoron respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Qeveria bën mbikëqyrjen ditore të ekzekutimit të detyrave përkatëse të organeve të sigurisë dhe së fundi, gjyqësori monitoron dhe ndërmer masa me rastin e shkeljes së ligjit nga ana e policisë dhe organeve të tjera të sigurisë. Vend të posaçëm ka angazhimi i qytetarëve dhe medimeve.

Mbikëqyrja demokratike e organeve të sigurisë kërkon krijim të besimit dhe mirëkuptimit në mes të Komisionit parlamentar dhe policisë. Krijimi i raporteve korrekte është esencial për sukses. Zonja dhe zotërinj më lejoni që në fund t'ju ofroj këto rekomandime dhe përfundime:

1. Është i domosdoshëm vazhdimi i investimit në polici në ngritje dhe plotësim të sistemit të sigurisë,
2. Themelimi i Akademisë së policisë dhe sigurisë,
3. Të vendoset se cili komision parlamentar do të bëj mbikëqyrjen, dhe komisioni përkatës parlamentar të filloj dëshmitë për të kuptuar gjendjen në strukturat e sigurisë si dhe përmbajtjen e ministrive që do të merren me siguri.
4. Parlamenti të intensifikoj dialogun në strukturat ndërkombëtare të cilat do të jenë në mbështetje të zhvillimit të organeve të sigurisë.

Dhe në fund, qëndrueshmëria e sigurisë në Kosovë më së miri garantohet me njohje të së drejtës për vetëvendosje dhe respektimit të qytetarëve të Kosovës që për shumicën absolute është pavarësia. Praktikisht pa pavarësi nuk ka siguri të qëndrueshme në Kosovë.

Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, z. Hashim Thaqi.

DEPUTETI HASHIM THAQI

I nderuari z. Kryetar. I nderuari z. Kryeministër, kryeministra, të nderuar zotërinj deputet, i nderuari z. Vittrup, ju përsbëndes të gjithëve në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

U desh të iniciohej nga forumi politik çështja e sigurisë, që peshën dhe përgjegjësinë e saj ta kuptoj edhe Parlamenti i Kosovës. Prandaj sot kemi mundësinë që të debatojmë për këtë problematikë. Çështja e sigurisë është një aspekt shumë i rëndësishëm apo më mirë të themi thelbësor në mbarëvajtjen dhe seriozitetin e procesit të plotësimit të standardeve, definimit të së ardhmes politik të vendit për ndërtimin e një shoqërie të lirë, tolerante të bazuar në vlerat demokratike.

Krijimi i ambientit të sigurtë për jetë për të gjitha etnitetet në tërë territorin e Kosovës, lëvizja e lirë e qytetarëve si element bazë i respektimit reciprok dhe sigurisë minimale fizike, ambienti i sigurt i qytetarëve, luftimi i krimit ekonomik dhe në tërësi krimit të organizuar, parandalimi i veprave të rënda të krimeve serioze dhe zbulimi i kuotave më të larta të ekzekutuesve të tyre, janë element më thelbësor në listën e prioriteteve tona si shoqëri dhe si institucione. Gjithashtu zbulimi, përkatësisht identifikimi dhe parandalimi i pistave të rrezikshme ekstremiste dhe terroriste me orientime kundër Kosovës dhe prezencës së Bashkësisë Ndërkombëtare në Kosovë, duhet të jenë një angazhim i përhershëm i të gjitha institucioneve Kosovare dhe qytetarëve, mekanizmave ndërkombëtar në Kosovë. Njëherit shprehi falënderim për përkushtimin e KFOR-it për ruajtjen e sigurisë në Kosovë dhe përkushtimin e Shërbimit Policor të Kosovës dhe atyre të UNMIK-ut.

Të nderuar deputet, ka 6 vite siguria jo rrallë ka qenë shqetësim dhe temë familjare në përditshmërinë e familjeve kosovare. Qindra akte dhune, dhjetëra vrasje të rënda e të pazbuluara apo të zbuluara e të paekzekutuara nga mekanizmat policor, shpërthime, bomba në kryeqytet, djegie misterioze, paraqitje të disa organizatave fantome me apo pa adresë, shumë kërcënime dhe aq më shumë misteriozitet të rëna prapa tyre, të përcjellura me qindra manipulime dhe keqpërdorime për qëllime përfitimesh materiale e politike, janë pjesë e errët e këtij realiteti tragjik në Kosovë që duhet të ketë një përgjegje dhe fund të merituar. Fatkeqësisht duhet konstatuar se reagimet institucionale në veçanti të segmentit përgjegjës për siguri në kuadër të UNMIK-ut ka qenë jo adekuat. Reagimet politike vendore nga forca të caktuara politike, më tepër kanë qenë nxitëse dhe tendencioze në raste të caktuara për qëllime akuzash dhe përfitime elektorale se sa që i kanë kontribuar klimës dhe qetësisë së situatës apo luftimit real të fenomeneve të tilla.

Zonja dhe zotërinj. Në të ardhmen e afërt do të hyjmë në proces politik që për qytetarët e Kosovës përmbyll kapitullin historik të ndërtimit të shtetit të Kosovës. Kosova si tërësi gjeografike me mentalitet dhe kulturë është pjesë e qytetërimit perëndimor me pretendime për plotësimin e standardeve demokratike që mundësojnë demokratizimin dhe integrimin e vendit. Standardet janë përkushtim dhe interes i vetë qytetarëve dhe nuk lejohet kjo çështje me presione mujore të plotësimin të tyre, por që lidhet me logjikën e ndërtimit të shtetit demokratik të qytetarëve të Kosovës. Situata fragile e sigurisë, pakënaqësitë e thella sociale të qytetarëve, përbindja e popullatës në varfëri ekstreme, papunësia me kuota jonormale të rritjes dhe nëse marrim në konsiderat moszhvillimin ekonomik dhe veprimet negative të qeverisjes aktuale atëherë nuk është vështirë të konkludojmë se vërtetë jemi në një situatë shumë serioze dhe kërkon rrugëzgjdhje.

Të nderuar deputet. Përgjegjësia dhe përgjegjshmëria do të jenë pjesë e rëndësishme e procesit në vendimmarrje dhe implementimin e suksesshëm të prioriteteve tona të përbashkëta. Kjo mund të arrihet me përkushtim dhe njerëz serioz, por jo në këtë mënyrë dhe jo me një qeverisje të tillë. Toleranca ndaj krimit në emër të ruajtjes nga kërcënimet e stabilitetit në Kosovë, përbën dobësim të ligjit para joligjshmërisë. Është momenti i fundit që t'i jepet kahje e kundërt, askush dhe asgjë nuk guxon të jetë pengesë e procesit politik historik të vetëvendosjes së qytetarëve të Kosovës.

Sfidat e problemeve të ballafaqimeve dhe të kompromiseve politike duhet të kenë bazën e të kuptuarit dhe përkrahjes qytetare si garant kryesor i implementimit të çfarëdo lloj marrëveshje që i hap perspektiv vetëvendosjes së qytetarëve të Kosovës. PDK-ja do të vazhdoj rolin e vetë opozitar ndaj koalicionit aktual qeveritar dhe ndaj këtij realiteti të hidhur. Nuk ka asnjë pretendim dhe as që do të pranoj ndonjë ofertë për futjen në koalicion të gjer bashkëqeverisës siç ka pëshpëritje kohëve të fundit nga mekanizmat e caktuar vendor dhe ndërkombëtar. PDK-ja do të punoj fuqishëm në shërbim të procesit politik që do të determinoj të ardhmen sovranë të vendit, si forca më e madhe opozitare duke kryer obligimet dhe përgjegjësitë që kemi ndaj elektoratit në frymën e kërkesave gjithëqytetare, lavdisë së luftës çlirimtare dhe idealit të dëshmorëve të lirisë. Nevoja për t'i implementuar standardet sot, ndërsa nesër për të marrë vendime politike na shtyn edhe më shumë që të ndërtojmë përkrahjen gjithëqytetare. Nuk guxojmë të futemi në proces me një situatë të tillë aktuale, improvizimesh dhe manipulimesh politike me moral të dyfishtë. Morali i dyfishtë i deklarimeve dhe veprimeve politike është një përkujtim i hidhur i epokave të marginalizuara komuniste. Futja në procesin e vendosjes së statusit politik në garën banale verbale shpesh krijohen përshtypje e gabuar se nuk është sovran një popull ai i cili përcakton veprimin tonë politik, por kërkesa legjitime për pavarësi është qëndrim lideri.

Të nderuar deputetë, papërgjegjshmëria dhe pa gatishmëria për tu marrë me çështjen dhe për të pranuar përgjegjësitë nuk mund të kompensohen me proklamime formaliste për pavarësi. Kompleksi i impotencës politike nuk mund të kompensohet me deklarime të papërgjegjshme politike. PDK-ja do të ofrojë platformën dhe strategjinë konkrete për status politik dhe do të kërkojmë konensus gjithë kosovarë për vizionin e saj, për shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës. Stabilitetin e brendshëm nuk mund ta kërkojmë pa ndodhur paraprakisht distancimi i qartë i strukturave aktuale qeveritare nga elementët e kriminit të organizuar e deri më sot kjo nuk ka ndodhur. Kjo ka ndikuar që vendi ynë të ketë varfërinë sociale në nivelin e kuotave maksimale, papunësinë në nivelin më të lartë Evropian, përkujdein për pensionistë në nivelin më të ulët në rajon. Keqpërdorimet e buxhetit po i kushtojnë procesit të edukimit, shëndetësisë, përkujdesjes minimale për invalidët e luftës dhe të punës.

Të nderuar deputetë, me institucione të tilla statusi i Kosovës jo që do të jetë i kushtëzuar por qysh sot është i kërcënuar. Nuk mund të zgjidhet drejt statusi politik i Kosovës me qeverinë më të korruptuar në rajon. Jo vetëm që po keqpërdoret vullneti i qytetarëve, por kështu po frikësohen edhe miqtë tanë ndërkombëtarë. Pa përgjegjshmëria e qeveritarëve duhet të trokas në ndërgjegjen e tyre morale, nëse vazhdon të tolerohet nga UNMIK-u që të ballafaqohet me sistemin e drejtësisë. Standardi i parë duhet të jetë përgjegjshmëria institucionale ndaj qytetarit, korrektësia politike në mes premtimit elektorale dhe realizimit praktik. Për të konkluduar, të nderuar deputetë, PDK-ja propozon këto rekomandime:

1. Ngritjen sa më të shpejtë të një komisioni të përbashkët vendor dhe ndërkombëtar për çështje të sigurisë, që do të punonte në identifikimin e problemeve kryesore të sigurisë në Kosovë, ngritjen e nënkomisioneve politike dhe profesionale në të njëjtën kohë.

2. Formimin e ministrisë së rendit dhe drejtësisë, jo nën kontrollin e këtij apo atij subjekti politik, por në shërbim të të gjithë qytetarëve me udhëheqje profesionale dhe konsensuale. Akademia policore është e formuar dhe funksionon në Vushtrri.
3. Krijimin e fondit të veçantë për kthimin e refugjatëve nëpër shtëpitë e tyre, krijimin e një Fondi nga Qeveria e Kosovës.
4. Krijimin e një projekti ad-hoc së bashku me autoritetet lokale të Komunës së Mitrovicës dhe ndarjen e një fondi të veçantë nga Qeveria e Kosovës për rikthimin e refugjatëve në të dy anët e qytetit në Mitrovicë, për rindërtimin e shtëpive të shkatërruara dhe veçanërisht për rihapjen e spitalit të Mitrovicës për të gjithë qytetarët, të fakultetit dhe të shkollave të mesme.
5. Ndërtimin e një lagjeje të urbanizuar të romëve në pjesën më të përshtatshme të Mitrovicës e jo rrezikimin e tyre buzë lumit Ibër, ku kushtet e jetesës edhe ashtu janë të rënda.
6. Implementimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve, rikthimin e besimit, programin e veçantë në mes të etniteteve nga Qeveria dhe integrimin e minoritarëve.

Të nderuar deputetë, PDK-ja ka kërkuar debat edhe më heret për çështjen e sigurisë. Pavarësisht monopoleve të krijuara nga mbivotimet teknike aktuale në Parlamentin aktual, do të ngritën edhe shumë gjëra të tjera që sot po dëmtojnë perspektivën qytetare që ka arritur nivelin më të lartë të varfërisë dhe krizës sociale. Të gjitha këto keqpërdorime është e qartë se bëhen nga zyrtarët aktualë qeveritarë dhe ju shërbejnë vetëm interesave të ngushta klanore brenda institucioneve qeveritare.

Një gjendje e tillë është e patolerueshme dhe ne duhet t'i japim fund të gjithë së bashku. Prandaj ju ftoj për solidaritet kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar e të instaluar në Qeverinë e Kosovës, të gjithëve pa dallime partiake, në mënyrë që të ndërtojmë sa më parë shtetin demokratik të Kosovës me institucione funksionale, sundim të ligjit dhe demokraci qytetare. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT Daci:

Radhën e ka Naim Maloku në emër të Aleancës, kurse le të përgatitet z. Surroi.

DEPUTETI NAIM MALOKU

I nderuari z. Kryetar, kryeministër, i nderuari z. Komisionar, kolonel Sheremet Ahmeti, të nderuar deputetë dhe të pranishëm të tjerë.

Grupi parlamentar i AAK-së e mirëpret debatin e sotëm në Kuvendin e Kosovës me temën mbi sigurinë në Kosovë si një prej çështjeve më të rëndësishme dhe më me ndikim të drejtpërdrejtë në të gjitha segmentet e funksionimit të shtetit dhe të shoqërisë. Më lejoni që në fillim të shprehim mirënjohje në emër të Grupit parlamentar dhe të partisë së AAK-së të pjesëtarëve të policisë së UNMIK-ut për angazhimin e tyre në të mirë të sigurisë së qytetarëve të Kosovës në këto 6 vite të kaluara, shprehim keqardhje për të gjithë ata pjesëtarë që humbën jetën gjatë shërbimit në Kosovë, mirënjohje të gjithë

pjesëtarëve të SHPK-së të cilët me gjithë se në kushte të vështira materiale dhe pa kompetenca të mjaftuara po bëjnë të pamundurën që niveli i sigurisë në Kosovë të jetë në rritje dhe keqardhje për policët e rënë në kryerje të detyrës për këto 6 vite në Kosovë, mirënjohje dhe falënderim të veçantë të gjithë pjesëtarëve të KFOR-it të cilët shërbyen dhe po shërbejnë për të mirën e Kosovës dhe sigurisë së qytetarëve të Kosovës dhe qytetarëve të rajonit, keqardhje për të gjithë ushtarët e KFOR-it të rënë në kryerje të detyrës në këto 6 vite të kaluara.

Të nderuar deputet, para 6 viteve Kosova doli nga një konflikt i tmerrshëm me pasoja të rënda të shprehura në humbje të jetërave, tortura nga më të ndryshmet dhe shkatërrime materiale që i pësuan qytetarët e saj. Detyrimisht kaluam në fazën e postkonfliktit e cila karakterizohet me dukuri negative dhe kriminale në rritje dhe të shprehura në forma dhe mënyra të ndryshme, zakonisht të ashpra. Pavarësisht nga kjo dhe nga fakti se Kosova ishte pa polici të veten, rolin dhe përgjegjësinë e së cilës e mori policia e UNMIK-ut në përbërje të së cilës hyjnë pjesëtarë nga më shumë se 50 vende të botës, me kultura gjuhë dhe përvoja të ndryshme, ne kemi arsye të shprehim brengosjen tonë për mosefikasitetin dhe papërgjegjësinë, veti këto që e karakterizuan këtë polici në përballje me të gjitha llojet e krimit në 6 vitet e kaluara në Kosovë.

Të gjitha vrasjet e ashtuquajtura enigmatike të ndodhura pas luftës dhe të mbetura të pazbardhura, atentate dhe tentatentate në pikë të ditës dhe të gjitha të mbetura të pazbuluara, të gjitha shpërthimet në Prishtinë apo vendet e tjera të ndodhura pas luftës të mbetura ende në hetime, duke mos identifikuar as pistat nga të cilat janë kryer dhe as motivet. Mbyllja e syve ndaj dukurisë së prostitucionit dhe trafikeve të qenive njerëzore për ushtrimin e kësaj veprimtarie qoftë në Kosovë apo duke e përdorur Kosovën si transit. Mosndërmarrja e hapave dhe veprimeve të duhura në shuarjen apo zhbërjen e strukturave paralele në veri të Kosovës e që do të jenë sipas mendimit tonë me pasoja shumë të rënda për siguri në Kosovë, e posaçërisht tani në fazën e vlerësimit përfundimtar të përmbushjes së standardeve si dhe në fazën e procesit të definimit të statusit përfundimtar të Kosovës, janë disa nga faktet e pamohuara. Të nderuar deputet, fakte këto të cilat mjaftojnë që qytetarët e Kosovës të jenë të shqetësuar për gjendjen e sigurisë dhe ne e ndajmë shqetësimin me ta.

Të nderuar deputet, ne mendojmë që në mënyrë të përshpejtuar duhet të bëhet bartja e kompetencave në sferën e drejtësisë dhe të rendit të institucionet e Kosovës, duke konsideruar se Kosova ka kapacitete të mjaftuara profesionale për të marrë fillimisht përgjegjësinë në ngritjen e këtyre dy ministrive, por mendojmë se duhet një qasje më serioze ndaj këtij procesi dhe propozojmë që:

1. Komisioni funksional për ministrinë e rendnit të jetë Komisioni për Gatishmëri Emergjente ekzistues në Kuvendin e Kosovës, ofrojmë gatishmërinë tonë për marrëveshje me të gjitha grupet parlamentare në Kuvend për zgjerimin e kompetencave të këtij Komisioni, riemërtimin e tij, ristrukturimin e tij, pasi që aktualisht AAK-ja e kryeson këtë Komision shprehim gatishmërinë tonë që me marrëveshje të heqim dorë nga vendi i kryesuesit në favor të një grupi parlamentar tjetër.

2. Të fillon sa më shpejtë trajnimi i Komisionit nga ana e OSBE-së dhe mbështetësve tjerë të Kuvendit në ushtrimin e kompetencave të reja, të bëhen vizita të ndërsjella me komisionet homologe të parlamenteve të ndryshme me qëllim të marrjes së eksperiencave të nevojshme për kontrollin mbi Ministrinë e ardhshme të rendit. Komisioni parlamentar duhet që të jetë i gatshëm me ushtrimin e këtyre kompetencave para se të bëhet emërimi i ministrit të rendit në Kuvendin e Kosovës.
3. Qeveria e Kosovës duhet që në afat sa më të shkurtër të formon grupin e ekspertëve të fushës së sigurisë me qëllim të hartimit të programit të punës të kësaj Ministrie deri në fund të mandatit dhe atë të ndarë në faza tri mujore dhe i njëjti t'i dorëzohet Kuvendit për miratim para se të bëhet nominimi i ministrit. Mendojmë se SHBA -ja dhe BE-ja përmes ekspertëve të kësaj lirie duhet të kenë rol të fuqishëm monitorues dhe këshillues edhe për një periudhë të pa caktuar kohore deri në përfundim të procesit të ngritjes së mekanizmave profesional të sigurisë dhe të gjitha segmenteve profesionale brenda ministrisë së rendit.

Zonja dhe zotërinj deputetë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës distancohet fuqishëm dhe në mënyrë të vendosur nga veprimtaria ilegale e të ashtuquajturave shërbime inteligjente partiake apo klanore në Kosovë. Duke konsideruar këtë veprimtari si shumë të rrezikshme me pasoja të paparashikuara negative në stabilitetin politik në Kosovë. Mendojmë se është i domosdoshëm formimi i një mekanizmi të tillë të sigurisë të kontrolluar nga Kuvendi i Kosovës i financuar në mënyrë legale nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, ofrojmë bashkëpunim në këtë drejtim.

Dhe krejt në fund më lejoni të them se Grupi parlamentar i AAK-së mirëpret një debat konstruktiv dhe ofruet që qon në bashkëpunim të të gjithëve në ndërtimin e rendit dhe të sigurisë në Kosovë, në të kundërtën mendojmë se qëndrimi në sallë kishte me qen i mundimshëm për ne. Ju faleminderit për vëmendjen.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit z. Surroi, kurse le të përgatitet z. Jakxhillar.

DEPUTETI VETON SURROI

Të nderuar zonja dhe zotërinj. Edhe unë kamë pritur që pas ngritjes në forum të sigurisë kjo çështje të trajtohet si shumë serioze, si në forum po ashtu edhe në Parlamentin e Kosovës, për fat të keq për shkak të përgatitjes së kësaj mbledhje shof se e prekim një temë kaq të rëndësishme në mënyrë sipërfaqësore, e kjo temë është aq e gjërë sa që do të konsumonte disa ditë debat.

Sfidat e sigurisë mund të ilustrohen në pika të ndryshme. Ta marrim p.sh një pikë justifikuese: Themi se këto ditë do të ndodhte një arrestim lidhur me aktivitet kriminal të shpërthimeve, të themi se janë mbledhur edhe provat për një gjë të tillë dhe të themi se kjo çështje do të duhej të kishte ndodhur në gjysmën e parë të muajit korrik, të themi për

një moment se iniciativa për të bllokuar një arrestim të tillë kishte ardhur nga një nivel politik, për ne që gjendemi jashtë mendojmë shumë gjëra tjera, por nuk kemi dituri të përditshme, e nuk e kemi sepse është ndërtuar me vite të tëra kultura e mosndërlidhjes me çështjen e sigurisë, nuk ekziston transparenca në formën e sigurisë për shkaqë objektive dhe për këtë ne si qytetar nuk mund të dijm. Themi se bllokimi i atij arrestimi është bërë sepse gjendemi në fazën përfundimtare të raportit të Aides, sepse mund të lëkundet apo jo qeverisja, koalicioni qeverisës, të gjitha këto presupozime janë në fakt implikim i drejtpërdrejtë i politikës me siguri dhe politika, është e lidhur me siguri dhe prandaj po debatohet sot lidhur me çështjen e sigurisë, po mos të kishte qen e lidhur ne do t'i kishim pasur ndryshe punët. Në qershor dhe korrik të vitit 1999 kamë qenë vetë dëshmitarë. Kosova është nisur nga një rrugë tjetër e sigurisë, ndërsa ka pasur një ofertë që fillimisht së paku 500 apo 600 polic komunikacioni, ish polic komunikacioni të Kosovës të marrin një kontratë dhe të hyjnë në shërbim si polic komunikacioni, për fat të keqë ka ekzistuar mungesa e vullnetit politik dhe marrëveshjes politike në mes liderëve shqiptar dhe jemi në një fazë ku është dashur të trajnohen me vite të tëra edhe policët tonë të komunikacionit. Gjatë këtyre viteve ne kemi pasur edhe dy fenomene. Fenomeni i parë është ajo që quhet siguri e fortë që do të thotë ushtarake, ruajtja e kufirit ka funksionuar në formë të shkëlqyeshme. NAT-ja gjithmonë gjendet në listën e popullaritetit, përdesia siguria e brendshme gjithmonë ka qenë jashtëzakonisht e dobët, ka qenë e dobët sepse në asnjë vend të botës polici i huaj nuk mund ta njeh realitetin e brendshëm, i duhet një kohë e gjatë dhe për këto 6 vite ne kemi pasur procesin ku nga njëra anë policia e UNMIK-ut nuk ka mundur të krijoj tërësinë e sigurisë në Kosovë, e nga ana tjetër duke pritur ngritjen e numrit të pjesëtarëve të SHPK-së dhe t'ju rikujtoj se Kosova ende nuk e ka përmbush numrin e pjesëtarëve të SHPK-së për të cilët ka nevojë, do të thotë se ne kemi jetuar në një zbrastësirë sigurie e cila i ka implikimet e veta në jetën tonë të përditshme.

Implikimi i parë ka qenë se në këtë zbrastësi kanë hyrë forma tradicionale të ruajtjes së sigurisë, formë tradicionale është familja e fortë, ti nuk më nguc mua, unë nuk të nguci ty dhe me kaq ka përfunduar çështja e sigurisë.

Forma e dytë ka qenë ajo e politikës, apo e politikës së armatosur dhe për këto 6 vite kemi parë se si njeriu duhet të jetë i armatosur nëse donë të mbroj pasurinë e tij. Implikimi i tretë është që në Kosovë është krijuar kultura e mosndëshkimit. Qytetarët ndiejnë se t'i mund të bësh çdo gjë, por nuk do të ndëshkohesh nga ligji sepse nuk ekzistojnë struktura të cilat do të ndëshkojnë. Kjo kulturë e mosndëshkimit do t'i kushtoj Kosovës shtrenjtë me vite të tëra, do të duhet vite të tëra ta ndërroj. Po për çka po flasim ne në siguri, siguria nuk mund të jetë e shkëputur nga nocionet e ndërtimit të shtetit. Kosova nuk mund të lavdërohet për çështjen e sigurisë, ndërsa ndërkohë nuk ka bërë shumë në ndërtimin e shtetit të së drejtës. Kosova nuk udhëhiqet nga ligji zonja dhe zotërinj, Kosova nuk e ka sistemin e vetë kushtetues juridik, në mungesë të sistemit kushtetues juridik të unifikuar, ekziston interpretimi politik i Ligjit, pra edhe interpretimi politik i sigurisë dhe kjo është gjendja ku gjendemi sot. Me sa mbaj mend unë koalicioni qeverisës kishte premtuar jo në fushatë por edhe mbasi që e morri pushtetin se për 6 muaj çështja e kushtetutës dhe e ligjeve do të përfundonte, me këtë ritëm jo për 6 muaj por as

për 6 vite të ardhshme nuk do të mjaftojnë as për kushtetutë e as për ligje dhe Kosova nuk do të sundohet nga ligji.

Në mungesë të sistemit kushtetues juridik Kosova ka sisteme paralele, kushtetues e juridike dhe në ato sisteme paralele të cilat janë edhe paralele etnike, pra një pjesë e territorit nuk administrohet as nga ligjet Kosovare e as nga të UNMIK-ut, kemi sisteme paralele të sigurisë, sisteme paralele shqiptaro-serbe, por edhe sisteme paralele në relacionet brenda shqiptar, ne kemi struktura paralele të sigurisë dhe ato me siguri e kanë pasur nevojën e vetë në kohën kur janë formuar, por ato sot janë në fakt pjesë e rëndësishme e dëmtimit të sigurisë së qytetarëve të Kosovës apo mund të jenë kërcënim për atë çështje. Çështja e katërt që ka të bëjë me sigurinë dhe që ka ndikuar drejtpërsëdrejti në pasigurinë e qytetarëve ka qenë mosdefinimi i pronës dhe i pronësisë. Në mungesë të formimit të relacioneve të drejta dhe ligjore në marrëdhëniet ekonomike ne kemi pasur politizim të pronës publike apo uzurpim të saj, administrim revolucionar të ndërmarrjeve dhe kemi pasur qartazi në këtë zbrastësirë ligjore edhe impenjim të fortë të kontrabandës, të krimit të organizuar të evazionit fiskal. Çështja e pestë, çështja e marrëdhënive ndëretnike ka ndikua seriozisht në çështjen e sigurisë dhe pse mos ta themi fillimisht me përndjekjen e minoriteteve në Kosovë që nga qershori i vitit 1999, nuk ka qenë vetëm përndjekja e serbëve, ka qenë përndjekja e romëve, ashkalinjëve dhe minoriteteve tjera, një çështje që fatmirësisht është tejkaluar në këto vite, por kanë mbetur pasojat, e pasojat janë edhe krijimi i sistemeve paralele nga ana e Serbisë në Kosovë. E kemi çështjen e gjashtë, e cila do të ndikoj, ka ndikuar në çështjen e sigurisë e ajo është korrupsioni i cili tashmë është shndërruar në kulturë në pjesë të kulturës qeverisëse në Kosovë dhe si i tillë është rrënim total i digave morale të cilat duhet të ekzistojnë për të krijuar një atmosferë më të sigurtë. Por të kthehemi në fillim dhe kjo është pika e fundit. Në mungesë të marrëveshjes politike dhe prandaj është me rëndësi që të ndërtohet një koncensus rreth kësaj, nuk do të ketë përparim në çështjen e sigurisë. Nëse shkojmë në kalim të kompetencave e jemi të gjithë për në këtë Kuvend, në gjendjen çfarë jemi sot do të inkuadrohen të gjitha ato aspekte negative të jetës sonë politike dhe të sigurisë në Ministrinë tonë të brendshme dhe në Ministrinë e Drejtësisë. Kosova do të integroj konfliktin politik brenda atyre ministrive dhe ajo çka do të ndodh është se qytetarët do të ndihen më të pasigurt sepse në to do të inkuadrohen konfliktet politike të cilat janë të panevojshme.

Unë besoj që kjo mbledhje në mos asgjë duhet të tregoj se nuk po mendohet për çështjen e sigurisë sepse po të ndodhte e kundërta, ne sot këtu do të dëgjonim për vizionin e Qeverisë që ka në transferin e kompetencave, një program detaj të transferimit të kompetencave, një buxhet detaj të atij transferi të kompetencave. Ne mund ta kemi vullnetin më të mirë në këtë Kuvend që të gjitha kompetencat, por siç do të na informoj ministri i financave nuk ka para në atë buxhet që do të konsumoj ato transfere. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Na ka mbetur edhe Mahir Jakxhillar në emër të Grupit 6+, urdhëroni

DEPUTETI MAHIR JAKXHILLAR

Sayın Başkan, Sayın Hükümet temsilcileri, Değerli milletvekilleri

6+ Parlamento gurubu adına Kosova'daki güvenlik durumuyla ilgili tartışmaların yapılması girişimini selamlarken, bu tartışmanın Kosova'daki güvenlik durumunun düzelmesine katkıda bulunacağına umut etmekteyiz.

Yurttaşların güvenliği ile durumun stabil olması, her devletin gelişmesinin temelini oluşturmaktadır. Kosova'nın durumunda ise bu oldukça daha belirgindir, çünkü şu anda Kosova, statüsün tanınmasını, standartların yerine getirilmesini ve tüm yurttaşlarının geri dönmesini beklemektedir. Saymış olduğumuz bütün bu etkinlikler sadece güvenliğin memnun edici seviyede olmasıyla gerçekleşebilir.

6+ Parlamento gurubunda yer alan Türk ve Boşnak topluluğu açısından, bu topluluk temsilcileri için güvenliğin tehlikede olmadığını, bu topluluk temsilcilerinin bireysel güvenliğinin ise Kosova'nın tüm yurttaşlarının seviyesinde olduğunu düşünmekteyiz.

Maalesef, son bombalı saldırılar, patlayıcı maddelerin belirli yerlere yerleştirilmesi, yalan ihbarlar ile diğer suç etkinlikleri bizim yurttaşlarımızda da kendisini güvensiz hissetmesini sağlamaktadır.

Kosova'daki güvenlik durumuyla ilgili somut örneklerin yetersizliği ile istatistik verilerinin olmayışı yüzünden, bununla birlikte güvenlikle ilgili Hükümet enformasyonlarının yetersizliği nedeniyle, Kosova'daki güvenlik durumu hakkında şu an herhangi bir somut değerlendirme yapmamız imkansız.

Bizler de, Mecliste yapılacak olan bu tartışmadan sonra, Kosova'nın güvenlik durumuyla ilgili daha ayrıntılı bilgilere sahip olacağımıza umut etmekteyiz.

Kosova'daki güvenlik durumunun düzelmesi ile artırılması amacıyla, yetkili güvenlik organları tarafından gözönünde bulundurulması gereken şu uyarılarımızı dile getirmek istiyoruz:

- Yetkili güvenlik organlarının kategorileri içinde ile arasında gereken enformasyonun sağlanması,
- Güvenlik organları ile Kosova enstitüleri arasında haberleşmenin daha iyi bir şekilde gerçekleşmesi,
- Güvenlik organları ve topluluk temsilcileri ile yerel hükümet arasında gereken enformasyonun sağlanması,
- Suç işlerinin daha başarılı bir şekilde önlenmesi ile çözümlenmesi,
- Paralel ile değişik olası haberleşme hizmetlerinin ortadan kaldırılması,
- Polis Hizmetindeki uzmansal kadroların gereken şekilde yetenekleştirilmesi,
- Azınlıklar topluluğu temsilcilerine işbulma planlarının sağlanması,
- Kosovada yaşayan toplulukların dillerinde güvenlikle ilgili enformasyonların sunulması,

- Güvenlik durumu ile buna benzer etkinliklerin zaman zaman incelenmesi.

Sonunda şunu belirtmek isterdim ki, güvenlik her gelişmenin temel esası olduğu için, bu soruna özel ve sürekli önemin verilmesi gereklidir. Bu günkü tartışmayı gözönünde bulundurarak ve ileride güvenlik durumun düzeleceği ile yetkili güvenlik organlarının çalışmalarında daha faydalı olacağına umut ederek, ilginize teşekkür ediyorum.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Këtu ka përfunduar paraqitja në nivel të grupeve parlamentar. Unë do të doja t'ju propozoja një procedim të mëtejshëm, sepse janë edhe 40 deputetë të paraqitur për debat. Nën një, do të doja që kur të kemi pauzë komisioni përkatës t'i marrë propozimet e grupeve parlamentare dhe në fund të debatit, në qoftë se arrijnë t'i harmonizojnë qëndrimet, rekomandimet ose konkluzat e debatit, në qoftë se e shfajtojnë seanca plenare dhe ka një kërkesë për shkak të kufizimit në kohë të njerëzve që ushtrojnë detyra të rëndësishme për mirëkuptim që në një pjesë të këtyre vrojtimeve të grupeve parlamentare t'i komentojnë, unë do të thoja që fjalën ta marrë kolonel Sheremet Ahmeti, sepse komisionarin e dëgjuam e ne pastaj vazhdojmë me debat.

SHEREMET AHMETI, kolonel i policisë:

Z. kryetar akademik Daci, i nderuari kryeministër, ministra të nderuar, z. komesar dhe deputetë. Vërtetë e ndiej veten shumë të privilegjuar që sot gjendem para jush dhe që diskutohet një çështje me rëndësi të veçantë, çështja e sigurisë, sepse ka të bëjë me qytetarët e Kosovës, me të gjithë banorët e Kosovës. Pa dyshim që Parlamenti i Kosovës këtë çështje e ka shtruar me të drejtë se të gjitha proceset e mëtutjeshme varen nga siguria në Kosovë, andaj nëse siguria në Kosovë nuk është në nivel të duhur sigurisht edhe të gjitha proceset tjera do të ngelin. Komisarari më herët ju bëri me dije m atë se si dhe çka po bën policia sot për të krijuar një ambient të sigurt dhe të qetë në Kosovë dhe sigurisht që gjithnjë ka vend për një punë më të mirë dhe më të madhe për të gjithë ne e mbi të gjitha për policinë e cila është në Kosovë. Pajtohem me shumë sugjerime që janë bërë në kuptimin e nevojës së arsimimit të policisë së Kosovës. Realiteti është që ne jemi polici e re, një pjesë shumë e vogël e jona janë policë që kanë përvojë, por sigurisht që të rinjtë kanë nevojë për t'u arsimuar e jo për t'u trajnuar. Trajnimi është një fazë emergjente e nevojës së krijimit të institucionit, ndërsa arsimimi është një fazë e cila është afatgjatë e ndërtimit të institucionit të shëndoshë, i cili vërtet duhet të jetë efikas në veprimin e vetë. Ne besojë se kah fundi i vitit, Qendra për Trajnim në Vushtrri do të kalojë në kompetencat e policisë vendore dhe ajo do të jetë qendër e aftësimit të policëve kosovarë. Është bindje e të gjithë neve në polici që ajo duhet të mbetet shkollë e policisë, ku do të bëhet aftësimi i kuadrove të policisë Kosovare. Sepse kuadrot nuk mund t'i aftësojmë për një ditë, as për një vit, ju lutem pak është edhe 5 vite, sigurisht që duhet krijuar ekspertë të mirë, të cilët vërtetë do të ndihmojnë në luftimin e krimit dhe të krijohet siguri për qytetarët e Kosovës e ne ende nuk kemi ekspertë në atë masë çfarë duhet. Edhe policia e vendeve më të zhvilluara që kanë traditë shekullore vërtetë kanë probleme me krijimin e kuadrove. Edhe me pas ekspertë të tillë, fatkeqësisht në disa fusha ku

nevojiten ekspertë kemi braktisje nga policia e Kosovës, largimin e tyre dhe punësimin e tyre në ato vende ku ka të ardhura më të mira materiale dhe mendoj se është e gabuar, sepse nëse në polici humbim ekspertë, atëherë ne nuk mund të kërkojmë që ajo vërtetë të jetë efikase dhe që të kemi rezultate të mira.

Unë dhe komisarit e tha se ne jemi në fazën kur vërtet është duke u bërë tranzicioni. Tranzicioni në stacione policore ka përfunduar, kanë mbetur vetëm edhe dy stacione, i veriut të Mitrovicës dhe i Zubinpotokut, ndërsa gjithashtu është bërë tranzicioni i dy regjioneve dhe themelimi i një regjioni të ri të Ferizajt. Fazat e tjera të ardhshme janë duke u krijuar kushte që të ndodhin, shpresoj që shpejt do të ndodhë tranzicioni i qendrës, gjegjësisht i kryeqendrës së Kosovës me komunat e tjera të Prishtinës, çka praktikisht do të bëhet bartja e pjesës më të madhe të përgjegjësi në policinë e Kosovës dhe sigurisht që gradualisht, pavarësisht nga ajo që deri më sot ndoshta kemi mund të themi se është përgjegjësi e dikujt tjetër, prandaj gradualisht do të bien mbi supet tona, mbi vetë Kosovarët dhe Kosovarët do të ballafaqohen me krijimin e sigurisë dhe luftimin e krimit, prandaj nuk do të mund askush që të arsyetohet se kjo ka qenë e dikujt tjetër, por gradualisht do të jetë e jona dhe vetë duhet të jemi përgjegjës për të luftuar krimet dhe krijuar siguri. Në atë aspekt është e domosdoshme edhe mbështetja materiale. Ju lutem se gjendjen e policëve tanë e dini që të gjithë, mendoj se edhe parafolësit e mi e thanë atë, sepse është një gjendje vërtetë jo e mirë. Ne jemi të vetëdijshëm se buxheti i Kosovës është i kufizuar, por mendoj se edhe gjendja e tillë çfarë është për momentin, kërkon që urgjentisht të ndryshohet, ka gatishmëri, ka entuziazëm të shumë policëve dhe policeve në SHPK që t'ju shërbejnë qytetarëve, por sa do të zgjatë ajo me një gjendje të këtillë materiale. Frikohem nga kjo gjendje se në SHPK do të fillojë një kancer, i cili është i rrezikshëm në shoqëritë në tranzicion dhe në shoqëritë e pas luftës. Ju them me plotë përgjegjësi dhe jam shumë i sigurt që Shërbimi Policor i Kosovës është një ndër shërbimet më të mira në rajon, një shërbim që jam shumë i sigurt që është më pak i korruptuar se çdo polici në rajon dhe më gjerë. Por, për të mos ndodhur ajo në të ardhmen duhet mbështetur edhe materialisht, duhet ngritur bazën materiale, ka gatishmëri për t'ju shërbyer qytetarëve, kurrë dhe në asnjë moment nuk hamendemi për t'ju shërbyer qytetarëve. Në kryerje të detyrës kanë rënë 8 policë të policisë Kosovare dhe kurrë nuk na kanë hamendur këto raste për të mos u shërbyer qytetarëve dhe të jeni të sigurt se nuk do të hamendemi t'ju shërbejmë qytetarëve. Po ashtu në këtë periudhë edhe 3 policë ndërkombëtarë kanë rënë në detyrë.

Unë vërtet ju falënderoj që më keni ftuar, kjo ishte një nderë i veçantë që i keni bërë vetvetes, sepse policia e Kosovës është e vërtetë që është pjesë e UNMIK-ut, por ne jem bijtë e Kosovës dhe Kosovarëve dhe ju shërbejmë juve përfaqësues të popullit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kolonel, ju faleminderit për komentet. Fjalën e ka znj. Nekibe Kelmendi, kurse le të përgatitet Sabri Hamiti .

DEPUTETJA NEKIME KELMENDI

I nderuari z. Kryetar, i nderuar z. Kryeministër, ministra, deputetë, komisionar i policisë së UNMIK-ut dhe kolonel Ahmeti.

Unë gjatë një orë e gjysmë sa kaloi nuk pata rastin të dëgjoj se cila është gjendja e sigurisë në Kosovë, e mirë apo e keqe, stabile apo jo stabile. Dëgjova vetëm disa të dhëna normative apo organizative të policisë, dëgjova programe që parashihen të realizohen në të ardhshmen dhe asgjë më tepër. Këto ditë, për fat të mirë, si lajm i mirë u dha lajmi se u hap rruga e Ibrit dhe mbi të apo përtej lumit mund të kalojnë të gjithë qytetarët, shumë lajmë i mirë. Por, si mund ta kalojmë urën e Ibrit pa i shkatërruar strukturat paralele që veprojnë në veri të Mitrovicës, këtë pyetje ua shtroj të dy pjesëmarrësve të lartë të policisë ndërkombëtare dhe vendore. Për të parandaluar krimin e organizuar, për të cilin u fol, mendoj se Shërbimi Policor i Kosovës duhet të jetë i kyçur në Interpol dhe në Evropol, që edhe këta dy mekanizma për parandalimin e krimit të organizuar të veprojnë në Kosovë dhe t'i kenë edhe përfaqësuesit e tyre edhe këtu në Kosovë.

Ngritja e nivelit të sigurisë në Kosovë është më se e domosdoshme, sidomos në prag të raportimeve për Kosovën në institucionet më të larta ndërkombëtare ose me rastin e vizitave të zyrtarëve të lartë ndërkombëtarë në Kosovë, sepse të gjithë jemi dëshmitarë se gjithmonë dhe sa herë që flitet për Kosovën ose rreth Kosovës në struktura të larta ndërkombëtare apo vizitohet Kosova nga ndonjë zyrtar i lartë ndërkombëtar, ndodh diçka dhe gjithmonë gati, gati si i dëmtuar na paraqitet një pjesëtar i ndonjë minoriteti, por gjithmonë thuhet për fat të mirë viktima nuk pati.

Për një siguri më të qëndrueshme në Kosovë për të gjithë qytetarët, sidomos për veprimtarët politik, duhet të angazhohet UNMIK-u dhe KFOR-i me policinë e vet që t'i shkatërrojë të gjitha shërbimet sekrete për të cilat vetë ka pohuar se ekzistojnë dhe se i kanë identifikuar dhe se kanë dijeni se janë duke vepruar në Kosovë. Këto struktura nuk janë vetëm struktura të Kosovës, por janë shërbime sekrete edhe prej shteteve tjera, sidomos prej Serbisë, e cila sa e sa herë e ka pranuar se vepron shërbimi sekret i saj në Kosovë. Në këtë kontekst do t'i shtroja pyetje edhe të dy zyrtarëve të lartë të policisë se çka është ndërmarrë në këtë drejtim që këto shërbime sekrete të asgjahohen apo të shuhen. Vërehet se gjendja e sigurisë në Kosovë nuk e ka një koordinatë të drejtë, ka luhetje dhe ajo ndryshon varësisht nga ngjarjet politike në Kosovë dhe rreth Kosovës. Do të duhej të kemi një siguri të qëndrueshme dhe jo siguri sipas situatave.

Unë mendoj se krijimi i atmosferës së pasigurisë, e sidomos këto ditëve të fundit që është paraqitur, ka si qëllim bllokimin dhe shtyrjen e procesit të zgjidhjes së statusit të Kosovës, për të mos thënë bllokimin e plotë të kësaj zgjidhje. Dikujt është duke i konvencuar që statusi politik i Kosovës të mos zgjidhet dhe të vazhdohet me kërcënime dhe rrezikime të këtilla në krijimin e kushteve të pasigurisë dhe dihet se kujt kjo i shërben. Kurse ne si Kosovarë e ndjejmë si nevojë imediate që statusi politik i Kosovës të zgjidhet sa më parë dhe epilog i atij statusi të jetë pavarësia dhe sovraniteti i plotë i Kosovës. Ju faleminderit.

DEPUTETI SABRI HAMITI

Unë kamë menduar dhe po ju them menjëherë se kjo është tepër serioze. Tema dhe diskutimi do të jetë shumë ma substancial se ky që po dëgjojmë, po ndoshta kjo është natyra jonë që këto mbledhje të Kuvendit ta kthejmë në kuvendime akademike në kuptimin elementar të fjalës. Menjëherë po them se unë hetova që përfaqësuesi i policisë ndërkombëtare abstenoj të flas për temën që ka ardhur këtu dhe atë që na tha, bash asgjë rreth temës, një abstenim duket krejt elegant, por po shihet ashiqare. Po ashtu edhe nga ana e përfaqësuesit të Shërbimit Policor të Kosovës ne kishim të njëjtën gjë, një abstenim nga tema themelore dhe implikim që i ka Shërbimi Policor i Kosovës, qoftë si financim, qoftë si strukturim.

Ne kishim edhe në fillim një diskutim, unë do të thosha normativo- politik orientimor që i dëgjuam nga përfaqësuesit më të mëdhenj të grupeve politike këtu dhe përnjëherë po ju them dhe përfitova përshtypjen që ne këtu do të kemi vazhdimin e këtij diskutimi akademik për një problem shumë të preftë të shoqërisë Kosovare. Kisha edhe një habi elementare, dy përfaqësuesit e atij forumi politik që sot u artikuluan nga goja e tyre këtu në Kuvend dhe thanë që ka qenë ideja e tyre që kjo temë të diskutohet d.m.th e paskan atë autorësi dhe paskan mbërrit këtu të diskutojnë. Unë ua fali autorsinë, por unë edhe ju them forumit politik se pse kanë abstenuar ta mbajnë atë mbledhje me 18, unë flas për informacione publike nuk di për informacione institucionale sepse unë nuk e njoh si funksionon ai forum, pse kanë abstenuar me 18 ta diskutojmë këtë temë dhe kanë pritur çka po thotë populli punues eventualisht në Kuvend për këtë problem.

Pak a shumë forumi nga prijësi në këto aktivitete ose avangarda si quhen me terma tjera të del në prapavijë, ne do ta shohim por mua nuk më pëlqen forumi le të diskutoj çka të dojë për sigurinë, por disa diskutime që i dëgjova këtu mu dukën si kërcënime të sojit të veçantë që nuk i pranoj hiq. Në rast se nuk ka ndonjë marrëveshje, nuk do të ketë as institucione të sigurisë, kjo është një marrë e madhe nëse mendohet kështu dhe flitet publikisht. Unë mendoj se siguria e Kosovës do të ndodh vetëm kur të krijohen institucionet e sigurisë në Kosovë, që nënkupton Ministrinë e rendit dhe shërbimi inteligjent nacional i Kosovës, ose si të doni ja vejmë emrin, të cilat do të kontrollohen nga Parlamenti si institucioni më i lartë. Kurrfarë sigurimi në Kosovë nuk do të ketë për deri sa nuk do të japin përgjegjësi të institucionet legale të pushtetit, nuk mund të ketë siguri në Kosovë me institucione që formohen nga donacionet e huaja dhe këtë edhe ndërkombëtarët e din, po ashtu edhe ne e dimë çka do të thotë me të financuar dikush për t'u siguruar. Ato dokumente që i kemi ne në diskutim edhe të komisioneve të veçanta që i kanë bërë në Kosovë mbërrijnë pak a shumë te kjo ide që duhet të kërkohen donacione, të sigurohen institucionet e sigurisë. Kjo nuk pi ujë askund në bot, por besoj se nuk ka shans as në Kosovë.

Ne kemi një njoftim dje që do të merren dy Ministri të reja, të cilat lidhen drejtpërdrejtë me funksionimin e ligjit dhe me sigurinë, po ashtu Ministria e rendit dhe e Drejtësisë menjëherë u tha dhe që ato do t'i merrni por nuk do të kenë kompetenca, sepse kompetencat i ruhen UNMIK-ut se UNMIK-u e ka një rezolutë të tmerrshme 1244.

Të gjitha këto probleme janë të lidhura dhe është çudi që thuhet se ato dy ministri do të ndërtohen kah fundi i vitit, dikush thotë se do të fillojnë punën në tetor, thua se ne jemi në një situatë shumë të mirë të sigurisë dhe ajo i bie edhe 6 muaj. Unë po ju them seriozisht se këtu nuk shoh seriozitet në trajtimin e temës aq më tepër si zhurmë e rrugëve, çoftë si evidencë se këtu thuhet: Në këtë Kosovën e vogël që është kthyer në një karantinë politike nga ndërkombëtarët, po bijën dhe po rriten shërbime të natyrave të ndryshme që rrezikojnë personat konkret dhe qytetarët në përgjithësi dhe këtu le të thuhet haptas dhe unë kam pritur që do të flitet shumë më haptas sepse ky është Kuvend. Ne kemi shërbime të huaja që rrezikojnë qytetarët, eksponentët politikë, eksponentët e natyrave të ndryshme të Kosovës, para dymë tona, nëpër rrugë, nëpër fshatra dhe këtë nuk e thotë askush dhe e din të gjithë dhe këtë nëse se dinë përgjegjësit për sigurim, nuk janë të vetëdijshëm, nuk janë duke e kryer punën për çka janë këtu.

Kam parasysh policinë e UNMIK-ut në radhë të parë dhe të tjerët pas tyre. Unë vetë dua ta them haptas, kam përvojë me shërbim të ashtuquajtur të krimeve të mëdha në Kosovë dhe janë ardhur njerëzit dhe më kanë thënë se je i rrezikuar seriozisht ti dhe ky, ky dhe ka thënë ruaje veten se ma mirë se me ruajt veten nuk ka dhe unë dua ta them këtë në Parlament këtë, se duhet t'i ketë ndodhur edhe ndokujt kjo, në atë moment ju kam thënë se ju po më detyroni që mos t'ju besoj zotëri dhe nuk ka gjë më keq se kur nuk i besohet atij që pretendon se e bën sigurinë. Në Kosovë po ndodh kjo por nuk po thuhet haptas dhe ato sigurime të ashtuquajtura të shqiptarëve që po thuhet brenda. Unë nuk kam informacione por kërkoj që të shpjegohet qartë a ekzistojnë, kush i komandon dhe çka bëjnë, se nëse ka sigurime të brendshme që i përcjellin njerëzit e vetë ata janë shërbime të cofta, ata nuk janë për asgjë. Kosova sigurohet ndryshe, e jo me pa kojshin se si po zgjohet në mëngjes. Ju faleminderit.

DEPUTETI EMIN KRASNIQI

Per të gjithë ne qytetarët e Kosovës, çeshtja e sigurisë ka qenë dhe do të mbetet njëra ndër çeshtjet me të ndjeshme, me të rëndësishme dhe më problemore, pra, çeshtje mbi çeshtjet me rëndësi jetike për të tëra aspektet e jetës sonë, edhe politike edhe ekonomike edhe kulturore. Siguria është konteksti, është rrafshi jetik nga i cili kanalizohen, zhvillohen e sforcohen të gjithë segmentet e jetës sonë insitucionale e joinstitucionale.

Siguria është fusha e cila krijon levat e para të besimit të ndërsjellë midis qytetarëve. Vetëm siguria e njëmendët për të gjithë qytetarët papërrjashtueshmërisht, krijon stabilitet, denjësi njerëzore dhe vitalitet, ndërton shtratin e sigurtë të një sfondi të gjërë, në bazë të të cilit do të mund të fillonin negociatat për statusin politik të Kosovës.

Që të mund të ndriçojmë aspektet e sigurisë në Kosovë, kërkohet qasje me përgjegjësi, (sepse që të gjithë ne jemi bashkëpërgjegjës për situatën ekzistuese), nga institucionet vendore dhe reprezentuesit ndërkombëtar (UNMIK -u e KFOR-i) kompetencë e të cilëve është segmenti i sigurisë. Thuhet se luftërat i nxitin ideatorët, gjersa i zhvillojnë dhe i përfundojnë të fuqishmit.

Po të elaborohet kjo tezë në kontekst të sigurisë aktuale në Kosovë, rrjedhon se individë dhe grupimi i tij në asnjë situatë nuk mund të jetë me i fuqishëm se të fuqishmit, siç janë këtu UNMIK-u e KFOR-i.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e problematikës së vënë për shqyrtim, do të përpiqem të theksoj paradokset dhe indikacionet e shtresuara në relacionet e korelacionet: UNMIK-KFOR-Institucione vendore (Presidencë Kuvend e Qeveri), dhe dualizma të tjerë institucional, të cilët krijojnë prolongime institucionale, kufizime maksimale investitive dhe pasiguri të vazhdueshme të qytetarët. Ja disa nga paradokset e indikacionet që në shoqërinë kosovare reflektojnë vazhdimisht energji negative në sektorin e sigurisë:

1. Prolongimi i vazhdueshëm i UNMIK-ut në përbartjen e kompetencave nga ndërkombëtarët të vendorët, edhe në lëmenjët e gjyqësisë, policisë e politikës së jashtme;
2. Mosdenoncimi për kallëzim penal të kryesve të veprave penale edhe pas afro 300 vrasjeve enigmatike në Kosovë në pesë vitet e fundit nga UNMIK-u;
3. Dhënja e "porcion" kompetencave nga UNMIK-u Shërbimit Policor të Kosovës;
4. Politika denigruese e AKM-se në privatizimin e fabrikave e ndërmarrjeve me infrastrukturën e tyre përcjellëse për një "grusht para" duke varfëruar edhe ashtu të shkatërruar ekonominë e Kosovës, e duke u pasuruar individë të caktuar;
5. Shpërfillja e vlerave të resurseve humane që nga krijimi i Këshillit Gjyqësor e Prokurorial të Kosovës, agjencioneve tjerë apo përbërja e Zyrës për Siguri e kryeministrit aktual;
6. Mosrespektimi nga reprezentuesit e ndryshëm i diversitetit të kulturave dhe të trashëgimisë kulturore;
7. Loja tragjekomike e UNMIK-ut dhe e qeverive të Kosovës me fatin e të pagjeturve. Vërrejte: po që se vazhdohet me këtë trend, që çdo muaj apo në dy tre muaj të pranojmë nga 10 - 30 a 100 trupa të njerëzve të viktimizuar nga ushtria e policia serbe, në qytetarët e Kosovës edhe 15 vjet nuk do të mund ta racionalizojmë vetëvetën;
8. Trysnia që na bëhet me projektin për kthimin e serbëve të shpërngulur nga Kosova, kur dihet se qeveria serbe në krye të komisionit për kthimin e serbëve në Kosovë ka emëruar atë që në hierarkinë politike e ushtarake të Serbisë, gjatë viteve të luftës në Kosovë, pas Miniqit (Milomir), Pavkoviqit, Lazareviqit e Shainoviqit ka qenë i pesti, tani deputet në Kuvendin e Serbisë, Velko Odalleviq. Vërejtje: UNMIK-u e përfaqësuesit e institucioneve tona, me konsiderata, kanë mund të ndikojnë që akcili shqiptar të mos pranohet as për shofer makine;
9. Nepotizmat, familjarizmat e lokalizmat që nga kryeministria e ministritë e shumta kanë krijuar aversion - efsim të qytetarët. Mësojmë që në akcilen ministri një drejtor divizioni prej 60 punëtorëve të punësojë 40 punëtorë nga komuna prej se cilës është, shikoni autobusët!;
10. Korrupsioni për misionarët ndërkombëtar e përfaqësuesit e institucioneve vendore, është shndërruar në "luftë të yjeve" për mediat tona;
11. Trafikimi me derivatet e naftës, cigareve e medikamenteve etj, dëmton për qindra milion euro buxhetin e Kosovës.

Dhe, dhjetra e qindra tregues tjerë reflektojnë energji negative për sektorin e sigurisë në Kosovë. Mirëpo, për të evituar këto anomalitë të jetës sonë duhet shfrytëzuar dhe kanalizuar potencialet ekzistuese të resurseve tona humane duke akceptuar dhe zbatuar objektivat që avancojnë pozitën tonë, sepse, siç thuhet në materialin e Grupit Këshillues për Zhvillimin e Sektorit të Sigurisë, 06.05.2005, "procesi duhet të përfshijë të gjithë elementet e ndërveprimit kompleks ndërmjet faktorëve kombëtar, ndërkombëtar, social e ekonomik që ndikojnë në sektorin e sigurisë".

Përfundoj fjalën me propozimin si vijon:

- Që të krijohet, strukturohet dhe zhvillohet Shërbimi i Inteligjencies së Kosovës, jo për shkak të mërive të shumshtrësuar, por si nevojë e pandërmjetme për interesat më të larta të sigurisë në Kosovë, rajon e me gjërë.

Për të realizuar këtë, edhe nga Grupi Këshillues për Zhvillimin e Sektorit të Sigurisë, do të duhej përfillur për menaxhim potencialet ekzistuese të resurseve humane të inteligjencies, të cilët do të referoheshin këtij Kuvendi.

Faleminderit

DEPUTETI MAZLLUM KUMNOVA

Z. kryetar, kryeministër, ministra dhe zyrtar të policisë.

Është fakt se në rrethana çfarë doli Kosova nga lufta e fundit dhe për një periudhë deri më sot mendoj se do të ishte iluzore të instalohet një siguri e qëndrueshme. Me gjithë atë duke respektuar përpjekjet e popullatës dhe institucioneve ndërkombëtare dhe ato vendore është arritur deri më tani dhe me sa dijë unë edhe në shtetet e tjera në rajon nuk mund të lavdërohen në drejtim të tillë.

Është e qartë se një situatë më të mirë do ta kishim sikur të përshpejtohet ngritja e institucioneve përkatëse vendore të rendit dhe sigurisë, drejtësisë dhe të mbrojtjes. Ky është fakt, nuk bën ta nënqojmë, nuk bëj aspak keq nëse konstatoj se është e domosdoshme në këtë fazë krahas ngritjes së institucioneve vendore me përgjegjësi të plotë, duhet të punohet me kujdes në ndërtimin e besimit të popullit tek institucionit e rendit, sigurisë dhe drejtësisë. Besoj se në këtë relacion ka mangësi të mëdha, nuk është e domosdoshme që populli të bashkëpunon me autoritetet e sigurisë dhe të rendit edhe atëherë kur ky autoritet është përgjegjës dhe i vetmi për krijimin e një besimi të tillë. Po ndalemi këtu në ndërhyrjen e policisë ndaj lëvizjes "Vetëvendosja" pamjet përmes mediave nuk krijojnë një imazh të mirë ndaj policisë. Vetëvendosja si parim është proklamuar para 2 shekujve dhe në shekullin e kaluar me konventa dhe dokumenta ndërkombëtar. Unë nuk kam vërejtur asnjë sjellje që parimi i vetëvendosjes është keqpërdorur skejshëm nga kjo lëvizje dhe për interpretimin e këtij parimi nuk është kompetente policia. Por edhe për ndonjë ministër të pa ftuar që gjatë gjithë jetës së tijë nuk ka pushuar me urrejtje të qmendur ndaj popullit shqiptar të bëhet një ndërhyrje e tillë e dhunëshme.

Në botën demokratike bëhet kjo dhe policia është e përmbajtur ndaj kësaj sjellje demokratike me mjete që nuk rrezikojnë jetën e një njeriu. Mirpo pamja e ndërhyrjes së policisë në këto raste duke mos anashkaluar edhe ndërhyrjen e dhunëshme ndaj

familjarëve të personave të pagjetur, krijon një distancë që është vështirë të riparohet ndërmjet policisë dhe popullit. U ndala te këto raste me qëllim që në kuadrin e krijimit të një sigurie të qëndrueshme është i domosdoshëm krijimi i një bashkëpunimi të policisë dhe popullit dhe është koha e fundit që të punohet më sereiozisht në këtë drejtim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem z. Komisionar në qoftë se keni ndonjë koment apo përgjigje ose diçka të shtoni po ju mundësojmë edhe njëherë që ta merrni fjalën.

KAI VITTRUP, Komisioner i policisë,

Fjala e zotëriut Vittrup është e transkriptuar nga përkthimi.

Ju faleminderit, gjendja e përgjithshme e sigurisë është stabile dhe pata dëshir ta theksoj këtë gjë. Mirëpo, në anën tjetër faktet e parashtruara kundër policisë së UNMIK-ut dhe Shërbimit Policor të Kosovës duhet të trajtohen me seriozitet, andaj nuk ka asnjë dyshim se KFOR-i dhe policia së bashku kanë krijuar një mjedis të sigurt i cili është stabil. Përveç kësaj shërbimi i inteligjencës ekziston në dy forma të shërbimeve të inteligjencës. Pra shërbimi i inteligjencës për siguri dhe për trajtimin e çështjeve të kriminit. Ai i sigurisë tani është duke u afruar nga ana e UNMIK-ut dhe KFOR-it pa pjesëmarrjen e Shërbimit Policor të Kosovës, e sa i përket inteligjencës rreth çështjeve të kriminit kjo udhëhiqet nga policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja. Është shumë me rëndësi që unë të vej në dukje se vendimi për krijimin e një shërbimi të tillë të inteligjencës gjendet në duart e politikanëve. Ky vendim duhet të merret, ne bëjmë çdo gjë që është e mundshme për ta përmirësuar gjendjen e sigurisë, për të përmirësuar gjendjen për sa i përket lirisë së lëvizjes. Ne kudo që të shkojmë, shkojmë për të kontrolluar. Unë kam punuar nga ora 1 deri në orën 5 për të siguruar, për të bërë inspektime, për të bërë kontrollimin, për të siguruar se policët a janë në vendin e punës, sepse është me rëndësi që qytetarët i shohin policët duke punuar, e për ta bërë këtë duhet që policët e rangut të lartë të dalin në terren.

Sa i përket personave të zhdukur kjo është një prej prioriteteve tona kryesore, ajo që kemi bërë është ajo që kemi krijuar një grup me përfaqësues të familjeve të të zhdukurve ku ka bashkëpunim të ngushtë. Ne bëjmë çmos për t'i mbështetur ata, i kuptojmë. Vetëm ata të cilët e kanë ndier dhembjen si pasojë e humbjes së të dashurve dhe të afërmeve të tyre mund ta kuptojnë. Ne nuk kemi pësuar asnjësoj, mirëpo bëjmë çmos që t'i mbështesim ata, mbajmë takime dhe do të vazhdojmë të angazhohemi sa më shumë që të mundemi. Sa i përket themelimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme apo të drejtësisë, afati i paraparë për këtë është 1 nëntori. Mirëpo, natyrisht ka probleme. Sa i përket hapësirave, financave dhe gjërave tjera. Mirëpo, ne nuk jemi këtu për të biseduar për ato gjëra, por për siguri. Si do që të jetë mund t'ju siguroj se Shërbimi Policor i Kosovës, policia e UNMIK-ut po bën çdo gjë që është e mundshme për ta përmirësuar gjendjen e sigurisë.

Së katërtri nuk mund të flas për shërbime të huaja të inteligjencës në Kosovë, ky është takim publik që transmetohet në televizion dhe ne nuk mund ta diskutojmë atë çështje duke marrë parasysh natyrën sensitive dhe delikate të kësaj çështje.

Së fundi desha t'ju falënderoj që na keni ftuar këtu, vërtet u jemi mirënjohës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem të gjithëve në orën 12,30 të jemi të gjithë në sallë dhe vazhdojmë debatin.

(Pas pauzës)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mendoj se mund të fillojmë 72 deputetë, ndërsa ajditë janë 93 copa, por kryesore kemi kuorum. Për fjalë Gjergj Dedaj, pastaj Gazmend Muhaxheri, Sokol Bashota edhe dikush i Aleancës një edhe Gjynnazja: Pse po e them këtë. Është një lutje e arsyeshme e shoqatës, e prindërve e atyre që vërtet e kanë më së vështiri të presin debatet tona që t'i japim pak kohë më të gjatë për të pagjeturit dhe kohë kur është transmetimi televiziv. Do të thotë në një mënyrë deputetët e tjerë le ta dorëzojnë me shkrim. Diskutimet me shkrim do të jenë pjesë e dokumentacionit zyrtar të Parlamentit. Po mirë de, ju që nuk deshët as të debatonit është në rregull me juve. Unë e kam problemin me Ramadanin, se me juve më lehtë merrem vesh. Prandaj Gjergj Dedaj e ka fjalën dhe të shkojmë me radhë, Gazmendi le të përgatitet

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ

Mendoj se do të m'i kompensoni këta minuta që m'i humbët.

Të nderuar të pranishëm, i nderuari z. kryetar, ministra. Pasi u fotografuan, kryeministri edhe përgjegjësit për siguri tash shkuan në pushim me siguri në drekë.

Para se të them diçka për çështjen e sigurisë, dua edhe një herë ta shpreh mospajtimin tim me mënyrën e procedimit të seancave të Kuvendit të Kosovës. Çdo respekt për grupet parlamentare, është e qëndrueshme që në radhë të parë ta marrin fjalën askush nuk e konteston,

kryetarët e grupeve parlamentare të partive të mëdha dhe kështu me radhë, por dua t'ju përkujtoj se në Kuvendin e Kosovës janë përfaqësuar 17 subjekte politike dhe pas grupeve parlamentare do të duhej ta marrin fjalën menjëherë kryetarët e partive që janë deputetë në Kuvendin e Kosovës. Këtë kërkoj edhe nga vëzhguesit e Kuvendit të Kosovës ta kenë parasysh dhe t'ia bëjnë me dije sekretarisë së Kuvendit.

Sot kemi shtruar dy çështje të rëndësishme, çështjen e sigurisë dhe problemin e të pagjeturve. Mendoj se këtë Qeveria ka bërë vetëm një farë mënyre për ta përmbyllur ciklin gjashtëmujor të aktivitetit të saj gjëja me një shqetësim për çështjen e sigurisë dhe çështjen e pagjeturve. Për këto dy çështje mendoj se Qeveria ka dështuar dhe se kontributi i saj është i barabartë me zero. E përkujtoj ish- komisionarin Shtefan Feller që

në varrimin e Sebahate Tolajt- pjesëtare e SHPK-së, të vrarë në komunën e Deçanit, ditën e varrimit i tha babait të Sebahatës : Të premtoj se do t'i zë autorët e krimin dhe do t'i qes para drejtësisë. Kjo nuk ndodhi sikur që nuk po ndodhë asnjëherë do më thënë vrasjet po ndodhin për çdo ditë . Qytetarin e Kosovës, gazetarin kosovar, politikanin, deputetin e tjerë edhe qytetarët e rëndomtë i mbron zoti edhe ndonjë herë kanuni i Lekë Dukagjinit .Pra, nuk do të duhej që Kosova të kthehet në Mesjetë.

Askush nga përgjegjësit për siguri deri më sot nuk kemi dëgjuar së ka dhënë dorëheqje si instrument i moralshëm demokratik për mos efikasitetin e zbulimeve të këtyre akteve kriminale që po ndodhin çdo ditë në Kosovë. Vetëm në komunën e Pejës janë vrarë 191 persona e mund të them se flas pas lufte dhe mund të them se mbi 95% të këtyre akteve kanë mbetur pa u zbuluar dhe askush nuk e qanë kokën për këta përveç ankhitit familjar. Edhe komisionari Vitrup edhe z. Ahmeti s'paskan pasur kohë sot kur e kanë ditë që një javë ka me u mbajt një seancë për sigurinë edhe me i dëgjuar vërejtjet e deputetëve dhe kjo mendoj siç thotë populli- Vetëm merr ujin në havan, që flasim sot për sigurinë, sepse po ma përkujton debatin për decentralizimin që bëme shumë zhurmë e më në fund vendoset nëpër kabinete e mos të them nëpër zyrat e tjera, por jo në Kuvendin e Kosovës. Edhe për sigurinë kështu po ndodhë. Dje mora një lajm gjëja të gëzueshëm se së shpejti do t'i transferojmë kompetencat e institucionit të Kosovës edhe në Ministrinë e Rendit edhe të Drejtësisë. Mendoj se nëse do të ndodhë kjo tani konsensus të gjitha subjekteve partiake përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës do më thënë edhe këtu do të kemi edhe një përshkallëzim e mos ta merrni se dikush këtu e mori si kërcenim përshkallëzim të gjendjes së sigurisë, sepse edhe Ministria e rendit edhe Ministria e Drejtësisë në këtë fazë transicioni që është Kosova duhet të jenë të monitoruara nga ndërkombëtarët, por do te duhej të ishin apolitike dhe duhet të ishin partiak, sepse atëherë shumë prej nesh duhet ndoshta me marrë me kërkua prapë azil politik edhe do të fillonin ndoshta edhe proceset e montuara politike nëse në këtë fazë të transicionit ndonjëra prej këtyre ministrive udhëhiqet dhe drejtohet nga grupimet cila do parti politike. Mendoj se këto dy çështje duhet me qenë shumë të vëmendshëm dhe shumë të kujdesshëm. Edhe një herë thash se unë për veti e di që kam folur krejtësisht kot, sepse ata që duhet me qenë përgjegjës për Qeverinë duke filluar prej kryeministrit Kosumi, zotit Vitrup, kolonelit Ahmeti, por ata nuk janë këtu me na dëgjuar me siguri që nuk kanë kohë as me i përcjellë seancat se kjo është veç një kohë e humbur para pushimeve verore të Kuvendit të Kosovës. Faleminderit shumë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Gjergj, po më dhimbet vetvetja që po ju jap gjithmonë respekt të gjithë deputetëve veçanti juve minoriteteve politike. Ju dhashë fjalën para anëtarit të Kryesisë të Kuvendit e nuk është e mjaftueshme ky parlament nuk është këshill tranzitor ka qenë gabimi im e unë mendoj e kur janë çështjet e tilla të sigurisë, politike krejt spektri politik përfaqësohet por mos u mundoni me i rrënuar të gjitha ndihmat dhe arsytet që i ka parlamenti ndaj jush. Gazmend Muhaxheri, Sokol Bashota, le të bëhet gati.

(Replik)

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ

Me të thënë të vërtetën edhe mua po më dhimbet vetë vetja edhe koha që po vi në këto seanca të Kuvendit të Kosovës, e sa i përket asaj që po na respektoni ne partive minoritare, flet fakti se partitë që jemi minoritet aktivitetin tonë në Kuvendin e Kosovës mund ta bëjmë vetëm në korridoret e Kuvendit të Kosovës ose në oborrin e Kuvendit të Kosovës edhe mund ta shfrytëzojmë tualetin e Kuvendit të Kosovës edhe asgjë më tepër. D.m.th. se kjo praktikë duhet ndryshohet ne jemi deputet të zgjedhur, përfaqësojmë parti politike, këtë respekt nuk ka nevojë me na dhuru, ky respekt dhe kjo na takon edhe fjalën në Kuvendin e Kosovës do të na takoj derisa do të pranojmë të ulemi ne në këtë Kuvend deri në zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Do t'ju takojnë gjithmonë minutat vetëm si deputet prej sodit deri sa nuk ndërrohet Kushtetuta dhe rregullorja tjetër. Gazmend Muhaxheri, Sokol Bashota.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit z. kryetar, përshëndes ministrin e Shëndetësisë që është prezentë në sallë, zonja dhe zotërinj.

Mungesa totale e debatit në fillim të mandatit të ri të Kuvendit kemi mbërrir deri te debatet pa përfundim dhe debate sa për sy e faqe.

Debati për decentralizimin dhe ai për ekonomi përfunduan pa asnjë rezultat konkret. Shtrohet pyetja- A do ta ketë të njëjtin fat edhe debati për sigurinë?

Njëra prej pyetjeve që duhet shtruar për sigurinë në këtë Kuvend është- Sa kontribuon puna jonë si deputetë në Kuvendin e Kosovës, në sigurinë e përgjithshme qytetarëve të Kosovës. Duke mos e kryer detyrën e vet si institucion përgjegjës në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe detyrimin e Qeverisë që ta bëjë transparent punën e saj, ne drejtpërdrejt ndikojmë negativisht në situatën e sigurisë në vend. Qëllimi i mbikëqyrjes së punës së Qeverisë nuk duhet të jetë zbulim i korrupsionit, por dhënia e llogarisë dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit. Me mos bërjen transparent të shpenzimeve buxhetore të ministrive dhe të Kuvendit për vitin 2004, ne hapim rrugën për keqpërdorime dhe keq menaxhim të buxhetit edhe për vitin 2005. Edhe pse ligji për menaxhimin e financave publike obligon ministrinë, Kuvendin dhe organizatat e tjera që shpenzojnë buxhetin e konsoliduar të Kosovës, bërjen publike të këtyre shpenzimeve çdo tre muaj.

Si anëtar i Kryesisë së Kuvendit nuk i kam të njohura shpenzimet e buxhetit të Kuvendit të Kosovës për shtatë muaj të këtij viti fiskal. Pra, nuk kam njohuri se kush ka vendosur dhe kur ndërtimin e rezidencës së ashtuquajtur protokollare (polemikë).... Vendimarrja është jo transparente. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në siguri z. kryetar. Ky Kuvend nuk po

nxjerr ligje, nuk po bënë kontrollimin e zbatimit të këtyre ligjeve. Kjo ka pasoja të drejtpërdrejta në siguri të përgjithshme. Gjashtë vjet pas luftës në qytetet tona nuk zbatohet ligji për planifikim urbanist, kështu që si rezultat kemi mungesën e tokës ndërtimore, lulëzimin e kriminalitetit ekonomik që lidhet me kriminalitetin politik dhe si pasojë kemi shkatërrimin e qendrave urbane dhe ndërtimet e egra dhe monopole në politikë dhe në rindërtim.

Po të zhvillohej debati si duhej dhe të ishte i përgatitur mirë do të duhet të përgjigjur në pyetjet, kusht ka krijuar strukturat e sigurisë partiake, kush i financon këto struktura partiake dhe kujt i japin llogari këto struktura. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, Sokol Bashota, Gjylnaze Sylja, le të përgatitet.

DEPUTETI SOKOL BASHOTA

Z. Kryetar, të nderuar kolegë deputetë.

Mos ndarja e temave në seancat e veçanta për sigurinë dhe të pagjeturit është tendencë e pamoralshme e përzierjes së krimin me çështjet jetësore të qytetarëve të zhdukur. Kjo tregon nivelin dhe respektin për të zhdukurit dhe familjarët e tyre.

Çështja e sigurisë si çështje ekzistenciale e shtetit dhe qytetarit të saj sot ngërthen në vete një peshë të veçantë për stabilitetin e vendit në përgjithësi, imazhin e saj të brendshëm dhe të jashtëm për zhvillime dhe investime ekonomike politike e sociale për qetësi familjare, individuale dhe relaksim dhe tolerancë ndëretnike e ndër fetare për të ardhmen e Kosovës. Ne tash duhet të flasim për çështjen e sigurisë në Kosovë pa pasur realisht përgjegjësi institucionale mbi të. Kosova tash e gjashtë vjet ka përjetuar shumë paradokse. Njëri prej tyre është edhe çështja e kompetencave për të cilat ky Kuvend mban përgjegjësi ,gjithashtu.

Kosova është një vend ku ndodhë krimi i të gjitha llojeve, korrupsioni, madje edhe trafikimi me qeneje njerëzore. Lidhur me këtë ,për mua janë dy çështje kapitale: E para sa është niveli i përgjegjësisë i institucioneve përkatëse për çështjen e sigurisë. E dyta-Prej kah po vjen jo stabiliteti i sigurisë. Sa i përket të parës dihet botërisht se zbulimi i krimeve të rënda duke përfshirë edhe shpërthimet kohëpaskohshme.

Jo stabiliteti i i sigurisë, sa i përket të parës, dihet botërisht se zbulimi i krimeve të rënda duke përfshirë edhe shpërthimet e kohëpaskohshme në Kosovë janë zbardhur 0%. Me këtë rast edhe aspekti i dytë është i rëndësishëm : Prej nga po buron jo stabiliteti i sigurisë mbetet i mjegullt dhe tej mase i manipuluar për fat të keq edhe prej një pjese të faktorit politik të Kosovës- koalicionit qeverisës.

Partia Demokratike e Kosovës ka kërkuar dhe kërkon në vazhdimësi e me këmbëngulje që të zbardhen të gjitha krimet e vrasjet politike që janë bërë në Kosovë që janë legjitimuar deri në atë shkallë sa një pjesë e faktorit politik të Kosovës siç thashë edhe

më parë thjeshtë është duke manipuluar me fatin e viktimave dhe fatkeqësinë e familjarëve të tyre deri në atë masë sa ata të përdoren edhe për qëllime politike.

Kosova nuk mund të ndërtojë shtet, derisa njerëzit vriten në mes të ditës dhe nëse rastet të tilla të mos ndriçohen prej organeve përgjegjëse të drejtësisë. Përse nuk ndriçohen ende vrasjet e veprimtarëve Shaban Manajt, Ekrem Regjës, Ismet Racit, Xhemajl Mustafës e shumë vrasje të tjera. Familjarët e tyre dhe qytetarët e Kosovës nga kush duhet të marrin përgjigje. Dikush është duke u tallur me fatin e qytetarëve dhe të ardhmërisë së Kosovës. Nuk zbulohen rastet të tilla makabre e as nuk ka përgjegjësi prej organeve kompetente për moskryerjen e detyrave për të cilat ata paguhen. Kjo çështje e lojës me jetën e njerëzve nuk mund të vazhdojë kështu edhe shumë gjatë e as politika prapa saj që merr të drejtën autoriale e të luajtjes së rolit të viktimës ende pa u thënë e vërteta e organeve përkatëse. Jemi dëshmitarë të gjithë se deri më tani segmenti vetëm që ka funksionuar në Kosovë, por jo në mënyrë të drejtë është vetëm burgosja e luftëtarëve të lirisë, duke i harruar në këtë mënyrë aktorët që bëjnë gjenocid në popullin e Kosovës dhe pyetja është: Sa prej tyre sot janë sjell para organeve të drejtësisë. Tashmë është bërë e qartë, se po thuaj se gjysma e kabinetit të Qeverisë aktuale është nën hetime në bazë të dyshimeve të involvimit të tyre në krimet e rënda. Kjo do të thotë se kryetari i Kosovës, me dashje ose pa te, është pajtuar për instalimin e logjikës së mafisë dhe të rrjetit kriminal edhe në institucionet e Kosovës. Ka indikacione të mjaftueshme që tregojnë se siguria e vendit, vrasjet, shpërthimet kanë marrë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me qeverinë aktuale. Dihet se prapa çdo krimi politik qëndron edhe interesi i tij politik dhe pyetja është e thjeshtë: Kush ka përfituar nga vrasjet politike në Kosovë. E them në përgjegjësi këtu se janë dy faktorë që kanë përfituar më së shumti prej krimeve politike- Qeveria aktuale dhe Beogradi. Ky është një realitet që është duke përcjell Kosovën tash e gjashtë vjet pas luftës.

Siguria në Kosovë sot është elementi më i rëndësishëm që reflekton peshë vendimtare për përcaktimin e statusit të Kosovës. E Kosova nuk mund të marrë përcaktimin e merituar të statusit deri sa në pushtet ka njerëz të involvuar në krim ata mund të shkojnë sot me dorëheqje por nesër pasojat mbesin, është turp që Kosova që pas çdo vrasjeje apo shpërthimi që vazhdohet deri në pakufi meritoret të partive politike në njërin anë dhe me konferenca për shtyp të organeve përgjegjëse në anën tjetër pas të cilës pason fjalia - hetimet vazhdojnë. Faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit, Gjylnaze Sylja, le të përgatitet Ramadan Kelmendi.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

I nderuari z. kryetar, i nderuari z. ministër, deputetë të nderuar.

Debati për sigurim për mua është i rëndësishëm dhe jam më se kënaqur që së paku institucioni ynë Kuvendi i Kosovës do ta ketë mundësinë që ta merr një qëndrim të përbashkët në fund të këtij debati. Unë mendoj se përkundër faktit se ne nuk i kemi ende

kompetencat në këtë lëmi qytetarët e Kosovës presin që Kuvendi i Kosovës si organ më i lartë i vendit të bëjë vlerësimin e gjendjes së sigurisë në vend.

Kosova po kalon nëpër një fazë vendimtare që do të përcaktojë rrjetat e më vonëve politike dhe statusin e ardhshëm të saj. Mu në këtë fazë jemi dëshmitarë të krimit përshtypjes së pasigurisë në vend, jemi dëshmitarë të disa incidenteve që ngjanë së voni sipas disa indikacioneve mund të vlerësohen se kishin prapavi politike. Gjithashtu në muajt e fundit ka ndodhur disa vrasje individësh në Kosovë që tronditët qytetarët e Kosovës. Këto janë vetëm disa skenarë të fundit që ndodhën në Kosovë pa i përmendur incidentet e më parme dhe vrasjet që ndodhën në të kaluarën. Po ashtu nuk do të harruar edhe krime tjera kundër pasurisë së qytetarëve sikur krimi i organizuar, krimet ekonomike dhe korrupsioni, të gjitha këto janë realitet kosovar dhe nuk mund ta injorojmë. Kjo nuk do të thotë se Kosova është e kriminalizuar sepse në çdo shtet në botë ekziston krimi i organizuar dhe krimi ekonomik. Për kundër këtyre ngjarjeve situata në Kosovë është stabile, është shqetësues niveli i ultë i ndriçimit të krimeve, fakti se shumica e sulmeve incidenteve, vrasjeve, krimeve ekonomike korrupsioni ngelen edhe të pazbardhura ose të pa ndjekura krijon huti dhe ndjenjën e pasigurisë të qytetarët që zgjon dyshimin për aftësinë e institucioneve të përgjegjshme për sigurinë në Kosovë që t'i përmbushin detyrat e tyre me sukses. Një vend ku ndodhin krime çdo ditë dhe përbindja e zbardhjes së tyre është shumë e ulët vlerësohet si vendi i pasigurt, e jo vendi ku ndodhen krimet sepse sikur theksova shumë shoqëri të avancuara përballen me lloje të ndryshme të krimeve. Për këtë arsye qytetarët e Kosovës shtrojnë pyetje se sa është efikase SHPK-ja dhe Policia e UNMIK-ut. Me qëllim që të pos bëjmë vlerësime me hamendje dhe të mos kërkojmë përgjegjësinë kujdestar unë do ta parashtrojë një pyetje tjetër. "Çfarë po bëjnë institucionet ndërkombëtare dhe vendore si dhe shoqëria në përgjithësi që gjendja e sigurisë të jetë edhe më e mirë dhe krimet të zbardhen".

Është fakt se përgjegjësia mbi policinë është në duart të UNMIK-ut. Administrimi i gjertanishëm në këtë kompetencë ka pas ditë të ndritshme, por edhe të zbehta, po nisemi nga institucionet përgjegjëse.

Mangësia kryesore e cila bie në pah tek përgjegjësit në sigurinë është mos inkuadrimi i mjaftueshëm i SHPK-së në zbulimin e krimeve serioze, është iluzion të mendohet se një trup i huaj mund të vë sigurinë në vend pa ndihmën e vendorëve. Shpresojmë se me bartjen e kompetencave kjo situatë do të ndryshojë, një mangësi tjetër evidente ka qenë transparenca e mangët e punës së policisë, nuk konsiderohet e nevojshme që opinioni të informohet për rezultatet e përndjekjes së krimit. Qytetarët nuk janë në gjendje të vlerëson se çfarë masash po ndërmerr policia në luftën kundër krimit dhe cilat raste janë zbardhur. Populli është i varur nga spekulimet ose informacionet e mediave të cilat nuk janë zyrtare dhe për më tepër nga një herë nxisin skepticizmin e qytetarëve për punën e policisë. Duke mos u ndalur vetëm në përgjegjësitë e policisë duhet theksuar edhe detyrat tona në këtë fushë. Bartësit e funksioneve publike duhet të jenë shembull të zbatimit të ligjit, përndryshe ata nuk mund të presin nga qytetarët t'i përmbajnë ligjeve që ata nuk i zbatojnë.

Politika e shteteve kosovare duhet të kontribuojë në ndërtimin e mekanizmave institucional të sigurisë. E kemi rastin historik të krijojmë institucione që do të përkujdesen në mënyrë institucionale për sigurinë në Kosovë. Për këtë arsye do të tregohemi të pjekur dhe do t'i

kontribujmë forcimit të institucioneve që do të qëndrojnë pavarësisht nga pushtetet politike që varësisht nga vullneti i popullit mund të humbasin legjitimitetin bazë të proceseve zgjedhore demokratike. Kjo vlen për të gjitha partitë në pozitë dhe opozitë. Duhet ta kemi të qartë se nëse opozita nuk është në pushtet është institucion në shoqërinë demokratike dhe ka përgjegjësi në shoqëri. Së fundi edhe qytetarët kanë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e sigurisë. Qytetarët duhet të besojnë në institucionet dhe t'i mbështesin ato në zbulimin dhe ndjekjen e krimit. Asnjë polici në botë, sado profesionale, nuk mund të jetë efikase pa ndihmën e qytetarëve. Nuk duhet të jemi indiferentë ndaj krimi se fatkeqësia që është sot është fatkeqësi për nesër, ajo godet edhe atë person që nuk e godet krimin edhe pse ka informata për te. Pra nga qytetarët kërkohet guxim dhe përgjegjësi qytetare në luftën e përbashkët për më shumë siguri.

Duke u bazuar në të gjitha këto dëshiroj që Kuvendi nga debati i sotëm publikisht:

1. Të dënojë të gjitha krimet e motivuara politikisht në Kosovë,
2. Të thërrasë policinë e Kosovës për transparencë më të theksuar në punë,
3. Të ftojë qytetarët për krimin e paktit në luftë kundër krimit në shoqëri,
4. T'i ftojë të gjitha minoritetet në Kosovë të mbështesin krijimin e institucioneve demokratike në Kosovë.

Deputetë të nderuar. Ju ftoj që t'i mbështetni këto pika që na obligojnë sidomos neve-bartës të mandatit politik në Kosovë që na kanë besuar qytetarët me votën e tyre të lirë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit, Ramadan Kelmendi, le të përgatitet Bajram Rexhepi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI

Ju faleminderit kryetar. Të nderuar deputetë dhe të pranishëm. Në një masë shumë të madhe gjendja e sigurisë ose e pasigurisë në Kosovë varet edhe nga situata në Mitrovicë e në veçanti në Kosovën veriore dhe zgjedhja e problemit të Mitrovicës. Te të gjithë qytetarët e Mitrovicës ekziston një shqetësim i madh se stacioni policor në veri do të ketë vetëm përbërje një etnike dhe atë nga serbët, por policët kur ndalin kërkojnë që çdo qytetar të flasë vetëm gjuhën serbe, kësaj nuk i duhet ndonjë koment më i madh.

Gjendja e sigurisë në Kosovë po vlerësohet nga këndet e ndryshme siç u vlerësua edhe sot këtu edhe shpeshherë në mënyrë subjektive, duke i ikur gjendjes reale në terren. Faktet flasin se siguria politike dhe ajo fizike e qytetarëve të Kosovës po dallon nga rajoni në rajon dhe nga qyteti në qytet, prov Mitrovica dhe pjesa veriore e saj. Në realitet gjendja e sigurisë varet nga kompetencat dhe shtrirja e tyre në hapësirën e Kosovës dhe krimi i Ministrisë për Siguri, sido që të jetë ngase mungon institucionet juridike dhe politike për ta parandaluar dhe luftuar parregullsinë, padrejtësinë, ryshfetin, korrupsionin, ryshfetin, vrasjen dhe format e tjera të krimit të organizuar. Të gjitha këto

kërkojnë qetësi dhe siguri, angazhim, por nga të gjithë nuk është i njëjti nivel për t'i përmbushur këto obligime.

Unë do të përqendrohem shkurt në disa segmente të pasigurisë në rajonin e Kosovës veriore që përfshinë 18, 82% territorit të Kosovës dhe konkretisht 26 mijë e 830 qytetarë shqiptarë të këtij rajoni nuk e gëzojnë sigurinë veçanti atë politike dhe të lëvizjes, duke mos mënjanuar atë juridike, sigurinë e punës, lëvizjes së lirë, kthimin në pronat e tyre dhe banesat e tyre. Është shumë formale ajo që publikohet sot në mjetet e informimit se është liruar ura e Ibrit kjo nuk paraqet ndonjë përparësi edhe pse është përkrahur, sepse të gjithë qytetarët shqiptarë nuk mund të kthehen në pronat, shtëpitë, banesat e tyre dhe çka na duhet të lëvizim për urë kur s'kemi ku të kthehemi në pronat dhe atje na presin pikërisht ata militantët që përsëri kontrollojnë atë pjesë, një sistem shumë paralel i vrazhdë që është ende nën ndikimin e regjimit të Beogradit. Në veçanti këto vërehen në Çabër, Koshtovë, Cerajë, Bistricë, Kelmend, Boletin, Zhazhë e tjera. Mbi këtë pjesë për shkak të presionit politik që vjen nga militarizmi Serb vendor dhe porositë politike që na i qon nga Beogradi shqetësimet dhe pasiguritë janë të pranishme kësaj kur i shtohet edhe vet fakti se qytetarët pengohen të rindërtojnë shtijat e tyre nga KFOR-i të djegura nga Serbët, nuk do ndonjë koment më të madh për sigurinë në këtë regjion paraqes vetëm këto argumente:

1. Kthimi është i penguar në shtëpi dhe banesat e tyre, ndërsa ura është liruar fatmirësisht, mos lëvizja e lirë e shqiptarëve në drejtimin e aksit rrugor Albanik,(Zubin Potok) paraqet specifikat të pasigurisë në veti. Nxënësit, studentët, profesorët nuk kanë mundësi as qasje në shkolla, objekte dhe në fakultetet e tyre. Pacientët nuk kanë qasje në qendrën rajonale të spitalit të Mitrovicës që fatkeqësisht vetë disa mjekë shqiptarë e lejuan që ajo të mbetet sot e kontrolluar vetëm nga mjekët serb. 16 mijë e 388 punëtorë shqiptarë nuk e kanë qasje në vendet e tyre të punës në Zveqan. Vazhdon jeta e ndarë në qytet, qarkullimi i njëanshëm nga jugu në veri është pamundësuar, ndërsa nga veriu nëpër tërë Kosovën. Lejimi i kontrabandës në aksin rrugor Mitrovicë – Rudar, heqja mbishkrimeve shqiptare në tërë pjesën veriore, protestat serbe të vazhdueshme vënia e mbishkrimeve ortodokse, ndërtimi i kishës ortodokse mbi qytetin Siniorl, të gjitha këto krijojnë pasiguri. Ka edhe shumë fakte të tjera të cilat nuk po i numërojë sepse të gjithë i dini, të gjitha këto flasin për pasigurinë e shqiptarëve në rajonin e Mitrovicës veçanti në pjesën veriore sepse pushteti i institucioneve tona dhe atyre ndërkombëtare në to ndihet pak atje ka erë dhe vull të punës së Beogradit. Me të drejtë qytetarët e këtij rajoni kërkojnë siguri dhe qetësi si gjithë pjesa tjetër e Kosovës ku është shumë më sigurt dhe më qetë. Për të arritur këtë kërkohet një angazhim dhe një funksionalizim më i madh i institucioneve të Kosovës në të mirë të gjithë qytetarit të saj pa dallim. Në veçanti angazhim më i madh për zgjedhjen e problemit të Mitrovicës para se të fillojë procesi final i statutit të Kosovës, është kërkesë e regjionit të Mitrovicës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ramadan,ju faleminderit, Bajram Rexhepi, Numan Balliq, le të përgatitet

DEPUTETI BAJRAM REXHEPI

Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë. Me qenë se kolegu dhe bashkëqytetari foli për situatën e sigurisë në Mitrovicë, nuk dua ta përsëris, por do të provoj t'i jap disa opinionë të mia në lidhje me situatën e sigurisë.

Nuk them asgjë të re se segmenti i sigurisë është një ndër çështjet themelore për të gjithë qytetarët e Kosovës, për të gjitha shoqëritë e sidomos për shoqëritë në tranzicion si është edhe Kosova, aq më parë kur gjendemi para sfidave të ndryshme, pra. para përcaktimit të statusit që e shton edhe më shumë rëndësinë e sigurisë. Edhe siguria është një nocion shumë i gjerë që ngërthen në vete shumë segmente dhe është vështirë që t'i paraqesim si të shkëputur. Derisa me sigurinë e përgjithshme që është kompetencë e KFOR-it mund të themi se edhe ka rezultate edhe është një gjendje e kënaqshme për sigurinë e brendshme ose rendin publik nuk mund të themi se mund të jemi të kënaqur. Po ashtu edhe në efikasitetin e gjyqësisë e në rend të parë të hetuesisë si segmente tepër të rëndësishme të sigurisë, nuk mund të jemi të kënaqur me efikasitetin e tyre. Pran të gjitha këto krijojnë një situatë me të cilën aktualisht nuk mund të jemi të kënaqur. Çmoj angazhimin dhe përkushtimin e komisionarit të policisë z. Kojvitrub. Nëse e krahasojmë me paraardhësin e tij për angazhimet e tij po megjithatë në këtë debat nuk kemi mund me prit një prezantimin më të mirë të situatës së sigurisë për arsye se ai edhe nuk e ka këtë mandat, përveç disa të dhënave të shkëputura statistikore dhe tërë organizimin e shërbimit policor të tashëm dhe në të ardhmen. Ky mos efikasitet i disa segmenteve të sigurisë ka edhe implikime ose pasoja që na i bartin tash dhe që e zbehtë perspektivën e Kosovës. Dihet se korrupsioni është në rritje e sipër për arsye se hetuesia dhe gjyqësia janë të mangëta në zbulimin e tyre. Po ashtu i kemi edhe konsekuencat e tjera si krimi i organizuar i llojeve të ndryshme, por edhe aktet kriminale individuale këto organizma çdo herë fuqizohen për arsye të mos efikasitetit të strukturave përgjegjëse, pra e ndien vetën të paprekshëm në veprimtarinë e tyre dhe është një mesazh shumë i keq për qytetarët e Kosovës. Po ashtu imazhi i Kosovës karshi faktori ndërkombëtar është i dëmtuar dhe do të dëmtohet edhe më tutje. Me ose pa të drejtë strukturat e ndryshme ndërkombëtare me paragjykime e paraqesin situatën shumë më të keqe se sa që është. Mirëpo, ne jemi të vetëdijshëm se nuk është edhe aq e mirë dhe kjo direkt ose indirekt pengon edhe në çështjen e përcaktimit të statusit të Kosovës.

Mos të flasë për perspektivën ekonomike, ku përveç sigurisë fizike indirekt vjen deri te një nivel shumë të ulët i sigurisë ekonomike, prandaj edhe këtu perspektiva e Kosovës zbehet edhe sa i përket integriteteve edhe rajonale edhe më gjer. Është shumë e mirë që pas shumë kërkesave që të transferohen kompetencat në duart e vendorëve më në fund është propozuar që të kalojnë Ministria e Brendshme dhe e Gjyqësisë në duart e vendorëve, por edhe këtu me disa përkufizime. Them sinjerisht se është një gjë shumë e mirë dhe na duhet të krijojmë edhe përvojë edhe mos të kemi iluzionë se me krijimin e këtyre ministrive situata do të ndryshojë shumë në aspektin pozitiv. Për arsye se nuk kemi struktura të mjaftueshme e të përgatitura mirë. Pra, ky është një proces, por është shumë mirë që të fillojë sa më parë, në mënyrë që këto ministri të janë shumë më efikase që do të jenë në bazë të një perspektive më të mirë për Kosovë. Mendoj se edhe më tutje

është e domosdoshme përkrahja edhe financiare në ngritjen e kapaciteteve të këtyre ministrive .Pra, nuk mjafton vetëm stafi politik të jetë në nivel ,por ka shumë struktura që ngërthehen në efikasitetin e këtyre ministrive. Mendoj se duhet të fillohet sa më parë dhe të ketë përkrahjen e të gjithë qytetarëve dhe të strukturave dhe institucionale dhe spektrit politik, në mënyrë që ta kemi një perspektivë më të mirë të përbashkët, edhe një herë them se me këto çështje me këto dy ministri që janë shumë të ndjeshme aty duhet të arrihet një pëlqim ose një lloj konsensusi, në mënyrë që të jenë shumë efikase. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Bajram,ju faleminderit. Për grupin që do të propozojë rekomandime. Ta shfrytëzoj rastin Bajrami tha ka gabime në nomenklaturë nga ana e deputetëve. Kosovës i duhet Ministria e Brendshme jo e Rendit. Pra, vetëm po e sforcuj atë propozim. Numan Balliq, Lulzim Zeneli, le të përgatitet në qoftë se nuk e dorëzon me shkrim.

DEPUTETI NUMAN BALIQ

Najpre neka je selam svima koji su prisutni u sali. Želim da iznesem i nadam se, jednu opravdanu primedbu a odnosi se na vođenju sednica i redosled govornika. Moji neodoljivi utisak je da sam bio među prvima, ako ne i prvi prijavljeni govornika izgleda da govorim dvadeseti. Dakle primedba se odnosi na redosled govornika koja je nastala u redosledu prijavljenih govornika. A kada je u pitanju sigurnosno pitanje želim da kažem da pitanje sigurnosti je ono koje sve nas interesuje. Ja kao čovek zajedno sa Vama kao rukovodioc jedne zajednice, predstavnik, zajedno sa mnogima drugima mislim da moramo svi biti živo zainteresovani da radimo na sigurnosti svih građana, svih etničkih zajednica i naravno sigurnosti svih delova Kosova, kako u onom delu Kosova u kome mi živimo tako i onom delu koje pripada Mitrovici, Štrpcu i tako dalje. Celosan pristup ovom pitanju nažalost do sada je nedostajao. Sa našeg stanovišta sigurnosna situacija jeste mnogo bolja u odnosu na 1999 godinu, u mnogim aspektima ona je i dobra, ali ako se razmatra sistem sigurnosti on funkcionira veoma loše ili ga gotovo nema. Ako su u pitanju institucije, odnosno organi koji se bave pitanjem sigurnosti, policija Kosova, policija Unmika kao i odgovarajuće institucije koje postoje i koje ih prate ili pomaž., moram da istaknem da je važno da svi mi damo jednoglasnu i nedvosmisleni podršku organima reda koji rade na uspostavljanju reda i mira ali da naravno imamo razumevanja, ja sam za to da apsolutno trebamo podržati sve njihove zahteve i za poboljšavanje položaja, i za finansiranje i povećanje plata, naravno da svaki policajac ako želi obaviti svoj posao dobro i ako treba obaviti on mora biti dobro plaćen, ali zato nemožemo poreći njihovu pooptpuno odgovornost i to odgovornost za mnogo stvari koje su se desile zadnjih nekoliko godina, za odgovornost za sve ono što se desilo a što je svima nama poznato. Ako stvari analiziramo od 1999 godine do danas, onda možemo reći da je 1999 godina bila godina kada su uglavnom stradali predstavnici manjinskih zajednica, dok je u toku 2000 - 2001 godine uglavnom došlo do stabilizacije tog stanja tako da sada sa ovog stanovišta mi imamo druge probleme, imamo probleme političkih ubistava, imamo probleme ubistva iz osvete, imamo razne paralelne, kriminalne , mafiozne i svake druge grupe i službe koje deluju na Kosovu, ali naravno imamo i

fenomen veoma prisutan na koji moramo naći odgovor. Taj fenomen manje ili više spomenuli su predhodni govornici radi se o tajnim službama partija i radi se o stranim tajnim službama, ne samo da trebamo nabrojati te probleme, mi svi moramo naći odgovor i moramo biti spremni da damo doprinos da se stane na put, u najmanju ruku da se rasvetli njihovo delovanje, u čijem su interesu partiske službe, koga one štite, dali one pomažu Kosovu, ako pomažu Kosovu dajte da znamo u čemu su pomogli, ako samo pomažu određenom broju ljudi onda je to sasvim drugo pitanje. Ja kao čovek i kao građanin moram da pitam dali je za Parlament Kosova za Vladu Kosova jednak život predsednika Kosova, predsednika Vlade, nekoga ministra ili život jednog običnog građanina, zato što se oni štite na različiti način, jednoga čoveka možda može čuvati pedeset ljudi dok drugi čovek će biti ubijen u sred bela dana, to je fenomen koji zaokuplja sve nas. Ja živim u Pečkoj regiji gde se uobičajilo gotovo je postalo popullarno da u sred dana bude ubijen čovek, čak je i metoda uobičajna vozilo u preticanju puca na vozilo koje je napadnuto i dešava se atentat, krvavo ubistvo, masakri čiji smo svedoci poslednjih nekoliko meseci, posebno su izraženi. Interes svih nas je da se tome stane na put i da se počinioci toga nađu, dakle moraju se zaštititi svi građani, moraju se zaštititi i predstavnici partija, institucija i vlasti, ali ne trebaju i ne smeju biti neki privilegovani a neki ne, zapostavljeni i moraju biti zaštićeni predstavnici svih etničkih zajednica ne samo Albanci nego i Bošnjaci, Romi, Egipćani, Srbi i svi ostali. Meni je drago da su neki politički lideri počeli javno da govore i osuđuju nasilje kao što je to danas rekao gospodin Suroi, ali ovaj problem u kome sam lično učestvovao i na kome radim već šest godina, moram da kažem da sam lično doprineo stabilizaciji sigurnosnog stanja i poboljšanju međuetničkih odnosa između Bošnjaka i Albanaca, a meni se danas dešava da ne mogu da dobijem reč i da govorim dvadeseti, a svojim sam životom doprineo na stabilizaciji sigurnosnog stanja na Kosovu, e pa takav odnos gospodine Daci institucija Kosova i svih institucija prema pojedincima koji doprinose ovoj zemlji to jednostavno nije moguće i to je na štetu ove zemlje. Dakle ja hoću da kažem da ako hoćemo da zaštititi sigurnosti ljudi moramo svi da pomognemo svaki na svome mestu na način koji je odgovarajući, tako da hoću da kažem da mi u naše ime smo osudili sve ono loše što su učinili Bošnjaci, na stotine puta ja sam govorio o lošim Bošnjacima i onima koji su bili u Miloševićevom režimu i oni koji su bili posle 1999 godine, ali očekujem i od Vas i od vođa albanskih institucija da kažu da desilo se nasilje prema manjinama, desilo se nasilje prema bošnjacima prema romima prema egipćanima mi to osuđujemo i to se ne sme ponoviti. Desilo se da je Kosovo napustilo 35000 bošnjaka. Da li znate gospodine Daci da bošnjaci i dalje odlaze sa Kosova, svaki dan po dvadeset bošnjačkih familija napušta Kosovo, da li to znači da je Vama svejedno. Za deset godina mi nećemo moći govoriti o sigurnosti bošnjaka. Zašto? Zato što ih neće biti. To pitanje neće biti na dnevnom redu, ja vas molim kao čovek, ja smatram to ličnim neuspehom zato što sam se godinama borio protiv prošlog režima koji je zlostavljao neke ljude a druge privilegovao i sada dešava se da u Kosovu za koje sam se borio da jednostavno Bošnjaci ne mogu da opstanu. Naš je zajednički posao da osudimo ono što je bilo, da stvorimo uslove za život tih ljudi da ih pozovemo da se vrate i da omogućimo svim tim ljudima da budu sigurni u svakom delu Kosova i u Peći i u Mitrovici, na kraju krajeva u severnom delu Mitrovice žive više stotina čak blizu hiljadu bošnjaka i ne razumem zašto Albanci iz Mitrovice neće da spomenu to pitanje, dakle mi moramo imati jedan pošten, pravedan i ljudski pristup ono što nam prvo nalaže naša vera i ono što nalažu najbolji principi međunarodne zajednice.

Meni je žao što ja sada nastupam sa pozicije čoveka koji izgledao kao da drži predavanje, ali to mi je najmanja želja. Govorim kao čovek koji je lično doprineo svemu ovome i pozivam da svi mi damo doprinos, ja sam spreman da dam svoj doprinos koliko god mogu u svemu ovom što sam radio godinama i da nastavim to i dalje. I da napomenem nadam se da će te mi dozvoliti još samo jednu rečenicu, moram da napomenem da mediji na Kosovu takode nisu bili naklonjeni ovom pitanju i mislim da oni moraju popraviti svoj položaj i da u svim ovim situacijama o kojima govorimo moramo nastupati onako kako je najbolje u interesu svih građana Kosova. Hvala !

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Numan, duhet t'ju them diçka që po e përsëritni disa herë që është fyerje e të gjitha institucioneve, disa nivele. Ju thuani "albanske institucije". Nuk është hera e parë, keni qenë ministër i këtyre institucioneve. Sot ka ministra që nuk janë shqiptarë. Kanë anëtarë të Kryesisë së Parlamentit. Në Parlament ka deputetë të gjitha grupeve etnike, prandaj në qoftëse edhe më tutje instistoni në këtë nomenklaturë, do të kërkoj që nuk keni fjalë më, do të kërkojë që kjo të mos jetë pjesë asnjë.

DEPUTETI LULZIM ZENELI

Z. kryetar. Fjalën time do ta dorëzoj me shkrim.

Një fakt dua ta theksoj në këtë rast se çështja e sigurisë në shumicën e rasteve po konceptohet në bazë të sistemit të izoluar ose të mbyllur. Për vetë faktin se Kosova mendoj se nuk i ka kapacitetet e nevojshme që të ketë një punë serioze në këtë drejtim. Sot, çështja e sigurisë konceptohet mbi politikat që garantojnë angazhimin shumëdimensional e që në shumicën e rasteve i tejkalon edhe kufijtë shtetëror, prandaj mbi këtë bazë kujtoj se formimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme që u theksua shumë herë nga ana e parafolësit është bazë që determinon një proces serioz në këtë drejtim. Pjesën tjetër të fjalimit unë do ta dorëzojë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Xhevat Bislimi, le të përgatitet Fadil Geci nëse insiston ta marrë fjalën.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI

Zoti kryetar, të nderuar deputetë. Çështja e sigurisë është çështje kapitale e një vendi, e veçmas për Kosovën. Nuk do të zgjas shumë për ato që u thanë dhe u përsëritën nga kolegët, por dua të veçoj faktin se forca politike që ka ndërtuar qeverisje dhe që ka fituar zgjedhjet është fshehur që gjashtë vjet pas mungesës së kompetencave. Nuk mendoj se faji është krejt te kompetencat, por te paaftësia e kësaj force politike që të organizojë pushtet. Është shumë e vërtetë se disa kompetenca kanë munguar kur kompetenca kryesore, vota e popullit i është dhënë forcës politike që qeverisë sot. Pra, kompetencat nuk duhet pritur të zbresin nga qielli, por duhet të merren dhe të

organizohen puna, pushteti, qeverisja dhe të ndërtohet siguri për qytetarin tonë, sepse më përgjegjëse se Kosova dhe institucionet e saj për siguri në Kosovë nuk ka dhe nuk do të ketë, pavarësisht se jemi pjesë edhe e sigurisë globale. Këtu me vete, për ta argumentuar atë që thash se është qeverisja aktuale ajo që është bërë pjesë e pasigurisë në vend që të ndodhë e kundërta kam disa dokumente që provojnë edhe implikimin e disa qeverisësve dhe qeveritarëve në korrupsion dhe tërthorazi në krijimin e pasigurisë në Kosovë. Fjala është për një dokument që provon që disa ministra aktual në Qeveri janë implikuar në shantazhin dhe kërcënimin e një politikani lokal që do tërhiqet nga politika. Këta ministra me emër, është zoti Salihu që është zëvendëskryeministër, Haraqija ministër dhe Haziri ministër. Dokument tjetër që dëshmon për implikimin sidomos të Adem Salihut në korrupsion dhe me shantazhin edhe të punëmarrësve ose sipërmarrësve të ndryshëm është edhe ky dokument ose kjo deklaratë e sipërmarrësit e firmës SOPI që provon se për punën që ka bërë në Ferizaj është shantazhuar nga komuna e atëhershme nga drejtuesit e kësaj komune Adem Salihu dhe nga bashkëpunëtorët e tij që të paguajnë mito dhe kanë marrë mito. Ka edhe fakte të tjera që dëshmojnë implikimin e Adem Salihajt, sidomos në shitblerje të veturave me një person nga Deçani që tërthorazi mund të ketë edhe implikime politike kur dihet gjendja në këtë rajon dhe vrasje të pazbuluara deri më tash. Pastaj kemi rastin e Melihate Tërmerkollit që vetëm disa ditë më parë deklaroi publikisht se nuk do të jepet asnjë cent për renovimin e pallatit të ish-Rilindjes dhe fakti është se kjo ministresh dhe ministria e saj kanë lejuar ose i kanë paguar firmës "Çlirimi" 2 milion € Tash shtrohet pyetja -Kënd e mashtrojnë këta qeveritare dhe kujt i duhen këto mashtrime, këto lidhen tërthorazi ose ndikojnë herë-herë edhe drejtpërdrejtë në sigurinë e Kosovës dhe të qytetarëve. E kam përmendur edhe kam kërkuar përgjigje nga kryeministri në mbledhjen e kaluar për një marrëveshje ndërmjet Haserllokut dhe Rugovës. Sipas Haserllokut vazhdon të paguhet nga 100 mijë euro afërsisht në muaj. Kërkoj prapë te di nga kryeministri që mungon, a vazhdon të paguhet ky person që është kryetari i një shoqate në Londër me nga 100 mijë euro në muaj nga buxheti i Kosovës? Kjo është arsye pse mbështes propozimin dhe kërkesën tashmë të bërë shumë herë për formimin e një komisioni hetimor, praktikë kjo edhe në shtetet e tjera dhe veçmas në SHBA në të cilën shpeshherë kur na duhet për ndonjë pikë politike thirrëmi. Në SHBA deri me tash janë ngritur mbi 1000 komisione të tilla hetimore për çështje të caktuara që i bie më shumë se 5 për vit. Pra, nuk ka pse mos të ngrihet një komision i tillë hetimor që do t'i verifikonte të gjitha akuzat e opozitës, por edhe të forcave ose të grupeve të tjera të interesit, të individëve të ndryshëm që janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen, qoftë nëpër gazeta, qoftë edhe nëpër organet e drejtësisë, drejtësi e cila mjerisht i mungon Kosovës, sepse po të ekzistonte do të jepte përgjigje në shumë akuza dhe to ta sqaronte situatën dhe to ta lehtësonte gjendjen politike dhe të sigurisë në Kosovë. Se ka rënë besimi i qytetarëve tek institucionet vendore e provuat edhe me faktin e krijimit të forumit politik dhe të iniciativës nga forca politike që ka fituar zgjedhjet. Fakti se është krijuar ky forum mbi institucional tregon për mosbesimin në ritje edhe të qytetarëve edhe të politikës të këto institucione. Një çështje tjetër që e rëndon gjendjen e sigurisë në Kosovë, mendoj se është edhe mesazhi tashmë i përditshëm ose mesazhet kërcënuese dhe shantazhet që vijnë nga qendrat e ndryshme qofshin ato ndërkombëtare ose vendore për trazirat e mundshme në Kosovë tashmë të paragjykuara dhe shtypjen e tyre me dhunë ose shtypjen e tyre nga forcat ushtarake policore. Mendoj se këto mesazhe kërcënuese nuk i shërbejnë stabilitetit dhe gjendjes në

Kosove ,sepse ne fund të fundit, çështja e Kosovës nuk mund të zgjidhet me dhunë dhe nuk do të dëshironin kurrë që të përsëritet dhuna, por të respektohet vullneti politik i qytetarëve të Kosovës dhe interesi i sigurisë në Ballkan, e vetmja zgjidhje për të tejkaluar gjendjen në Kosovë dhe në rajon. Po e përsëris edhe një herë, është mirë që seriozisht të ndalemi të kemi guximin, burrninë dhe ta shohim të vërtetën në sy, ta njohim gjendjen, ta vërtetojmë atë, ta hetojmë dhe në fund të nxjerrin konkluzionet, të marrin masat të cilat do të kontribuonin në rritjen e sigurisë e jo në rritjen e pasigurisë, siç po ndodhë tash sa vjet.

Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Fadil Geci, le te përgatitet Bislim Hoti

DEPUTETI FADIL GECI

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë .Dëgjuam shumë fjalë që nuk janë gjë tjetër veç na bëjnë të qeshim dhe këtu vlen një fjalë e urtë e popullit që thotë" i qeshni të qesh". Çështja e sigurisë është një temë dhe një preokupim kryesor në Kosovën e pasluftës. Kjo çështje mund të analizohet në dy aspekte .Së pari, siguria e jashtme e Kosovës, kufijtë e siguria e Kosovës. Siç dihet u tha edhe më parë nga bashkëfolësit se për sigurinë e jashtme të Kosovës kujdesen forcat e KFOR-it. Andaj thuhet se Kosova sot ka kufijtë më të sigurt në rajon. Një aspekt tjetër i sigurisë në Kosovë është siguria e brendshme. Në këtë aspekt mund të themi se ka probleme dhe se niveli i sigurisë së brendshmen Kosovë është më i ulët se sa ai i sigurisë së jashtme . Por ndërkombëtarët dhe vendorët e kanë ditur dhe them se siguria stabile në një vendi nuk mund të garantohet tërësisht pa organizimin shtetëror në këtë fushë. Prandaj element i përbashkët i këtyre dy aspekteve të sigurisë është edhe për sigurinë e jashtme edhe për sigurinë e brendshme, kompetencat janë pothuaj se plotësisht në duart e ndërkombëtarëve deri më tani. Kështu, përderisa siguria e jashtme është në kompetencat e plot të KFOR-it, ajo e brendshme është në duart e policisë së UNMIK-ut dhe pjesërisht edhe në duart e Shërbimit Policor të Kosovës ,që edhe më tutje është në mbikëqyrje të UNMIK-ut.Pra,edhe çështja e sigurisë së përgjithshme në Kosovë është një çështje e rezervuar,në të cilën vendorët, në shumicën e rasteve, vetëm akuzohen, por ata nuk kanë pasur kompetenca në duart e tyre deri tani. Në këto gjashtë vjetët e pasluftës Kosova është përballur me të dyja këto probleme në forma dhe në mënyra të ndryshme. Kështu sot e kësaj dite ekziston rreziku i përhershëm nga pala maqedonase për aneksimin e rreth 2500 hektarëve në kufi me Kosovën në bazë të një marrëveshje të fshehtë me Serbinë. KFOR-i e sidomos brigada shumëkombëshe e Lindjes që komandohet nga amerikanët së bashku me institucionet qendrore deri tash kanë mbajtur një qëndrim parimor, duke shtyrë këtë çështje të kufirit ndërmjet të Kosovës dhe Maqedonisë për një periudhë të mëvonshme, pra në një të ardhme të afërt mbetet që kjo çështje të zgjidhet në bazë të kufijve ekzistues të Kosovës të njohur dhe përcaktuar shumë vite më parë dhe që garantohen edhe sot me Kornizën Kushtetuese. Në anën tjetër edhe siguria e brendshme e Kosovës është lëkundur herë pas here. Vrasjet me motive politike pas luftës, mos arrestimi i autorëve të këtyre vrasjeve, veprimi gjysmë ilegal i shërbimeve të fshehta të vendeve të ndryshme e sidomos të

vendeve fqinje, mungesa e lirë dhe e plotë të qarkullimit të lirë në një pjesë të Kosovës në ato veriore, janë disa prej sfidave me të cilat po ballafaqohet Kosova në këto vitet e pasluftës. Pra, vrasjet nuk po ndalen. Autorët e vrasjeve nuk po arrestohen. Drejtësia po vonohet, strukturat e ardhshme nuk po shihen e sidomos tash në pjesën veriore. Këto probleme e rendojnë çështjen e sigurisë së brendshme në Kosovë, pra kërkojnë zgjedhje më të shpejtë për të shtuar shkallën e sigurisë së brendshme në Kosovë. Dihet se Kosova është ende nën protektoratin ndërkombëtar në bazë të Rezolutës 1244, por prej asaj kohe të miratimit të kësaj rezolute në Këshillin e Sigurimit në Kosovë janë bërë ndryshime të mëdha pozitive. Pra, tash kur i kemi zgjedhur institucionet e Kosovës si :presidencën, Parlamentin, Qeverinë, pastaj Shërbimin Policor të Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, gjykatat, prokuroritë e format e tjera të organizimit institucional të një shteti. Mirëpo, shtohet pyetja sa janë kompetente dhe sa kanë përgjegjësi të gjitha këto institucione të Kosovës për çështjen e sigurisë së sajë. Nga praktika e deritashme mund të thuhet se të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës më tepër kanë qenë vrojtues të situatës se sa kompetent për të zgjedhur situatat emergjente në fushën e sigurisë. Edhe në këtë drejtim duhet dhe ekziston gatishmëria në radhë të parë e Përfaqësuesit Special zotit Petersen për bartjen e një pjese të kompetencave në fushën e sigurisë në duart e vendorëve. Nënshkrimi i Rregullores për formimin e dy ministrive të reja :Ministritë së Drejtësisë dhe Ministritë së Brendshme dhe pavarësimi i plotë i Shërbimit Policor të Kosovës deri në fund të këtij viti, janë hapa të mëdhenj në shtimin e përgjegjësisë vendore për sigurinë e brendshme në Kosovë. Marrja e përgjegjësisë nga ana e vendorëve për këto dy fusha të rëndësishme të sigurisë, me siguri se do ta ngritin nivelin e sigurisë së brendshme në Kosovë, por kjo nuk do të thotë se organet e drejtësisë ose të policisë së UNMIK-ut nuk e kanë kryer punën me sukses në Kosovë .Kur dihet se vendorët i njohin më mirë rrethanat në Kosovë, atëherë mund të besohet se siguria do të jetë në një shkallë më të lartë. Kosova ka mundësinë të jetë një shembull i mirë i një vendi të sigurt dhe stabil në rajon ,duke ndarë kompetencat ndërmjet vetës ndërkombëtarët e vendorët, atëherë edhe shkalla e sigurisë së përgjithshme në Kosovë do të jetë në nivel më të lartë. Pra ,është e domosdoshme që çështja e sigurisë të centralizohet në nivel vendi. Komisioni parlamentar për Siguri duhet të marrë detyrat që i takojnë ngase një Kosovë e sigurve do të thotë një siguri më e madhe në rajon, do të thotë një hap ma i shpejt në Evropë.

Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

DEPUTETI BISLIM HOTI

Ju faleminderit zoti kryetar, përshëndetje kolegë deputetë, përshëndetje të veçantë për mysafirët prapa që shumica nga ta mezi presin që të diskutohet edhe çështja e personave të zhdukur. Është shumë e arsyeshme që sot diskutohet për çështje të sigurisë dhe në mënyrë të hapur po jepen sugjerimet, vërejtjet, propozimet që do t'i kontribuojnë demokracisë dhe sigurisë së vendit si dhe krijimit të një strategjie pasi së shpejti do t'i kemi Ministrinë e Rendit dhe atë të Drejtësisë. Siguria do të thotë kur të gjitha komunitetet do t'i gëzojnë të drejtat e tyre, pa u penguar nga të tjerët dhe të trajtohen në mënyrë të barabartë nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare. S'di sa kam të

drejtë të them sa i thuhet siguri kryefamiljarëve që sa vite presin më të dashurit e tyre. A i thuhet siguri personave që ende jetojnë nëpër kampe. A i thuhet siguri atyre që e lëshuan Kosovën për 6 vjet dhe jetojnë në kushte jonjerëzore në vendet e rajonit? Tashmë ata kanë humbur besimin, arsimin, punësimin, shëndetin, shpresën për të jetuar dhe se kthimi i tyre nuk mund të sigurohet ashtu siç shkruhet në letër, sepse veprimtaria mbi baza institucionale nuk po vërehet ende që 6 vjet. Siguri do të thotë edhe punësimi e për fat të keq sot pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës dhe të UNMIK-ut e lëshuan sallën dhe duhet të bëja një pyetje-Pse që gjashtë vjet nga radhët e komunitetit tonë egjiptas asnjë person nuk gjendet në Shërbimin Policor të Kosovës. Kemi edhe shumë çështje të tjera me interes që kanë të bëjnë me sigurinë. Siguri i thuhet edhe asaj që qo do të thotë t'i shprehesh lirshëm brengat e një komuniteti nëpërmjet mediave të shkruara ose atyre elektronike. Cila është siguria në Kosovë kur nuk zbulohen aktorët e krimeve, të atyre të dhunës dhe të gjitha veprimtarive kriminale dhe të atyre që nxisin urrejtje ndëretnike dhe politike. Policia e UNMIK-ut dhe ajo e Kosovës ende nuk po arrijnë përvojën e duhur që t'i zbulojnë ata që vrasin mu në mes të ditës. Është e qartë se me dy muaj kurs nuk mund të arrihet një gjë e dëshiruar. Thotë një fjalë popullore "Siç është vendi bëhet kuvendi," andaj ne jemi në Kosovë dhe policia aktorët e krimit në të gjitha fushat duhet t'i bëjë transparent para opinionit kosovar dhe të lihet më ajo praktikë e vjetër sa herë që ndodhin krimet thuhet hetimet vazhdojnë, sepse kështu do të jemi dëshmitarë të veprimtarive kriminale të reja. Prandaj mendojmë se ka ardhur koha që të krijohet një kuadër i mirëfilltë ligjor me një zbatim efektiv ku duhet të punohet në mënyrë të paanshme dhe të respektohen në tërësi të drejtat e njeriut, të ekzistojë një qasje e barabartë në gjyqësi dhe se askush mos të jetë mbi ligjin, ku nuk do të ketë falje për ata që shkelin ligjin. Është alternativë e vetme që të gjithë së bashku të kontribuojnë për krijimin e masave të rrepta ligjore për t'i luftuar krimet e motivuara mbi baza etnike, politike, ekonomike, shoqërore dhe financiare. Kolegë deputetë, unë shpresojë se në Kosovë mund të arrihet një ligj i fortë sigurie i cili do të ishte gur themeltar për ndërtimin e institucioneve të Kosovës dhe ku do të kenë qasje të barabartë të gjithë qytetarët e saj pavarësisht përkatësin e tyre kombëtare, fetare sepse me një ligj të fortë do të kemi të gjithë qytetarët një jetë pa brenge, më të lumtur dhe më me perspektivë. Ju falem nderit

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit!

Ylber Hysa, le të përgatitet Fartmir Rexhepi edhe pastaj shohim se çka do të bëjmë

DEPUTETI YLBER HYSA

Është shumë me rëndësi që më në fund na u dha shansi të debatojmë për siguri në Parlamentin e Kosovës, ndonëse në mënyrë shumë të improvizuar, kjo edhe për fatin se morëm informata që më në fund do të fillojë bartja e transferim të kompetencave për krijimin e dy ministrive kaq të rëndësishme atë të rendit dhe të brendshëm. S' duhet harruar që kjo ndodhë në një kohë të një fragmentarizmi të famshëm në shoqëri dhe në elitën politike kosovare kur mbizotëron një cens i madh i pasigurisë dhe në këtë aspekt duket se ka pritje të skajshme dhe kalkulime që bartja e kompetencave do t'i zgjedhë

shumë nga këto probleme, nuk ka nevojë ndoshta në ilustrim të madh për të parë në fakt se sa ka kompetenca SHPK-ja dhe patroni i tyre në UNMIK në fakt kjo do të mjaftonte sikur vetëm të krahasoni në informatë kur këtu i kishim dy njerëz kryesorë. Njeriu i parë i SHPK-së me uniformë të bardhë, para disa kohësh kishte kërkuar nga kolegu i tij që të intervistonte një të arrestuar që lidhej me një rast të rëndësishëm dhe ai nuk e kishte marrë këtë të drejtë. Ndoshta, kjo në mënyrën më të mirë e tregon faktin se si, në çfarë kushtesh punojnë ata që sot na prezantuan sigurinë dhe pjesa ndërkombëtare e tyre. Ju garantoj që kur nuk do të kishte marrë guximin ta bënte një paraqitje të tillë para Parlamenti të tillë në vendin në të cilin është ai kurrë nuk do ta pranonte një formë të tillë të komunikimit. Kjo në fakt shtron shumë çështje, në cilin stad gjendet SHPK-ja .Ajo përkundër rezultateve nuk ka një status ligjor, nuk ekziston një ligj për SHPK-në, nuk ekziston statuti i beneficuar. Nëse një pjesëtar i SHPK-së do të vritej në aksion as familja e tij nuk do të gëzonte asgjë. Përkundër kësaj sukseset e SHPK-së në fakt më shumë janë në administrim se sa në aspektin operacional. Sa për ilustrim. Kryeqytetin e Kosovës me rrethinë natën e mbrojnë katër patrulla , tri prej tyre janë të lidhura me aspekte statike, ndërsa një mund të qarkullojë andaj edhe mos çuditni pse gollaku aq rrallë e sheh pjesëtarin e policisë deri në kufi me Serbinë, po ashtu është një pjesë tjetër e cila këtu u përmend fakti i shërbimeve të inteligjencës më duket se mirë e ngriti zoti Hamiti këtë çështje, mirëpo në fakt një pjesë e Shërbimit të zbulimit që ndërkohe në SHPK financohet me paratë e zotit Hamiti dhe me paratë e mija dhe të qytetarëve, kjo është KSB-ja e cila është byroja për krime serioze e cila merr pjesën më të madhe dhe në pjesën e Shërbimit Policor të Kosovës vetëm për vitin 2004 i ka shfrytëzuar diku 1.7 milion euro, d.m.th. shumica e parave të dedikuara për operacione të fshehta. Nëse ndalemi e mendojmë se çka ka ndodhur në vitin 2004 atëherë nuk do shumë koment dhe në fakt kjo, në mënyrë të drejtpërdrejtë e lidhë një çështje tjetër kaq me rëndësi. Cili është në fakt kontrolli civil i këtij relacioni, nëse një pjesë e SHPK-së financohet nga buxheti i Kosovës dhe kontrollohet nga ju kosovarët dhe nuk ka asnjë raport ndaj këtij Parlamenti, atëherë ndaluni mendoni se çfarë ja vlen fjala e shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së i cili kërkon institucionalizim të tolerancës. Ajo në fakt që i duhet Kosovës është institucionalizimi i sigurisë dhe, nëse në këtë aspekt disa nga pjesëtarët e partive këtu sot janë bërë aq naiv dhe indiferent duke pretenduar se në Kosovë nuk ka shërbime inteligjente që lidhen me partitë e tyre, atëherë duket se këtu ka probleme në funksionimin e partive. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë unë do t'u kisha propozuar që ta ngrinim një komision që c tashmë në fazën e ngritjes dhe bartjes të këtyre kompetencave do ta bënte një lloj prerje për të vërtetuar nëse shërbime të tilla ka dhe nëse të gjitha këto akuza që gjithë së bashku i dëgjuam janë të vërteta ose jo. Andaj, në mënyrë që ky debat të mos mbarojë në mënyrë shterpe, siç ndodhi me ekonomi dhe decentralizimin, ju ftoj që në fund të krijojmë në lloj komisioni që do t'i ngrihej nga ky Parlament i përbërë nga pjesëtarët e të gjitha partive, që do të bëhej si një komision, i cili pastaj do ta informonte Parlamentin për gjendjen në të cilën gjendet Kosova , para bartjes së këtyre kompetencave. Pra, bartja e tyre në asnjë moment nuk duhet t'i shtojë iluzionet që do ta arrijë sigurinë në Kosovë. Ne do të vazhdojmë të kemi probleme shumë serioze, sidomos, në këtë fazë të ndarjes kaq të madhe partiake dhe sidomos në fazën kur ngritën negociatat për Kosovën. Atëherë, nëse e keni seriozisht, do t'ju kisha propozuar që ta ngremë këtë komision në mënyrë që këto pyetje mos t'i bëjmë publike

para qytetarit, po të përpiqemi t'i përgjigjemi atë. Ne jemi të gatshëm të kontribuojmë në këtë komision.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falem nderit dhe Fatmir Rexhepi, urdhëroni

DEPUTETI FATMIR REXHEPI

Ju falem nderit zoti kryetar, megjithatë kohën time për diskutim do ta lë për temën tjetër dhe do t'i përgjigjem pozitivisht kërkesës tuaj që ta dorëzoj me shkrim. Ju falem nderit!

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falem nderit shumë.

Unë propozoj një orë pushim për drekë dhe në orën tre vazhdojmë me rendin e ditës

Ju falem nderit!

Pas pauze, Seanca vazhdoi punën)

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

A mund të vazhdojmë debatin. Sipas ranglistës, për fjalë është paraqitur.... Më parë e kërkon fjalën Xhaviti. Urdhëroni...

DEPUTETI XHAVIT HALITI:

Zoti kryesues, unë nuk pajtohem me mënyrën se si po përpiqeni të monopolizoni gjithçka si subjekt politik. Kryesia e Kuvendit të Kosovës i ka 8 anëtarë dhe, në mungesë të Kryetarit të Kuvendit, seancën e udhëheqë bashkëkryesuesi. Kështu ka funksionuar gjithmonë. Unë e di që në Rregullore, të cilën e kemi miratuar këtu në mirëbesim, shkruan diçka krejt ndryshe, por sipas Kornizës kushtetuese dhe sipas të gjitha rregullave në fjalë, në vendin ku jeni ulur ju, do të duhej të ishte Rama, dhe bashkëkryesues i Ramës do të duhej të ishte ai që vjen me radhë.

Mendoj se nuk është mirë një formë e tillë e veprimit. Në qoftë se anëtarët e Kryesisë së Kuvendit janë për dekor për me ndejt atje, ju mundeni me i thirrë dhe Sekretarinë e Kuvendit me ulë aty komplet dhe të bëni logje me ta. Mendoj se nuk është vepruar drejt dhe nuk është në funksion të bashkëveprimit dhe të bashkëfunksionimit si Kuvend.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falem nderit. A ka kush tjetër? Urdhëroni Naser, për çka është fjala.

(Ndërhyrje e deputetit – pa kyçje të mikrofonit – nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Zoti Haliti, ju shtruat vërejtjen tuaj dhe për këtë mund të bisedojmë. Për këtë që sot e bëj, jam drejtpërdrejt i autorizuar nga Kryetari i Kuvendit në bazë të Rregullores së punës dhe duhet ta vazhdojë këtë punë.

Ndërkaq, për këtë zoti Osmani, ne do të bisedojmë dhe do të përcjellim vërejtjet tona të përbashkëta.

Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori, le të përgatitet deputeti Genc Gorani. Urdhëroni zoti Brajshori.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI:

I nderuari zoti kryesues,

Unë kam dorëzuar me shkrim fjalën time në kuptim të asaj se do t'i kontribuojmë në përgjithësi temës që kemi në rend të ditës. Ju faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit. Le të evidencohet dhe të përcillet materiali. Urdhëroni Genc, pastaj le të përgatitet deputetja Fatmire Kollçaku.

DEPUTETI GENC GORANI:

Ju falënderoj zoti kryesues. Do të jam sa më i shkurtër, me qëllim të ngjashëm si deputetë tjerë, të cilët e dorëzojnë fjalimin me shkrim. Kjo për arsye se kisha dashur të tërheq vëmendjen në një segment shumë preciz në lidhje me sigurinë.

Të nderuar anëtarë të Qeverisë, Kryeministër, mysafirë të nderuar, zonja dhe zotrinjë deputetë,

Kisha dashur të vë theksin me disa fjalë në relacionin e rëndësishëm që ekziston në mes të sistemit tonë të arsimit fillor, atij të mesëm dhe të sigurisë. Në sistemin tonë shkollor janë të regjistruar afër 420 mijë nxënës. 27 mijë punëtorë arsimor merren me edukimin dhe arsimimin e fëmijëve tanë. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, ne të gjithë banorët e Kosovës, jemi të ndërlidhur nëpërmjet sistemit shkollor. Rëndësia e sistemit shkollor, si themel i zhvillimit shoqëror demokratik, është kapitali, dhe rëndësia për ardhmërinë tonë është vendimtar. Mirëpo, ky segment i shoqërisë sonë, që është më i ndjeshmi, nuk ka përkujdesje të duhur në aspekt të sigurisë. Gjendja është alarmante, në mos për ndonjë arsye tjetër – sepse mungojnë të dhëna të sakta, ngase mjedisi ynë shkollor është kaheërë cak i krimit të organizuar brenda Kosovës por edhe krimit të organizuar regjional. Ky segment i popullsisë është më i rëndësishmi, ndërkaq është më i pambrojturi nga intencat kriminale. Dëmet që shkaktohen sot, do të na kushtojnë shumë, dhe ndoshta edhe nuk do të mund të korrigjohen.

Në anën tjetër, në vetë gjirin shkollor ndodhin dukuri që na japin të kuptojmë se devijimet sociale të sotme janë po ashtu burim i kriminalitetit të nesërm. Me kushtet e punës dhe të aftësisë që ne i ofrojmë punëtorëve të arsimit, me investimet tona në sistemin tonë shkollor, mund të jemi të sigurtë se krimi i organizuar dhe kriminaliteti i të gjitha llojeve do ta ndiejnë veten të pacenuar. Qëllimi është që Ministria për Arsim duhet sa më shpejt të adresojë këtë problem, dhe gjendja e sistemit tonë shkollor - në veçanti gjendja e sigurisë e meriton një seancë të dedikuar për këtë. Ju faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të faleminderit zoti deputet. Fjalën e ka Fatmire Kollçaku, deputete e ORA, le të përgatitet deputeti Kamber Kamberi. E keni fjalën zonjë.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU:

Faleminderit. Që në fillim kisha dëshiruar të theksoj diçka. Që t'i vëmë në rend dite dy çështje kaq të rëndësishme siç është çështja e personave të pagjetur dhe në anën tjetër çështja e sigurisë në vendin tonë dhe të tentojmë që t'i absolutojmë për një ditë, mendoj se, së paku - nuk është serioze.

Sa i përket vërejtjes së dytë, që kam - është edhe tendenca që është bërë, si me thënë, njëfarë dukurie që ne që mbetemi për pjesën e pasdites zakonisht fillojmë të ndihemi, ose ishte dashur të ndihemi keq, sepse faktikisht nuk po i dorëzojmë diskutimet me shkrim, por po tentojmë të flasim.

Meqenëse po flas tash për çështjen e sigurisë dhe vij nga Rrafshi i Dukagjinit dhe qysh më parë parafolësit e mi cekën, domethënë që kemi pas 191 të vrarë dhe 95% të rasteve të pazbardhura të krimit - ndihem shumë e thirrur që në emër të tyre do të doja të flas diçka për çështjen e sigurisë dhe nuk mund ta tërheq domethënë fjalën apo ta dorëzoj vetëm me shkrim, edhe pse - normal mënyra e tillë ndoshta e ka edhe atë validitetin e njëjtë.

Unë desha në fillim të shtroj çështjen: çka po bëjmë ne si deputetë dhe Kuvendi i Kosovës konkretisht?

Zonja e zotërinj,

Qysh më parë në këtë foltore, që faktikisht është e shenjtë, janë thënë shumë akuza të rënda, të adresuara në adresa konkrete. A mendoni ju se unë këtë po e flas mu për një shkak, sepse nga kontaktet që kam pas me njerëz, dhe tash këtë e kemi të imponuar mu për shkak të postit që kemi, jam e thirrur t'i përcjell shqetësimet e tyre. Në qoftë se në këtë foltore thuhet akuza aq të rënda, mendoj se dikush duhet të përgjigjet. Nuk i prejudikojmë rastet. Le të fitojë e drejta dhe ligjshmëria. Mirëpo, ai që paraqet akuza, apo ai që është i apostrofuar, duhet të dihet se kush e ka të drejtë.

Mendoj se kjo Qeveri nuk ka arsye, ose vetë Kuvendi, të pengojë formimin e një komisioni hetimor thjeshtë për shkak të opinionit dhe të dihet cilat janë faktet. Nuk mund të mohojmë se këtu, prej fillimit dhe prejse që jam unë në këtë përbërje të legjislacionit -

janë thënë shumë akuza të rënda në këtë Kuvend dhe asgjë nuk është bërë në definimin e këtyre rasteve.

Tjetra, që flitet gjithashtu, për këto shërbime të inteligjencës. Dihet që dyshojmë se ka, normal edhe të vendeve tjera, por është e pamohueshme që kemi edhe të atyre partiake. Pse nuk flitet haptas për këto? Nëse nuk ekzistojnë, le të flet dikush që është i thirrur. Nëse ekzistojnë, ta dimë pse. Do të thotë po flitet se ka njohuri, po dihet se ekzistojnë. Faktikisht ato po mbjellin frikë te popullata.

Tjetra që desha ta them, është po ashtu ajo që edhe më parë e kam cek, se po kërkohet vazhdimisht bashkëpunim i qytetarëve me policinë. Nga përfaqësuesi i policisë dëgjuam se vyen kohë për konstituimin e policisë, vyen arsimimi i mëtutjeshëm. Por, kanë kaluar gjashtë vite...! Unë nëse nuk jam prekur konkretisht, ndoshta edhe mund të toleroj, por ai që ka personin e vrarë familjar – me siguri nuk mund të pretë që policia jonë të aftësohet edhe nja gjashtë viti së paku dhe atëherë ta fillon zbardhja e fateve të tyre. Në njërin anë, e kam respektin për policinë dhe për të gjitha veprimet e tyre, por ajo çka dëgjuam nuk arsyeton ato shifrat konkrete që po i dimë të gjithë kur është fjala për zbardhjen e krimeve – vrasjeve.

Po ashtu, mund ta theksoj vetëm edhe një segment, sepse është shumë me rëndësi. Është çështja konkrete, me të cilën merrem – është shëndetësia, ku më së paku duhet për t'u ndie i sigurt, sepse normal nëse nisemi prej shëndetit të njeriut, dimë se këtu është apostrofuar shumë dhe jo vetëm në shëndetësi por edhe në nivele tjera sikur është korrupsioni, joprofesionallizmi. Çfarë është bërë në këtë drejtim që të kemi sigurinë e shëndetit tonë? Vetëm shkoni në një barnatore. Mundeni me pa se edhe fëmijët blejnë barna – si me kanë bombona, dhe aty kemi të bëjmë me sigurinë e shëndetit.

Çka është bërë konkretisht - për shembull - që në barnatore të jenë njerëz profesional, ku janë reçetat. Sot reçeta në Kosovë është vetëm sa për sy e faqe, sepse shpeshherë nga barna esenciale e shpesh edhe mungojnë barnat dhe nuk ka. Në barnatore njerëzit shkojnë si në shitore – blejnë çka të donë, e këtu është shëndeti!

Edhe për një gjë tjetër, është përmendur trafikimi. Pse nuk bëhet asgjë për trafikimin e qenieve njerëzore – prostitucionin. Prostitucioni bartë me vete sëmundje ngjitëse. Domethënë dihet fort mirë se në njëfarë mënyre është duke funksionuar në Kosovë pa pengesë. Pse policia nuk po bën më tepër që ta ndërprejë një zinxhir të tillë. Po flas këtu konkretisht, edhe për nga aspekti i shëndetit publik.

Ne duhet të dalim me një qëndrim. Nëse është nevoja, të formohet një komision hetimor i Kuvendit, apo Qeveria t'i marrë seriozisht vërejtjet e paraqitura në këtë Kuvend, sepse mendoj çdo deputet që flet këtu është i autorizuar prej dikujt, dhe nuk është rastësisht. Më vjen keq se të gjithë s'kemi emra të njohur deri tani, por emri krijohet me kohë. Domethënë, këtë e kemi krijuar së paku dhe deri tash kemi dhënë njëfarë kontributi që t'na respektohet fjala e jo me grimasa a me buzëqeshje ironike të jetë e përcjell drejt çdo diskutimi të dikujt që nuk na pëlqen. Faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit zonja deputete. Fjalën e ka deputeti Kamber Kamberi, le të përgatitet deputeti Berat Luzha. E keni fjalën, zoti Kamberi.

DEPUTETI KAMBER KAMBERI:

Faleminderit. Do të përiqem që praktikisht të jem i shkurtër, jo vetëm deklarativisht, meqenëse na pret një pikë tjetër e rendit të ditës e që është mjaft e rëndësishme dhe duhet të shprehim keqardhje për këta që po presin këtu në sallë, së bashku me ne.

Kujtoj se gjendjen e sigurisë e dimë të gjithë dhe çfarë mbretëron këtu në Kosovë dhe do t'kisha thënë se duhet kërkuar zgjidhje. U prek kjo çështje, dhe së pari ose si pikë e parë duhet që të kalojnë kompetencat, ose të krijohen ministritë për punë të brendshme dhe ajo e drejtësisë.

U tha këtu po ashtu, se nuk do të zgjidhet problemi dhe nuk do të përmirësohet ku ta di sa gjendja e sigurisë në Kosovë. Unë kujtoj se UNMIK-u tash nuk na jep llogari neve, dhe kujtoj se me krijimin e këtyre ministrive atëherë është e drejtë e jona të kërkojmë përgjegjësi dhe të kërkojmë punë transparente të këtyre ministrive.

Edhe një çështje tjetër që dua ta theksoj shkurtimisht, është se kujtoj që duhet të bëhet edhe një punë, të thirren edhe ata njerëz që kanë punuar përpara dhe mendoj se kemi disa profesionist që kanë punuar në këto fusha, e gjithashtu edhe prej TMK të thirren njerëz që kanë punuar përpara dhe janë profesionist. Kujtoj se nuk kemi njerëz të qesim poshtë, duhet t'i kemi parasysh të gjithë këta deri sa të krijohen edhe kuadro të reja këtu në Kosovë. Faleminderit për mirëkuptim.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Berat Luzha, le të përgatitet deputeti Nazim Jashari. E keni fjalën zoti Berat.

DEPUTETI BERAT LUZHA:

Të nderuar kolegë deputetë,

Megjithëse sapo të dalë nga lufta e përgjakshme, Kosova ka bërë hapa drejt stabilizimit të tërësishëm, por edhe pas gjashtë viteve të krijimit të paqes dhe të ndërtimit të një shoqërie demokratike çështja e sigurisë është mjaft e brishtë. Vendin e mundojnë probleme të kimit të organizuar duke përfshirë këtu edhe krimin politik që shkaktojnë probleme të theksuara për sigurinë e tërësishme të popullatës së Kosovës, sidomos për pjesëtarët e bashkësive etnike pakicë. Popullsia shumicë e ka për detyrë politike dhe humanitare që të krijojë kushte dhe rrethana të favorshme të sigurisë për tërë popullsinë si dhe të krijojë tolerancë ndëretnike dhe raporte demokratike në shoqërinë kosovare..

Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme që janë bërë, problemet ndëretnike në Kosovë nuk janë tejkaluar. Përkundrazi, ato qëndrojnë mbi interesat e përgjithshme të Kosovës dhe rrezikojnë të ardhmen e vendit. Këto probleme nuk janë krijuar për një ditë dhe as që mund të zgjidhen për një ditë. Kurse, për t'i zgjidhur problemet e grumbulluara ndëretnike, nuk mjafton vullneti politik vetëm i njëjës palë. Duhet vullnet i dyanshëm, si i shqiptarëve ashtu edhe i serbëve dhe i bashkësive të tjera. Për fat të keq, sot problemet e sigurisë janë fokusuar gati vetëm në raport me popullsinë serbe e cila ende manipulohet nga Qeveria e Beogradit dhe organizohet në strukturat paralele të Serbisë në Kosovë. Mendoj se strukturat paralele të sigurimit serb në Kosovë kanë një rol tejet negativ për sigurinë e përgjithshme në vend.

Problemi i sigurisë dhe krimit të organizuar ekziston edhe për popullsinë shumicë, edhe për bashkësitë tjera etnike që jetojnë në Kosovë. Vrasjet misterioze, ndonjëherë edhe të karakterit politik si dhe shpërthimet gjithnjë e më të shpeshta, nuk po zbardhen kurrë. Korrupsioni i një shkalle të lartë, që ka depërtuar edhe në instancat më të larta - deri në kreun politik, pastaj prostitucioni dhe tregtimi me qenie të gjalla, tregtimi dhe shpërndarja e drogë e tjera - janë vetëm disa nga pikat kyçe të krimit, të cilat seriozisht po dëmtojnë ardhmërinë e Kosovës.

Për të siguruar një zhvillim dhe siguri për qytetarët e Kosovës, krimi duhet të goditet në kokë, duhet të goditet edhe në nivele më të larta - në institucione të vendit, ku siç dihet tashmë - nuk ka transparencë dhe ka aq shumë afere e skandale për keqpërdorime financiare dhe për korrupsion. Kabineti qeveritar tashmë ka marrë akuza nga shumë anë dhe është detyrë e tij që t'iu përgjigjet deri në imtësi atyre akuzave. Ndryshe nuk mund të qëndrojë sikur nuk ka ndodhur asgjë dhe pa bartur asnjë përgjegjësi.

Në luftë kundër krimit të organizuar, organet e sigurisë dhe ato të drejtësisë deri tash nuk kanë pas ndonjë sukses që meriton të lavdërohet. Parulla si "askush nuk është mbi ligjin" ose "për krimin toleranca zero" ishin pritur nga popullata me shpresë se një ditë vërtetë krimi do të ndeshet me drejtësinë, por pritja ishte e kotë. As organet e sigurisë dhe as ato të drejtësisë që janë kompetenca ende të rezervuara - nuk kanë bërë hapa përpara në luftë kundër kësaj të keqe që po e dëmton aq rënd shoqërinë. Në vend se ta luftojnë krimin, policët vendor zënë pozicione nëpër rrugë për t'i gjobitur udhëtarët apo vrapojnë për t'i shlyer muret e shkruara me parulla, por edhe për t'i arrestuar ata që kanë shkruar parulla. Kemi parë skena të trishtueshme kur policia pa asnjë maturi dhe përgjegjësi ka ndërhyrë për t'i arrestuar të rinjtë veprimtar të cilët nuk pajtohen që Kosova serish të bëhet mall për kusuritje. Kemi parë skena të trishtueshme edhe në Hade, ku pos ndërhyrjeve brutale ndaj popullsisë - kishim edhe shkatërrime masive e pa kriter të shtëpive dhe objekteve tjera të banimit. Në asnjë rast gjatë këtyre intervenimeve policore nuk kemi parë se ishte prishur rendi publik. Në asnjë rast kur kishte intervenuar policia nuk kemi parë se ishin të rrezikuara apo të sulmuara organet e rendit. Në asnjë rast nuk kemi parë njerëz që kanë rezistuar apo kanë shkaktuar probleme që janë të dënueshme me ligjet në fuqi.

Duket se policia ndërkombëtare dhe ajo vendore tashmë i kanë shpallur luftë vetëvendosjes, prandaj edhe pavarësisë së Kosovës. Intervenime brutale ndaj të rinjve tanë veprimtarë, si dhe arrestimet e tyre, të cilët shprehin në mënyrë legale e demokratike

bindjet dhe kërkesat e tyre por edhe protestat – nuk mund të kenë sukses. Kërkesën për vetëvendosje apo për pavarësi kurrë më nuk duhet ta shohim si një kërkesë armiqësore, siç e trajtonte dikur Serbia. Kjo çështje është jetike dhe është e ligjshme për Kosovën. Prandaj është krejt normale që të kërkohej vetëvendosje e popullit për të ardhmen e tij dhe që për statusin e Kosovës të mos negociohet me palën kundërshtarë e cila, natyrisht, se kurrë nuk do të pajtohet me një zgjidhje të drejtë e të qëndrueshme për vendin tonë. Faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit zoti Luzha. Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari, le të përgatitet deputeteja Melihate Tërmkollli. E keni fjalën zoti Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI:

Faleminderit zoti kryesues. Ju përshëndes. Ju përshëndes zoti Kryeministër, zonja ministre, të nderuar deputetë,

Më lejoni që në fillim të shpreh brengën dhe protestën time për mënyrën e organizimit dhe të udhëheqjes së kësaj seance. Është një seancë e cila debaton dy çështje fundamentale serioze për këtë shoqëri dhe që mënyra se si po udhëhiqet dhe mënyra se si po organizohet debati lë shumë për të dëshiruar. Është një mungesë respekti ose pavarësisht që po pretendohet të shfaqet respekti për familjet e të zhdukurve dhe të pagjeturve, është pikërisht e kundërta – është mungesa e respektit që po manifestohet për ta - duke e ngutur debatin për pikën e parë me pretendim që të mbërrihet të debatohet për pikën e dytë dhe të jeni të sigurt, zonja e zotërinj, se nuk do të debatohet as për pikën e dytë sepse nuk do të ketë thjeshtë kohë që të debatohet për atë pikë.

Dua ta shpreh protestën edhe për mënyrën se si po privohet e drejta e fjalës e deputetëve nga koalicioni qeveritar, flas për ata të cilët në mënyrë të pavullnetshme iu merret e drejta e fjalës, duke sugjeruar që ta deponojnë me shkrim fjalën e tyre. Çka, në qoftë se ndonjëri prej tyre nuk ka përgatitur kurgjo me shkrim dhe nuk ka se çka të deponojë? Po, fjalë, siç thotë – ka sigurisht.

Prandaj, kjo mënyrë e udhëheqjes së kësaj seance, është një mënyrë e cila do të duhej të ishte mënyrë nuk do të përsëritej më. Do të duhej të ishte mirë që sa më parë ta heqim nga rendi i ditës këtë formë të organizimit të mbledhjeve dhe këtë formë të harxhimit të temave vetëmsa për t'i harxhuar temat.

Po debatojmë një çështje, siç thash edhe më herët, shumë të rëndësishme – çështjen e sigurisë. Të debatohet për çështjen e sigurisë detyrimisht duhet të debatohet edhe për dy elemente të këtij trinomi, për politikën dhe për krimin. Është e pamundur të debatohet për çështje sigurie pa debatuar për çështje politike ose për efektshmërinë e politikës, si dhe për manifestimin e krimit në shoqëri.

Po qe se ndalemi te pika e parë – te efektshmëria e politikës, zonja e zotërinj, pikërisht ky organizim, kjo mbledhje tregon se sa është e efektshme politika te ne. Tregon se sa kjo

politikë është e zonja t'ia ngushtojë hapësirën krimin dhe me këtë të arrijë sigurinë! Ne sillemi ndaj një çështjeje kaq të rëndësishme me kaq noshalancë, me kaq ç'kujdesje, do të thoja, thuaja se bisedojmë për ndonjë rast në Taxhikistan, kurse është fjala për Kosovën, është fjala për vendin tonë, është fjala për sigurinë në vendin tonë dhe mënyra se si e trajtojmë – është një mënyrë absurde, do të thoja. Klasa jonë politike do të duhej ta tejkalonte vetveten, ose së paku këtë edicion të vetvetes, dhe do të duhej që t'i tejkalonte pragjet e ndarjeve partiake dhe me një unitet, do të thoja, në fazën në të cilën ndodhemi të përpiqemi ta ndërtojmë një konsensus të përgjithshëm shoqëror për të gjitha çështjet që i kemi përpara, e në këtë rrafsh – posaçërisht për çështjen e sigurisë.

Edhe ato shërbimet e inteligjencës politike apo parapolitike, apo të partive politike, si do t'i quajmë, do të ishte dashur të debatojmë për to në mënyrë më të hapur dhe mundësisht më të sinqertë që ta gjejmë atë të vlershmen brenda tyre dhe ta hedhim të pavlershmen. Dhe në rast se ka diçka të vlershme brenda tyre, t'i funksionalizojmë në interes të Kosovës, e jo në interes të partive politike. Pra, do të duhej një debat i hapur, një debat i sinqertë, i cili mungon – fatkeqësisht, po e përsëris edhe një herë mungon sepse thjeshtë ky Kuvend nuk lejohet ta kryejë punën e tij, deputetët e këtij Kuvendi nuk lejohen ta kryejnë punën e tyre. Pra, është gjithmonë dikush në ngutje, gjithmonë është dikush që ka agjenda të tjera, të cilat i shtynë përpara me forcë dhe çështjet – agjendat të cilat janë parapërcaktuar dhe janë dhënë në rend dite – tejkalohehen me një elegancë.

Po qe se nuk e bën ky Kuvend këtë tejkalim të vetvetes dhe po qe se nuk ia del ta ndërtojë një qëndrim unik lidhur me këto probleme që kemi përpara, e në këtë rast kemi temën e sigurisë – në rend të parë për sigurinë – atëherë dyshoj shumë se do të mund të ndërtojmë qëndrim të përbashkët edhe për çështjet tjera që janë ndoshta jetike për Kosovën, siç është çështja e statusit, çështja e bisedimeve për statusin ose çështja e raporteve tona me grupet tjera etnike në Kosovë dhe çështje tjera të rëndësishme, të cilat i kemi përpara dhe po ashtu për të cilat ky Kuvend do të duhej të ndërtonte një pajtueshmëri. Kjo është pra sa i përket pikës së parë, sa i përket politikës ose efektshmërisë në politikë.

Pika e dytë, ose çështja e dytë - monomi i tretë i këtij trinomi: politika, krimi, siguria është krimi, zonja dhe zotërinj. Po qe se e marrim dhe trajtojmë krimin, do të shohim se krimi është gjithkund i pranishëm, është i gjithkundgjindshëm në Kosovë. Vetëm në dukje të parë nuk e kemi, sepse në këtë teatrin tonë të absurdit është ndriçuar vetëm vija e parë e skenës paraskena dhe nuk e kemi ndriçuar skenën e thellësisë, e po ta ndriçonim skenën e thellësisë do të shihnim gjithçka, do të shihnim shantazhime, reketime, vrasje të porositura – të zbatuara nga llojloj mafiash qofshin ato politike, ekonomike apo edhe mikste politike-ekonomike. Është instaluar zonja e zotërinj mafia reketuese nëpër zona urbane e cila shantazhon biznesin, shantazhon tregtarët, kemi mafien e naftës, kemi mafien e cigareve, kemi mafien e narkotikëve, janë mafiet të cilat e rëndojnë situatën e sigurisë në Kosovë në një masë shumë të madhe dhe sa më shumë hapësirë të kenë këta për të manovruar siguria do të jetë më e brishtë.

Kjo në këtë Kuvend nuk po trajtohet si duhet dhe në mënyrën më të mirë të duhur, por po mbahen fjalë akademike, diskutime herë-herë pseudoakademike për çështje të tilla të rëndësishme, kurse jeta ose terreni na flet, sepse njerëzit - për ta organizuar një kafiteri

dhe për ta mbajt në këmbë - duhet dikujt t'i paguajë një shumë të hollash, përndryshe mund t'ju shkojë në erë dyqani, mund t'ju shkojë në erë një vetëshërbim apo supermarket siç ndodhi në Ferizaj para disa kohësh, ose mund të shkojë në erë edhe koka. Në raste të caktuara, kemi edhe ngjarje të tilla. Për derisa nuk po sqarohen, kemi të drejtë t'i japim vetes atë të drejtë të spekulojmë sepse mund të ketë motive të llojllojshme prapa këtyre likuidimeve që ndodhin në Kosovë.

Dua të ndalem te pika e tretë, kryesorja që po debatojmë sot pra – siguria. Siguria e jashtme, u tha këtu, edhe siguria e brendshme u tha këtu - janë dy aspekte të kësaj sigurie. Siguria e jashtme nuk e ka vetëm një element, nuk e ka vetëm një dimension, nuk është vetëm dimension i invazionit nga jashtë prej të cilit sigurisht jemi të sigurtë, sepse nuk ka kush mbi rruzullin tokësor sot që guxon të mësyjë ushtarakisht aty ku NATO siguron territorin, por siguria duhet të është edhe siguria e kufijve të një vendi nga invazioni – ta quaj ashtu – ekonomik, i kontrabandës thjeshtë, i evazionit fiskal që ngjet përditë në Kosovë. Edhe ai është element i sigurisë. Në Kosovë hyjnë kontrabandë nëpër të gjithë kufijtë e Kosovës, qofshin ata në veri, qofshin në lindje atje kah unë vij, qofshin atje në perëndim nga Mali i Zi, hyjnë mallra të pa zhdoganuara e të cilat varfërojnë buxhetin e Kosovës dhe me këtë drejtpërdrejtë ndikojnë në rritjen e sigurisë ose zvogëlimin e sigurisë në Kosovë. Prandaj nuk mund të themi se siguria e jashtme në Kosovë është siguri perfekte.

E kemi sigurinë e brendshme, si element i dytë, i cili ka të bëjë me sigurinë fizike të qytetarit por edhe me sigurinë ekonomike të tij. Siguria fizike e qytetarit sigurisht se komponentën reale, atë sigurinë elementare për jetë, e cila përveç vlerës reale e ka edhe një vlerë imagjinare do të thojë vlerën e perceptimit se sa është ai i sigurt e që ndryshon nga njeriu te njeriu tjetër dhe sigurisht se përveç perceptcionit ekziston edhe një vlerë mesatare e cila nuk është do të thojë kritike, sepse elementet që i kemi këtu që garantojnë këtë siguri janë mjaft të fuqishëm sa për të mos lejuar që kjo të eskalojë por ekziston edhe një kulturë tradicionale do të thojë dhe siç e përmendi deputeti Dedaj, ajo kulturë e cila mundëson funksionimin e sigurisë fizike të qytetarëve tanë edhe në rrethanat kur në Kosovë nuk ka pas kurrfarë organesh për mbajtjen e rendit dhe të ligjit.

Përveç kësaj, te siguria e brendshme, është edhe siguria ekonomike, e cila dihet se është katastrofike zonja e zotërinj. Qytetari në Kosovë nuk ka kurrfarë sigurie ekonomike. Siguria ekonomike e tij është do të thojë në nivelin më të ulët të funksionimit, në nivelin më të ulët të mundshëm të qëndrueshmërisë. Edhe në fazën – më lejoni të them në Kuvend – në fazën e pushtetit arbitrar të dhunshëm serb siguria ekonomike ka qenë më e madhe – them siguria ekonomike. Është keq të thuhet në Kuvendin e Kosovës kjo, po kjo është fakt.

Qytetarët tanë me shumicë i janë shtruar rasteve sociale. 70-80% të qytetarëve të Kosovës kanë nevojë për ndihma sociale, zoti Kryeministër. Kanë nevojë për ndihma sociale për t'i kryer obligimet e tyre familjare, për ta paguar rrymën, për ta paguar telefonin dhe taksat tjera të cilat janë shumë të mëdha, shumë të shtrenjta. Prandaj, të gjitha këto ndikojnë në sigurinë në Kosovë, të gjitha këto janë ato elementet të cilat këtë siguri e bëjnë të brishtë, e bëjnë që të cenohet, e bëjnë që qytetarët tanë të mos jenë funksional, në

mënyrën më të mirë të duhur që bëjnë të mos mund ta japin efektin e tyre më të mirë në të mirë të Kosovës, në të mirë të vetvetes. Ju faleminderit shumë për vëmendje.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit zoti Jashari. Fjalën e ka deputetja Melihate Tërmmkollli, le të përgatitet deputeti Ymer Halimi. E keni fjalën.

MINISTRE MELIHATE TËRMKOLLI:

Faleminderit zotni kryesues. Ndoshta më shumë jam në cilësinë e anëtares së Qeverisë për faktin se ma përmendi dikush këtu emrin dhe u bë zakon tash kur përmendet emri me dalë me i thënë dy fjalë dhe është mirë ndonjëherë me u përmend emri, sepse kur s'përmendet asnjëherë nuk dihet çka ka.

Një deputet i PDK e pash që ngriti lartë një letër me do të dhëna, gjëja, rreth objektit të Rilindjes dhe unë absolutisht edhe nuk dua as të arsyetoj. Në veçanti nuk dua të arsyetoj kur para Kuvendit deputetë i japin vetes të drejtë të shfaqin të pavërteta të plota, por më tepër për të konfirmuar atë që deputeti ka thënë diçka shumë të pavërtetë, e cila si fjalë publike, si çdo fjalë publike tërheq pas vetes përgjegjësinë edhe ndaj këtij deputeti apo edhe ky deputet dhe fjalë e tij tërheq përgjegjësinë, dhe atë jo vetëm para opinionit por edhe përgjegjësi tjetër. Me gjasë, deputeti është i ri, nuk i din rregullat dhe është mirë t'i mësojë. Është mirë me i tregua këta të tjerët që kanë pas edhe mandatin e kaluar.

Edhe një çështje tjetër, rreth çështjes së sigurisë, pasi veç dola këtu. Unë them se përpjekjet e institucioneve të Kosovës janë në forcim të institucioneve të sigurisë, në forcimin e atyre që janë ekzistuese dhe formimin e institucioneve të reja në këtë funksion. Në këtë drejtim u thanë shumë fjalë dhe, për ta kursyer Kuvendin, nuk do të dëshiroja të përsëris ato që janë thënë deri tani. Por, është një fakt shumë i rëndësishëm, formimi i një mekanizmi që quhet shërbim i inteligjencës si institucion shtetëror.

U thanë po ashtu disa fjalë, apo u bë shumë fjalë për ekzistimin e tyre nëpër parti politike, dhe në shumicën e diskutimeve unë kam pa se ka një përpjekje për të hedhë diçka joekzistuese aty ku nuk ka asnjë argument dhe për të mbuluar atë që tashmë janë shumë të njohura për publikun, për opinionin dhe për institucionet e Kosovës. Asnjë fjalë nuk dëgjova deri tash, dhe nuk u tha asgjë për veprimin papresedan të PDK ndaj disa anëtarëve të Qeverisë. Pra, veprimi për të ashqutuarjturat të "famshmet dosjet" që mund ta bëjë vetëm një parti politike, siç është PDK dhe ta marrë autorësinë për diçka që - po të ekzistonin - do të duhej të ishte punë e institucioneve shtetërore. Dhe ka të drejtë, dhe i jep vetes të drejtë PDK të flasë për ekzistimin e institucioneve ose për sigurimin e mekanizmave nëpër parti politike?! Këtë e dinë mirë krerët e kësaj Partie apo edhe vetë Partia a është shërbim i inteligjencës PDK-ja, a e ka bërë këtë me SHIK-un, a e ka bërë me shërbimin e Serbisë apo e kanë bërë të gjithë bashkërisht.

Dhe, krejt në fund, për një fjalë që e tha këtu zotni deputeti Luzha: se Qeveria po bëhet sikur nuk ka ndodhë asgjë. Nuk është e vërtetë. Qeveria po bëhet sikur ka ndodhë diçka.

Dhe, vërtetë, ka ndodhë diçka. Ka ndodhë diçka shumë e mirë, sepse Kosova po ecë përpara me këtë Qeveri. Faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju lus. Fjalën e ka deputeti Ymer Halimi, le të përgatitet deputetja

Replikë!? Po s'ju është përmend emri. S'ju është përmendur emri, por mundeni, e keni një minut në disponim. Jepnja fjalën deputetit më të ri, nuk po ia dim emrin.

(Nea Kryesia e punës: Xhevat Bislimi)

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI:

Faleminderit zoti kryesues. Unë në fillim ju lus t'mos ma ndërpreni fjalën për një minutë sepse kam drejtë në replikë, edhe pa u përmend emri kur aludohet, është e sqaruar qartë në Rregullore.

Zonja Melihate, unë s'kam asgjë me emrin e saj sepse s'më intereson fare emri i saj por vetë fakti se ka status të dyfishtë – deputete dhe qeveritare – është çështje që flet mjaft për personalitetin e saj, prandaj edhe nuk është mirë ta shfrytëzohet mikrofonin e Kuvendit - herë si deputete herë si qeveritare.

Ne nuk kemi kërkuar asgjë më shumë, por përgjigje: janë paguar dy milion euro "çlirimit" apo nuk janë paguar? Këtë nuk e tha, nuk dha përgjigje.

Zonja deputete, dosjet dhe akuzat mund t'i bëjë çdo parti. Ne jemi deputetë këtu për të ngritur çështje. Ju jeni qeveritar për të dhënë përgjigje dhe shpjegime. Kuvendi ka të drejtë legjitime morale, politike të ngritë komisione hetimore. Në qoftë se nuk je aty, ku thuhet se je, le të ngritët komisioni zonjushë ose zonjë e nderuar dhe ju qeveritarë të nderuar dhe le t'i vërtetojë faktet. Nuk kemi asgjë kundër, nuk kemi kërkuar as të shkojë kush në burg as të lirohet, as të dënohet. Të vërtetohen faktet, ose dyshimet që janë shumë të bazuara, por që ne nuk mund të marrim vendime. A është fakt apo s'është, le të bëhet komisioni.

Prandaj, në fund, kërkoj dhe një përgjigje: çfarë përgjegjësie tjetër do të kemi, se s'e mora vesh. A ishte ky kërcënim, shantazhim apo selam. Është mirë ta dimë të paktën këtë, dhe shpjegoje pak, apo elaboroje më tej. Faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Mirë! Fjalën e ka deputeti Ymer Halimi.... Berat, edhe ti je i përmendur a? Dy minuta i ke Berat.

DEPUTETI BERAT LUZHA:

Më vjen keq. Fjala ime i paska tingëlluar keq Ministres, e cila vërtetë është për çdo kritikë në veprimtarinë e saj si ministre dhe unë i tregoj asaj se me te si ministre dhe me një kabinet çfarë është, Kosova nuk mund të shkojë përpara. Dhe, me një institucion – Kuvendi i Kosovës siç është ky, i cili shkel rregullat në çdo moment, nuk mund të ecë Kosova përpara. Faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Urdhëroni zoti Ymer Halimi. Ymer e keni fjalën dhe le të përgatitet deputetja Selviqe Halimi.

DEPUTETI YMER HALIMI:

Më në fund. Faleminderit zoti kryesues. I nderuar Kryeministër Kosumi, deputetë të nderuar,

Kur flas për sigurinë në Kosovë, mendoj për një kohë të shkurtër më pak se gjashtë vite, e po të flas me këtë guxim që po flasim edhe këta të tjerët, atëherë nuk di sa jam i sigurt në jetë. Prandaj, le ta kemi të qartë se siguria është tepër komplekse, polidimensionale dhe si sistem te ne është e përbërë nga pjesë jo edhe aq kompatible – me ndërkombëtarë më të ndryshëm e vendorë që te qytetari edhe krijojnë ndjenjë edhe josigurie. Ndërsa, segmenti i sigurisë sipas funksionit që ka, duhet të jep veprim të drejtpërdrejtë në kualitetin e jetës të çdonjërit prej nesh.

Derisa KFOR-i është bartës i besueshëm i sigurisë te qytetari, bartës i besueshëm i sigurisë civile. UNMIK-u shumëherë është paradoksal dhe jo i sinqertë, kështu që sot kemi një gjendje sigurie asimetrike fatkeqësisht për shumëçka. Mbi sigurinë po rëndon: statusi i pazgjidhur i Kosovës; strukturat paralele dhe të shumë llojeve të cilat po pezullojnë zhvillimet demokratike; gjendja je rëndë sociale ekonomike dhe koha e pasluftës; si dhe trysnia mbi kufijtë legjitim që i ka Kosova. Këto po bëjnë që siguria të jetë labile, ashtu si njeriu që qëndron ulur në një karrige, e cila ka vetëm dy këmbë.

Aq sa shihet, përgjegjësit e UNMIK-ut sigurinë civile në Kosovë e menduan vetëm mbi bazën e numrit të policëve ku sot në Kosovë ka rreth 9 mijë – tamam ushtri - policë vendor e ndërkombëtar, ndërsa për ironi fati – kemi të shprehur dhe të konfirmuar dukuritë: trafikim dhe përdorim droge; prostitucion; trafikim me qenie njerëzore; korrupsion; keqinterpretim dhe keqpërdorim të besimit fetar nga qarqe të caktuara; vrasje edhe të vetë bartësve të sigurisë dhe të tëra këto dosje – për fat të keq – mbesin enigmatike. Shtrohet pyetja: Pse? Kjo flet shumë, por duam ta kuptojmë.

Mendoj se është i papranueshëm mendimi se këto janë dukuri të pasluftës – transicioni apo mentalitet ballkanik. Së paku, për mua këto lënë dilemë për paaftësinë e organeve kompetente për çështjen e sigurisë në Kosovë.

Deputetë të nderuar,

Siguria e qytetarëve në Kosovë, si edhe kudo në vendet demokratike, mbështetet mbi dy baza: mbi bazën e ligjit dhe strukturën e tij, dhe aftësisë së shtetit për zbatimin e ligjit nga një anë; dhe nga ana tjetër, të vetëdijesimit të çdo qytetari se edhe ai është përgjegjës për sigurinë.

Nuk janë fajtorë vetëm keqbërësit dhe ata që kanë detyrë t'i pengojnë e nuk arrijnë t'i ndalojnë, por edhe ata - që i shohin - e nuk reagojnë.

Po ç'ndodhë te ne, nëse reagon një qytetar në mënyrën e duhur? Është viktimë e së nesërmes. Pse? Sepse mungon përgjegjësia institucionale e përgjegjësve të sigurisë; mungon konspiracioni shtetëror i kësaj vije dhe kjo ngritë pabesueshmërinë e qytetarit mbi segmentin e shtetit.

Po bëhet shumë fjalë edhe nga ndërkombëtarët për një segment të sigurisë - për sigurinë e lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës, duke aluduar në minoritetin serb. Është e natyrshme dhe humane iniciativa që vjen nga ndërkombëtarët dhe përkrahen nga vendorët, por asnjëherë nuk është analizuar se cili është shkaku thelbësor i këtij fenomeni të sigurisë së lëvizjes së tyre e për të dhënë të vërtetën. Prandaj, politika jonë e pritjes, është dashur që moti të kthehet në politikë aktive së paku në rrafshin e brendshëm. Politikën aktive në këtë rrafsh e filloi ish kryeministri Haradinaj, dhe tendencë për të ecë.

Kam bindje, deputetë të nderuar, se të gjithë jemi të vetëdijshëm se çështja e sigurisë është çështje e shtetit. E ne, po ndërtojmë shtet, apo më drejtë të themi se jemi shtet në embrion. Atëherë, ky debat le t'i paraprijë formimit dhe zhvillimit të sigurisë në nivelin e duhur dhe gjithëpërfshirës, i vizuar pastër, inteligjent, që të jetë i qëndrueshëm e i besueshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës. Këtë duhet ta bëjmë ne vendorët me përgjegjësinë maksimale. Natyrisht, ndihma profesionale e bashkësisë ndërkombëtare është e domosdoshme, jo vetëm për këtë fazë, por në vazhdim dhe për këtë do të jemi mirënjohës. Ju faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit zoti Halimi. Fjalën e ka deputetja Selvije Halimi, le të përgatitet deputeti Ilmi Ahmeti. E keni fjalën Selvije.

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI:

Faleminderit zoti kryesues. Të nderuar deputetë,
Duke u nisur nga një fakt se vetë shoqëria është komplekse, vetë jeta e njeriut është komplekse, vetë edhe tema e sigurisë e shtruar sot për debat në Kuvendin e Kosovës i ka kompleksitetet e veta dhe është e shtruar në atë formë që është vështirë të përcaktosh se prej cilit kënd do të diskutosh sa i përket sigurisë. Mirëpo, një fakt është i vërtetë, të cilin e kaluam në pjesën e paradites: në vend se të kishim një raport se sa është numri i vrasjeve në Kosovë që nga dita e përfundimit të luftës e gjer më sot; sa është numri i vetëvrasjeve në Kosovë që nga dita e përfundimit të luftës e deri më sot – dukuri kjo që nuk ka qenë e pranishme së paku në mesin e popullit tonë; cilat janë rajonet më të qeta në

Kosovë; kush ishin shkaktarët e këtyre vrasjeve, nëse nuk është arritur që kryesit e vrasjeve apo nxitësit e vetëvrasjeve në mënyrë indirekte të zbulohen dhe të dalin para drejtësisë – atëherë cilët janë shkaktarët po çojnë në këtë drejtim. Ne kishim një raport se ekziston SHPK, një raport se do të bëhet një ministri e punëve të brendshme, apo për siguri publike apo e rendit, që ende nuk ia dimë as emrin.

Të nderuar deputetë,

Termi "drejtësi" në Kosovë është i njohur vetëm teorikisht dhe disa e mësojnë nëpër fakultete apo shkolla të mesme – ata të cilët janë duke ndjekur studime, disa lexojnë literaturë për të pasur njohuri për vete. Mirëpo, se a kemi sistem të drejtësisë në Kosovë dhe a ka përpjekje për sistemin e drejtësisë në Kosovë, kjo është pyetje që nuk do koment, sepse nuk ekziston as sistem drejtësie e as përpjekje për një sistem të tillë.

Kur e them këtë, bazohem në faktin se të gjitha format institucionale, të organizuara në Kosovës, si të pushtetit lokal diku më shumë e diku më pakë, në veçanti ato të nivelit qendror – po udhëhiqen nga një qendër, e cila ka dalë standard mbi standarde dhe ligj mbi ligje – korrupsion. Për çfarë sigurie mund të flasim ne sot në Kosovë, kur ky korrupsion në vend se të ndërpritet ky po kultivohet, dhe ata të cilët janë të korruptuar udhëheqin institucione apo edhe marrin grada avancimi nga zgjedhjet në zgjedhje në kuadër të institucioneve të Kosovës.

- Çfarë sigurie ka qytetari sot në Kosovë po qe se ka nevojë t'i nënshtrohet ndonjë mjekimi në spitale të Kosovës?
- Çfarë sigurie ka qytetari sot në Kosovë po qe se merr një rrugë dhe lëvizë nga një komunë në komunën tjetër në Kosovë?
- Çfarë sigurie ka qytetari sot në Kosovë po qe se vendos që fëmijë e tij apo vetë i rrituri i drejtohet universitetit për studime në Kosovë?
- Çfarë sigurie ka sot qytetari apo kryefamiljari i cili shkon në shitore për të blerë artikuj më elementar ushqimor?
- Çfarë sigurie ka sot në Kosovë po qe se një qytetar bën një padi apo një institucion bën një padi në gjykatat e Kosovës?

Si konkludim për këtë mund të nxjerrim se është pikërisht ai korrupsioni që është aq mirë i lidhur mes veti dhe nuk lë lëvizje më tutje.

- Çfarë sigurie mund të kemi sot në Kosovë kur vetë institucionet duke shkelur ligjet, duke shkelur procedurat shkakton konflikte ndër qytetarë?

Rasti më i fundit është, kur vetë Kuvendi, bën shkelje të procedurave, bën shkelje të ligjit për një qendër të famshme protokollare administrativë dhe pse një grup qytetarësh ngre zërin e protestës vjen deri te një konflikt fizik që ka mund të kalojë në përmasa më të mëdha në mes punëtorëve të kompanisë që merren me ndërtim dhe qytetarëve që ngrehin zërin për diçka që iu duket e padrejtë. Do të thotë, në këtë formë, edhe qytetarëve për të shprehur mendimin e tyre të lirë ne po ua mohojmë atë si institucione.

Çfarë sigurie ka sot në Kosovë një qytetarë që të investojë për të shtuar pronën e tij apo për të siguruar një shtëpi apo banesë si kulm mbi kokë? Kur asnjë hap nuk merret në drejtim të sqarimit të titullarit të pronës në Kosovë. Të gjitha hapat deri sot ndërmerren me veprime ose të paligjshme ose ndërhyjnë korrupsioni. Për çfarë sigurie flasin ne sot? Diskutim shterpë sikur në të gjitha temat tjera kur janë çështje kaq vitale për Kosovën! Pa përfundime, pa konkluzione, pa komisione hetimore.

A kemi të drejtë dhe a jemi në gjendje ta shfrytëzojmë të drejtën si Kuvend që të formojmë një komision hetimor për hetimin e pasurisë së personave që udhëheqin institucionet e Kosovës, po pse jo – edhe biznesmenëve të ndryshëm që veprojnë në Kosovë, prejardhjen e pasurisë së tyre. I njëjti komision të hulumtojë se sa konto bankare janë të hapura jashtë Kosovës në shtetet ku aludohet se ka siguri bankare... Këto janë gjëra, të cilat kërkojnë përgjigje prej dikujt. Mirëpo pa u shkëputur rrënjët e korrupsionit këto është vështirë të arrihen.

Kush mund të garantojë qytetarin e Kosovës sot se nesër në bisedime për statusin politik të Kosovës nuk do të zinet, më falni do ta përmend një fjalë që e thotë populli: “nuk do të zinet bishti me derë” në emër të korrupsioneve dhe veprimeve të paligjshme që të bëhen kalkulime në interes të Kosovës. A është dikush në gjendje që këtë ta thotë publikisht – se unë nuk do të veprojë ndryshe, vetëm do të veproj ashtu si u sakrifikuva në të kaluarën edhe ende sakrifikohet për Kosovën? Kush i jep të drejtë vetes që në emër të besimit se pavarësia e Kosovës është një proces t’i sigurojë apo ti bëjë barrkada sigurie vetëm vetvetes dhe të mos interesohet për sigurinë e qytetarëve? A kemi menduar ne sot se kur shtrohet tema për sigurinë do t’i zgjohet ndjenja e dhembjes çdo prindi që ka humbur fëmijën e vet, çdo fëmiu që ka humbur prindin e vet, çdo motre që ka humbur vëllain e vet në rrethana të pasqaruara – gjashtë vjet pas luftës. Këto janë pyetje që donë përgjigje, i nderuari Kryeministër, dhe ju po qe se vetë nuk keni mundësi t’i parandaloni këto, po qe se vetë nuk keni mundësi të jepni një ultimatum të gjithë përgjegjësve për siguri e në rend të parë kabinetit tuaj qeveritar, pastaj shtyllës së parë të UNMIK-ut e pse jo edhe Shërbimit Policor të Kosovës për të kërkuar ndihmë edhe prej KFOR-it e NATO ju duhet të deklaroheni se jeni në ndikimin e presioneve dhe nuk mund të vazhdoni më tutje dhe Kosova të vazhdojë me këtë rrugë.

Ne... Ju lutem, unë ju dëgjova të gjithëve! Ne duhet të deklarohejmë publikisht: kush është i shantazhuar prej kujt që veprohet me të njëjtin kurs? Kush nën ndikimin e të cilave presioneve detyrohet me shkelë ligjin, apo detyrohet të anashkalojë procedura. Cilët ekspertë në Kosovë janë të siguruar që të thonë fjalën e tyre për veprime që po ndodhin në Kosovë, qoftë ata të kriminalistikës, qoftë ata në aspektin shëndetësor, qoftë ata për urbanizëm e planifikim, qoftë ata për zhvillim ekonomik. Pse, etika e tyre profesionale shkelet pikërisht për shkak të shantazheve politike. Andaj, është dashur që për korrupsionin të jetë një raport, është dashur që të kemi raport për atë që përmenda më herët – vrasjet dhe vetëvrasjet në Kosovë dhe çka është ndërmarrë që këto të parandalohen.

Uroj që ky Kuvend në përfundim të këtij debati për këtë pikë të dalë me disa përfundime apo konkluzione dhe të jepet një afat i llogaritur apo parallogaritur se çka mund të

ndërmarrin institucionet vendore me ndihmë edhe të ndërkombëtarëve në parandalimin e këtyre dukurive apo në shtimin e nivelit të sigurisë për qytetarin e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ilmi Ahmeti, le të përgatitet deputeti Hajredin Hyseni. E keni fjalën zoti Ahmeti.

DEPUTETI ILMIAHMETI:

I nderuari kryesues, të nderuar të pranishëm. Padyshim se po debatojmë për një prej segmenteve më të rëndësishme të jetës së qytetarit të Kosovës – çështjen e sigurisë, pjesë e të cilës jemi të gjithë.

Qytetarët e Kosovës janë përcaktuar fuqimisht për paqe, liri, shtet demokratik dhe progres në të gjitha segmentet e jetës, dhe pothuaj të gjitha segmentet e zhvillimit të një shoqërie demokratike varen nga shkalla e sigurisë, pa të cilën proceset demokratike rrezikojnë të rrëshqasin në anarki. Në një shoqëri ku nuk ka siguri dhe nuk garantohet liria e lëvizjes dhe e shprehjes së mendimit të lirë, nuk do të ketë as arsim e as ekonomi të zhvilluar dhe as të arritura në fusha tjera të jetës, por do të ketë vetëm rritje të kriminalitetit.

Ne si Kuvend i Kosovës kemi jo vetëm të drejtë por edhe obligim që së bashku edhe me institucionet tjera të Kosovës, pra me Qeverinë por edhe me UNMIK-un e KFOR-in të punojmë vazhdimisht në rritjen e shkallës së sigurisë për çdo qytetar të Kosovës dhe atë duke luftuar krimin në Kosovë të çfarëdo forme qoftë ai

Në bazë të natyrës dhe formës së paraqitur, kam përshtypjen se krimi po merr formë të organizuar dhe po gjend strehë në Kosovë dhe atë sidomos në atë pjesë të Kosovës ku organet kompetente nuk janë aktive sa duhet, e kam fjalën për veriun e Kosovës dhe pjesën veriore të Mitrovicës. Kam të drejtë dhe obligim si qytetar dhe si deputet të kërkoj që të gjitha institucionet demokratike të Kosovës të kenë qasje edhe në këtë pjesë të Kosovës, pra edhe SHPK, edhe gjykatat sepse pa veprimin e tyre nuk mund të rritet siguria e të gjithë qytetarëve.

Ku mund të flitet për siguri në vendin kur as polici nuk është i lirë të lëvizë. Kush ta luftojë krimin që zhvillohet atje, kush ta organizojë jetën përpos strukturave paralele që dihet se janë të komanduara nga Beogradi. Si ta plotësojë Kosova standardin e sigurisë dhe të kthimit të qëndrueshëm kur nuk lejohet të kthehen dhe të ndërtojnë shtëpi, e kam fjalën për shqiptarët në veri të Mitrovicës ose edhe të kthehen në banesa në shkolla dhe në spitale.

Të nderuar deputetë,

Kam përshtypjen se ndoshta nga dëshira për të plotësuar standardet para statusit për Kosovën me të shpejtë po favorizojmë pakicën në dëm të shumicës. Ne jemi përcaktuar

për një Kosovë të hapur, për lëvizje të lirë të njerëzve dhe të mallrave. Por edhe në vendet më të demokratike se Kosova kufijtë ruhen, pra edhe kufiri i Kosovës duhet të jetë më i kontrolluar nbase kjo edhe për shkak të pozitës gjeografike të Kosovës. Ikja nga burgu i qarkut të Mitrovicës e dhjetëra kriminelëve para 3-4 vitesh - rritë pasigurinë e qytetarëve në këtë pjesë të Kosovës dhe sot e kësaj dite nuk ka të dhëna se a ndjekën këta të ikur dhe se a ndjekën të tjerët që para 3-4 vitësh në një rebelim të serbëve në Mitrovicë vranë 15 qytetarë në mesin e të cilëve edhe fëmijë. Ku mund të lëvizin më lirshëm kriminelët se sa aty ku nuk vepron dora e shtetit. Do të thotë, e kam fjalën për verium e Kosovës ku automjetet lëvizin me nga dy e tri targa , pa to fare por jo edhe me targa të Kosovës.

Është lajm i mirë se ura mbi lumin Ibër është hapur 24 orë në ditë, por si të qarkullohet në atë pjesë kur dihet se ende kontrollin mbi atë pjesë të qytetit e kanë grupe kriminelësh dhe "rojat e urës" të cilat vetëm se kanë ndërruar forma të veprimit. Si t'u garantohet siguria qytetarëve joserbë kur edhe për dhjetëra të vrarë ende nuk ka asgjë në këtë drejtim. Duhet të them se pamundësia për t'i kapur dhe vënë para gjyqit të ikurit nga burgu dhe ekzekutuesit e atyre qytetarëve shqiptar të pafajshëm ku në mesin e tyre pra kishte edhe fëmijë nuk garanton siguri as qarkullim të lirë dhe as kthim në shtëpitë e veta.

Prandaj bashkësia ndërkombëtare, në radhë të parë UNMIK-u - që është përgjegjës për gjendjen sigurisë duhet të shtojë përpjekjet në drejtim të parandalimit të dhunës, krimit të organizuar, kontrabandës dhe dhënies fund të strukturave paralele të veprimit dhe në rritjen apo dhënien e më shumë kompetencave institucioneve vendore demokratike e sidomos dy segmenteve që drejtpërdrejt janë të lidhura me çështjet e rendit dhe të sundimit të ligjit. Pra, sa më shpejt të formohet ministria e brendshme dhe ministria e drejtësisë - besoj do të arrihej një shkallë më e lartë sigurie për të gjithë qytetarët që e njohin realitetin e ri në Kosovë duke respektuar rendin, ligjin dhe institucionet e votës së lirë demokratike në Kosovë. Ju faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit zoti Ahmeti. Fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni, le të përgatitet deputeti Gani Koci. E keni fjalën zoti Hyseni.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë,

Siguria është në nga çështjet më esenciale të një shoqërie apo individi. Ajo është bazament i ndërtimit dhe zhvillimit shoqëror në një vend, dhe zhvillimi i atij vendi është i kushtëzuar edhe nga shkalla e sigurisë që ka nga aftësia që posedon qeverisja e atij vendi që këtë tu ofrojë qytetarëve të saj dhe investitorëve të huaj, të cilët dëshirojnë të kenë investime dhe të zhvillojnë biznesin e tyre në një vend.

Një çështje mjaft e rëndësishme është se si institucionet e një vendi i qasen këtij segmenti të rëndësishëm dhe jetik, se si ato respektojnë vetë ligjin, i cili është kusht që një shoqëri të ndihet e sigurt dhe të jetë e vetëdijshme për të ardhmen e vet. Kosova, edhe pas gjashtë viteve të frymimit të saj të lirë në këtë segment nuk mund të thuhet se ka shënuar progres,

sepse sot në Kosovë ndodhin ngjarje të ndryshme të cilat krijojnë pasiguri tek qytetarët, krijojnë një gjendje psikologjike të një stresi dhe pasigurie kolektive, sepse këto ngjarje ndodhin në mes të ditës e në vende shumë frekuentuese dhe i vetmi refren që dëgjohet nga njerëzit përgjegjës të sigurisë, të cilëve nuk ua dimë emrin dhe për të cilat thuhet se "hetimet vazhdojnë" dhe me këtë lihet vend për manipulim dhe manipulohet për fatin tragjik të tyre. Me këtë, dikush bën edhe përfitime politike dhe lind pyetja pse? Sepse, ata që janë përgjegjës nuk e kryejnë punën si duhet. Ata edhe kur janë afër zbulimit të rasteve asnjëherë nuk i përfundojnë ato. Kjo është e qartë se dikush ka mundësinë e ndërprerjes së këtyre hetimeve por nuk dëshiron të ndërpriten ato, dëshiron të vazhdojë agoninë dhe për këtë do të duhej që dikush të japë përgjigje, jo vetëm para këtij Parlamenti, por para qytetarëve që ndodhin në ankth dhe presin që vërtetë drejtësia të ngadhënjë mbi krimin.

Për mua është e rëndësishme të sqarohen shqetësimet tek qytetarët të ngritura kohëve të fundit dhe shtroj këto pyetje, që përgjegjësit e rendit do të duhej të jepnin përgjigje:

- Pse nuk iu sqarua qytetarëve të Kosovës se cila ishte arsyeja e vërtetë e bastisjes së shtëpisë private apo si e quajnë rezidencës së Ibrahim Rugovës, sepse ai është president i Kosovës, kur ajo bastisje u bë nga njësitë speciale antiterroriste të UNMIK-ut dhe arsyet – natyrisht – kanë qenë shumë të forta: krim politik dhe ekonomik siç kanë deklaruar ata;
- Organet e sigurisë duhet të sqarojnë cili është dyshimi i bazuar i organeve të sigurisë ndërkombëtare për lidhjet e djalit të Ibrahim Rugovës me botën e krimit të organizuar në Kosovë dhe rajon, madje edhe me trafikun e lëndëve narkotike për të cilat flitet;
- Pse nuk u bë e ditur se cili ishte burimi dhe destinimi i një milion eurove të gjetura gjatë kësaj bastisje, madje edhe të dinarëve jugosllav, sasi të mëdha të armatimit dhe të municionit ushtarak, mjetet shpërthyes, teledirigjuese që u gjenden në shtëpinë e Ibrahim Rugovës athua për çfarë qëllimesh ishin të destinuara. Për vetëmbrojtje!? Nëse po, nga kush, apo kundër kujt ishin ato?
- Sa ishte numri i personelit të angazhuar pranë shtëpisë së Ibrahim Rugovës. Flitet për 140 të tillë, një ushtri e vogël – janë paramilitarë a çka?
- Kundër kujt dëshironte Ibrahim Rugova ta shfrytëzojë këtë formacion në Kosovën e lirë dhe kush e financonte këtë grup, me mbështetjen personale presidenciale të Ibrahim Rugovës apo buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Të gjitha këto janë çështje të cilat mendojnë ndërgjegjen e çdo qytetari kosovar dhe për të cilat përgjegjësit e sigurisë në Kosovë duhet dhënë përgjigje dhe duhet t'i sqarojnë qytetarëve të Kosovës.

Askush në Kosovë, as Ibrahim Rugova, nuk duhet t'i shpëtojë hetuesisë kur ka argumente, nëse dëshirojmë të kemi siguri në Kosovë. Edhe ai duhet të përgjigjet para ligjit. Por kjo nuk ndodh sot në Kosovë, sepse dikujt i konvenon kjo pasiguri që të përfitojë ende nga kjo. Të gjithë, me përjashtim të atyre që janë të korruptuar, thonë se ka korrupsion në Kosovë, sepse kjo shihet kudo që të shkosh në institucione, kudo që të

trokasësh për të kryer ndonjë punë, kudo që do të konkurrosh për një tender. Përqindja është pjesë plus e tenderit dhe askush nuk është përgjigjur dhe nuk përgjigjet për këto.

Kjo për dy arsye zonja dhe zotërinj. E para, se në Kosovë kjo çështje është në kompetencën e Përfaqësuesit special i cili në realitet është vetë ligji, dhe e dyta – se institucionet po ndërtohen mbi bazën dhe parimin e korrupsionit dhe përfitimeve klanore. Them pra kushtimisht, burimi i mossigurimeve është si rrjedhojë e moszbatimit të ligjit nga ata që bëjnë ligje dhe janë të thirrur ta kontrollojnë zbatimin e tyre, sepse ligji në Kosovë përdoret varësisht nga dëshira e interpretimit dhe jo nga domosdoshmëria e zbatimit të rregullave që i normon ai.

Se në Kosovë nuk zbatohet ligji, është edhe një fakt që thyen të tërë normat ndërkombëtare, se në Kosovë shkohet në burg me vendime politike. Kjo nuk ndodhë askund në botë, por në Kosovë kjo bëhet për qëllime politike të ditës. Kjo tregon se s'ka gjyqësi të pavarur në Kosovë, se s'ka hetime pa ndërhyrje politike dhe pa këto dy segmente do të thoja nuk ka siguri.

Në një gjendje të tillë, kur ligji nuk është sovran dhe nuk zbatohet me përpikëri siguria është një dëshirë e shoqërisë, një aspiratë që të arrihet në një të ardhme, sepse në Kosovë të nderuar deputetë dhe përfaqësues të rendit mund të shkohet në burg dhe t'i marrësh 17 vite vetëm me supozime dhe derisa mos të vërtetohen ato gjithkund do të ishin: thashetheme. Dhe, me këso thashetheme në Kosovë mund të dënohesh, siç është rasti i grupit të Llapit dhe shumë grupeve tjera të dënuara në bazë të supozimeve dhe për të plotësuar orekset e dikujt, metodë e cila nuk ndodhë dhe nuk praktikohet askund në botë që të dënohet dikush me supozime. Kjo nuk ndodhë në një vend që synim ka sigurinë, rendin dhe zbatimin e ligjit. Kurse, në Kosovë nuk shkohet në burg dhe nuk përgjigjet askush edhe pse humbin me miliona euro të popullit, edhe pse keqpërdoren ato edhe nga ministrat, nga institucionet, nga qeveritarët. Ndërsa, ata që kanë ligjin në duart e tyre, nuk duan ta përdorin, sepse më lehtë manipulohet dhe kushtëzohen qeveritarët e korruptuar, më lehtë përdoren institucionet e korruptuara – sepse atyre iu qëndron shpata mbi kokë dhe lehtë bëhen shantazhe mbi ta, se ata thonë ashtu siç u thuhet të thonë. Edhe kur i tërë parlamenti, siç ishte një debat më parë këtu për decentralizimin - është kundër pilotprojekteve – ata thonë parlamenti ka vendosë që të vazhdohet me pilotprojekte. Një mashtrim i tillë në pikë të ditës nuk krijon siguri, por pasiguri totale, jo vetëm individuale por kolektive.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Për të pasur siguri dhe për të ndërtuar institucione demokratike në Kosovë duhet të zbatohet ligji dhe ligji duhet të arrijë te çdokush që e shkelë atë, qoftë ai në krye të institucionit apo qytetar i thjeshtë. Ligji duhet të jetë sovran në veprim. Vetëm atëherë mund të flasim për siguri dhe rend, vetëm atëherë mund të synojmë shoqëri demokratike. Me këtë praktikë që vazhdohet sot në Kosovë, me këtë shkallë të korrupsionit të institucioneve, me këtë lejim që i u bëhet atyre – kjo vetëm do të mbetet dëshirë dhe aspiratë e qytetarëve. Ju faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Koci, le të përgatitet deputeti Jakup Krasniqi.

DEPUTETI GANI KOCI:

Faleminderit zoti kryesues. Po të shikohet në aspektin institucional, Kosova do të duhej të ishte vendi më i sigurt në botë. Në Kosovë sot vepron KFOR-i si një organizatë ndërkombëtare ushtarake, pastaj Policia e UNMIK-ut, Shërbimi Policor i Kosovës, prokuroria, gjykatat në të cilat veprojnë edhe ekspertë të këtyre lëmvive – ekspertë ndërkombëtar. Ndërsa po të shohim anën funksionale të tyre, dhe nëse matet kjo ana funksionale e tyre na del se funksionet e tyre janë zero dhe gjithkund dëgjojmë konstatimet se në Kosovë ose Kosova prinë në atë ranglistën e krimit, të korrupsionit, të pasigurisë edhe fizike edhe kolektive. Shtrohet pyetja në këtë rast: a thua rendi dhe qetësia publike duhet të matet me sjelljen e qytetarëve; siguria të matet me sjelljen e qytetarëve apo rendi dhe siguria duhet të maten me mënyrën e zbatimit të ligjit, me mënyrën e veprimit të institucioneve që duhet të respektojnë dhe implementojnë ligjet në Kosovë.

Shtrohet çështja nga aspekti funksional i këtyre mekanizmave: sa është shkalla e parandalimit të krimit në Kosovë dhe cilat janë masat parandaluese të krimit që kanë ndërmarrë mekanizmat e tillë; sa është shkalla e zbulimit të krimit qoftë ai krim ekonomik ose politik dhe sa është shkalla e gjykimit të këtij krimi.

Po t'i shikojmë këto në parametra, atëherë parametrat na dalin, për mos me thënë zero – tepër larg asaj të dëshirueshmes.

Në Kosovë, përveç këtyre institucioneve që janë përgjegjëse për sigurinë, ekzistojnë struktura paralele të sigurisë, ekzistojnë gjykata paralele të sigurisë, shkolla paralele, shëndetësi paralele, administratë paralele dhe po të shihen të tëra këto – shohim se Kosova po ecën në një paralel sistem ose në një sistem paralel dhe kur ecet paralele në paralele është rrezik që pastaj edhe të shkyhet, të ndahet dhe të copëtohet.

Kur është fjala se flitet për krimin e organizuar politik dhe ekonomik, praktikat e të gjitha vendeve deri sot, po edhe e Kosovës, thonë se krimi i organizuar i çfarëdo natyre qoftë nuk mund të ekzistojë në qoftë se ai nuk është i lidhur me segmente të caktuara të institucioneve të shtetit. Prandaj, nëse është kështu, atëherë kush është ai që prodhon pasigurinë në Kosovë. A janë qytetarët që po prodhojnë pasiguri në Kosovë apo janë institucionet – qofshin ato ndërkombëtare, qofshin ato vendore – që po prodhojnë pasiguri në Kosovë? Unë them se, pikërisht pasiguria në Kosovë krijohet dhe po krijohet nga institucionet në radhë të parë vendore, po edhe qarqeve të caktuara të ndërkombëtarëve që janë nën ombrellën e UNMIK-ut. Nuk dua të flas për këto të UNMIK-ut por unë dua të përmend vetëm një fakt për institucionet tona vendore të cilat prodhojnë pasiguri.

Vij nga regjioni i Drenicës që, në kuptimin e sigurisë dhe qetësisë së rendit publik, është shembull jo veç në Kosovë por edhe më gjerë. Po të shikohet në aspektin e zhvillimit ekonomik atëherë është vendi më i pazhvilluar ekonomikisht. Jeni të informuar që në Drenas nesër do të ketë protestë dhe situata mund të eskalojë. Dhe, kjo situatë që do të krijohet nesër - është prodhim i qytetarëve të Drenicës apo është prodhim i institucioneve të Kosovës gjegjësisht të Qeverisë së Kosovës, AKM-ës dhe Ministrit të tregtisë dhe industrisë? Për segmente të tilla që prodhojnë pasiguri, siç është ky rast, do të duhej të përgjigjur së pari para vetvetes së tyre, pastaj edhe para qytetarëve dhe para këtij Kuvendi.

Thamë se është krijuar ajo pasiguri pikërisht për faktin se AKM-ja, në bashkëpunim me institucionet e Kosovës, në procesin e privatizimit – në shitjen me aq lehtësi të pasurisë së Kosovës – ka krijuar dhe po krijon në vazhdimësi pasiguri në forma të ndryshme të qytetarëve në Kosovë.

Tenderimi i fundit i Feronikelit dhe loja me ofertuesit, të cilat i ka bërë pikërisht Ministri i tregtisë dhe industrisë, tregon se sa kjo Qeveri dhe njerëz të kësaj Qeverie janë të zhytur në prodhimin e pasigurisë në Kosovë.

Deklarimet e shtypit, që nuk duhet t'i hedhim shumë poshtë, se kjo lojë rreth tenderit të Feronikelit është bërë pikërisht pse ofertuesi i parë s'ka pranuar që të japë 3 milion, në mënyrën si kanë kërkuar këta, ka ofruar deri te një ofertues i dytë që ka një prejardhje shumë të dyshimtë dhe si i tillë ky ofertues sot – me seli siç thuhet në Angli – është i dënuar nga organet e gjyqësisë të Anglisë për marifetet e tija në korrupsion dhe në mashtrim dhe për këtë fakt dua t'i sjell zotit Kryeministër këtu..... Dua të citoj se një dëshmi që është botërisht e njohur. Kush dëshiron ta hetojë këtë, sepse thuhet: hetimet vazhdojnë lidhur me aferat e politikanëve, përfshirë një Nazarabajev a kush është ky dhe ish kryeministrit të Trinidadit Vasedo Pandi me të cilin Mitall ka bërë marrëveshje. Pandi është akuzuar se ka dështuar që të deklarojë dhe arsyetojë pasuritë jashtë vendit, përfshirë pronën në Londër, përderisa biznesmeni nga Rusia Patko Shodijev që është njëri nga pronarët e ofertuesit të fundit të Feronikelit i cili ka përfaqësuar Mitalin në Kazakistan është subjekt i hetimeve lidhur me korrupsionin nga autoritetet belge. Të tre ofertuesit janë me origjinë nga Kazakistani dhe të tre ofertuesit e kanë të ndaluar të merren – e kanë të ndaluar të merren me biznesin për të cilin me aq lehtësi Qeveria e Kosovës dhe AKM-a e përzgjedh si ofertuesin më të mirë për Feronikelin.

Dua të them vetëm edhe këtë dhe ta përfundoj. Urdhëresa precizon se të akuzuarit nuk kanë të drejtë që të shesin apo të bëjnë biznes me produkte të aluminit, kromit dhe hekurit nga minierat dhe plotacionet e Kazakistanit. Ndërsa, zëvendëskryesuesi i Bordit të AKM, zoti Bujar Dugolli, me sugjerimet dhe letrat e tij dhe presionet - pikërisht zgjedh këta ofertues për njerëz më të përshtatshëm për ta shitur Feronikelin, dhe atë me një çmim më të ulët për 16 milion euro, në krahasim me ofertuesin e parë. Dhe, kuptohet pse i jepet këtij për 16 milion euro! Llogaria është e qartë, 16 milion euro nuk..... S'di kush nuk do të jetë ai që s'do do blihet me 16 milion euro.

Pra, këta janë ata që prodhojnë pasiguri në Kosovë. Këta janë ata që regjionet ndoshta shumë të qeta nesër do t'i bëjnë që vërtetë të dalin jashtë atyre paraleleve, jashtë binarëve dhe pastaj prodhojnë pasiguri ndoshta edhe në regjion dhe më gjërë.

Konsideroj se rreth këtij segmenti të sigurisë vërtetë është mirë që po përfillet për krijimin e ministrisë së rendit, ministrisë së gjykatave. Por, megjithkëto probleme në fushën e sigurisë dhe gjyqësisë a mos është ajo që tërë përgjegjësinë që e kanë pas këta mekanizma brenda këtyre gjashtë viteve dhe që nuk e kanë zgjidhë asgjë.....

(Ndërprerje nga regjia – tejkalim i kohës së paraparë për diskutim)

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit Gani. Dhjetë minuta të plota ishin, të lutem.

(Reagim – pa kyçje të mikrofonit)

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Jo, jo. Ti ishe i pari që e çove përtej kohën. Fjalën e ka Jakup Krasniqi, pastaj le të përgatitet deputeti Xhelal Canziba. Urdhëroni zoti deputet.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

Ne, si Grup Parlamentar, që në fillim të seancës kemi qenë të bindur se debati për sigurinë është i papërgatitur. I gjithë zhvillimi i debatit e sidomos fjala e përfaqësuesve të Policisë së UNMIK-ut dhe Shërbimit Policor në këtë Parlament mendoj ka ulur vlerën e debatit dhe ka ulur vlerën e Parlamentit të Kosovës për faktin se këta dy përfaqësues janë përfaqësues të shërbimeve profesionale dhe si të tillë nuk kanë pas të drejtë t'i drejtohen Parlamentit të Kosovës. Të drejtë për sigurinë dhe për t'iu drejtuar deputetëve në Parlamentin e Kosovës e ka shefi i Shtyllës së parë të UNMIK-ut, i cili nuk e ka pa të arsyeshme që të raportojë me një seriozitet për situatën e sigurisë në Kosovë.

Gjithashtu, u pa se ky debat është i papërgatitur edhe për faktin se përfaqësuesit e Qeverisë, përfshirë edhe Kryeministrin, ishin të painedesuar për ta dëgjuar debatin, ishin të painedesuar për të dhënë një raport se cilat janë vështirësitë e tyre si Qeveri për të pas më shumë siguri dhe për të pas më shumë kompetenca dhe përgjegjësi për siguri.

Dhe, nuk di sa mund të flasim për sigurinë në Kosovë kur qe gjashtë vite asnjë krim politik – i organizuar politik – nuk është zbardhur, nuk janë gjetur motivet dhe kryerësit e këtyre veprave nuk janë përgjigjur.

Si mund të flasim për sigurinë kur asnjë vepër kriminale e krimit ekonomik përfshirë kontrabandën dhe korrupsionin nuk është zbardhur dhe nuk është përgjigjur askush, kurse përditë flitet edhe për krim, edhe për korrupsion, edhe për kontrabandë, edhe për trafiqe tjera të ndaluara. Kjo do të thotë se në Kosovë nuk ka sundim të ligjit, nuk vepron ligji.

Dhe, cili është mesazhi që marrin qytetarët e Kosovës nga të gjitha këto? Ose, cili është mesazhi që marrin të inkrimnuarit nga mosveprimi i gjyqit dhe i drejtësisë në Kosovë: "veproni të lirë, plaçkitni, grabitni, vritni se ligji në Kosovë nuk do t'ju ndëshkojë"!

Prandaj, vërtetë në një shoqëri të tillë, kur krimi është i toleruar nga ata që do të duhej ta ndëshkonin atë, është shumë vështirë të flitet për siguri. Të pasigurt jemi të gjithë.

U tha se Kosova është e sigurt, kufijtë e jashtëm të Kosovës janë të sigurt!? Unë nuk di sa janë të sigurt kufijtë e Kosovës kur ata grabiten. Sa janë të sigurt kufijtë e Kosovës kur një hapësirë jo e vogël e saj nuk kontrollohet as nga institucionet vendore as nga përgjegjësit për siguri – nga KFOR-i dhe nga UNMIK-u. Do të thotë, në Kosovë as nuk ka siguri të jashtme as nuk ka siguri të brendshme derisa në një hapësirë tepër të kufizuar të Kosovës - vetëm në territorin e dy komunave bëhen vrasje të shumta në pikë të ditës dhe kryerësit e tyre nuk gjenden, kur dihet se në Kosovë, sikur në asnjë hapësirë, në asnjë vend tjetër nuk ka qat shumë forca të sigurisë.

Dihet se Dukagjini është një nga zonat që janë kryer më së shumti vrasje të pazbuluara. Dhe, kjo dihet që gjashtë vjet. Pse përgjegjësit e sigurisë nuk përqendruan forcat e tyre për t'i gjetur vërtetë cilat janë motivet dhe cilët janë kryerësit e këtyre vrasjeve.

Prandaj, unë po përfundoj fjalën time, por i bindur se ashtu siç ka shkuar pa ndonjë seriozitet debati për ekonomi - po shkon edhe ky debat dhe do të shkojnë edhe të tjerët për arsye se askush në Kosovë e as institucionet e dala nga vota e qytetarëve nuk e kanë gatishmërinë për t'u përballur me probleme që i ka sot Kosova dhe me probleme që i kanë qytetarët e saj.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falemnderit. Fjalën e ka deputeti Xhelal Canziba, le të përgatitet deputetja Brikenda Kryeziu. Ashtu....? Atëherë, le të përgatitet deputeti Bajrush Xhemajli.

DEPUTETI XHELAL CANZIBA:

Falemnderit kryesues. I nderuar Kryeministër dhe ju kolegë deputetë, Rëndësi vendimtare dhe parakusht themelor i zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të një vendi është stabiliteti politik dhe siguria e tij.

Fatkeqësisht Kosova, në trendin aktual të zhvillimeve politike dhe gjendjes së sigurisë, nuk mund të krenohet për një situatë të kënaqshme të sigurisë. Megjithatë institucionet kosovare sot juridikisht ende vuajnë nga privimi i përgjegjësive në fushën e sigurisë, kjo nuk nënkupton edhe faktin se përgjegjësia e qeveritarëve aktual në fushën e sigurisë mund të abstrohoen thjeshtë në faktin e mospasjes së kompetencave të tyre në këtë fushë e të jenë të vetëdistancuar nga veprimtaria e krimit të organizuar.

Në parim, implikimi i një qeverie në kriminalitet pamundëson luftimin e tij. Para disa muajsh, subjekti politik që i takoj unë, ka ofruar një mori faktesh konkrete të implikimit

të rëndë të përgjegjësve aktual qeveritar në krimin e organizuar. Fatkeqësisht, deri më tani, megjithë informatat e konfirmuara, kemi një steposje të institucioneve përgjegjëse pa reagime konkrete.

Sot Kosova, si vendi më i varfër i Evropës, ka nivelin më të lartë të korrupsionit dhe keqpërdorimeve ekonomike qeveritare në nivel Evrope. Skandalet financiare, aferat e vjedhjeve dhe keqpërdorimeve të zyrtarëve aktual qeveritar tanimë janë përditshmëri normale. Edhe disa reagime të mediave të shkruara dhe elektronike në disa raste ndaj këtyre fenomeneve kalohen me injorancë dhe mospërfillje sikur këto fenomene të kenë ndodhë krejt diku tjetër jashtë vendit tonë.

Pushtetarët e Qeverisë aktuale, duke menduar se kanë legjitimitetin e të pacenuarit të tyre juridik, nuk shohin të nevojshëm as të fshehin gjurmët e tyre të krimit.

- Një milion euro më tepër shpenzime për teket e një kryeministri – shtesë e ndërtimit të një oxhaku në ndërtesën e re të Qeverisë;
- Pesë milion euro për "sulltanate" të sigurimit të presidentit; Aparaturë përgjimesh me vlerë tre milion për sigurimin e presidentit;
- Dy milion euro janë dhënë për vetura të blinduara të blera për zotin Rugova;
- Veturat janë blerë nga kushëriri i bodigardit të zotit Rugova dhe kanë kushtuar 600 mijë euro.

Opinionit të gjerë dhe neve si deputetë na intereson: ku kanë shkuar një milion e 400 mijë euro – nga ky pazar i stilit anadollak. Pse këto mjete nuk janë qarkulluar në mes shërbimeve zyrtare financiare dhe përse nuk është shpall tenderi publik për blerjen e këtyre veturave. I takon presidentit dhe Qeverisë që të sqarojnë për këto çështje dhe shkelësit e ligjit të merren në përgjegjësi.

- Dy milion të tjera për një projekt të ndërtimit imagjinar të një shtëpie presidenciale pa lokalitet ndërtimi dhe pa buxhet;
- Në kohën kur zoti Rugova ka shpenzuar edhe 3 milion të tjerë për ndërtesën e vet nën thojza "presidenciale" në Velani që askush s'e din pronësinë e saj.

Këto janë vetëm disa nga degjenerimet e përfitimeve dhe pastrimeve të parave që petku qeveritar sot bën në dëm të qytetarëve të vet.

Të nderuar deputetë,

Ekziston një paralogari e ekspertëve tanë ekonomik se vetëm nëse do të kishim kufizime të shpenzimeve të qeveritarëve në këto shpenzime lukse, të cilat i përmenda, do të kishim një rritje automatike të pagave mujore të arsimit për 15% apo rritje të pensioneve në masën 50 euro në muaj.

Të nderuar zonja e zotërinj,

Kur ne sot debatojmë për sigurinë në vend, nuk mund të mos përmendim edhe faktorët politik që kanë ndikim vendimtar në të. Kriminelë dhe vrasës sot enden nëpër Kosovë lirshëm. Shtrohet pyetja a mos të tillët janë vetëm apo kanë edhe ndonjë mbështetje

logjistike nga faktorët më të fortë dhe më të komplikuar sesa armët e tyre vrasëse? Ne do të ngrisim çdoherë çështje të veprimeve të papërgjegjshme të kujtdoqoftë që cenon progresin e arritur dhe pengon rrugën drejt mëvetësisë politike dhe rrezikon jo vetëm sigurinë fizike të qytetarëve por edhe tërë perspektivën politike të vendit tonë. Nga segmente të caktuara qeveritare ka tendenca për krijimin e monopoleve të biznesit në Kosovë në bazën e preferencave politike dhe të përfitimeve materiale dhe është duke u fuqizuar jo vetëm segmenti i krimit të organizuar mbi biznesin por ka edhe rreziqe të influencimeve të kontrolleve edhe mbi tërë procesin politik. Faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falemnderit. Fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemajli, le të përgatitet deputetja Flora Brovina. E keni fjalën zotëri.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI:

Ju faleminderit zoti kryesues. Përshëndetje, përshëndetje për Kryeministrin, dy ministrat. Kolegë deputetë,

Unë, në seancën e kaluar, shfaqja brengosjen time se Kryeministri po e bën normë mosdërgimin e materialeve me kohë, por me votimin e sotëm që kemi bërë këtu që të vazhdojmë të punojmë pa material bazë, mbi bazën e të cilit do të diskutohej, tregon se ne po bëhemi imun dhe po tregojmë se ne jemi kundër kualitetit të punës në Parlament.

Ka këtu shumë parafolës që janë brengos se komisioneri shkoi dhe zoti Sheramet Ahmeti!? Unë për veten nuk jam brengos për shkak se nga ajo që thanë, në fakt, nuk mora vesh diçka çka s'kanë ditë. Do të thotë kanë folë gjëra aq të përgjithësuara sa ka bërë të mos folin fare. Krejt ajo çka u tha – u tha për transferimin e kompetencave dhe vendosmërinë për luftë kundër krimit që realiteti e demanton menjëherë se kurrfarë vendosmërie s'ka pas deri më sot dhe s'besoj se nëse kështu vazhdohet do të ketë diçka të mirë. Në bazë të atyre që u tha, apo ekspozenë nëse mund ta quajmë, deputetët nuk mund – besoj – të rezymojnë asgjë për sigurinë në Kosovë.

Unë mendoj se materiali ka qenë tepër i domosdoshëm paraprakisht por edhe një ekspozë e thukët dhe pastaj të gjykojmë mbi atë bazë. Ta zëmë, sa vrasje, sa krime, sa vepra për korrupsion e tjera e tjera janë evidentuar deri sot? Sa janë arrestuar për shkak të këtyre keqbërjeve dhe sa janë dënuar? Dhe, të krahasohet pak edhe me fqinjët tanë, me regjionin e tjera dhe të vijmë në përfundim ne mbi atë bazë se athua sa jemi të sigurt ne.

Po të përmendet vetëm një dimension, mendoj se ne jemi të pasigurt. Derisa UDB-a jugosllave – e Serbisë në të vërtetë tash – vepron shlireshëm në Kosovë dhe këmbëkryq rin këtu, unë nuk mendoj se jemi të sigurt. Këtu mund të ketë dikush, sikur që thanë ka siguri e tjera e tjera, por mendoj se nuk qëndrojnë.

Zonja e zotërinj,

Është vërtetë dëshpëruese mosndriçimi i vrasjeve dhe krimeve të ndryshme të pazbuluara, për të cilat këtu u fol. Unë nuk do të ndalem në këtë aspekt. Mendoj se është e zëruar mjaft. Dua të flas në një aspekt tjetër.

Konsideroj se siguria apo mossaiguria në rend të parë i një vendi varet nga stabiliteti politik i cili në momentet që po kalojmë është duke u luhatur tepër shumë. Ka kohë që nga faktori ndërkombëtar na jepen sinjale se duhet bërë kompromis për statusin e Kosovës. Por, këto ditë, është thënë diçka shumë decisive për institucione të Kosovës dhe klasës politike natyrisht në përgjithësi – se duhet bindur populli për kompromis në zgjidhjen e statusit të Kosovës. Sigurisht se shumëkush, duke parë këtë rrjedhë negative që po kalojmë – po organizohet, dhe tjerat do të organizohen sigurisht edhe më vonë ashtu siç është tipi i Lëvizjes për vetëvendosje. Dikush mund ta marrë si një lëvizje shumë të dobët dhe të thjeshtë. Unë, nuk e mendoj ashtu. Këto organizime sigurisht që janë të drejta pasi pjesa më e madhe e klasës politike në Kosovë ka treguar se nuk është e zonja t'i përballojë presioneve në dëm të Kosovës, siç po ndodhë me mënyrën që po bëhet decentralizimi e shumë e shumë çështje tjera. Dhe, në këtë kontekst, pasiguria do të zgjerohet.

Klasa politike edhe për çështjen e kompromisit për status të Kosovës do të vazhdojë me mbajtjen e hises së asaj që dikton bashkësia ndërkombëtare dhe rrjedhimisht pakënaqësia do të rritet, sepse unë nuk e di kush do të jetë i gatshëm së paku publikisht që të bëjë një kompromis apo që ta bindë popullin për një kompromis të tillë siç po kërkohet.

Pakënaqësisë do t'i japin hov sigurisht arrestimet dhe burgosjet së aktivistëve të lëvizjes për vetëvendosje dhe kërkesave të tyre shumë të drejta. Kjo mënyrë e ndjekjes së aktivistëve të Lëvizjes, mënyra e arrestimeve, fyerjeve dhe poshtërimeve që iu bëhen në mes të rrugës vetëm pse ata shkruajnë një grafit në rrugë – do të jetë edhe një hedhje, mendoj e benzinës në zjarrin që sapo është ndezur. Këto skema i kemi parë në Kosovë që nga vitet e 80-ta dhe rezultatet i dimë.

Prandaj, prej këtu po them: Mjaft më me arrestime, me arrestime banale, me poshtërime dhe fyerje. Kjo është shkelje e të drejtave elementare njerëzore, e drejta për të protestuar në mënyrë të qetë dhe me denjëtet dhe kështu po bëhet kjo protesta e vetëvendosjes.

Ata që mundohen t'i shtypin kërkesat e drejta me represion, kushdoqofshin ata, në staza të gjata - kurrë nuk mund të fitojnë. Përkundrazi, vetë do të marrin përgjegjësinë për dëmet që shkaktojnë dhe për sigurinë.

Dhe, krejt në fund. Meqë zonjusha ministreshë e Shërbimeve Publike na u drejtua disa herë si PDK, e ndjej për obligim si pjesëtar i PDK-ës që jam – dhe deputet – t'i them zonjushës Tërnkolli se Partia Demokratike e Kosovës do të vazhdojë të mbledhë fakte në funksion të ndriçimit të krimin të organizuar dhe atë – do të mbledhë fakte aty ku mundet. Por, me Serbinë – Partia Demokratike e Kosovës është përshëndetur moti, para të gjithëve. Sepse PDK i ka shpallur luftë krimin të organizuar, mafies, korrupsionit, keqpërdorimeve të ndryshme të funksionarëve qeveritar dhe në fakt ne do të kryejmë

detyrën e opozitës për t'i nxjerrë në shesh të gjitha të palarat e pozitës. Opozitë keni dashur, opozitë do të keni. Ju faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Në rregull. Deputetja Flora Brovina, le të përgatitet deputeti Hydajet Hyseni. Urdhëroni zonja Flora. Meqë s'keni kartelë, aktivizoni kartelën e Xhavit Halitit.

DEPUTETJA FLORA BROVINA:

Në rregull është. Sot patëm një fjalë të rastit nga përfaqësuesit e rendit, me të cilën assesi nuk mund të jemi të kënaqur. Megjithatë, siguria do të shihet nga disa prizma. Unë në këtë moment do të flas për pasigurinë sociale që shpesh është një burim i shumë dukurive të rënda në shoqëri dhe ajo mund të ngjajë në një bombë të kurditur në një vend, dhe në Kosovë pa dyshim.

Kosova i plotëson kushtet për këtë pasiguri për shkak të numrit të madh të njerëzve të papunë, kryesisht të ri dhe për shkak të mungesës së perspektivës kur dihet se një pjesë e tyre me entuziazëm dhe me shpresë lanë vendet e tyre të punës në Perëndim dhe u kthyen për të mbetur të papunë në Kosovë dhe për t'u bërë raste sociale.

Nga ana e Qeverisë nuk ka një iniciativë për hapjen e vendeve të reja të punës, nuk ka madje as punësim sezonal të organizuar në vendet e tjera. Kjo perspektivë mbyllet edhe me nepotizëm, me korrupsion dhe me dukuri tjera negative nga vetë institucionet qeverisëse të Kosovës. Mungon vullneti për mbrojtjen institucionale më të merituarve - familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranëve të luftës, të ish të burgosurve politik, viktimave civile, familjeve të të pagjeturve, invalidëve të punës, atyre që humbën punën për shkak të luftës, transicionit, të pensionistëve.

Nuk ka nis asnjë iniciativë institucionale për kthimin e fondit pensional të Kosovës të grabitur nga Serbia. Nuk ka nisur asnjë iniciativë për suksesionin me Serbinë. Pasigurisë ekonomike i shtohet edhe gjendja e pasanuar shëndetësore e mentale e popullatës së traumatizuar nga lufta, sindromit pas traumatik mjaft të lartë në vendin tonë i cili sindrom shfaqet tek pas përfundimit të luftës dhe disa vite më vonë. Nuk kemi as tretman adekuat në mbrojtjen institucionale të këtyre njerëzve të cilët të shumtën herë në mbrojtje të OJQ-ëve - joprofesionistëve.

Ka provokime të shpeshta në popullatë. Do t'i përmend vetëm disa: mosdënimi i kriminelëve të luftës, të atyre që shkaktuan krimin dhe gjenocidin në Kosovë; prezenca e shërbimeve të ndryshme në Kosovë; krimi i organizuar e tjera.

Shpesh ndodhë që kriminelët të kthehen në vendin e ngjarjes. Raste të tilla ka. Do të përmend vetëm një. Kur në delegacionin e Serbisë ndodhte krimineli i identifikuar nga familjet, që ishte një rast shumë provokativ për qytetarët e Gjakovës. Ngjashëm ka ndodhë edhe në Prizren, Klinë dhe në qytete të tjera.

Në fjalën e rastit Veton Surroi tha se mungon ndëshkimi. Mungon ndëshkimi për kriminelët mirëpo jo edhe ndëshkimi për çlirimtarët, sepse burgjet e Kosovës janë të mbushura me çlirimtarë, të cilët po gjykohen në gjykimet politike. Ndaj tyre ka sjellje shumë brutale dhe jokorrektësi. Kur emërohen kriminelët shpeshherë dënohen ata që ndriçojnë rastet dhe identifikojnë këta kriminelë, e jo vetë kriminelët.

Do të shtroja pyetje, megjithëse ata që duhet të përgjigjen nuk janë më këtu: Kush u dënua dhe a ka filluar procedurë e akuzës për ndonjërin nga kriminelët të cilët janë në listën që e paraqitën para sa kohësh dhe disa herë me radhë nga KAN-i dhe familjet e personave të zhdukur? Unë e di saktësisht, dhe ju të gjithë e dini, se megjithatë u akuzuan ata që i akuzuan kriminelët.

Çdo harrim dhe largim nga kjo problematikë mund të shndërrohet në një sfidë të rrezikshme dhe që rrezikon sigurinë në Kosovë. Këtë duhet pas parasysh kur flasim për siguri në përgjithësi. Ju faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit zonja Brovina. Lus që të kihet parasysh posedimi i kartelave. E ka fjalën zoti Hydajet Hyseni, pastaj le të përgatitet deputeti Zef Morina. E keni fjalën zoti Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI:

Faleminderit zoti kryesues. Po më lë përshtypje ky kujdes dhe xhentilitet për kartelat tona! Po unë kam vendosur që t'mos merrem shumë me çështje procedurale se s'i kam edhe detyrë, por s'mund të mos e kundërshtoj trajtimin e sotëm që iu është bërë bash familjarëve të të pagjeturve që janë ftuar këtu për të marrë pjesë në debatin për më të dashurit e tyre. U ndërrua rendi i ditës me motivacione se zotërinjtë që erdhën këtu kanë obligime, po ata shkuan dhe ne vazhduam me të vjetrën dhe tani ata janë detyruar të dëgjojnë muhabetet tona për sigurinë.

Mendoj se nuk do të duhej të lejonim situata të tilla sepse, më besoni, ndjehem keq nëse unë do të flas diçka që objektivisht nuk është prioritet i tyre.

Sido që të jetë, po e bëj si të gjithë të tjerët. Unë thash – muhabet për sigurinë, se vërtetë s'di si ta quaj ndryshe këtë. Të themi është çështje e ngutshme, nuk është shtruar si çështje e ngutshme; të themi mocion përmbajtjesor – dihet si shtrohet mocioni, nuk është ashtu. Në rend dite, siç duhet, nuk është futur. Prandaj – muhabet, pa asnjë letër, sikur dikur që i kemi bërë – 20 – 30 vjet përpara në shumëçka, madje edhe në diskursin, kurse flitet se ka një projekt për ndërtimin e sistemit të ri të sigurisë. Pse, zotërinj nuk na e sillni këtu që deputetët ta lexojnë, të thonë ndonjë mendim. Ne po flasim kuturu – në hava.

Siguria është një nga standardet kryesore dhe ne flasim – e tash kërkush s'po na bën vërejtje se është kompetencë e rezervuar, por në të vërtetë ju e dini se objektivisht ne gjatë gjithë kohës nuk kemi pas instrumentet e duhura dhe as kompetencat për të dhënë provimin në fushën e sigurisë. Pse flasim? E marr me mend, e merrni edhe ju me mend.

Po flitet se do të bëhet një ndryshim pozitiv dhe tash është vrapi kush po e grabitë atë për ta kapitalizuar. Nejse, është lojë politike dhe le të vazhdojë.

Por - shtrohet çështja, nëse e shtrojmë kështu: kush duhet të jetë intolokutori ynë, a i ftuari ynë? Janë ftuar, nuk e di se s'e kam parë tekstin, s'është shpërndarë teksti fillestar. Kush ka vendosë që të ftohen përfaqësuesit e policisë? A është çështja e sigurisë vetëm çështje policie – policore, apo është diçka pak më shumë?

Nejse, ata erdhën dhe ne i dëgjuam, dhe dëgjuam për shembull edhe një xhevahir sipas të cilit përfaqësuesi zyrtar i policisë ndërkombëtare deklaroi se krimi i organizuar, një pjesë e tij, sidomos shpërthimet e kanë motiv – nëse e kam kuptuar saktë dhe e citoj saktë: "pamundësimin e funksionimit të Qeverisë". Mua, më shtrohet dilema – policia a është për të konstatuar se cili është qëllimi i fenomeneve negative a krimi, apo është aty për t'i zbuluar kush janë ata, për t'i parandaluar ata, apo për të bërë analiza e kualifikime politike, kurse kjo praktikë po vazhdon vazhdimisht.

Nejse, policia edhe mund të bëjë, se vërtetë nuk do të duhej të ftoheshin përfaqësuesit e policisë këtu, i kemi marrë në qafë. Tjetërkush duhet të japë përgjigje për fushën e sigurisë dhe për sistemin e sigurisë në Kosovë – edhe për gjendjen dhe për të ardhmen e saj. Por, nuk do të duhej Parlamenti të bjerë në atë grackë.

Çështjet që unë do t'i shtroja janë: a kemi sistem unik politik dhe integral. Dikush tha se këto strukturat paralele janë krijuar për shkak do akteve të dhunës ose tjera. Strukturat paralele, kanë qenë vazhdimisht. Pse nuk e shtrojmë – çka do të thotë ky në realitetin tonë kosovar. Çka ndihmon këtu policia, ju lutem – për këtë çështje?

Sa varet sistemi i sigurisë nga ajo që u fol këtu bukur shumë – gjendja sociale, ekonomike, varfëria, papunësia, paperspektiva e rinisë e tjera? Të gjithë e dimë, prandaj s'po marr kohë, por pyetja ime është: çka mund të ndihmojë këtu policia të cilën ne e kemi ftuar?

Po krimi, që është edhe çështje e policisë, a është i tëri që edhe mund të luftohet prej policisë. Çka me krimin, për të cilin përsëri u fol këtu shumë - në nivele shumë të larta - dhe të fshehura në petkun institucional. Policia mund të arrestojë një varfanjak që ka prerë disa dru në mënyrë të paligjshme – në mal të tij ndoshta. Por çka me ata që e rrezikojnë tërë pyllin, ndoshta me gjithë barinj e roje, a edhe kur është ndoshta park nacional. Çka me rreziqe të tilla? Policia thotë – s'kemi çka të bëjmë, sepse është në nivel tepër të lartë, kurse ju zonja e zotërinj e dini se te ne problemet nuk janë në nivele të qytetarëve të Kosovës. Janë në nivele ku rrezja e veprimi të policisë nuk po arrin, nuk po arrin madje as rrezja e ndikimit të qytetarëve. Dhe ne duhet të vëmë gishtin në plagë nëse duam të japim përgjigje të duhura.

Çka me problemin që u theksua po ashtu këtu – për hapësirën e tepruar për funksionimin e strukturave të ndryshme të shërbimeve sekrete? Kush ka krijuar këtë dhe kush e lejon? Çka mund të bëjnë policët që i kemi ftuar këtu në këtë drejtim. Ata s'kanë kompetenca për t'u përzier në çështje të tilla.

Ose, çka me hapësirën po ashtu që është krijuar për veprimin e strukturave mafioze të krimit e tjera që janë më të fuqishme se sa strukturat tona edhe të përziera – pa lere më ato thjeshtë kosovare. Ata s'kanë probleme me kompetenca të rezervuara, as me instrumentet që do t'i kenë. Të gjitha i kanë. Ata s'kanë as kufizime etnike e tjera. Të gjitha i kanë. Dhe, çka mund të bëjë shoqëria jonë e brishtë, e ballalfauar me një rrezik të tillë? Përgjigjen e dini të gjithë zotërinj.

Ose çka mund të bëjmë ne dhe çka mund të bëjë policia jonë të cilën ne e ftojmë në këtë debat për pasoja që prodhon privatizimi i procesit të privatizimit, procesit gjoja të konsolidimit të shoqërisë kosovare dhe loja me miliona, me vetura, me lukse që nuk i kanë as vendet më të zhvilluara – ju lutem, dhe irritohen miqtë që na vijnë. Çka mund të bëjë policia me këtë? Jemi ne, zotërinj që duhet të japim përgjigje në to.

Dhe, mund të vazhdoj shumë, por s'po dua edhe t'ju lodhi. Por, çka mund të bëjë policia ta zëmë me lojërat politike që organizohen s'di nga kush, me do vizita provokative të ministrave që pretendojnë se e mbulojnë edhe Kosovën dhe vijnë këtu në Kosovë pikërisht ditën e "Vidovdanit" – e ju e dini çka ka sjellë në Kosovë "Vidovdani" edhe për ta që presin atje në lozhë dhe vijnë na japin mesazhe luftënxitëse këtu dhe pastaj policia jonë del dhe arreston do djem sepse "i paskan penguar në detyrën zyrtare funksionarët e tjerë" dhe ne i dëgjojmë këtu po ashtu shpjegimet e tilla, e tjera. Lojëra politike janë ato që krijojnë situata të tilla. Lojërat politike nuk i bëjnë qytetarët e Kosovës. Nuk i bën as policia jonë që vjen shpesh në situata të rënda.

Prodhon pasiguri, siç u tha, edhe e ardhmja e papërcaktuar dhe lojërat që bëhet me të, lojëra nganjëherë që po bëhen edhe me ne, me dofarë kalkulimesh për statuse politike, me statuse politike e tjera dhe mendoj se edhe atje duhet ta kërkojmë burimin e pakënaqësisë e cila pastaj prodhon edhe forma të ndryshme të reagimit.

Mbi të gjitha, unë mendoj se do të duhej të vënim gishtin te vakumi institucional e ligjor që është çështje kryesisht e jona. Në vend se të bëjmë muhabetë shterpe, ne do të duhej të shtronim nevojën e ndërtimit të sistemit të sigurisë, ndërtimit të infrastrukturës ligjore për të mbuluar çështjen e sigurisë.

Do të duhej, në këtë kuadër, pastaj edhe të krijojm hapësirën për policinë tonë të re e cila meriton respekt për punën që bën, meriton respekt edhe nga fakti se vepron në kushte shumë të vështira dhe shpesh edhe në pozitë jo denjëtoze e tjera, por nuk do të ishte mirë që ne ta fusim policinë në lojëra tona politike midis partive e tjera.

Zonja e zotërinj, unë jam për një qasje tjetër, jo për ta mbyllur këtë debat siç u propozua, por le të shërbejë kjo thjeshtë si një shkundje a një zbrazje dhe ne le ta përgatisim për një seancë tjetër shqyrtimin e kësaj çështjeje me dokumente, me letra, me raporte, me projekte dhe me strategji për ndërtimin e sistemit shumë të rëndësishëm të sigurisë në Kosovë.

(Ndërprerje nga regjia - tejkalim i kohës për diskutim)

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit zoti Hyseni. Fjalën e ka deputeti Zef Morina, le të përgatitet deputeti Nait Hasani.

DEPUTETI ZEF MORINA:

Faleminderit zoti kryesues. I nderuar Kryeministër, ministra, zonja dhe zotërinj deputetë, Nuk dëshiroj të marr shumë kohë për shkak se pika e dytë e rendit të ditës, e cila ka gjithashtu një rëndësi shumë të veçantë, duket do të ngelet për seancë tjetër ose për nesër. Sido që të jetë, mendoj se duhet të gjithë të jemi shfrytëzues më relativ të kohës që kemi.

Edhe përkundër ngjarjeve të ndodhura në Kosovë, mund të themi se ka një siguri, por e cila mund të jetë në nivel më të lartë në qoftë se do të ketë një bashkëpunim më të mirë në mes institucioneve kompetente ndërkombëtare dhe atyre vendore për sigurinë e qytetarëve.

Edhe pse çështja e sigurisë është kompetencë e rezervuar e UNMIK-ut, institucionet vendore nuk mund të rrinë anësh por duhet të jenë më aktive, dhe në bashkëpunim me organet kompetente, të krijojnë një ambient më të sigurt për qytetarët e vet.

Mendoj se Qeveria, edhe pse në këtë rast nuk është kompetente, ka përgjegjësi dhe duhet të kërkojë me vendosmëri tek organet kompetente të UNMIK-ut për zbardhjen e rasteve kriminale dhe për vënien para drejtësisë autorët e krimit. Dhe, në këtë mënyrë, po të ishte me një vendosmëri më të madhe të përqendruar, sigurisht se disa ngjarje do të zbardheshin.

Andaj, PSHDK-ja, për të pas një siguri më të mirë për qytetarët e Kosovës, kërkon që sa më parë të formohet shërbim informativ inteligjent në nivel kombëtar, i cili do të jetë nën kontrollin e institucioneve gjegjësisht të Parlamentit dhe të Qeverisë, të bëjë eliminimin e menjëhershëm apo të kërkojë nga UNMIK-u eliminimin e menjëhershëm të strukturave sekrete serbe të cilat në çdo moment mund të destabilizojnë vendin dhe këtë faj t'ua hedhin vendorëve. Pastaj, shuarjen e strukturave të shërbimeve informative partiake, të cilat me veprimet e tyre, për interesat e partive që iu përkasin, janë duke rrezikuar interesat e qytetarëve të Kosovës.

Me krijimin e ministrisë së punëve të brendshme dhe të drejtësisë të bëhet menjëherë bartja e kompetencave dhe jo siç dëgjuam apo siç shkruan edhe në rregulloren e UNMIK-ut që këto ministri do të kenë kompetenca të kufizuara apo të kenë përgjegjësi pa kompetenca, gjë që kjo do të krijonte formimin e ministrive dekorative dhe joekzekutive, sepse raste të tilla kemi pas edhe në qeverinë e kaluar kur ministrinë kanë qenë përgjegjëse ndërsa nuk kanë pas mundësi që të veprojnë për të zgjidhur probleme për të cilat edhe kanë qenë të ftuara. Në këtë mënyrë, mendoj se shumë shpejt Kuvendi dhe institucionet tona duhet të kërkojnë që transferi i kompetencave të jetë i plotë në mënyrë që ne të jemi ballëhapur ose të kemi të drejtë të flasim para qytetarëve dhe të mos themi

se kjo është e drejtë apo është mundësi për t'u realizuar gjegjësisht mos të themi se kjo është kompetencë e rezervuar, apo kjo është kompetencë të cilën ne mund ta kryejmë.

Siguria në Kosovë është shumë e ndjeshme por nuk pajtohem se nuk ka siguri, sepse po të ishte ashtu atëherë edhe ne këtu nuk do të ishim. Faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Nait Hasani, le të përgatitet deputeti Enver Hoxhaj. Urdhëroni zoti Hasani. Lus regjinë që deputetin Hasani t'i mundësohet për ta marrë fjalën.

DEPUTETI NAIT HASANI:

Zoti kryesues, zoti Kryeministër, Ministër Haraqija dhe Tërmkollli, Unë dëgjova këtu të gjitha leximet e deritashme të deklaratave të ndryshme për sigurinë. Dhe mendoj se siguria, është çështje e rëndësishme që është shtruar të diskutohet sot. Mendoj se nga Kosova dhe në Kosovë kemi disa shërbime të ndryshme, të cilat janë marrë dhe po merren me sigurinë e Kosovës. Kur e them këtë, kam parasysh se njëqind shtete i kemi në Kosovë, njëqind shërbime të sigurimit i kemi në Kosovë duke përfshirë Serbinë e cila është më e zonja prej të gjithave dhe luan lojën e vet kurdo dhe të bëjë çfarë të dojë këtu.

Për ato leximet që i dëgjova nga kolegët deputetë për sigurinë, mendoj se këtu duhet të jetë një debat pikërisht me prezencën e atyre që janë për siguri dhe ata që ishin të cilët nuk siguronin sigurinë, mendoj se ata ishin një pjesë e asaj që dëshmuar se nuk mundën t'na sigurojnë.

Megjithatë, unë pash edhe disa kolegë nga Lidhja Demokratike që i dorëzuan diskutimet me shkrim duke pas mosguximin e vet shprehjen për sigurinë në Kosovë. E them këtë sepse edhe ata duhet të kenë siguri, por të paktën mendoj se disa nuk mendojnë ashtu siç mendon kreu. E them edhe këtë, sepse në Kosovë u përmend që gjashtë vite kemi kaq raste – njëqind e sa raste në zonën e Dukagjinit për vrasje dhe për to asnjë nuk është i arrestuar. Mendoj se rasti i Enver Haradinajt është kulminanti i krimit të organizuar në këtë zonë, ndërsa policia thotë: vazhdojnë hetimet. Çfarë sigurie do të kërkojmë dhe do të sigurojmë edhe ne që diskutojmë këtu për qytetarët e zonës së Dukagjinit. Krimet janë duke vazhduar, ndërsa ne vetëm diskutojmë.

Për të arritur t'i zgjidhim këto, dikush thotë do ta krijojmë ministrinë e mbrojtjes. Kjo seancë unë mendoj është thirrur pikërisht sepse është folur se do të krijohet ministria e punëve të brendshme. Duke pas parasysh se do të krijohet, atëherë duhet të zëmë hapin dhe të dimë si t'ia bëjmë dhe kënd do ta bëjmë ministër. Ministri nuk i zgjidhë problemet.

Ky Parlament, edhe kolegu ynë dëshmoj, nuk është i sigurt dhe edhe ne si deputetë nuk jemi të sigurt, sepse kushdo mund t'na ndalë dhe të dalim para aktit të pasigurisë.

Duhet të them pse nuk vlerësohen, pse nuk bëhen organizimet dhe arrestimet e kriminelëve, që e dëshmoi edhe deputeti i ORA-s Veton Surroi. Bllokimi i arrestimit të tyre është bërë për shkak të politikës të cilën do ta vlerësojë pozitivisht Kei Eide. Sa do të jetë kjo e qëndrueshme dhe e sigurt? Sa do të presim ne që Kei Eide ta vlerësojë politikën në Kosovë të drejtë dhe ne atëherë të fillojmë me përmasa të arrestimit të kriminelëve, ose edhe sa krime do të ndodhin derisa të bëhet ky vlerësim. Mendoj se ne po ecim në staza të krimit të organizuar politik, ekonomik dhe të korrupsionit.

Të gjitha u përmenden këtu, prandaj Kuvendi duhet të dalë me qëndrime të caktuara dhe të detyrojë ata të cilët janë përgjegjës për mbajtjen e rendit, në këtë rast Qeverinë, duke pas parasysh se kemi këtu edhe Kryeministrin, ta bëjë një prezantim të qartë për këto dhe të dalim para qytetarëve për të thënë se Kosova është e sigurt. Kosova nuk mund të jetë e sigurt përderisa në Kosovë ekzistojnë mbi njëqind shtete dhe mbi njëqind sigurime të ndryshme. Faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit. Fjalën ia jap deputetit Enver Hoxhaj, le të bëhet gati deputeti Ymer Muhaxheri. Urdhëroni zoti Hoxhaj.

DEPUTETI ENVER HOXHAI:

I nderuari zoti kryesues, i nderuari zoti Kryeministër, anëtarë të Qeverisë, zonja dhe zotërinj,

Meqë jemi pothuaj në fund të këtij debati, dilema më e madhe që kemi aktualisht është çka pas këtij debati. Dhe, përgjigja është, si zakonisht – asgjë. Në parim, ky debat ka konfirmuar edhe një herë kulturën shterpe të Parlamentit të Kosovës – të Kuvendit të Kosovës dhe jogatishmërinë që të shkohet më tutje përpara.

Debati fillimisht dhe për fund është vetëm refleks i asaj që Kosova e ka qeverinë më të dobët në rajon dhe Kosova e ka qeverinë më të dobët në historinë e saj dhe me këto konstatime kjo qeveri do të mbetet në mend.

Kshim mund të shkojmë sigurisht përpara me këtë debat nëse fillimisht të dy përfaqësuesit e sigurisë t'na kishin ofruar një raport të mirëfillt pune i cili do të ishte një bilanc i mirëfillt sa i përket sigurisë në Kosovë, sa i përket problemeve të cilat i ka ballafaquar Kosova këto pesë-gjashtë vite të fundit dhe nëse në të njëjtën kohë Kryeministri, për të cilin po thuhet e ka zënë gjumi, t'na kishte ofruar një vizion i cili do të jetë edhe vizion i Qeverisë së Kosovës se cilat do të jenë hapat për ndërtimin e ministrisë së punëve të brendshme dhe asaj të drejtësisë nëse vërtetë do të kemi transferim të mirëfilltë të kompetencave.

Prandaj, debati ka konfirmuar edhe një herë se Qeveria e Kosovës, si qeveria më e dobët, ka tri prioritetet: korrupsionin, krimin e organizuar dhe shkeljen e ligjit, dhe këto tri prioritetet të Qeverisë, për mendimin tim dhe për mendimin e të gjithë qytetarëve të

Kosovës - janë burim i pasigurisë dhe i destabilitetit që ka Kosova. Faleminderit për vëmendjen.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ymer Muhaxheri, le të përgatitet deputeti Demir Lima.

DEPUTETI YMER MUHAXHERI:

Kuvend i nderuar, zotni kryesues,
Kam bindjen se debati ka qenë i bollshëm, shpeshherë impresionues por edhe me kahje të kundërt. Janë vënë në duke shumë probleme që ngarkojnë realitetin shoqëror e që për ne paraqesin shqetësime dhe obligim për mundësinë e zgjidhjes së tyre.

Për me pas konsideratë ndaj kohës, i veçoj vetëm dy momente, për të cilat mendoj se më kanë tangu – prekë më tepër se tjerat. E para, është lidhur me presupozimin se subjektet politike – dy të mëdha tonat – në kuadër të aktivitetit të tyre kanë edhe shërbime sekrete. Nëse ju kujtohet, autoritetja e parë e Parlamentit Evropian Doris Pak e ka vënë në dukje këtë. Besoj se deputetët këtu të cilët e kanë edhe cilësinë e anëtarëve të Kryesisë së këtyre dy partive, përndryshe parti motra për arsye se atributi demokratik i bën ato të jenë të njëjta të afërta – programi i tyre, edhepse historikisht në një mënyrë kujnike gjatë të gjithë kohës dhe mosgjetyes së një mirëkuptimi në mes veti.

Në çfarë mase është në gjendje ky Kuvend, ka obligim ndaj opinionit kosovar të japë sqarime, komente lidhur me ekzistimin apo mosekzistimin e këtyre dy shërbimeve. Mendoj se është kontribut i drejtpërdrejtë i këtij Kuvendi me dhënë sqarime.

Çështja e dytë, e cila po ashtu më prek, por ndoshta është kufizueshmëri imja se nuk kam mund mirë ta përcjell pledoajenë e zotni Surroit, në mesin e të cilës pledoaje e paraqet edhe një mënyrë të të menduarit hipotetik kur e vë në dukje mundësinë se është dashur të burgoset një pjesë e një lloji të krimit të organizuar, edhe për këto e këto shkaqe nuk është vepruar, në çfarë mase e ka përdorur këtë mënyrë të të menduarit? A është mundësia formale, e cila është platformë e krijimit artistik në përgjithësi apo ka folë për një mundësi reale objektive, diçka çka ka ndodhë në realitet.

Kjo mosmundësi imja me distinktua këtë dallim se në çfarë konteksti e ka thënë e paraqet dilemën time dhe besoj nëse e ka thënë në këtë kuptimin e dytë se mundësi reale diçka ka qenë ekzistuese atëherë ky Parlament – ky Kuvend ka obligim gjithsesi me dhënë sqarime, dhe në këtë drejtim me formuar komisionin hetues lidhur me të. Kjo është e tepërt që e ngarkon momentalisht mendjen e shoqërisë kosovare. Kaq pata.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit zoti Muhaxheri. Janë edhe dy diskutues. Deputeti Demir Lima e ka fjalën, le të bëhet gati Teuta Hadri.

DEPUTETI DEMIR LIMA:

I nderuar zoti kryesues, i nderuar zoti Kryeministër, të nderuar kolegë deputetë, Unë nuk do të zgjerohem shumë, do të fokusohem vetëm në një çështje dhe shumë shkurt, për arsye se shumë kolegë deputetë mendoj e kanë elaboruar dhe paraqitur gjendjen e sigurisë ashtu edhe si është.

Çështja e sigurisë që po e debatojmë sot, për të gjithë qytetarët e Kosovës është e rëndësishme së veçantë kurse përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës dhe UNMIK-ut. Padyshim se strukturat e policisë së UNMIK-ut kanë dështuar në zbardhjen e shumë vrasjeve enigmatike që kanë ndodhur në Kosovën e pasluftës, ose më mirë të themi as që janë interesuar për një gjë të tillë.

Zyrtarët e policisë mund të thonë se ne kemi qenë të interesuar që të bëhen zbardhjet e këtyre vrasjeve por kot së koti. Atëherë, unë i pyes: pse nuk është zbuluar asnjë vrasje në këto gjashtë vjet të fundit kur një pjesë dërmuese e tyre kanë qenë shënjestër edhe ish luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Po ashtu, habit fakti se Qeveria Kosumi nuk ka bërë asnjë përpjekje t'iu drejtohet organeve të UNMIK-ut që të interesohet se çfarë po ndodhë me vrasjet e qytetarëve të saj. Dhe menjëherë dua t'i bëj pyetje zotit Kryeministër: Sa e ndien veten përgjegjës se Qeveria e Kosovës përballë vetëvrasjes së fundit të invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i cili për shkak të gjendjes së rëndë sociale dhe të familjes së tij bëri vetëvrasje këto ditë, kategori kjo – zoti Kryeministër – që si rezultat i humbjes së gjymtyrëve të trupit dhe në fund të jetës së tij jeni edhe ju në postin e Kryeministrit të Kosovës.

Një gjë duhet ta kemi të gjithë të qartë, po ashtu edhe Qeveria Kosumi, se pa luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe flijimin e shumë dëshmorëve të kombit dhe të invalidëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk do të ishim sot ku jemi të gjithë këtu. Dhe, jo rastësisht, ka ndodhë vetëvrasja. Në mënyrë indirekte pasiguria ka ndikuar edhe në gjendjen e rëndë sociale tek invalidi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të bërë vetëvrasje. Por, as edhe një prononcim zyrtar që të shprehin dhembjen qeveritarët tanë për humbjen e jetës të këtij ushtari të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk e kanë bërë, të paktën moralisht.

Zotërinj qeveritarë,

Praktika e shteteve para nesh ka treguar se çdo qeveri që është shkëputur nga populli është gjykuar për dështim. Luksi për ju dhe rreth jush s'do të thotë se Kosova po zhvillohet dhe është e sigurt ose edhe ka mirëqenie sociale. Ju thash edhe në fillim, zoti kryesues, se do të jam shumë i shkurtër për arsye se është zgjatur dhe stërzgatur shumë debati, dhe kur kemi parasysh edhe faktin tjetër që përveç bisedës asgjë më tepër nuk do të ketë konkrete, edhe gjendja e sigurisë nuk do të ndryshojë për qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit. Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri, le të përgatitet deputetja Teuta Sahatqija.

DEPUTETJA TEUTË HADRI:

Faleminderit zoti kryesues,

Do të jam shumë e shkurtër. Siç shohim të gjithë deputetët, kanë kaluar mbi shtatë orë që janë në Parlamentin tonë të Kosovës dhe diskutohet rreth çështjes së sigurisë së qytetarëve të Kosovës. Nuk di sa ia vlen dhe si do të dalim ne para qytetarëve tanë pasi ta lëshojmë këtë sallë të Parlamentit – çfarë premtime dhe sigurime do t'iu bëjmë ne atyre pa asnjë konkluzion.

Unë të gjithë deputetët i dëgjova dhe përveç Bajrush Xhemajlit asnjëri nga deputetët nuk përmendën çështjen e sigurisë së deputetit të Parlamentit të Kosovës, çka është deputeti i Parlamentit, kush është ai dhe çfarë imuniteti ka. Kur ne sot dalim nga këto karrige të parlamentit dhe do them me plotë fjalën këto ID që na i keni dhënë a vlejné si ID identifikimi, sigurimi apo çka i shërbejnë deputetit të Parlamentit të Kosovës kur deputeti, nuk e them se injorohet nga qytetari, por nga personat që i drejtojnë institucionet tona – të Qeverisë, nga persona zyrtar të policisë që kanë bërë trajnim 3 muaj dhe dalin e ndalin deputetin 20 minuta në udhëkryqin e Prishtinës për ta penguar për të marrë pjesë në mbledhjen e këtij Kuvendi. Çka jemi ne, dhe kush garanton për jetën tonë. Po sikur ta bënim një sjellje pak më të shprehur, mund sot të keqpërdorej ai akt dhe qak edhe mund të rrehehi para vetë qytetarëve të Kosovës. Njëzet minuta kemi pritur në semafor duke i lutur me një ID të Parlamentit a ka mundësi se kemi mbledhje të parlamentit dhe t'na mundësohet të arrijmë me kohë atje. Jo thyerja e ligjit, siç thonte ai ligj, se në fakt ai shkelte ligjin se deputeti sipas ligjit është njeri autoritativ, ashtu sikur edhe ndihmë urgjente dhe si makinat e policisë që japin shenja, në ligjin e Kosovës është edhe çështja e deputetit është person autoritativ dhe mund ta shfrytëzojë atë benificion. Prandaj, zoti kryesues, dhe ju që e drejtoni kryesinë, ju kisha propozuar në të ardhmen në mbledhjen e parë të bëhet edhe një pikë e rendit të ditës dhe të sigurohet edhe çështja për imunitetin e ardhshëm para deputetit të Parlamentit të Kosovës. Faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit zonja deputete. Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija dhe i fundit le të përgatitet deputeti Xhavit Haliti.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA:

Faleminderit zoti kryesues. Do të kisha dëshirë që seancat në të ardhmen të kenë pak më tepër respekt, Kuvendi të ketë më tepër respekt për temat për të cilat flasim këtu dhe për dy tema të rëndësishme së veçantë mos ti qesim në të njëjtën seancë. Në këtë mënyrë është treguar se edhe fati i njerëzve të pagjetur dhe i familjarëve të tyre, të cilët qe sa vjet janë duke vuajtur, përsëri është duke u marrë si një çështje joserioze. Shpresoj se herëve tjera këto nuk do të përsëriten.

Për çështjen e sigurisë, ne në Kosovë e kemi një fat krahasuar me vendet tjera, që fëmijët të ne mund të luajnë lirisht pa pas mbikëqyrjen prej dikujt të rritur aty. Te ne, edhe kur ka

mungesë të rrymës, fatmirësisht nuk ndodhin gjëra të cilat ndodhin në vende që janë shumë më të civilizuar. Te ne, edhe femra mund të ecë rrugës në mbrëmje duke pas një lloj të sigurisë. Por të gjitha këto nuk janë pasojë e një sigurie të siguar në mënyrë institucionale. Të gjitha këto janë për shkak se roli i familjes, edhe i respektit për femiun, për femrën është një respekt që në këto treva është tradicional dhe falë kësaj dhe meritë e kësaj ane për atë që i ceka më përpara.

Kur vjen te shpërthimet te partitë politike, kur vjen te shpërthimet në afërsi të veturës së presidentit, kur vjen te rastet e vrasjeve politike – atëherë situata qëndron më ndryshe. Këtu policia është e pafuqishme. Dhe “hetimet vazhdojnë” është një refren i cili tepër shpesh është duke u dëgjuar. Këtu vetëm si ilustrim të vogël e kisha ndërlidhur si referencë sulmin në Londër që u bë, ku për më pak se një javë u gjetën emrat e kriminelëve, u gjetën fotografitë bile u gjetën para një viti ku kanë qenë ata të cilët shkaktuan këtë. Ndërsa, te ne refreni vazhdon.

Për polici... Policia te ne pas luftës është një polici të cilën e kemi mirëpritur, sepse është polici jona, sepse ajo punon për ne – në krahasim me policinë e cila ka qenë para luftës. Edhe policët të cilët punojnë sillen në mënyrë jashtëzakonisht të mirë dhe korrekte me njerëz. Por, problemi qëndron jo në policë me të cilët ne kemi direkt kontakte por si duket problemi është në administratë, problemi është diku tjetër, diku më lartë. Për këtë shkak edhe të gjitha këto krime nuk zbulohen.

Unë isha koncentruar edhe në pasigurinë në ekonomi, për korrupsionin i cili është patjetër i lidhur me situatën e sigurisë. Korrupsioni dhe evazioni fiskal krijon një pasiguri në biznes në ekonomi, në investime të huaja dhe investime të brendshme. Dhe, ky trend i mbrapsht, do të vazhdojë të lulëzojë përderisa akterët nuk do të japin përgjegjësi. Mirëpo, në vend që të dënohen për destruksion ata avancohen në poste tjera. Me këtë rast rritet pasiguria në popull, rritet pasiguria në ekonomi dhe vjen deri te rrëzimi, deri te degradimi i vlerave të mirëfillta të cilat kanë qenë prezente në trevat tona. Krijohet një pasiguri te qytetarët se ata të cilët i respektojnë këto vlera dhe sillen në mënyrë të ndërgjegjshme ata mbesin në margjina, mbesin të dënuar, ndërsa të tjerët avancohen dhe krijojnë një situatë të pashpresë, një situatë të degradimit të çdo gjëje të ndershme, të çdo vlere të mirëfillte.

Pasi korrupsioni dhe pasiguria në ekonomi është ngusht e lidhur me politikë me parti dhe, me këtë edhe me krijimin e strukturave - direkt ndikojnë në krijimin dhe rritjen e pasigurisë së përgjithshme. Pra, siguria në çdo vend, e edhe në Kosovë, është shumë komplekse. Siguria është, siguri e lëvizjes, është siguri e zbardhjes së krimeve, fusha e respektimit të të drejtave të njeriut, çfarë është prostitucioni, trafikimi e tjera, në arsim, në shëndetësi, në ekonomi, e tjera. Në mënyrë institucionale pengohet edhe zbatimi i ligjshmërisë, shantazhohen anëtarët e komisioneve të ndryshme, duke i treguar konsekuencat sepse nëse vendosë në mënyrë tjetër që të respektohet ligji atëherë do të pasojnë dënimet.

Unë jam për propozimin e rekomandimeve dhe të formohet ky komision hetimor i cili do të duhej përkrahur prej të gjitha partive dhe ky komision përveç tjerash t'i bëjë edhe rekomandimet Qeverisë dhe këto çka u thanë këtu të përcillen dhe të mos mbesin sikur

në seancat tjera çfarë ishte seanca e decentralizimit, çfarë ishte seanca e ekonomisë në të cilën të gjithë deputetët i shprehën frustracionet e veta dhe çdo gjë mbeti aty pa qenë konstruktive.

Shpresoj se ky debat, kjo seancë e sotme të ketë tjetër rrjedhë prej seancave tjera dhe të jetë frytdhënëse. Faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit dhe ia jap fjalën deputetit Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI:

I nderuar kryesues, zoti Kryeministër, të nderuar deputetë, Diskutimet e sotme unë i kuptoj si shqetësim të të gjithë deputetëve, edhe të atyre që diskutuan edhe të atyre që s'diskutuan, edhe të atyre që i dorëzuan fjalët me shkrim, që mendoj se nuk do të duhej të veprohet ashtu për shkak se s'jemi në seminar por jemi deputetë dhe fjalën tonë duhet ta dëgjojë jo vetëm Kryetari dhe Sekretaria e Kuvendit, por duhet ta dëgjojë i tërë opinioni – qytetarët e Kosovës.

Është e vërtetë se po jetojmë të shqetësuar të gjithë. Është e vërtetë se Kosova është me shumë probleme. Është e vërtetë se mundësitë tona janë të kufizuara si institucione, por është e vërtetë e pakundërshtueshme që këto institucione – edhe pse me pak kompetenca – kanë mundësi shumë më të mëdha për të vepruar dhe për t'i luftuar fenomenet e këqija, krimin e organizuar dhe korrupsionin, por edhe atë të paorganizuarin.

Është e vërtetë dhe nuk dua ta akuzoj Qeverinë së pari, por është e vërtetë se qytetari i Kosovës në qoftë se donë ta kryejë një shërbim cilindoqoftë duke filluar nga zyrat e shërbimeve civile dhe kuvendet komunale e deri në instancat më të larta duhet të paguajë haraç. Këtë nuk po e them se ia kam inat dikujt, nuk po e them për ta denigruar dikend, por ky është shqetësim i të gjithë njerëzve, i gjithë qytetarëve të cilët kanë të bëjnë me zyrtarët komunal, qeveritarë apo kushdoqofshin ata.

Kemi vërtetë akuza, të cilat mëse janë të vërteta, por nëse nuk janë të vërteta është obligim i atyre të cilët janë të apostrofuar të sqarojnë këtë dhe mendoj se është obligim i këtij Kuvendi që përmes mekanizmave të tij t'i ofroj opinionit publik të vërtetat apo të pavërtetat e atyre që janë ngritur deri më tash.

Jemi në një fazë kur vërtetë bashkësia ndërkombëtare po kërkon nga ne që të përmbushim standardet dhe njëra ndër standardet kryesore mendoj se është lëvizja e lirë e qytetarëve dhe kthimi i qytetarëve serb në Kosovë. Unë e di që sot deputetët serb s'kanë folë dhe s'janë këtu, por më shqetëson fakti se deputetët shqiptar në rend të parë nuk merren më seriozisht me këtë punë dhe nuk ngrisin shqetësimin e tyre për akuzat që bëhen ndaj institucioneve të Kosovës, akuzat që bëhen ndaj nesh dhe thjeshtë të shprehim qëndrimin tonë të përbashkët se a ka vërtetë presion nga dikush, nga qytetarët, nga institucionet dhe cili është mesazhi ynë të paktën për qytetarët lidhur me këtë çështje.

Është e vërtetë se në Kosovë kemi bomba, kemi vrasje. Bile-bile dje më ka ra në dorë edhe një trakt i njëfarë organizate ose "reise byro – perëndia – islami" a nuk e di çfarë ishte, që tregonte rrugën e të gjithë atyre që duan të "fluturojnë dhe ta çojnë shpirtin te zoti". Për mua nuk është për të qeshur, është shumë shqetësuese sepse në kushtet kur ne po themi se jemi aleat të Perëndimit në sytë tanë, në trollin tonë po na shfaqet një fenomen i rrezikshëm me të cilin po ballafaqohet njerëzimi, po ballafaqohet bota demokratike sot.

Prandaj, prapë po them, duke mos pas kompetenca do të duhej që këtij fenomeni institucionalisht, publikisht, me mjete të informimit, nga këto foltore të Parlamentit të Kosovës t'i themi stop sepse nuk e kemi njet me bë Kosovën qendër të terrorizmit botëror.

Ne mund të prejudikojmë këtu ndaj njëri-tjetrit dhe mund ta akuzojmë njëri-tjetrin për bombat. Nuk e konsideroj veten se mund të jam ndonjëfarë specialisti por nuk e besoj se iu ka tekë dy vetëve – dy djemve të ri ose një vajze a një çuni të ri që t'i gjejnë dy bomba diku dhe t'i vendosin tek UNMIK-u, t'i vendosin kudoqoftë nën makinat e UNMIK-ut, të policisë ose ku i kanë vendosë ato – sepse qenkan të pakënaqur me situatën në Kosovë ose qenkan të pakënaqur me jetën e tyre.

Unë nuk besoj se nuk është dikush mbrapa këtyre dhe nuk mund të jenë këta vetëm dhe nuk mund t'i bëjnë këto veprime pa mbështetje të caktuar politike dhe pa mbështetje financiare.

Është e vërtetë se kemi vrasje të shumta në mes të shqiptarëve, dhe të gjitha këto po mbesin enigmë, sikur u tha edhe deri më tash. Por, unë nuk dëgjova nga të dërguarit këtu, të cilët erdhën me uniforma – që unë nuk do t'i preferoja, megjithatë respekt që erdhën, na thanë diçka – s'na thanë kurgjo. Cila është politika e sigurisë dhe cila është politika e këtyre të cilët janë të angazhuar dhe të ngarkuar për ta ruajtur sigurinë e Kosovës? Pse nuk burgosen njerëzit e krimi? Pse nuk veprohet fuqishëm me anën e ligjit dhe të forcës kundër atyre që organizojnë dhe cilët janë - kam përshtypjen dhe kam në njëfarë mënyre bindjen, të gjveshur tani se cilët janë dhe nga vijnë. Apo, është një politikë tjetër e cila fatkeqësisht është aplikuar në disa vende – praktika e likuidimit të grupeve njëri me tjetrin derisa të mbesin dy-tri kokrra kundër të cilave pastaj të mund të veprojë ligji.

Në qoftë se KFOR-i, Policia e UNMIK-ut, SHPK-ja dhe gjithë mekanizmat e sigurisë në Kosovë kanë frikë, siç u tha këtu, nga mekanizma të caktuar politik dhe nga ku ta di unë, raportues të ndryshëm, atëherë do të duhej të jepnin dorëheqje dhe të shkonin nga kanë ardhë dhe të vinte dikush më i guximshëm që veprom.

Ne kemi disa lloj krimesh në Kosovë dhe nuk do të futem t'i bëjë analizë krimeve, duke përfshirë edhe atë ekonomik, por e dimë të gjithë se në Kosovë ka pas dhe ka vrasje politike, ka vrasje me motive të ulëta, ka vrasje të interesave ose të konflikteve ekonomike dhe ka vrasje kanunore. Ne jemi këtu për t'i shërbyer dhe për t'i dhënë rrugë çështjeve, për të miratuar ligje dhe për të debatuar për çështje që na brengosin. Prandaj,

këtë nuk dëgjoja deri më tash dhe do t'kisha pas dëshirë që të dëgjoja ato që ngrita më lartë më shumë dhe të dëgjoja athua mund të organizohemi ne, jo si udhëheqës të mëdhenj, jo si përfaqësues qysh po kemi qef ta quajmë veten të popullit, sepse të tillë jemi, por nganjëherë po e theksojmë, po si njerëz me shqetësime për këtë vend dhe t'ju drejtohem të paktën njerëzve tanë dhe t'i themi stop kësaj në mënyrën që disa protagonistë të pajtimit të madh janë në këtë sallë.....

(Ndërprerje nga regjia – por i vazhdohet mundësia e diskutimit)

...Do të thotë, ne duhet të kemi forcë nga ky parlament, të kemi guxim dhe të kemi njerëz të cilët janë të gatshëm të shkojnë, t'iu ulen të gjithëve në tryeza dhe pranë votrës dhe t'ju kërkojmë që në emër të të gjithë të rënëve, në emër të Kosovës, në emër të së ardhmes së fëmijëve tanë t'i themi stop njëherë e përgjithmonë këtyre vrasjeve, e tjera dhe t'ua kthejmë atë që e kemi obligim ligjor konform standardeve, që thash më herët. Faleminderit.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit. Të nderuar, me kaq edhe përfundon debati për këtë temë. Kanë marrë fjalën të gjithë ata që e kanë kërkuar. Propozoj që Komisioni për shërbime publike në bashkëpunim me Komisionin për gatishmëri emergjente të nxjerrë rekomandimet si propozim nga transkripti i cili do të bëhet shumë shpejt nga ana e Sekretarisë. Ju faleminderit.

Çështja e dytë. Pyes Kuvendin a të vazhdojmë me pikën tjetër sot apo ta lëmë nesër në mëngjes. Cili është deklarami i Kuvendit? Urdhëroni zoti Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI:

I nderuari kryesues,

Mendoj se për shkak të seriozitetit të temës që trajtojmë, kjo temë do të duhej të trajtohet nesër tërë ditën, ndërsa pikat e parapara tjera - siç janë ato të leximit të parë dhe të dytë eventualisht pasnesër apo sa të ka nevojë të vazhdojmë me to. Propozojmë kështu për arsye që nesër të mos ketë debat të kufizuar. Ju faleminderit shumë.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Faleminderit. Ky është propozim i deputetit Gashi. A pajtoheni për këtë propozim?

Ju faleminderit. Atëherë vazhdojmë punën nesër në orën 10.

(Për pikën – çështja e sigurisë, në vijim transkriptit i bashkëngjiten diskutime të dorëzuara në formën me shkrim – të përshkruara apo skanuara nga origjinali)

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI:

Zoti Kryetar i Kuvendit, i nderuar Kryeministër, ministra dhe ju deputetë,
Çështjen e sigurisë në Kosovë, përveç tjerash, duhet kuptuar si nocion – se çka në të vërtetë përfshin aspekti i sigurisë, sa është i gjerë dhe në cilat fusha shtrihet ndikimi më i madh i tij por duhet kuptuar edhe si strategji të veprimit ose më saktë se çka duhet ndërmarrë që siguria në Kosovë të jetë e kënaqshme me qëllim të zhvillimit pozitiv të proceseve në Kosovë.

Siguria gjithmonë ka edhe dimension politik, institucional, rajonal, shoqëror dhe gjithsesi edhe ekonomik – pra ka një shtrirje të gjerë me një ndikim po ashtu të madh në të gjitha sferat e jetës.

Unë do të ndalesha shkurtimisht në aspektin e ndikimit të elementit të sigurisë në zhvillimin ekonomik të vendit. Padyshim se niveli më i lartë i sigurisë së gjithmbarshme në Kosovë do të ndikojë edhe në zhvillimin ekonomik në përgjithësi dhe në tërheqjen e investimeve të huaja në veçanti. Sipas disa të dhënave investimet e jashtme direkt në Kosovë në periudhën e pasluftës janë më të voglat në krahasim me vendet e rajonit (rreth 30 mil euro) edhe pse Kosova është vendi me nevojën më të madhe për kapital të jashtëm financiar. Në Kosovë mund të thuhet se është bërë progres në aspektin e sigurisë edhe fizike, juridike, politike dhe institucionale por që ajo duhet të jetë e qëndrueshme dhe e avancuar për çdo ditë e më shumë për shkak të reflektimeve të mundshme pozitive apo negative. Gjithsesi se faktori i siguri nuk është i vetmi i cili ka pas ndikim në trendet investive në Kosovë qofshin ato të brendshme apo të jashtme. Por, megjithatë e ka një ndikim të veçantë.

Nxjerrja e legjislacionit ekonomik në Kosovë e rritë sigurinë e investimeve dhe në këtë drejtim edhe janë bërë përparime. Në procedurë parlamentare janë ligji për investimet e huaja në Kosovë i cili i vë në pozitë plotësisht të barabartë investitorët e jashtëm me ata të brendshëm por edhe ligji për procedurën e dhënies së koncesioneve. Megjithatë, në këtë drejtim, duhet të kompletohet i tërë legjislacioni ekonomik dhe Qeveria e Kosovës duhet të garantojë investime të jashtme në Kosovë. Garantimi i investimeve nga ana e Qeverisë të vendeve të ndryshme për investimet e tyre të realizuara në Kosovë, do të ndikonte në zhvillimin ekonomik dhe në mënyrë indirekte edhe në rritjen e aspektit të sigurisë dhe në përmirësimi në gjendjes sociale në vend.

Një stabilitet ekonomik më i madh do të thotë edhe gjendje e sigurisë me stabile dhe e kundërta – një shkallë më e lartë e sigurisë së përgjithshme në Kosovë dhe sidomos e sigurisë ekonomike do të thotë mundësi më të mëdha për zhvillim ekonomik dhe tërheqje të investimeve.

Bartja e plotë e kompetencave tek organet kompetente vendëse të sigurisë, ato do t'i bëjë më përgjegjëse dhe plotësisht përgjegjëse për aspektet e sigurisë në Kosovë. Formimi i ministrive përkatëse të rendit dhe të drejtësisë tanimë është imperativ i kohës. Fuqizimi dhe mbështetja materiale e organeve për çështje të sigurisë – SHPK do të ndikojë në

profesionalizimin e mëtejshëm të tyre dhe me këtë edhe në ngritjen e efikasitetit veprues. Organet e rendit dhe të sigurisë në Kosovë megjithë kufizimet buxhetore duhet të kenë trajtim të veçantë buxhetor, duke pasqyruar rolin dhe vendin e tyre në ndërtimin institucional të vendit dhe në periudhën nëpër të cilën po kalojmë. Qytetarët e Kosovës dëshirojnë të kenë vetëm një forcë të rendit dhe të sigurisë në Kosovë, e cila do të jetë në mbrojtje të sigurisë së tyre fizike, pronësore dhe qytetare. Ekzistimi dhe veprimi eventual i strukturave tjera pa marrë parasysh se nën përkujdesjen e kujt ato veprojnë, e dobëson rolin dhe efikasitetin e organeve kompetente të sigurisë. Roli i institucioneve të Kosovës në përmirësimin në pozitës materiale dhe të pajisshmërisë teknike të organeve të rendit dhe të sigurisë është i pazëvendësueshëm. Faktori ndërkombëtar duhet të luajë rolin e vet edhe në drejtim të bartjes së kompetencave por edhe të zhvillimit të një partneriteti veprues me këto institucione në të mirë të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

(Deputeti Behxhet Brajšhori, d.v. - i nënshkruar)

DEPUTETI FATMIR REXHEPI:

Përshëndetje, të gjithëve

Siguria dhe pasiguria në jetën e Kosovës në vazhdimësi u ndikua nga shumë faktorë. Unë do të paraqes disa nga pengesat dhe bllokadat që gjeneruan pasiguri dhe jostabilitet gjatë këtyre viteve në vend, si:

1. Vonesa dhe zhagitja disavjeçare në zgjidhjen e statusit përfundimtar, përkundër sakrificës, luftës së drejtë të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi si dhe të drejtës për vetëvendosje.
2. Toleranca dhe fenomenet e veprimit të administratës ndërkombëtare ndaj ndërhyrjeve të Qeverisë së Beogradit, si:
 - manipulimi me serbët e Kosovës, me tentim të bllokimit të punës së institucioneve të Kosovës;
 - provokimet dhe prodhimi i armiqësisë permanente ndaj Kosovës;
 - destabilizimi dhe ndërhyrja përmes strukturave sekrete dhe kriminale;
 - mosgjykimi i kriminelëve të luftës në Serbi, dhe
 - manipulimi i saj me fatin e të zhdukurve të Kosovës,
3. Frika dhe pasiguria për qytetarët, në vazhdimësi vije nga:
 - provokimet me kufijtë dhe sovranitetin territorial të Kosovës;
 - veprimi ilegal disavjeçar i strukturave paralele nëpër enklava serbe;
 - lejimi dhe veprimi i shërbimeve të ndryshme nëpër Kosovë;
 - moszbulimi i vrasjeve dhe ndalimi i krimit të organizuar të pranishëm gjatë këtyre viteve;
 - kontrollimi i dobët i kufijve, dhe
 - masat e dobëta për ndalimin e krimit ekonomik.

4. Perspektiva ekonomike në mungesë të programit special nga bashkësia ndërkombëtare dhe institucioneve vendore për zhvillim dhe rritjes së punësimit pas luftës, dhe shkatërrimeve disa vjeçare të këtij vendi të vogël.

Vlerësimi im është, se stabiliteti dhe siguria e vendit janë në varëshmëri të plotë nga zhvillimet pozitive, puna politike, dhe hapat konkret të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore, si:

1. Ndërtimi i sistemit ligjor dhe përgatitja e vendit me Kushtetutë të Re, vazhdimi i reformave demokratike si dhe reforma e pushtetit lokal bazuar në Kushtetutën e Re;
2. Ngritja e kapaciteteve të qeverisë nacionale dhe ushtrimi i pushtetit sovran në tërë Kosovën. Vendosmëria e institucioneve vendore dhe konsensusi i forcave politike për reformat në zhvillimin ekonomik, sundim të ligjit, garanci të plota për pakicat dhe mardhënie të mira me vendet fqinje;
3. Zhvillimi dhe organizimi më i mirë i forcave të rendit, të drejtësisë, si dhe krijimi i shërbimit informativ nacional, në mbrojtje të interesave dhe pasurisë për të gjithë qytetarët, si dhe demistifikimi dhe zhdukja e të gjitha shërbimeve dhe sistemeve paralele dhe ilegale;
4. Vlerësoj se lëvizja e shpejtë e bashkësisë ndërkombëtare, duke përfshirë SHBA-të dhe anëtarët e BE-s, drejt marrëveshjes për njohjen e pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës, bashkë me garancitë dhe obligimet në vazhdim për institucionet vendore në përmbushjen e standardeve, do të krijonte siguri dhe stabilitet të qëndrueshëm për ardhmërinë e vendit dhe qytetarëve të tij.

(Deputeti Fatmir Rexhepi, d.v. – i nënshkruar)

DEPUTETI FERID AGANI:

I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë

Më vjen keq që duhet të konstatoj se debati i sotëm, për një çështje tejet të mprehtë, është i papërgatitur.

Fillimisht mungoi materiali i punës ku do të paraqitej vlerësimi i gjendjes së sigurisë nga organet kompetente për sigurinë në Kosovë.

Më tutje, mungoi analiza e mirëfilltë e gjendjes, si dhe programi i Qeverisë për zhvillimin e strukturave të domosdoshme të sigurisë me të cilat Kosova sot nuk disponon.

Konsideroj se është momenti i fundit që Qeveria t'i angazhojë të gjitha resurset që i ka në dispozicion, në drejtim të themelimit të ministrive të paralajmëruara - asaj të punëve të

brendshme dhe asaj të drejtësisë, si dhe të sigurojë aktivizimin e tyre në baza të të arriturave bashkëkohore profesionale dhe politike.

Dëshiroj të besoj që , në periudhën e ardhshme , debatet në Kuvendin e Kosovës , do të jenë më mirë të përgatitura.

Në bazë të kësaj që thash , hapësira për diskutim të mëtejshëm substancial është e pamjaftueshme. Ju faleminderit!

(Deputeti Dr. Ferid Agani, d.v. i nënshkruar)

Puna e pjesës së pasdites të seancës me datë 20.07.005 përfundoi në orën 17,40.

Vazhdimi i seancës plenare më datën 21.07.2005

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëseardhje në vazhdim të seancës së rregullt.

Të pranishëm janë 88 deputet në sallë, i lus të tjerët që t'i vendosin kartelat identifikuese në pajisjet e tyre.

Në rend dite është: Shqyrtimi i çështjes së personave të pagjetur.

Në propozim të Grupit parlamentar të Aleancës për ardhmërinë e Kosovës dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Kryesia e Kuvendit ka radhitur në rend dite debatin për çështjen e personave të pagjetur.

Me qëllim të përgatitjes së një debati të frytshëm dhe konstruktiv, Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga Qeveria që para deputetëve ta paraqesin një informatë për aktivitetet e ndërmarra në zbardhjen e fatit të personave të pagjetur. Me që shpeshherë ka informata të pa sakta, kishte edhe në debatin e djeshëm. Unë dua ta përkujtoj seancën plenare dhe opinionin që duhet të theksohet se Kuvendi i Kosovës edhe në mandatin e kaluar ka debatuar lidhur me këtë problematikë dhe se ka miratuar rezolutën për personat e rrëmbyer dhe të pagjetur, pra edhe njëherë po i lus deputetët, le të jetë informata e fundit para çdo debati të paraqiten, Sekretaria ju ka shpërndarë mënyrën e paraqitjes në mënyrë që pas asaj të mos ketë probleme në radhitje ose në mosdhënien e fjalës.

Në emër të Qeverisë e ftoj kryeministrin e Kosovës Bajram Kosumin që ta marrë fjalën. Foltorja është e juaja kryeministër.

KRYEMINISTRI BAJRAM KOSUMI

I nderuari kryetar i Kuvendit, z. Daci, të nderuar deputet, zonja dhe zotërinj.

Më lejoni që së pari të përshëndes nismën dhe gatishmërinë e Kuvendit të Kosovës që edhe njëherë kjo çështje mjaft senzitive, çështja e personave të pagjetur të Kosovës që nga koha e luftës të debatohet përsëri në Kuvendin e Kosovës si pikë e veçantë. Më lejoni fillimisht që të përshëndes familjet e personave të pagjetur që kanë qenë gjatë tërë ditës

dje të pranishëm në sallën e Kuvendit dhe që janë sot prezent këtu dhe përshëndesim ardhjen tyre këtu.

Lufta e fundit në Kosovë përveç pasojave në njerëz dhe dëmeve të tjera që na ka shkaktuar na ka lënë edhe një breng të madhe neve si institucione, familjeve dhe mbarë shoqërisë Kosovare e kjo është çështja e personave të pagjetur dhe e pengjeve të luftës së fundit në Kosovë. Jemi në vitin e 6 pas luftës dhe fatkeqësisht ende nuk dihet fati edhe i 3.000 qytetarëve të Kosovës. Janë bërë përpjekje të shumta që nga paslufta e këtij për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, por rezultatet kanë qenë dekurajuese. Në vitin 2002 Qeveria e Kosovës në kuadër të kornizës së dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit që mbikëqyret nga ana e përfaqësuesit special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe në bazë të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së ka formuar grupin punues qeveritar për personat e pagjetur si dhe Komisionin qeveritar për këtë çështje. Grupi punues qeveritar ka mandatin të angazhohet dhe të funksionoj në pajtueshmëri me aktet relevante të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Synimi kryesor i Grupit punues është që të bëj përpjekje për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur dhe në përputhje me këtë t'i informoj familjet e tyre, gjithashtu t'i adresoj nevojat ligjore dhe administrative të familjeve të personave të pagjetur. Komitetit ndërkombëtar i Kryqit të Kuq kryeson me punën e grupeve punuese për personat e pagjetur sipas mandatit të tij në cilësinë e ndërmjetësit neutral dhe të pavarur. Nga mekanizmat ndërkombëtar që janë të kyçur në këtë çështje aktivisht është edhe zyra për personat e pagjetur dhe **Forenzik** pranë UNMIK-ut. Komisioni Ndërkombëtar për personat e pagjetur, si dhe departamenti i drejtësisë pranë UNMIK-ut. Ndërsa një falënderim të veçantë për Kuvendin e Kosovës dhe angazhimin e tij i cili me 10 prill 2003 ka debatuar për këtë çështje dhe ka miratuar një rezolutë të veçantë.

Me gjithë përpjekjet e shumta që janë bërë si nga faktori vendor ashtu edhe nga ai ndërkombëtar rezultatet mungojnë apo nuk janë të mjaftueshme. Më lejoni të them se kompetencat dhe përgjegjësitë në këtë fushë janë e drejtë e rezervuar e Departamentit të drejtësisë pranë UNMIK-ut. Faktori për ngecjen e këtij procesi dihet, është po ai që edhe shkaktoi këto tragjedi jo vetëm te ne por edhe më gjerë në rajon është Qeveria e Beogradit. Qeveria e Beogradit nuk ka treguar një vullnet të duhur deri më tash për të ndriçuar këto çështje, ose ka treguar aq vullnet sa ta përdorë edhe këtë çështje për hesape të veta politike, por Qeveria e Kosovës mbetet thellësisht e përkushtuar që kjo çështje është thellësisht çështje humanitare e jo çështje politike.

Të nderuar deputet më lejoni që t'ju informoj për rezultatet e deritashme për agjendën e aktiviteteve të Qeverisë dhe Grupit punues qeveritarë si dhe për objektivat e Qeverisë lidhur me këtë çështje. Që nga formimi i grupit punues për bisedime me palën serbe për personat e pagjetur janë mbajtur tri takime pune, kurse takimi i radhës do të mbahet në fund të muajit shtator në Beograd. Gjatë këtyre takimeve janë miratuar rregullat e punës nën udhëheqjen e Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq. Gjatë bisedimeve prioritet ju është dhënë familjarëve, sepse ata duhet të dinë dhe të kenë sa më shumë informata për më të dashurit e tyre, sepse një kohë të gjatë kjo ishte një barrë e vetë familjarëve.

Komisioni ndërkombëtar për personat e pagjetur ka mbledhur 12.403 mostra të gjakut nga të gjithë familjarët e personave të pagjetur në Kosovë që paraqesin 3.815 individ. Përputhja e ADN-së është bërë për 2.902 persona të pagjetur. Duke u bazuar në listën e fundit të Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, ky Komision kërkon edhe 500 mostra shtesë që ne edhe me këtë rast i inkurajojmë familjarët që t'i përgjigjen aksionit të dhënies së gjakut për identifikimin më të shpejtë të familjarëve të tyre. Deri më tash ky Komision ka pranuar 3.297 mostra të eshtrave që përfaqësojnë 2.482 individ të ndryshëm. Nga të dhënat e lartshënuara konstatojmë se janë identifikuar pozitivisht 95% e rasteve me testin pozitiv të ADN-së.

Zyra për persona të pagjetur dhe Forenzik pranë UNMIK-ut deri më tani ka bërë ekshumimin e 11.196 kufomave të plota ose të pjesshme. Janë riatdhesuar eshtrat e 484 personave, ndërsa në Beograd gjenden eshtrat edhe të 391 personave nga të cilët 191 janë identifikuar në testin e ADN-së. Qeveria e Kosovës ka vazhduar angazhimet e veta intensive rreth kësaj çështje. Në të gjitha takimet e mija zyrtare dhe diplomatike kjo çështje ka qenë në agjendën kryesore. Po ashtu edhe Grupi punues qeveritar ka zhvilluar aktivitet intensiv muajve të fundit duke filluar nga kontaktet me zyrat diplomatike në Prishtinë, takime të rregullta me Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, zyrën e UNMIK-ut për personat e pagjetur dhe Forenzik, Departamentin e drejtësisë, Komisionin ndërkombëtar për personat e pagjetur dhe takimi me kryetarin e këtij Komisioni, z. Xhejms Kimzi në Sarajevë. Po ashtu Qeveria ka përshëndetur zbulimin e eshtrave të disa qytetarëve të humbur në periudhën e luftës në fshatrat e Klinës. Zbardhja e fatit të personave të pagjetur mund të arrihet vetëm me një presion të madh dhe në kontinuitet mbi Qeverinë e Beogradit, qoftë nga ne, qoftë nga kryeqytetet Evropiane dhe SHBA-të, po ashtu edhe sot nga foltorja e Kuvendit të Kosovës i bëj thirrje faktorit ndërkombëtar dhe qendrave të vendosjes që të bëjnë çka është e mundur për ndriçimin e fatit të personave të pagjetur në radhë të parë duke shikuar këtë çështje si një akt humanitar për hir të familjeve që ende po i vuajnë pasojat, për hir të ndërtimit të një perspektive më të ndritur në Kosovës dhe me vendet tjera në rajon.

Qeveria e Kosovës do të vazhdoj t'i intensivikoj mundësitë e identifikimit të eshtrave të gjetur dhe në zbulimin e fatit të personave të tjerë për të cilët nuk dihet asgjë. Qeveria e Kosovës nuk ka mundësi tjera veprimi por do t'i shfrytëzoj maksimalisht këto mundësi që i ka. Është me interes që Kuvendi i Kosovës të miratoj edhe një deklaratë në të mirë të trajtimit të çështjes nga të gjithë, pra edhe nga Beogradi zyrtar si çështje humanitare dhe të përshpejtohen punët në ndriçimin e fatit të secilit person të pagjetur në Kosovë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kryeministër ju faleminderit.

Hapim debat për pikën e rendit të ditës. Ftoj përfaqësuesin e Aleancës si propozues i rendit të ditës dhe pastaj LDK-së që ta marrë fjalën.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

Duke shprehur respektin dhe konsideratën e lartë për familjet. Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ju kërkon falje familjeve që qëndruan dje gjatë tërë ditës në sallë në pritje të debatit për çështjen e personave të rrëmbyer dhe të pagjetur.

I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar ministra dhe deputete të nderuar. Riafirmimi i çështjes së personave të pagjetur dhe dhënia e kontributit për zgjidhjen e sajë është qëllimi i Grupit parlamentar të Aleancës në debatin e sotëm. Çështja e personave të pagjetur është komplekse e ndjeshme që kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe afatgjatë gjë që e dëshmoj edhe përvoja e Bosnës dhe Kroacisë. Gjithashtu është çështje humanitare e drejtësisë dhe akt i shkeljes së të drejtave të njeriut, të viktimave dhe të familjeve të tyre.

Në përpjekje për të gjetur drejtësinë dhe kuptuar të vërtetën për më të dashurit e tyre, familjet e personave të pagjetur ndjehen të vetmuar dhe të harruar. Vërtetë nuk mund të ndërtohet paqja e qëndrueshme në mendjen e njerëzve që presin në ankth lajmet për më të dashurit e tyre, për deri sa torturohen në mendjen dhe zemrat e tyre, me ndjenjën e pasigurisë, andaj sot duam të jemi zëri i tyre. Të nderuar deputet kujtimet tona për luftën e vitit 98 dhe 99 janë të dhimbshme dhe të hidhura. Pasojat e saj janë të shumta dhe të dukshme edhe sot, në këtë luftë janë rrëmbyer 3.500 njerëz, fëmijë, gra dhe burra u rrëmbyen në shtëpitë e tyre, në rrugë dhe fati i shumicës nuk dihet as sot. Por dihet se shumë njerëz dhe kufoma u rrëmbyen dhe u dërguan në Serbi. Në varrezat masive në Batajnicë, Petrovo Sello, Bajna Bashta etj. U gjetën më se 900 kufoma të shqiptarëve. Dihet nga mediat serbe se disa kufoma u hodhën në Danub. Andaj edhe pse kaluan 6 vite nga lufta mijëra familje vazhdojnë të ndiejnë dhembje dhe ankth për të afërmit e tyre të pagjetur.

Të nderuar deputet, Marrëveshja e Kumanovës që u nënshkrua në qershor të vitit 1999 nuk përfshiu çështjen e personave të pagjetur dhe të pengjeve të luftës. Tribunali i Hagës luajti rolin më të rëndësishëm për çështjen e personave të pagjetur dhe të paidentifikuar, pas kësaj marrëveshje. Me gjithë atë problemi kryesor me Tribunalin ka qenë se ishte i preokupuar me gjetjen e dëshmive për krimet e luftës, por pa e trajtuar çështjen e personave të pagjetur në tërësi. Andaj kjo çështje ngel barrë e rëndë jo vetëm për familjet, por edhe për shoqërinë kosovare. Në mënyrë që Kosova ta arrijë ripërtrirjen e plotë të dëshiruar të saj, zgjidhja e kësaj çështje është qenësore. Shoqëria kosovare nuk mundet plotësisht të shërohet pa shërimin e kësaj plage të madhe.

Zonja dhe Zotërinj, familjet e personave të pagjetur në përpjekjet e tyre për të ngritur vetëdijen e shoqërisë dhe tërheq vëmendjen e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, formuan shoqatat e tyre. Kanë qenë aktive në mënyra të ndryshme, përmes protestave, grevës së urisë, ngritjes së padive në gjyqet në Prishtinë dhe Prizren, bllokimin e rrugëve në Prishtinë, fushata, organizim të peticionit, paraqitje në media etj. Ka pasur edhe arrestime të anëtarëve të familjeve si ajo në ditën ndërkombëtare të personave të pagjetur më 30 gusht 2004. Nga kjo është e qartë se shoqatat e kanë bartur barrën e problemit.

Pavarësisht angazhimeve siç është ai i Komisionit qeveritar, mekanizmave dhe organizatave tjera si zyra e UNMIK-ut për personat e pagjetur, Këshillit ndërkombëtar për persona të zhdukur që gjithmonë kanë qenë afër familjeve, situata e tyre nuk ka ndryshuar në masën e nevojshme. Nuk duhet angazhuar edhe angazhimet e Qeverisë, kontributin e organizatave ndërkombëtare dhe vendore, por edhe të qeverive si ajo e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zvicrës, Britanisë të cilat kontribuuan në mënyra të dukshme, u jemi mirënjohës dhe ju falënderojmë.

Sot pozita e familjarëve është e vështirë për shkak të shumë arsyeve. Pos nevojës së pakontestueshme që ata të dinë se çfarë ka ndodhur me të afërmit e tyre, ata ndeshen çdo ditë me vështirësitë e shumta, si të natyrës financiare ashtu edhe të asaj psiko-sociale. Masakra në Krushë të Vogël e që sot kryesisht e përbëjnë gratë dhe fëmijët, pasi që mbajtësit e familjes u vranë nga të gjitha rastet e tjera si në Gjakovë, Krushë të Madhe, Therandë, Mitrovicë, Fushë Kosovë e vende tjera personat e pagjetur ishin meshkuj dhe kjo bën që popullata e këtyre anëve të ballafaqohet me vështirësi të jetës, gjendja ekonomike e familjeve është e rëndë.

Familjet e të pagjeturve konsiderojnë se institucionet ndërkombëtare dhe vendore janë pasive dhe nuk angazhohen sa duhet për familjet, njohuritë, rrethanat e vrasjes dhe lokalizimi i varreve janë kryesore. Njohuria për këto i bën ata që më lehtë të ballafaqohen me situatën. Procesi i identifikimit ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë i vështirë për anëtarët e familjeve. Gjatë këtij procesi anëtarët e familjeve ju nënshtruan një mashtrimi nga ana e disa avokatëve dhe njerëzve që morën të holla nga familjarët duke ju premtuar informata për anëtarët e familjeve, por asnjëherë askush nuk i gjet të gjallë.

Kjo ka ndikuar që familjet në fillim të refuzojnë të marrin veprime ligjore nga frika se mos po i lëndojnë të afërmit e tyre për të cilët supozonin se ishin në burgjet sekrete në Serbi. Kjo gjithashtu shtoi ankthin dhe shkaktoi shpenzime të kota financiare. Është e çartë se Serbia ka informata në lidhje me atë se çfarë ka ndodhur me personat e pagjetur duke përfshirë vdekjen e tyre, transportimin, rivarrimin si dhe ekshumimin në tri lokacionet, në Batajnicë dhe Petrovo Sello të cilat kanë qenë terren ushtrimi për policinë dhe ushtrinë e Serbisë. Këto informata i posedon Ministra e Drejtësisë së Serbisë dhe as UNMIK-u dhe as kosovarët nuk kanë qasje në to. Këtë e dëshmon edhe deklarata e ish ministrit të drejtësisë së Serbisë në vitin 2004 se 17 varreza masive me trupa të shqiptarëve të vrarë në periudhën 98 – 99 ekzistojnë në territorin e Serbisë. Ai po ashtu patë deklaruar se Qeveria e Serbisë nuk është e gatshme t'i ndjek penalisht kriminelët, ky është edhe një fakt tjetër që e mbështet argumentin se Serbia i ka informatat, pra ekzistojnë prova të ndryshme për të ushtruar presion dhe fillimin e ndjekjeve penale të personave të tillë.

Krimet në Kosovë janë kryer në mënyrë sistematike dhe në numër të madh, le të kujtojmë masakrën në Krushë të Vogël ku në mars 99 u zhdukën 112 civil shqiptar prej moshës 13 deri në moshën 77 vjeçare, në mesin e tyre edhe pleq e gra. Si pasojë e kësaj fshati sot ka 82 të veja dhe 145 bonjak. Kjo si dhe krimet tjera nuk do të ishin të mundura të organizoheshin nga ushtarë të rëndomtë, por vetëm nga zyrtarë të lartë në hierarkinë e lartë të shtetit. Ata të cilët i kryen krimet nuk janë më në Kosovë, andaj adresa e fajësisë

duhet drejtuar kah Beogradi. UNMIK-u mund të ushtroj presion në Beogradin përmes Këshillit të Sigurimit, gjë që nuk e ka bërë deri më tani. Nga ana e saj Qeveria e Kosovës do t'i rrisë përpjekjet për shfrytëzimin e mekanizmave ndërkombëtar për të avancuar çështjen. Aktualisht Qeveria e Kosovës do të marrë kompetenca të reja dhe do të ballafaqohet me sfida të shumta duke përfshirë edhe statusit përfundimtar të Kosovës. Duke marrë parasysh kapacitetet e limituara Qeveria në mënyrën më të sigurtë do t'u sqaroj familjeve pengesat për zgjidhjen e problemit për shkak të statusit aktual politik të Kosovës, por edhe veprimet që mund t'i marrë kur të ekzistojnë kushtet politike adekuate, një problem që e vështirëson kontributin më të madh të Qeverisë është se kompetencat për drejtësi dhe polici janë në duar të UNMIK-ut.

Të nderuar deputet më 10 prill 2003 Kuvendi i Kosovës miratoi rezolutën me 11 pika. Me gjithë se disa janë plotësuar, kurse disa kanë mbetur pa u plotësuar. Trajtimi i familjeve të personave të pagjetur duhet të jetë i drejtë dhe adekuat, tri janë kërkesat kryesore të familjeve:

1. Kthimin e menjëhershëm dhe pa kushtëzime të të gjitha kufomave nga Serbia në Kosovë me theks nga Batajnica,
2. Hapjen e dosjeve sekrete policore dhe ushtarake të Serbisë ku është e shënuar e vërteta,
3. Kushtëzimin e ndihmave Beogradit nga Bashkësia Ndërkombëtare në plotësimin e dy pikave të para.

Grupi parlamentar i Aleancës i mbështet këto kërkesa të drejta të familjeve. Gjithashtu konsideron se për zgjidhjen e kësaj çështje janë të nevojshme veprimet e menjëhershme dhe ato afatgjata. Janë tri veprime konkrete të menjëhershme që kërkojnë angazhimin e Qeverisë, Kuvendit të Kosovës dhe UNMIK-ut.:

1. Krijimi i zyrës për personat e pagjetur në Kryeministri, ashtu që në çdo komunë të jetë përfaqësuesi në mënyrë që secili qytetar mund të paraqes argumentet dhe faktet për rastet e tyre dhe njëkohësisht të marrin këshilla për veprimin e mëtejshëm. Kjo zyre do të ndihmonte në kryerjen e hetimeve të pavarura dhe duhet të punësoj specialist të kualifikuar dhe ekspert ligjor që janë në gjendje t'i bëjnë hetimet në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe të përgatisin dosjet për paditë kundër Serbisë për dëmshpërblim dhe pranimin e fajit. Me qëllim të realizimit të këtij projekti i propozojmë Qeverisë që të angazhohet për identifikimin e organizatave ndërkombëtare që mund të kontribuojnë në ekspertizën e tyre dhe mbështetje financiare.
2. Institucionet e Kosovës duhet të monitorojnë hetimet dhe i propozojmë Kuvendit të Kosovës krijimin e Komisionit ad-hoc për persona të pagjetur i cili do ta kryej këtë punë. Kuvendi i Kosovës duhet të bëjë legjislacionin që përcakton statusin ligjor të personave të pagjetur dhe të familjeve të tyre. Çështja e trashëgimisë dhe pronësisë e personave të pagjetur gjithashtu duhet të rregullohet me ligj. Ftojme Kuvendin që ta përkrah këtë veprim.

Institucionet e Kosovës duhet të iniciojnë procesin e kërkimit të dëmshpërblimit nga Serbia dhe familjet duhet të përfshihen në këtë proces. Dëmshpërblimi mund të jetë financiar dhe jo financiar. Madhësia e dëmshpërblimit financiar duhet të caktohet nga shuma e përcaktuar nga ekspertët ashtu që fëmijët, gratë ose anëtarët

e tjerë të ngushtë të familjes të personave të pagjetur të marrin pensione nga Qeveria e Serbisë. Dëshmërbliimi jo financiar përfshinë pranimin zyrtar të Qeverisë së Serbisë për dëmet e bëra, të kërkuarit falje për krimet e bëra dhe ndërtimin e memorialëve.

3. UNMIK-u duhet të ushtroj presion direkt mbi Beogradin dhe përmes kontakteve të veta me diplomatët e huaj me që sipas mandatit që ka është përfaqësues i Kosovës jashtë. UNMIK-u duhet të merr veprime konkrete në emër të qytetarëve të Kosovës duke tërhequr vëmendjen e Bashkësisë ndërkombëtare se Serbia si anëtare e organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës i shkel në vazhdimësi dokumentet ndërkombëtare, nënshkruese e të cilave është dhe të cilat do t'i veçoj tri:

1. Deklaratën e përgjithshme të drejtave të njeriut,
2. Konventën për të drejtat e njeriut,
3. Ligjin ndërkombëtar humanitar që është në përbërje të Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 49 dhe protokollit të saj.

Institucionet e Kosovës duhet të përqendrojnë vëmendjen në krijimin e strategjisë afatgjatë e cila përfshinë koordinimin dhe angazhimin e vetë shoqërisë civile, ekspertëve ligjorë, atyre në fushën e historisë, drejtësisë, shkencave politike etj. Zgjidhja e çështjes së personave të pagjetur duhet të jetë prioritet si për institucionet vendore ashtu edhe atyre ndërkombëtare, sepse kjo do të thotë paqe të qëndrueshme për Kosovën. Ne duhet të sigurohemi se s'do të ketë më vuajtje, se s'do të ketë më rrëmbim. Shpresojmë se në fund të këtij debati familjet nuk do të ndihen të vetmuara sepse sot do të dëshmohejmë se jemi me ta dhe për ta. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit

Z. Ragip Zekolli në emër të propozuesit të pikës së rendit të ditës së LDK-së

DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI

Z. kryetar, të nderuar familjarë, të nderuar deputet të Parlamentit të Kosovës. Më lejoni që në emër të Grupit parlamentar të LDK-së të paraqes fjalën lidhur me një çështje tejet të rëndësishme, të ndjeshme, të dhimbshme dhe tejet të rëndë.

Problemi i të pa gjeturve edhe pas gjashtë viteve barra ma e rend, jo vetëm për familjarët, por edhe për shoqërinë Kosovare në përgjithësi . Ekzistojnë pak çështje që politikisht janë më komplekse, teknikisht janë më sfiduese dhe emocionalisht më të vështira, se sa çështja e personave të pa gjetur si pasojë e luftës së armatosur në Kosovë apo krimeve kundër njerëzimit që ndodhën në tokën e djegur.

Për një Kosovë stabile që ka kaluar një shërim të plotë , zgjidhja e këtij problemi është jetik . Nuk mund të ketë një shoqëri të shëndosh Kosovare për deri sa kjo çështje të mbetet plagë e hapur.

Situata e trashëguar pas konfliktit të vitit 1999 nuk u përfshi as në marrëveshjen e Kumanovës. Pas luftës në Kosovë me këtë çështje u mur Tribunali i Hagës për krime lufte por vetëm pjesërisht dhe atë në ndjekjen e krimeve. Puna mbeti e përgjysmuar pa raporte konkrete dhe pa të dhëna për organet relevante në Kosovë. Pas kësaj periudhe në Kosovë në vitin 2000 u formua VRIK-u një asociacion shumë jetëshkurtër, por çështjen para dhe pas luftës e kishte përcjellur Këshilli për Mbrojtjen e të drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë. I vetmi institucion që ishte marrë me këtë çështje së bashku me këshillin ishte edhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar.

Në tetor të vitit 2000 u formua Zyra e Personave të zhdukur dhe të burgosur. Por kjo çështje u institucionalizua në Kosovë në vitin 2002, kur u krijua Zyra për të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore pranë UNMIK-ut. Në këtë kohë nuk po e themi rastësisht por lista e konsoliduar e personave të humbur kishte 5172 veta, ku prej tyre 355 u kthyen të gjallë. Tani numri i personave të humbur në Kosovë është 2780, atëherë deri më tash janë identifikuar dhe zbuluar vetëm 2037. Nuk do të merrem me shifra sepse nuk jam i interesuar që ta trajtojë këtë çështje si problem shifror, mirëpo të nderuar deputet, të nderuar mysafir nëse dëshironi informata më të hollësishme mund të merrni edhe adresën elektronike e cila është www.unmik.org/justice/ompf/index.htm.

Po e them këtë sepse ka qenë e drejtë e rezervuar dhe ne jemi munduar që gjithsesi bashkërisht të jemi bashkëpjesëmarrës në këtë plagë kaq të dhimbshme. Përveç zyrës së UNMIK-ut për mjekësi ligjore me këtë çështje është marrur edhe Komisioni Ndërkombëtar për personat e humbur ICMP i cili në Kosovë është vendosur më vonë. Por, për fat të keqë këto kompetenca, këto vështirësi i janë gjuajtur njëri tjetrit dhe pala kosovare është dashur të bredh për të ardhur deri te informata më e sigurt. Që të jem besnik para jush në çështjen për bisedime me palën serbe jemi detyruar që Kryqin e Kuq Ndërkombëtar ta involvojmë që të ndërmjetëson në mesë të Këtyre dy institucioneve, ne kemi shënime konkrete vetëm e vetëm që kjo çështje të arrijë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën.

Detyrat kryesore me të cilat është ballafaquar zyra e UNMIK-ut është se procesi i hetuesisë është fokusuar në akuzim e jo identifikim. Hetimi i krimeve sistematike merret për të gjithë por duke i injoruar identitetin individual të viktimës, siç kërkon ndërtimi i paqes për një lëvizje psikologjike tej konflikteve të fundit. Zgjidhja e çështjes së të humburve është imperativ për stabilizimin e ambientit të pas luftës. Këtë çështje kaq të ndjeshme dhe humane mbi supet e veta e mbajtën vetë Asociacionet Familjare të cilat në gusht të vitit 2001 u bën së bashku, ato mbajtën mbledhjen e këshillit të parë dhe që tani veprojnë 18 asociacione që merren me këtë çështje. Duhet theksuar se Këshilli Kordinues i Asociacioneve Familjare dhe Pengjeve të të Zhdukurve dhe Familjeve me viktime të luftës në Kosovë dhe Rejeti i aktivistëve KAN që nga 1 nëntori i vitit 2003 e deri me 1 shkurt 2004 grumbulluan 236311 nënshkrime, gjë të cilën deshën ta bëjnë së bashku si shoqëri civile për të nxitur opinionin dhe për të vetëdijësuar ndërgjegjen lidhur me këtë çështje.

Pikërisht tani një vit me 30 gusht 2004 deri sa një pjesë e këtyre asociacioneve po protestonin në qeder të Prishtinës, në ditën Ndërkombëtare të të zhdukurve policia

ndërkombëtare përdori një dhunë të pa pare ndaj protestuesve . Familjarët gjithnjë e më tepër janë duke humbur durimin sidomos nga kthimi i ngadalshëm i kufomave dhe rezultatet pozitive të ADN-së dhe nga vonimi i mostrave të ADN-së që vijnë nga Sarajeva dhe Tuzlla.

Komisioni Qeveritar për Personat e pa Gjetur është formuar në dhjetor te vitit 2002 dhe ishte Komision Ndërministror . Ai ka senzibilizuar opinionin , është takuar me përfaqësuesit e Zyrave Diplomatike në Prishtinë, ka pasur raporte të ngushta me zyrën e UNMIK-ut, Komisionin ndërkombëtar, Asociacionet Familjare, ka siguruar një fond prej 2 milion euro të cilat shpenzohen vetëm për shërbimet e ngushta të varrimit, rivarrimit të familjarëve, bartjes së kufomave, sigurimit të gjërave për varrim.

Me gjithë atë presioni më i madh është ushtruar përmes Bashkësisë Ndërkombëtare në institucionet Serbe të cilat ende mbajnë në varrezat masive në Serbi eshtrat e shqiptarëve me analizë pozitive të ADN-së. Asnjëherë nuk është biseduar për këtë çështje si çështje e shtruar e dialogut, sepse është kërkuar të jetë kthim i pakusht.

Komisioni Parlamentar për të pagjeturit dhe pengjet e luftës , në mandatin e kaluar merrej me faktet, informatat lidhur me të pa gjeturit dhe i jep Parlamentit rekomandime për aksionet e nevojshme Parlamentit. Ky parlament me 10 prill 2003, ky Kuvend e ka miratuar rezolutën e cila i obligon institucionet e përkohshme vetëqeverisëse që të ngritin çështjen e të pagjeturve me çdo palë me ndërkombëtarët. Kërkon që Bashkësia Ndërkombëtare ta ndriçoj fatin e personave të pa gjetur duke potencuar që ç'do lloj bisedimesh të kushtëzohen me këtë çështje. tje . Gjithashtu kërkon formimin e një Arkivi të veçantë për të zhdukurit dhe të rrëmbyerit në Kosovë . Gjithashtu rezoluta kërkon që statusi I personave të zhdukur dhe të rrëmbyer në Kosovë të përcaktohet me ligj .

Duke pare mungesën e rezultateve konkrete në këtë fushë dhe parashtrimin e Standardeve për Kosovën është filluar edhe Dialogu për bisedime me palën serbe për personat e pa gjetur dhe kjo çështje është vër si prioritet i Qeverisë. Këtë çështje z. Petersen e ka paraqitur edhe në Këshillin e Sigurimit të Kombeve te Bashkuara si çështje të veçantë. Për këtë qellim qeveritë kanë formuar grupet punuese te cilat deri me tani janë takuar tri here. Janë formuar grupet punuese te cilat janë takuar përmes ndërmjetësuesit ndërkombëtar dhe janë dakorduar për rregullat e punës, gjithashtu është miratuar lista e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar që të jetë valide dhe tani punohet në çështje konkrete.

Suksesi për këtë duhet kërkuar edhe në këtë sallë ku sot ne po bisedojmë dhe vërtet duhet trajtuar si çështje prioritare . Ne jemi të gatshëm të themi se pala Kosovare është e gatshme të shtroj jo vetëm listën, porë edhe çështjen e burgjet sekrete dhe çështjen jetike që familjarët tanë asnjëherë nuk ishin as në Batajnicë e as në Bajna Bashte e as në vendet tjera për të parë vendin ku ndodhen më të dashurit e tyre.

Duke parë situatën në të cilën ndodhemi Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës rekomandon:

1. Hartimi i strategjisë së përbashkët ku do t'i përfshinte te gjithë akterët qe mund të merren me këtë çështje: Presidencën Qeveria Parlamenti dhe Shoqëria civile ne përgjithësi.

2. Presioni me i madh i te gjithë këtyre faktorëve përmes Bashkësisë Ndërkombëtare mbi Qeverinë e Beogradit për përfundimin e këtij procesi, sepse ai është faktori.

3. Është ne interesin e Kosovës që Kompetenca e Rezervuar për këtë çështje kaq të rëndësishme dhe të dhimbshme të kalojë në duar të vendorëve.

4. Të ndihmohet Zyra e UMPF-se që të sillen ekspert ndërkombëtar si patolog, mjek ligjor dhe ekspert tjerë dhe kësaj çështje kaq të dhimbshme ti arrihet fundi.

Me kënaqësi mund t'ju them se zyra e SHBA-ve për të shpejtuar këtë proces ka ofruar 300.000 euro dy javët e fundit.

4. Sa më shpejt të ndërtohet Institute i Mjekësisë Ligjore në përbërje të Ministrisë së ardhshme të Drejtësisë.

5. Të gjitha të dhënat të grumbullohen për prezantimin e fakteve për dialog me Beogradin të grumbullohen në një qendër.

6. Domosdoshmëria e Qeverisë dhe këtij Parlamenti është përkrahja për ngritjen e padive penale dhe akteve të krimit që ka ndodhur në Kosovë.

7. Hartimi i ligjit për personat e pa gjetur në baze të përvojave të shteteve në rajon që ne mund t'ju ofrojmë modelin e Bosnës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Më lejoni që të bëj një përjashtim të vogël. Unë do të doja që kësaj radhe t'i japim rastin kryetares së Komisionit Qeveritar për persona të pagjetur që ka shprehur gatishmërinë dhe dëshirën që t'i drejtohet Kuvendit, prandaj e ftoj znj. Nusrete Kumnovën që ta merr fjalën.

KRYETARJA E KOMISIONIT PËR TË PAGJETURIT NUSRETE KUMNOVA

I nderuari z. Kryetar, i nderuari z. Kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar deputet, shumë të nderuar familjarë të personave që ju mungojnë.

Me shumë shqetësim të madh familjarët i dëgjojnë termet për më të dashurit tanë: i zhdukur, i humbur, i pagjetur, kurse e vërteta është pengjet e luftës. Ne po i japim shansin Serbisë që të na i humbin gjurmët e më të dashurve tanë. Nisur nga fakti se populli i Kosovës edhe pas 6 viteve është akoma në ankthin e pritjes për zbardhjen e fatit të më të dashurve tanë. Ne si familjar dhe nëna të stresuara të Kosovës, pas përfundimit të luftës organizuam protesta gjithë popullore në rrugë. Bëmë greva urie, mbajtëm konferenca me moton e vërteta dhe paçja, ku kanë qenë të ftuara personalitete më të larta botërore dhe ndërkombëtare. Vazhdimisht kërkuam që të bëhet presion tek Qeveria e Serbisë që t'i hap dosjet dhe arkivat ku aty janë shënimet për çdo person veç e veç, me të cilat shënime posedojnë edhe familjarët ku kemi emra dhe mbiemra, kush na i rrëmbeu më të dashurit tanë. Argumentet ja ku janë:

Argumentet tona i kemi dhënë Parlamentit, Qeverisë, UNMIK-ut dhe të gjitha janë futur nën tavolinë. Organizuar peticionin me moton të gjithëve na mungojnë ku u mbledhën mbi 236.000 nënshkrime. Ky peticion u organizua në bashkëpunim me KAF-in dhe rrjetin për aksion KAN. Peticioni ju dorëzua institucioneve vendore Parlamentit dhe Qeverisë, organizatave më të larta botërore z. Kofi Anan, Këshillit të Sigurimit z. Kolin Pauell, SHBA-ve, Parlamentit Evropian, znj. Doris Pak. Bëmë spote të ndryshme, vendosëm fotografitë e më të dashurve tanë në rrethojat e Kuvendit ku mund t'i shohim të gjithë qytetarët dhe vizitorët e personaliteteve më të rëndësishme të botës, me qëllim të senzibilizimit të opinionit vendor dhe atij ndërkombëtar, se kjo çështje madhore duhet të zgjidhet pa tjetër, pra nuk mund të kalohet në tjetrën pa u zgjidhur e kaluara. Një shembull konkret për sjelljet e policëve ndërkombëtar që ndodhi më 30 gusht 2004, dita ndërkombëtare e të zhdukurve ku shënohet në tërë botën, atë ditë policia ndërkombëtare i arrestoi 36 familjar dhe u mbajtën më tepër se 5 orë të arrestuar, në paraburgim vetëm e vetëm pse i kërkuaam bijtë dhe bijat tona. Pyesim: Ku qëndron këtu drejtësia ndaj popullit shqiptar Me gjithë presionin e bërë edhe pas 6 viteve deri më sot u kthyen vetëm 480 kufoma të shqiptarëve të vrarë dhe të identifikuar që në vitin 2001, kurse mbi 380 kufoma gjenden ende nëpër varrezat e Batajnicës dhe Bajna Bashtes në Beograd të identifikuar, ku kthimi i kufomave bëhet simbolikisht në numra prej 30 – 40 kufoma?

Si rezultat i kthimit të këtyre kufomave është vetëm atëherë kur na vizitojnë personalitete të ndryshme ndërkombëtare, kur për fat të keqë ne kërkujmë dhe presim akoma 2780 njerëz që padrejtësisht mbahen në varrezat masive të Serbisë dhe Kosovës, ku sot e kësaj dite janë të pazbuluara, ku askush për fatin e tyre nuk jep llogari.

Dialogu në mes Prishtinës dhe Beogradit ka filluar, ku ne nuk presim rezultate të këtij dialogu, sepse në Beograd nuk ka vullnet politik, as gadishmëri njerëzore që të zbardhet fati i pengjeve të luftës dhe që të kthehen të gjitha kufomat përnjëherë. Fati i më të dashurve tanë do të zgjidhet vetëm me presionin dhe drejtësinë ndërkombëtare e jo me bisedime që mund të zgjasin edhe me vite të tëra e ne nuk do ta kuptojmë fatin e tyre. Ne mendojmë se në burgjet ushtarake të Serbisë ka të gjallë, mirëpo deri më sot askush nuk i ka zbuluar apo nuk dëshirojnë t'i zbulojnë këto vende. Ne si familjar kërkujmë që të dilet me fakte konkrete dhe zyrtar për gjetjen e atyre që na mungojnë dhe të lihet pazarllëqet bizneset me më të dashurit tanë.

Pyesim edhe ne për rezolutën që është zbatuar dhe miratuar më datën 10.04.2003 në Kuvendin e Kosovës, ku kjo rezolutë është përpiluar me Komisionin Parlamentar dhe KAF-in. Jemi shumë të shqetësuar për neglizhencën e vendorëve dhe kryekëput të UNMIK-ut për zbardhjen e fatit të më të dashurve tanë të cilëve më prioritet u jepet kthimit të të zhvendosurve ku krijon tensione te familjarët e të pagjeturve, ku edhe ashtu gjendja psikike e familjarëve është tejte e rënd. Kërkujmë që bisedimet për çdo çështje me Serbinë dhe kudo që të zhvillohen të kushtëzohen me ndriçimin e fatit të të rrëmbyerve. Ne si Komision qeveritar kërkujmë nga kryeministri që ky Komision të shndërrohet në zyrë e cila do të veprojë në kuadër të Qeverisë së Kosovës. Me krijimin e kësaj zyreje kërkujmë që të kemi arkivin e posaçëm për të rrëmbyerit dhe të zhdukurit në Kosovë.

Krijimi i një trupi ekspertësh për ngritjen e kallximeve penale për krime dhe gjenocidin e kryer mbi popullin dhe akuzimin e shtetit të Serbisë, në këtë zyrë duhet të ketë jurist, ekspert të mjekësisë ligjore **antropolog** dhe njohësit e të drejtave të njeriut. Kërkojmë që të përcaktohet me ligj statusi i personave të rrëmbyer dhe të zhdukur gjatë luftës në Kosovë dhe të drejtat e familjeve të tyre. Për të pasur paqen duhet të dihet e vërteta për pengjet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Znj. Nusrete ju faleminderit.

Në emër të Grupit parlamentar 6+ Xhezair Murati, kurse le të përgaditet Veton Surroi në emër të Orës.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI

Poštovani predsedniče, g. Premieru, ministri, kolege i gosti. Ovo je bolna tema, tema koja treba da da novo svetlo na svu tragediju svih nestalih. Mislim da Kosovsko društvo ulazi u onu fazu zrelosti kada ne priznaje tabu teme, makar i one najbolnije kako je doživelo Kosovo a kako je doživela nedavno, nakon obelažavanja komomeracije, i Srebrenica gde smo mogli pred čitavim svetom da vidimo sličnu sudbinu još jednog Balkanskog naroda odnosno Bošnjackog a i evo ovde albanskog. Što znači kada nas pri dolasku u Skupštinu Kosova slike nestalih podsećaju na svu tragediju porodica, ovo je prilika da izrazimo jedno saosećanje sa bolnom i na žalost tragičnom istinom kako se ovde pominje 4.000 ljudi čija se sudbina ne zna. Ja ću danas reći da iz zajednice koje pripadam, dakle iz bošnjačke zajednice, na ove podatke od 33 nestalih ali ovoga puta nakon rata na Kosovu mislim da treba svi da shvatimo da bol građana Kosova se ne završava sa oslobođenjem Kosova od jedne okupatorske vojske, od paramilitaraca, nego smo imali jedno posleratno stanje koje je trajalo još nekoliko meseci nakon oslobođenja Kosova gde je 33 građana bošnjačke zajednice nestalo bez traga. Prvih godina nakon oslobođenja dok nisu uspostavljene Kosovske institucije, normalno oni najbliži tražili su tragove od predstavnika međunarodne zajednice i KFOR-a koji je bio prisutan ovde u mnogo većem broju nego danas. Nakon upostavljanja Kosovskih institucija krajem 2001 god, i sve do danas mi nemožemo a da na neki način ne osećamo i sami ako ništa drugo odgovornost jer smo možda mogli više da učinimo uvažavajući sve poteškoće sa kojima smo svi građani Kosova suočeni kada je u pitanju ova tema.

Imena žrtava znamo svi nažalost, ime počinitelaca ne znamo, ja danas ovde apelujem da zajedno svi učinimo sve, mi vratiti nestale nećemo ali ćemo porodicama i njihovim najbližima pomoći da bar znaju tragove gde da se obrate onom svom najbližem. Kada su žrtve u pitanju identitet je savršeno nevažan, ali svakako kada su u pitanju manjinske zajednice ima nekog specifikuma, međutim mi kao grupa pridružujemo se da nastavte sa intezivnim aktivnostima kako bi smo došli vremenom, nažalost kako brzo prolazi a

najbolje znaju oni koji pate za nestalima, koliko je to vreme dugo, da preduzmemo sve mere da bi smo došli do imena počinilaca, kako bi smo kao institucija preduzeli sve mere da olakšamo bol i što ćemo ljude koje pripadaju tim porodicama na neki način zbrinuti, starati se o njihovoj deci, starati o njihovim najbližim itd. Dakle mi se pridružujemo ovoj raspravi kako bi smo ovu bolnu temu kao društvo na jedan human, rezonantan i transparentan način, ublažili bol i pronašli počinioce i preko međunarodnih organizacija da preduzmemo sve ono što sledi za počinioce. Ja se pridružujem kolegama u ovoj aktivnosti. Zahvaljujem.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Le të paraqitet Veton Surroi, kurse le të përgaditet Flora Brovina, paraqitja e të cilës me shumë vonesë ka arritur në emër të PDK-së. Unë i kam shikuar të gjitha listat e të gjithë përfaqësuesve të PDK-së ku janë paraqitur si deputet, prandaj nuk është ndonjë lëshim te kryetari apo në Kryesi.

DEPUTETI VETON SURROI

Zonja dhe zotërinj, fotografia e Rexhep Ramadanit ka qenë deri vonë në kangjellat e Kuvendit të Kosovës. Prej dy muajsh fotografia e tij nuk gjendet më në këtë rrethoj prej nga hyjmë. Rexhep Ramadani në natën e 24 dhe 25 marsit të vitit 1999 është zënë nga forcat ushtarake dhe policore në zyrat e "Kohës" në Prishtinë. Më datën 25, për herë të fundit është parë një shenjë gjaku nga zyra e Kohës dhe trupë i ti në një kontejner të bërlllokut në qytetin e Prishtinës. Është dashur 6 vite që para dy muajsh ta varrosim mikun tonë Rexhep Ramadanin në varrezat e Prishtinës. Në terminologjinë tonë në këtë scancë të Kuvendit, Rexhep Ramadani figuron ose figuronte si i pagjetur. Ai më 24 mars nuk doli me shetit e të humbet që të mos gjendet më, por më 24 mars u arrestua u zu nga forcat ushtarake dhe policore serbe, u ekzekutua, u hodh në kontejner bërlloku dhe më pastaj u hodh në një varrezë masive. Ka ekzistuar një makineri shtetërore, e cila e ka bërë Rexhep Ramadanin të figuronte në atë që ne e quajmë të pagjeturit. As ai, e asnjëri prej këtyre qytetarëve të Kosovës, të cilët i quajmë të pagjetur nuk kishin dalë që të shëtisnin e të kumbisnin dikund e të mos gjinden, por ishin të arrestuar brenda një konteksti ushtarak dhe me një mbështetje shtetërore dhe si të tillë mund të figurojnë vetëm si pengje lufte e jo të humbur, jo të zhvendosur, jo të pagjetur.

Këtu ekziston dallimi i terminologjisë, por edhe dallimi i besimit dhe dallimi i trajtimit të kësaj teme. Kryeministri na tha se kjo është çështje humanitare, është çështje humanitare, por jo vetëm humanitare, kjo është çështje kryekëput politike. Për deri sa mbetet si çështje humanitare, ajo do të trajtohet si çështje humanitare dhe kjo do të thotë se do të mbetet në fund të listave të prioriteteve të cilësdo qeveri, të cilësdo udhëheqje politike dhe për 6 vite familjarëve u është thënë se nga njëra anë do t'i kushtohet vëmendje çështjes së të zhdukurve, gjegjësisht të pengjeve të luftës, do të formohen komisione, por në fakt kjo çështje ka mbetë poshtë në rendin e ditës së trajtimit politik. Kjo është një çështje kryekëput politike dhe është në fakt pjesë e cila do të determinon statusin politik

të Kosovës. Kosova ka qenë në një luftë të pashpallur me Serbinë, por duhet ta nënshkruaj një paqe me Serbinë dhe Kosova nuk mund të nënshkruaj paqe me Serbinë me pengje të luftës dhe kjo është çështja fundamentale, të cilën duhet ta thotë ky Kuvend dhe nëse ky Kuvend merret vesh se ky do të jetë pozicioni i Kosovës, atëherë të gjitha veprimet e tjera, që kanë të bëjnë me pengjet, duhet të varen nga ky Vendim.

Në Serbi është marrë një vendim politik lidhur me të pagjeturit. Kam biseduar me kryetarin e Kuvendit të Vojvodinës Nenad Čanak dhe ai më ka thënë personalisht se vendimi është marrë në mbledhjen e DOS-it. Ai vendim është që të mos kthehen kufomat e pengjeve të luftës së Kosovës në tërësi, sepse kjo do të krijonte një pasqyrë negative ndërkombëtare për Serbinë. Ky është vendim politik dhe ekziston dëshmia për te. Veprimi me të cilin po silltet Qeveria edhe sot në këtë mbledhje, e më falni kolegë deputetë edhe të koalicionit qeverisës, është një veprim i cili po na bien në pozitë të keqe të gjithë neve këtu në Kuvend. Kryeministri na thotë se kjo është çështje humanitare, ju dilni me lista sugjerimesh se çka duhet bërë, bini ndesh me kryeministrin tuaj, nuk dakordoheni se cili do të jetë pozicioni e ndërkaq ky është një pozicion i cili kërkon konensus jo vetëm tuajin, të koalicionit tuaj qeverisës, por të këtij Kuvendi. Familjarët e pengjeve të luftës kërkojnë që të jemi unik, unifikoni ju së pari qëndrimet tuaja e pastaj do mblidhemi edhe ne të tjerët. Nuk mund të silleni ndaj Qeverisë suaj sikur të ishit anëtar të opozitës, atë vend e kemi të rezervuar ne.

Do të përkrahim çdo veprim, por jo veprime të cilat do të krijojnë komisione të reja. Çështja e pengjeve të luftës nuk zgjidhet nëse krijohet edhe një komision plotësues për këta pengje. Çështja e pengjeve të luftës është çështje për ne madhore, për këtë kryeministri duhet të autorizohet nga ky Kuvend që të ndërmarrë hapa dhe të kërkojë që çështja e pengjeve të luftës të vihet si pikë e parë e rendit të ditës në dialogun e ardhshëm politik me Beogradin. Kryetari i Kosovës duhet të autorizohet që të shkruajë një letër, ku i kërkohet që në një takim, në cilindo vend të tretë, që me z. Tadiq të bisedojë për pengjet e luftës. Ne duhet të kërkojmë dhe këtu është dallimi në mes qasjes të cilën po e propozoj dhe të cilën po e propozoni ju, ju na thoni se nuk keni kompetenca, ju na thoni se nuk varet prej jush, ju na thoni se Bashkësia Ndërkombëtare duhet t'i kryejë këto veprime, kërkon zotri Ju takim, kërkon dhe keni të drejtë, e keni obligim ndaj pengjeve të luftës të shkoni e të bisedoni, të kërkon publikisht që trupat e pengjeve të luftës të gjallë apo të vdekur të kthehen në Kosovë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Flora Brovina dhe me këtë përfundon niveli i grupeve parlamentare, urdhëroni.

DEPUTETJA FLORA BROVINA

I nderuar kryetar, i nderuar kryeministër, ministra, kolegë dhe kolege, të nderuar familjarë që ndodheni këtu dhe të nderuar mysafirë.

Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës kërkoj falje për organizimin e kësaj teme sepse mendoj se nuk është në nivelin që duhej të ishte. Mendoj se kjo pikë e rendit të ditës së pari është thirrur shumë për ngut, nuk kemi pasur ndonjë material bazë dhe me propozim të Lidhjes Demokratike dhe Aleancës të cilët nuk e kanë par të arsyeshme që deputetëve paraprkishtë t'u dorëzoj një material ose propozim. Në çdo rast tjetër kryetari i Parlamentit do të thoshte mos të mblidhemi si në Hajt Park sikur ka thënë herëve tjera kur Komisioni i mëparshëm për persona të pagjetur ka kërkuar që të debatohet në nivel të tillë, çfarë po debatohet tani edhe me material bazë. Për këtë arsye them se kjo mbledhje nuk është përgatitur si duhet.

Kjo pikë shumë e rëndësishme për Kosovën siç e tha edhe kolegu Veton Surroi, një ndër pikat më të rëndësishme edhe për bisedimet me Beogradin, po ashtu edhe për statusin e Kosovës u vu në rend dite dhe familjarët priten tërë ditën që sot ditën e dytë të debatohet për rendin e parë. Kujt i drejtohem sot, i drejtohem Qeverisë, UNMIK-ut, Serbisë apo dikujt tjetër. Realisht jam e mendimit se tema që po e shqyrtojmë ja vlen të flitet për çdo ditë dhe për çdo javë, të flasim për mangësitë institucionale vendore dhe ndërkombëtare për mosefikasitetin për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, mirëpo fjalët nuk mjaftojnë, me gjithë se mund të merremi veç e veç me secilin institucion, barra ma e madhe i takon ekzekutivit, pra Qeverisë. Kuvendi në mandatin e parë ju qas kësaj problematike si më të fundit të saj duke formuar komisione për personat e pagjetur një vit pasi që u themelua dhe tërë barrën e barti vetëm ky Komision. Me gjithë atë arriti që Kuvendit t'i propozoj dhe Kuvendi t'i aprovoj disa dokumente të cilat e obligojnë ekzekutivin. Më 10.04.2003 aprovoi rezolutën për personat e pagjetur, më 10.12.2003 aprovoi konkluzionet në bazë të analizës që Komisioni bëri, sa po aplikohet kjo rezolutë e nxjerrë nga Parlamenti dhe pastaj më 9.06.2004 aprovoi informatën e Komisionit e cila informatë pati edhe përkrahjen e petitionit të familjarëve dhe të KAN-it si dhe dha propozime pas një debati të gjerë në Parlament.

Sikur të ishin zbatuar të gjitha këto që u than sot sigurisht do të kishim një rezultat më ndryshe. Komisioni për persona të pagjetur qeveritar nuk është ajo që ka kërkuar Komisioni për personat e pagjetur, ne realisht kemi kërkuar zyrë ekspertësh pranë Qeverisë. Institucionet tona nuk e ngrisin sa duhet zërin dhe si duhet për personat e pagjetur në bisedime me ndërkombëtarët. Mungon presioni ndërkombëtar dhe shumë çështje tjera dhe janë para problemit më të ndjeshëm që flet për gjenocidin e kryer në Kosovë, flet për rrëmbimin e njerëzve të pafajshëm. Bisedimet e për personat e pagjetur me Beogradin u shtrua në nivel shumë të ultë me nivelin e bisedimeve teknike edhe pse flitet për krimin e shumfishtë.

Ndërmjetësimi i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar është i pamjaftueshëm, nuk pajtohem me kryeministrin se kjo është vetëm çështje humanitare. Humanizmi pushon në momentin e gjetjes së kufomës ose personit që kërkohet, një e tillë mund të jem edhe unë, unë i kam shumë borxh Kryqit të Kuq Ndërkombëtar për gjetjen time, të mos më gjente sigurisht se do të më kërkonte në mesin e kufomave në Beograd. Me gjithë atë kujtoj se roli i ndërmjetësuesit të Kryqit të Kuq nuk mjafton. Grupi për bisedime më duket më shumë e patë një rol që të fotografohet dhe të luaj një rol inferior sepse hyni në bisedime nga

ana jonë pa u përgatitur, nuk pati transparencë të mjaftueshme se çka po ndodh në këto bisedime me një fjalë u prezantua në mënyrë jo profesionale dhe madje për këtë detyrë as që ishte i vetëdijshëm, nuk ishte i vetëdijshëm as për mosdijen e vetë. Ata shkelën edhe dokumentet që u aprovuan në këtë Parlament e në rend të parë edhe Rezolutën. Kufomat që po vijnë nga Beogradi vijnë me të njëjtin tempe me të njëjtin numër si edhe para hyrjes në bisedime nga 10 – 20 – 30 ose pak më shumë dhe vetëm kur shkon në favor politik të Beogradit, pra nuk ka rezultate ndryshe ose të reja nga ato që ishin para bisedimeve. A është e vetëdijshme të paktën Qeveria për atë se çka ndodhi, si u morën këta njerëz dhe çka ndodhi në masakrën më të madhe, në varrezën më të madhe të shqiptarëve në Batajnicë, po ta dinte dhe unë po ia përkujtoj se atje njerëzit u hodhën në lum, u dogjën, pati disa furra për djegien e skeleteve, 39 veta u sollën të gjallë emrat e tyre dihen, për çdo rast materialin e posedoj duhet ta ketë Qeveria dhe unë pas këtij fjalimi do t'ia dorëzoj kopjen. Pse nuk kërkohet nga ana e Qeverisë që të vizitohen këto kufoma të burgosura që ende ndodhen në Beograd, pse nuk u ngrit asnjë aktpadi kundër Serbisë, qe katër vite pas ekshumimit të këtyre kufomave në Batajnicë të cilat ende ndodhen nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë së Serbisë, ku janë të tjerët që i kërkojnë, pse nuk bëhet presion i mjaftueshëm ndërkombëtar, por aq lehtë hyhet në bisedime me krerët politik ose pranohet të hyhet në bisedime me krerët politik që edhe sot nuk e pranojnë krimin e besa edhe janë bashkëpjesëmarrës për krimin për derisa kanë informacione për personat e pagjetur ose të rrëmbyer, pengjet e luftës nuk e zbardhin këtë të vërtetë.

Deri më sot është bërë pak edhe për mbrojtjen institucionale për mbrojtjen e familjeve që kanë të pagjetur dhe nuk është zgjidhur statusi i tyre juridik, nuk ka një ligj për mbrojtjen institucionale të familjeve të pagjeturve. Me iniciativën e ish kryetares së personave të pagjetur dhe në përkrahje të grupit parlamentar, Kryqit të Kuq dhe familjarëve tani më është përgatitur një version i projektligjit për familjet e personave të pagjetur e cila kërkoj që të përkrahet edhe në Parlament. Ne kërkojmë që të riorganizohet zyra qeveritare e personave të pagjetur, në kuadër të kësaj zyreje të hapen arkiva dhe dosje për secilin person të pagjetur, të nis procedura rreth ndërtimit të një memoriali përkujtimor për personat e pagjetur. Ç'do 6 muaj Qeveria t'i jap raport këtij Kuvendi përgatitjen për zhvillimin e bisedimeve dhe të kushtëzohen këto bisedime me kthimin e personave që tani më janë ekshumuar qysh para 4 viteve dhe të zbardhet fati i atyre për të cilët nuk dijmë.

Qeveria të kërkoj më shumë transparencë dhe më shumë kompetenca nga ndërkombëtarët për këtë çështje pasi që dihet se të gjitha kompetencat ajo ende nuk i ka. Qeveria të bëjë më shumë tryzni për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, po ashtu edhe të ndërkombëtarët të kërkoj që të bëhet kjo mbi Beogradin për zbardhjen e personave të pagjetur gjatë luftës së fundit në Kosovë dhe të ngritet niveli i bisedimeve, bisedimet të kushtëzohen me rezultate konkrete. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kalojmë në nivel të deputetëve, Sasha Gjokiq, kurse le të përgatitet Kolë Berisha

POSLANIK SAŠA ĐOKIĆ

Poštovani presedniče, poštovani premijere, ministri, poštovane kolege poslanici i poštovani gosti.

S obzirom da smatramo da je ovo jedno od najvažnijih pitanja nestalih, želim da istaknem stav SDS naše političke partije. Želimo da damo maksimalan doprinos u pronalaženju nestalih, kidnapovanih, ubijenih i otetih, ali ne možemo nikako da prihvatimo da se govori samo o jednoj strani nestalih lica, jer u predhodnom ratu, naročito posle rata, bilo je brutalnih ubistava i otimanja Srba, Albanaca, Roma i ostalih. Takođe postoje masovne grobnice i na Kosovu i Metohiji. Međutim ovde se celo vreme u Skupštini govori, koliko sam ja mogao da shvatim, samo da su Albanci stradali u toku rata. To po mom mišljenju apsolutno nije tačno, jer da bi rata bilo mora da postoje najmanje dve strane u sukobu. Ako želimo da se ovo pitanje rešava, moramo da pogledamo istini u oči i da pitanje nestalih i kidnapovanih prestati da iskorišćavamo u političke svrhe. U cilju doprinosa naše političke partije SDS Kosovo i Metohije predlažemo da se formira jedna Skupštinska Komisija, koja bi radila samo na pronalaženju nestalih, ali podvlačim svih nestalih u predhodnom periodu. U suprotnom mislim da će ovo pitanje i dalje biti na dnevnom redu i biće veliki balans u našem daljem radu.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Sanije Alijaj, kurse le të përgatitet Bajram Rexhepi

DEPUTETJA SANIJE ALIJAJ:

I nderuar z. Kryetar, i nderuar z. Kryeministër, ministra, shumë të respektuar familjarë dhe të nderuar deputetë.

Fotografitë e të pa gjeturve në rrethojat e Kuvendit janë një pasqyrë e realitetit të hidhur dhe të dhembshëm në Kosovë për të cilën sot po debatojmë. Problemi i personave të rrëmbyer dhe të pagjetur mbetet një ndër çështjet më të rënda të pazgjidhura për të drejtat e njeriut në Kosovë edhe pse kaluan 6 vite të prezencës ndërkombëtare në Kosovë, fati i personave të pagjetur mbetet ende i pazbardhur. Vuajtjet e familjeve të prekura për mos gjetjen e më të dashurve të tyre paraqet pengesë për pajtimin e komuniteteve si dhe në masë të madhe ndikon në besimin ndaj administratës ndërkombëtare dhe institucioneve vendore. Deri më tani qasja e personave të rrëmbyer dhe të pagjetur nuk ka qenë në

nivelin e duhur. Veprimtaria e zyrës së UNMIK-ut për të zhdukurit, puna e Komisionit Qeveritar dhe komisionit parlamentar, nxjerrja e rezolutës në Parlamentin e Kosovës, formimi i grupit punues për bisedime për të pagjeturit, është një zhvillim pozitiv, por edhe për kundër kësaj procesi i ngadalshëm i zbardhjes së fatit të personave të pagjetur është i pakuptimtë.

Ne jemi të vetëdijshëm se për të ardhur deri te rezultatet konkrete duhet ngritur problemin shumë seriozisht në institucionet ndërkombëtare të vendosjes në mënyrë që ndriçimi i fatit të të pa gjeturve të kushtëzohet te Qeveria e Serbisë me zhvillimet ekonomike dhe integrimet ndërkombëtare të Serbisë, prandaj duhet kërkuar nga Kombet e Bashkuara, shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, SHBA-të që të kontribuojnë duke bërë trysni te Qeveria e Serbisë në kontinuitet që të përshpejtohet ky proces, sepse kjo Qeveri ngadalsimin e zbardhjes së fatit të personave të pagjetur e bën për interesa politike. Kjo çështje shumë e rëndësishme për institucionet e Kosovës është një standard që duhet ta plotësoj shteti i Serbisë dhe ata që e krijuan.

Mendoj se kompetent për ndërkombëtarizimin e fatit të personave të rrëmbyer dhe të pagjetur gjatë luftës në Kosovë është zyra e UNMIK-ut për personat e zhdukur e cila duhet të jetë transparente dhe të bashkëpunojë me institucionet vendore për të gjitha çështjet, të përshpejtoj procesin e bisedimeve teknike për këtë çështje, humanitare dhe politike sepse për ndryshe me asgjë nuk mund të arsyejtohet kur në Kosovë kthehen në ç'do 2-3 muaj nga 30 deri në 50 kufoma të identifikuar që familjarët i shkatërron fizikisht dhe shpirtërisht në ankthin e pritjes, ata kanë të drejtë të mos përjetojnë Mërdaren në vazhdimësi si vendin e tmerrit. Si hap konkret dhe shumë i domosdoshëm është që Qeveria të shndërroj Komisionin qeveritar në zyrën për persona të pagjetur e cila ekzekuton vendimet që i merr Kuvendi i Kosovës. Kjo zyrë së bashku me z. Petersen ta detyrojë Qeverinë e Serbisë që të jetë transparente, ku janë njerëzit e zënë peng, ku janë kufomat e vjedhura, ku janë varrezat masive në Serbi, ku janë varrezat masive në Kosovë, të detyrohet t'i hap dosjet dhe arkivat për çdo person, që bisedimet teknike me Serbinë kurdo që të zhvillohen të kushtëzohen me zbardhjen e fatit të personave të rrëmbyer dhe të pagjetur, të bëhet trysni tek ata që merren me procesin e identifikimit në mënyrë që të përshpejtohet ky proces, vetëm në këtë mënyrë i kontribuohet paqes dhe stabilitetit në rajon.

Zyra për të pagjetur të përpiloj listën e të pagjeturve që nga fillimi i luftës së vitit 1998 deri me rastin e hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë. Të grumbulloj fakte dhe të dhëna për krimin e dyfishtë të kryer ndaj qytetarëve të pafajshëm nga ana e ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve serb. Të bashkëpunoj me prokuroritë komunale dhe familjarët të ngrisin kallëzime penale kundër kriminelëve për gjenocidin e kryer në Kosovë sepse familjet kanë të dhëna konkrete. Qeveria tregon një përkujdesje institucionale për familjet që kanë të zhdukur, mirëpo Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale duhet të përshpejtoj hartimin e ligjit që rregullon statusin e luftëtarit, të zhdukurve dhe kategorive tjera shoqërore sepse vonesa e miratimit të ligjit rezulton me mostrajtimin adekuat të familjeve. Mendoj se duhet të informohen të gjitha zyrat diplomatike në Kosovë dhe anëtarët e Grupit të kontaktit me konkluzione të dalura nga ky debat, në mënyrë që kjo

çështje e dhembshme për familjet dhe shoqërinë e Kosovës të ndriçohet sa më parë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Dr. Bajram Rexhepi, kurse le të përgatitet Bajrush Xhemajli.

DEPUTETI BAJRAM REXHEPI

I nderuari kryetar i Kuvendit, z. Kryeministër, ministra, të nderuar deputet dhe të nderuara familje të pengjeve të luftës.

Është me të vërtetë vështirë që të merr kahen dhe të kesh një diskutim emocional për një çështje që ashtu ashtu është shumë e dhimbshme, emocionale ose të provosh të jesh racional dhe të japësh ndonjë propozim se si kjo çështje aq e dhimbshme në rend të parë për familjarët, por edhe për gjithë shoqërinë Kosovare të përshpejtohet.

Duhet ta përsëris vetveten në një takim me familjarët e pengjeve të luftës që mendoj se është termini ma i drejtë edhe pse terminologjia ka pasuar ndryshime gjatë tërë kësaj kohe se përkundër asaj se sa angazhohen institucionet, partitë politike por edhe të gjithë qytetarët, asnjëherë nuk është mjaft për pengjet e luftës dhe asnjëherë nuk do të jetë mjaft për familjarët e tyre të cilët këtë dhembje e përjetojnë 24 orë, ndërsa ne të tjetër që kemi edhe obligime tjera merremi me këtë çështje kohë pas kohe. Unë nuk dua të hyjë në kronologji për arsye se ato u paraqitën nga kryetari i Komisionit qeveritar të ish Qeverisë nga z. Ragip Zekolli për themelimin e Komisionit për mjetet të cilat janë ndarë nga buxheti i Kosovës dhe kushtet që janë ofruar nga zyra e Kryeministrit që ata të kenë mundësi të jenë më efikas. Po ashtu një ndër shtytjet kryesore që të pranojnë bisedimet teknike në atë kohë ishte që pak a shumë të jemi më të efektshëm në zbardhjen e fatit të pengjeve të luftës. I kemi përkrahur edhe politikisht dhe materialisht këto komisione që të kemi një bashkëpunim më të ngushtë edhe me komitetin ndërkombëtar për persona të pagjetur me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, me familjarët që të bëhet një koordinim më i mirë që të jenë më të efektshëm. Disa nga propozimet nga Rezoluta e Parlamentit të kaluar janë plotësuar, por disa kanë mbetur të pa plotësuara për arsye se edhe objektivisht ka qenë vështirë që të plotësohen. Unë pajtohem se vetëm me këtë nivel që nuk mund të thuhet se është vetëm teknik, nuk mund të ketë ndonjë sukses të dëshirueshëm.

Po ashtu çështja e pengjeve të luftës mendoj se është komplekse, është humanitare, juridike dhe politike, nuk mund të shkëputet si një kategori e veçantë. Mirë po secili duhet ta bëjë punën e vetë. Këto komisione deshëm apo nuk deshëm duhet të shërbejnë si logjistikë se shkon deri në një informatë dhe cakton procedurën e riatdhesimit, mirëpo sukcesi do të ishte më i madh vetëm nëse këto bisedime do të jenë edhe në nivelet politike më të larta, pajtohem me sugjerimin e z. Surroi që në një nga takimet politike të nivelit të lartë të jetë çështje prioritare në mënyrë që të bëhet një presion më i madh te

strukturat politike të Beogradit, po ashtu duhet të jemi të vetëdijshëm se pa një presion më të fuqishëm të ndërkombëtarëve në rend të parë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe shteteve të Unionit Evropian të cilët mund t'i bëjnë kushtëzimet Beogradit rezultatet do të jenë të mangëta aq më parë kur edhe strukturat aktuale politike në Beograd, por edhe regjimi i përparshëm përveç krimeve që i kanë bërë, vrasjeve kanë pasur në strategjinë e tyre që t'i mshcfin edhe gjurmët e krimit, sikur ata t'i japin të gjitha informatat që i kanë për krimet e bëra ata e pranojnë drejtpërdrejtë fajësinë për të gjitha ato lufta dhe krime që janë bërë, ndërsa ata nuk janë të gatshëm ta bëjnë këtë, rasti më i mirë ishte në 10 vjetorin e Srebrenicës ku ka zëra të ndryshëm dhe thuhet se më shumë kanë pësuar popullata serbe sesa ajo boshnjake edhe pse botërisht dihet se ishte një gjenocid i vërtetë, prandaj realisht vetëm metodat e presionit dhe kushtëzimit të fuqishëm mund t'i lëvizin strukturat qeveritare të Beogradit që t'ju mundësojnë komisioneve të tyre që t'i japin informatat e domosdoshme. Dua të them edhe një të dhënë që lidhet pak a shumë edhe me profesionin, po ashtu edhe identifikimi i kufomave është një procedurë shumë e vështirë. Unë besoj se sikur t'i kemi informatat se cilët persona janë varrosur në varrezën masive kjo do të ishte një lehtësim për ekspertët më vonë, por është edhe ajo që ekzaminimet antropologjike që janë të përafërta po bëhet paraprakisht një identifikim i cili nuk është i plotë. I vetmi identifikim që garanton saktësinë 99% është në metodën e ADN-së, është një metodë relativisht e re, ka 10 – 15 vjet që ka filluar të aplikohet, nuk ka numër të madh të ekspertëve, prandaj është edhe vetë procedura e ekzaminimit është mjaft e gjatë dhe e ndërlikuar, prandaj këto janë disa çështje objektive që ky proces përkundër dëshirës do të kalojnë edhe vite të tëra deri sa të zbardhet edhe fati i të tjerëve.

Ishte rasti me Srebrenicën ku prej 8.000 të vrarëve deri më tani vetëm 2.000 janë identifikuar, prandaj duhet të jemi realist në pritjet tona, por shpresoj se pas bisedimeve të këtij debati do të dalin disa propozime konkrete të cilat do t'ju ndihmojnë institucioneve tona që të jenë më të efektshme në prezantimin e kësaj çështje të dhimbshme dhe që sa më shpejtë të zbardhet fati i pengjeve të luftës. Këtu duhet të jetë një koordinim i ngushtë edhe në mes të institucioneve, por edhe komisioneve gjegjëse, asociacioneve të familjeve në mënyrë që secili ta kryej pjesën e vetë të punës dhe ta kryejmë një obligim ndaj familjarëve për më të dashurit e tyre, por edhe për tërë shoqërinë Kosovare. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Bajram ju faleminderit, z. Emrush Xhemajli, kurse le të përgatitet Bexhet Brajshori.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI

I nderuari z. Kryetar, kryeministër, të nderuar familjarë të të pagjeturve, kolegë deputet dhe të gjithë të pranishëm.

Fatkeqësisht ende kur po bisedojmë për një çështje të dhimbshme, sjelljet e Serbisë ende nuk kanë ndryshuar dhe pikërisht treguesi më i mirë për sjelljet e Serbisë është sjellja ndaj të pagjeturve dhe është shprehje e një gjendje të luftës në të cilën e mban ende Serbia Kosovën. Për më tepër Serbia po të ketë mundësi edhe tash merr pengje dhe i dërgon në Serbi. Rasti i Anton Lekës është rasti më i mirë që e dëshmon këtë që po e them. Anton Leka është nga Gjakova, është një ushtar i ish ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka qenë duke udhëtuar nëpër Mal të Zi për në Bosnje dhe është kidnapuar nga shteti i Serbisë dhe Malit të Zi dhe është dënuar në Beograd, e kemi këtë rast që është i rrëmbyer dhe është i gjetur dhe ende mbahet atje. Në raste të ngjashme për ish komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për kryekomandantin Agim Çekun, për z. Thaçi për rastet tjera është intervenuar nga Bashkësia Ndërkombëtare, por është shumë domethënëse për këtë ushtar, thjesht nuk është bërë asgjë, ndoshta është bërë e zakontë që të bisedohet në këtë Kuvend tepër në mënyrë të përgjithësuar, por mendoj se pavarësisht që po bëhet fjalë për fatin e një individi për deri sa nuk jemi në gjendje që rastet konkrete t'i mbrojmë në mënyrë konkrete do të jetë shumë vështirë për neve si shoqëri që të ecim më tutje, dihet se si veprohet në shtetet e ndryshme të botës kur cenohet një qytetar i vetëm, nëse ka faj për ndonjë gjë Anton Leka edhe rastet e ngjashme qytetarët e Kosovës duhet të përgjigjen në Kosovë, por me sa e dimë ne në Kosovë nuk është i akuzuar për asnjë vepër penale.

Na vije shumë keq që çështja e të pagjeturve është përdorur për qëllime politike kundër Kosovës që përmes të pagjeturve një çështje shumë e dhimbshme detyrohet Qeveria e Kosovës që të hyj në dialog dhe pretendohet që të futet Kosova nën shtetullat e Serbisë, kjo është një teknologji e njohur, shumë e padrejtë dhe për mendimin e LPK-së këtu duhet të intervenoj Bashkësia Ndërkombëtare në këtë çështje dhe nuk ka çka të bëjë Qeveria e Kosovës sepse është e pafuqishme që të bëjë më tepër në këtë drejtim.

Kufomat të sillen në Merdare dhe të merren nga familjarët të gjallë ose të vdekur dhe nuk ka çka të dialogohet edhe në lufta ka këmbim robërish, ka këmbim të pagjeturish etj. Këtu kanë kaluar 6 vite nga lufta ende Serbia është duke vazhduar me të vjetrën pa i dëgjuar rregullat e luftës dhe të pasluftës në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Është shumë e pa pranueshme ajo që u tha këtu. Serbia është fajtorë për atë çka ka ndodhur në Kosovë dhe është përgjegjëse edhe për të gjithë ata që janë të pagjetur, shqiptarë, serb, rom etj. Ajo që nga viti 1912 ka qenë këtu pushtuese, qindra masakra ka bërë këtu, është sjellur në mënyrë vandale dhe ajo është përgjegjëse për të gjitha. Tentimi për ta barazuar luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me luftën e paramilitarëve dhe militarëve që kanë bërë masakra në Kosovë duhet marrë fund së paku nga partitë politike që janë të regjistruara në Kosovë. Ju faleminderit.

DEPUTETI BEXHET BRAJSHORI

I nderuari z. Kryetar, kryeministër, ministra, të nderuar familjar dhe kolegë deputetë. Tema për të cilën sot po bisedojmë, sipas mendimit tim, është shumëdimensionale, është edhe politike, është edhe humanitare, por është edhe obligative për ne. Është politike

sepse politika serbe shkaktoi një gjendje të këtillë dhe sot politika duhet të merret me zgjidhjen e këtij problemi. Është humanitare sepse nuk i kemi të afërmit tanë tash dhe është obligative sepse mbi sakrificën e tyre dhe të tjerëve sot gjendja në Kosovë është krejt ndryshe nga koha kur ata u morën nga dora serbe, u vranë dhe u zhdukën. Nisur nga këto fakte, ne kërkojmë kthimin e tyre në fund të fundit edhe me çmimin e dhembjes se ata nuk janë të gjallë, por në këtë rast shtrohet pyetja e paevitueshme: Në kuadër të kompetencave të mundësive të institucioneve tona pas lufte a kemi bërë apo jo të mundshme zbardhjen e fatit të pengjeve të luftës ose të pagjeturve. UNMIK-u si autoritet ndërkombëtar në Kosovë dhe përgjegjës për këtë a ka bërë të mundshmen në këtë plan apo jo. Politika zyrtare e vendeve të ndryshme mike të Kosovës dhe ndërtuese të paqes, progresit dhe mirëqenies në mes të popujve e bëri ose jo të mundshmen në këtë plan. Institucionet ndërkombëtare, misioni i të cilave është marrja me këtë problematikë, e bën të mundshmen apo jo. Bazuar në faktet që u thanë edhe me këtë rast të gjithë mund të jemi të pakënaqur. Beogradi vazhdimisht e ka përdorur këtë çështje për realizimin e qëllimeve të caktuara politike. Atëherë kur i duhet të bëjë një lëvizje politike pozitive për interesat e veta në Kosovë lejon kthimin e numrit të caktuar të kufomave të të afërmeve tanë duke e ripërtërirë deri në skajshmëri dhembjen dhe vuajtjen e familjarëve të tyre dhe të gjithë Kosovës. Kështu vazhdon të bëjë edhe sot dhe çka duhet bërë shkurtimisht.

Një presion i vazhdueshëm dhe i fuqishëm ndërkombëtar mbi Beogradin është shumë i domosdoshëm dhe sigurisht edhe i pazëvendësueshëm për rrethanat aktuale. Nuk besoj se mund të arrihet paqja dhe stabiliteti në këto hapësira pa zgjidhjen e këtij problemi, i cili nuk duhet dhe nuk mund të jetë problem vetëm familjar, ndoshta edhe më së paku duhet të jetë familjar. Obligimi për zbardhjen e fatit të tyre është i yni, kurse dhembja është e përbashkët. Nxjerrja përsëri edhe e një rezolute ose deklarate nga ana e këtij Kuvendi, e cila do t'u adresohet qendrave ndërkombëtare të vendosjes dhe UNMIK-ut në Kosovë duhet të ripërtërijë dhe riafirmojë edhe njëherë këtë çështje tepër të ndjeshme. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Z. Sabri Hamiti, kurse i c të përgatitet Gjergj Dedaj

DEPUTETI SABRI HAMITI

Faleminderit z. Kryetar i Kuvendit.

Është shumë e qartë që tema është shumë komplekse dhe mbi të gjitha është e dhimbshme, temë që në të njëjtën kohë kërkon një rezon të ftohur politik të cilat është vështirë që t'i bëjë bashkë njeriu në qoftë edhe në një diskutim të këtillë të këtij forumi. Paraprakisht ndiej nevojë që të bëjë një sqarim sepse rreth emërimit të statusit të këtyre njerëzve të dashur u bë në mënyrë ironizuese, një diskutim këtu që mua më duket shumë i pavend dhe shumë pa lidhje, kjo u shtrua edhe nga një diskutues dhe nga z. Surroi në

mënyrë ironike dhe lëvizhga gjuhësie siç thonte Laz Gushi gjithmonë kanë vërejtje ata që nuk e njohin gjuhën mirë. Ky Kuvend në përbërjen e vetë nga ai i përparshmi ka të njëjtën strukturë me përjashtim të një grupimi të ri që ka hyrë brenda, tri strukturimet tjera e dinë shumë mirë pse ka ndodhur ky ndryshim në emërim, sepse është menduar dhe komisionet janë emëruar kështu dhe është menduar se duke ju thanë të pagjetur kjo është një metodë për të mos pranuar që janë të vdekur, që nuk janë të gjallë fare, nuk është puna që nuk është ditur se çka është ajo, ka qenë një emërim ruajtës mjekues për dhimbjet e mëdha që të mos emërohen njerëz të zhdukur që nuk ekzistojnë më, por të pagjetur dhe kështu është bërë ky emërim dhe ky emërim është bërë me pëlqimin e shoqatave që janë marrë me këtë, Komisionet që i ka ndërtuar Parlamenti dhe në fund të një rezolute që e ka nxjerrur ky Parlament dhe më duket që është shumë pa lidhje që ne tash ta shqyrtojmë tutje këtë punë. Nuk është punë gjuhësie kjo, por kjo është punë e një metode të dhembjes dhe tash nëse mendohet se duhet t'ju thuhet vetëm pengje lufte i thojmë, por kjo nuk ndreq asgjë në substancë mendoj unë.

E dyta, ne kemi një fat që kemi në bankat e Kuvendit eks kryeministrin përpara, ministrin e ri dhe nuk kemi nevojë që t'i shtrojmë detyra të pamundëshme të riut, pasi nuk i kemi shtruar të pamundëshme të vjetërit. Problemi është që nuk ka munguar interesi i institucioneve të Kosovës, shkurt me i ra si Bajram Rexhepi, Bajram Kosumit që nga pozicionet e tyre udhëheqëse që të zgjidhet ky problem por shkurt duhet të thuhet dhe shqip Qeveria e Kosovës as dje as sot nuk ka fuqi vepruese, nuk ka fuqi ndikuese kaq të madhe në Beograd që të sillen kufomat qoftë edhe ato që janë gjetur. Kjo është e vërteta. Si ta marrë kjo Qeveri atë fuqi, ne nëse kemi çelës po ja japim por nëse nuk kemi nuk duhet të kërkojmë të pamundurën prej tyre, gjithmonë edhe ata ma radikalët që flasin këtu fjalinë e dytë e thonë se duhet ta lusim Bashkësinë Ndërkombëtare me i ba presion Serbisë mos me i dhanë para se s'po na dëgjon d.m.th nga një maksimale zbritet në një minimale sepse e vërteta është që Qeveria jonë duhet të bëjë çka mundet, çka ka mundësi ajo ka filluar me grupin dhe e ka provuar se çka ka mbërriri. Unë mendoj se është dashur të bëhet nga ana e Qeverisë një raport shumë më i detajuar se çka kanë mbërriri me atë grup, personalisht mendoj se nuk do të mbërrijmë shumë si në të gjitha degët tjera sepse Kosova në bisedime me Serbinë sot dhe unë jam ai që kam thënë dhe nëse bisedohet për kanalizim është bisedë politike se le për njerëz të gjallë apo të vdekur dhe për projekte dhe grupet e Kosovës me të Serbisë sot unë mendoj se as për njësinë matëse të kohës nuk mund të merren vesh d.m.th është loja që të krijohet dialogu por situata është shumë e vështirë që të krijohet marrëveshja. Kjo ka ndodhur edhe me këtë problem dhe unë po them se ne mund të rishfaqim kërkesën tonë të fuqishme që të zgjidhet problemi në nivelin që të mund të zgjidhet, por jo të shtrojmë kërkesa të pamundshme sepse bëhemi joracional. Unë e di që është e dhimbshme dhe po ju them fotografitë që i kemi të njerëzve që na mungojnë është një ngarkesë faktikisht një ngarkesë psikologjike për çdo njeri që vjen dhe hyn në këtë Kuvend dhe sillen rreth tij dhe të ngjajnë në albumin e Argjentinës që e ka bërë Ernesto Sabato për të zhdukurit e tyre.

Kjo nuk i jep të drejtë askujt që të bëhet i ndjeshëm apo ma i pandjeshëm se tjetri dhe nga ky pozicion të kërkojë diçka më shumë se solidariteti, sepse ju e dini që ne kemi edhe në banka kolegë dhe vetë jemi që gjysmën e familjes i kemi të zhdukur. Askush këtu nuk

duhet të bëjë gara rreth kësaj teme, por të bisedohet thellësisht çka mund të zgjidhet. Unë mendoj personalisht se çdo vdekje e një njeriu është një tragjedi dhe të gjitha të tjerat nëse bëhen kolektive bëhen politike dhe statistikë, prandaj mendoj se shumëçka këtu ka kaluar në politikë dhe statistikë. Unë kërkoj që shënimet të jenë të sakta sepse ne dëgjuam këtu nga dy burime p.sh për njerëzit që mungojnë njëri e dha 2750, kurse tjetri 2780 këtu janë 30 fate njerëzish, kërkoj që në frymën e kësaj që po e them që çdo rast të studiohet dhe mundësisht të zgjidhet si i veçantë dhe të bëjmë atë që mundemi. Rezoluta mund të rimerret dhe të rihet. Unë nuk shoh që mund të shtojmë diçka të veçantë pos ndërtimit të ligjit për statusin e tyre dhe familjeve për të cilën folën të gjithë dhe unë pajtohem. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT Daci:

Gjergj Dedaj, kurse le të përgatitet Genc Gorani

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ

Faleminderit z. Kryetar, z kryeministër, ministra, deputet të nderuar dhe mbi të gjitha familjarë që jeni këtu në sallë, por edhe të gjithë familjarët anë e kënd Kosovës të cilët me siguri me interesim dhe shqetësim e përcjellin këtë debat të sotëm të Kuvendit të Kosovës që unë mendoj se është edhe një gjest i vullneti të mirë për të dëshmuar solidaritetin e Kuvendit të Kosovës me këta familjar të dhembjes sonë krenare. Fati e ka dashur që sot të flas jo vetëm si deputet por edhe si familjar i dhjetëra anëtarëve të vrarë dhe të zhdukur gjatë konfliktit të fundit në Kosovë dhe nëse mund të ketë ndonjë emocion, ju kisha lutur të mos më keqkuptoni se nuk po e bëj për marketing, por sinjersht familjarët jemi të prekur me trajtimin që po na bëhet dhe që po ju bëhet familjeve të personave të zhdukur. Këtu u thanë shumë terme e që unë mendoj se janë të kidnapuar, të zhdukur të pagjetur deri më sot tash e 6 vite. Ne jemi pajtuar dhe e dimë se janë pengë që janë marrë, janë arrestuar dhe janë ekzekutuar dhe janë dërguar në varrezat masive të Serbisë. Çështja është të nderuar deputet që eventualisht me sjelljet tona dhe trajtimin që ua bëjmë këtyre familjeve dhe këtyre familjarëve mos të hapim eventualisht plagë të reja, më ka ra disa herë me qen në Merdare për t'i pritur qeset prej plastike me eshtrat e më të dashurve tanë dhe asnjëherë nuk i kamë parë liderët e institucioneve të Kosovës përveç me një rast kryeministrin Haradinaj, e kamë parë vetëm njëherë një ministër se kamë parë asnjë kryetar të asnjë komune të Kosovës dhe dua t'ju përkujtoj diçka se në Meje të Gjakovës, Korenicë, Guskë e rekë të keqe ka afër 400 djem të rijë dhe burra që janë vrarë me 27 prill 1999 dhe mundem me ju thanë me bindjen më të plotë se kurrnjherë nuk e kamë parë asnjë lider të asnjë institucioni të Kosovës së paku me ardhë që t'ju bëj një përkrahje të sinjertë dhe solidare familjeve sepse ajo çka është Meja dhe Korenica, Prekazi e Reçaku, mos t'i përmendi se ka dhjetëra e dhjetëra vendbanime është për ne Vukovar dhe Srebrenicë. Ndaj këtyre varrezave, ndaj këtyre familjeve, këtyre fëmijëve ndaj këtyre zonjave të reja ku kemi edhe nuse 18 vjeçare 20 vjeçare që kanë vendosur të qëndrojnë në shpi dhe me i ruajt fëmijët, unë mendoj e besoj që edhe ju, por ju duhet të veproni fjala është për Qeverinë se ju jeni ekzekutivi që të keni një trajtim

se Serbia edhe 100 mbledhje le t'i mban Parlamenti i Kosovës ka me i kthyer kur të donë dhe nga sa të donë në qese plastike për të mos na lënë të qetë dhe do të na i kthej pak nga pak, ndoshta edhe me vite të tëra kemi me i prit, por mesazhi im si familjar është që institucionet e Kosovës të sillen pak më ndryshe dhe ma me përgjegjësi ndaj këtyre familjeve.

Kemi raste që nuk dua t'i përmend me emra por nuk dua. Kur fëmijët që i kanë të zhdukur prindërit janë fëmijë jetimë dhe nuk pranohen në shkollë të mesme. Kur fëmijët vajzat dhe djemtë që i kanë të zhdukur prindërit dhe të gjithë meshkujt e familjes nuk pranohen në Universitetin e Prishtinës, nuk jam për t'iu falur notat e as diplomat, por duhet të rregullohet me ligj çështja e familjarëve, fëmijëve të familjeve të të zhdukurve, të vrarë, syrgjynosur që ndoshta disa as që do të na kthehen kurrë, por ne jemi pajtuar me atë fat bile edhe jemi krenar, e nëse është nevoja për pavarësinë e Kosovës edhe na duken pak, por ne mos të bëjmë plagë apo mos t'i vrasim edhe njëherë këta familjar, kjo është ajo që kërkoj, të bashkëndejmë dhimbjen me këto familje dhe me këta fëmijë që t'u japim mundësi dhe t'ua plotësojmë mungesën e prindërve të tyre dhe unë përshëndes sinqerisht zyrën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë që ka dhënë një shumë prej 300.000 € për t'u ndihmuar këtyre familjeve dhe ndoshta është mirë që Qeveria e Kosovës dhe ministrat tonë le ta lënë ndonjë xhip të zi mangu dhe le t'ju dërgojnë ndonjë mbështetje këtyre fëmijëve. Një fshat i vogël në Gjakovë me emrin Guskë ka vetëm 100 banorë 25 djem dhe vajza i ka të vrarë që do të thotë 25% të banorëve i ka të zhdukur, kjo nuk ka ndodhur askund në Ballkan dhe askund në Evrop. Asnjëherë askush nga Komuna nuk ka qen atje, as kryetari i Komunës së Gjakovës dhe asnjë ministër ose dikush i liderëve të Kosovës ta vizitoj fshatin që është më i dëmtuari në Evrop ndonjëherë në ndonjë luftë. D.m.th kjo është për çka ne duhet të angazhohemi që sinqerisht ta nxjerrim urgjent një ligj për t'i mbrojtur fëmijët, për t'i mbrojtur këto familje, që t'u mbrohet dinjiteti i tyre t'u ipet perspektivë këtyre fëmijëve bonjak që janë me qindra e mija dhe krejt në fund e përshëndes angazhimin e të gjitha grupeve të Qeverisë dhe të gjitha komisioneve qeveritare, të znj. Brovina, znj. Kumnova dhe të gjithë atyre njerëzve që sinqerisht me vullnet të mirë interesohen për fatin e këtyre njerëzve që janë më të dashurit dhe që e kanë shkruar historinë e Kosovës, sepse pa gjakun e tyre ne sot nuk do të ishim në këtë Kuvend. Ju faleminderit

DEPUTETI GENC GORANI

Ju faleminderit z. Kryetar, i nderuari z. Ministër, anëtarë të Qeverisë, familjar të nderuar.

Që në fillim më lejoni të përmend disa prej fakteve mbi çështjen e pengjeve të luftës në regjionin e Prizrenit. Nga 351 raste të evidentuara, 268 personave nuk ju dihet akoma fati, ndërsa për 83 persona në të shumtën e rasteve është konstatuar se kanë qenë të ekzekutuar njerëz të martirizuar. Rrjedh se nga 351 raste të personave të pagjetur në regjionin e Prizrenit vetëm ¼ së tyre u është zbuluar fati në këto 5 -6 vitet e kaluara. Me këtë ritëm ne jemi pajtuar që ky proces të na vazhdojë edhe 15 vjet. Sot anëtarët e familjeve të pengjeve të luftës i kemi vu në një mezerie njerëzore të panjohur në historinë

tonë kombëtare, ne ua refuzojmë ndihmat e mundshme madje edhe elementare njerëzore siç i përmendi parafolësi im edhe pse mundësitë e institucioneve tona së paku materiale janë kolosale në krahasim me nevojat e tyre. Sot familjarët e personave të pagjetur detyrohen t'i shpallin të dashurit të vdekur nga se për ndryshe administrata jonë ua refuzon edhe ato pak ndihma sociale, kjo zhagitje jo humane e përcjellur me paraqitje të shpeshta dhe verbale të Klasës politike është shprehje e një indiference dhe të një hipokrizie të të njëjtës klasë politike. Mungesa e vlerave themelore civilizuese e të njëjtës klasë. E vetmja shpresë e mbetur është se opinioni kosovar më në fund do të arrijë që t'ia imponoj klasës politike Qeverisë në rend të parë zgjidhjen e këtij problemi. Deri sa të shtojmë dhe me një arrogancë të hapur me përmbushjen e ndërgjegjes sonë kolektive do të vazhdojmë të jemi injorant të lirisë, qenie të ulta egoiste, prepotente, të përqeshur nga e gjithë bota e veçanërisht kur betohemi për të drejtat e njeriut apo për demokraci.

Nuk duhet të ekzistoj asnjë kërkesë sociale nga ajo e pensionerëve, arsimit e deri te kërkesat më elementare politike tonat pa u përcjellur me kërkesën definitive dhe urgjente të çështjes së të pagjeturve. Çdo aktivitet politik në të gjitha instancat e mundshme duhet të fillojë dhe të mbaroj me çështjen e pengjeve të luftës si parakusht për realizimin e proceseve tjera. Ju faleminderit.

DEPUTETJA SALA AHMETAJ

Përhëndes kryetarin e Kuvendit, kryeministrin, ministrat, deputetët dhe posaçërisht anëtarët e familjeve të të pagjeturve.

Edhe familja ime e gjëra dhe e ngushta ka të vrarë dhe të pagjetur, prandaj sot më shumë do të flas në këtë cilësi. Sot këtë debat e dëgjojnë edhe fëmijët e vëllait tim dhe fëmijët e të gjithë të të vrarëve dhe të të zhdukurve që u bën therorë për këtë liri të brishtë të Kosovës. Të gjithë ata fëmijë shpresonin se lira e Kosovës do të hynte edhe në shtëpitë e tyre dhe do t'u bëhej prind, fatkeqësisht lira në shtëpitë e tyre solli vetëm fjalë dhe ironi dhe fajtorë për këtë është shoqëria kosovare, jemi ne, është platforma politike që shkel mbi gjakun dhe mbi vlerat më madhore të një kombi dhe të njerëzimit, përgjegjës janë të gjithë. Indiferenca është sëmundja më e rëndë e shoqërisë sonë, është lëngimi më i keq i institucioneve tona. Këtu dëgjova shumë diskutime më tepër mëshiruese, për dramën e Kosovës tragjedinë e rëndë dhe për ankthën e gjatë të gjithë janë fajtorë. Loja me fatin e të pagjeturve dhe të të vrarëve bëhet në mënyrat nga më të ndryshmet që nga thurja e elegjive dhe diskutimeve patetike e deri te injorimi, çështja nuk zgjidhet as me elegji as me ode por me vendosmëri me kushtëzime dhe me përgjegjshmëri. Ajo nuk zgjidhet me presion dhe me lutje dhe unë madje do të pyesja z. Kryeministër? Çka nënkupton ai me fjalën presion, jo presion zotëri, por kushtëzime. Familjarët e viktimave kanë nevojë për përkrahje institucionale e jo për fjalë të bukura dhe për stilizim, fjalët e bukura dhe vajtimet nuk ke përshpejtojnë zgjidhjen. Respekti për familjet e personave të pagjetur dhe për familjet e dëshmorëve nga institucionet e Kosovës është i paktë për të mos thënë përbuzës, kjo metafor e turpit dhe e dhimbjes sonë nuk zgjidhet me mëshirime, me lutje, por me respekt me përkushtim me vendosmëri dhe me kushtëzime.

Luftën dhe betejën e fiton ai që nuk frikësohet prej saj. Me frikacak dhe servil nuk fitohet asnjë betejë e as kjo për zbardhjen e fatit të të pagjeturve. Serbia i ka vrarë dhe i ka zhdukur, ne nuk duhet të kërkojmë mëshirën e saj vetëm vendosmëria, serioziteti dhe respekti i institucioneve dhe i shoqërisë Kosovare e zgjidh në mënyrën më meritore dhe më të dinjitetshme këtë dramë të madhe. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ju lutem që deri në orën 12,30 të bëjmë një pauzë të shkurtër dhe vazhdojmë.

(Pas pauzës)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Deputetët le të ulen, të fillojmë . Kemi forum sa për ta filluar punën.
Mendoj se mund të fillojmë. Unë jam për gatitur për t'ia dhënë fjalën zotit Enver Hoxhaj , në qoftë se është në sallë.

Nuk është.
Atëherë Hydajet Hyseni

Deputeti Hydajet Hyseni, le të përgatitet Nekibe Kelmendi .Nuk është Nekibja. E presim Urdhëro Hydajet

DEPUTETI HYDAJETE HYSENI

Faleminderit zoti kryetar, zonja e zotërinj deputetë,
Edhe sot ne po debatojmë për një çështje shumë të rëndësishme dhe përsëri , pa letra , pa raporte, aq më tepër kjo vërejtje mund të shtrohet kur në emër të Grupit Parlamentar që e ka iniciuar këtë çështje e shohim të marrë fjalën përgjegjësi që është i angazhuar edhe në Komisionin për çështjen për të cilën po bisedojmë. Ka qenë e udhës që ky komision ose zyra ose kushdo qoftë tjetër ,të na ofrojë një material, në të cilin do të ishin shumë nga ato që u thanë në debat ose në ekspozetë e tyre. Sido që të jetë, ne po bisedojmë për një çështje , madje pa i definuar as nocionet e siç do të thoshte Konfuçi” Puna e parë që duhet bërë është të sqarohen nocionet”. Megjithatë, pa dashur të kapemi për fjale, nuk besoj se kjo çështje mund të kualifikohet si brengë, është diçka më shumë - shumë më shumë . U tha këtu është plagë, është plagë e hapur dhe për ma tepër plagë e hapur që po kullon, për ma tepër është plagë e hapur që po shpupurishet dhe po shpupurishet keq po shpupurishet edhe nga lojërat politike edhe nga politizime të llojllojshme, po shpupurishet edhe nga një përpjekje për të licituar me të për ta trajtuar si diçka që duhet dhënë me doza të caktuara në konjunkturën politike dhe gjithmonë në funksion të lojërave politike. Madje po bëhet një përpjekje për ta përdorur edhe çështjen e pengjeve të luftës si një formë shantazhi ndaj Kosovës së Re dhe do të thoshë edhe pranisë ndërkombëtare në Kosovë. Po mbahet, prandaj, peng jo vetëm e vërteta, jo

vetëm fati i mijëra personave të rrëmbyer, të tretur pa gjurmë dhe pastaj edhe të konsideruar të pagjetur, por po mbahet peng praktikisht jo vetëm familjet e tyre, po mbahet peng një popull i tërë. Unë do të thosha se po mbahen peng praktikisht edhe proceset e normalizimit dhe të pajtimit në Kosovë, po mbahet peng edhe procesi i demokratizimit të mirëfilltë në Kosovë, mirëpo edhe procesi i ndërtimit të paqes së qëndrueshme në Kosovë dhe për më tepër është një përpjekje ose një përshtypje se ka një indiferentizëm dhe njëfarë tolerance e kësaj loje politike, me çështje aq të ndjeshme. Kur është fjala për fatin e vëllezërve Bytyçi u gjetën mënyra që kjo çështje shumë shpejt të sqarohet dhe të gjejë finalizimin ashtu siç mund të ishte, pse, sepse qëndrimi e qasja ishin tjetër fare. Shtrohet pyetja:” Po të ishin bijtë tanë ose vëllezërit tanë, motrat tona etj. do të thotë me një shtetësi tjetër a mund të presim se për ta do të kishte trysni dhe trajtim tjetër dhe çështja do të zgjidhej shumë më shpejt. Pse të mos kërkojmë që edhe qytetarët tanë të Kosovës të trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në fund të fundit fatet janë të njëjta dhe janë në funksion të njëjtit ideal, të së njëjtës çështje. Po për fat të keq ne s’mund t’i fajësojmë të tjerët se megjithatë as ne vetë nuk kemi bërë gjithë atë që duhej ta bënim dhe këtu secili prej nesh duhet të ndihet keq, as ky kuvend nuk ka bërë sa duhet. Ne, megjithatë, kemi aprovuar dy- tri dokumente për këtë çështje dhe për fat të keq po t’i shikojmë me vëmendje vërejmë se edhe ato nuk janë nuk respektuar dhe nuk janë mbajtur parasysh. Një nga kërkesat e Rezolutës e parë e të mëvonshme, që kemi miratuar ka qenë që edhe çfarëdo dialogu me çfarëdo çështje, lidhur me çfarëdo çështje me Serbinë të zhvillohen që do të zhvillohen të kushtëzohen me ndriçimin e fatit të rrëmbyerve dhe të të humburve. Çka ndodhi? Ndodhi megjithatë një turr relevant për të vrapuar kush mundet më parë dhe megjithatë kjo çështje u anashkalua. Ndodhi tjetra pastaj që të fillohet edhe një proces i bisedimeve i negociimit për këtë çështje pa e sqaruar në këtë Kuvend a është çështje që negocohet, a duhet negociuar për këtë çështje apo jo dhe pasi u vendos të bisedohet, ndodhi diçka që mund të mos ndodhte, që në këtë proces të shkohet jo sa duhet të përgatitur dhe për pasojë vetëm rezultatet të mos jenë ato që priten, domethënë të mos jenë pozitive, por droja është që janë edhe shpesh të kundërta. Për mua dhe duhet të jem i hapur. Më ka bërë përshtypje shumë të keqe edhe paraqitja në këtë ballafaqim. Nuk dua të përmend emra se nuk e kam hallin aty, por më vret nëse dikush në emër të Kosovës shkon të bisedojë për këtë çështje kaq të ndjeshme, kaq të dhembshme dhe ka për ballë njerëzit që kanë qenë drejtpërdrejt ose tërthorazi, por gjithsesi të përgjegjshëm për atë që ka ndodhur dhe ai zotëriu që ish nga Kosova e shikon në maje të kreshtë, kurse përfaqësuesi ynë e shikon te këpucët. Edhe unë e di se me fotografi mund të bëhen lojëra, por ne duhet t’i kemi ato fotografi që kanë hije, sepse në fund të fundit nëse për çështje të tjera dhe mund të mos jemi kokën lart, së paku për këtë çështje do duhet të kishim dinjitetin e duhur. Nëse asgjë tjetër romanin e Kadaresë” Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, do të duhet ta ketë lexuar secili, dramën për gjeneralin dhe duhet ta kishte parë secili. Mijëra qytetarë të pafajshëm janë në pyetje dhe kokën ulur duhet ta mbajnë ata që janë fajtorë dhe përgjegjës për të, ne megjithatë jemi të motivuar që këtë çështje ta tejkalojmë, ta mundim dhembjen, prandaj edhe kemi zgjatur dorën që të zgjidhim çështjen dhe të krijojmë kushtet për pajtim edhe në suazat e Kosovës, por edhe më gjerë. Megjithatë ka edhe kjo disa parakushte, si thonë kusht i parë i faljes është njohja dhe pranimi i fajit. Nuk po ndodh zonja e zotërinj kjo dhe nuk po kërkohet që të bëhet kjo në mënyrën e duhur. Distancimi nga ajo politikë që ka shkaktuar fenomene të këtilla, për më tepër po tolerohet edhe paralajmërimi i njëfarë

mënyre i situatave të ngjashme edhe në të ardhmen, po lejohet edhe që të luhet me drejtësinë ndërkombëtare. As ne nuk e kemi respektuar kërkesën që të bëjmë gjithë atë që duhet për t'i procesuar rastet në Tribunalin e Hagës. Por jemi, kemi arsye të jemi të pakënaqur edhe me qasjen e faktorëve ndërkombëtarë kur është në pyetje drejtësia, për atë që ka ndodhur në Kosovë. Mëshirimi i kriminelëve, thonë, është dënimi i viktimave. Ne mund të konstatojmë se në rastin e Kosovës kjo po ndodh, zonja e zotërinj, dhe ajo që u theksua këtu disa herë, dhe për mua ka rëndësi të veçantë, është, cila është mënyra më e mirë për të vënë melhem në varrën e madhe po e perseris, që po kullon. Për mendimin tim është e rëndësishme edhe reagimi i Kuvendit edhe krijimi i strukturave që u propozuan këtu edhe unë i mbështes ato dhe rregullimin me ligj i kësaj çështjeje. Mendoj që ne do duhej ta kishim kryer më shpejt këtë çështje, por mbi të gjitha është zgjidhja e çështjes së Kosovës, zgjidhja e dëshirueshme, e drejtë dhe e qëndrueshme, në përputhje me vullnetin e atyre për të cilët flasim, në përputhje me vullnetin e më të dashurve të tyre, në përputhje në fund të fundit edhe me vizionin që situata të tilla dhe fenomene të tilla të mos na ndodhin kurrë në Kosovë dhe të mos i ndodhin askujt.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Hydajet të faleminderit – Brikena Kryeziu, le të përgatitet Zylfije Hundozi

DEPUTETJA BRIKENA KRYEKZIU

Zoti kryetar, zoti ministër, kolegë deputetë, posaçërisht përshëndes dhe i falënderoj familjarët për durimin që patën gjatë kësaj periudhe. Si duket fati pas luftës ua ka imponuar që durimi të jetë i vetmi mjet për të qëndruar deri tash. Më vjen mirë që kjo çështje debatohet në Kuvendin e Kosovës dhe është çështje që më sjell përpara një përgjegjësie të veçantë, sidomos, para qytetarëve të komunës së Gjakovës që komunë konsiderohet se ka numrin më të madh të pagjeturve deri tash. Nuk dëshiroj të manipuloj shifra, nga ky numër një pjesë shumë e vogël i tyre është kthyer. Është një komunë në të cilën, vetëm në një fshat – në fshatin Meje- të Komunës së Gjakovës ka ngjarë një Srebernicë e vogël, dhe brenda pak orëve në oborrin e shkollës së fshatit janë ekzekutuar më se 400 meshkuj.

Një nismë e OJQ-ve dhe e qytetarëve të komunës është munduar që ta ngrinte zërin në maksimum me protestat e qeta për vite të tëra përpara institucioneve ndërkombëtare dhe atyre vendore, por, si duket në institucionet ndërkombëtare hasur në vesh të shurdhër. Kjo çështje negociohet nga eprorët e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq të cilët udhëheqin negociatën në mes të përfaqësuesve të Kosovës dhe të Serbisë për të pagjeturit dhe bazohet zakonisht në çështje humanitare. Këtu nuk është çështja për problemet humanitare, për të cilat duhet të debatohet dhe të ndihmojë ky asociacion i konsideruar si më i madhi në Botë. Ky problem është një problem politik, sepse ashtu konsiderohet dhe trajtohet edhe nga Qeveria serbe. Zvarritjet e kthimit të kufomave të ekspozuara, por edhe të pagjeturit, Serbia i përdor për qëllimet e veta të caktuara që ndryshe do t'i quaja monedhë kusuri ose manipulim i qëllimshëm. Këtë e bëjnë në

momentet kyçe në vizitat që i bëhen Beogradit disa ditë para vizitave të rëndësishme që t'i tregojnë opinionit ndërkombëtar se janë shumë humanë dhe i dërgojnë eshtrat e njerëzve, apo të kosovarëve në Kosovë. Kjo zakonisht ndodh kthimi i tyre ndodhë një numër shumë i vogël (20-30). Vetëm në rastin e fundit janë sjellë 64 persona, d.m.th. një numër më i madh. Nëse ndërkombëtarët nuk ndërmarrin asgjë për këtë çështje unë dëshiroj të di se si e konsiderojnë këtë veprim i cili është në kundërshtim me të gjitha normat humanitare në botë dhe ende vazhdon pa pasur ndonjë presion serioz. Ndoshta kështu ngjan për arsye të dërgesës së kufomave nga Kosova nëpër lokacione të ndryshme të Serbisë - një metodë unike e cila ka ndodhur apo nuk ka ndodhur në asnjë luftë që ka ngjarë deri më tash në botë. Mendoj se familjarët janë shumë korrektë dhe modestë në kërkesat e tyre. Ata vetëm kërkojnë kthimin e familjarëve të pagjetur në çfarëdo gjendje që janë trupat e tyre, prandaj është një kërkesë minimale e cila gjithsesi duhet të plotësohet shpejt dhe tërësisht derisa të mos jetë vonë. Trupi dhe mendja e njeriut i kanë kufijtë e qëndrësës dhe të durimit, prandaj as ndërkombëtarët e as vendorët që janë më pak të fuqishëm në këtë drejtim, nuk guxojnë të provojnë plasaritje të mundshme të popullit të cilat do t'i arsyetonte edhe opinioni botëror dhe për të gjitha këto jemi të vetëdijshëm se nuk do t'i shërbejnë rajonit dhe aq më pak Kosovës. Personalisht e ndiej peshën dhe urgjencën e këtij problemi madhor që po i qasemi sot në mënyrë mjaft serioze në organin më të lartë legjislativ të Kosovës. Sot nga kjo sallë duhet të del një kërkesë shumë e fuqishme dhe mirë e precizuar drejtuar në radhë të parë UNMIK-ut, Bashkësisë Evropiane dhe Këshillit të Sigurimit që ky problem detyrimisht të zgjidhet sa më shpejt. Duke mos dashur të anashkaloj iniciativat dhe bisedat që bëhen në nivele të komisioneve që kanë për temë njerëzit e pagjetur, kanë rëndësinë e vet për situatën e tanishme, zvarritjen e procesit, që do të ndikonin në zhvarrimin e procesit, zhvarrimin i cili do të humb kuptimin e vet. Nëse një gjë e tillë nuk ndërmerret nga institucionet ndërkombëtare, prandaj konsideroj vetëm një zgjidhje dhe këtë situatë shumë të rëndë do ta zgjidhë vetëm presioni shumë i fuqishëm i bashkësisë ndërkombëtare i cili direkt do të gjente zgjidhjen e problemit sa më shpejt dhe do të mundësonte jetën normale të të gjithë familjarëve të cilët fizikisht e kanë mbijetuar luftën, por pasojat e saj ende i mbajnë gjashtë vjet pas luftës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS:

Zylfije Hundozi le të përgatitet Enver Hoxhaj

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI

Zoteni Kryetar, Zoti ministër, deputetë, familjarë të personave të rrëmbyer. Në Kosovën e pasluftës çështja e personave të rrëmbyer nga forcat serbe gjatë luftës vazhdon të mbetet plaga më e rëndë që ka shoqëria kosovare. Ankthi dhe hidhërimi janë përqendruar sidomos te familjarët e personave të rrëmbyer, të cilët janë të pranishëm në çdo minutë të jetës për shkak të mosdijes për fatin e të afërmeve të tyre. Të gjitha familjet e personave të rrëmbyer, por edhe ne, nuk do të kemi jetë të rehatshme derisa nuk do të marrim vesh përfundimisht për fatin e tyre. Policia, njësitë ushtarake dhe ato paraushtarake, nën kontrollin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të autoriteteve jugosllave, janë përgjegjës për

shqiptarët të cilët janë rrëmbyer. Dëshmia PRIMA FACIEJ që doli nga varrezat masive në Serbi e vërteton këtë konkluzion. Publiciteti lidhur me varrezat masive, kontribuoi deri diku që të përgatitet populli serb për dorëzimin e Millosheviqit në Hagë, pas dorëzimit të tij publiciteti i dhënë pothuaj u zhduk plotësisht dhe autoritetet e Serbisë edhe pse deklaroheshin se janë demokratike dhe të ndryshme nga ato të Millosheviqit nuk ndërmorën asgjë për hetimin dhe ndjekjen penale të atyre që janë përgjegjës për vrasjet masive të shqiptarëve të Kosovës në vitin 1998-1999 edhe pse standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut i obligojnë shtetet t'i parandalojnë zhdukjet gjatë luftës dhe nxjerrin para drejtësisë ata që e kanë bërë këtë. Të vetmen gjë që autoritetet serbe bënë dhe janë duke bërë ishte dërgimi i kufomave të zhvarrosura në grupe të vogla duke e mbajtur kontinuitetin e pikëllimit dhe ankthit të familjarëve të personave të rrëmbyer dhe të gjithë neve. Autoritetet serbe e kanë vështirë të ballafaqohen me vetveten dhe të pranojnë se kanë bërë gjenocid në popullin shqiptar, por as bashkësia ndërkombëtare nuk ka bërë sa duhet trusni në ta, që fati i personave të rrëmbyer të zbardhet. Komisioni për Personat e Pagjetur vazhdoi punën për implementimin e Rezolutës të nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës duke bashkëpunuar vazhdimisht me institucionet vendore dhe me të huajat në Kosovë që pikat 2 dhe 3 të kësaj rezolute të aplikohen në çdo takim pune të këtyre institucioneve, por megjithatë fati i shumicës së personave të rrëmbyer mbetet ende i panjohur, pa marrë parasysh kompetencat rreth kësaj çështjeje institucionet vetëqeverisëse kosovare si edhe shoqëria në tërësi, nuk bënë të jenë indiferentë, por duhet të bëjnë trysni të vazhdueshme mbi Beogradin nëpërmjet bashkësisë ndërkombëtare, por edhe drejtpërdrejt, siç është precizuar dhe rekomanduar me Rezolutën. Nën dy, duhet dhënë ndihma materiale, psikologjike dhe juridike familjeve që presin të sqarohet fati i anëtarëve të tyre dhe kjo të bëhet në mënyrë institucionale. Nën tre, të ndërmerren masat për saktësimin e situatës juridike të personave të pagjetur për shkak të pasojave që i kanë anëtarët e familjeve të tyre rreth trashëgimisë dhe ruajtjes së autoritetit prindër. Nën katër, pjesëmarrja e ekspertëve kosovarë të mjekësisë ligjore, antropologëve në identifikimin e kufomave të gjetura nëpër varrezat masive dhe nën pesë, njëri prej rekomandimeve të Rezolutës që është nxjerrë nga ky Kuvend është që zyra e UNMIK-ut për personat e pagjetur të ngritë kallëzime penale për krimet e bëra në Kosovë nga ana e forcave serbe, por deri më sot ky rekomandim nuk u përfill. Nga puna e komisionit në terren dihet se ekzistojnë dëshmi dhe dëshmitarë të shumtë që tregojnë për kryerësit e krimeve, prandaj është më se e nevojshme që çështja e kallëzimeve penale të aktualizohet përsëri se ndoshta kjo do të jetë edhe çelës për përfundimit sidomos të rasteve që ende nuk dihet se ku ndodhen, kur hetimet fillojnë personat e përfshirë në krime do të jenë të detyruar të tregojnë se ku ndodhen personat, fati i të cilëve ende nuk dihet. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS:

Enver Hoxhaj ,le të përgatitet Kolë Berisha

DEPUTETI ENVER HOXHAJ

I nderuar zoti Kryetar, i nderuar zoti Ministër, të nderuar familjarë, të nderuar kolegë.

E kam ndërmend vetëm t'i përmend disa probleme në një formë shumë të shkurtër. Në fillim do të ndalesha në fjalën e kryeministrit dhe në termat e përdorur aty, dhe sidomos në konstatimin e tij që shpeshherë edhe këtë problem e ka shtruar edhe para instancave ndërkombëtare. Mendoj që shtrimi i çështjes të personave të pagjetur dhe e pengjeve të luftës është një çështje shumë imediate dhe duhet të shtrohet vazhdimisht, mirëpo nëse kryeministri për gjenocidin i cili ka ndodhur në Kosovë, e përdor fjalën tragjedi, mendoj që nuk është përdorim i duhur dhe përshkrim i situatës në formën më precize të mundshëm dhe nëse kryeministri mendon që çështja e personave të pagjetur sot është brengë, mendoj që përsëri nuk është reflektim i drejtë i një situatë të tillë. Në Kosovë ka ndodhur gjenocid dhe për të gjitha shoqëritë që janë ballafaquar me gjenocidin në periudhën e parë të tij, ka vetëm dy binarë, ai si është procesi i gjetjes të së vërtetës dhe jetësimi i drejtësisë, kështu që problemin të cilin e diskutojmë sot është kryesisht i natyrës politike, por mbi të gjitha edhe i asaj humanitare dhe mendoj se në të ardhmen do të duhej vërtet edhe si përfaqësues të institucioneve të Kosovës edhe si deputetë me terma precizë ta përshkruajmë situatën mjerisht precize të cilën e ka pasur Kosova gjatë viteve të kaluara. Mendoj që nuk duhet edhe aq shumë të dihet për atë se çfarë ka ndodhur në Kosovë. Ndoshta vetëm historia e një familje, siç është historia e familjes Berisha të Suharekës e konfirmon që në Kosovë ka ndodhur gjenocid. Kjo familje fillimisht është ekzekutuar që është shkelja e parë e dinjitetit, kjo familje mandej është varrosur dhe është zhvarrosur dhe kjo familje pas zhvarrimit, trupat e të ndjerëve janë bartur në Serbi. Këtu kemi të bëjmë me planifikim dhe asgjësim masiv të një familje dhe kemi të bëjmë me një qasje dhe sistematike, kryesisht politike, prandaj ne si përfaqësues të institucioneve të Kosovës çdo herë do të duhej, për mendimin tim, problemin e personave të pagjeturëve ose edhe të pengjeve të luftës, ta shtrojmë në kontekstin e gjenocidit të ushtruar mbi qytetarët e Kosovës. Më parë u tha se ne do të duhet të debatojmë rreth asaj se çka mund të bëjnë vërtet institucionet e Kosovës dhe unë do të synoj të reflektoj pikërisht në këtë frymë se çka do të mund të bëjnë institucionet e Kosovës. Mendoj që Qeverisa e Kosovës mund ta ketë një komision qeveritar shumë më operacional në punën e tij, mendoj që familjarët e personave të pagjeturëve nuk është dashur këta dy vjetët e fundit vazhdimisht informohen se si Komisioni nuk është operacional në punën e tij, se si kryeministri nuk është në gjendje t'i bindë as zyrtarët e kësaj qeverie të marrin pjesë në punën e Komisionit, dhe se si një gjendje e tillë të përshkruhet edhe nga vetë zonja e cila e kryeson Komisionin pranë Qeverisë, për të cilën kam respekt jashtëzakonisht të madh. Do të thotë kjo tregon për mungesën e kësaj qeverie që vërtet ta adresojë problemin e personave të pagjeturve. Aspekti i dytë është që në kuadër të grupeve të punës, në kuadër të dialogut teknik me Beogradin, ne vazhdimisht shohim se çdo muaj ka takime të grupeve punuese kur është fjala e kthimit të refugjatëve kosovarë serbë, ndërsa çdo tre muaj ka takime kur është fjala e kthimit të personave të pagjeturve. Për më tutje Grupi i Punës nga Kosova, siç u tha edhe më herët vazhdimisht takohet me ish-kryeshefin serb të regjimit të Millosheviqit për Kosovë me z. Velko Odaloviq. Mendoj që takimi i një grupi pune nga Kosova me z.

Odaloviq nuk është asgjë tjetër, veç një lloj shkelje, po ashtu e dinjitetit të viktimave të cilat ne e bëjnë si institucionet e Kosovës. Kërkoj, prandaj që Qeveria e Kosovës vërtet në një mbledhje të ardhshme ta kontestojë udhëheqjen e këtij grupi serb edhe nëse nuk mund të ndryshojë asgjë nga z. Odaloviq. Kërkoj që kjo të shtrohet edhe para institucioneve ndërkombëtare. Më herët u përmend po ashtu çështja se në çfarë forme kthehen eshtrat e të pagjeturve. Dhe forma dihet -në thasë dhe mendoj që nëse edhe më tutje e marrim përgjegjësinë e shkeljes së dinjitetit të viktimave, kthimi i tyre duhet ndodhë ashtu si janë kthyer viktimat në të gjitha vendet e botës në arkivole, mirëpo nuk do të duhej të vazhdohej me një formë të tillë. Këtu pat shumë fjalë lavdëruese për punën e UNMIK-ut dhe askush nuk i përmendi keqpërdorimet të cilat i ka bërë shefi i Zyrës për personat e zhdukur dhe mjekësi ligjore të UNMIK-ut Hoze Pavllo Barabar. Zotëriu në fjalë që nga viti 2002 deri në vitin 2004, kur është zbuluar afëra ka përdorur pjesë të trupit dhe pjesë të eshtrave të personave të pagjetur për qëllime trajnimit dhe për qëllime hulumtimesh shkencore në një universitet amerikan. Deri me tash institucionet e Kosovës nuk kanë reaguar ndaj një gjëje të tillë, në një formë të shkruar dhe mendoj që ky Kuvend do të duhej vërtet të kërkojë nga Qeveria e Kosovës që të paktën me një shkresë të tillë të reagojë ndonjë shkeljeje të tillë të dinjitetit. Historia e gjenocidit të Kosovës mund të përmblihet me një fjali të shkurtër Krimi është ushtruar nga një pakicë serbe, është përkrahur nga një shumicë serbe dhe në heshtje nga të gjithë. Ky debat sot ndoshta ka thyer heshtjen, mirëpo ky debat do të ishte në gjendje vërtet heshtjen ta mbizotëronte vetëm nëse institucionet e Kosovës sa më parë ta hartonin një plan operativ dhe një strategji, prandaj në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës kërkoj që Qeveria të zotohet që brenda disa muajve të ardhshëm qoftë në shtator, qoftë në tetor, qoftë edhe në nëntor ta kenë përsëri një seancë të na ofrohen strategji dhe plane konkrete se çka do të bëjë Qeveria e Kosovës të hartohen të gjitha strukturat e nevojshme qoftë në rrafshin qendror, qoftë në rrafshin komunal dhe ta kemi një datë edhe në vjeshtën e vonë, por ta kemi edhe një datë se kur vërtet do të përfundon zgjidhja e fatit të pagjeturve. Faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS:

Kolë Berisha , të bëhet gati Teuta Hadri

DEPUTETI KOLË BERISHA

I nderuari kryetar Daci, të nderuar familjarë të pagjeturve, kolegë deputetë të nderuar

Një farë çatipi i njerit nga pushtuesit tanë shumëvjeçarë, me rastin e tërheqjes një herë e përgjithmonë nga këto troje, vendësve u kishte thënë: "Ne po ikim nga ky vend i mallkuar, por, prapa po ua lëmë një plagë aq të rëndë, sa që dhembjet që do t'ua shkaktojë ajo edhe për një kohë relativisht të gjatë, do ta zëvendësojnë praninë tonë". Fatkeqësisht, e njëjta gjë u përsërit edhe sot me rastin e tërheqjes së pushtuesit të fundit - Serbisë. Tragjedia që këto ditë e goditi familjën Gashi nga Gremniku i Klinës, e në veçanti tema për të cilën sot po debatohet, është dëshmia më e mirë se pushtuesit janë pushtues. Ata një emër kanë, një gjuhë e flasin, një zeje ushtrorë dhe një qëllim synojnë: që të shkaktojnë sa më shumë dhembje, sa më shumë pikëllim. Është në traditën, në shpirtin e

tyre të sadistit, që edhe kur janë të detyruar të ikin ta lënë prapa siç thotë populli "tymin rrotull" ta lënë pas vetës plagën të hapur, që të mos mund t'i gëzohesh ikjes se tyre; që ti mos mund ta hetosh mungesën e tyre; që nga dhembjet e mëdha që i shkaktonte ajo plagë, ti të mos mund t'i gëzohesh fitores; të mos mund t'i gëzohesh lirisë, aq shumë të pritur, aq shtrenjtë të paguar gjatë shekujve. E kësaj lirisë sonë, do të thosha, të dozuar, ende ne vazhdojmë t'i paguajmë haraç të madh. U bënë gjashtë vjet nga përfundimi i luftës, e ne ende vazhdojmë të bëjmë varrime, zhvarrime, rivarrime të eshtrave të gjetur të fëmijëve tanë, të prindërve tanë dhe të afërmve tanë të tjerë. U bënë gjashtë vjet nga tërheqja e turpshme e makinerisë serbe të vdekjes, e ne, qoftë në ambiente të mbyllura, qoftë në ato të hapura, këtu në Kosovë, apo në diasporë, ende vazhdojmë të organizojmë mbledhje komemorative dhe akademi përkujtimore, të shënojmë përvjetorë mortorë, të hartojmë nekrologë e in memoriamë në shenjë nderimi, kujtimi dhe respekti të përjetëshëm për ata që na i mori lufta, për ata që kaluan në përjetësi.

U bënë gjashtë vjet nga përfundimi i luftës, e ne shqiptarët, pas myslimanëve fatzinj të Bosnjës, në Ballkan, ende vazhdojmë ta mbajmë primatin si vizitorët më të shpesh të lëndinave të lotëve.

Sepse, pushtuesit, këtij pushtuesit tonë të fundit, sikur nuk i mjaftuan më se 14.000 viktima shqiptarë, rreth 30.000 femra shqiptare të dhunuara, mbi 200.000 shtëpi dhe ekonomi të tjera familjare tërësisht të shkatërruara, dhe mbi një milionë shqiptarë të dëbuar jashtë trojeve të tyre, krejt këto sipas parimit:

- një të tretën duhet vvarë,
- një të tretën tjetër të duhet dëbuar jashtë kufijve, dhe
- një të tretën e tretë duhet detyruar të vdesë nga uria,

kurse pjesën që do të mund të mbijetojë, duhet ta shndërrojmë në barinj dhe shërbëtorë, sepse, këta janë të mirë, vetëm kur t'i kemi nën këmbë.

Por, pasi kësaj nuk ia doli ta realizojë, na e la të hapur edhe një tjetër plagë e cila, tash e gjashtë vjet, vazhdon të prodhojë ankth dhe të kullojë gjak: në tërheqje e sipër, eskadronet e vdekjes, i morën me vete, i kidnapuan rreth 4000 shqiptarë të të gjitha moshave, një pjesë prej tyre të gjallë, kurse pjesën tjetër të vvarë, për t'i varrosur në varreza masive në Batajnicë e gjetkë Serbi, përkatësisht, për t'i vendosur në kazerma ushtarake, larg mundësive të komunikimit, larg syve të botës, për ta fshehur krimin, por edhe duke i angazhuar në punë të detyruar.

E, ne, tash sa kohë, vazhdojmë të presim për të dialoguar tri herë në vit me Beogradin, për njerëzit tanë.

Ne tash sa kohë vazhdojmë të dalim në Merdare për t'i pritur eshtrat e të afërmve tanë. E ata na vijnë në rracione të caktuara. Na vijnë në kuota të dozuara. Na vijnë të parcializuar. Na vijnë grupe grupe, pjesërisht. Na vijnë në qese najloni, sepse kështu e ka paraparë kthimin e disa prej tyre shpirti sadist serb. Nuk i sjell të gjithë përnjëherë, qoftë edhe të vdekur, sepse, dhembjen e shkaktuar nga Millosheviqi, donë ta zgjasë sa me shumë që të jetë e mundur, Beogradi zyrtar postmillosheviqian.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në Kosovën e këtyre viteve, çdo temë që shtrohet për debat në institucionet vendore, siç është ky parlament, ose në ato ndërkombëtare (madje edhe atëherë kur, për shkak të rrethanave objektive, paraprakisht dihet se, rezultati i angazhimit tonë është baras me zero), megjithatë, vënia në rend të ditës e ka rëndësinë e vet, e ka peshën e vet, dhe natyrisht se, e ka edhe të veçantën e vet.

Me fjalë të tjera, në Kosovën e sotme, çdo gjë është prioritare, është çështje mbi çështjet, është temë mbi temat që kërkojnë zgjidhje të shpejtë.

Çështja që është shtruar sot për debat - çështja e të kidnapuarve, nëse jo e para, gjithsesi është ndër të parat që është dashur të shtrohet në këtë kuvend shumë me herët, madje dy-tri here deri më tani.

Është rrenë e kulluar nëse themi se mungesën e këtyre personave të pagjetur, e ndiejmë edhe ne njësoj si familjarët e tyre. Po të ishte kështu, edhe ne si vendorë, por edhe ndërkombëtarët, do të angazhoheshim më shumë dhe më herët në këtë drejtim. Ta vëmë dorën në zemër dhe ta pyesim secili prej nesh, se çfarë do të kishim bërë nga këto pozita që i kemi, po të ishim në lëkurën e ndonjërit nga ata të cilët e kanë humbur djalin e vetëm - vëllanë e nëntë motrave, apo prindin, djalin, vëllanë etj? Sa prej nesh, u ndalem për një çast të rrethojat e këtij kuvendi që t'ua hedhim një sy atyre portreteve, atyre fytyrave që sikur kërkojnë ndihmë nga ne që t'i tërheqim nga ajo tokë e djallit dhe, të gjallë apo të vdekur, t'i sjellim këtu në token e shenjtë të Kosovës?

Megjithatë, edhe pse me një vonesë vërtet të pajustificueshme, më në fund, jemi sot këtu, për të debatuar për njërin prej çështjeve sa të ndjeshme, po aq edhe të dhembshme; për të debatuar për njërin ndër plagët tona më të mëdha që la politika shfarosëse e garashaninëve e ekzekutuar nga Millosheviqi dhe e vazhduar pikë për pikë, në mënyrë autentike nga Koshtunica, Tadiqi, Drashkoviqi dhe të tjerë si këta sot; jemi sot këtu për të debatuar për një pjesë të trungut tonë, për një pjesë të qenies; për të debatuar për ata të cilët, gjashtë vjetë më parë, nga kanibalët mesjetarë serbë të fundshekullit XX, u kidnapuan në shtëpitë e tyre, u morën me dhunë në arë, në livadh, apo në mal, duke u fshehur nga rrebeshet e automatikëve të soldateskës me të ndytë të shekullit, dhe nga thikat e paramilitarëve më gjakpirësë të kohës.

Tua them të drejtën, kur në Kryesinë e Lidhjes Demokratike të Kosovës, morëm qëndrim unanim që, përmes shefit të grupit tonë parlamentar, z. Gashi, t'i propozohet Kryesisë së këtij Kuvendi, që për këtë seancë plenare, të vihet në rend të ditës për debat çështja e të pagjeturve, nuk kishim iluzion se ky Kuvend do mund të gjejë ndonjë formulë magjike, sipas të cilës do të mund të shërohej, ose të zbutej sadopak kjo plagë e cila, edhe gjashtë vjet pas luftës, vazhdon të pikojë mall, të pikojë, dhembje, të pikojë ankth, të pikojë lot dhe gjak.

Personalisht kam menduar që, debati i cili do të zhvillohet sot këtu, në mos asgjë tjetër, të fokusohet në dy çështje: së paku, të jetë edhe një vaj yni kolektiv, por kësaj radhe, i zëshëm dhe institucional; të jetë një vaj parlamentar; të jetë një bashkëvajtje yni me familjarët të të pagjeturve; të jetë vaj i përbashkët me fëmijët të cilët, tash gjashtë vjet presin prindërit e tyre, një bashkëvajtje me prindërit të cilët edhe sot, gjashtë vjetë pas përfundimit të luftës, presin kthimin e bijve të tyre.

Por, po ashtu kam menduar sa ja vlen që, secili prej nesh t'ia bëjë një pyetje vetes: a kemi mund të bënim diçka më shumë në shërimin e kësaj plage kaq të rëndë?

Si njëri nga ata që ka pasur takime të shumta me familjarët e të pagjeturve dhe që me vëmendje ka dëgju dhe shumë rënd i ka përjetuar rrëfimet e tyre tronditëse, mendoj se nuk kemi bërë aq sa duhet. Si mund të arsyetohet fakti se, edhe sot, gjashtë vjet pas përfundimit të luftës, ne as si institucion e as si familjarë, nuk dimë asgjë, ose dimë fare pak për fatin e këtyre fatmjerëve. Nuk dinë komisionet tona, qofshin ato të vendit, apo ato mikste. Nuk di Kuvendi. Nuk di Qeveria. Nuk di Kryqi i Kuq i Kosovës. Nuk di ai ndërkombëtar. Nuk di, madje as, UNMIK-u, si i vetmi sovran që qeveris Kosovën. Nuk dimë, sepse, bashkësisë ndërkombëtare i mungon një Josip Vrhovec, i cili, në vit 1989, duke alarmuar botën, i shpëtoi nga mbytja me dajak nëpër kazamatet serbe 238 izolantë shqiptarë.

Ne, më në fund, duhet ta pranojmë se, çështja e të kidnapuarve është çështje thjesht politike. Ata vazhdojnë të mbesin peng i statusit të Kosovës. Beogradi zyrtar, duke i konsideruar si heroj për masakrat në Bosnjë, edhe sot, dhjetë vjet pas masakrës së Srebrenicës, u ofron mbrojtje, i fsheh dhe nuk i dorëzon në Hagë kriminelët e luftës. Klika millosheviqiane e mbetur në pushtet, nuk ofron të dhëna për njerëzit e kidnapuar, për të cilët dyshohet se ka edhe të gjallë. Ata që i kidnapuan, nuk ishin nga marsi ose nga ndonjë planetë tjetër: ata ishin udhëheqësit e garnizoneve ushtarake dhe të stacioneve policore në Kosovë. Ata janë përgjegjës për marrjen e tyre. Ata dinë se ku janë sot të afërmit tanë. Problemi është fare i thjeshtë, sepse adresa e kriminelëve të cilët i kidnapuan të afërmit tanë, na janë të njohura edhe neve në Kosovë, edhe atyre në Serbi. Problemi është se, nuk ka angazhim të fuqishëm dhe të drejtpërdrejtë. Janë caktuar për kontakt, njerëzit nga UNMIK-u që nuk kanë autoritet, nuk kanë dije dhe janë të papërgjegjshëm.

Prandaj kërkojmë që ky debat i sotëm të mos jetë vetëm monolog ndërshqiptar, por të jetë një grishje e ndërgjegjes së atyre të cilët, gjashtë vjet më parë, në emër mbrojtësve të vlerave të civilizimit kudo në botë, në emër të humanizmit dhe të njerëzores, duke intervenuar gjashtë vjet më parë kundër makinerisë ushtarako-policore dhe paramilitare të regjimit më të egër në Evropën e fundshekullit XX, nga e cila, edhe sot gjashtë vjet pas luftës, gjejmë vdekjen fëmijët tanë, e shpëtoi nga zhbërja totale këtë pjesë të popullit shqiptar, do të ndërmarë hapa konkretë, duke emëruar një emisar special nga rangu më i lartë i OKB-se për të ushtruar presion të drejtpërdrejtë mbi Beogradin zyrtar, që t'i kthejë në Kosovë të kidnapuarit, ose të ngrihet në Tribunalin e Hagës, kundër Koshtunicës, Tadiqit dhe stafit të tyre, për vepër penale - fshehjen, përkatësisht mosdorëzimin e kufomave të vjedhura dhe, për mbajtjen në fshehtësi të personave të kidnapuar, për të cilët dyshohet se janë gjallë. Në të kundërtën, në Kosovë, nuk mund të ketë qetësi. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Teuta Hadri le të përgatitet Nekibe Kelmndi

DEPUTETJA TEUTA HADRI

I nderuari z. kryetar, të nderuar deputet.

Para se ta marr fjalën kisha një vërejtje teknike e them për sekretarinë që herave të tjera mos vepronë ashtu siç po vepron vazhdimisht, se kërkuesit e fjalës që e marrin fjalën është të renditen ashtu sipas dorëzimit të fjalës e jo ditën e dytë njerëzit inspirohen nga takimi ose mbledhja e sotme dhe ta marrin fjalën siç po ndodhë që shumë njerëz që i parqiten sot kërkesat dulen para nesh edhe u veprua kështu që edhe personat që kanë munguar këtu, po dalin po dalin përsëri para nesh. Ju faleminderit.

Është për të ndier dhimbje se sot pas një viti po në tën njëjtën kohë, në fund të korrikut, sikur vitin e kaluar, në mbledhjen e fundit të datës 28. 29 dhe 30 korrik Kryesia pat propozuar si pikë të rendit të ditës çështjen e të zhdukurve, por për çudi kjo pikë aq e rëndësishme dhe e ndieshme për Kosovën dhe për politikën e saj mbet si pikë e -19- të e rendit të ditës dmth. pikë e fundit, por kjo nuk kaloi pa u kritikuar nga deputeti i PDK-së zoti Berat Luzha që kjo pikë të mos mbetet si pikë e -19-të, por të renditet në pikën e parë të rendit të ditës si pikë e një rëndësie të veçantë. Përkrahje dhe mbështetje nuk gjeti nuk gjeti as nga kryetari i Parlamentit e as nga Kryesia. Nuk mund të kuptoj edhe sot se Kryesia e Kuvendit të Kosovës për këtë çështje të të zhdukurve a ndien i imbje, a ndien përgjegjësi apo bëjnë marketing politik. E them këtë se juve zoti kryetar është fakt dhe po flasim sot me fakte se në atë mbledhje kundështuat duke quajtur marketing politik. Të nderuar deputetë, sot debatojmë përsëri pas një vjeti, para pushimeve vjetore, veç sa nuk qajmë nga dhimbja e pastaj shkojmë në pushim freskohemi, rrezitemi dhe bëjmë konkurrencë se kush ka shkuar në pushim dhe vende më të shtrenjta, e vjen shtatori përsëri na gjen me pika të pakonkluduara dhe të papërfunduara. Kaluan gjashtë vite e asnjë qëndrim nuk u muar për të zhdukurit, bile çështja e të zhdukurve as nuk u kushtëzua për të hyrë në bisedime me Beogradin. Këtij parlamenti nuk iu mundësua asnjëherë të bëjë propozimin e rendit të ditës, rendi i ditës me fanatizëm caktohet vetëm nga kryetari dhe Kryesia. E mbaj mend se vetëm një herë nga ky arlament, vitin e kaluar, kur u propozua rendi i ditës nga deputetët e Parlamentit vetëm atëhere kur Kryetari dhe Kryesia kishin marrë vërejtje nga OESC-ja për shkelje procedurash. Është për çudi, është fakt zoti kryetar. Kryetarja e Komisionit për çështje të të zhdukurve, zonja Flora Brovina kishte bërë kërkesë me shkrim në Kryesi dhe kishte kërkuar disa herë nga Parlamenti që të shqyrtohet kërkesa e saj për të zhdukurit, që u vonua disa muaj, por mezi pas 5-6 maj në fund të korrikut të vitit të kaluar doli. Kjo shtyrje nuk ndodhë me deputetët e grupeve të tjera parlamentare, por kërkesat e tyre miratohet shumë shpejtë për seancat e menjëhershme, kjo shihet qartë edhe sot. Propozimi i kësaj pike pa u përgatitur mirë për debat, duam në rend dite pa u pyetur komisionet përkatëse që u takojnë e as deputeti në Parlament as nuk kemi marrë ndonjë material informues rreth kësaj pike kaq të dhimbshme për Kosovën. Çka të debatojnë deputetët kur s'kanë marrë asnjë material rreth kësaj pike ose vetëm të duartrokasin si zakonisht në gallomaninë psiopateske të ideologjisë partiake. A nuk është ky një marketing politik, z. kryetar?

Ju vet z. kryetar vitin e kaluar në mbledhje keni shtyrë këtë pikë të rendit të ditës dhe keni penguar propozimin e deputetëve të partive të tjera, duke thënë se për këtë pikë duhet përgatitur- siç tha z. Flora hajt pak. E sot pse me aq nguti dhe me urgjencë, kur ju dhe Kryesia e Kuvendit në momentin e dhunës dhe të maltretimit të nënave tona, nënave të zhdukurve që protestonin vitin e kaluar u rrahë nga policia e UNMIK-ut nuk e pat të

arsyeshme të veprohet me urgjencë dhe të hyhet në rend dite e të debatohet për sjelljen e policisë ndaj nënave.

Të nderuar deputetë. Edhe sot turpërohem, skuqem nga qyqarllëku i këtij Parlamenti ,që nuk pat guxim të marrë vendim për këtë. Nënata e të zhdukurve nuk i mbyllën rrugët kyçe të Kosovës, as urdhëratë, ato protestuar për kërkesat e tyre legjitime. Kërkuar të drejtën elementare të njeriut çka është një prej standardeve për t'u plotësuar. Besoj edhe po t'ju pyesim juve z. kryetar dhe kryeministrinë që fatkeqësisht nuk është këtu se në cilin komision është çështja e të zhdukurve ku i përket, nuk do të dini të përgjigjeni se me çështjen e të zhdukurve kush merret. Komisioni i formuar nga Qeveria , zyra e të zhdukurve , grupi punues për bisedime me Beogradin ose zyra e UNMIK-ut. Asnjëri nga këto nuk u miratuar në këtë Parlament të Kosovës si organ legjitim i qytetarëve të Kosovës, i zgjedhur me votën e tyre. A është demokraci kjo? Për të zhdukurit, gjatë këtyre gjashtë vjetëve ,pjesa më e madhe e varrezave u zbuluan dhe u hapen nga vetë familjarët e të zhdukurve që me forcë hapen varrezat për t'i rivarrosur të dashurit e tyre, e shumë pak u punua nga zyrat e UNMIK-ut. Edhe ju z. kryeministër më vjen keq që s'je këtu dhe dëgjon, por ndëgjon përmes mjeteve të informimit me siguri. Vitin e kaluar si deputet që ishit atëherë ne emër të grupit tuaj keni thënë në mbledhjen e fundit të korrikut se ne kuptojmë vullnetin e deputeteve për ta shprehur çështjen e të zhdukurve dhe keni thënë se duhet kihet parasysh se është aq njerëzore dhe aq e dhimbshme sa që nuk lejon asnjë lloj politizimi. Pse sot këtë çështje ju vet z. kryeministër e politizoni dhe vetë si në përfundim të fjalës tuaj keni thënë se Grupi parlamentar i juaj propozon të vihet menjëherë në votim dhe konkluzionet e propozuara nga komisioni përkatës të përfundojnë. Prandaj z. kryeministër kjo që bëni ju sot është një fushatë që bëni se e keni parandicë kjo Qeveri, duhet të pranuar se po dështon. Kudo në botën demokratike ku ka civilizim politik, demokratik të gjitha këto dështime dhe gabime që ka bërë dhe po bënë Qeveria duhet të pranuar me qetësi politike dhe Qeveria të tërhiqet. Ky parim i tërheqjes matet dhe vlerëson shkallën e nivelin politik të klasës tonë politike. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Nekibe Kelmendi, le të përgatitet Fehmi Vula

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI

I nderuari z. kryetar, të nderuar të gjithë të pranishëm. Në veçanti të respektuar dhe të nderuar familjarë të viktimave. Për këtë pikë të rendit të ditës, që është aq e dhimbshme dhe aq madhore për popullin tonë, do të duhej të sillemi si parlamentarë e jo si opozitë ose si pozitë..për fat të keq kjo nuk po ndodh. Është për të ardhur keq se disa deputetë, duke diskutuar për një temë kaq të dhembshme e kaq të ndjeshme, foltoren e këtij Kuvendi po e keqpërdorin për marketing politik, madje, edhe për të kërkuar rrëzimin e Qeverisë. Emocionet e mia që kam për familjet e viktimave të luftës, sidomos për familjen e personave fati i të cilëve ende nuk është zbardhur, nuk ma mundësuan që fjalimin tim ta përpilojë dhe ta radhis më mirë, sepse sot nuk flet vetëm mendja ime, por edhe zemra ime. Përvoja e mëhershme ka treguar se regjimi i Beogradit, jo vetëm që bëri

masakra e gjenocid , tragjedi familjare ndaj popullatës shqiptare,por ai diti edhe të manipulojë me kufomat e masakruara me të vetmin qëllim që ta fsheh krimin dhe të mos përballet me përgjegjësi penale e politike. Këtë e ilustron më së miri rasti i manipulimeve me kufomat e masakrës së Reçakut ,që kam pasur rastin ta shoh me sytë e mi, jo vetë unë ,por edhe bashkëshorti im i ndjerë. Me këto kufoma u manipulua asisoj që refuzohej dorëzimi i përnjëhershëm i tyre, me qëllim që civilëve të pafajshëm që u masakruan në këtë masakër duke ua veshur në trup të vdekur kufomat e UÇK-së dhe të paraqitet rrejshëm fakti se ushtria me ushtri luftoi dhe se viktimat e Reçakut janë viktima ushtri me ushtri.

Këtu u fol shumë rreth termit që do të ishte më i përshtatshëm për të përdorur për personat për të cilët po bisedojmë. Nga këndvështrimi penalo-juridik ata edhe mund të quhen pengje, por vetëm me kusht nëse janë marrë të gjallë, sepse epilogu i pengut mund të jetë lirimi, plagosja ose vrasja. Mirëpo të zhvarrosen të varrosurit, siç është rasti me kufomat e fshatit Izbicë e të shumë fshatrave të tjera dhe të dërgohen ato në varrezat masive në Serbi ose të hidhen në furrat e minierave serbe, është dallim thelbësor nga marrja e pengjeve, fati i të cilëve ende nuk është zbardhur.

T'ju them të vërtetën, pasi që burrin dhe dy fëmijët e mi i kidnapuan nga shtrati i fjetjes në shtëpi dhe i ekzekutuan vetëm dhjetë minuta pas kidnapimit , puna e parë që e bëra unë si viktimë që çlirimin e Kosovës e prita në një dhomë 20m² pa dritë natyrore, ishte të shkoj drejt në varreza për t'i verifikuar a i kanë zhvarrosur dhe i kanë marrë kufomat e tyre nga vendi ku unë i varrosa dhe ai i kanë dërguar në Serbi. Kjo tregon se sa janë të mëdha dhimbjet dhe vuajtjet e nënave,të baballarëve, të motrave dhe vëllezërve për persona për të cilët sot po bisedojmë .Nga kjo po del se dhembja ime pothuajse është më e vogël se dhembja e tyre.

Në as sot e kësaj dite nuk kemi të dhëna të sakta dhe fakte të vërtetuara nëse të gjithë personat, fati i të cilëve deri më sot nuk është zbardhur si dhe i atyre që u kthyen në qese të plastikës, u dërguan në Serbi të gjallë dhe atje u vranë, u dërguan si kufoma ose ende diku janë të gjallë në ndonjë burg që për fat të keq ende nuk është identifikuar ose zbuluar.

Personalisht deri sa isha bashkë drejtuese e Departamentit të Drejtësisë për Persona për fatin e të cilëve po diskutohet, u kam shkruar letër të gjitha institucioneve relevante ndërkombëtare,(kjo ka qenë në vitin 2000 e 2001) organizatave të ndryshme humanitare, por kam shkruar edhe artikullin në shtypin tonë të përditshëm. Në këto letra dhe shkrime gjithmonë e kam potencuar faktin se Beogradi zyrtar dorëzimin e kufomave të identifikuara po e bënë në mënyrë të dozuar si terapi të mjekut, duke politizuar këtë çështje sa humanitare aq edhe politike. Është për të ardhur keq që bashkësia ndërkombëtare nuk i ka kushtuar rëndësi më të madhe çështjes së personave për të cilët sot po diskutojmë, krahasuar me rëndësinë që ia ka dhënë ngjarjeve më 17 marsit 2004, të cilat të gjithë i kemi gjuar, por me gjasë këto ngjarje sikur i lanë anash gjenocidin që u ushtrua ndaj popullit tim dhe mos zbardhjen e fatit të personave, për të cilët me dhembje të madhe sot po diskutojmë .Pra, zgjerimi i pilot-projekteve, për një zyrtar shumë të lartë të bashkësisë evropiane është më i rëndësishëm se sa fati i personave për të cilët sot

po diskutojmë këtu. Do të ishte një veprim i qëlluar i drejtë dhe me bazë po qe se UNMIK-u do të kërkonte nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së dhe nga tërë bashkësia ndërkombëtare që ta detyrojnë Beogradin zyrtar me kërcenim të vendosjes së sanksioneve në vend të favoreve që po i bëhen që çështjen e këtyre personave ta zbardhë sa më parë ,që të identifikuarit t'i kthejë përmjetherë e jo në mënyrë të dorëzuar .Pra, në rast se s'ka ka të gjallë menjëherë t'i tregojë varrezat e tjera masive për të cilat publikisht dhe zyrtarit ka pranuar se ekzistojnë, në mënyrë që kufomat nga ato varreza masive të identifikohen dhe t'i dorëzohen Kosovës për të cilën u flijuan. Në të kundërtën, po qe se Beogradi zyrtar nuk do të veprojë kësisoj ose nuk do të ndërmarrë diçka nga këto faktorë relevantë, Këshilli i Sigurimit dhe bashkësia ndërkombëtare për mosveprimin e Beogradit lidhur me personat për të cilët po diskutojmë ,do të duhej të konsiderojë si refuzim të bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës, sepse fshehja e tyre nuk është asgjë tjetër, por shmangie nga përgjegjësia penale dhe politike. Për këtë qëllim propozoj që ky Kuvend të nxjerrë edhe një rezolutë në, sot të cilën do të duhej të përfshihej një pjesë e sugjerimeve të mia.

Neve, sot na nevojitet kthimi i personave për të cilët po diskutojmë, të gjallë ose të vdekur. Kjo do të ishte zbardhje e vërtetë e fatit të tyre, ndërsa kthimi i kufomave do të dëshmojë më së miri se pothuajse dorëzimi i tyre po na shndërrohet në gëzim në vend të pikëllimit ,se ata persona po i marrin të vdekur. Dhe në fund dua të them se atë që regjimi i Beogradit e bërë ndaj popullit tim, nuk dëshiroj t'i ndodhë as armikut tim, por është më se e vërtetë se ajo kurrë nuk ka për t'u harruar. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit Nekibe, Fehmi Vula, le të përgatitet Ferid Agani.

DEPUTETJA FEHMI VULA

Z. kryetar, z. ministër, deputetë dhe familjarë të nderuar.

Këtë problem është dashur ta zgjidhë Kryqi i Kuq i Kosovës me anën e Shërbimit të kërkimeve sikur të ishin kushtet normale në një shteti normal. Shërbimi i kërkimeve të Kryqit të Kuq është i formuar qysh në vitin 45-ë dhe s'është shumë i aftësuar për t'i kryer këto punë. Nuk kreu asgjë në këtë drejtim për shkak të pamundësive të tija, s'kishte me ke të bashkëpunojë. Kur e pyetëm Kryqin e Kuq në Beograd ,ata na u drejtuan : Është problem Qeverie dhe ne nuk kemi qasje në këtë,kështu që në këtë drejtim mbetëm shumë sufficientë dhe ndihmuam vetëm në përpilimin e tri edicioneve të librave të njerëzve të zhdukur, edhe aty ngeli i gjithë aktivitetit i Kryqit të Kuq, fatkeqësi për ne. Nuk e pranoj për arsye se gjatë luftës nuk u përfillën asnjë nga kodet e detyruara çfarë janë: konventat dhe protokollat, të drejtat e njeriut, por këtë e vazhdoi edhe pas luftës. Pas luftës njëri prej problemeve kryesore që humbi aftësinë e humanizmit ishte se si të shpjegohet ndryshe kur 900 kufomat të- ekshumuara gjatë katër vjetëve nuk janë në gjendje t'i kthejnë më shumë se 50 e diçka % . Me të drejtë mandej përmendim dhe themi se mbajtja

e kufomave është një monedhë kusuri e Serbisë ,që kolegët më përpara e përmendën dy - tri herë.

Për të bërë një krahasim çfarë kemi ne e çfarë janë zotërinjtë në Serbi. Pas luftës së dytë botërore më se 25 vjet në hyrje të qytetit të Kragujevcit ka ekzistuar një pano e madhe ku ka shkruar qytetarëve Gjermanë nuk ju sigurohet jeta në këtë qytet, në atë kohë as Qeveria e Titos as Bashkësia ndërkombëtare nuk reagoi ndaj kësaj embargo. Ne në Kosovës asnjëherë nuk e shkuam një gjë të tillë, dëshirojam që në kuptim të vërtetë t'i përmbushim standardet tona. Kisha fatin që para dy jave të takohem vetë i treti me z. Kai Eide përveç shumë të tjerave i thashë edhe diçka në këtë drejtim, i thashë se nënat tona nuk kanë pyeture asnjëherë në takimet e shpeshta që unë kisha me to në cilësinë e kryetarit të Kryqit të Kuq të Kosovës, nuk pyetën asnjëherë kush ma vrau djalin, pse ma vrau djalin ose të kërkojnë ndonjë dëmshpërblim , kërkuam vetëm një gjë" Ma ktheni djalin në çfarëdo gjendje të jetë ai ose mbetjet e trupit të tij. Mendoj se është një minimumi i kërkesave të cilat Kosova e sidomos Bashkësia ndërkombëtare detyrimisht duhet ta plotësojë edhe atë drejtë dhe shpejtë.

Aspak nuk kam besim në grupet e negociatave, pas formimit të grupit të negociatave në Beograd - Prishtinë, kryetarja e Zyrës së Komitetit ndërkombëtarë pyet për mendimin tim i thashë se është mirë negociojmë por unë nuk kam besim në këto. Fatkeqësisht në takimin e fundit që kishim në Prishtinë unë isha anëtar pa të drejtë fjalën në këtë grup dhe u binda se rezultatet e këtyre bisedimeve do të jenë aq insuficiente aq të gjata sa do të na qojnë në pakufi. Për atë mendoj se ne përveç Rezolutës duhet t'i bëjmë edhe dy gjëra:

Së pari në nivelet më të larta të bisedimeve që do të ngjajnë në mes të Prishtinës dhe Beogradit bashkëbiseduesve duhet t'i kushtëzohet që para se gjithave duhet të plotësohet ky kusht që ata të cilët janë gjet ata të cilët duhet të eksumohen pa tjetër të kryejnë shpejtë dhe drejtë dhe kjo brengë jona të hiqet nga rendi i ditës, natyrisht kjo deri tash nuk u përmend ajo që patjetër do të përmendim më vonë e asnjë moment nuk u apostrofua problemi i Maqkaticës që është shumë problematikë prej të gjitha varrezave tjera.

E dyta nëse në këtë drejtim nuk intervenon Bashkësia ndërkombëtare me një veprim të shpejtë dhe të drejtë unë mendoj se kjo punë ky detyrimi yni do të ngec gjatë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Ferid Agani, le të përgatitet Fatmire Kolçaku

DEPUTETI FERID AGANI

I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuar ministër dhe të nderuar deputetë dhe familjarë të pengjeve të luftës dhe të personave të pagjetur.

Sot e kësaj dite çështja e pengjeve të luftës dhe të personave të pagjetur paraqet plagë të hapur të shoqërisë kosovare, plagë që gjeneron ankth, dhembje, pikëllim të papërfunduar, zemërim, mosbesim dhe pasiguri për të ardhmen. Shumë herë kam pasur rastin që të bisedojë me këta familjarë dhe çdo herë kjo ka paraqitë sfidë të veçantë profesionale dhe njerëzore për mua. E mijëra familje të dëshpëruara dhe gjashtë vjet pas kryerjes së krimit çdo ditë ia shtojnë vetes pyetjen se kur do të përfundojë kjo gjendje e padurueshme për këta.

Administratë ndërkombëtare dhe institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë dhe gjashtë vite pas përfundimit të terrorit të organizuar shtetëror dhe gjenocidit në Kosovë nuk kanë arritur që të kthehen në Kosovë me mijëra trupa të viktimave të pafajshme që ende dergjen në institucionet mjeko ligjore dhe në varrezat masive në Serbi. Shtrohet pyetja si ishte e mundur kjo situatë të tolerohet kaq gjatë, si u bë që administrata e UNMIK-ut me mandat të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara organi më të lartë vendimmarrës në politikën ndërkombëtare për gjashtë vjet nuk ishte në gjendje që të ndërkrejë tregtinë e pandershme politike të shtetit Serb me trupat e pajetë të Shqiptarëve dhe të ndërpres këtë krim që në literaturën bashkëkohore juridike quhet krim në vazhdimësi. Me këtë dëshmohet se ky problem madhor përpos dimensionit të padiskutueshëm humanitar, politik e ka edhe dimensionin juridik, s'i shmanget përgjegjësia penale siç e tha deputetja Kelmendi por edhe si krim në vazhdimësi ndaj familjarëve të viktimave, veçanërisht në aspektin psikologjik. Mendoj se këtij dimensionit juridik duhet kushtuar vëmendje më të madhe nga ana e Qeverisë dhe ekspertëve të kësaj lëmi.

Angazhimi i kësaj administrate në vitin e fundit nën udhëheqjen e z. Petersen është dëshmia më e mirë se për këtë çështje gjatë mandateve paraardhësve të tij ka mund të bëhet shumë më tepër.

Situata psikologjike me familjet e të pagjeturve të kombësive të tjera të Kosovës është njëjtë shumë e rëndë. Nëse diç mund të ngushëllojë këto familje është fakti se institucionet demokratike të Kosovës gjithnjë janë distancuar nga krimet individuale që kanë mundur t'i kryejnë gjatë luftës në Kosovë dhe janë përpjekur që në kuadër të kompetencave të tyre të kufizuara të zbardhin fatin e personave të zhdukur.

Të nderuar deputetë. Kjo situatë ka pasoja serioze për shëndetin e popullit të Kosovës. Traumata e përditshme psikologjike dhe veçanërisht traumat që ndodhin me rastin e kthimit dhe rivarrimit të më të dashurve nëpër të cilin kanë kaluar dhe janë duke kaluar ose do të kalojnë familjet e 3815 pengjeve të luftës dhe të pagjeturve të Kosovës paraqet ngarkesë teje të rëndë psikologjike me pasoja evidente që janë dëshmuar edhe me hulumtimet e shumta. Në këtë rast do të përmendi vetëm një studim të bërë nga ekspertët e shërbimit shëndetit mendor të Gjakovës prej nga një e katërta ($\frac{1}{4}$) e të gjithë pengjeve të luftës në Kosovë vijnë. Në periudhën e kthimit të trupave të pajetë nga Serbia, numri i klientëve me çrregullim të stresit post reumatik që paraqet pasojë më të rëndë të traumave psikologjike u shtua për 80% krahasuar me vitin paraprak 2002. Kjo rritje dëshmon seriozitetin e plotë të situatës në këtë aspekt. Deri në muajin maj të vitit 2003 katër vjet të plotë pas ngjarjeve tragjike në Gjakovë nuk është kthyer asnjë trup i

pajetë i pengjeve të luftës, ky fakt e dëshmon arsyen e përdorimit të termit pengjet e luftës, sepse shumica e tyre nuk ishin të pagjetur nga autoritetet Serbe, ata ishin të gjetur por trupat e tyre të pajetë mbaheshin ashtu siç vazhdojnë të mbahen edhe sot nga autoritetet e shtetit serbo malazeze për qëllime të qarta politike.

Situata ishte e ngjashme edhe në viset e tjera të Kosovës, tek në maj të vitit 2003 autoriteti Serb e fillojnë që në grupe të vogla prej 29 deri 43 të kthejnë në Gjakovë trupat e pajetë të zbuluar nga varrezat masive të Batanicës 1 dhe 2. Në shumë raste familjeve që kishin më shumë anëtarë të zhdukur u kthehej vetëm nga një trup i pajetë në çdo grup. Moshë që më së shumti u prek çrregullimi i stresit postraumatik ishin moshë të reja 20 / 40 vjet ndërsa në këtë periudhë disa ditë pas rivarrimit të trupave të pajetë u shënuan edhe 2 raste të vetëvrasjeje në mesin e familjarëve. Në rast se vazhdohet me ritmin e tanishëm të kthimit të kufomave atëherë ky proces i rëndë i traumave do të zgjasë edhe shumë vite duke shkaktuar pasoja të rënda të pakthyeshme për shëndetin e familjarëve veçanërisht të fëmijëve dhe të rinjve. Në ndërgjegjen e atyre që kanë pasur mundësi dhe kanë mundësi të parandalojnë këto zhvillime qëndron barë e rëndë e përgjegjësisë morale ndërsa ndërprerja e kësaj zhargitje të qëllimit të autoriteteve Serbe do të duhej të paraqiste standard para të gjitha standardeve për administratën ndërkombëtare që është prezent në Kosovë.

I nderuari kryetar i Kuvendit, Partia e Drejtësisë propozon që Kuvendi i Kosovës në fund të këtij debati të nxjerrë Rezolutë të re me të cilën nga Administrata Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara në Kosovë do të kërkojë që të paraqes kërkesë para Këshillit të Sigurimit dhe të Kombeve të Bashkuara për kthimin urgjentë dhe të njëkohshëm të trupave të pajetë të shqiptarëve nga ana e shtetit Serb duke e ngritë këtë kërkesë në nivelin e njëjtë politikë me kërkesën e të cilit Bashkësisë Ndërkombëtare është duke ia bërë Serbisë për dorëzimin e kriminelëve të luftës Milladiq dhe Karaxhiq.

Gjashtë vite pas luftës në Kosovë Bashkësia Ndërkombëtare dhe institucionet e Kosovës duhet të disponojnë me resurse të mjaftueshme financiare dhe profesionale që procesi i mëtutjeshëm i identifikimit të viktimave të pafajshme të bëhet në Kosovë dhe të mos vazhdojë më në Serbi. Më lejoni që me këtë rast t'ju drejtohem edhe përfaqësuesve të institucioneve të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë të kërkojë dorëzimin e kriminelëve të luftës nga shteti Serb dhe të mos kërkojë njëkohësisht dorëzimin e menjëhershëm të trupave të pajetë të viktimave të tyre me të cilat i njëjti shtet në mënyrë të paskrupullt vazhdon të manipuloj paraqet veprim të mangët politik dhe padrejtësi të madhe. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT Daci:

Ju faleminderit, Fatmire Kollçaku, le të përgatitet Ramë Buja, e pastaj shkojmë në pauzë.

DEPUTETJA FATMIRE KOLLÇAKU

Faleminderit z. kryetar përshëndes të gjithë të pranishmit e në veçanti familjarët e pengjeve të luftës.

Po theksoj që në fillim së e përkrahi plotësisht fjalën e z. Surroi. Ajo që më shtyri të lajmërohem sot është që edhe pse sot flasë në cilësinë e deputetes në fakt unë jam kryetare e një komisioni parlamentar. të cilit me Rregulloren e re që është nënshkruar para dy ditësh ju ka bashkëngjitur edhe Komisioni për Persona të Pagjetur. Unë do të koncentrohesh pikë së pari në komisionet.

Fillim kisha cekur për Komisionin qeveritar ku kemi pasur një takim me këtë komision ne krye me z. Nusrete Kumnova të mbajtur më 4. korrik 2005 edhe pse kuptuam nga Qeveria se me të vërtetë dëshiron t'i trajton në formë të duhur këtë çështje aty kuptova shumë shqetësime dhe brenga për funksionimin e këtij komisioni, ajo çka kuptuam se faktikisht vetë edhe mospjesëmarrja e disa prej anëtarëve të komisionit shpesh po e mundëson mos funksionimin e këtij komisioni dhe janë shtruar disa,..... parashtrohet pyetja e reduktimit të numrit të anëtarëve të komisionit. Shumë prej pikave nga Rezoluta e miratuar në Kuvendin e Kosovës nuk janë realizuar, por nuk janë varur prej ndërkombëtarëve janë varur pikërisht prej institucioneve të Kosovës, disa prej tyre që nuk janë të realizuar.

Sa i përket grupit punues me Beogradin isha koncentruar vetëm në një gjë, ajo që është dashtë të kontestohet është normal kryesuesi i grupit punues nga Beogradi z. Velko Odallovic që është një njeri i regjimit të Millosheviqit dhe normal që nuk mund të jetë bashkëbisedues konstruktiv apo së paku nuk do të na ndihmon shumë në zbardhjen e fatit të personave apo të pengjeve të luftës që është person i kontestuar edhe nga forcat progresive të Beogradit e njëra ndër to është edhe Fondi për të drejtën humanitare në krye me z. Natasha Kandiç.

Dhe pika e tretë ku do të flasë konkretisht për Komisionin temë është se edhe në seancën e mbajtur më 20 maj këtu në emër të Komisionit atëherë jam deklaruar se duke e konsideruar çështjen e pengjeve të luftës si shumë të rëndësishme dhe madhore trajtimin e kësaj çështje. Kemi menduar se duhet të formohet një komision i veçantë, me qenë se edhe në legjislacionin e kaluar ka ekzistuar si i tillë, dhe po shohim këtu se me sa pengesa ka funksioni dhe sa vështirësi, e si mendojmë na me që sot në legjislacionin e tanishëm ku i kemi të bashkuar tri komisione që kishin funksione si të veçanta në legjislacionin e kaluar që është Komisioni për Shëndetësi, Komisioni për Punë dhe Mirëqenie Sociale që e dimë se jemi shtet që kemi shumë probleme sociale. Duhet të trajtohem sërish çështjesh shumë të rëndësishme t'i bashkëngjitet edhe një çështje aq e rëndësishme që u kuptua edhe nga debati i sotëm, një plagë e hapur dhe një çështje aq e rëndësishme për Kosovën dhe për fatin e të gjithë neve . Mendoj edhe për përcaktimin e statusit definitiv final të Kosovës . Që të jetë trajtimi i kësaj çështje në mënyrë serioze , propozoj si deputete që të mendojmë mirë për formimin e një komisioni, me qenë se dëshirojmë t'i qasemi kësaj çështje në mënyrë të duhur.Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit edhe Ramë Buja

DEPUTETI RAMË BUJA

Të nderuar familjarë të pengjeve të luftës, ju që jeni sot në sallë dhe ju që jeni kah na përcillni përmes mediave, përmes televizionit, të nderuar kolegë deputetë, i nderuari z. kryetar, i nderuar z. ministër.

Nuk dua t'i përsërisë ose të përpiqem, mos t'i përsërisë ato gjëra që u thanë nga kolegët e mi. Shumë respekt për fjalët e mbajtura dhe për mendimet e thëna, me përjashtim një vërejtje që politikanët do të duhej ta kishin zemër kokë dhe jo kokën zemër kur debatojnë për çështjen kaq të ndjeshme dhe kaq madhore. Mua dhe familjarët e vet pengjeve të luftës besoj na brengos një çështje të ndërjegjeshëm se sa mund të bëjë Qeveria e Kosovës sa mund të bëjë Parlamenti i Kosovës dhe sa mund të bëjë organet përgjithësisht të Kosovës.

Qasja jo serioze e një problemi shumë serioz dhe tragjik që ka Kosova sot. Nisemi mbase nga elementi i parë. Kryeministri nuk e pa të arsyeshme as të denjë që të rrijë dhe t'i dëgjojë se paku këto dhimbje të njerëzve ose këto opinione për të plotësuar diçka që mbase mund t'i ndihmonte fjalimit të tij tepër të zbehtë për këtë çështje. Dhe nuk dënoi ose s'ka dënuar paraprakisht që së pakut atë fjalë të tij të na afrojë neve deputetëve sot në mëngjes, në mos më herët më herret që ta dimë dhe një element shumë qenësor . U propozua iks herë këtu një rezolutë që do të duhej të dilte nga ky Parlament me argumentet e shtuara, sepse nuk përfundon rezoluta për këto çështje me njëshin e legjislaturës së mëparshme. Do të ishte mirë që propozuesit e kësaj pike të rendit të ditës së paku ta sillni një projektrezolutë që në përveç dhembjes që shprehën, shqetësimit, që shprehën përveç argumenteve mbase përplotësuese që mund të sjellin ta përplotësonim edhe atë rezolutë që të vishte një trysni për mekanizmat ndërkombëtarë që të bëjnë më shumë për çështjen e pengjeve të luftës se këta janë pengjet e luftës se në Kosovë ka ndodhur një luftë çlirimtare edhe sot ata mbahen peng dhe përdorën si dikur lëshimet e objekteve shkollore një objekt shkollor dhe një unazë e sanksioneve e hequr për Serbinë. Është fatkeqësi që njeriu mund ta bëjë këtë krahasim, por çështja është që shqetësimi bie edhe mbi mungesën e seriozitetit edhe në qarqet e sotme. Shefi i grupit për bisedime me Serbinë sjell fakte të tjera z. Sabri e tha 30 njerëz lëvizin nga numri dhe çështjet tjera që janë po ashtu shqetësuese dhe që lëvizin nga fotografi që e sjell z. kryeministër dhe shqetësimi bie këtu . Unë ndaj mendimin me kryefamiljarët dhe me familjarët e të zhdukurve që organet shtetërore ose organet e Kosovës së sotme të kenë qasje më serioze, përkushtim më serioz dhe mbajtje para mendjes dhe hundës së ndërkombëtarëve që ata të bëjnë presion më shumë mbi Serbinë që ato pengje të luftës të kthehen sa më parë në Kosovë. Të tjera këtu njeriu nuk ka mundësi të thotë, sepse çka mund të bëhet. Serbia vazhdon ta bëjë luftën edhe tash e 6 vjet me Kosovën me ndjenjat dhe i mban në ankth familjarët e të zhdukurve, andaj ne duhet ta kuptojmë këtë se ajo këtë luftë do ta vazhdoje për aq sa mundet e ajo mundet sipas të dhënave që u paraqite këtu. Unë dua të rishtojë se ajo që duhet të bëjnë organet e Kosovës është vëmendja e shtuar për t'u bërë presion të vazhdueshëm dhe të pashkëputshëm të mekanizmave ndërkombëtar që janë të pranishëm në Kosovë dhe jashtë saj ,në mënyrë që kjo trysni të bëhet edhe për një argument të veçantë. Unë nuk di se ka ndonjë rast diku në botë në luftërat e ngjashme të zhvilluara që janë marrë viktimat me makina dhe janë bartur në atdheun e kriminelit. Ky është një rast që nuk e ka parë historia botërore dhe për këtë fakt trysnia ndërkombëtare

do të duhej të ishte plus, që kjo gjë të ndodh sa më parë që ata njerëz që janë në ankthin e pritjes të më të dashurve të tyre që urojmë dhe dëshirojmë që për ata që nuk dinë a jenë të gjallë dhe t'u kthehen sa më parë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ramë, ju faleminderit. Unë do ta lutja Komisionin funksional, i ndihmuar nga ish-komisioni funksional e tani për çështje juridike dhe kushtetutë që ta shfrytëzoj këtë debat të meritshëm dhe nëse arrijmë, që unë dyshoj se sot mund ta përfundojmë për shkak të numrit të madh të paraqitur që në fund ta miratojë një deklaratë ose rezolutë. Me qëllim po kërkoj nga Komisioni për kushtetutë dhe të tjerët të shoh edhe pjesët e mundshme dhe të pamundshme dhe t'ua prezantojnë deputetëve në fund të debatit. Në ora 3,00 shihemi. Ju faleminderit.

Pjesë e punës së Seancës, të datës 21.07.2005, e filluar në orën 15,00.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Lus deputetët t'i zënë vendet dhe të fillojmë punën e sesionit të pasditës. E ka fjalën Nimon Alimusaj, le të përgatitet deputeti Fadil Kryeziu. Urdhëroni Nimon.

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ:

I nderuari zoti Kryetar, të nderuar dhe të respektuar familjarë, të nderuar kolegë deputetë, Që nga dita kur e mora rendin e ditës të kësaj Seance, kam qenë plotësisht i okupuar shpirtërisht me atë se çka mund të bëjë dhe çka mund të them që do t'i kontribuonte sadopak zgjidhjes së kësaj çështjeje. Që nga ajo ditë, kam menduar se kjo brengë – do të thosha kombëtare – nga diskutimet që do të dalin këtu do t'më prezantohen me mijëra ngjyrëra rrëqethëse. Kam menduar se do të jepen me dhjetëra e dhjetëra propozime për zgjidhje. Por, nuk kam besuar se pa ndonjë arsye serioze do të ndërrohet rendi i ditës e të mos dalë kjo si pikë e parë dje. Nuk kam besuar se dikush do të propozojë që kjo temë të hiqet nga rendi i ditës, as nuk kam besuar – siç u tha nga një diskutues publikisht – se dikush do ta marrë fjalën i frymëzuar nga një diskutim tjetër dhe bashkë me frymëzimin – zoti Kryetar – e mori fjalën para të të paraqiturve.

Sidoqoftë, çështja e personave të pagjetur, dhe kthimi i eshtrave të të gjeturve në varrezat e ndryshme masive në Serbi është një çështje siç u tha shumëherë – vërtetë e dhembshme, vërtetë serioze, vërtetë e madhe për momentin në të cilin po kalon Kosova. Kjo është një çështje shumë komplekse dhe shumë dimensionale për aktualitetin kosovar. Andaj, vënia në rend dite, me kërkesë të Grupit Parlamentar të AAK dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës në këtë seancë nga Kryesia duhet përshëndetur.

Që në fillim duhet të konstatoj se institucionet e Kosovës nuk kishin as nuk kanë kompetenca të cilat do të mundësonin të bëjnë një punë më të madhe që ta zbuste sadopak këtë plagë, të cilën e konsidero, siç thash, kombëtare dhe më të dhembshmen pas luftës. Këtë mund ta konstatoj me argumentin se institucionet e Kosovës nuk kanë

kompetenca që t'i përgjigjen pyetjes: ka apo nuk ka të gjallë nga pengjet e luftës, anipse unë besoj se ka, dhe sot e kësaj dite manipulohet me këtë temë duke pas, për fatkeqësinë më të madhe tonën, edhe interesa materiale.

Faktori ndërkombëtar, mbi të cilin binë shumë kompetenca që i referohen kësaj çështjeje, mendoj nuk ka bërë sa duhet për këtë çështje, sidomos me një presion të duhur mbi Beogradin – madje as për kthimin e kufomave të atyre që janë gjetur dhe identifikuar.

Mendoj se duhet të kihet parasysh dhe të merret seriozisht një konstatim - që përsëritet vazhdimisht qoftë nga familjarët e të pagjeturve, qoftë nga asociacionet e tyre: se në Kosovë nuk mund të ketë qetësi shpirtërore të rreth 2.500 familjeve pa zgjidhjen e këtij problemi, e së këndejmi edhe të tërë popullatës shqiptare sepse të gjithë lidhemi në një mënyrë dhe mënyrën tjetër për këtë çështje.

Kjo çështje, derisa të jetë e pazgjidhur, do të jetë jo vetëm brengë permanente e qytetarëve të Kosovës por edhe pengesë në efikasitetin e funksionimit të institucioneve demokratike të Kosovës.

Qytetarët e Kosovës, sidomos familjarët e të pagjeturve - nuk i shqetëson vetëm mosgjetja e personave të gjallë apo të zhdukur nuk i iriton dhe shqetëson vetëm moskthimi i të gjeturve nga varrezat masive në Serbi por edhe mosndëshkimi me ligj i autorëve të kësaj plage dhe, atëherë kur bëhen mirë të ditur, kur janë të gjetur madje edhe të arrestuar - siç ndodhi pak ditë më parë me një në Argentinë.

E ndiej për obligim si deputet i regjionit të Pejës të shpreh mllëfin e qytetarëve të këtij regjioni për një mosnxjerrje para ligjit të një njeriu të tillë. Është fjala për Nebojsa Miniq, i quajtur "komandant mrtvi" – autor i krimeve më rrëqethëse që kanë ndodhur jo vetëm në Pejë, i cili këto ditë është arrestuar në Argjentinë. Për bëmat e tij prej xhelati, qytetarët e rajonit të Pejës dinë histori të tëra, madje për to kanë shkruar edhe gazetarë të jashtëm.

Këshilli për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Pejë ka grumbulluar material voluminoz për ekzekutimet, dhunimet – madje edhe të vajzave të vogla në praninë e prindërve, që ka bërë plaçkitje e tjera dhe ka bërë kallëzim penal në Tribunalin e Hagës, kallëzim ky i shoqëruar nga një katalog i gjatë i krimit të bëra nga ai. Edhe prokurori publik i Pejës ka ngritur kërkesën për të kryer hetime ndaj tij më 29 dhjetor të vitit 2000. Për çudinë më të madhe, Gjykata e Qarkut në Pejë, nuk ka vendosë edhe sot e kësaj dite nëse duhet marrë një vendim për fillimin e hetimeve që është mundësuar nga "Ligji mbi procedurën penale të RSFJ" me arsyetimin tepër banal e absurd dhe tepër iritues – "sepse nuk janë marrë prova". Krimet e këtij "komandanti të vdekjes" siç quhet ai u aktualizuan shumë kur me 26 maj 2005 u bë e ditur nga Zyra ndërlidhëse e Interpolit në Argjentinë se ai është arrestuar atje.

Tani, institucionet e Kosovës, të cilat pa të drejtë po akuzohen për çështje politike këtu, patën rastin dhe bënë kërkesën për ekstradimin e tij në Kosovë, aty ku ai ka bërë krimin – praktikë kjo e njohur kudo. Pas kësaj kërkesë Grupi punues për funksionimin e ligjit –

standardi 2, kërkoi përgjigje nga Departamenti i drejtësisë së UNMIK-ut përkitazi me këtë. Me një përgjigje, të cilën unë e kam përpara dhe e cila mban datën e 4 korrikut 2005, me titullin: "Shënime të reja përmbledhëse për Nebojsa Çović" jepen përgjigje vërtetë irituese. E citoj dokumentin:

"1. Gjykata e Qarkut nuk ka marrë vendim për fillimin e hetimeve sepse nuk janë marrë prova",

e për këtë din krejt bota, këtë e shtova unë;

2. Se ka çështje të tjera më me prioritet sesa ndjekja për vepra penale për krime lufte;

3. Se Miniq vuan nga një sëmundje dhe se nuk mund të jepet parashikim për jetëzgjatjen e tij;

4. Se Miniq do të mbahet në Argjentinë në varësi të konsideratës që do t'i jepet kërkesës serbe për ekstradimin e tij."

Çuditërisht përjashtohet kërkesa e institucioneve të Kosovës për këtë. Unë kujtoj se ushtrimi i kallëzimeve penale për njerëz të tillë, që po hezitohet të bëhet nga faktori ndërkombëtar, është me rëndësi të shumëfishtë, sidomos:

1. Ngritë besimin në institucionet gjegjëse të Kosovës;
2. Kriminelët e luftës ndahen nga populli të cilit i përkasin dhe nuk akuzohet populli por individi dhe një veprim i tillë, që është e rëndësishme dhe kërkesë e faktorit ndërkombëtar – ndihmon procesin e kthimit, të integritit, të dialogut e tjera;
3. Kallëzimet e tilla penale do të ishin një lloj ngushëllimi dhe lehtësim për familjet dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës që sot konsiderohen të pagjetur apo të gjetur e që pritet të kthehen në Kosovë – priten të kthehen në trojet e tyre.

Kujtoj se faktori ndërkombëtar dhe ai vendor duhet të japin një shembull të parë të mirë duke kërkuar ekstradimin e Miniqit në Kosovë dhe nxjerrjen e tij para organeve të drejtësisë nëpërmjet mekanizmave të tij. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Fadil Kryeziu, le të përgatitet Bajrush Xhemajli.

DEPUTETI FADIL KRYEZIU:

Është vështirë, domethënë të konkludohet ose të vi unë personalisht në përfundim nëse heshtja do të fliste më shumë sesa vetë fjalët për këtë problem. Pata mundësinë që ta kam atë privilegj që të dëgjoj numrin më të madh të diskutimeve, edhe pse kam qenë ndoshta njëri nga të parët në ditën e djeshme që jam paraqitur për të diskutuar. Sidoqoftë, si deputet i Parlamentit po kështu me një pjesë të diskutimeve jam i kurajuar për

shqetësimin dhe i dekurajuar me një pjesë tjetër të diskutimeve të cilat janë të brumosura me fjalë të mëdha, madje edhe me një gjuhë që unë do ta definoja si një lloj patriotizmi profesionist rreth këtij problemi. A ka peshë të thuhet edhe një herë se sa e rëndësishme është për të gjithë ne – për popullin e Kosovës - kjo temë që po e debatojmë sot.

Ne mund t'i quajmë të pagjetur, të zhdukur apo edhe rob luftime. Mund t'i quajmë njerëz që na mungojnë, sigurisht por që të gjithë këta kishin një emër, kishin mbiemrin dhe për të gjithë këta dihet se kush i vrau, për disa të tjerë kush i arrestoi dhe ku i dërgoi. Aktori i këtyre krimeve po kështu ka adresën e tij. Pra informacioni se ku janë drejtuar të gjallët dhe të vdekurit ekziston, por ku janë ata – këtë ne nuk e dimë.

Në mitologjinë tonë përshkruhen raste, por edhe në traditën tonë edhe këtyre ditëve, sikurse në librat e besimeve për mosqetësimin e shpirtit jo vetëm të të gjallëve por edhe të vdekurve deri sa nuk rehatohen ata në dheun e tyre, madje jo vetëm ta por edhe pjesët e trupit të tyre. Ndërkaq, shpirtrat e të pagjeturve tanë çdo ditë trazojnë ndërgegjen tonë, çdo ditë thërrasin për bashkim në të gjallë apo në përjetësi qofshin ata.

A mund të qetësohet ky shpirt yni deri sa nuk kemi qoftë edhe shenjat e më të dashurve tanë, dhe si mund t'i thërrasim - ne si njerëz të zgjedhur të këtij populli për progres të proceseve në Kosovë të cilin po e bëjmë në vazhdimësi – Besimin, Ramën, Liridonin, Shqiponjën apo edhe të tjerët kur ende nuk dinë gjë për vëllezërit, për djemtë, për babën, për axhën apo tjetrin të familjes. Këta bij tanë pra u morën rob, u morën peng nga thundra shoveniste ushtarake e paramilitare e një vendi, e një shteti që arriti të transformojë emrin e tij nga "Yu" në ish "Ju" e deri së fundi në SNDM por këta mjecranë të cilët madje edhe në ditët e sotme thirren në demokraci për ditë nuk respektuan dje asnjë konventë, asnjë moral, madje as atë njerëzor, nuk respektojnë edhe sot, sepse ata dje u përpoqën të zhduknin gjurmët e krimit të tyre. Vetëm junta hitleriane provoi të shkrymosë krijesat e pafajshme të zotit, por popujt e tjerë, ata që ishin pre e një dhune të tillë – ditën pra t'i nënshtrohen katargjës, pastrimit shpirtëror, të dliroheshin nga ndjenjat shoveniste e gjenocidale. Ndërkaq, ky fqinj yni, për fat të keq, jo vetëm se djegu, vrau e shkretoi Kosovën, por mban peng edhe eshtrat, edhe shpirtrat e bijve tanë. Fatkeqësisht, ky shtet po mban peng edhe popullin e tij dhe sidomos bashkëqytetarët tanë serbë me këto lojëra të ndyra që s'kanë shembull apo më mirë shëmbëllejnë skëterra të mesjetës.

Bashkësisë ndërkombëtare i jemi shumë mirënjohës për të gjitha çfarë bëri dhe bën për Kosovën. Bashkësisë ndërkombëtare, popujve të civilizuar të Evropës dhe popullit të Amerikës ky popull po përpiqet t'i dëshmojë se e donë edhe lirinë e tjetrit, e jo vetëm të tij. Këtë sigurisht se do ta bënte edhe më fuqishëm sikur të arrijmë të qetësojmë shpirtin tonë për njerëzit që na mungojnë sot.

Bota demokratike perëndimore po thërret Kosovën që të përmbushë standardet, ndërkaq institucionet demokratike të Kosovës – sado të quajtura të përkohshme por të dala nga besimi i popullit – jo vetëm se dhanë e japin garancione për një gjë të tillë, por këtë po e bëjnë çdo ditë në vepër. Pra, Kosova çdo ditë po standardizon veten me vendet evropëroëndimore, me civilizime të përparuara. Përkushtimin tonë për këtë e themi edhe sot, edhe në këtë moment. Mirëpo, bota demokratike, sidomos Shtetet e Bashkuara të

Amerikës dhe Shtetet Evropë do të duhej më me ngulmë ta ndihmojnë Kosovën, të na ndihmojnë pra të gjithë neve në shërimin e kësaj plage të madhe duke bërë presione të domosdoshme ndaj pengmarrësve – pra Serbisë, ushtrisë së saj dhe institucioneve të saj që të heqin dorë nga pengmbajtja e bijve tanë të gjallë apo të vdekur. Ne nuk po kërkojmë gjë tjetër përveç një të drejte elementare njerëzore pa kalkulime e pa hesape tjera, sepse zgjidhja e fatit të robërve, të të pagjeturve vetëm sa do ta qetësonte shpirtin e këtij populli, do ta qetësonte Kosovën dhe rajonin përgjithësisht.

Zoti Kryetar,

Unë sugjeroj që nga ky debat, duhet të japim një mbështetje të plotë angazhimeve të Qeverisë për zbardhjen e fatit të të pagjeturve, sepse edhe do t'u ikim çdo lloj kusurritjeje rreth fatit të tyre. Ne duhet t'i lëvizim të gjitha mundësitë tona për të realizuar këtë, pra duke riaktualizuar edhe Rezolutën e aprovuar kohë më parë nga ky Parlament.

Po nga ky debat, ne duhet të kërkojmë nga të gjitha instancat ndërkombëtare angazhimin më të përkushtuar, më të këmbëngultë ndaj kësaj çështjeje – pra zbardhjen e fatit të tyre, kthimin e të gjithë eshtrave në Kosovë dhe atyre që eventualisht mund të jenë të gjallë pa kurrfarë kushtëzimi, dhe këtë para se t'i qasemi zgjidhjes përfundimtare të statusit të Kosovës.

Zbardhja e fatit të të pagjeturve, kthimi i pengjeve të gjalla, kthimi i të gjitha kufomave do të ndihmonte procesin në të cilin ecën Kosova dhe rajoni. Në të kundërtën, asnjëherë nuk do të mund t'i kemi shpirtat e qetë qofshin këta edhe shpirtat e krushjanëve të Krushës së Vogël, prizrenasve apo të therandasve, gjakovarëve, drenicasve, shpirtërat e Kosovës përgjithësisht. Më në fund, kjo është e drejtë jona dhe më në fund bota duhet ta kuptojë se kjo do të ndihmojë sepse edhe për këtë i ka mundësitë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Bajrush Xhemajli, le të përgatitet Remzije Nimani.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI:

Ju faleminderit zoti Kryetar. Përshëndetje për të gjithë, në veçanti për familjarët e të pagjeturve, që janë prezent dhe kudo që gjenden.

Sot po trajtojmë një çështje vërtetë të rëndë, dhe sa të rëndë aq edhe komplekse. Sigurisht se jemi të brengosur të gjithë për të pagjeturit, por gotën e helmit e kanë pirë të tërën familjarët e të pagjeturve duke bredhur poshtë-lartë për më të dashurit e tyre dhe duke hasur në llojlloj vështirësish e peripetishë.

Dimë të gjithë se janë arrestuar në mënyra dhe vende të ndryshme. Ta zëmë Xhavit Haziri ishte ai që shkante në Këshillin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve, por u rrëmbye dhe u zhduk. Hafir Shala, mjek - ishte duke shkuar për të shëruar të sëmurët. Ukshin Hoti, duke dalur nga burgu, e shumë e shumë të tjerë, në mënyrat më të ndryshme.

Dhe, përkundër të gjitha këtyre, bashkësia ndërkombëtare pas lufte në këtë aspekt ka përkdhelur Beogradin duke i hapur rrugë në mekanizmat evropian apo ndërkombëtar dhe në vazhdimësi po e përkëdhelë në vend se të pagjeturit të ish-in parakusht për hapjen e cilësdo porte për Beogradin, sepse Beogradi i ka ditur dhe i di se ku i ka dërguar ata qoftë të masakruar, qoftë të gjallë.

Fillimisht çështjen e të pagjeturve, matrapazët serbë të përkrahur nga Qeveria e tyre e të lidhur me njëfarë soj kriminelësh këtu te ne - e kanë shfrytëzuar për tregti, duke fituar shuma të mëdha parash, me mashtrime të cilat iu kanë bërë familjarëve dhe se gjoja akëcili i zhdukur është i gjallë në këtë apo atë vend tjetër në Serbi. Pra, ka bërë tregti, ashtu siç patë bërë tregti me të burgosurit politik. Ndërsa, tash po bën tregti, veçse tani tregti politike.

Saherë që na kthehen - në thasë - eshtrat e tyre, pra të të zhdukurve, bashkësia ndërkombëtare i jep si një lloj falënderimi dhe mirënjohjeje Beogradit për këtë "mirëkuptim" që po tregon Beogradi ndaj eshtrave të të zhdukurve, të masakruarve e tjerë, në vend se të dënohen këto lojëra të Serbisë dhe ta kushtëzojnë atë çdo ditë e më shumë. Thjeshtë, bashkësia ndërkombëtare në këtë çështje ka rënë në provim moral.

Po çështja qëndron: athua ne - a kemi rënë në provim moral, ose konkretisht mekanizmat që drejtohen sot në Kosovë nga vetë ne vendorët? Unë nuk pajtoj me tezën që po përsëritet shumëherë, natyrisht nga të pozitës, se nuk është në kompetenca tona dhe ne duhet në njëfarë forme të bëjmë sehir se ç'po bën bashkësia ndërkombëtare për t'na i gjetë të zhdukurit.

Përkundrazi, mendoj se Qeveria ka obligime dhe Qeverisë i ka dhënë obligime edhe ky Kuvend e që u tha disa herë këtu nga shumë parafolës se ne kemi nxjerrë një Rezolutë ku ka obliguar Qeverinë që të angazhohet në mënyra të ndryshme, ndër tjera edhe të bëjë kushtëzime qoftë në bisedime e tjera për të pagjeturit. Çështja, thjeshtë shtrohet: çka ka kushtëzuar Qeveria deri sot? Po mezi ka prit me biseduar me kendoqoftë, në daç me Beogradin, në daç me kënd duash - vetëm me biseduar diçka. Dhe tash, nuk është e drejtë të thuhet se s'kemi bash kurrfarë kompetencash. Kemi kompetencë së paku me bë presion të mirëfilltë. Kjo kompetencë ka qenë. Dhe, mendoj, Kuvendi s'po e kryen detyrën si duhet, karshi kësaj çështjeje. Kryeministri thotë se ne kemi formuar një grup punues dhe po citoj ".....në bazë të kornizës për dialogun me Beogradin".

Unë s'di për atë kornizë dhe kurrë kurgjo s'ka thënë për të, cila është ajo kornizë. Unë mendoj, dhe po e stërpërsëris këtë, mendoj që është shumë vitale për Kuvendin: pa material nuk bën të diskutohet. Ne vetë po pranojmë një çështje të cilën askush s'duhet pranuar. Materialet duhet të jenë relevante. U tha se ka diku, që mund t'i gjejmë nëpër kompjutera atje e s'di çka, në email-a. Po pse s'janë pru pikërisht ato materiale që po thonë se janë diku? Ato për ne duhet të jenë, në mënyrë që vërtetë ta bëjmë një debat cilësor, dhe mbi bazë të materialeve. Pa këto materiale, unë mendoj thjeshtë zoti kryetar - mund të bëjmë si në Angli në Hajd Parkun, që hajt kush të do mund të flasë diçka e qëlloj

e s'e qëllloi, apo "hajt pak" në këtë televizionin që është fort i qëlluar, por është për një çështje krejt tjetër – hajt pak të fillojmë, kush të do sa të do.

Unë mendoj se në këtë drejtim Kuvendi s'po e kryen detyrën karshi kësaj çështjeje dhe ne atje në katundin tonë – në Komogllavë kur vijmë në këto situata kështu për katundin – në këtë rast për Kuvendin themi "sa poshtë ka ra katundi" dhe vërtetë në këtë rast, në këtë dimension pa material që po diskutojmë vërtetë poshtë po biem, dhe mendoj se cilësia është shumë më e mangët, e jo me ardhë këtu kryeministri me një material paraprak mbi bazën e së cilit do të thotë këto grupet punuese kanë qenë dashur t'i raportojnë dhe t'na bjen një material e jo ne të ngasim, e sot na tregohet se janë diku në email-e. Unë po them, nuk është mirë me ra shumë poshtë kështu shpesh. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Në fund të debatit edhe unë do ta them ndonjë fjalë. E ka fjalën Remzije Nimani, le të përgatitet Jakup Krasniqi.

DEPUTETJA REMZIJE NIMANI:

Zotëri Kryetar i Kuvendit të Kosovës, zonja dhe zotërinj deputetë, të nderuar familjarë dhe të pranishëm tjerë në sallë,

Çështja e personave të pagjetur është ndër problemet më të mëdha dhe më shqetësuese për shoqërinë tonë në tërësi e për familjet e tyre në veçanti. Edhe Mitrovica, që nga fillimi e gjer më sot ballafaqohet me problemin e të pagjeturve dhe me pamundësi për t'i ndihmuar familjet e tyre në këtë situatë të vështirë. Konkretisht, në regionin e Mitrovicës situata është e rëndë dhe për shkak të numrit të madh të të pagjeturve ngase që nga 10 qershori i vitit 1999 e deri më sot janë të pagjetur ose të zhdukur gjithsej 307 shqiptarë, ndërsa nga ky numër gjer më tani janë identifikuar nga familjarët e tyre, e në prezencën e ndërkombëtarëve, 94 persona dhe 72 persona janë identifikuar me metodën shkencore të ADN-ës. Në raport me numrin e tërësishëm brenda gjashtë viteve janë identifikuar vetëm 166 persona, çka është shumë pak dhe mjaft shqetësuese ngase kanë mbetur pa u identifikuar edhe 141 të zhdukur. Prandaj, 141 familje jetojnë në ankth dhe pritje në përgjigje nga institucionet kompetente, por fatkeqësisht kjo pritje e gjatë po i shkatërron familjet e tëra në Kosovë. Pra, jo vetëm se është obligim moral, por duhet bërë çmos që të përdoren të gjitha mekanizmat e presionit nga ana e organeve vendore e ndërkombëtare tek autoritetet serbe që ky problem të mbyllet, duke i kthyer në familje më të dashurit e tyre.

Vlerësoj se problemet me të cilat ballafaqohen familjet e personave të pagjetur janë:

1. Procesi shumë i ngadalshëm i kthimit të të pagjeturve;
2. Proceset e komplikuar rreth hetimeve;
3. Proceset e rënda administrative dhe burokratike;

4. Mosvënia para drejtësisë e atyre që i bënë këto krime, ku asnjë serb i Kosovës nga Tribunali i Hagës nuk akuzohet për krime lufte apo rrëmbim të mbi 5800 personave shqiptarë.

Gjer më tani nuk ka pas fletëarrest ndërkombëtar nga autoritetet e UNMIK-ut për 15 kriminelët e akuzuar për krime lufte, të cilët u "arrestuan" në thojza nga burgu i Mitrovicës.

Dhe, 5. Mungesa e ligjit për mbrojtjen e familjeve të të pagjeturve dhe shpalljen e personave të zhdukur.

Zonja dhe zotërinj,

Se me çfarë vështirësie përballen familjet e të pagjeturve, po ua prezantoj vetëm një shembull nga Mitrovica, ku 15 familje nga lagjet veriore të qytetit – me të pagjetur, të papunësuar, dhembje, vuajtje dhe shqetësime shpirtërore, të dëbuar me dhunë nga serbët prej banesave dhe shtëpive të tyre jetojnë si refugjatë në qytetin e tyre dhe paguajnë qira të larta. Tërë kjo situatë e ndërlikuar flet për arsyen e ngutshme të zgjidhjes së këtij problemi në mënyrë sa më të shpejtë dhe më të drejtë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Zoti Jakup Krasniqi, le të përgatitet Ibush Jonuzi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI:

Zoti Kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar familjarë të pengjeve të luftës, Unë çmoj dhe vlerësoj lartë çdo diskutim që po bëhet këtu, pa marrë parasysh se është për patriotizëm, për çështje politike apo për dhembje njerëzore apo familjare. Nuk respektoj dhe më vjen keq që Kryeministri dhe ministrat e Qeverisë, të cilët kanë përgjegjësinë më të madhe për këtë kategori, nuk gjenden në kohën kur ne po debatojmë. Por, le të mbetet në përgjegjësinë dhe moralin e tyre – edhe si qeveritarë, edhe si njerëz dhe veprimtarë politik.

Lufta është politikë. Frytet e luftës prodhojnë politikë, prandaj njerëzit që janë marrë nga shtëpitë e tyre qofshin të gjallë apo të vrarë, të gjetur apo të pagjetur – janë peng të luftës. Dhe mendoj që terminologji tjera në këtë rast dhe për këtë rast nuk shkojnë. Edhe terminologjia duhet të jetë politike. Pse? Të gjitha flijimet e luftës së fundit që ka ndodhur në Kosovë kanë krijuar një realitet të ri politik dhe janë në shërbim të një politike të re e cila edhe pas gjashtë viteve ka bërë pak jo vetëm për pengjet e luftës por ka bërë pak edhe për familjet e dëshmorëve, ka bërë pak për invalidët e luftës dhe veteranët që vazhdojnë të kenë jetë të rëndë. Dhe qe gjashtë vite, për këto kategori qoftë të marra së bashku qoftë veç e veç – institucionet e dala nga vota e qytetarëve nuk ka arritur të bëjnë një ligj apo të bëjnë disa ligje që institucionet e Kosovës apo qytetarët e Kosovës dhe të gjithë ata që gëzojnë frytet e luftës të japin kontributin e tyre për të gjitha këto kategori pa flijimet e të cilëve ne nuk do të ishim sot në këtë sallë dhe nuk do ta zhvillonim këtë debat që jemi duke e zhvilluar.

U tha nga shumë parafolës se institucionet e Kosovës nuk kanë pas mundësi të bëjnë shumë për pengjet e luftës. Është e vërtetë e madhe që nuk kanë pasë mundësi të bëjnë shumë, por shtrohet pyetja: a e kanë bërë atë që kanë pas mundësi ta bëjnë?

Ne kemi pas mundësi si forca politike, si institucione, si njerëz të veshur me përgjegjësinë e qytetarëve të kemi një konsensus. Ne as sot nuk kemi konsensus për terminologjinë e fjalës se si t'i quajmë këta njerëz që kanë qenë në mesin tonë, që janë rrëmbyer nga një pushtues i egër dhe që nuk gjenden më në mesin tonë dhe që nuk dimë më se ku gjenden. Ne edhe e kemi vështirë të kemi konsensus për këtë, kur ne si forca politike, si veprimtarë politik, si liderë politik, si institucione nuk kemi konsensus për statusin politik të Kosovës. Ne nuk kemi konsensus as për të vlerësuar vlerën kulmore tonën kombëtare – luftën çlirimtare. Prandaj, nuk kemi pas konsensus edhe për të bërë ligje që këto kategori i meritojnë dhe vështirë është që të kemi konsensus për këtë çështje të dhembshme për familjarët, por jo edhe më pak për ne si qytetarë të Kosovës me shumëçka për gjysmë e me shumëçka të padefinuar.

Kemi pas mundësi të ofrojmë një përkujdesje më të madhe për familjarët, për fëmijët e të pagjeturve si dhe të të gjitha kategorive tjera që kanë nevojë për përkujdesjen tonë e që kanë dalë sidomos me nevoja pas luftës çlirimtare.

Këtu dëgjuam edhe disa fjalë që bëjnë një krahasim në mes të pengjeve të luftës të marra nga aparatet shtetërore të okupatorit, me viktimat e pasluftës – që në fakt edhe ato janë pasojë e asaj politike të luftës dhe të paraluftës që ka ekzistuar në Kosovë. Dhe, tendenca për të barazuar viktimat e pasluftës me viktimat e luftës është e paqëndrueshme.

Viktimat e luftës i ka bërë një makineri shtetërore e organizuar. Viktimat e pasluftës nuk janë pasojë e mekanizmave të shtetit apo mekanizmave tjerë të organizuar. Janë pasojë e luftës dhe e padrejtësisë që i ka shkaktuar regjimi i gjatë dhe i egër serb në Kosovë. Ne pra, nuk kemi të drejtë t'i akuzojmë të tjerët që s'kanë bërë sa duhet për pengjet e luftës, se në fund të fundit, pas qershorit 99 politika e tyre ka shkuar në një drejtim tjetër. Ata kanë qenë të interesuar që t'atë e ndëshkimit mos ta drejtojnë në drejtim të Beogradit dhe makinerisë së Beogradit por e kanë drejtuar në drejtim të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të atyre që na kanë sjellë po ashtu në këtë sallë që të flasim sot. Dhe, natyrisht se ata për të gjitha këto të këqija i kanë pas edhe argatët e tyre - të cilët kanë përndjekur luftëtarët e lirisë, ata që kishin qenë më të përndjekurit gjatë dekadave të shkuara, dhe natyrisht ata kanë zbatuar një politikë të tillë.

Po cila ishte dhe cila është politika jonë? Ne kemi pas mundësi edhe si forca politike edhe si institucione të kushtëzojmë bisedimet në raport me Beogradin jo vetëm për kategorinë e të pagjeturve por për të gjitha të këqijat që ky regjim ia ka bërë Kosovës dhe qytetarëve të saj. Dhe ne nuk e kemi kushtëzuar, përkundrazi kemi bërë lëshime e lëshime në dëm të proceseve politike në Kosovë. Mendoj se edhe kjo papërgjegjësi e qeveritarëve që të jenë sot në këtë sallë flet se sa është niveli i përgjegjësisë së tyre dhe se sa është vendosmëria e tyre për të bërë presion të mjaftueshëm mbi Beogradin dhe mbi ata që e meritojnë presionin. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Ibush Jonuzi, le të përgatitet Januz Kastrati.

DEPUTETI IBUSH JONUZI:

I nderuari zoti Kryetar i Parlamentit, deputetë të nderuar, dhe mbi të gjitha të nderuar dhe shumë të respektuar familjarë të pranishëm,

Tema e sotme është shumë e ndjeshme dhe ne duhet të jemi të vetëdijshëm në seriozitetin që e kërkon. Problemi i të zhdukurve po rritet dita ditës sikurse edhe zvarritja e gjetjes së tyre dhe kjo na shqetëson pa masë dhe duhet t'na shqetësojë çdoherë. Çdo hap yni, çdo përpjekje jona duhet të rezultojë përfundimisht me zbardhjen e fatit të të gjithë kosovarëve që konsiderohen të pagjetur nga periudha e luftës. Pritja me vite e familjarëve është e rëndë, plot ankth e dhembje, prandaj ne duhet të ngrisim zërin më fort si institucion për të bërë trysni mbi autoritetet ndërkombëtare dhe ato të Beogradit që të zbardhet kjo çështje e rëndësishme.

Ne duhet të faleminderit dhe përkulemi para të gjithë atyre që flijuan për Kosovën, por edhe të punojmë më shumë për ta. Sado që jemi përpjekur brenda Komisionit parlamentar në mandatin e kaluar, nuk na është dhënë forca e vendimmarrjes dhe nuk kemi pas mundësi ta japim maksimumin që është dashur, prandaj ndiej shumë keqardhje për këtë.

Siç e dini, vi nga qyteti i Vushtrrisë, i cili po ashtu ka shumë të pagjetur dhe në emër të qytetarëve që i përfaqësoj këtu duhet ta ngris zërin plot revoltë për ta adresuar këtë hall të madh, që lirisë së Kosovës ia zë frymën. Solidarizohem me familjarët e të zhdukurve anekënd Kosovës duke kërkuar që nga këtu të dalim me formulë të saktë të zgjidhjes së kësaj çështjeje. Edhe pse formula është shumë problematike, megjithatë se u bënë shumë diskutime, u dhanë shumë propozime, mendoj që Qeveria e Kosovës duhet të kërkojë nga Përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm, nga Bashkimi Evropian dhe mbi të gjitha nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, meqë dihet kryerësi i veprës, të bëhet një ultimatum dhe të kërkohej nga Qeveria e Serbisë për përfundimin e këtij procesi shumë të dhembshëm. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Januz Kastrati, le të bëhet gati Myrvete Dreshaj.

JANUZ KASTRATI:

Faleminderit Kryetar. I nderuar Kryetar i Kuvendit, të nderuar familjarë, të nderuar deputetë dhe të pranishëm të tjerë,

Sot po shqyrtohet padyshim çështja më e ndjeshme dhe njëkohësisht edhe më e dhembshme e pasluftës.

Në komunën e Malishevës prej nga vi unë ka mjaft njerëz fati i të cilëve ende nuk dihet edhe sot, numri i të cilëve edhe pse është komunë e vogël - sillet në rreth 70. Edhe ne jemi për krijimin e kushteve për kthimin e të zhvendosurve siç tha Petersen apo për respektimin e normave ndërkombëtare siç tha Kryeministri, por këmbëngulim gjithashtu fuqishëm në kërkesën për ata që kanë fuqinë e ndikimit të bëjnë presion edhe më të madh mbi Beogradin dhe të dihet sa më shpejt për fatin e të pagjeturve.

Në komunën time ende s'është kthyer asnjë nga të zhvendosurit dhe ndoshta pikërisht vetë zgjidhja e fatit të të pagjeturve do ta ndihmonte edhe kthimin e të zhvendosurve. Këtë e thash edhe në takimin e sotëm me gjeneral Kermabon që kishim në Kuvendin Komunal të Malishevës.

Për fund, kam një kërkesë, që komisionet për personat e pagjetur qofshin në kuadër të Qeverisë apo Kuvendit të kenë takime, edhe pse e di që ka këso lloj takimesh, por megjithatë të ketë edhe të tjera me komisionet komunale ku do prezentonin udhëheqësit komunal dhe deputetët nga ato komuna së bashku edhe me familjarët e të pagjeturve dhe të paktën për pak çaste ta ndiejnë ngrohtësinë e atyre për të cilët votuan dhe të cilët janë të obliguar ta ngritnin zërin për çështje si kjo e sotme. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirë, faleminderit. Myrvete Dreshaj e ka fjalën, le të përgatitet Teuta Sahatqija.

DEPUTETJA MYRVETE DRESHAJ:

I nderuar zoti Kryetar, deputetë dhe familje të personave të pagjetur. Diskutimi në seancën e sotme plenare për persona të pagjetur për shumë arsye më duket është sa i rëndësishëm aq edhe i vështirë dhe i ndjeshëm. I ndjeshëm për shkak të efekteve psikologjike me të cilat përballemi çdo ditë dhe i rëndësishëm për nevojën e domosdoshme që të saktësojmë edhe më tej parimet për identifikimin dhe përfundimin sa më të shpejtë të procesit të gjetjes së pengjeve dhe të zhdukurve të luftës. Në këtë aspekt, problemin e shohim në kontekstin institucional dhe në kontekstin politik. Në kontekstin institucional do të duhej të konfirmonim edhe një herë se a janë ngritur të gjithë organizmat që do të merren me të pagjetur dhe a janë shfrytëzuar mjaftueshëm të gjithë mekanizmat qeveritar e joqeveritar, vendor e ndërkombëtar për pengjet e të zhdukurit dhe a mund të ngrisin edhe mekanizma të tjerë. Mendoj se nuk e kemi nxjerrë mjaftueshëm dhe me forcën e argumenteve para institucioneve ndërkombëtare problemin e të pagjeturve, të cilët në raste të tjera dhe për çështje të tilla të rëndësishme institucionet ndërkombëtare nën presionin e qeverisë serbe shpeshherë kanë ditur t'na hedhin në tavolinën e dialogut.

Në kontekstin politik, vlerësojmë se problemet janë edhe më të gjera në moszbardhjen e së vërtetës për persona të rrëmbyer. Me mbajtjen peng të tyre Serbia vazhdon të mbajë peng Kosovën dhe zhvillimin politik, ekonomik e sociopsikologjik të saj. Duke mbajtur peng të zhdukurit Serbia vazhdon të përdorë mekanizma të fshehtë dhe të hapur për vjeljen ekonomike të familjeve të pagjeturve. Dhe, kështu, në vazhdimësi rrënon gjendjen

sociale dhe ekonomike të këtyre familjeve. Mjafton të shohim se në ç'nivel ka rënë mirëqenia familjare në qytetin e Gjakovës, dikur njëri prej qyteteve me standard të qëndrueshëm jetësor. Duke mbajtur peng të të rrëmbyerit, Serbia vazhdon të ushtrojë terror psikologjik e shpirtëror në popullatën shqiptare, dhe prej gjendjeve të tilla të trazuara vështirë mund të kërkohet plotësimi i atyre standardeve të cilat mund t'i plotësojë vetëm një popull i stabilizuar në aspektin sociopsikologjik.

Siç dihet, të zhdukurit nuk i takojnë vetëm një qyteti a një fshati, por pothuaj gjithë Kosovës dhe për kidnapimin e tyre për fat të keq kanë ndihmuar edhe vetë serbët lokal, prandaj është e pabesueshme që të arrihet kthim i qëndrueshëm i serbëve në Kosovë në kohën kur shqiptarët presin qoftë edhe një gjykim të kriminelëve serb, një pendesë kolektive të tyre dhe sidomos një lajm për fatin e bijve të tyre të zhdukur. Në këto rrethana, nuk mendoj se guxojmë ta zbusim qoftë edhe fjalorin e identifikimit të këtij problemi.

Situata është e qartë: Familjet e personave të pagjetur, e këta nuk janë pak por një tërësi e madhe e popullit, e quajnë luftë të hapur përkatësisht të vazhdueshme me Serbinë derisa të kthehet personi i fundit i tyre.

Nëse ne këtë problem nuk e artikulojmë qartë, duke identifikuar këtu edhe bartësit, edhe përgjegjësinë e tyre, atëherë atë që sot po përpiqemi ta mbajmë si problem humanitar - nesër mund t'na kthehet në një problem politik, pra të kthehet në vetë burimin e tij. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Myrvete faleminderit. E ka fjalën Teuta Sahatqija, le të bëhet gati Berat Luzha.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA:

Të nderuar familjarë, i nderuari Kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë,
Më 4 korrik isha prezent në takimin në ndërtesën e Kuvendit të cilin e organizoi Komisioni qeveritar për persona të pagjetur me deputetët e Kuvendit. Aty pata rasti të njoftohem më afër me gjendjen e tanishme, me aktivitetet dhe rezultatet e këtij Komisioni qeveritar. Dhe, kuptova se nuk ka ndonjë lëvizje të madhe përpara.

Më prekën shumë fjalët e zonjës Nysrete Kumnova, e cila tha se: ne jemi bërë nëna të rrugëve, sepse institucionet tona na kanë lënë në rrugë. Fjala për të ardhur keq, nuk më duket fjalë adekuate, është e butë, por duhet thënë se është turp për ne që këto nëna që kanë humbur të dashurit e tyre, ku shumë prej tyre mbeten pa askënd në shtëpi, dhe e vetmja gjë që i mbanë gjallë është ajo që ato janë të detyruara që të dalin në rrugë për të zgjuar nga gjumi ata që patën fatin të mos jenë në ato lista, që të mos kenë fotografinë në hekurat e Kuvendit.

Unë vi nga Gjakova, e cila ka numër të madh të personave të pagjetur, dhe ku çdoherë përsëritet agonja e pafund, dhembja e pafund e familjarëve – të pafuqishëm që të ndërrojnë diçka dhe të përshpejtojnë procesin e kthimit të më të dashurve të tyre.

Në Gjakovë, ku nga një familje ka katër apo pesë anëtarë, dhembja përsëritet çdoherë kur një nga një person kthehen dhe nuk përfundon agonja. Kthehen ato pamje të para gjashtë viteve, edhe një herë përjetohet tmerri, edhe një herë përjetohet pafuqia e familjarëve në luftë me injorimin e tyre nga faktorë që do të duhej të merren seriozisht me këtë çështje. Më kujtohet edhe homazhi në Mejë i këtij viti dhe fotografitë e viktimave dhe familjarëve të tyre që i mbanin në duar, të cilët fatkeqësisht edhe sot pas gjashtë vitesh janë lënë në mëshirën e fatit të tyre – pa përkrahje institucionale.

E kam të qartë që të pagjetur ka edhe prej nacionaliteteve tjera. Edhe fati i tyre duhet pajtjetër të zgjidhet, sikur edhe të pagjeturit tjerë shqiptarë. Dhe e kuptoj se kjo është çështje humanitare, por mendoj që vetëm ana jonë është duke konsideruar këtë çështje si çështje humanitare. Nga Serbia kjo nuk konsiderohet si çështje humanitare. Kjo është një çështje, një matematikë e llogaritur jashtëzakonisht mirë, e kryer prej njerëzve që kanë dhënë urdhëra, njerëzve që janë zgjedhë me vota, iu ka dhënë besimin populli dhe ata kanë ekzekutuar atë matematikë të tyre për Serbinë dhe për këta njerëz të cilët unë i kisha ndarë – të pagjetur dhe pengje të luftës. Të pagjeturit janë ata të cilët nuk janë gjend, ndërsa pengje të luftës janë ata të cilët sipas kësaj matematike, sipas kësaj strategjie janë arrestuar, janë vra, janë varrosur, janë zhvarrosur, janë dërguar në Serbi, kanë shkuar nëpër varreza masive, janë fundosur në Danub, kanë shkuar dhe janë bluar, janë djegë e tjera. Krejt këto, sipas urdhërave. Këto nuk janë gjëra që kanë ndodhë rastësisht. Këto nuk i kanë bërë individët në mënyrë sporadike. Kjo ka ndodhë në mënyrë institucionale. Dhe këta persona nuk janë për ta persona, këta janë numra. Prandaj në fjalimin tim nuk desha të përdori asnjë numër. Nuk desha që edhe unë të jam pjesë e asaj matematike ku njerëzit do t'i konsiderojmë si numra. Këta janë njerëz, këta janë individë të cilët kanë emër, të cilët kanë ndejt me ne, kanë punuar me ne, kanë qeshë me ne, kanë qajtur me ne. Prandaj, të mos shkojmë edhe ne me numra dhe t'i ndihmojmë matematikës së tyre. Kjo vazhdon ende. Vazhdon me mina, vazhdon me vazhdimin e asaj strategjie e cila është përpiluar moti.

Rezultatet e këtij Komisioni qeveritar, rezultatet e peticioneve, të Rezolutës që ka prur Kuvendi dhe formave tjera nuk u treguan efikase. Shihet se problemit duhet qasur në një mënyrë radikalisht të ndryshme. Problemi nuk është te ne dhe ne nuk mund ta zgjidhim duke i detajizuar veprimet tona, duke bërë edhe një komision, duke detajizuar edhe një detyrë brenda atij komisioni. Problemi qëndron në vendimin e Beogradit, në atë strategji, në atë matematikë. Dhe strategjinë e Beogradit, për numrin e të kthyerve – çfarë numri do të kthehet, kur do të kthehet dhe në çfarë mënyre do të kthehet, në atë theksin me të cilin bëjnë që njerëzit duhet të „gëzohen“ që iu ka ardhë personi i dashur. Dhe ky është një ekuacion matematikor shumëmirë i llogaritur dhe ne nuk kemi faktorë në këtë ekuacion. Problemi do të zgjidhet nëse kjo formulë zgjidhet me veprim politik sepse për Serbinë ky nuk është dhe nuk mund të jetë veprim humanitar.

Me veprimet tona të përbashkëta, të UNMIK-ut, të bashkësisë ndërkombëtare, pas vendimit politik, kur nuk do të ekzistojnë ndalesa politike të Beogradit, atëherë do të jenë shumë të vlefshme dhe ne plotësisht i përkrahim të gjitha ato që deputetët prej secilës parti u angazhuan dhe treguan rezultatet që të formohen zyrat, që të punojnë profesionistë, jo njerëz të cilët do të merren me kohë – dhe kur kanë kohë të lirë me këtë çështje, që të formohet arkivi, që të ngritën paditë që ende nuk janë bërë, që nuk ka qenë pjesë e kompetencave, që statusi i pengjeve dhe i familjarëve të rregullohet. Të gjitha këto janë shumë të vlefshme por nuk janë të vlefshme në këtë kohë kur ekziston ndalesa.

Do t'i kisha apeluar Qeverisë, do t'i kisha apeluar bashkësisë ndërkombëtare, do t'i kisha apeluar UNMIK-ut që me gjithë atë zellin që e kanë për decentralizimin, megjithatë zellin me të cilin merren, me kthimin e personave të zhvendosur, me atë arsytimin shumë të vlefshëm që secili person, secila qenie njerëzore duhet të kthehet në vendin prej nga ka ardhë – që të mendojnë se këta persona janë edhe ata njerëz të cilët mbahen në një shtet tjetër, në një vend tjetër dhe ata, pa marrë parasysh a janë gjallë a janë të vdekur, a është trupi a një pjesë e trupit – të kthehen në vendin e vet.

Me këtë kisha përfunduar, duke shpresuar se ky zell të vazhdon edhe në këto çështje tjera dhe të jetë si rekomandim për Qeverinë, UNMIK-u, bashkësinë ndërkombëtare që të dalin me një strategji precize, me një plan aksional për zgjidhjen e këtij problemi dhe që në vazhdimësi të jemi të informuar për këtë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Teutë Faleminderit. E ka fjalën Berat Luzha, le të përgatitet Fadil Gashi.

DEPUTETI BERAT LUZHA:

Zoti Kryetar,

Së pari desha t'ju pyes, mbase jeni në dijeni, se ku ndodhet kabineti qeveritar që nuk është këtu në sallë. Prej 15 anëtarëve të kabinetit nuk ndodhet asnjëri. A mos janë në punë, se në të vërtetë janë punëtorë të mëdhenj apo mos është në pyetje injorimi i Kuvendit siç po ndodhë çdoherë.

Unë mendoj se shqyrtimi dhe debatimi në këtë pikë të rendit të ditës nuk ka qenë dashur të bëhej pa pas një material bazë, pa pas shënime se çka është realizuar deri tash nga të ashtuquajturat bisedime teknike që në fakt janë bisedime politike e të cilat kanë mund të kushtëzoheshin nëse vërtetë është dashur me çdo kusht të zhvilloheshin.

Është fakt se edhe gjashtë vjet pas luftës Kosovës i mungojnë afër 3 mijë persona. Pjesa e viktimave të luftës që janë gjend të varrosur nëpër Serbi ende po kthehen në grupe të vogla. Ju një herë, para një kohe të gjatë, keni pas thënë se nuk do të lejoni që të kthehen në grupe të vogla, por kjo praktikë ka vazhduar.

Mosgjetja e personave të cilët gjatë luftës janë arrestuar nga organet e rregullta policore-ushtarake të shtetit të Serbisë edhe sot Kosovën po e mbajnë në një ankth duke shkaktuar që plaga e luftës të mbetet e pashërueshme dhe të sjellë dhembje të mëdha shpirtërore. Familjet por edhe e tërë Kosova ka të drejtë dhe duhet të kërkojë më me ngulm të dijë për fatin e më të dashurve që sot dalin si persona të humbur.

Dihet se adresa e saktë për kërkimin e pengjeve është Qeveria e Beogradit. Institucionet tona mund të kenë qasje në këtë problematikë vetëm përmes misionit të OKB. Koordinimi i punëve për këtë çështje përmes institucioneve vendore dhe atyre të UNMIK-ut asnjëherë nuk ka funksionuar si duhet. Ka munguar presioni i institucioneve të Kosovës, të UNMIK-ut dhe të institucioneve të tjera ndërkombëtare, së paku për hapjen e dosjeve të qeverisë serbe për personat e arrestuar gjatë luftës në Kosovë.

Qeveria e Kosovës, edhe pse ka formuar grupin punues për të ashtuquajturat bisedime teknike me Beogradin nuk ka arritur deri tash ndonjë sukses për ndriçimin e fatit të pengjeve. Si duket ato bisedime po bëhen vetëm sa për formë, për t'i plotësuar standardet apo më së shumti për të bërë një paritet të padrejtë: atë të barazimit të krimit serb që kishte përmasa të një gjenocidi me „krimin“ e supozuar shqiptar.

Siç dihet, delegacionit serb i prinë një person, i cili edhe vetë ishte i involvuar në krimet që janë bërë në Kosovë dhe këtë person do të duhej ta refuzonte delegacioni kosovar.

Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë një Rezolutë para më shumë se dy vjetëve por pas nxjerrjes së saj askush nuk është marrë më me problemin e pengjeve, veçanërisht Qeveria nuk është parë të ketë bërë deri tash ndonjë përpjekje në këtë drejtim, e të mos flasim më për Presidencën. Madje, nuk është nxjerrë as edhe ligji i veçantë dhe asnjë normë ligjore për kategorinë e personave të pagjetur dhe për familjet e tyre, kurse familjet e pengjeve janë përballur me probleme të mëdha të ekzistencës duke mos pas asnjë mbështetje institucionale. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Fadil Gashi, le të bëhet gati Kamber Kamberi.

DEPUTETI FADIL GASHI:

Faleminderit zoti Kryetar. Të nderuara familje, të nderuar kolegë deputetë, Duke vënë sot në shqyrtim çështjen e robërve të luftës që herë i quajmë të zhdukur e herë të pagjetur, besoj se shënojmë fillimin e fillimit të zgjidhjes së kësaj nyjeje gordiane tash më shumë se pesë vite.

Pa dash të merrem me atë pse kaq kohë nuk merremi me këtë problem, dua të them se Serbia është gjeneratori i problemit, por edhe anashkalimi i tij nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, si dhe nga institucionet tona që mbesin faktor shkaktar pse problemi mbetet i pazgjidhur. Prandaj, sot pas këtij debati, përfundimisht duhet nxjerrë një

dokument i cili nuk do të mbetet në sirtarët e këtij Parlamenti siç ishte me rezolutën e parë, duke mos evituar dilemën se ndaj kësaj çështjeje kishte përkushtim vetëm sa për sy e faqe.

Mbi 2500 është numri i atyre për të cilët nuk dimë kohë të gjatë, bijtë më të mirë që Serbia i nxori nga kolonat e përndjekjes dhe i dërgoi në Serbi. Për këta ka gjurmë, ka dokumenta, ka prova. Dhe këta njerëz ose janë të vrarë, për çka kemi krijuar paragjykitime jokorrekte, të pamoralshme dhe të mëkatshme, ose janë gjallë së paku një pjesë e tyre, që rob të luftës janë në kuptimin më të drejtpërdrejtë të fjalës. Dhe se ka robër të gjallë e që i mban ushtria serbe për këtë ka jo vetëm gjasa por edhe prova të besueshme dhe të bindshme.

Familjarët kanë informata të besueshme se një numër i robërve – bijve të tyre, që sillen diku në mes 360 deri afër 500 edhe sot mbahen gjallë nga ushtria serbe nën mbikëqyrjen e hekurt të shtetit serb, por ata nuk kanë guximin e publikimit të informatave të tyre para se gjithash nga rreziku që iu kanoset bijve të tyre sikundër që nuk guxojnë ta kompromitojnë as burimin e informimit. Fatin e tyre e dinë dhe për të janë përgjegjës të gjitha garnizonet regjionale në Kosovën e paraluftës dhe gjatë luftës, garnizonet ushtarake që kanë pas komandantë, si dhe stacionet e policisë po ashtu që kanë pas komandantet e tyre, dhe prej tyre duhet kërkuar llogari.

Formimi i komisioneve qeveritare parlamentare për zgjidhjen e këtij problemi si dhe definimi i tij si çështje teknike që po diskutohen e dialogohen me Serbinë defakto është vetëm blerje e kohës nga Serbia. Problemi është krijuar me motive dhe parallogari politike dhe vetëm me mjete politike, saktësisht me presionin e nevojshëm politik, diplomatik e tjera që mund dhe duhet ta bëjë bashkësia ndërkombëtare mbi Serbinë zyrtare mund dhe duhet të zgjidhet ai. Në Serbi ka rënë Millosheviqi por nuk ka rënë millosheviqizmi dhe ky fakt shtrin pasojat e veta edhe sot e gjithë ditën, në radhë të parë në këtë mënyrë të pazgjidhur por edhe në çështje tjera në Kosovën e sotme.

Krimi më i rëndë është ai që vazhdon, që nuk ka fund. Prandaj, familjarët të mos ndjehen më tej të vetmuar, të mos ndodhë krijimi i kësaj dhembjeje e ankthi që mbajnë kaq gjatë shumë familjar që me mosveprim - të mos bëhemi bashkëpjesëmarrës të së keqes por domosdoshmërisht dhe përfundimisht duhet të veprojmë. Veprimi ynë mendoj se nënkupton para se gjithash gjithë atë që është e mundur dhe e drejtë. Presioni i institucioneve tona dhe përfaqësuesve të tyre tek UNMIK-u dhe gjithë bashkësia ndërkombëtare për të mos lejuar më tej heshtjen e këtij problemi, kësaj fatkeqësie që reprodukon fatkeqësi, keni parasysh të nderuar deputetë vetëdijëcin e një nëne në Meje të Gjakovës.

Duke qenë se krimet në përgjithësi janë bërë drejtpërdrejtë nga serbët, moszbardhja e fatit të robërve të luftës drejtpërdrejt reflekton në procesin e kthimit dhe posaçërisht në atë të riintegritit të të kthyerve. Në disa mese, si në Klinë, toleranca e treguar në këtë proces është shprehje dhe dëshmi e sakrificës së re për të ardhmen e Kosovës, por kjo nuk nënkupton stabilitetin e plotë për të mos thënë se çështja e të pagjeturve që nga lufta

mbetet kërcnim i hapur dhe i vazhdueshëm i stabilitetit në Kosovë, fakt ky i cili nuk duhet të injorohet.

Neglizhimi i deritashëm i kësaj plage që prore kërkon shërim e mbyllje bën që njerëzit të jenë të ofenduar, të fyer rënd nga mosinteresimi, nga anashkalimi dhe në veçanti nga paragjykimi se „janë të vrarë dhe për të vrarët pse të interesohemi“. Por, zgjidhje më e lehtë nuk është edhe zgjidhja më e drejtë, kurse në këtë rast nuk është zgjidhje fare. Përkundrazi, ky problem nuk mund të shërohet vetvetiu dhe ai nuk do të shërohet as me kalimin e kohës. Prandaj, vërtetë është kohë e fundit kur duhet vepruar. Rruga bëhet duke ecur, edhe kur ajo nuk ekziston, por për këtë çështje rruga është e hapur, angazhimi, insistimi, këmbëngulja dhe presioni që do të jetë i domosdoshëm duhet ndërmarrë pa hezitim. Shpresoj në qasjen meritore dhe vendimtare të të gjithë neve ndaj kësaj çështje, ndaj kësaj plage e dhembje e cila megjithatë është kolektive. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. E ka fjalën Kamber Kamberi, le të bëhet gati Mazllom Kumnova.

DEPUTETI KAMBER KAMBERERI:

Faleminderit zoti Kryetar. Të nderuar dhe të respektuar familjar që jetoni me ankth të vazhdueshëm për fatin e më të dashurve tuaj.

Është një çështje mjaft e ndjeshme kur flitet për personat e kidnapuar, të rrëmbyer dhunshëm këtu në Kosovën e tyre dhe të zhdukur apo të fshehur diku nëpër Serbi. Këta njerëz – më të dashurit tanë – u rrëmbyen në mënyrën më çnjerëzore nga regjimi serb nga prehrit e nënave të tyre apo në prezencën e më të dashurve të tyre pa dallim moshe apo edhe gjinie.

Kjo çështje e të zhdukurve mund të ishte humanitare sikur të trajtohej në mënyrë të tillë nga pala serbe, por Serbia po bën politikë dhe po arrin konsensione me fatkeqësinë tonë, me eshtrat apo gjysmëeshtrat e shqiptarëve që po shëtisin dhunshëm në thasë najlloni pasi janë varrosur, zhvarrosur e rivarrosur kushedi për të satën herë nëpër Serbi. Kjo është jashtë çdo norme morale e njerëzore, sepse thuhet thjeshtë për ariun: “arusha - bishë e egër, por nuk merret më me të vdekurit” e me njerëzit tanë po luhet edhe nga regjime të mëparshme të Serbisë por edhe nga regjimi aktual e të pushtetshëm tash e gjithë ditën.

Nga ky debat mund të përsëriten gjërat dhe nuk do të doja që këto t'i përsëris edhe unë. Edhe unë vi këtu nga një regjion i Rekës së Keqe – regjion më i goditur nga lufta e fundit qoftë materialisht, qoftë edhe nga pësimi në njerëz. Këtu, brenda një dite, më 27 prill 1999 në fshatin Meje dhe rrethinë u vranë apo kidnapuan në mënyrën më çnjerëzore rreth 500 njerëz nga mosha prej 15 deri në 75 vjeç dhe kjo “natë e Bartolomeut” u bë ditën - përdiell para syve të mijëra grave e fëmijëve shqiptar.

E përmenda si vend ku ka ndodhur gjenocidi më i madh i kryer nga serbët këtu në Kosovë në luftën e fundit dhe ky vend nuk u përmend nga përfaqësuesja e OAK-ës që kishte përmendur emërvende tjera me fat të ngjashëm. Gjithashtu, këtu nuk u përmend

edhe angazhimi i pamohueshëm dhe i drejtpërdrejt i vazhdueshëm i Presidentit Rugova për zbardhjen dhe gjetjen e këtyre të të rrëmbyerve. Kujtoj që këtij problemi, kaq të ndjeshëm, kaq delikat – duhet t'i qasemi esëll, pastër, pa asnjë pretendim qoftë politik apo qoftë tjetër. Bashkërisht të nxjerrim përfundime dhe të bëjmë krejt që mundemi që ky ankth i vazhdueshëm të mos rrijë pezull mbi kokat e familjarëve të tyre por edhe më gjerë, sepse kujtoj të gjithë në Kosovë janë të prekur me këtë.

Gjithashtu, kujtoj - së fundi, se është e udhës që ky Parlament të caktojë një datë të përbashkët për njerëzit e zhdukur si një ditë zie për gjithë Kosovën në përkujtim për çdo vit dhe për t'u solidarizuar me familjarët që i goditi kaq shumë kjo luftë e fundit. Faleminderit.

(Në vazhdim, punën e Seancës e kryeson deputeti Džezair Murati)

KRYESUESI DŽEZAIR MURATI:

Hvala gospodine Kamberi. Sledeći diskutant je poslanik Mazlom Kumnova, neka se pripremi poslanik Gani Koci.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA:

Zoti kryesues, familjarë të nderuar,
Fill pas luftës, kur u përballëm me pasoja të terrorit serb në Kosovë, plaga më e rëndë mbeti me njerëz tanë të vrarë, të arrestuar dhe të rrëmbyer nga forcat serbe. Këta familjarë, filluan të organizohen për të kërkuar të afërmit e tyre dhe falë këmbënguljes së tyre kanë arritur të prezantojnë dimensione të krimeve masive. Institucionet vendore të përkohshme ishin në pozicionin e ndërmjetësit me organizatat ndërkombëtare dhe përgjegjësit e qeverive të ndryshme. Duke rimarrë të dhënat e këtyre familjarëve, rrugën që kanë ecur deri tani, njeriu krijon një bindje se aq shumë është folur, premtuar dhe aq pak është realizuar – duke filluar nga Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të bashkuara, mekanizmat humanitar, diplomatë të Bashkësisë Evropiane, të personaliteteve të shteteve të njohura dhe në njëfarë mënyre është trokitur në ndërgjegjen e tyre.

Rastësisht, duke shfletuar shënimet personale të kohës kur isha kryetar i Komunës së Gjakovës pas lufte, një mandat i shkurtër por shumë i vështirë, u ndala te shënimet e mbajtura me rastin e takimeve me delegacione të ndryshme që frekuentonin Gjakovën dhe Kosovën ato ditë – me ambasadorë të Këshillit të Sigurimit, me Sollanën, e shumë e shumë të tjerë në funksione të ndryshme diplomatike e humanitare. Më ka mbetur një refren i tyre kur bisedohej për të pagjeturit ose pengjet: "Mos pritni mrekulli, por çdo gjë tjetër do të bëjmë". Fatkeqësisht edhe sot e kësaj dite, pas gjashtë vjetëve – nuk u realizua ky premtim, dhe shumë prej tyre janë në funksione diplomatike që kanë pas dhe kanë mundësi të bëjnë së paku të domosdoshmen.

Në atë kohë, ne nuk besonim në mrekullira, por besonim në ndërgjegjen e tyre me një të drejtë elementare të njeriut për të zbardhur një të vërtetë, për të ditur për fatin e fëmijëve, prindërve, vëllait, mikut e të tjerë. Sot janë mbi 1.500 persona – thuhet të të gjitha

moshave, me adresë të njohur: në Serbi, që i ka vrarë, i ka zhdukur, pranon se i ka trupat e tyre, nuk i kthen dhe bën politikë. Kjo është vazhdimësi e krimit, vazhdimësi e ideologjisë gjenocidiale. Dje në territorin e Kosovës, sot nga territori i Serbisë bën krim në territorin e Kosovës. Por, edhe të mbash nën pengun e ankthit një familje, një farefis, miq e shokë për fatin e të afërmit të tij – është krim.

Dihet se njerëzimi ka miratuar alamet konventa, dokumente dhe akte tjera universale për të drejtat e njeriut - që e dënojnë këtë krim. Por, përse nuk i adresohet kjo aktakuzë Serbisë? Është e drejtë edhe e këtij Kuvendi të pyes dhe të kërkojë përgjigje për këtë.

Aktualisht, Serbia pranon se i ka rreth 400 kufoma në murgun e Beogradit e që presin identifikim. Nëse i referohemi të dhënave të fondeve humanitare jashtë dhe brenda Serbisë – ka edhe vende të tjera të krimit masiv – varreza nën dhe e mbi dhe, ashtu si ajo ka ditë të bëjë. Të gjithë ata kanë pas identifikim dhe dihen me emër e mbiemër, vendlindje, kohën e ekzekutimit, varrimet e zhvarrimet sepse këtë krim e kanë udhëhequr institucionet e shtetit. Prandaj, këtë duhet ta pranojnë.

Dhe, ne në Kosovë, nuk guxojmë të heshtim me kërkesën tonë qoftë drejtpërdrejt Serbisë qoftë përmjet UNMIK-ut i cili mban përgjegjësinë që kjo çështje aq e ndjeshme nuk u mbyll akoma për të filluar shërimin e kësaj plage. Për këtë nuk ka negociime në nivel të grupeve. Serbia i ka rrëmbyer, i ka vrarë njerëzit tanë. Për ne janë pengje, për bashkësinë ndërkombëtare janë të pagjetur, por jo për Serbinë që e din se ku janë. Është kjo përpjekje e saj për ta mbajtur nën fshehtësi shtetërore të vërtetën, për të kufizuar përmasat e krimit dhe gjenocidit që ka bërë në Kosovë. Është kjo përpjekje politike për rehabilitimin e një krimi masiv, një gjenocidi të cilin ende sot e kësaj dite nuk po klasifikohet e tillë.

Nëse Serbia nuk ka guxim të ballafaqohet dhe të shikojë me përgjegjësi njerëzore krimet e bëra atëherë bashkësisht ndërkombëtare – së paku – ka mundësi të klasifikojë këtë veprim të kriminalizuar të Serbisë, ta dënojë si veprim mendjeprishur politik mesjetar. Ne jemi duke kërkuar diçka që është e jona, që shpirtërisht është e jona. Po kërkojmë që me nderime dhe denjëtet t'i riadhesojmë. Ne dimë se që nga maji i vitit 2003 kur ka filluar riadhesimi i njerëzve tanë nuk është ngritur asnjë aktakuzë në Serbi për ekzekutorët, sepse edhe ata kanë emër e mbiemër dhe janë ende në kabinete të institucioneve shtetërore të Serbisë. Thuhet se çështja e Serbisë është çështje e Serbisë, e ndërgjegjes së saj, e demokratizimit të saj. Disa ideator dhe urdhërdhënës të krimeve janë të njohur, por të tjerët po shëtisin lirisht në rrugët e Beogradit. Qenka çështje e Serbisë!? Por, është e drejtë jona që në raport me Serbinë ta kushtëzojmë atë. Është e drejtë e jona të kërkojmë nga bashkësia ndërkombëtare të veprojë ndërgjegjshëm, sepse këta të fundit dinë të na imponojnë edhe kërkesa të tilla për standarde – standarde pa standarde, por shpesh harrojnë se janë hartues të konventave për parandalim të krimit të gjenocidit.

Megjithatë, secili prej nesh - veç e veç padyshim, por edhe si Kuvend e Qeveri, duhet t'i kthehemi vetvetes – ndërgjegjes: a kemi mundësi të bëjmë më tepër dhe edhe të pamundshmen për familjet e atyre personave që fotografitë e tyre rrinë natë e ditë në dyert e institucioneve tona?

Edhe sot kur po debatojmë, mund të bëjmë diçka më tepër se që kemi bërë deri tani. Nuk mjafton vetëm ta ndajmë dhembjen me ata familjarë, por të veprojmë me përgjegjësi si të zgjedhur të tyre. Nuk bën të lejojmë një proces pambarimisht të gjatë ankthi për këta familjarë. Faleminderit.

KRYESUESI DŽEZAIR MURATI:

Hvala vam kolega Kumnova. Reč ima poslanik Gani Koci, neka se pripremi gospodin Fetah Berisha.

DEPUTETI GANI KOCI:

Faleminderit zoti kryesues. Ne, që nga mëngjesi e deri tani jemi duke debatuar dhe konsideroj se të gjitha ato që i kemi thënë sot këtu nuk janë të panjohura për familjarë që tash e dy ditë po maltretohen duke na pritur se ç'po themi ne si kuvendarë këtu dhe aq më keq që përgjegjësit kryesor të kësaj çështjeje - Qeveria e Kosovës - nuk del që të presë dhe bile sot këtu kur pritën tash e dy ditë familjarët me të cilët secili prej nesh me gojë po ndajmë dhembjen me ta. Janë mësuar edhe më herët edhe me deklaratimet tona edhe me debate tona për këtë çështje të caktuar, por unë do të shtroj çështjen pak më ndryshe.

Tash e gjashtë vjet Serbia ka kushtëzuar faktorin ndërkombëtar por edhe ka kushtëzuar edhe institucionet tona për të nxjerrë privilegje, benificione për pjesëtarët serb që jetojnë këtu në Kosovë. Në një mënyrë ka legalizuar edhe struktura paralele, ka nxjerrë universitete për ta, ka nxjerrë dokumente, po them prapë paralele kushtimisht në thojza, me targa paralele dhe ne sot si Kuvend a jemi të gatshëm që të nxjerrim një vendim dhe ai vendim të autorizojë Qeverinë, t'i jap përgjegjësi Qeverisë që Qeveria e Kosovës të dalë me qëndrime të veta – se nuk ka asnjë dialog me Serbinë qoftë ai edhe për çështje teknike, se nuk ka as një lëvizje të qeveritarëve serbë nëpër Kosovë; a është e gatshme që ky Kuvend të marrë vendim që në një mënyrë edhe të ngrijë ndoshta edhe disa raporte edhe me UNMIK-un si përgjegjës për këtë çështje përderisa të gjithë ata që nuk i kemi në mesin tonë qoftë edhe si eshtra të jenë në Kosovë. Nëse jemi të zot ta bëjmë këtë dhe ta detyrojmë Qeverinë, atëherë ta bëjmë sot dhe të mos maltretojmë këta që vërtetë presin në ankth. Nëse nuk jemi të zotë, ne mund të debatojmë sot, nesër, një muaj të tërë, një vit të tërë – dhe problemin nuk e kemi zgjidhur.

Prandaj, si përfundim imi, është që në atëfarë rezolute, që do të nxirret nga ky Kuvend të jetë pikërisht ky vendim – që Kosova më në fund të kushtëzojë çdo kontakt, çdo bisedë edhe me Serbinë por edhe me strukturat e caktuara të faktorit ndërkombëtar këtu. Tek pas kësaj, mund të bisedohet dhe mund të fillohet sipas asaj komize të zotit kryeministër për dialog me Serbinë. Ju faleminderit.

KRYESUESI DŽEZAIR MURATI:

Hvala kolega Koci. Reč ima gospodin Fetah Berisha, neka se pripremi poslanik Fadil Geci.

DEPUTETI FETAH BERISHA

I nderuar zoti kryesues, shumë të nderuar familjarë, dhe kolegë kuvendar,
Sot po debatojmë për të pagjeturit, po debatojmë për dhembjen tonë të pashëruar – temë që fatkeqësisht është ende e pambaruar.

Të pagjeturit janë dhembja jonë e madhe familjare dhe kombëtare. Për të gjithë të zhdukurit dhembja për ta është njësoj, ata i kanë vrrarë, i kanë masakruar, i kanë kidnapuar – të gjithë janë të zhdukur dhe për të gjithë ne duhet të dimë se ku janë.

Komuna e Rahovecit, nga vi unë, është nga komunat më të sakatosura nga paramilitarët, nga policia dhe ushtria serbe - edhe në njerëz edhe në material. Në Rahovec plotësisht është zbatuar taktika e “tokës së djegur” dhe pastrimi etnik. Pos fshatit Xërxe, asnjë fshat i komunës së Rahovecit – bashkë me Rahovecin – nuk i shpëtuan djegies, granatimit dhe shkatërrimit. Unë do të përmend edhe numra. Në komunën e Rahovecit makineria vrasëse e Beligradit ka vrrarë e masakruar dhe ka kidnapuar mbi 933 persona. Nga këta 673 janë vrrarë, ndërsa 260 janë të zhdukur. Deri tani, 126 janë gjetur kurse pritet të gjenden edhe 134 persona. Dhembja për të gjithë të zhdukurit dhe interesimit për t’i gjetur ata është i njëjtë, ndërsa mënyra e zhdukjes është e ndryshme, ashtu siç ishte moshja e tyre e ndryshme. Këtu, do t’i përmend vetëm tri raste nga shumë të tjera:

1. Në fshatin Pastasel, pasi u ndanë burrat nga gratë dhe nga fëmijët, policia serbiane i pushkatoi në tri grupe 106 persona. Nga tmerrri i këtyre, shpëtuan 12, se kishin me qenë më shumë. U varrosën – ashtu - nga kush mundi. Mirëpo, pas sa dite, vrrasarët serbian i zhvarrosën disa kufoma për t’i zhdukur dikah dhe sot e asaj dite janë të pagjetur.
2. Në Krushë të Madhe, vrasësit serb autobusat e mbushur me njerëz të moshave të ndryshme i zhdukën dikah në drejtime të panjohura, të cilët edhe sot e kësaj dite kërkohen. Dhe,
3. Edhe rasti i zhdukjes së profesorit të çmuar Ukshin Hotit është gjithashtu specifik. E liruan të dielën për ta zhdukur. Formulë tjetër këtu s’mund të ketë.

Kjo nuk ishte praktikë e burgjeve komuniste. Kurrë s’kishte ndodhur që i burgosuri politik të lirohet të dielën dhe jashtë dyerve të burgut. Thuhet: e rrëmbyen dy civilë serb dhe e zhdukën dikah. E, pastaj, ndodhi edhe masakra mbi të burgosurit e Dubravës. E, burgu është institucion ndëshkues shtetëror.

I përmenda këto tri raste për të veçuar larushinë e krimeve serbe, pastaj edhe qëllimet e tyre që kishin për qëllime t’i zhdukur krerët politik dhe intelektual të Kosovës.

Këtë mund ta ilustrojmë vetëm me këta tre-katër shembuj, kurse ka edhe me qindra të tjerë. Pse a nuk e ilustron këtë më së miri vrasja e profesor Aganit; e profesor Latif

Berishës; e avokatit të mirënjohur i cili më ka mbrojtur në 81-shin Bajram Kelmendit; pastaj avokati i mirënjohur dhe pajtimtari i gjajeve Bardhyl Çausi?

Prandaj, këtu u tha më parë nga një diskutues se ne dhe ky Kuvend diskutojnë në mënyrë të njëanshme!? Jo zotëri, të njëanshëm janë ata që kanë bërë gjenocid kundër shqiptarëve. Ne diskutojmë për të pagjeturit tanë.

Megjithatë, institucionet e Kosovës dhe UNMIK-u me sukses po i përmbushin standardet; po krijojnë kushte që minoriteti serb të kthehet në prona të tyre; që minoriteti serb të integrohet në institucione të Kosovës dhe në realitetin e ri. Kjo është në rregull, por plaga e të pagjeturve po rrit zvarrë mbi ndërgjegjen e regjimit të Beligradit, i cili abuzon mbi të pagjeturit për hesape të veta politike.

Prandaj, edhe unë mendoj si të tjerët: është domosdoshmëri e kohës që institucionet vendore dhe sidomos ato ndërkombëtare të bëjnë trysni më shumë se çdoherë tjetër mbi regjimin e Beligradit që të bashkëpunojnë seriozisht e t'i tregojnë se ku i kanë zhdukur shqiptarët e vrarë, të masakruar e të rrëmbyer dhe natyrisht se edhe Beligradi të pranojë fajësinë e tyre. Pastaj, të bëhet identifikimi i tyre, të riarrosen, t'u dihet varri e shenja i tyre i përkujtimit dhe të mbyllet edhe kjo plagë e hidhur për Kosovën martire.

Dhe, në fund, kisha me thënë: Familjarët e të pagjeturve zoti i ndihmoftë dhe i ndjeftë. Ju faleminderit.

KRYESUESI DŽEZAIR MURATI:

Zahvaljujemo kolega Berisha. Jedna napomena. U sali su prisutni 50 poslanika. Mislim da možemo raditi, ali ne možemo odlučiti. Da bi bila veća prisutnost bila bi i legitimnost veća. Sledeći diskutant je gospodin Fadil Geci, neka se pripremi Selvija.

DEPUTETI FADIL GECI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë, të nderuar familje të të pagjeturve, Lufta e fundit në Kosovë ka lënë shumë plagë të pashëruara. Një nga plagët më të dhembshme është sot fati i pengjeve të luftës në Kosovë.

Ne deputetët e Parlamentit të Kosovës, si përfaqësues të zgjedhur të popullit të Kosovës, duhet të jemi të ndërgjegjshëm për ata burra e gra, pleq e të ri nga Kosova të cilët edhe sot e tutje nuk dihet se a janë gjallë apo të vdekur. Ne duhet të ndajmë dhembjen me këta familjarë. Institucionet e Kosovës nuk mund të parakalojnë aq lehtë para fotografive të pengjeve të luftës, të cilat janë të ngjitura në rrethojat e jashtme të ndërtesës së Qeverisë e të Kuvendit të Kosovës. Komuna, nga unë vi, pra Skenderaj ka një numër të madh të pengjeve të luftës, më të madhin pas komunës së Gjakovës.

Të nderuar deputetë,

Serbia po mban peng fatin e pengjeve në Kosovë, duke shkaktuar kështu dhembje dhe pikëllim në popullin e Kosovës e posaçërisht të familjeve kosovare të cilat i presin më të dashurit e tyre dhe një ditë t'iu kthehen të gjallë apo të vdekur në vendlindjet e tyre.

Tani është e ditur se në vendet e ndryshme të Serbisë ekzistojnë varreza masive në të cilat është varrosur popullata civile shqiptare e masakruar gjatë luftës në Kosovë. Serbia edhe më tutje po i mban të fshehura këto varreza masive duke dashur kështu të fshehë krimet e veta që i ka bërë në Kosovë.

Të nderuar kolegë,

Pengjet janë pjesë e popullit të Kosovës. Ata – të gjallë apo të vdekur – duhet të kenë përkujdesje shtetërore të Kosovës. Siç dihet, në kuadër të bisedimeve teknike me Beogradin, institucionet kanë formuar grupin punues i cili merret me çështje të pengjeve të luftës së fundit në Kosovë. Megjithëse nuk janë bërë hapa të mëdhenj në këtë drejtim, diçka është arritur në këtë aspekt. Kohëve të fundit, kemi një numër simbolik të kufomave që kthehen nga varrezat masive në Serbi por janë edhe qindra e mijëra pengje të tjera të cilat nuk dihet se a janë të gjallë apo të vdekur apo ku janë varrosur dhe kur do të kthehen në Kosovë.

Unë mendoj se bashkësia ndërkombëtare duhet të ushtrojë presion mbi Beogradin që të kushtëzohet me integrimet evropiane deri sa të kthehen në radhë të parë të gjallët dhe të gjitha kufomat e civilëve të vrarë në Kosovë. Por, edhe institucionet e Kosovës duhet të bëjnë edhe më shumë për zbardhjen e fatit të popullatës civile dhe të zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Ne së bashku me institucionet ndërkombëtare duhet të kushtëzojmë vazhdimet e bisedimeve teknike me Serbinë përderisa nuk do të kthehen në Kosovë të gjitha kufomat që gjenden sot në varrezat masive në Serbi.

Kthimi i të gjitha kufomave në Kosovë nga varrezat masive në Serbi është obligim yni moral ndaj këtyre martirëve të luftës për liri. Ndërkaq, zbardhja e fatit të pengjeve në luftën e fundit në Kosovë është një obligim shtetëror i Kosovës ndaj këtyre familjarëve, të cilët me lot në sy presin që të dinë për fatin e më të dashurve të tyre.

Të nderuar deputetë,

Në Kosovën e lirë, të çliruar nga okupatori serb, ende nuk janë kthyer të gjithë ata që duhet të kthehen në Kosovë. Një pjesë e atyre që edhe më tutje gjenden të burgosur dhe varrosur në varrezat masive në Serbi janë të zhdukurit nga Kosova. Ata janë flijuar për lirinë e Kosovës, ndërkaq trupat e tyre ende nuk prehen në dheun e tyre të Kosovës së lirë.

Të nderuar kolegë,

Nëse liria e Kosovës ka ngjyrë të gjakut të këtyre martirëve të Kosovës, atëherë ne që po gëzojmë këtë liri – së bashku me bashkësinë ndërkombëtare që e kemi këtu dhe që na ndihmuan të çlirohemi – duhet të bëjmë gjithçka që së paku kufomat e tyre të kthehen dhe të varrosen në Kosovën e lirë. Faleminderit.

KRYESUESI DŽEZAIR MURATI:

Hvala vam gospodine Geci. Sledeći diskutant je poslanik Selvije Halimi, neka se pripremi kolega Hajredin Hyseni, naravno ukoliko je prisutan.

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI:

Zoti kryesues, të nderuar deputetë, të nderuar dhe shumë të respektuar familjarë të personave të pagjetur, apo pengjeve të luftës.

Në seancën e sotme, kur për temë diskutimi është një çështje kaq e ndjeshme, është vështirë të munden emocionet, andaj respekt për të gjitha diskutimet në këtë Kuvend në ditën e sotme.

Të nderuar deputetë,

Se kur është në pyetje çështja e shqiptarëve, bashkësia ndërkombëtare vazhdon të përdhosë drejtësinë dhe konventat ndërkombëtare, po dëshmohet edhe në këto gjashtë vite pas luftës.

Nëse kthehemi në një retrospektivë shumë të afërt dhe shohim se sa kemi arrit që ta dëbojmë pushtuesin nga Kosova duke kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare, e shohim se nuk kemi pas sukses. Çka kemi bërë? Jemi detyruar të veprojmë vetë për t'u çliruar, për të bindur se e kemi seriozisht ta çlirojmë Kosovën dhe të vendosim vetë në Kosovë.

Andaj, edhe për çështjen e personave për të cilët po flasim, mendoj se Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë veprime konkrete edhe përkundër mungesës së ndonjë raporti lidhur me atë se deri ku është arritur, ku kemi has në pengesa. Nuk mund të flasim apo të mendojmë se kemi të bëjmë me çështje humanitare kur janë në pyetje veprimet e pushtuesve. Nuk mund të themi se kemi të bëjmë me çështje politike derisa drejtësia dhe konventat ndërkombëtare janë duke u përdhosur apo janë duke u anashkaluar dhe duke dëmtuar interesat e popullit shqiptar në Kosovë nga politika të caktuara.

Më vjen keq që ky Kuvend vazhdon të shndërrohet në një trupë të vogël punues ashtu si komisionet punuese për bisodime teknike dhe të jetë në shërbim të Qeverisë. A e kemi në Qeverinë në shërbim të Kuvendit dhe ajo të zbatojë politika që dalin nga ky Kuvend dhe të zbatojë ligje që dalin nga Kuvend apo ne do të detyrohemi të debatojmë edhe në mungesë raportesh për punën apo veprimet e Qeverisë?

Mendoj se, duke kërkuar represione apo presione të ndryshme ndaj Beogradit, nuk zgjidhen këto probleme. Duhet që të përgatitet një platformë konkrete e afatizuar, duke u kontrolluar nga ky Kuvend dhe të jetë e kushtëzuar sa i përket personave për të cilët po diskutojmë. Në të kundërtën, do të vjen edhe dhjetëvjeçari, sikur që erdhi gjashtëvjeçari, dhe bota perëndimore do të thotë: ja edhe një turp - sikurse ishte rasti me Srebrenicën - për personat e pagjetur, të zhdukur në Kosovë, e tjera e tjera. Ju faleminderit.

KRYESUESI DŽEZAIR MURATI:

Zahvaljujemo kolegënicu Selvije Halimi. Sledeći diskutant je kolega Hajredin Hyseni, ako je ovde, a neka se pripremi gospodin Nazim.

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI:

Zoti kryesues, të nderuar deputetë dhe familjarë të pranishëm,
Nuk pajtohem me termin: të pagjetur. Mendoj se ky term është një eufemizëm dhe sikur dëshirohet nga dikush që ta humbim adresën e vërtetë të atyre që i kanë rrëmbyer qytetarët e Kosovës qoftë ky i aprovuar edhe nga Parlamenti i mëparshëm.

Së dyti, mendoj se ata janë të rrëmbyer dhe rrëmbyesi është Serbia. Pra, kjo është adresa e vërtetë. Këto janë gjëra të qarta se kush janë rrëmbyesit dhe ku është vendi që ata janë të dërguar dhe në cilën kohë ka ndodhur kjo. Pra dihen ekzekutorët, ata që kanë bërë krimin të cilët duhet të përgjigjen, dhe nuk kemi të bëjmë me të pagjetur. Kemi të bëjmë me të rrëmbyer, sepse regjimi i Beogradit, si ai i Millosheviqit edhe ai i Koshtunicës, i din të gjitha këto dhe vazhdojnë njësoj të bëjnë krime mbi ta.

Mendoj se trajtimi i një plage të tillë nuk ka një qasje adekuate si nga institucionet vendore ashtu edhe nga faktori ndërkombëtar. Kjo plagë dhe zgjidhja e saj do të duhej të ishte në agjendë parësore si për institucionet vendore ashtu edhe për bashkësinë ndërkombëtare dhe një plagë e tillë të mos bartej edhe pas gjashtë viteve të luftës.

Duke parë angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare, e cila po të merrej seriozisht do ta zgjidhte këtë çështje, dhe institucionet si e trajtojnë këtë çështje, krijohet përshtypja se ata këtë e trajtojnë vetëm sa për të krijuar përshtypjen se ata nuk e kanë harruar këtë, se ata e dinë se qytetarët e Kosovës janë të rrëmbyer nga një fqinj yni i cili ka qenë okupator. Ndërsa, krerët e institucioneve me një zgjedhje të madhe, të pashpjegueshme i dëgjon të deklarojnë se ata janë të gatshëm të takohen edhe me kryeministrin serb, edhe me kryetarin serb pa iu kujtuar se në Serbi ndodhen qytetarë të rrëmbyer të Kosovës.

Çdo takim me ta do të duhej të ishte kusht së pari zgjidhja e fatit të tyre e pastaj të bisedohet me ta për gjëra teknike apo të tjera. Pse të bëhet takimi me kryeministrin serb derisa ai vazhdon të shkaktojë ende vuajtje për qytetarët e Kosovës, vazhdon të veprojë ashtu siç ka vepruar Millosheviqi, vazhdon të luajë me të rrëmbyerit dhe të kthejë herë dhjetë herë pesëdhjetë varësisht se si leverdisë me bashkësinë ndërkombëtare duke bërë pazar për këtë çështje.

Do të duhet vërtetë që për fatin e qytetarëve të Kosovës të ketë një angazhim më serioz edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Mendoj se ekzistojnë mekanizma që Serbinë do të mund ta detyronin të sqaronte fatin e qytetarëve të rrëmbyer dhe këtë në një kohë sa më të shkurtër, sepse vërtetë shumë zhvillime do të varen nga zgjidhja e kësaj plage.

Është e patolerueshme të kërkohet nga shqiptarët që të punojnë për kthimin, që të ketë ambient të qetë kur pikërisht po në këtë vend nga duhet të kthehen ndodhen të rrëmbyerit

qytetarët e Kosovës, fati i të cilëve ende nuk është sqaruar dhe për këtë nuk bëhet trysni e nevojshme nga bashkësia ndërkombëtare. Ajo merret me këtë vetëm si për çështje humanitare, e mendoj se kjo është çështje jetike për këtë shoqëri, për ndërtimin e një shoqërie demokratike.

Sot, me fatin e të të rrëmbyerve, merren kryesisht familjarët e tyre dhe ndonjë organizatë, siç është Rrjeti i KAN-it dhe këta janë ata që na përkujtojnë, që përkujtojnë edhe Qeverinë, po edhe këtë Parlament - se ekziston një çështje e pazgjidhur, se është edhe një punë që don trajtim adekuat gjë që nuk do të duhej të ishte kështu. Institucionet nuk duhet të veprojnë në bazë të emocioneve. Ato duhet të kryejnë obligimin e vet që kanë para qytetarëve. Duhet t'i përdorin të gjitha mekanizmat për të sqaruar fatin e të të rrëmbyerve. Ato nuk duhet që këtë çështje ta ngritin në agjendën e tyre vetëm atëherë kur shohin familjarët e tyre, vetëm atëherë kur dikush ua përkujton këtë çështje.

Në qoftë se ky Kuvend ka ndonjë ndikim në këtë Qeveri, duhet ta obligojë që këtë çështje ta trajtojë me seriozitet të duhur dhe jo vetëm ad hoc – atëherë kur i nevojitet për konsum të brendshëm, apo si çështje humanitare. Qeverisë duhet t'i kërkohet që të mos ketë asnjë bisedim me Beogradin pa zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Në qoftë se ky Parlament është përfaqësues i qytetarëve të Kosovës, duhet ta ndjen njësoj dhembjen për të rrëmbyerit sikurse familjarët. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Nazim Jashari, le të përgatitet Nait Hasani.

DEPUTETI NAZIM JASHARI:

Ju përshëndes – familjarë të nderuar. Ju përshëndes kolegë deputetë, posaçërisht juve deputetë të koalicionit qeveritar të cilët ia dolët që ta shtyni përpara një temë kaq të rëndësishme dhe kaq esenciale për momentet nëpër të cilat po kalon Kosova sot – çështjen e të zhdukurve, pengjeve apo të pagjeturve, të cilat janë nocione të cilat po përdoren shumë shpesh dhe të cilat reflektojnë edhe një pasaktësi do ta quaja terminologjike në trajtimin e këtij problemi kaq madhor.

Është kjo një temë, për të cilën është bërë përpjekje maksimale nga ana e opozitës që të shtyhet përpara në këtë Kuvend por ka hasur në vesh të shurdhër nga kryesuesit e Kuvendit dhe nuk e kanë pa të arsyeshme ta fusin më herët në agjendë – përderisa nuk e morët ju këtë punë në dorë.

Prandaj, ju përshëndes posaçërisht, por përshëndes edhe Kryetarin e Kuvendit i cili sot pati durimin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm që t'ju dëgjojë të gjithëve juve dhe të mos kërkojë nga ju që ta dorëzoni fjalën me shkrim.

Përshëndes edhe deputetin i cili, duke ndër veten mbase të marginalizuar nga zhvillimet aktuale politike në Kosovë, jo nga Grupi Parlamentar ORA me siguri por nga grupi i tij

parlamentar dhe nga partia të cilës i takon po i cili duke mos pasur çka t'i bëj "kalit i mëshon samarit" duke akuzuar këtu të tjerët se po përpiqen të shtyjnë terminologji private ose terminologji të cilat nuk i përkohjnë problematikës me të cilën sot po merremi.

Dhe unë mendoj se një nga problemet themelore të cilat e identifikojnë këtë mosgjdhje të kësaj çështjeje dhe të këtij problemi është pikërisht terminologjia e përdorur deri më sot. Sepse, të nderuara zonja dhe zotërinj, nuk është njësoj sikur të thuhet: peng lufte, sikur të thuhet i pagjetur, i humbur rastësisht – sikur të thuhet i zhdukur nga kushedi kush. Pengjet e luftës janë kategori e veçantë e personave për të cilët kërkohet trajtim i veçantë. Pengjet e luftës mund të jenë të gjallë, mund të jenë edhe jo të gjallë dhe të vdekur. Është absurde të thuhet që ka pengje të vdekura. Po pikërisht Serbia po na bind se ka pengje, edhe të vdekura sepse mënyra se si po trajton njerëzit apo trupat e njerëzve, trupat e pajetë të njerëzve tanë atje të cilët janë të identifikuar aktualisht me emër, me mbiemër dhe mënyra se si po i kthen në Kosovë flet se ajo po i trajton si pengje dhe po përpiqet të përfitojë nga fatkeqësia e tyre.

Unë kisha apeluar te ky Kuvend që në këtë moment dhe për këtë temë, për këtë çështje kaq të ndjeshme dhe kaq të dhembshme për shumicën e qytetarëve të Kosovës të mos kemi ndarje partiake, nuk na duhet. Kemi çështje tjera për të cilat mund të kemi ndarje partiake dhe kemi çështje tjera për të cilat do të dëshmojmë zotësinë tonë për ta qeverisur ose mos qeverisur këtë vend. Kjo është çështje e cila kërkon një pajtueshmëri të plotë, kërkon një konsensus.

Dhe, ju njoftoj zonja dhe zotërinj, se sot pikërisht në Forumin politik të Kosovës nga Grupi i ORA-s, nga kryetari i ORA-s u ngrit çështja e formimit të një grupi punues i cili do të merret ekskluzivisht me fatin e pengjeve të luftës dhe kjo iniciativë e tij hasi në përkrahje edhe nga kryetari i Kosovës edhe nga të pranishmit tjerë aty, në atë forum.

Kjo temë dhe mënyra se si po trajtohet kjo temë nga deputetët, nga parafolësit e mi, flet për një seriozitet në qasje, flet për një nevojë, për një rishikim të strategjisë së përdorur deri më sot mbase ky Kuvend duhet më shpesh ta shtrojë këtë çështje në rend dite derisa të mos zbardhet përfundimisht fati edhe i pengut të fundit apo i personit të fundit të pagjetur. Dhe kjo mund të bëhet vetëm në rast se ne e vendosim këtë temë në rend dite saherë që kërkohet dhe saherë që të jetë nevoja, sepse askush këtë punë nuk mund ta bëjë vetëm, askush nuk mund ta bëjë vetëm presionin tek instancat kryesore vendimtare në Kosovë po qe se ne si grup i tërësishëm apo si Kuvend i Kosovës nuk e bëjmë me një zë presionin tek ta.

Sigurisht se do të ndodhë kjo që po ndodhë, që Qeveria e Kosovës të ketë prioritete tjera të cilat ia imponojnë të tjerët, sepse mosperceptimi i prioriteteve tona, mosperceptimi i prioriteteve nga ky Kuvend, nga deputetët e këtij Kuvendi të cilat do t'i imponoheshin kësaj Qeverie bën që të tjerët ta gjejnë "sheshin dhe ta bëjnë përsheshin". Ata fusin decentralizime, fusin standarde edhe pa standarde, fusin bashkim të komunave kadastrale si t'u teket sepse Qeveria jonë lejon që të tjerët të fusin tema dhe të fusin çështje të cilat për ne, nuk them se janë të parëndësishme, por me siguri nuk e kanë peshën e çështjes për të cilën po diskutojmë sot.

Prandaj, ky Kuvend do të duhej që të ngritej dhe ta thotë zërin e vet fuqishëm që fati i këtyre njerëzve definitivisht të zbardhet, që këta njerëz definitivisht – qofshin gjallë qofshin të vdekur të kthehen në Kosovë, që qytetarët tanë – ata të cilët i kanë më të afërm e të zhdukur, të pagjetur, pengje – t'i marrin dhe në qoftë se janë të vdekur t'i varrosin me nderime që meritojnë dhe me pietetin që kjo shoqëri duhet ta shfaqë gjithmonë për ta sepse ishin pjesa më e rëndësishme e cila e mobilizoi botën perëndimore për t'na ardhë në ndihmë në momentin më kritik. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

E ka fjalën Nait Hasani dhe i fundit Xhevat Bislimi. Urdhëroni zoti Hasani.

DEPUTETI NAIT HASANI:

Faleminderit zoti Kryetar. Përshëndes familjet që sot kanë ardhur këtu, e t'na dëgjojnë, si kryetarja e Komisionit për familje të pagjetura e të zhdukura, e unë mendoj se është për familjet e depërtuara apo të rrëmbyera pikërisht sepse me 9 – 10 qershor është bërë rrëmbimi dhe deportimi i tyre në Serbi. Mendoj që, kur është bërë kjo, atëherë nuk ka qenë Parlamenti ynë por ka pas mundësi të bëhen disa pengesa të cilat ne sot mund t'i gjykojmë në forma të ndryshme.

Rrethanat të cilat i kemi të krijuara sot dhe të cilat i kemi pas të krijuara pak më herët, neve na ofrohen ato mundësi që sot ta ngrisin zërin edhe një herë dhe të kërkojmë me këmbëngulje se çdo formë e bisedimeve apo bashkëbisedimeve me Beogradin si një nga kushtet të jetë edhe kthyerja e kufomave të deportuara në Serbi me 10 qershor apo edhe para 10 qershorit.

Unë kam parasysh ato mjaft viktime, mjaft njerëz të masakruar, të vrarë dhe mund të them se një e treta e këtyre të masakruarve gjendet në rrethin nëpër Drenicë apo në rrethin e Prizrenit. Vetëm një fshat – Krushë e Vogël e cila me madhësinë e banorëve me 40 shtëpi i ka 120 të masakruar, i ka të djegur dhe eshtrat e tyre të djegura janë bartur dhe varrosur në Serbi. Përveç Krushës së Vogël kemi edhe Krushën e Madhe, Bellacërken, Celinën që kanë diku rreth 800 të masakruar. Po çështjet që është dashtë dhe duhet të ngriten, pikërisht edhe të atyre që kanë mundësuar të mbajmë edhe në këtë Parlament, atyre që kanë ndikuar me punën e tyre, me angazhimin e tyre politik është edhe çështja e Ukshin Hotit, Xhavit Hazirit, Hysen Zogjanit – njerëz të zhdukur, njerëz të arrestuar për të cilët as ky Parlament as Qeveria e kaluar as kjo Qeveri nuk kanë bërë sa duhet.

Mendoj që pa këta dy: Ukshin Hotin, por njëherit edhe Xhavit Hazirit që ka qenë bërthamë kryesore e të gjitha ndryshimeve politike nga vitet e 80-ta e deri në ditët në prag të çlirimit ky Parlament është dashur të ngritet në nivelin e duhur dhe t'i japë vend të merituar, dhe kërkojë me këmbëngulje formën çarë duhet për bisedim, të çdo bisedimi me ndërkombëtarët apo edhe me Serbinë. Nëse ne nuk iu dalim në mbrojtje dhe në kërkesa të tyre, këto mund të themi do t'na vazhdojnë në kohë më të gjatë sikur se kanë vazhduar e po vazhdojnë edhe në Bosnje me të pagjeturit.

Mendoj se për çështjen e Ukshin Hotit ka mundësi të kërkohej kushtëzim, dhe ky Parlament duhet të bëjë kërkesë publike edhe ministrisë së Serbisë, bashkësisë ndërkombëtare sepse dihen personat të cilët e kanë marrë Ukshin Hotin, ku e kanë çuar dhe çfarë është bërë me të. Unë e them këtë, sepse drejtori i burgut të Dubravës - Aca Rakoçeviçi ka qenë prezent. I quajtori Miki - komandant i burgut, por njëherit edhe Branku mbikëqyrës. Të gjithë këta e dinë ku është dhe çfarë është fati i Ukshin Hotit.

Prandaj, ky Parlament duhet të bëjë çmos e të kërkojë me formë të veçantë dhe të dihet për fatin e tij. Nëse ne nuk e bëjmë këtë, ne kemi bërë një mëkat, mëkat dhe neve do t'na gjykojë e ardhmja. Për të gjithë këta të deportuarit, mendoj se është deportim i kufomave të masakruara që janë bërë këtu – është larje dhe fshirje e gjurmëve të cilat Serbia i ka bërë në Kosovë. Për t'i fshirë këto gjurmë, ajo edhe sot bën përpjekje që neve t'na kthejë me nga 10, 15 dhe kështu të mundohet të tregojë se nuk ka ndodhë asgjë në Kosovë e kur e dimë se në Kosovë ka ndodhë një luftë, dhe ka ndodh një gjenocid i Serbisë ndaj shqiptarëve në Kosovë.

Prandaj, për të mbërri atje ku ne duam, mendoj se grupi punues i Komisionit duhet ta formojë një rezolutë, rezolutë e plotësuar e cila do t'i mbështesë kërkesat e këtij Parlamenti që të arrijmë e të bëjmë diç të paktën aq sa mund të bëjmë për familjet dhe të kenë si ngushëllim se ne po mundohemi të bëjmë përpjekjet tona. Mendoj se kusht kryesor është që Serbisë t'i vijmë përballë dhe të thojmë se çdo formë e bisedimeve duhet të vendoset me kushtin e kthimit të deportuarve, të masakruarve dhe kthimi i eshtrave të tyre në Kosovë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Edhe Xhevat Bislimi. Urdhëroni Xhevat.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI:

Faleminderit zoti Kryetar. Të nderuara familje të të zhdukurve, të nderuar kolegë deputetë,

Edhe gjashtë vjet pas asaj që po e quajmë çlirim, ky Kuvend edhe sot u mbledh për të bërë llafe, për të rrahur ujë në havan dhe për të thënë se nuk mund të bëjmë asgjë. Këtë, mjerisht e dëgjova nga shumë kolegë deputetë të pozitës, të cilët defakto ngritën duart dhe thanë – nuk kemi çka të bëjmë.

Unë mund të them se kjo është një rrenë e kulluar sepse këto institucione të Kosovës dhe veçmas Kuvendi i Kosovës, organi i vetëm legjitim i zgjedhur në mënyrë demokratike, përfaqësues i këtij populli është institucion i cili ka mund të bëjë dhe mund të bëjë shumë më shumë sesa që ka bërë për çështjen e të zhdukurve ashtu sikurse edhe për çështje të tjera të rëndësishme jetike, të rëndësishme së stabilitetit dhe gjendjes së mirë politike në vendin tonë.

Është mirë që dikush propozoi nga opozita që grupet parlamentare, forcat politike, të kenë një konsensus për çështje madhore si kjo, por mësa duket pozita edhe kësaj here do ta billokojë këtë iniciativë të qëlluar të një kolegu nga opozita ose disa kolegëve nga opozita. Duhet të lëmë anash dallimet partiake, përkatësitë partiake për çështje të tilla madhore dhe të ndërtojmë konsensus, të marrim vendime politike sepse nuk jemi këtu që të vajtojmë, siç e tha një kolegj nga pozita, ndoshta jemi bërë për t'na vajtuar populli ynë por jo ne të vajtojmë. Ne kemi një funksion dhe funksione politike dhe ky organ ka marrë përsipër që t'i dalë zot interesave të Kosovës dhe të popullit të saj. Nuk di që ka ndonjë deputet që dikush e ka detyruar me forcë që të vëjë kandidaturën e tij për deputet dhe që e ka detyruar kush të vijë me dhunë në këtë Kuvend dhe të ngre duart e të thotë se nuk kemi çka të bëjmë. Më poshtë se kaq, nuk ka ku të bjerë katundi ose paria e katundit, më mirë me thënë.

Unë mendoj se ky Kuvend është dashur tashmë, por në qoftë se nuk e ka marrë deri tash duhet ta marrë sot ose në një seancë të ardhshme një vendim politik me të cilin kushtëzohet çdo bashkëpunim ose çdo kontakt me qeverinë e Beogradit. Dhe të jeni të bindur, se pas këtij vendimi politik i cili do ta obligonte edhe Qeverinë edhe Kryetarin të zgjedhur nga ky Kuvend pas këtij vendimi politik bashkësia ndërkombëtare do të lëvizë. Nuk na ka faj bashkësia ndërkombëtare, nuk e ka hallin vetëm të viktimave tona bashkësia ndërkombëtare. Ka halle të mëdha tjera bashkësia ndërkombëtare. Ka probleme të mëdha në botë. Prandaj, është e jona të lëvizim, dhe jo e bashkësisë ndërkombëtare. Është e jona të hapim rrugë që të na përkrah bashkësia ndërkombëtare. Ishte lufta e UÇK-ës ajo që e solli bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë, dhe jo llafet. Prandaj, edhe tash, me këto llafe kurrë bashkësia ndërkombëtare s'do të lëvizë, as s'ka për të lëvizur as për çështjen e të zhdukurve.

Pse nuk u kushtëzua kthimi i të gjallëve me kthimin e kufomave tona. Është një çështje që mund të zgjasë ta zëmë në vite identifikimi i tyre, por nuk ka nevojë të zgjatet kthimi i tyre, sepse identifikimi mund të bëhet në Kosovë. Kush nuk e din se Qeveria e Serbisë - edhe kjo aktuale - i ka të gjitha të dhënat për secilin individ që është rrëmbyer, është ekzekutuar apo është i gjallë në Serbi. Secili njeri e din. Nuk ka budalla, veç ne po bëhemi ose po shtiremi sikur nuk dimë gjë, naivë politik deri në ekstrem. Sot vajtojmë këtu. Ne nuk jemi për të vajtuar. Për të vajtuar janë familjet e tyre që po vajtojnë tash gjashtë vite dhe po presin zgjidhje nga ne. Dhe, kanë arsye. Ne jemi të ofrojmë zgjidhje, jo të vajtojmë. Ka kush të vajtojë.

Pse nuk u kushtëzua ardhja e Tadiçit në Kosovë, por u miratua nga kryetari dhe kryeministri i Kosovës. Pse nuk u kushtëzua ardhja e Koshtunicës? Pse nuk u kushtëzua ardhja e Drashkoviçit? Pse nuk u kushtëzua decentralizimi? T'i lëmë llafet, t'i lëmë proçkat dhe mashtrimet që po i bëjmë këtij populli për çdo ditë. Dhe nëse nuk mund të bëjmë asgjë, të dalim nga këtu dhe t'i shuajmë këto institucione që nuk mund të bëjnë asgjë, sepse institucione të tilla nuk i duhen as Kosovës, as bashkësisë ndërkombëtare, as Ballkanit, sepse këto do ta çojnë paqen, sigurinë në Ballkan drejt rreziqeve të reja. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Më lejoni, në përfundim të debatit t'i them dy-tri konstatime të përgjithshme. Nën një. Heq petkun partiak të hyrjes të secilit diskutim. Pjesa tjetër ka qenë mëse e dobishme, cilësore dhe që krijon një propozim të ri, një qasje të re, prandaj nuk qëndron ajo – pas më tepër se gati 60 diskutantëve në Parlament – që nuk ka konsensus në Kosovë për çështjet më vitale dhe më të dhembshme që i ka Kosova. Për pjesë të vogla të ndonjë diskutimi është çështje e emocioneve dhe e ndjenjave, që është normale ta përcjellin një debat të tillë.

Karakteristika e dytë, është se ka një pakënaqësi të përgjithshme nga i tërë Parlamenti me udhëheqjen e Kryetarit të Parlamentit sepse kinse radhën e diskutuesve nuk e ka bërë si duhet. Është e qartë, se për 60 diskutues është shumë vështirë me ia dhënë të parit ose të fundit fjalën, ose me pas radhitje si duhet. Mirëpo, në qoftë se i analizoni transkriptet me vëmendje do të shihni se megjithatë forca parlamentare është respektuar gati krejtësisht.

Dhe nëni tre. Ajo që është kryesorja në emrin tuaj – kolegë deputetë, i falënderoj të pranishmit – familjarët dhe ata që për këto gjashtë vite u munduan më së shumti, kurse ne nuk mundëm të bëjmë atë që realisht pret Kosova dhe kosovarët. Është lehtë me kritikuar një kryeministër të mandatit të kaluar, një kryeministër në fillim të këtij mandati, ose relesh raketash në kryetarin e Parlamentit ose në ndokënd tjetër por do të jetë mençuri që të kontribuojmë në shkurtimin e rrugës së vuajtjeve, dhe të marrzinave që po i lejojmë bashkërisht me bashkësinë ndërkombëtare që në doza sa të dojë - ai që e shkatërrojë krejt Kosovën - të na sjell në Merdare.

Në emër të kësaj unë falënderoj dy komisionet që janë munduar të krijojnë një rezolutë ose deklaratë. Unë do ta preferoj të jetë deklaratë, që të mos jetë shumësi e rezolutave, sepse rëndësia është e njëjtë, por për shkak të kohës së shkurtër ka mendime substanciale se kjo deri në ditën e nesërme mund të përmirësohet, të bëhet një dokument që e përfaqëojmë të gjithë dhe në seancën e nesërme në fillim besoj do ta aprovojmë. Prandaj, ju faleminderit për pjesëmarrje në debat. Shihemi nesër.

(Puna e Seancës të datës 21.07.2005 përfundoi punën në orën 17.10.)

(Seanca vazhdon punën nesër më 22.07.2005 në orën 10.00)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirë mëngjes.

Mirëseardhje në vazhdim të seancës plenare ose në sesionin e sotëm. Shpresojë se ajditë i keni me veti, prandaj vendosni se vetëm 65 kartela janë të vendosura. Para se të fillojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, unë ju lus që këtë që e keni Ministri Qemajl Ahmeti, njoftoi dje gojarisht, por edhe sot me shkrim se zyrtarisht është jashtë vendit

sot. Pyetjes së kolegut Muhaxheri t'i përgjigjet, andaj ngel për një seancë tjetër, vetëm ta dini do të thotë pika 17 e rendit të ditës hiqet sot nga rendi i ditës. Kalojmë në shqyrtimin e dytë të Projektligjit për procedurën kontestimore. Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë me 20 maj 2005. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, si komision funksional e ka shqyrtuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin dhe rekomandimin me propozim që Projektligji për procedurën kontestimore t'i kthehet propozuesit- Qeverisë për ripunim. Unë lus kryetarin e Komisionit Hydajet Hysenin që një sqarim t'ia jep seancës plenare.

Fjala është juaja Hydajet .

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

I nderuar zoti kryetar, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislative, Kornizë Kushtetuese, Barazi Gjinore dhe Peticione Publike e ka shqyrtuar edhe një herë Projektligjin për procedurën kontestimore, të shqyrtuar dhe të miratuar në parim në këtë Kuvend . Pas shqyrtimit të gjithanshëm ka arritur në këtë përfundim, që t'i rekomandojë Kuvendit të Kosovës ta rikthejë Projektligjin për procedurën kontestimore për ripunim të mëtejshëm te propozuesi i tij, Qeveria. Sipas nenit 20. pika 1 dhe nenit 2, pika 3 të Rregullores të punës së Qeverisë, vendimit të Qeverisë të 01.2005 për hartimin e dorëzimit legjislacionit dhe rregullave 33.1 dhe 33.2 të Rregullores të punës së Kuvendit, ligjet e hartuara nga Qeveria, duhet të jenë të hartuara sipas metodologjisë dhe standardit unik dhe të jenë në përputhshmëri me Kornizën Kushtetuese. Gjatë shqyrtimit të projektligjit në fjalë, Komisioni ka konstatuar mangësi të shumta formale dhe materiale në projektligj. Komisioni ka konstatuar se formatizimi i projektligjit nuk është bërë në mënyrë të duhur. Paragrafët e neneve nuk janë të evidencuar me numra, kurse në tekstin e projektligjit hartuesi u referohet paragrafëve të pa qenë në projektligj, por më tepër janë evidencuar me numra vetëm 9 paragrafët dhe atë vetëm në disa raste, kështu që çdo referencë në projektligj shkakton konfuzion lidhur me tekstin që i referohet. Kjo natyrisht mund të shkaktojë vështërsi të mëdha në zbatimin e ligjit. Komisioni konstaton se projektligji ka mangësi, lëshime e gabime të shumta, që nuk mund të evitohen me procedurën e amendamenteve. Komisioni ka vërejtur edhe dallime qenësore ndërmjet versioneve gjuhësore të projektligjit. Teksti në versionin shqip, serbisht dhe anglisht nuk përputhen në disa nene. Natyrisht, këto do të ishin të mjaftueshme për ta kthyer ligjin siç edhe ka qenë një qëndrim i Kryesisë. Ligjet nuk mund t'i dërgohen Kuvendit vetëm si lëndë e parë, po për më tepër do të jetë edhe arsyeja kryesore. Ndoshta Komisionit i ka arritur, po ashtu , një shkresë nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut që pretendon se ky projektligj hyn në fushat e rezervuara të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe për këtë arsye siç është thënë, nuk mund të procedohet më tej në Kuvend. Për më tepër udhëheqësi i Zyrës Ligjore të UNMIK-ut, në mbledhjen e Komisionit të datës 6 qershor 2005, i ka informuar anëtarët e Komisionit se zyra e tij e ka njoftuar Qeverinë e Kosovës me kohë për vërejtjet e UNMIK-ut lidhur me këtë projektligj. Propozuesi i ligjit të memorandumit të tij shpjegues nuk përmend fare komunikimin me UNMIK-un dhe konstaton pa arsyetim juridik se ky projektligj është në përputhshmëri me Kornizën Kushtetuese dhe me pushtetin e institucioneve të

Kosovës. Së fundi, memorandumit shpjegues, propozuesi konstaton se zbatimi i projektligjit nuk do të ketë implikime buxhetore, ngase nuk krijohen agjenci ose organe të reja. Ky konstatim është vetëm pjesërisht i saktë, ngase propozuesi nuk ka paraparë shpenzime për trajnimin e gjyqtarëve dhe të stafit të gjykatave lidhur me ligjin e ri. Trajnimi i gjyqtarëve dhe stafit të gjykatave dhe avokatëve është qenësore për implementimin e këtij ligji. Shpenzimet lidhur me trajnimet duhet të evidencohen, në mënyrë që të sigurohen mjete të mjaftueshme nga buxheti i Kosovës ose nga donatorët. Për arsyet e lartpërmendura, Komisioni i rekomandon Kuvendit që t'ia kthejë Projektligjin propozuesit për ripunim të mëtejshëm. Njëkohësisht, rekomandohet që propozuesi në memorandumit sqarues t'i inkorporojë vërejtjet e UNMIK-ut lidhur me projektligjin dhe qëndrimet e argumentuara të Qeverisë, në mënyrë që Kuvendit t'i jepet gjendja që të marrë qëndrim lidhur me këtë çështje dhe projektligjin në përgjithësi. Së fundi, propozuesi është i obliguar që t'ia bashkangjes memorandumit shpjegues edhe deklaratën e implikimeve financiare për implementimin e ligjit. Jemi shumë të interesuar që të përshpejtojmë procesin e ligjvënies në Kosovë, por zonja e zotëri, ne jemi bindur se me ligje që do t'i kalonim shpejt e shpejt, me mangësi e defekte të shumta, së pari nuk e ndihmojmë, por e ngatërrojmë procesin e ligj dhënies, kurse së dyti pamundësohet sidomos zbatimi i ligjeve në praktikë, që te ne është një fenomen shumë evident. Ju falem nderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit zoti kryetar i Komisionit funksional. Unë e ftoj seancën që të deklarohejmë. Ju e dini që mendimi i Komisionit funksional gjithmonë është udhërrëfyes në vendimmarrje, prandaj ju ftoj kush është për këtë vendim të Komisionit funksional. Ju faleminderit. A ka ndonjë votë kundër? Është një votë kundër. A ka abstenime dhe pse në rregullore nuk është? Edhe një votë abstenime. Prandaj konsideroj se propozuesi duhet ta vazhdojë procedurën sipas këtij vendimi dhe të rekomandimeve të Komisionit.

Kalojmë në pikën e radhës: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbeturinat

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë me një 20. maj 2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente. Amendamentet i kanë të gjithë deputetët. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se projektligji për mbeturina ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese, Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit të mbeturinave, amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për mbeturinat dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojë të drejtat dhe interesat e komisioneve. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor si Komision funksional dhe raportues, Departamenti për Mbështetje Ligjore dhe procedurale e ka bërë radhitjen e rekomandimeve dhe amendamenteve, do të thotë amendamentet janë të Komisionit funksional. Unë e lus regjinë që të përgatitemi për vendimmarrje të miratimit të amendamenteve. Regjia është gati

Amendamenti 1

votojmë tani

Për 54

Kundër 4

Konsideroj që ka kaluar amendamenti 1.

Unë ju lus që të kemi kujdes, i kemi në dorë, i ke Nekibe. Ju lutem, por në qoftë se ka nevojë, unë e konsideroj se ka kaluar amendamenti ,do t'u jap kohë më shumë,.Shikoni numri 4 është, po numri 2 po më duket është. Ju e keni udhëzimin secili edhe ju lutemi funksionon mireë dhe mos të humbim kohë. Konsiderojmë se amendamenti 1 ka kaluar.

Amendamenti 2

Regjia të bëhet gati, përgatitemi për vendimmarrje, votojmë tani:

Për 76

Kundër 1

Konstatoj që ka kaluar amendamenti 2.

Amendamenti 3

Përgatitemi për vendimmarrje, votojmë tani:

Për 73

Kundër 3

Konsideroj që amendamenti 3 ka kaluar.

Amendamenti 4

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 75

Kundër 1

Konsideroj që amendamenti 4 ka kaluar.

Amendamenti 5.

Përgatitemi për vendimmarrje, votojmë tani:

Për 77

Kundër 2

Konsiderojmë që ka kaluar amendamenti 5 .

Amendamenti 6.

Përgatitemi për vendimmarrje, votojmë tani:

Për 76

Kundër 2

Amendamenti i 6 ka kaluar.

Amendamenti 7.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 74

Kundër 2

Konsideroj se ka kaluar amendamenti 7.

Prandaj konsideroj se edhe ky amendament është miratuar. Ky ishte amendamenti i fundit në këtë projektligj. Ju ftoj që tani të marrim vendim për ligjin në tërësi me amendamentet e miratuara - përgatitemi.

Urdhëroni zoti Jashari, jepni mikrofonin

DEPUTETI NAZIM JASHARI

Zonja dhe zotërinj, deputetë. Në bazë të Rregullores se re të punës ne kemi të drejtë të debatojmë për projektligjin para votimit. Ne si grup parlamentar i përkrahëm të gjitha amendamentet që u vunë në votim dhe votuam për to. Mirëpo, po ashtu, si grup parlamentar nuk do të votojmë për këtë projektligj dhe duam të tregojmë se pse. Unë jam anëtar i këtij Komisioni, prandaj duke qenë anëtar i Komisionit kolegët e mi e dinë afërsisht vërejtjen të cilën do ta bëjë se të njëjtën e kam bërë edhe në Komision. Është fjala për qarkullimin ndërkufitar të mbeturinave. E kemi në kapitullin 9, neni 34. Po që se nuk pretoni çelëni Projektligjin dhe do t'i shihni aty dy pikat të cilat janë shumë kontradiktore, do të thosha edhe indikativë për materien me të cilën merret ky ligj dhe për të ardhmen e Kosovës si vend që mund të shndërrohet në depo të mbeturinave të rrezikshme. Në pikën 34,3 lejohet importimi i mbeturinave jo të rrezikshme në Kosovë, vetëm kur ekzistojnë objektet dhe pajisjet adekuate për trajtim dhe nëse lejohet nga Ministria. Në pikën 34.4 ndalohet importimi transit i mbeturinave, përveç kur lejohet nga Qeveria. Unë nuk dua të paragjykoj, sepse konsideroj se kjo Qeveri është e përgjegjshme dhe që nuk do të ndërmerr hapa të tillë të papërgjegjshëm për të lejuar transitin dhe importimin e mbeturinave të rrezikshme. Po, merre në mënyrë hipotetike një qeveri jo të papërgjegjshme, një qeveri që mundohet të jetë në krye të detyrës dhe mos kryej detyrën si duhet dhe që në një kombinim ta quaj ashtu hipotetik ta shndërrojë Kosovën në depo mbeturinash të rrezikshme, prandaj për këtë arsye, për këtë pikë të nenit 34 Grupi ORA e kundërshton këtë projektligj dhe kërkon që t'i kthehet hartuesit dhe që të trajtohet më tutje. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zoti Jashari, kemi qenë në proces të vendimmarrjes. Është dashur këtë vërejtje ta jepni në fillim, sepse unë me këtë kam bërë thyerje të procedurës të udhëheqjes së Kuvendit. Nuk kemi më fjalë, u krye. Ju lutem përgatitemi për proces të vendimmarrjes të ligjit me amendamentet e miratuara. Regjia bënë përgatitjet, votojmë tani:

Rezultati i votimit është:

Për	53
Kundër	23

Prandaj konsideroj që është miratuar ligji në shqyrtim, Ju faleminderit.

Faleminderit dhe vetëm një fjalë pata. Unë në tërësi kam qenë në veti me atë që e ka ngritë deputeti, por kjo është dashtë edhe në lexim të parë të mundohet që të fitohet seanca plenare, sepse një prej rreziqeve më të mëdha që i paraqitet çdo shoqërie është pikërisht ajo që e kanë. Por kur hyjmë në proces të vendimmarrjes, ju lutem mos provoni se të tjerët pastaj po ngritën tensione dhe të përfundojë procesi i vendimmarrjes ose gjithmonë shqetësimet e arsyeshme ose që e ndien dikush le t'i thonë në kohën e duhur.

Pika në vazhdim është: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rritur.

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë me 21 prill 2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendi ia kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport si Komision funksional dhe raportues Departamenti për Mbështetje Ligjore dhe Procedurale në vijim jep radhitjen e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për aftësimin, arsimin dhe aftësimin për të rritur. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese. Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rritur dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rritur dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Edhe një herë po theksoj se amendamentet dhe rekomandimet janë të Komisionit funksional.

Amendamenti 1.

Përgatitemi për vendimmarrje, votojmë tani:

Për 72,

Kundër 4

Prandaj konstatoj se ka kaluar amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 71

Kundër 4

Ka kaluar amendamenti 2

Amendamenti 3.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 68

Kundër 2

Amendamenti 3 ka kaluar.

Amendamenti 4.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 70

Kundër 2

Amendamenti 4 ka kaluar.

Amendamenti 5.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 62

Kundër 3

Ka kaluar amendamenti 5

Amendamenti 6.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 71

Kundër 6

Ka kaluar amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 71

Kundër 5

Ka kaluar amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 67

Kundër 3

Ka kaluar amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 69

Kundër 3

Ka kaluar amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Përgatitem për votim, votojmë tani:

Për 64

Kundër 3

Ka kaluar amendamenti 10.

Amendamenti 11

Përgatitem për votim, votojmë tani:

Për 71

Kundër 2
Ka kaluar amendamenti 11.

Amendamenti 12.
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 70
Kundër 2
Ka kaluar amendamenti 12.

Amendamenti 13.
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 65
Kundër 3
Ka kaluar amendamenti 13.

Amendamenti 14.
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 65
Kundër 1
Ka kaluar amendamenti 14.

Amendamenti 15.
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 69
Kundër 2
Ka kaluar amendamenti 15.

Amendamenti 16.
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 70
Kundër 2
Ka kaluar amendamenti 16.

Amendamenti 17.
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 70
Kundër 2
Ka kaluar amendamenti 17.

Amendamenti 18.
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 70
Kundër 4
Ka kaluar amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 66

Kundër 2

Ka kaluar amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 65

Kundër 2

Ka kaluar amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 67

Kundër 2

Ka kaluar amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 67

Kundër 1

Ka kaluar amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 61

Kundër 0

Ka kaluar amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 60

Kundër 2

Ka kaluar amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 65

Kundër 0

Ka kaluar amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 57

Kundër 3

Ka kaluar amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 68,

Kundër 2

Ka kaluar amendamenti 27.

Amendamenti 28

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 65

Kundër 2

Ka kaluar amendamenti 28.

Amendamenti 29

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 62

Kundër 2

Ka kaluar amendamenti 29.

Amendamenti 30

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 64

Kundër 3

Ka kaluar amendamenti 30.

Amendamenti 31

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 67

Kundër 1

Ka kaluar amendamenti 31.

Amendamenti 32

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 71

Kundër 3

Konsiderojmë se ka kaluar amendamenti 32.

Amendamenti 33

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 63

Kundër 1

Ka kaluar amendamenti 63.

Amendamenti 34

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 65

Kundër 4
Ka kaluar amendamenti 34.

Amendamenti 35
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 66
Kundër 1
Ka kaluar amendamenti 35.

Amendamenti 36
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 72
Kundër 2
Ka kaluar amendamenti 36.

Amendamenti 37
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 66
Kundër 1
Ka kaluar amendamenti 37.

Amendamenti 38.
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 65
Kundër 2
Ka kaluar amendamenti 38.

Amendamenti 39
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 66
Kundër 1
Ka kaluar amendamenti 39.

Amendamenti 40
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 66
Kundër 2
Ka kaluar amendamenti 40.

Amendamenti 41
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 68
Kundër 1
Ka kaluar amendamenti 41.

Amendamenti 42

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 66

Kundër 1

Ka kaluar amendamenti 42.

Amendamenti 43

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 66

Kundër 1

Ka kaluar amendamenti 43.

Amendamenti 44

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 68

Kundër 3

Ka kaluar amendamenti 44.

Amendamenti 45

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 70

Kundër 1

Ka kaluar amendamenti 45.

Amendamenti 46

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 64

Kundër 3

Ka kaluar amendamenti 46.

Amendamenti 47

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 71

Kundër 0

Kalon amendamenti 47.

Amendamenti 48

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 67

Kundër 3

Ka kaluar amendamenti 48.

Amendamenti 49. i ka dy propozime:

- a) Komisioni Funkcional,
- b) Komisioni për Buxhet.

A ka ndonjë harmonizim në ndërkohë? Urdhëroni.

Meqenëse unë jam kryetar i Komisionit po e marrë fjalën para Nimonit, ndoshta s'i vjen vështirë.

Kjo është e Komisionit funksional. Besoj se nuk e keni ndryshuar mendjen për qëndrimin e Komisioni funksional, urdhëroni

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ

Zoti kryetar. Fillimisht më lejoni t'i falënderojë anëtarët e Komisionit të gjitha grupeve parlamentare, ekspertët e Ministrisë së Arsimit dhe të ministrive të tjera si dhe ekspertet e jashtëm të cilët në 10 mbledhje të gjata të këtij Komisioni, ku u shqyrtua nen për nen ligji, ndihmuan që me 50 amendamente ta përmirësojnë, në një shkallë të lartë këtë ligj dhe të heqim shumë dilema që patën dalë nga dëgjimi publik dhe në leximin e parë këtu. Sa i përket amendamentit të Komisionit për Buxhet, Komisioni në bazë të Rregullores së përkohshme të Kuvendit të Kosovës ka mbajtur mbledhjen me 14. 7., i ka shqyrtua të katër pikat e këtij amendamenti dhe ka pasur këtë arsyetim për qëndrimin që shihet se është në amendamente. Pika 1 thotë: "Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë për organizimin e arsimit dhe aftësimin të rriturve nga personat juridikë dhe fizikë, pa u regjistruar dhe pa u licencuar". Kjo dispozitë nuk e ka vendin te dispozitat ndëshkuese po del në shumë dispozita për në kapitujt përkatës dhe e kemi pa të pa nevojshëm këtu. Sa i përket pikës 2 ne i pamë edhe ligjet e miratuara deri tash se ekziston gjoba më e ulët dhe gjoba më e lartë. Ne pjesërisht e morëm propozimin e këtij Komisioni dhe ngritëm atë shkallën më të lartë në 10.000 po kështu edhe për pikën 2 dhe vendosem që ndonjë jurist këtu që është të jep mendimin e tij dhe nuk do të ishim kundër nëse juristët binden se ndryshe nga ligjet e tjera mund të jepet një gjobë fikse. Sa i përket pikës katër, plotësisht jemi të pajtimit, d.m.th. dilema është vetëm a të ekzistojë apo jo gjobitja më e ulët dhe më e lartë. Përndryshe Komisioni ka qenë dakord që gjobat të jenë sa më të larta.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Urdhëro Naser, Komisioni për Buxhet

DEPUTETI NASER OSMANI

I nderuar kryetar, të nderuar kolegë.

Ne e kemi shikuar amendamentin 49 në Komision dhe kemi konstatuar se propozimi jonë në këtë rast e ka vendin për arsye se kemi të bëjmë me të vetmin veprim dhe ai është ndalesa e ushtrimit të veprimtarisë për arsimin e të rriturve dhe aftësimin e të rriturve. Kjo nënkupton se duhet të ketë vetëm një gjobë, ajo është fikse për arsye se është vetëm një veprim. Edhe kështu mendojmë si Komision të veprojmë edhe më tutje në rastet e tilla, në mënyrë që të mos ketë për veprime të njëjta dënime të ndryshme për me e eliminuar edhe korrupsionin në fjalë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit!

I dëgjuam të dy versionet

Urdhëro Fatmir Sejdiu, në emër të Grupit

DEPUTETI FATMIR SEJDIU

JU faleminderit zoti kryetar

Ne pra kemi parasysh para vetes dy variantet, dy amendamentet e ndryshme. Mendoj se arsyetimi që e dha Komisioni i Buxhetit është i qëndrueshëm. Arsyeja është shumë e qartë. Pikësëpari është një veprimtari e ndaluar dhe nuk mund të ketë variacione në gjohë ose në masë ndëshkimore se bënë më pak e bënë më shumë. Nëse lihet variacioni në shkallën siç është i propozuar Komisioni funksional 5000 deri 10.000 lejohet mundësia që njeriu ta provojë nuk ec i merr 5000 euro dënim, provon tjetri prapë asisoj dhe këto masa në njëfarë mënyre i stimulojnë veprimet e ndaluara. Komisioni i Buxhetit e ka më të qëndrueshëm dhe e thërras Grupin Parlamentar të LDK-së dhe jap këtë arsyetim që të votojnë për

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Më duhet ta respektoj procedurën. Ju dëgjuat Grupin Parlamentar të LDK-së.
Urdhëroni znj. Nerxhivane

DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI

Në rolin e deputetes dhe si profesionaliste.

Kryetari i Komisionit Funksional për Arsim kërkoi një mendim të juristit . Mendoj se i analizova të dy amendamentet të Komisionit funksional, amendamentin 49 pika a/ dhe Komisionit për Buxhet nën b/ Mendoj se amendamenti i propozuar nga Komisioni për Buxhet ku kërkohet që të ndalohet ushtrimi i veprimtarisë për organizimin e arsimit dhe aftësimin të rriturve nga personat juridik dhe fizik pa u regjistruar dhe pa u licencuar që është shumë në rregull dhe 40.2 në rast të ushtrimit të veprimtarisë për organizimin e arsimit dhe aftësimin të rriturve pa u regjistruar dhe pa u licencuar personi juridik dënohet me gjohë me shumë fikse , pra prej 10.000 euro. Unë konsideroj se shuma e justifikuar në pikëpamja juridike është amendamenti 49, pika b/, prandaj unë mendoj se duhet votohet nën b/.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Prandaj unë mendoj se hyn në procedurë. Amendamenti duhet të vijë i shkruar për të mundur deputetët me vendos, prandaj ne i dëgjuam të dy alternativat, unë kërkoi nga ju që të përgatitemi për proces të votimit sipas propozimeve, ata që janë për Komisionin

funksional nën a/, sepse rrugë tjetër nuk kemi, LDK-ja u përcaktua d.m.th voton për Komisionin për buxhet, me gjithë atë është e drejtë e deputetëve.

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ

Komisioni është dakord pas këtyre sqarimeve z. kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI :

Ju faleminderit, d.m.th votojmë vetëm për propozimin e Komisionit për Buxhet. Futemi në proces të votimit, votojmë tani:

Për 65

Kundër 5

Kalon amendamenti 49, propozimi nën b/ i Komisionit për buxhet.

Amendamenti 50

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 72

Kundër 2

Ka kaluar amendamenti 50 dhe

Amendamenti 51

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 67

Kundër q 3

Ka kaluar amendamenti 51.

Dhe tani ju ftojë që në tërësi ta votojmë ligjin me amendamente, përgatitemi për vendim marrje, votojmë tani:

Për 73

Kundër 2

Konsideroj që është aprovuar Ligji,

Tani do të kemi një orë pauzë. Lus dy komisionet që i kemi autorizuar dhe ta finalizojnë deklaratën ose rezolutën si do ta emërtojmë, në mënyrë që të mos i lodhim më prindërit që janë këtu dhe menjëherë në fillim, pas një ore 12,20 fillojmë punën e seancës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem mund të vazhdojmë, kemi kuorum pune.

Në rend dite është: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën administrative

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë me 22 prill 2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendi i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente përkatëse.

Në bazë të raporteve kryesore dhe Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media si komision funksional dhe raportues. Departamenti për Mbështetje Ligjore dhe Procedurale në vijim jep radhitjen e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për procedurën administrative.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për Procedurën Administrative ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për Procedurë Administrative dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për procedurën administrative dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Amendamentet dhe rekomandimet janë të Komisionit funksional.

Amendamenti numër 1,

Lus regjinë që përgatitemi për të votuar për vendimmarrje dhe votojmë tani:

Rezultati

Për 57

Kundër 5

Kalon amendamenti 1.

Në sallë janë të pranishëm 72 deputetë

Amendamenti 2

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 64

Kundër 2

Kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3

Përgatitemi për vendim marrje dhe votojmë tani:

Për 61

Kundër 1

Kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 61

Kundër 2

Kalon amendamenti 4.

Amendamenti 5

Përgatitemi për votim votojmë tani:

Për 62
Kundër 1
Kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 62
Kundër 2
Kalon amendamenti 6.

Amendamenti 7
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:
Për 61
Kundër 1
Kalon amendamenti 7.

Amendamenti 8
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:
Për 67
Kundër 2
Kalon amendamenti 8.

Amendamenti 9
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:
Për 64
Kundër 2
Kalon amendamenti 9.

Amendamenti 10
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:
Për 70
Kundër 2
Kalon amendamenti 10.

Amendamenti 11
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:
Për 67
Kundër 4
Kalon amendamenti 11.

Amendamenti 12
Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:
Për 70
Kundër 2
Kalon amendamenti 12.

Amendamenti 13

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 65

Kundër 3

Kalon amendamenti 13.

Amendamenti 14

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 68

Kundër 3

Kalon amendamenti 14.

Amendamenti 15

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 70

Kundër 2

Kalon amendamenti 15.

Amendamenti 16

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

73 vota janë për

2 janë kundër

Kalon amendamenti 16

Amendamenti 17

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 73

Kundër 2

Kalon amendamenti 17.

Amendamenti 18

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 75

Kundër 3

Kalon amendamenti 18.

Amendamenti 19

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 72

Kundër 0

Kalon amendamenti 19.

Amendamenti 20

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 75

Kundër 1

Kalon amendamenti 20.

Amendamenti 21

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 70

Kundër 3

Kalon amendamenti 21.

Amendamenti 22

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 74

Kundër 2

Kalon amendamenti 22.

Amendamenti 23

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 70

Kundër 0

Kalon amendamenti 23.

Amendamenti 24

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 74

Kundër 2

Kalon amendamenti 24.

Amendamenti 25

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 69

Kundër 3

Kalon amendamenti 25.

Amendamenti 26 dhe i fundit

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 77

Kundër 2

Kalon amendamenti 26.

Në sallë janë të pranishëm 82 deputetë. Tani e ftoj seancën të votojmë për pranimin e ligjit në tërësi me amendamentet e aprovuara.

Përgatitemi për vendim marrje dhe votojmë tani:

Për 81

Kundër 3

Do të thotë numërimi nuk është bërë në rregull sipas kartelave 91 jemi të pranishëm, por sipas numërimit 82 do të thotë 81 vota janë për, 3 janë kundër. Duhet ta referoj ashtu si e kam në monitor. Konsideroj se ligji në shqyrtim është miratuar me të gjitha amendamentet.

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë me 24 mars 2005. Komisionet parlamentare i kanë shikuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe amendamentet. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energetikë, Transport dhe Telekomunikacion si Komision funksional dhe raportues Departamenti për Mbështetje Ligjore dhe Procedurale ka bërë radhitjen e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informative.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për shërbimet e shoqërisë informatike ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike dhe amendamentet e propozuara nuk përbëjnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Amendamentet dhe rekomandimet janë të Komisionit funksional.

Para se të kalojmë në votim unë edhe një herë i ftojë komisionet që po e harmonizojnë atë deklaratë a rezolutë. Ta përfundojnë punën dhe të kthehen në seancën plenare, në të kundërtën duhet ta marrin në dorë shefat e grupeve parlamentare.

Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës

Amendamenti 1

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 69

Kundër 3

Kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 70

Kundër 2

Kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 75

Kundër 2

Kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4

Përgatitemi për të votuar, votojmë tani:

Për 73

Kundër 2

Kalon amendamenti 4.

Amendamenti 5

Përgatitemi për të votuar, votojmë tani:

Për 69

Kundër 3

Kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 73

Kundër 3

Kalon amendamenti 6.

Amendamenti 7

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 70

Kundër 2

Kalon amendamenti 7.

Amendamenti 8

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Për 79

Kundër 2

Kalon amendamenti 8.

Seanca plenare e dt. 22.7.2005

Pjesa e II, fajli 3 e 4.

Amendamenti 9

Përgatitemi për vendimmarrje votojmë tani:

Për 75
Kundër 2
Kalon amendamenti 9.

Amendamenti 10
Përgatitim për votim, votojmë tani:
Për 71
Kundër 2
Kalon amendamenti 10.

Amendamenti 11
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 73
Kundër 2
Kalon amendamenti 11.

Amendamenti 12
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 70
Kundër 2
Kalon amendamenti 12.

Amendamenti 13
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 66
Kundër 3
Kalon amendamenti 13.

Amendamenti 14
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 69
Kundër 3
Kalon amendamenti 14.

Amendamenti 15
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
Për 70
Kundër 3
Kalon amendamenti 15.

Amendamenti 16

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 69

Kundër 4

Kalon amendamenti 16.

Amendamenti 17

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 70

Kundër 2

Kalon amendamenti 17.

Amendamenti 18

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 71

Kundër 2

Kalon amendamenti 18.

Amendamenti 19

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 68

Kundër 3

Kalon amendamenti 19.

Amendamenti 20

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 62

Kundër 2

Kalon amendamenti 20.

Amendamenti 21

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 63

Kundër 3

Kalon amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 70

Kundër 3

Kalon amendamenti 22.

Amendamenti 23

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Anëtarët e Komisionit 2 minuta tërhiqen prapë.

Për 69

Kundër 3

Kalon amendamenti 23.

Amendamenti 24

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 56

Kundër 2

Kalon amendamenti 24.

Amendamenti 25

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 60

Kundër 2

Kalon amendamenti 25.

Amendamenti 26

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

Për 67

Kundër 3

Kalon amendamenti 26.

Dhe amendamenti i fundit.

Fatmiri Rexhepi, pastaj Sabri Hamiti

FATMIR REXHEPI

Unë kam vërejtje tek amendamenti 27. Nuk e di se si ka ndodhur ky lëshim i Komisionit, por mendoj se ky duhet të tërhiqet se nuk është formulim adekuat dhe duhet të mbetet ashtu siç është propozuar në projektligj..

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. A pajtohet Komisioni funksional, mendimin dua ta dëgjojë Në rregull. Prandaj amendamenti 27 tërhiqet nga procedura dhe ngel ashtu siç ka qenë neni në ligj.

Prandaj tani ju ftojë që të marrim vendim urdhëro Sabri më fal.

SABRI HAMITI

Në esencë unë e përkrah Fatmirin sepse pak a shumë e bënë pa objekt diskutimin që e kisha megjithatë nuk e përjashton atë që dishta të them se vetëm në këtë nenë që është amendament që janë bërë 3-4 gabime gjuhësore që janë qesharake të bëhen kjo rikthen problemin unë i kam pa të gjitha pikat në të gjitha ka gabime dhe ka gabime materiale që janë të rëndësishme te amendamenti 14, te 19 pika c) e tjera të cilat e ndryshojnë kuptimin se nisen njëjës e mbarojnë shumës, problemet nuk janë formale gjuhësore, janë substanciale, unë prandaj insistova me këtë të fundit se është shumë transparent që po thonë për gjithë me pa që në këtë fjali janë tri gabime, d.m.th. gabimet e kësaj natyre kur

dhe unë sugjeroj ne ashtu i votuam. Ju lutem shumë që të shihet ky tekst ,sepse format gjuhësore e dëmtojnë substancën. Ju faleminderit, kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor,ju faleminderit. Është urdhër i seancës plenare që ligji të mos vij në nënshkrim dhe mos t'i dërgohet SPSP pa korrigjimet e nevojshme, megjithatë më lejoni t'ju ftojë që ta votojmë ligjin me amendamentet e miratuara. Përgatitemi për vendimmarje dhe votojmë tani:

Për	69
Kundër	6

Konsiderojë që e kemi miratuar ligjin në shqyrtim.

Urdhëroni. E ka kërkuar fjalën Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOCI

Z. kryetar ,do të dëshiroja që diskutimin tim ta kuptoni si qëllim mirë, por sikur nuk e morët me shumë seriozitet vërejtjen që e dha deputeti Jashari prej Grupit Parlamentar ORA. Ne,sot miratuam 5 ligje që i kishim në shqyrtim të dytë. Deri më tani i kemi pasur 2 rregullore që s'e kemi ditur: Rregulloren e punës së Kuvendit që nuk 'kemi ditur me cilën po punojmë. U gëzua kur e miratuam këtë të fundit dhe thamë: Më në fund do të shkojmë sipas rregullores së fundit, por sikur po na përcjell prapë praktika e punës nga më herët. Rregulla 37 pikë 3 thotë :Në rast kur të gjitha amendamentet e zgjedhura për shqyrtim janë miratuar ose janë hedhur poshtë teksti i projektligjit me ndryshime të bëra do të shqyrtohet pas të jetë caktuar koha për debat të mëtejshëm para votimit përfundimtar. Unë konsideroj se të gjitha këto projektligje për shqyrtim të dytë i miratuam siç i kemi miratuar përpara. Do të dëshironim që tani e tutje në votimin përfundimtar të na sillt komplet projektligji me ndryshimet e bëra sepse edhe gjatë shkrimit dhe futjes së ndryshimeve po ndodhin gabime dhe të evitohen këto gabime. Dhe unë e konsideroj se për këtë çështje ne mund të miratojmë si sot amendamentet e 5 ligjeve dhe në një seancë tjetër të miratojmë ligjin komplet me tekstin e ndryshuar që do ta kemi në dorë.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Gani,ju faleminderit. Departamenti për Procedura e ka dëgjuar, le të mendojë dhe të veprojë konform rregullores. Unë besoj që Hydajeti është gati apo jo. Hydajet, unë mendoj komisionet që janë autorizuar unë e kam një kopje por do doja që kryetarja e tij Komisioni ta lexon tekstin që e keni përgatitur.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

Mendova se është fjala për procedura e thashë s'jam bash tamam pushkë e mbushur gjithmonë.

Të nderuar deputetë. Ishte detyrë jo e lehtë e për dy komisionet që të formulojmë ashtu si u detyruam të punojmë, do të thotë duke improvizuar pa qenë në gjendje as të ndjekim gjithë debatin, pa pas mundësi që të kemi edhe transkriptin e debatit dhe të nxjerrim gjitha çështjet që janë shtruar, prandaj ju lutem që të keni mirëkuptim, nëse në tekstin tonë nuk kemi arritur të sintetizojmë as gjithë shqetësimin tuaj e as gjithë idetë që ky Kuvend i ka shprehur për një çështje aq të dhembshme dhe aq të ndjeshme. Dhe që ne fillim unë duhet t'ju kërkoj ose të bëjë një sqarim që komisionet nuk kanë arritur që të kenë një qëndrim unik me konsensus, siç kemi arritur për çështje të tjera, për emërtimin e dokumentit, megjithatë ka mbizotëruar mendimi i mbështetur edhe nga ekspertet se për çështjen për të cilën do të deklarohemi forma e dokumentit si deklaratë është më adaptuese dhe më e fuqishme. Prandaj ne kemi propozuar që Kuvendi të miratojë një deklaratë dhe teksti i deklaratës është ky:

Kuvendi Kosovës,

Bazuar në deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi të zhdukurit, Rezolutën e Kombeve të Bashkuara 47/133, Konventat e Gjenevës të vitit 1949 si dhe aktet tjera universale për të drejtat e njeriut;

Duke riafirmuar Rezolutën e Kuvendit të Kosovës të datës 10. prill 2003;

Duke shprehur shqetësimin për fatin ende të pazbardhur të mijëra qytetarëve të Kosovës të rrëmbyer gjatë luftës nga formacionet e armatosura shtetërore e paramilitare të Serbisë;

Duke ndjerë dhembjen dhe vuajtjet e familjeve të pengjeve të rrëmbyerve dhe të pagjeturve pa dallim;

Të ballafaquar me prirjen e autoriteteve të Beogradit për abuzim dhe licitim politik me çështjen e trupave të gjetur të qytetarëve të Kosovës nëpër varrezat e shumta në Serbi;

Të motivuar nga synimi për normalizimin e gjendjes në Kosovë dhe për ndërtimin e një shoqërie të lirë, demokratike, tolerante e pluraliste;

Kuvendi i Kosovës miraton këtë

DEKLARATË

1. Kuvendi i Kosovës e konsideron çështjen e pazgjidhur të pengjeve të luftës, të rrëmbyerve dhe të pa gjeturve si çështje tejet të rëndësishme humanitare, juridike e politike.
2. Kuvendi i Kosovës kërkon nga gjithë faktorët relevantë që të ushtrojnë gjithë ndikimin e tyre për zbardhjen e fatit të gjithë pengjeve, të rrëmbyerve dhe të pagjeturve dhe kthimin e shpejt e të pakushtëzuar të tyre ose të trupave të tyre të identifikuar e të paidentifikuar,

3. Kuvendi i Kosovës kërkon nga Qeveria dhe institucionet tjera të Kosovës që të ngrenë në nivelin më të lart politik e institucional angazhimin për zbardhjen e çështjes së pengjeve, të të rrëmbyerve dhe të pagjeturve, dhe përkujdesjen ligjore e institucionale për familjet e tyre dhe me këtë të informohen rregullisht Kuvendi.

4. Kuvendi i Kosovës kërkon nga PSSP, nga Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, shtetet e Grupit të Kontaktit, qendrat të tjera ndërkombëtare të vendosjes dhe qeveritë tjera, që të kërkojnë nga Serbia kthimin e pakusht të pengjeve të luftës, të rrëmbyerve dhe të pagjeturve,

5. Kuvendi i Kosovës kërkon nga organet e drejtësisë ndërkombëtare që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të vënë para drejtësisë shtetin e Serbisë dhe përgjegjësit e tij, si faktorin kryesor përgjegjës për gjenocidin në Kosovë dhe në fqinjësi;

6. Kuvendi i Kosovës fton forcat demokratike, humaniste e paqedashëse në Serbi që të vazhdojnë të kontribuojnë në zbardhjen dhe zgjidhjen e fatit të pengjeve, të rrëmbyerve dhe të pagjeturve, si akt i vullnetit të mirë dhe parakusht për dialog konstruktiv, ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit komisionëve dhe kryetarit që raportoj. Ju ftojë tani të marrim vendim kush është për tekstin e deklaratës siç e lexoi z. Hydajet Hyseni.

Ju faleminderit, a ka ndonjë votë kundër sa për procedurë. Ju lutem një herë kemi hi në vendim marrje, kush është kundër, numëroni votat ju lutem. 3 vota sa po i shoh unë kundër. Ju faleminderit, a ka abstenime edhe pse nuk kanë vlerë. Prandaj konsideroj që Kuvendi ka aprovuar deklaratën dhe unë shpresoj që të na falin pjesëtarët pjesëmarrësit që kanë qenë tri ditë me ne, prindërit dhe familjarët dhe prej këtij momenti jeni të lirë. Jakup Krasniqi. Unë debat nuk kam hapur dhe nuk është me procedurë, por urdhëro Jakup.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

Mendoj se para se të votohej do të duhej që grupet ose grupi që ka bërë kërkesën të deklarohet se a pajtohet me këtë formë të deklaratës dhe a janë përmbushur qëllimet pse ka kërkuar që kjo çështje të debatohet në Kuvendin e Kosovës. Kurse, atyre që kanë punuar nga opozita në deklaratë ,do t'ju kisha thënë: A e kanë dëgjuar debatin e përfaqësuesve të tyre ose të deputetëve të subjekteve të tyre se çka kanë deklaruar. Unë konsideroj që deklarata e fundit nuk ka shpërpushje të madhe me debatin që është bërë në këtë Parlament. Prandaj, kam votuar kundër.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Jakup ju faleminderit. Ata që kanë kërkuar debat me votën e tyre, pra u përcaktua edhe opozita me votën e vet , prandaj kjo çështje ka përfunduar, nuk ka debat. Ju propozoj që tani kur vijmë ligjet në shqyrtim të parë të bëjmë një ndërprerje edhe të hënën në orën, 10,00 e vazhdojmë seancën.

(Pjesë e Seancës plenare, mbajtur më 25.07.05, e filluar në orën 10,00)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes. Mirëseardhje në sesionin e sotëm të Seancës së rregullt. Lus deputetët të zënë ulëset e veta. Do të fillojmë menjëherë.

Në rend dite është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 7 qershor 2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.

Vërejtjet parimore do t'i referohen për shqyrtim Komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet Ministresha Melihate Tërmkollli, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të prezantojë Projektligjin. Ministreshë, foltorja është e lirë për ju.

MINISTRE MELIHATE TËRMKOLLI:

Faleminderit. I nderuari Kryetar, të nderuar deputetë,
Nxjerrja e ligjit për dhënien e provimit të jurisprudencës ka një rëndësi të madhe, në radhë të parë për faktin e mungesës së bazës ligjore për këtë çështje konform standardeve ndërkombëtare dhe sistemit të ri politik e juridik në Kosovë.

Përcaktimi i kushteve dhe procedurës unike për dhënien e provimit të jurisprudencës do ta lehtësojë punën e të gjithë juristëve si dhe të tjerëve të interesuar për përgatitjen dhe dhënien e këtij provimi.

Me këtë ligj do të krijohen lehtësi praktike për t'u njohur me kushtet dhe mundësitë ligjore për të drejtën e paraqitjes së kërkesës për provim, si dhe përgatitjen dhe dhënien e provimit nga të interesuarit.

Me nxjerrjen e këtij ligji, do të eliminohet një zbrastësi ligjore e cila deri tani ka paraqitur huti, pasiguri ligjore dhe mungesë njohurish për përgatitjen e kandidatëve në lëmin e gjyqësisë dhe të mbrojtësve ligjor – avokatëve.

Ky ligj ka rëndësi të shumëfishtë si përnga aplikueshmëria e tij, përnga përcaktimi i institucioneve kompetente dhe përgjegjëse për zbatimin e tij, nga procedura e reformuar në dhënien e provimit të jurisprudencës, pastaj përcaktimin e kushteve siç janë: lëndët, përbërja e komisionit, forma e provimit dhe të tjera.

Ky Projektligj është i hartuar në 6 kapituj, të cilët në vete paraqesin një tërësi homogjene të çështjeve të veçanta të cilat do t'i rregullojë.

Projektligji përmban dispozita mbi qëllimin e dhënies së provimit të jurisprudencës, si një provim profesional, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për dhënien e provimit si dhe format me shkrim dhe gojore të dhënies së provimit.

Në Projektligj, po ashtu, janë paraparë kushtet dhe lëndët për dhënien e provimit të jurisprudencës, përbërja dhe mënyra e punës së komisionit – përfshirë edhe institucionin kompetent për formimin e komisionit dhe strukturën organizative të tij, si dhe aspekte tjera të rëndësishme për këtë çështje.

Mund të them se, zbatimi i këtij ligji, nuk sjell shpenzime buxhetore, përkundrazi është një burim i të hyrave në buxhetin e Kosovës.

Të nderuar deputetë, kërkoj që Parlamenti ta miratojë këtë Projektligj dhe të vazhdojë procesin e tij deri në miratim të tij. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministreshë, ju faleminderit. Hap debatin në parim për Projektligjin në fjalë. E ka fjalën Ramadan Kelmendi, në emër të LDK. Urdhëroni Ramadan.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI:

I nderuari Kryetar, të nderuar ministra, të respektuar deputetë të pranishëm, Grupi i Lidhjes Demokratike ka shqyrtuar dhe analizuar këtë propozimigj dhe vlerëson se në fazën e parë të shqyrtimit të tij duhet miratuar në parim.

Megjithatë, vlerësohet se është mëse e nevojshme dhe e domosdoshme që Kosova të ketë ligjin mbi provimin e judikaturës gjegjësisht të jurisprudencës, me të cilin do të përcaktohen dhe realisht janë përcaktuar kushtet, mënyra dhe komisioni për dhënien e provimit, ngase deri më tani ky provim është dhënë në bazë të ligjit të huaj për ne dhe

para një komisioni që në shumtën e rasteve në vlerësimin e njohurive dhe verifikimin e tyre nuk ishte edhe aq profesional.

Në këtë aspekt, mendohet se do të arrihet efekti i dëshirueshëm në harmoni me kërkesat konform standardeve të Bashkësisë Evropiane. Në veçanti, mbështetja i jepet në momentin kur kemi reformën e sistemit të drejtësisë, reformën në gjykata, ndërrimin e sistemit në studimet në fakultetin juridik, nxjerrja e ligjit mbi organizimin e gjykatave, emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe procedurat rreth kësaj çështjeje.

Në mungesë të ministrisë së drejtësisë dhe po ashtu në mungesë të gjykatës kushtetuese, të gjitha këto japin arsyeshmëri të bazuara që të përkrahjet, por natyrisht edhe të plotësohet me amendamente të cilat do ta begatojnë përmbajtjen e tij.

Me propozimligj duhet të krijohen kushtet për përgatitjen profesionale për punë praktike në fushën e gjyqësisë gjegjësisht gjyqësorit. Kjo do të thotë se do të arrihej në një fushë tjetër të së drejtës, për shembull në fushën e administratës, duke tërhequr vërejtjen për barazinë në mes provimit profesional, provimit për kundërvajtje dhe provimeve të titujve të akademisë shkencore, siç janë për magjistër dhe doktor të shkencave juridike, ngase pikërisht në këtë Projektligj kemi interpretime të ndryshme, huti dhe paqartësi lidhur me përgatitjen e kandidatëve në lëmin e gjyqësorit, të administratës dhe në lëmi tjera të së drejtës, për shembull në procedurën hetuesore, policore, civile, administratë e tjera.

Konkretisht, mendojmë se në nenin 1, propozimligji ngatërron provimin e jurisprudencës me provimin profesional, duke cituar kushtet dhe kriteret për ta dhënë këtë. Andaj mendojmë se në këtë drejtim duhet të japim kontributin tonë që vërtetë të mos ketë diskriminim të juristëve të diplomuar sipas sistemit të vjetër dhe atij të ri dhe në shumë çështje, siç janë gjykatat e rregullta, prokuroritë dhe punët publike, ose të zyrave të avokatit.

Vlerësoj se, e drejta për dhënien e provimit të jurisprudencës - duhet t'iu mundësohet juristëve të diplomuar, që kanë së paku një vit përvojë pune në profesionin e tij.

Vlerësimi i LDK është se komisioni për dhënie të provimit duhet të jetë shumë më profesional, me kriteret të caktuara të profesionalizimit, specializimit, përvojës në punë e tjera, e tjera.

Duke u bazuar në atë që u referua, Lidhja Demokratike gjegjësisht Grupi parlamentar, propozon që në fazën e parë të miratohet si i tillë, duke u proceduar në procedura të mëtutjeshme.

Në do ta japim kontributin tonë me amendamente konkrete në dispozitat e Projektligjit dhe begatimin e tij për procedim të mëtejshëm. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DADI:

Ju faleminderit. 84 deputetë janë të pranishëm. Lus deputetët, të cilët nuk e kanë vendosur kartelën identifikuese, atë ta bëjnë. E ka fjalën profesoreshë Nerxhivane Dauti, le të përgatitet Mazllom Kumnova. Urdhëroni Nerxhivane.

DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI:

Ju faleminderit. I nderuari zoti Kryetar, të nderuar deputetë,
Me ligjin për provimin e jurisprudencës, përcaktohen kushtet dhe procedura për dhënien e provimit të jurisprudencës si provim profesional, të cilin e japin juristët e diplomuar e me të cilin fitojnë të drejtën për ushtrim të punëve dhe detyrave kryerja e të cilave është e kushtëzuar me dhënien e provimit.

Sipas këtij ligji, qëllimi i dhënies së provimit të jurisprudencës është verifikimi i aftësive teorike dhe praktike për juristët për kryerjen e pavarur të detyrave në zbatimin e ligjeve, si dhe të njohjes së idealeve të etikës së profesionit të tyre, të drejtave të njeriut dhe liritë themelore të njohura nga e drejta e brendshme dhe ajo ndërkombëtare.

Nxjerrja e këtij ligji ka një rëndësi të veçantë, sepse me këtë ligj, do të krijohen lehtësi praktike për t'u njohur me kushtet dhe mundësitë ligjore për të drejtën e paraqitjes së kërkesës për këtë provim. Ky ligj ka rëndësi, sidomos:

- Së pari, nga përcaktimi i institucioneve kompetente dhe përgjegjëse për zbatimin e tij;
- Së dyti, nga procedura reformiste në dhënien e provimit të judikaturës;
- Së treti, përnga përcaktimi i kushteve, në veçanti i lëndëve, përbërjes së komisionit dhe formës së shkruar e gojore për kandidatët gjatë dhënies së tij;
- Së katërti, është paraparë struktura organizative e këtij komisioni, kushtet që duhet t'i plotësojnë ata me rastin e zgjedhjes në komision, mënyra e të vendosurit të komisionit, afati i punës së komisionit si dhe mënyra e raportimit të këtij komisioni për ministrinë kompetente.

Edhe pse në ligj theksohet se parashihen kushte të përgjithshme për dhënien e provimit të judikaturës, të cilat janë të njëjta për të gjithë kandidatët - pa dallim përkatësie kombëtare, politike dhe tjera - ligji nuk përmbush këtë kërkesë, sepse diskriminon kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet master me ata studentë të diplomuar sipas planprogramit të vjetër katërvjeçar në fakultetin juridik.

Duhet riformuluar nenin 3, që ka të bëjë lidhur me kushtet e veçanta për dhënien e provimit të jurisprudencës, konkretisht paragrafët 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Duhet riformuluar neni 6, paragrafët 1,2,3 lidhur me komisionin për dhënien e provimit të jurisprudencës.

Duhet riformuluar nenin 10, paragrafët 1,2,3,4 dhe 5, konkretisht lidhur me çështjen se kur konsiderohet që kandidati nuk ka kaluar provimin.

Duhet riformuluar neni 12 me gjashtë paragrafë, lidhur me çështjen e mbetjes në riprovim të kandidatëve.

Po ashtu duhet riformuluar neni 13, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 lidhur me shtyrjen e provimit të filluar.

Megjithkëto vërejtje të paraqitura, duke marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e veçantë të këtij ligji në praktikë, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, propozoj që ligji të miratohet në shqyrtim të parë dhe po ashtu të përmirësohet cilësia e ligjit në fazën e amendamentimit në komisionin përkatës funksional. Ju faleminderit për vëmendjen.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Mazllom Kumnova, le të përgatitet Teuta Sahatqija.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA:

Zoti Kryetar,

Edhe këtë Projektligj, Grupi i AAK në këtë Kuvend, sa ka mund ta vlerësojë, së pari ka konstatuar se ka bërë mirë Ministria e Shërbimeve Publike që ka favorizuar në prioritetet e saj të infrastrukturës ligjore hartimin e këtij Projektligji që rregullon çështjen e provimit të jurisprudencës, sepse certifikimi i këtij kuadri profesional – i domosdoshëm në këtë fushë - deri më tani është bërë me ligj të vitit 1977 të kapërcyer në çdo aspekt dhe me mangësi ligjore që dalin nga detyrimet e standardeve ndërkombëtare e që në njëfarë mënyre kontestojnë qëllimin e gradimit në këtë veprimtari me interes të veçantë.

Përmbajtja e këtij Projektligji është e qartë dhe ka të shënuar qëllimin e përcaktuar, edhe pse në një numër të kufizuar të neneve. Mirëpo, gjatë vlerësimit tonë për një përkrahje parimore, kemi vërejtur lëkundje në përcaktimin e përmbajtjeve dhe mbetet për një përpunim në qartësi, sidomos në disa nene për të cilat vërejtjet do t'i japim edhe me shkrim, siç janë: nenet 1, 3, 4, 6, 7 e tjerë.

Besojmë se ka nevojë t'i kushtohet një kujdes i duhur edhe çështjes terminologjike që prekin fushën e vlerësimit. Në të njëjtën vijë të trajtimit, mendojmë në përdorimet e gabuara të shqipes, ka përlujë ndaj gjuhës së huaj. Këto mospërfillje gjuhësore, duhet të mënjanohen. Padyshim, gjatë procedimit mund të merren në konsiderim vërejtje e përmendura dhe ato të përmirësohen.

Si përfundim, Grupi i AAK në tërësi vlerëson pozitivisht dhe i jep përkrahje në parim këtij Projektligji duke siguruar kontributin tonë në komisione gjatë procedimit dhe shqyrtimit të dytë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. E ka fjalën Teuta, le të përgatitet Shpresa Murati.

DEPUTETJA TEUTA SAHATOJJA:

Ju faleminderit zoti Kryetar. E nderuara Qeveri, të nderuar deputetë, Provimi i jurisprudencës, të gjithë e dimë, ka një rëndësi të veçantë dhe Projektligji për këtë provim është mëse i nevojshëm për ta përmbushur legjislacionin e Kosovës.

Grupi Parlamentar ORA përkrah këtë ligj dhe jemi për miratim në parim në shqyrtimin e parë, ndërsa vërejtjet do t'i japim dhe do të jemi konstruktiv gjatë punës në komisionin funksional. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Teutë, ju faleminderit. E ka fjalën Shpresa Murati, le të përgatitet Milazim Haliti.

DEPUTETJA ŠPRESA MURATI:

Hala. Poštovani predsedniče, poštovani ministri, kolege poslanici, Usvajanjem ovog nacrta zakona od strane Parlamenta Kosova eliminisaće se nedostatak zakonskih uslova koja su osnova za rešavanje ovih pitanja s hodno utvrdjenim standardima iz oblasti prava a u skladu sa najnaprednijim medjunarodnim praksama.

Usvajanjem ovog zakona eliminisaće se i postojeća pravna praznina iz ove oblasti koja, kao takva, predstavlja zakonsku nesigurnost i nedostatak pravnih propisa imperativne odnsono zapovedne prirode za pripremu svih zainteresovanih kandidata za polaganje ovog ispita, što je od neprocenjive važnosti uopšte za kosovsko pravosudje.

U načelu, mi nemamo primedbe na sam srž sadržine Nacrta zakona o pravosudnom ispitu zato što pre svega smatramo da isti u potpunosti ispunjava sve uslove koje su neophodni za jedan ovakav zakon, a prvo vezano za prijavljivanje polaganja pravosudnog ispita, načina rada, polaganje ispita, podnošenje zahteva za polaganje, posebno regulisanje polaganja pismenog a posebno usmenog polaganja ispita, kad se smatra da je kandidat položio, kad se smatra da nije položio, ponovno polaganje, odlaganje već započetog ispita, nepojavljivanje kandidata za polaganje ispita, zaštita prava kandidata, izdavanje potvrde o položenom ispitu, itd.

U ovom nacrtu zakona moramo posebno da istaknemo da cenimo odredbu člana 2. koja se odnosi na to da se ne sme praviti razlika izmedju kandidata po nijednom osnovu; odredbu člana 8. tačka 2. po kojoj se obavezno zahteva od kandidata da u svom zahtevu istakne na koji zvanični jezik želi da polaže ispit, kao i odredbu člana 15. po kojoj kandidat može da zaštiti svoja prava ukoliko smatra da je u postupku polaganja pravosudnog ispita oštećen.

Medjutim, mi moramo da istaknemo, nažalost i odredjene primedbe, koje se sada reflektuju u Nacrtu zakona o pravosudnom ispitu.

Ja se nadam, ovo što ću sada istaći da nije isti slučaj sa verzijama Nacrta zakona obradjenih na albanskom i engleskom jeziku, ali Nacrt ima ozbiljnih jezičkih, gramatičkih i pravopisnih grešaka u srpskoj verziji - po kojem mi obradjujemo skupštinske materijale. Čak neke odredbe menjaju, zbog ovakvih grešaka, i pravni smisao radi koje su trebale biti ustanovljene.

Konkretno, u članu 1. tačka 2, umesto reči „poznaju ideale“ smatramo da treba da stoji „poznaju osnove“.

U članu 2. tačka 2. drugi deo rečenice zista nema nikakvog pravnog smisla a glasi „ima da se procene isto istim kriterijumima“ smatramo da treba da stoji „važe isti kriterijumi“.

Član 2. tačka 3. smatramo da treba preciznije definisati - koje sve stanovnike Kosova, kako bi se znalo ko će sve po ovom zakonu imati pravo da polaže pravosudni ispit.

Predlažemo da Parlament razmotri odredbe 2.1. i 3.5. jer je po nama odredba 3.5 suprotna odredbi 2.1 jer je posao pravnika ovde različita vrednovan odnosno u zavisnosti od toga da li je pravnik radio u pravosudju ili van prvosudnih organa, napravljena je razlika kod istog zanimanja odnosno favorizovan je posao pravnika u pravosudju.

Takodje smatramo da trebamo preciznije pojasniti odredbe iz člana 12. šta to znači „ponovno polaganje kandidata“.

U članu 16. šta to znači u nazivu „ponavljanje ispita“ i da nam se ne dogodi da su ove dve odredbe u suprotnosti.

Zatim, ponovo ću istaći da se malo koristi pravna terminologija kada su u pitanju reči „ideale“ i smatramo da treba da stoji „osnova“; „podvrgnu“ smatramo da treba da stoji „polažu“, kao i u članu 14. reč „vremenu“ smatramo da treba da stoji „rok“.

Na kraju, opšti zaključak Parlamentarne Grupe 6+ na ovaj nacrt bio bi sledeći:
Ukoliko se isprave pravne, jezičke, gramatičke i pravopisne greške, kao i ukoliko se otklone kontradiktornosti u ovde pomenutim odredbama da će građani Kosova dobiti još jedan savremeni zakonski dokument sprovodljiv u praksi savremenog Kosova. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Milazim Haliti.

DEPUTETI MILAZIM HALITI:

Ju faleminderit. I nderuari zoti Kryetar, të nderuar ministra, kolegë të nderuar deputetë, Projektligji për provimin e jurisprudencës, për të cilin po debatojmë sot, i propozuar nga Ministria e Shërbimeve Publike është i një rëndësie të veçantë. Me këtë Projektligj bëhet përcaktimi i kushteve dhe procedure unike për dhënien e provimit të jurisprudencës.

Rëndësia e këtij Projektligji qëndron në aplikueshmërinë dhe përcaktimin e institucioneve për zbatimin e tij në praktikë.

Edhe pse Projektligji përmban 21 nene, në formë përmbajtësore, në gjashtë kapituj përfshin të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë lëmi duke filluar nga dispozitat e përgjithshme që është qëllimi i dhënies së provimit të jurisprudencës, me çka juristët i plotësojnë njohuritë e tyre profesionale dhe do të kenë të drejtë të ushtrojnë punët dhe detyrat për të cilat kërkohet dhënie e provimit të jurisprudencës. Gjithashtu, parashihen kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për dhënien e provimit profesional, pastaj përbërja e komisionit, strukturat organizative dhe mënyra e punës së tij.

Edhe pse Projektligji është i hartuar mjaft mirë nga grupi i ekspertëve, ka nevojë që t'i bëhen intervenime me riformulime dhe plotësime të disa neneve, si:

Në nenin 2, ku thuhet: "personat të cilët mund t'i nënshtrohen provimit të jurisprudencës duhet të jenë të diplomuar në fakultetin juridik sipas programit të vjetër katërvjeçar ose studimit master". Ky kusht, përsëritet si kusht i veçantë në nenin 3, mendoj pa nevojë, dhe në vazhdim bëhet përsëritja e njëjtë në katër aline të këtij neni. Dhe, shtrohet pyetja: a duhet të jetë obligative përvoja aq e gjatë e punës së paraparë, siç është dy vjet punë në gjykata, tri vjet në gjykata për kundërvajtje. Mendoj në këtë drejtim se kjo përvojë kaq e gjatë do të duhej të shkurtohej.

Në fund, mendoj se për vërejtjet e theksuara dhe të tjera që ka Projektligji, do të plotësohen në procedurën e më tutjeshme gjatë amendamentimit dhe në parim e përkrah miratimin e këtij Projektligji. Ju faleminderit për vëmendjen.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Për këtë debat nuk ka të paraqitur tjerë, prandaj ftoj regjinë të bëhet gati për të votuar për miratim në parim të Projektligjit.

Votojmë tani. 86 deputetë kanë votuar për, 3 deputetë kundër, prandaj konsideroj se është i aprovuar në parim Projektligji i shqyrtuar.

Dhe, në bazë të Rregullës 23 pika 6 dhe Rregullës 35 pika 2 Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për shërbime publike, administratë lokale dhe media, si komision funksional dhe referues;
- Komisionin për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese;
- Komisionin për buxhet; dhe
- Komisionin për komunitete.

Pika me radhë e rendit të ditës, është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga zjarri.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 9 qershor 2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.

Vërejtjet parimore do t'i referohen për shqyrtim komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet Ministresha Tërmkolli që në emër të Qeverisë të Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin. Urdhëroni Ministreshë.

MINISTRE MELIHATE TËRMKOLLI:

Faleminderit zotni Kryetar. Të nderuar deputetë,
Në mungesë të legjislacionit përkatës në Kosovë që do të rregullonte çështjen e mbrojtjes nga zjarri, nevoja për nxjerrjen e ligjit për mbrojtjen nga zjarri, është e një rëndësie të veçantë.

Projektligji për mbrojtjen nga zjarri rregullon këtë fushë të rëndësishme, në veçanti çështjen e përcaktimit të kompetencave dhe përgjegjësisve për të gjithë subjektet që do të merren me mbrojtjen nga zjarri.

Projektligji përfshin dispozitat me të cilat përcaktohet qëllimi i mbrojtjes nga zjarri, i jetës së njerëzve dhe pasurisë së tyre, trajton organizimin e mbrojtjes nga zjarri, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe përgjegjësitë e pronarëve dhe shfrytëzuesve të objekteve varësisht nga kategoria e rrezikshmërisë së tyre.

Projektligji po ashtu përmban përcaktimin e masave të mbrojtjes nga zjarri, përgjegjësinë e personave juridik, për projektme, mënyrën e dhënies së lejes për ndërtim, përcakton punën e komisionit për pranim teknik të objekteve, mënyrën e importimit dhe instalimit të pajisjeve kundër zjarrit, stacionet e zjarrfikësve dhe të shpëtimit, shoqatat e zjarrëfikjes dhe çështjet tjera.

Në Projektligj trajtohet mbikëqyrja për zbatimin e masave për mbrojtjen nga zjarri, ku përcaktohen përgjegjësitë e inspektorëve komunal si dhe personave të autorizuar nga ministria dhe masat që merr ministria me qëllim të parandalimit të zjarrit.

Në këtë Projektligj shkollimit dhe aftësimit të kuadrove për mbrojtjen nga zjarri i jepet një rëndësi e veçantë dhe krejt kjo është në funksion të edukimit, pastaj të trajnimit të kudrave për zjarrfikës, duke zhvilluar dhe aplikuar metoda profesionale shkencore në lëmin e mbrojtjes nga zjarri si dhe hulumtimin profesional të shkaqeve të zjarrit.

Duhet të them se për zbatimin e këtij ligji, mjetet e parapara financiare janë të pranueshme dhe në kuadër të mundësive buxhetore.

Edhe për këtë Projektligj, kërkoj që Parlamenti ta miratojë në parim dhe të shkojë më tutje për shqyrtim në procedura të Parlamentit të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministreshë, ju faleminderit. Hap debatin në parim. E ka fjalën Agim Krasniqi, në emër të LDK, dhe le të bëhet gati Emin Krasniqi në emër të PDK.

DEPUTETI AGIM KRASNIQI:

I nderuar zoti Kryetar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë, Unë do t'i them disa fjalë në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës lidhur me Projektligjin për mbrojtjen nga zjarri.

Duke qenë se në memorandumun shpjegues apo preambulën e Projektligjit për mbrojtjen nga zjarri hartuesi i këtij Projektligji ka dhënë sqarime të mjaftueshme, përmes të cilave shpreh rëndësinë e veçantë që ka ky ligj, shpreh se cilat janë qëllimet dhe fushat të cilat ai i mbulon, dhe nuk do të doja të përsëris asgjë nga to, pasi që vlerësojmë se lidhur me këtë çështje çdo gjë është e qartë.

Megjithatë, duhet potencuar se me finalizimin e këtij ligji, përmes procedurës së rregullt të amendamentimit dhe aprovimit të tij nga Kuvendi i Kosovës, infrastruktura ligjore e Kosovës do të begatohet edhe në këtë fushë të veçantë.

Kujtoj se është bërë një punë e mirë në përgatitjen e këtij Projektligji dhe si i tillë, me të gjitha vërejtjet parimore dhe përmbajtësore që do të bëhen sot në shqyrtimin e parë dhe në vazhdimësi në shqyrtimin dhe përpunimin e rregullt në komisionin funksional, si dhe në procedurë të mëtutjeshme të amendamentimit dhe aprovimit, do të kemi një ligj mirë të kompletuar, funksional dhe të zbatueshëm.

Duke qenë se sot është shqyrtimi i parë në parim i këtij Projektligji, me pak fjalë do të përqendrohëm me disa nga vërejtjet dhe mangësitë që janë në masë të konsiderueshme

Së pari, vërejtjet kryesore, kanë të bëjnë me kapitujt 2, 3, 4, 5, 7 dhe 8 respektivisht me nenet 2.3, 6.2, 8.2, 24.2, 35.2, 40.1, 48.1v dhe 52.2. Teksti i përfshirë në këto dispozita, nuk është mirë i definuar, është i paqartë, konfuz, fjalitë jo të ndërlidhura dhe krijohet përshtypje se mungojnë fjalë dhe fjali të tëra, të cilat dëmtojnë kontinuitetin dhe logjikshmërinë e përgjithshme. Në ndonjë vend, duket sikur është fjala për ndonjë gabim, e tjera.

Unë do të provoj që vetëm dy-tri, nga këto vërejtje t'i paraqes, për shembull:

Në nenin 35.2, thuhet, citoj: "Njësitë e shërbimit të zjarrfikjes dhe përcaktuar dhe të informojnë departamentin mbi kryerjen e detyrave nga fushëveprimi i vet". Vetë shihet se kjo fjali dhe kjo përmbajtje nuk është e qartësuar sa duhet. Me siguri se në mes këtyre dy fjalive të shkëputura dhe gjysmake mungon teksti i caktuar, i cili nuk do të lejonte që ky nen të jetë kaq i paqartë dhe kaq konfuz.

Për shembull, në nenin 48.1v, citoj: "Mirëmbajnë të gjitha rrugët pyjore dhe automjeteve zjarrfikëse", e tëra është kjo fjali. Edhe kjo është një argument i mjaftueshëm që më lejon të nxjerr konstatim se disa nene janë krejt të paqartë dhe të pakuptueshëm, sepse mungon një pjesë e madhe e tekstit përmbajtjesor.

Disa kompetenca që duhet t'i përcaktojë ky ligj nuk kanë qartësi as saktësi të mjaftueshme se a duhet të jenë vërtetë në kompetenca të ministrit apo të ministrisë. Për shembull, disa nene, sipas mendimit tonë do të duhej të jenë në kompetenca të ministrit, kur është fjala për shembull për urdhëresat administrative e disa çështje tjera, që do të duhej lidhur dhe ndërlidhur me emrin e ministrit, ndërkaq në anën tjetër për ministrinë me siguri se do të ishte më mirë që në kompetenca të jenë përcaktimet dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me hartimin e programeve të ndryshme, planeve të ndryshme e tjera.

Ka edhe raste, kur disa do të duhej të ishin për organet kompetente administrative në nivelin e ministrisë dhe ministrit, do të thotë në nivele më të ulëta dhe me siguri që këto çështje do të duhej që në përpunimin e mëturjes të ligjit të definohen më mirë.

Gjithashtu, vlerësojmë se duhet edhe më tutje në procedurën vijuese të punohet në definimin e qartë të kompetencave të Ministrisë së Shërbimeve Publike në njërin anë dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në anën tjetër – kur ka të bëjë për çështje dhe fusha të caktuara konkrete dhe në mënyrë të përbashkëta përmga natyra për të dy këto ministri.

Dispozitat që kanë të bëjnë me këto çështje janë të paraqitura në nenin 13, 14 dhe 17.

Gjithashtu ka vend për vërejtje të konsiderueshme edhe në harmonizimin e përkthimeve në të tri gjuhët, ka mangësi të mëdha.

Duke qenë se sot është vetëm shqyrtimi në parim i Projektligjit, nuk do të marrë kohë më tepër dhe propozoj në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që ky Projektligj të marrë përkrahjen e Kuvendit dhe të miratohet në parim. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Agim Ju faleminderit. E ka fjalën Emin Krasniqi, le të bëhet gati Gjylnaze Syla.

DEPUTETI EMIN KRASNIQI:

I nderuar Kryetar, ministra dhe kolegë deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, që në komisionin funksional përfaqësohemi me 3 anëtarë fillimisht do të paraqitja - gjë që është bërë rutinë për të gjitha projektligjet që na ofrohen - vërejtje të shumta gjuhësore, që vërehet një sintaksë e huajë. Edhe për këto, edhe në procedurën e dytë dhe tretë, në shqyrtim të dytë e të tretë procedurën e amendamentimit të këtij ligji ne anëtarët – deputetët në Komisionin funksional do të japim kontributin tonë duke i shtuar infrastrukturës sonë ligjore për avancimin e pozitës sonë të infrastrukturës ligjore në komisionin funksional. Ju përsëndes.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Gjylnaze Sylja, le të përgatitet Ylber Hysa.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA:

Faleminderit. I nderuari zoti Kryetar, të nderuar ministra, deputetë të nderuar, Iniciativa e Qeverisë për nxjerrjen e këtij Projektligji është për t'u përsëndetur dhe mirëpritur. Në Kosovë shtëpitë dhe ndërtesat ndërtohen pa miratimin e planit të ndërtimit nga ana e autoriteteve komunale. Kjo praktikë do t'na vëjë një ditë para një sfide të madhe në rast se ndodhin fatkeqësi të shkaktuara nga zjarri. Shtëpitë dhe ndërtesat janë të ndërtuara shumë afër njëra-tjetrës dhe në rast të fatkeqësive nuk ka korridore të mjaftueshme për shpëtim dhe zjarri mund të përhapet shumë shpejt nga njëri në objektin tjetër.

Me këtë ligj, parashihet nxjerrja e rregullativës për çështjet e sigurisë së objekteve, e cila do të duhej të përfilllet gjatë vlerësimit të lejueshmërisë së projekteve për ndërtim. Konsiderojmë se krahas përkujdesit për rivënien e rendit në çështjet e ndërtimit të objekteve në territorin e Kosovës autoritetet komunale duhet të përkujdesen për implementimin e këtyre rregullativave.

Në anën tjetër, përkujdesjes preventive për mbrojtjen kundër zjarrit nuk i është dhënë kujdes i nevojshëm në Kosovë, sidomos masave për mbrojtjen kundër zjarrit në ndërtesat publike ku ka lëvizje të madhe njerëzish dhe rreziqe të shumta që mund të çojnë tek ndezja dhe nuk janë marrë masa të nevojshme preventive dhe mbrojtëse kundër zjarrit. Ky fakt edhe më shumë shtron nevojën e aprovimit imediat të këtij Projektligji.

Megjithatë, kemi disa vërejtje në këtë Projektligj, sidomos në nenin 18.2 dhe në nenin 21. Në nenin 18.2 kërkohet që për produkte dhe materiale të ndërtimit të merret leja e posaçme nga Ministria e Shërbimeve Publike. Kjo paraqet një kërkesë të tepërt për ndërtuesit. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me ligjin mbi produktet ndërtimore kontrollon kualitetin dhe rezistueshmërinë e produkteve ndërtimore që prodhohen dhe tregtohen në Kosovë. Pra, prodhuesit dhe tregtarët janë të ngarkuar me përgjegjësinë e vënies në treg të prodhimeve që kanë rezistueshmëri të mjaftueshme nga ndezja. Për këtë arsye, kërkesa për leje të posaçme nga Ministria e Shërbimeve Publike për produktet e ndërtimit është barrierë e panevojshme burokratike dhe duhet të mënjanohet.

Sipas nenit 21 aparatet për shuarjen e zjarrit duhet të kontrollohen nga një person i autorizuar nga Ministria së paku dy herë në vit. Pra, çdo person fizik ose juridik, pa dallim duhet të paguajë dy herë në vit për kontroll aparateve për shuarjen e zjarrit qoftë edhe për aparatet më të thjeshtë fiks të zjarrit, për deri sa me të njëjtin ligj detyrohet çdo person që të pajiset me aparate të tilla për objektin e banimit ose afarist. Ndoshta kjo kërkesë është e arsyeshme për ndërtesa të mëdha publike ose afariste, por nuk është e arsyeshme për të gjitha objektet qofshin edhe ato shtëpi për banim.

Produktet për fikjen e zjarrit i nënshtrohen inspektimit dhe certifikimit tregtar dhe janë të pajisura me garanci shumëvjeçare. Kërkesat e tilla nuk janë të arsyeshme.

Një ndryshim tjetër që duhet të pësojë Projektligji është përcaktimi i qartë i kompetencave në mes administratës lokale dhe qendrore.

Përkundër disa mangësive të përmendura, që mund të evitohen në fazën e amendamentimit, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, mbështet Projektligjin e propozuar nga Qeveria dhe fton deputetët ta votojnë aprovimin e tij në parim. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Ylber Hysa, le të përgatitet Xhezair Murati.

DEPUTETI YLBER HYSA:

Kolegë të nderuar, marr parasysh mangësinë dhe rëndësinë që ka ky ligj. Ne në parim do ta përkrahim duke ndarë shumicën nga vërejtjet që këtu u thanë, sidomos kur e dimë se ky ligj do të kthehet në Komisionin për emergjencë, e ku besoj do t'ia bëjmë një trajtim të domosdoshëm. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. E ka tani fjalën Xhezair Murati.

DEPUTETI DŽEZAIR MURATI:

Pozdrav predsedniku Skupštine, ministrima i kolegama koji su ovde, i gostima. Mi u Grupi 6+ smo analizirali malo detaljnije ovaj zakon i mi smatramo da on otprilike pledira da pokrije praznine u oblasti zaštite ljudi i imovine izazvane od požara.

Struktura zakona, koja je rasporedjena u 11 poglavlja, dobro je podeljena, pokrivajući ovu oblast od identifikovanja i preventive do mera kažnjavanja od centralnih do lokalnih organa, umesto da ide možda obrnutim redom.

Ukoliko se razmotri tekst memoranduma, može se zaključiti da je mestimično nedorećen, ponegde konfuzan, sa dosta grešaka u formulacijama, u jeziku – pravopisnih dakle, ima

grešaka stručnih termina i tako dalje. Znači, nastalo je do velikih grešaka. Naime na kraju svake stranice po nekoliko rečenica nedostaje, ja koliko sam primetio, u sva tri jezika. Mislim da ove tehničke greške treba otkloniti.

Kada su u pitanju objekti od posebnog značaj odnosno interesa, ja mislim da je trebalo ugraditi i neke posebne specifične odredbe. U delu o preventivi, mislim da nedostaju neki detalji koji se moraju u narednoj proceduri otkloniti.

U poglavlju 4. – Mere za zaštitu od požara, u članu 33. stav 1. umesto „dužni“ mislim da treba da stoji „obavezni“ jer u ovoj oblasti nema razmišljanja i znaka pitanja nego tu se mora ići sa terminima koji imaju imperativan značaj.

Dalje, u poglavlju 5. gde se obrađuje oblast vatrogasnih stanica i udruženja u članu 33. prilikom zapošljavanja novih radnika pominje se kao limit 35 godina starosti za zapošljavanje lica, dakle ne starih od 35 godina. Koliko je to pravna osnova, trebamo proveriti.

Dalje, nameće se i dalje dilema nejasnoća nadležnosti dvaju ministarstava nad ovom oblašću, Ministarstva za javne službe i za Životnu sredinu i prostorno planiranje.

Ipak smatramo da će dorada ovog nacрта zakona, uz primedbe koje su iznete i koje će biti iznete mislim da su dobar osnov za donošenja jednog uspešnog zakona i mi ga u ime Grupe 6+ u načelu podržavamo. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Xhezair, ju faleminderit. Lus regjinë të bëhet gati për votim. Dëgjuam mendimet e grupeve parlamentare dhe tani do të deklarohe mi për miratim në parim të Projektligjit.

Votojmë tani.

80 deputetë kanë votuar për. Asnjë votë nuk është kundër, prandaj konsideroj se ligji në parim është miratuar.

Pikë e radhës në rend dite është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin profesional.

Konstatimet hyrëse janë:

1. Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 9 qershor 2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.
2. Vërejtjet parimore do t'i referohen për shqyrtim Komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet Ministri Agim Veliu që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Ministër, foltorja është për ju.

MINISTRI AGIM VELIU:

Faleminderit Kryetar. Të respektuar deputetë,
Përveç ligjeve dhe projektligjeve tjera të aprovuara e të miratuara nga Kuvendi, Projektligjin të cilin po e paraqes sot është i gjashti me radhë. Ky ligj përfshin mbulimin e fushës ligjore për arsimin dhe aftësimin profesional. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me përkushtim po punon që përmes krijimit të infrastrukturës ligjore t'u jep shtytje zhvillimeve të arsimit në Kosovë drejt integriteteve të plota në strukturat euroatlantike.

MASHT me prioritet ka parashtruar krijimin e infrastrukturës ligjore dhe implementimin e strategjisë zhvillimore të arsimit në Kosovë për periudhën afatmesme 2007-2017. Implementimi i kësaj strategjie dhe i ligjeve për arsim në Kosovë mundëson avancimin e proceseve edukativo-arsimore dhe menaxhimin e mirë të proceseve zhvillimore në rajon, Evropë dhe më gjerë.

Arsye e nxjerrjes së këtij ligji është krijimi i kushteve për funksionim të rregullt e ligjor të arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë. Çështje te adresuara përmes këtij ligji, janë:

- arsimimi dhe aftësimi profesional i qytetarëve mbi baza vullnetare në pajtim me kërkesat e ekonomisë së tregut;
- kualifikimi profesional i punonjësve të pakualifikuar dhe rikualifikimi i atyre të kualifikuar;

Qëllimi i ligjit është ndërtimi i një sistemi unik të arsimit dhe aftësimin profesional në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Kosovës, përfshirë ndryshimet ekonomike dhe teknologjike, kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e individëve gjatë transicionit drejt ekonomisë së tregut duke shfrytëzuar në mënyrë optimale burimet financiare, njerëzore dhe të infrastrukturës.

Ky ligj ofron bazën e strukturës, organizimit dhe menaxhimit të institucioneve që ofrojnë arsim dhe aftësim profesional. Ky ligj, po ashtu rregullon ofrimin e arsimit dhe aftësimin profesional nga institucionet publike dhe private tek te rinjtë dhe të rriturit pa diskriminim në baza gjinore, etnike, aftësive të kufizuara e tjera.

Që Kosova të ketë ligjin për arsimin dhe aftësimin profesional, është nevojë e kahershme. Kjo nevojë është bërë edhe më e domosdoshme në fazën e tanishme kur gjendemi në proceset e transicionit dhe se për shoqërinë kosovare janë rrethana krejtësisht të reja. Duke ndër këtë nevojë, MASHT hartimin e këtij projektligji e ka parashikuar si çështje urgjente dhe me prioritet të lartë për funksionimin ligjor të arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë.

Ky Projektligj ka rëndësi të madhe për shoqërinë kosovare. Rëndësia shprehet në zhvillimet shoqërore, ekonomike, kulturore, bashkëkohore. Me këtë ligj arsimi dhe aftësimi profesional në Kosovë avancohen kurse proceset shoqërore arrijnë kuptueshmërinë e vet ligjore. Ky ligj ofron përparimin e gjithmbarshëm ekonomiko-

social e kulturor të Kosovës dhe ka rëndësinë e madhe praktike për nevojat e përgjithshme të Kosovës në kuadër të zhvillimeve të proceseve ndërkombëtare.

Në përgatitjen e këtij Projektligji është punuar gjatë, është konsultuar literaturë e ndryshme dhe është hartuar në pajtim me kushtet dhe rrethanat e Kosovës, duke u bazuar në ligjet gjegjëse të Sllovenisë, Gjermanisë, Anglisë e tjera. Në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë ekspertë të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë dhe të Qeverisë në përgjithësi, si dhe ekspertë të fushës përkatëse nga Sllovenia dhe Anglia. Gjatë hartimit të Projektligjit vëmendje e rëndësishme i është kushtuar konsultimit të ligjeve të avancuara në rajon e më gjerë nga kjo fushë.

Projektligji për arsimin dhe aftësimin profesional është ligj mjaft i përparuar dhe kompatibil me aktualitetin dhe vizionin për zhvillimin e procesit arsimor. Ky vlerësim është jo vetëm i anëtarëve të grupit punues por edhe i ekspertëve të shumtë vendorë dhe opinionit të gjerë kosovar që kanë marrë pjesë në diskutimin publik. Të gjitha këto vlerësime, bëjnë të kuptueshëm se Projektligji është në harmoni me praktikën e standardeve vendore dhe të atyre ndërkombëtare në përgjithësi.

Projektligji i arsimit dhe aftësimin profesional është një ligj i ri pasi që në të kaluarën nuk ka ekzistuar një ligj i cili ka rregulluar arsimin dhe aftësimin profesional në Kosovë.

Projektligji për arsimin dhe aftësimin profesional, në pajtim me Udhëzimin administrativ numër 01/2004 lidhur me procedurat për hartimin dhe dorëzimin e projektligjeve Qeverisë dhe Kuvendit dhe Vendimin e Qeverisë së Kosovës numër 2/136 datë 8 mars 2005 për hartimin dhe dorëzimin e legjislacionit në Qeveri, i është proceduar Qeverisë së Kosovës për aprovim dhe më pas Kuvendit të Kosovës për punë të mëtejme dhe miratim.

Kostoja e Projektligjit për planprogramet dhe trajnimet për arsimin dhe aftësimin profesional për vitin shkollor 2004/2005 kap shumë prej 870 mijë euro. Këtu nuk kanë hyrë donacionet e ndryshme të organizatave qeveritare dhe joqeveritare. Shumë e njëjtë ose edhe më e lartë do të jetë për vitin shkollor 2005/2006. Gjithsej kostoja e Projektligjit është rumbullakësuar rreth 870 mijë euro. Ju faleminderit për vëmendjen.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT Daci:

Ministër, ju faleminderit. Hap debatin në parim. E ka fjalën Nimon Alimusaj, në emër të LDK, le të bëhet gati Sala Ahmetaj. Urdhëroni Nimon.

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ:

I nderuari zoti Kryetar, të nderuar ministra dhe ju kolegë deputetë,

Njëra ndër sfidat më të mëdha në sferën e arsimit në periudhën e pasluftës është zhvillimi i një strukture të re institucionale e cila do të ishte e aftë të bëjë reforma të mëdha në këtë sferë dhe kështu Kosova edhe në sferën e arsimit të lëvizë përpara drejt integriteteve të

mëdha evropiane. Dhe për të bërë një hap të madh reformues në sferën e arsimit, duhej bërë një infrastrukturë të re ligjore.

Ministria aktuale e arsimit këtë e konsideron si çështje të ngutshme, dhe përveç hartimit të ligjeve për arsimin fillor, të mesëm e të lartë ka ndërmarrë që të nxjerrë edhe ligje të tjera dhe kështu të mbulohet legjislati në sfera të rëndësishme, siç ishte Ligji për arsimin dhe aftësimin e të rriturve të cilin e miratuam pak më parë dhe ligji për arsimin dhe aftësimin profesional që kemi tash në lexim të parë.

Ky ligj, nuk ka dyshim se është i rëndësishëm sepse mbulon një sferë të rëndësishme të arsimit, ka për qëllim vendosjen e standardeve të pranueshme ndërkombëtare të mundësisë në arsim dhe aftësim profesional.

Arsimi dhe aftësimi profesional ka padyshim ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe në zhvillimin e bizneseve në Kosovë. Ky ligj, jemi të sigurt, se duke ndërtuar një sistem unik të arsimit dhe aftësimin profesional, do të ndikojë fuqishëm në rritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore në Kosovë. Pra, ligji është i një rëndësie të madhe, prandaj ka bërë mirë kjo Ministri, siç e tha edhe vetë, që hartimin e këtij Projektligji e ka parashikuar si shumë urgjent.

Periodha e pasluftës, është periudhë e ndryshimeve të mëdha pozitive në sistemin e arsimit. Në këtë periudhë, veç tjerash, do të formohet një sistem i ri i kualifikimeve. Në Kosovë, siç ka ndodh në shumicën e vendeve të Evropës, po bëhen përpjekje për nxjerrjen e kornizës kombëtare të kualifikimeve e cila bën rangimin në nivele të kualifikimit konform standardeve ndërkombëtare. Ky ligj, ndryshe nga ligjet e nxjerra më parë nga kjo Ministri, është ligj i partë që ofron bazë të mirë për kornizën kombëtare të kualifikimeve nxjerrja e së cilës është hapi më i madh në sferën e arsimit profesional në të ardhmen.

Pra, rëndësia e madhe dhe nevoja e nxjerrjes së këtij ligji sa më parë, është arsyeja e parë që Grupi ynë Parlamentar do ta miratojë në parim.

Së dyti. Ne konsiderojmë se ky Projektligj është hartuar relativisht mirë, qoftë si formë qoftë si përmbajtje. Hiq ndonjë lëshim, siç është pasaktësia e duhur e disa përkufizimeve në kapitullin e parë, paqartësia dhe pasaktësia e disa dispozitave, kundërshtimet ndërmjet dispozitave tjera – ligji është hartuar, siç thash, mirë.

Lidhur me këto të meta, po përmend ndonjë shembull. Te përkufizimi i termit “diploma” thuhet se “dokumenti jepet për përfundimin e suksesshëm të programit arsimor trevjeçar dhe katërvjeçar”, kurse në nenin 6.a) thuhet “shkollat profesionale mund të zbatojnë programe dyvjeçare”. Domethënë, jepen diploma për dyvjeçare dhe kundërshtohet ligji. Ose, si shembull për paqartësi dhe konfuzitet, po marrim nenin 25.a). Shikoni përmbajtjen: “Përjashtimisht personat deri në 24 vjet mund t’i regjistrojnë programet e arsimit”. Nuk di kush e gjen vendin e fjalës “përjashtimisht” këtu.

Hiq këto të meta që mund të riparohen shumë lehtë, ligji meriton të aprovohet në parim edhe si realizim i mirë.

Ne si Grup Parlamentar, duke u angazhuar ekspertë të tërë nga kjo sferë, do të kontribuojmë që në procedurën e mëtejshme ligji të plotësohet, të përmirësohet dhe të marrë një formë sa më të përkryer. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. Sala Ahmetaj, le të përgatitet Myrvete Dreshaj-Baliu.

DEPUTETJA SALA AHMETAJ:

I nderuari Kryetar, të nderuar ministra dhe të nderuar deputetë,
Është për të ardhur keq që ministrinë tona zakonisht na sjellin ligje të cilat shpesh po përkthehen pa ndonjë kriter. Fatkeqësisht rrallë na ndodhë që t'i lavdërojmë për punën e bërë. Zakonisht, Komisioni ynë po detyrohet t'i ripunojë ligjet të cilat na vijnë. Prisnim se ligji për arsimin profesional të jetë punuar më me përkushtim dhe më me përgjegjësi. Por, edhe në këtë ligj, si në shumicën e ligjeve tjera, përshkohet me shumë paqartësi dhe me mangësi që e bëjnë vështirë të zbatueshëm po s'u ripunua.

Vërejtjet tona do t'i vështronim në disa rrafshe.

1. Gabime dhe paqartësi në nocione dhe koncepte;
2. Struktura dhe përmbajtja e ligjit është tejet abstrakte dhe shpesh e pamundshme për t'u zbatuar;
3. Gabime të rënda që kanë të bëjnë me kulturën gjuhësore dhe drejtshkrimore, dhe shpesh hasim edhe shpërputhje në mes të teksteve shqip, anglisht dhe serbisht.

1. Paqartësitë konceptuale dhe të nocioneve, janë të ndërlydhura si zakonisht me përkthimin e dobët. Ja, dy shembuj:

Te neni 4 pikë 1a), ta zëmë, për vazhdimin e tekstit po them, "që janë duke ndjekur – dmth. nxënësit – programet e arsimit profesional formal me bazë në shkollë". Domethënë, "jo me bazë në shkollë" po në sistemin e rregullt arsimor.

Ose margaritari tjetër – neni 8.3 "Për të hyrë në tregun e punës si punëtor i shkathët", në vend që të jetë "Punëtor i aftësuar profesionalisht" sepse shkathhtësia është veçori e individit që ka antonimin e ngathtë, edhe pse është i ngathtë ai mund të jetë profesionalisht i aftësuar.

2. Struktura dhe përmbajtja e ligjit, paraqesin vështirësi të mëdha për zbatim. 28 nene të këtij ligji, nga 42 sa i ka tërësisht, thirren për t'u sqaruar në udhëzime administrative, që do t'i nxirrte Ministria. Pra, sipas këtij ligji, gati për secilin nen duhet të nxirret nga një udhëzim administrativ - madje, edhe për çështje tejet të përgjithshme. Shtrohet pyetja: kujt do t'i hyjë në punë një ligj i tillë dhe sa do të jetë i zbatueshëm një ligj që duhet të mbështetet në së paku 28 udhëzime administrative?

Një ligj i tillë, asnjëherë s'do të funksionojë dhe s'do të jetë i zbatueshëm me këtë strukturë tejet abstrakte. Ne do të pyesnim: pse do të nxirrej një ligj i tillë, kur duhet të ketë gjithë këto udhëzime administrative.

Është e çuditshme të kërkohet që, ta zëmë "planprogramet, obligimet e shkollës, format e regjistrimit, plani vjetor i punës, numri i nxënësve" e tjerë të kërkohet që të rregullohen me udhëzim administrativ, sepse disa dispozita vlejnë për të gjitha mënyrat e shkollimit dhe ato vetëm duhet të harmonizohen me ligje tjera, ose dispozita për sistem të pavarur, për ankesë, provimi i fundit e tjera.

3. Gabime të rënda gjuhësore.- Është bërë rëndomtësi që gjuha shqipe të dhunohet në mënyra dhe forma më të këqija të mundshme. Por, kur një përbuzje e tillë i bëhet nga institucioni siç është Ministria e Arsimit, shqetësimi ynë është më i thellë, sepse Ministria e Arsimit do të duhej të ishte model i kultivimit të gjuhës shqipe e jo i çoroditjes së saj. Ja ndonjë shembull, sa për ilustrim.

Neni 13, pika 2."Do të sigurojë një forum gjithëpërfshirës". Forumi nuk sigurohet, por themelohet ose formohet. Sigurisht sigurohet makina, shtëpia e tjera.

Neni 25 pikë 1. "Programi në pyetje", "programi për të cilin bëhet fjalë" e tjera.

Megjithkëto vërejtje, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike përkrah në parim miratimin e këtij Projektligji dhe vërejtjet tona do t'i bëjmë në Komisionin përkatës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Myrvete Dreshaj-Baliu, le të bëhet gati Genc Gorani.

DEPUTETJA MYRVETE DRESHAJ-BALIU:

Faleminderit. I nderuar zoti Kryetar, ministra dhe deputetë,
Ky Projektligj paraqet një hap cilësor në procesin e arsimit dhe aftësimin profesional, si dhe specifikon rëndësinë e përhershme të nxënies së dijes e cila për një shoqëri shpreh njëri prej kushteve më elementare në ndërtimin dhe theksimin e vlerave të saj. Nevoja për këtë ligj është pjesë e përgjithshme e kërkesave dhe përpjekjeve tona që edhe në Kosovë të vendosen me ligj standardet e pranueshme ndërkombëtare të dijes në arsimin dhe aftësimin e vazhdueshëm profesional.

Projektligji është punuar duke u mbështetur në ligje gjegjëse të disa prej shteteve që tashmë kanë një përvojë të mirë dhe të përparuar në këtë drejtim dhe në bashkëpunim me ekspertë vendor e ndërkombëtar. Kjo na bën të besojmë në besimin e standardeve evropiane, por kjo nuk e bën këtë Projektligj të kryer. E lë të hapur për një qasje gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të tij.

Detajimet e disa problemeve që dalin nga ky Projektligj, si Grup Parlamentar i AAK do t'i bëj në Komisionin përgjegjës, ndërsa tashti po i bëjmë vetëm disa vërejtje parimore.

1. Artikulimi jo gjithnjë i qartë i përkufizimeve hyrëse në fushë të terminologjisë, të cilat duhet të jenë në funksion të tekstit të mëtejshëm. Shih përkufizimet për aftësimin profesional, arsimin teknik, mësimin gjatë gjithë jetës, mësimin praktik, arsimin dhe karrierën, partnerin social, kualifikimin, kompetencat e tjerë.
2. Joharmonizimi mes teksteve në të tri gjuhët.
3. Disa përsëritje nga njëri në nënin tjetër.

Shih veç tjerash paragrafin 1 të nenit 5 dhe nenin 3 apo nenin 2 – të përsëritura edhe në nenin 5 nën c); nevojën e riformulimit të disa neneve, nenin 7 paragrafi 1, nenin 9 paragrafi 1 e të tjera.

4. Një përkufizim më të saktësuar të kujdesshëm do të duhej pas edhe në pjesët për rolin dhe përgjegjësinë e këshillit për arsimin dhe aftësimin profesional, i cili duhet sikur shpesh ka përgjegjësi më të gjera sesa ato që i ka vetë ministri i arsimit.

Dhe nën 5. Këtij Projektligji i duhet një redakturë e mirë gjuhësore.

Së fundi, duke besuar se komisioni do të vazhdojë punën në shqyrtimin e këtij Projektligji nën për nen, duke marrë parasysh edhe vërejtje parimore që do të dalin nga dëgjimi publik i këtij Projektligji, Grupi Parlamentar i AAK në parim përkrah iniciativën e Qeverisë për procesim të mëtutjeshëm të këtij Projektligji. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Genc Gorani, le të përgatitet Nuran Malta.

DEPUTETI GENC GORANI:

Ju faleminderit zoti Kryetar. I nderuar zoti Kryetar, të nderuar qeveritar, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Vërejtjet tona në lidhje me këtë Projektligj kanë të bëjnë veçanërisht me plotësimet e nevojshme që ky Projektligj duhet t'i ketë në domen, them në veçanti në domen të aftësimit, domethënë të nxitjes së kyçje profesionale të të rinjve në tregun evropian të punës. Jam praktikisht dakord me shumicën e vërejtjeve të cilat kolegët e mi deputetë nga grupet tjera parlamentare i kanë paraqitur këtu. Si zakonisht Komisioni përkatës funksional do të ketë një punë relativisht të gjatë për ta kompletuar dhe korrigjuar, mund të thuhet, këtë Projektligj.

Ne, si Grup Parlamentar ORA e përkrahim miratimin e këtij Projektligji. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Genc, ju faleminderit. E ka fjalën Nuran Malta, le të bëhet gati Kamber Kamberi.

DEPUTETJA NURAN MALTA:

Sayın başkan, sayın bakanlar, sayın milletvekilleri,

Tartıştığımız Mesleki Eğitim Yasa Tasarısı geliştirmekte olan Kosova'nın Birleşmiş Milletler standartlarına ulaşması için önemli bir adım olduğunu düşünmekteyiz.

Kosova'nın bugünkü durumunu göz önünde bulundurursak, buradaki her enstitünün profesyonel kadroya ihtiyacı olduğunu görmekteyiz. Buranın ticari, ekonomik ve sosyal açıdan gelişmesi ancak bu eksikliğin giderilmesi ile doğru orantılıdır. Kosova'nın ekonomik, ticari ve sosyal gelişmesi için en önemli yol eğitimidir. Eğitimin kalitesi ve mesleki açıdan profesyonel kişilerin yetişmesi, bu adımda, ilk adımda uğraşması gereken bir şarttır. Tasarıdaki önerilerimize gelince Yasanın ilk sınırlama bölümünde, bazı definisyonlar verilmiştir, açık öğretimin ne olduğuna dair açıklama da bu bölümde verilmektedir, ancak açık öğretimle ilgili herhangi bir madde Yasada bulunmamaktadır. Mesleki eğitim okullarında pratik eğitiminin çokluğu gözönünde bulundurulursa açık eğitimin pek fazla başarı sağlamıyacağını düşünüyoruz. Bu yüzden Yasaya, mesleki eğitimde açık eğitim olamaz diye bir madde daha eklenebilir. Bundan başka uyarılarımızı ise biz komisyonda, ilerideki çalışmalarda vereceğiz. 6+ grubu adına bu Yasa Tasarısını destekliyoruz. Teşekkür ederim.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit. E ka fjalën Kamber Kamberi, le të bëhet gati Naxhije Doçi.

DEPUTETI KAMBER KAMBERI:

Faleminderit. Shpreh mendimin tim se është një nga Projektligjet e përpunuara me një përkushtim të duhur për një lëmi të veçantë. Megjithatë, kujtoj se është dashur një qasje edhe më e vëmendshme, domethënë ky ligj të jetë i kuptueshëm, mundësisht edhe nga nxënësit, prindërit, arsimitarët dhe më gjerë.

Në këtë variant të parë që natyrisht duhet të përmirësohet me vërejtjet dhe sugjerimet e duhura, ma merr mendja se do të plotësohet një vakum i deritashëm i kësaj lëmie.

Formulimi i disa neneve del ndonjëherë i pakuptueshëm, i paqartë dhe gjuhësisht i paqëndrueshëm. Për shembull, te kapitulli 7, neni 20 pika 1, ku shkruhet, citoj: "Drejtori i një institucioni që ofron programe të arsimit profesional duhet të ketë së paku 5 vjet përvojë pune", e tjera – e tjera. Këtu, ma merr mendja, duhet të qartësohet nëse është fjala për zgjedhjen e drejtorit apo diçka tjetër.

Pastaj kapitulli 8, ku bëhet fjalë për nxënësit dhe kushtet e regjistrimit për programe të arsimit profesional, formal neni 25 pika 4, ku thuhet citoj: "Përjashtimisht personat deri

24 vjet mund t'i regjistrojnë programet e arsimit të mesëm të lartë" e tjerë. Është plotësisht e pakuptueshme dhe gjuhësisht e paqëndrueshme. Këtu doemos duhet të bëhet një formulim tjetër dhe i kuptueshëm për të gjithë.

Kapitulli 9, neni 30 pika 3, citoj: "Nxënësi e humb vitin nëse ka notë të dobët në praktikë profesionale, por ka të drejtën në ankesë". Është e pakuptueshme për mua dhe propozoj të formulohet kështu: "Nxënësi mund ta humb vitin nëse ka notë të dobët në praktikë profesionale, por ka të drejtë në ankesë drejtuar këshillit të shkollës, këshillit të arsimtarëve apo drejtorit të shkollës".

Për fund, mendoj që duhet përcaktuar në këtë ligj procedura e provimit përfundimtar, ose të diplomës mbase me një udhëzim administrativ për të gjitha lëmitë profesionale. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Naxhije Doçi, le të bëhet gati Nexhat Rexha.

DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI:

Faleminderit. I nderuari Kryetar Daci, të nderuar ministra, kolegë të nderuar deputetë, të nderuar mysafirë dhe të pranishëm në sallë,

Vlerësimi i shoqërive bashkëkohore se arsimit është ndër vlerat më të mëdha për njerëzimin obligon ekspertët që të bëjnë përpjekje të vazhdueshme në kërkim të realiteteve të reja të të mësuarit në dobi të transformimeve dhe të reformimeve të gjithmbarshme të shoqërisë. Konkretisht obligon institucionet kosovare të dalin nga vota e lirë e popullit që të vendosin rregullat ligjore për mbarëvajtjen e tërësishtme të arsimit në Kosovë duke miratuar ligje adekuate. Aftësitë mendore dhe fizike të të rinjve dhe të rriturve në përgjithësi kanë nevojë që të zhvillohen dhe të ushtrohen përmes të të mësuarit se vetëm në këtë mënyrë zhvillohet si duhet personaliteti i tyre si dhe ndjenja e respektit dhe identitetit të tyre në shoqëri.

Projektligji për arsimin profesional në Kosovë është i një rëndësie të veçantë, sepse përmes tij krijohet mundësia që të rregullohet edhe një segment shumë i rëndësishëm i administrimit të suksesshëm të arsimit në Kosovë. Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional në Kosovë nuk ka ekzistuar më parë, andaj edhe nevojë që ta kemi një ligj të tillë është e kahershme dhe e vazhdueshme për ne. Shoqërisë kosovare në tranzicion i duhet ndoshta si asnjëherë tjetër më shumë që ta ketë ligjin për arsimin dhe aftësimin profesional, sepse është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme që nxënësit që kryejnë shkollimin e obligueshëm të pajisen me njohuri teorike dhe me shkathtësi të caktuara praktike profesionale sipas zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe përgjithësisht sipas zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Dispozitat e këtij Projektligji trajtojnë çështje të rëndësishme, që kanë të bëjnë me arsimin dhe aftësimin e të rinjve dhe të të rriturve pa dallime gjinore, racore, etnie – në

mënyrë të rregullt, me dëgjim të plotë të programeve arsimore në institucionin e arsimit profesional si dhe përmes dhënies së provimeve.

Me këtë Projektligj iu mundësohet njerëzve të moshave të ndryshme për të mësuar dhe për t'u aftësuar gjatë gjithë jetës. Njohuritë teorike dhe shkathhtësitë praktike të përvetësuar gjatë periudhave të caktuara të të mësuarit duhet të zbatohen suksesshëm në mënyrën e funksionimit të mjeteve si dhe të kurorëzohen me kualifikime dhe rikualifikime. Kualifikimi, që është një pasqyrim formal i aftësive profesionale të punëtorit dhe që klasifikohet sipas llojit dhe nivelit të të arriturave mund të jetë edhe standard që punëtori i përmbush kërkesat për realizimin e një profesioni të veçantë në kuadër të fushës përkatëse profesionale.

Është pozitive në këtë Projektligj se njohuritë dhe shkathhtësitë e fituara gjatë arsimimit dhe aftësimit profesional sipas përzgjedhjes së profesioneve rrisin kapacitetin e individit për të siguruar punë dhe për të krijuar një jetë më të mirë në shoqëri. Përfitues direkt nga ky Projektligj janë të rinjtë dhe të rriturit që kanë përfunduar shkollimi në obligueshëm ndërsa përfituesit tjerë janë ndërmarrjet dhe ekonomia e Kosovës.

Projektligji për arsimin dhe aftësimin profesional ka 13 kapituj dhe 42 nene, ku përfshihet ecuria e rregullimit të arsimit dhe aftësimit profesional në institucionet publike formale dhe jo formale të Kosovës si dhe në institucionet private të licencuara nga MASHT.

Synimi i Projektligjit në fjalë është ringjallja e ekonomisë së Kosovës dhe zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë duke u përqendruar me përkushtim të madh në ruajtjen e kulturës kombëtare dhe në ruajtjen e traditave të minoriteteve.

Edhe në këtë Projektligj për arsimim, bashkëpunimi me DKA-të është shumë i kufizuar. Mendoj se edhe në Grupin punues për hartimin e Projektligjit për arsimin dhe aftësimin profesional është dashur që të jetë i caktuar edhe ndonjë përfaqësues nga DKA. DKA-të përmenden vetëm në kapitullin e shtatë kur flitet për këshillin e shkollës si organ i lartë i strukturës së menaxhimit e i institucionit të arsimit dhe aftësimit profesional që informon për rregullat disiplinore të shkollës, financimin dhe për veprimtari të tjera jashtë planprogrameve.

Mendoj se do të ishte i nevojshëm shtimi i një neni të veçantë apo i më shumë neneve ku do të zbertheheshin më qartë detyrat dhe obligimet që duhet t'i kenë DKA-të në menaxhimin e shkollave brenda komunës së caktuar. Kujtoj se një zberthim i tillë do të kontribuojë në mënyrë pozitive në lirimin nga stërngarkimet e tepërta me punë të MASHT-it dhe në favor të decentralizimit.

Në parim e përkrah këtë Projektligj se edhe një segment i rëndësishëm në arsim radhitet në kornizën ligjore, me kërkesë që të plotësohet me amendamente në Komisionin funksional. E përkrah edhe se ka të definuar shumën e shpenzimeve.

Është bërë zakon vazhdimisht që të themi se Projektligji ka gabime gjuhësore. Mendoj se kemi kulturë gjuhësore dhe ekspertë të bollshëm gjuhësor për evitim të gabimeve të tilla, dhe që ne të mos merremi më me çështje të tilla në Kuvend. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën Nexhat Rexha dhe pastaj le të përgatitet Mahir Jaghillar.

DEPUTETI NEXHAT REXHA:

I nderuar zoti Kryetar, ministra dhe të nderuar kolegë deputetë,
Unë, në diskutimin tim, do të bëj përpjekje që ato që u thanë mos t'i përsëris.

Duke pas parasysh faktin se arsimit të Kosovës i ka munguar ky lloj arsimimi dhe është shumë e rëndësishme puna e finalizimit të këtij ligji, gjatë leximit të tij, kam konstatuar se është punuar mirë dhe si i tillë duhet të kalojë nëpër faza të punës përfundimtare, sepse duhet të harmonizohen edhe disa çështje të tjera të cilat mund të harmonizohen dhe mund të konkretizojnë më përsëafërmi lidhjen e dy ministrive me të cilat ka lidhshmëri ky ligj.

Për të funksionuar më mirë ky ligj, unë kam këto vërejtje:

- Të krijohet lidhja më e mirë, në ndonjë nen, në mes MASHT-it – zyrave rajonale të arsimit dhe drejtorive komunale të arsimit. Për të funksionuar në mënyrë praktike ky ligj, është mirë që të hartohen tekstet apo librat shkollor për këtë lloj të arsimit sepse, siç e dimë të gjithë ne, në Kosovë në disa lëndë mësimore mësimi zhvillohet pa libra përkatës. Kjo çështje mund të harmonizohet me nenin 41 të këtij ligji dhe mendoj se ky lloj i arsimimit pa tekste përkatëse nuk mund të arrijë qëllimin e tij;
- Ndërsa, neni 11 pika 6, përmbajtja e kësaj pike do të duhej të kishte këtë formulim: "Ministria e punës në koordinim me MASHT-in të lejojnë apo krijojnë mundësi për plotësimin e nevojave për arsim dhe aftësim profesional." Pra, bashkërisht këto dy ministri të harmonizojnë nevojat në të gjitha nivelet e këtij arsimimi;
- Nenin 15, t'i shtohet afati i botimit të librave përkatës shkollor krahas fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Pra, ky Projektligj, me disa plotësime mund të zbatohet në praktikë sepse është shumë i rëndësishëm për një pjesë të madhe të njerëzve që të avancojnë njohuritë e tyre teorike dhe praktike për punë të suksesshme në shoqërinë kosovare. Unë përkras në parim këtë Projektligj. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën i fundit Mahir Jaghillar.

DEPUTETI MAHIR YAĞCILAR:

Ju faleminderit zoti Kryetar. Unë kam një pyetje, të shkurtër rreth koston së Projektligjit, i cili ishte afër 880 mijë euro. A janë siguruar këto mjete për zbatimin e ligjit?

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Po Ministri e tha, nënkuptohet ajo. Në kosto do të thotë se janë të planifikuara. Në qoftë se Ministri ka përgjigje për këtë, le të urdhërojë, por edhe gjatë amendamentimit mund të rregullohet kjo. Unë e kuptova se po, por është këtu Ministri. Ministër, a dëshironi diç lidhur me këtë? Ju faleminderit.

Dëgjuam debatin në parim. Lus regjinë të përgatitet për të votuar.

Votojmë tani. 64 deputetë kanë votuar për, 3 janë kundër – prandaj konsideroj se është aprovuar Ligji në parim.

T'ju informoj edhe për komisionet që duhet ta shqyrtojnë, e ato janë:

- Komisioni për arsim, shkencë, teknologji dhe kulturë, rini e sport, si komision funksional dhe referues;
- Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese;
- Komisioni për buxhet; dhe
- Komisioni për komunitete.

Pika e radhës të rendit të ditës është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për akreditimin.

Konstatimet hyrëse:

1. Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 9 qershor 2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim;
2. Vërejtjet parimore do t'i referohen për shqyrtim Komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftoj Zëvendësministrin Kadri Kryeziu që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin. Zëvendësministër, foltorja është e lirë për ju.

ZËVENDËSMINISTRI KADRI KRYEZIU:

I nderuar Kryetar, të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e hartimit të Projektligjit në fjalë, të përmend shkurtimisht interpretimin e këtij Projektligji dhe ndikimin në sistemin e gjithumbarshëm ekonomik të Kosovës.

Ligji për akreditim përcakton kornizat për themelimin e organit akreditues dhe procedurat e akreditimit, organizimat të cilët nevojiten të akreditohen dhe rolin e akreditimit në procedurat e vlerësimit të konformitetit me standardet dhe rregullat teknike.

Arsyeja për nxjerrjen e një ligji të tillë është domosdoshmëria për dhënien e besimit organizmave të cilët bëjnë vlerësimin konform produkteve vendore në mënyrë që të zvogëlohen rreziqet eventuale me rastin e plasimit të produkteve në treg dhe njohjen e rezultateve të këtyre organizmave në nivel regjional dhe ndërkombëtar.

Projektligji është strukturuar në pesë kapituj dhe ka gjithsej 16 nene. Pas dispozitave të përgjithshme që zënë vend në kapitullin e parë, kapitulli i dytë rregullon çështjen e themelimit dhe fushëveprimin e organit akreditues.

Kapitulli i tretë rregullon fushën e akreditimit. Sipas rregullave të Projektligjit, praktikat dhe procedurat e akreditimit duhet të realizohen konform kërkesave të Bashkësisë Evropiane dhe konventave ndërkombëtare në këtë fushë për vërtetimin e aftësisë së personave fizik dhe juridik për kryerjen e vlerësimit të konformitetit. Procedura e akreditimit nga organi që zhvillon një procedurë të tillë, bazohet në parimet e paanshmërisë, transparencës dhe përgjegjësisë profesionale.

Kapitulli i katërt përcakton ndërlidhjet e akreditimit dhe dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me vlerësimin e konformitetit për produkte, proceseve dhe shërbimeve, mënyrën e vendimmarrjes së organeve akredituese.

Prandaj, të nderuar deputetë, ju rekomandoj që ta miratojmë në parim këtë projektligj, duke pas parasysh rëndësinë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sferën e ekonomisë, e veçanërisht në ndërtimin e një sistemi funksional në shërbim të biznesit dhe konsumatorit, me ç'rast do të ngrit edhe një nga shtyllat kryesore të infrastrukturës së cilësisë për produkte, proceset dhe shërbimet në Kosovë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zëvendësministër, ju faleminderit. Për debat në parim e ka fjalën Behxhet Brajshori, në emër të LDK, le të përgatitet Bajrush Xhemajli.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI:

Zoti Kryetar, ministra, të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka analizuar këtë Projektligj dhe konsideron si të rëndësishëm nxjerrjen e ligjit për akreditim, sepse me të mbulohet vakumi ligjor i cili ka ekzistuar më herët dhe me anë të të cilit bëhet i mundur themelimi i organeve kompetente për akreditim, përcaktohen fushat e akreditimit, si dhe bëhet i mundshëm zbatimi i procedurave të vlerësimit të akreditimit në fushën e ekonomisë.

Ligji, në fazën e implementimit të tij, siguron kryerjen e shërbimeve nga fusha e akreditimit në pajtim me kërkesat e veçanta të standardeve përkatëse, rregullave teknike dhe akteve normative në fuqi.

Ligji është mjaft i shkurtër, është mjaft i qartë – me ndonjë përjashtim në formulime dhe besojmë po ashtu – mjaft i lehtë për zbatim. Ka aty-këtu gabime teknike, ndoshta edhe gjuhësore – si rezultat i përkthimit të Projektligjit, por të cilat gabime lehtë mund të eliminohen.

Projektligji parasheh edhe formulimin e organit të pavarur të akreditimit në Kosovë për kryerjen e shërbimeve të akreditimit dhe që parashihet të veprojë në kuadër të Agjencionit për Standardizim pranë Ministrisë për Tregti dhe Industri. Me themelimin e këtij organi do të krijohen kushte më reale për implementimin me sukses të ligjit të miratuar.

Megjithëkëtë, Projektligjit mund t'i bëhen edhe sugjerime të caktuara me qëllim të përmirësimit të tij në procedurën e amendmentimit të tij. Për shembull, neni 6 i Projektligjit, më qartë duhet të përmbajë se cila duhet të jetë fusha e akreditimit, ose objekti i akreditimit ashtu siç pretendohet dhe jo të sqarojë procedurën e akreditimit e cila bëhet në nenin 7 të Projektligjit.

Sido që të jetë, të nderuar kolegë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në parim mbështet Projektligjin për akreditim dhe në fazën e amendmentimit të tij do të jap kontributin e vet nëpërmjet komisioneve përkatëse dhe ftoj kolegët deputetë që ta përkrahin në parim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Behxhet, ju faleminderit. E ka fjalën Bajrush Xhemajli, le të përgatitet Mazllom Kumnova.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI

Ju faleminderit, zoti Kryetar. Përshëndetje për të gjithë që janë në sallë. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës përkrah në parim Projektligjin por ka edhe rezervat e veta dhe atë në katër çështje.

Nën një. Çështja qëndron se si themelohet organi për akreditim. Ky organ është fundamental në këtë fushë të veprimit, prandaj është e papranueshme që të themelohet me akte nënligjore, pra me rregullore në vend që të themelohet nga Kuvendi përmes këtij Projektligji.

Unë do të vë në pah se është interesant, kryesisht ministrat nganjëherë mundohen të bëjnë pak ligj për veti, jo fort për çështjen e cila është materie. Ta lidhin gjithmonë aty ku ka licencime, ku ka akreditime, ku ka çështje të ndryshme pak a shumë për veti, që së paku

t'i kenë në kompetencë. Mendoj se ky organ, nuk meriton të formohet me akt nënligjor, po përmes këtij ligji.

Nën dy. Ne veç kemi aprovuar në këtë Kuvend Ligjin për konformitetet dhe tani ky Projektligj përmes Rregullores për akreditim e krijon një raport shumë konfuz ndërmjet këtyre dy fushave dhe krijon kundërthënie në mes nenit 4 dhe nenit 9.

Nën tre. Parimisht dihet, duhet t'u referohemi standardeve evropiane dhe konventave ndërkombëtare sidomos mbi këtë çështje, që është e ndjeshme në këtë drejtim, por nuk ka ndonjë përshtatje që është për rrethana tona për në Kosovë. Mendoj se duhet një përshtatje t'i bëhet, sepse nuk jemi të njëjtë sikur në Evropën qendrore dhe si te ne.

Nën katër. Duhet Kuvendit ti sillet një vlerësim financiar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë pasi që organi i cili duhet të formohet e ka një kosto bukur të madhe, është mirë të dihet ajo kosto dhe a ia vlen që vërtetë në këtë formë siç është të formohet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Bajrush, të faleminderit. Mazllom Kumnova, le të përgatitet Teuta Sahatqija.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA:

Zoti Kryetar, Grupi i AAK e ka marrë në shqyrtim këtë Projektligj dhe me këtë rast ka konstatuar se së pari Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka bërë një punë të mirë që ta rregullojë sistemin e akreditimit në Kosovë me një ligj të veçantë, për të cilin aktualisht është një zbrastësi ligjore në fushën e ekonomisë, më konkretisht në zbatimin e procedurave të vlerësimit të akreditimit.

Njëkohësisht, ky Projektligj krijon kushte të ngritjes së një organi funksionimi i të cilit do të jetë në shërbim të akreditimit në Kosovë.

Edhe Grupi ynë ka vërejtjet e njëjta – përafërsisht si parafolësi.

Së dyti. Projektligji, krahas përcaktimit të fushës ku kryhet akreditimi, ka dhënë edhe rolin e akreditimit në procedura të vlerësimit në harmoni me standardet dhe rregullat teknike tani të zbatuara ndërkombëtarisht.

Së treti. Projektligji pretendon të jetë gjithëpërfshirës për fushën e akreditimit në mbështetje të dispozitave që zbatohen në Bashkësinë Evropiane duke respektuar edhe kushtet ekonomike në Kosovë.

Mirëpo, për mënjanimin e disa paqartësive, sugjerojmë që të rishikohet përmbajtja e disa neneve, të cilat vërejtje ne do t'i dorëzojmë edhe me shkrim.

Ka përdorime të gabuara gjuhësore, mirëpo në krahasim me projektligjet që kemi pas në dorë deri më tani, vërejmë një kujdes më të madh.

Kemi mendimin si Grup se ky Projektligj duhet të përkrahet dhe të procedohet në komisionet e këtij Kuvendi duke iu siguruar edhe kontributin tonë të mëtejshëm. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Faleminderit Mazllom. Teuta Sahatqija, le të përgatitet Mahir Jaghillar.

DEPUTETJA TEUTA SAHATOJA:

Ju faleminderit zoti Kryetar. Është shumë e nevojshme që procedurat e akreditimit të rregullohen me ligj në ç'mënyrë krijohen instrumente të nevojshme për sigurimin e cilësisë dhe përgjegjësisë për organizatat të cilat janë përgjegjëse për testimin e produkteve dhe proceseve. Me këtë rast, ka disa aspekte pozitive, siç janë: përkrahja e bizneseve të cilat do të merren me këtë punë dhe rritja e punësimit, kursimi i buxhetit të Kosovës duke mos krijuar laboratore testimi në kuadër të ministrive dhe mbrojtja e konsumatorit nga produktet jocijësores.

Ligji nuk është plotësisht i qartë në disa nene, siç është për shembull neni 4, ku ka të bëjë me detyrat e organit për akreditim. Pikërisht, në pikën iii) – ku thuhet se njëra detyrë është akreditimi i organizatave të vlerësimit të konformitetit, me ç'rast duhet të kihet parasysh interaksioni me Projektligjin për konformitet, i cili është miratuar më parë. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh edhe organin e akreditimit në interaksion me organin për konformitet.

Në Projektligj duhet të qartësohen çfarë institucione laboratore, çfarë pajisje dhe kualifikime janë të nevojshme për të kryer veprimtarinë e akreditimit, si dhe kostoja financiare e kësaj.

Gjithashtu, duhet të kihet parasysh që Projektligji të përshtatet me kushtet tona.

Grupi Parlamentar ORA përkrah miratimin në parim, ndërsa kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. E ka fjalën edhe Mahir Jaghillar. Urdhëroni Mahir.

DEPUTETI MAHIR YAĞCILAR:

Ju faleminderit zoti Kryetar.

Sayın başkan, sayın bakanlar, ve milletvekilleri,
Akreditasyona ait Yasa Tasarısını prensipsel olarak destekliyoruz. Bu Yasanın yürürlüğe geçmesiyle, Kosova Piyasası ve Endüstri alanlarında, Kosovada daha olumlu ekonomi etkinlik koşullarının sağlanmasına katkı sunacaktır.

Yasa üstüne ilkesel uyarılarımız şunlardır:

- 10 000 euro tutarındaki Finansi deklarasyonunu küçük ve gerçekçi bulmuyoruz
- "Akreditasyon organı" terminolojisinin (Organi akreditues) ayan olmadığını düşünüyoruz. Bu arada bu organ bağımsız bir organ olarak tanımlıyorken, aynı zamanda Ticaret ve Endüstri Bakanlığı çerçevesinde olduğu ileri sürülüyor.
- Yasanın 14. noktasında, Akreditasyon organının Organi ve müdüründen söz edilmektedir. Bu da yine, önceki uyarı ve finansi deklarasyonuna aykırıdır.
- Bize göre sözkonusu Yasa'nın, Mecliste önceden kabul edilen Yasalarla uyumlaştırılması gerekir.

6+ Grubu bu yasa Tasarısını prensipsel olarak destekliyor ve Komisyonlarda belirli işlemlerden geçtikten sonra daha iyi bir şekil alacağına inanıyoruz. Dikkatinize teşekkür ediyorum.

KRYETARLI KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Tani përgatitimi për t'u deklaruar për aprovim në parim të Projektligjit. Regjia të bëhemi gati për votim.

Tani votojmë. 66 deputetë janë për, 2 vota kundër, prandaj konsideroj se është aprovuar Ligji në shqyrtim të parë. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën me radhë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dizajnin industrial.

Konstatimet hyrëse:

1. Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 17 qershor 2005 dhe janë përmbyshur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim;
2. Vërejtjet parimore dok t'i referohen për shqyrtim Komisionit funksional.

T'ju informoj se komisionet që duhet ta shqyrtojnë, janë:

1. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji dhe kulturë, rini e sport, si Komision funksional dhe referues;
2. Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese;
3. Komisioni për buxhet, dhe
4. Komisioni për komunitete.

Ftohet Zëvendësministri Kadri Kryeziu që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Zëvendësministër foltorja është e lirë për ju.

ZËVENDËSMINISTRI KADRI KRYEZIU:

I nderuar Kryetar, të nderuar deputetë,

Më lejoni që në mënyrë të shkurtër të prezantoj objektin e rregullimit dhe rëndësinë e Projektligjit për dizajnin industrial.

Ligji vendos një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore për dizajnin industrial me të cilin rregullohen kushtet e mbrojtjes, të drejtat e mbrojtjes, fitimi i dizajnit, të drejtat ekskluzive, vëllimi dhe vlersshmëria e procedurave të regjistrimit, ndryshimet në dizajn, ndërprerja dhe anulimi, depozitimi ndërkombëtar i dizajnit, mbrojtja civile juridike dhe dispozitat kundërvajtëse.

Ligji për dizajnin industrial është njëri nga ligjet që i takojnë paketës së ligjeve që mbulojnë pronësinë intelektuale gjegjësisht atë industriale, prandaj edhe ka një rol të rëndësishëm për legjislacionin e Kosovës.

Dizajnët aplikojnë një numër të madh produktesh nga sektorë të ndryshme të industrisë dhe tregtisë, duke filluar nga instrumentet komplekse, me një përdorim të veçantë dhe ekskluziv si makineri, automjete, vegla, motorë, kompjuterë, struktura arkitektonike e deri tek artikujt e thjeshtë apo të përditshëm si veshje, argjendari, pajisje elektronike, mobilie e tjera.

Ligji për dizajnin industrial mbron këto produkte, në bazë të karakteristikave të tyre estetike, duke përjashtuar mbrojtjen e karakteristikave teknike apo funksionale të produkteve të cilat aplikohen.

Dizajni industrial është një karakteristikë marketingu. Arsyeja për përfshirjen e dizajnit në një produkt të veçantë është tërheqja e vëmendjes së konsumatorit për produktin i cili është hedhur në treg për shitje. Sa më i madh të jetë suksesi që arrin dizajni në treg, aq më i madh do të jetë vlera ekonomike për kompaninë. Dizajni, si element rrit avantazhin konkurrues të një kompanie kur dobia praktike e një produkti ngjashëm me një produkt tjetër përmbush të njëjtin funksion. Konsumatori do të bazojë zgjedhjen e tij në dizajnin e produktit. Kjo do të thotë se konsumatori do të vendosë të blejë produktin më tërheqës, më origjinal, më joshës dhe me dizajn më të mirë. Në fund të fundit, rëndësia e mbrojtjes së dizajnit mbështetet në faktin se dizajni rrit vlerën komerciale të produktit për të cilin është aplikuar.

Duke marrë parasysh këto fakte, ligji për dizajnin industrial ofron mbrojtje ligjore të dizajnuesve kundrejt kopjimeve. Në të vërtetë, përmjet aplikimit dhe regjistrimit para zyrës së pronësisë industriale bartësi i dizajnit fiton të drejtën ekskluzive mbi krijimin dhe mbrojtjen e tij.

Të nderuar deputetë,

Projektligji për dizajnin industrial është edhe një hap konkret në realizimin e zotimit të cilin e ka marrë përsipër Qeveria e Kosovës lidhur me planet për implementimin e standardeve për Kosovën respektivisht standardi i pestë për ekonominë mbi pronësinë

intelektuale dhe detyrë e cila rrjedh nga prioritetet e planit të veprimit për implementimin e partneritetit evropian për Kosovën.

Prandaj, ju ftoj që këtë Projektligj, pas shqyrtimit në Kuvend, ta miratoni në parim, pasi që shihet qartë se përbën një komizë normative komplementare në kontest të legjislacionit ekonomik të Kosovës dhe jo vetëm se do të avancojë legjislacionin ekonomik të Kosovës por do të ofrojë edhe më tepër siguri juridike ër prodhuesit dhe ndërmarrësit vendor, si dhe për investitorët e huaj që planifikojnë të investojnë në Kosovë. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zëvendësministër ju faleminderit. Hapim debatin në parim. E ka fjalën Fatmir Rexhepi, në emër të LDK, dhe në emër të PDK Sala Berisha – Shala. Urdhëroni Fatmir.

DEPUTETI FATMIR REXHEPI:

Faleminderit zoti Kryetar. Të nderuar deputetë, Projektligji për dizajnin industrial mund të vlerësohet në grupin e projektligjeve të hartuara mirë.

Ky Projektligj, së bashku me ligjet të cilat i kemi aprovuar më herët, për patentën, markën tregtare dhe të drejtën e autorit përbën komizë që rregullon çështjet e pronës intelektuale.

Projektligji, në strukturën e tij, përmban këto çështje, siç janë: kushtet dhe procedurat e regjistrimit të një dizajni industrial, të drejtat që fitohen dhe vlefshmëria e tij, mekanizmat juridik për mbrojtje dhe ekzekutimin e të drejtave. Vërejtjet e mia në parim do të ishin në çështjet që ka brenda ligjit – themelimi i zyrave ose i agjencioneve të ngjashme, e cila po vazhdon dhe kujtoj se, nëse vazhdon me këto qindra ligje, atëherë do të kemi një administratë shumë të madhe brenda Qeverisë. Edhe mënyra dhe forma e vendosjes brenda ligjeve, është për çdo vërejtje, e tha pak më herët edhe kolegu Bajrush Xhemajli prandaj kujtoj se edhe këtu krijimi i zyrës është i tepërt sepse ka mundësi racionalizimi dhe këto punë të kryhen në paket ose brenda një zyre që do t'i mbulonte të gjitha këto ligje që i përmenda më lartë.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me mënyrën që është paraparë brenda ligjit të caktimit të taksave brenda kësaj ministrie. Kujtoj se këtu duhet shikuar edhe çështjen e regjistrimit, por edhe ndryshimi që këto taksa të bëhen në një paketë, në një tabelë dhe të aprovohen nga ana e Qeverisë e jo ashtu në mënyrë individuale, do të thotë të jenë në pajtim me ligjet e tjera.

Po ashtu, edhe procedura dhe mënyra e zgjidhjes së kontesteve është stërgjatë dhe e ngarkon çështjen e përfundimit të këtyre proceseve, prandaj deri te gjykata e veçantë duhet të shkurtohet kjo rrugë dhe të kryhet brenda ministrisë me forma më të lehta.

Me këto vërejtje, unë përkrah projektligjin në parim dhe në emër të Grupit Parlamentar po ashtu i japim mbështetje në procedim të mëtejshëm.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Fatmir, të faleminderit. E ka fjalën Sala Berisha-Shala, le të përgatitet Xhevdet Neziraj.

DEPUTETJA SALA BERISHA-SHALA:

Zoti Kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra, Projektligji mbi dizajnin industrial së bashku me ligjin mbi patentën, ligjin për të drejtën e autorit dhe Ligjin për markën tregtare përbën një komizë gjithëpërfshirëse ligjore që rregullon çështjen e pronës intelektuale në një nivel që është konpatibil me standardet evropiane dhe praktikat më të mira.

Megjithatë, ka disa mangësi përmbajtësore, me të cilat Komisioni funksional i Kuvendit do të merret më tutje.

Të gjitha vërejtjet që edhe unë i kam paraparë, vërtetë Grupi Parlamentar, që janë sikur ato të përmendura nga kolegu i mëparshëm. Megjithatë do të shkoj më tutje:

Në pjesën e regjistrimit, Projektligji krijon një zyrë të veçantë për dizajnim industrial, e cila bën shytimin dhe procesimin e aplikacioneve. Mirëpo, me qëllim të efikasitetit dhe ruajtjes së burimeve tona që janë ashtu, kështu të kufizuara, kjo zyrë t'i bashkëngjitet zyrës për patentim. Kjo është një praktikë që kanë shumica e vendeve në rajon, kështu që do të ishte e arsyeshme që edhe këtu të jetë ashtu.

Përveç kësaj, neni 10 kufizon regjistrimin e dizajnit industrial vetëm për persona fizik. Hulumtimet megjithatë sugjerojnë se kjo mbrojtje duhet të zgjerohet për të përfshirë edhe personat juridik.

Më tutje, neni 46 kërkon që taksa për regjistrim do të caktohet me një akt nënligjor që e lëshon Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Mirëpo, me qëllim të promovimit të transparencës dhe sigurimit të taksave të cilat janë kompatible me ligjet tjera, tabela e këtyre taksave duhet shqyrtuar dhe aprovuar nga i tërë kabineti i Qeverisë.

Projektligji është mjaft i qartë kur bëhet fjalë për të drejtat që dalin nga regjistrimi lidhur me mbrojtjen ligjore, duke përfshirë të drejtën për të shfrytëzuar dhe transferuar një dizajn që është unik me karakter të veçantë dhe që nuk i lë konsumatori përshtypje se ai dizajn veçse është përdorur në treg.

Mirëpo, përkufizimi i kriteriumeve në nenin 33, të cilat një dizajn duhet t'i përmbushë në mënyrë që të kualifikohet për mbrojtje ligjore, është mjaft konfuz. Në veçanti ky nen i referohet pjesës së parë të ligjit, gjegjësisht përkufizimeve dhe nenit 9 i cili po ashtu i referohet disa kushteve tjera të cilat janë shpërndarë në nene të ndryshme të ligjit.

Në pjesën e Projektligjit, ku bëhet fjalë për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave, është krijuar një varshmëri e madhe në gjykatat për zgjidhjen e kontesteve. Mirëpo, nëse një regjistrim refuzohet, pezullohet apo deklarohet jo i vlershëm, atëherë është më tepër e udhës që këto çështje të zgjidhen nga departamenti i ankesave përbrenda zyrës për patentim dhe dizajnim industrial.

Edhe pse shpresojmë se me ristrukturimin e sistemit gjyqësor do të kemi një gjykatë të veçantë që do të merret me zgjidhjen e kontesteve lidhur me pronën intelektuale dhe çështjet tjera ekonomike e komerciale, megjithatë kjo gjykatë e veçantë duhet të mbetet si opsion i fundit, pra pasi që të jenë shfrytëzuar të gjitha opsionet administrative.

Sidoqoftë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës Projektligjit në fjalë i jep vizën për t'u proceduar më tutje - në shqyrtimin e dytë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Xhevdet Neziraj, le të përgatitet Teuta Sahatqija.

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ:

I respektuari Kryetar i Kuvendit Akademik Daci, të respektuar ministra, zëvendësministër dhe kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë Projektligj të identifikuar dhe të sponsoruar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe me këtë do të mbulohet një vakum ligjor në një fushë që nuk është rregulluar me asnjë ligj. Prandaj, me anë të këtij Projektligji do të krijohet bazë dhe kushte ligjore për mbrojtjen e dizajnit industrial që ka risi dhe karakter të veçantë dhe që nuk ka ngjashmëri dhe nuk është identik me dizajnet tjera industriale. Përveç mbrojtjes së dizajnit industrial, synohet të mbrohet edhe vlefshmëria e mbrojtjes, e drejta për regjistrim, anulim dhe me anë të këtij ligji bëhet edhe depozitimi ndërkombëtar sipas marrëveshjes së Hagës. Do të bëhet mbrojtja juridike e autorizuesit, për fitimin e së drejtës për dizajnin industrial dhe fituesi i të drejtës ka të drejtën për shfrytëzim të dizajnit industrial të regjistruar dhe pengimin e të tjerëve për shfrytëzim pa lejen e tij.

Grupi Parlamentar i Aleancës jep vizë të gjelbërt për këtë Projektligj edhe pse vërejtjet e pakta Grupi Parlamentar do t'i analizojë nëpër komisione përkatëse ku deputetët e Aleancës do të japin kontributin e tyre. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Xhevdet, ju faleminderit. E ka fjalën Teuta Sahatqija, le të përgatitet Mahir Jaghillar.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA:

Faleminderit zoti Kryetar. Mbrojtja e të drejtave të autorit, të dizajnit industrial, të markës tregtare, të patentit deri tani është e panjohur te ne. Me miratimin e Projektligjit për dizajnin industrial dhe projektligjeve tjera të cekura më parë, do të rregullojmë me ligj këtë lëmi me ç'rast do të mbrohen të drejtat intelektuale të autorit.

Projektligji ka një numër mjaft të madh – 62 nene dhe rregullon mjaft mirë shumë aspekt të punës. Megjithatë, ka mangësi në disa nene. Është trend nga ministrinë përsëri ngjashëm me Projektligjin për akreditim që për çdo projektligj të krijohet nga një zyre apo nga një agjencion me ç'rast rritet numri i administratës, rritet kostoja dhe me këtë rast nuk vjen deri te rritja e kualitetit të punës. Edhe këtu parashihet zyre për dizajn industrial, edhe pse mund të funksionojë mjaft mirë me zyre të ngjashme të cilat merren me problematikën e ngjashme.

Në nenin 10, nuk parashihet që dizajnuet të jetë personi juridik, por vetëm personi fizik. Mendoj se ka qenë me siguri lëshim ky i cili do të përmirësohet gjatë punës në Komisionin funksional.

Në nenin 33, kur kemi të bëjmë me kualifikimin për mbrojtje ligjore, duhet të jetë pak më i qartë se në këtë mënyrë si është i rregulluar është pak konfuz.

Te zgjidhja e kontesteve, këtu pajtohem edhe me parafolësit e mi, sidomos në nivelin e parë, duhet t'i jepet më shumë hapësirë zgjidhjeve brenda zyrës apo brenda departamentit për dizajn industrial, pasi drejtimi i menjëhershëm në gjykata pa përpunuar së pari rastin, sjell në vonesa dhe rritje të kostos.

Prandaj, ne si grup parlamentar, përkrahim për miratim në parim këtë Projektligj dhe kontributin tonë do ta japim në punën në komisionin funksional. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Edhe Mahir Jaghillar e ka fjalën, i fundit.

DEPUTETI MAHIR YAĞCILAR:

Ju faleminderit. Sayın başkan, sayın bakanlar, ve milletvekilleri,

6+ Parlamento gurubu adına Endüstri dizaynıyla ilgili Yasa Tasarısı üzere yorum yapmak istiyorum.

Ticaret ile endüstrinin normal çalışması ve müellif haklarının korunması yönünde bu Yasanın oldukça büyük önemi vardır.

Düşüncemize göre, sözkonusu Yasa dizaynının izinsiz kopyalanmasını kısıtlayacaktır. Aynı zamanda bu Yasa, Kosova piyasasındaki ürünlerin korunumu ile garantisini sağlayacak ve bununla birlikte Kosova tüketicilerini sahte ürünlerden faydalanmasını engelleyecektir.

Sözkonusu Yasa Tasarısıyla ilgili prensipte şu uyarılarda bulunmak istiyoruz:

- Bu Yasanın hazırlanması için çalışma gurubunda 16 üye bulunmaktadır ve bunlardan sadece altısı ad ile soyadıyla adlandırılmıştır,
- Definasyonlar bölümünde, "dizayn" kelimesi yeterince ayan değil, yani gereken şekilde açıklanmamıştır.
- "Dizayn yeniliği" kelimesi ayan olmamakla birlikte, İngilizce şekliyle uyumlaştırılmamıştır.
- "Dizayner" kelimesi definasyonlar bölümüne aktarılmalı ve daha ayan olmalıdır.
- 14. noktadaki "endüstri dizaynın kazancı" önemi kayıpla başlıyor, oysa hakların kazanılması şekli gerektiğince açıklanmıyor. Aynı zamanda bu nokta müellif haklarıyla uyumlu olmalıdır.
- "Korunum süresi"- Neden bu süre sadece 5, daha doğrusu 25 yıl olarak sınırlandırılmış. Düşüncemize göre, dizaynla uğraşanların eserleri her zaman için korunum altında bulunmalıdır.
- "Dizaynın kayıtlanması prosedürü" olarak adlandırılan bu Yasa Tasarısının VII. bölümünde hemen "büronun" yetkilerine geçiliyor, oysa "büronun" yapısı ile seviyesi hakkında hiçbir açıklama yapılmıyor, daha doğrusu sadece sertifikaya sahip olma koşulları açıklanıyor.
- Bu büronun çalışması ile sözkonusu Yasanın uygulanmasıyla ilgili finansi deklarasyonda 97.000 euronun harcanması öngörülmektedir. Eğer, şu anda merkezi Prizrende olan Metroloji enstitüsünün Priştineye taşınması için 98.000 euro gerekiyorsa, o zaman bu büronun da aynı masrafı içerdiği farkedilmektedir ya da hesaplamada hata yapılmıştır.

6+ Parlamento gurubu adına bu Yasa Tasarısını prensipte destekliyoruz, aynı zamanda ilerideki süreçte bu hataların düzeltileceğine umut etmekteyiz. İlginize teşekkürler!

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Ftoj regjinë të bëhemi gati për t'u deklaruar.

Votojmë për pranim në parim të Projektligjit.

Votojmë tani.

77 vota janë për, 3 kundër prandaj konsideroj se Projektligji në parim është aprovuar.

Më lejoni t'i bashkëngjitëm pas votimit vërejtjeve të shumë diskutuesve.

Kosova po krijon një aparat burokracie që edhe ekonomitë më të zhvilluara nuk do të mund ta financojnë. Një analizë sipërfaqësore që është punuar te unë për të gjitha komunat – zyrat që i kanë formuar ministrinë - gati fare pak janë të angazhuara për këtë.

Unë do të thoja që, së shpejti dhe ndoshta në fund të vitit të kemi një analizë të përgatitur mirë dhe pastaj të mendojmë për vitin e ardhshëm në shkurtim të burokracisë. Në veçanti, në veçanti po them - është katastrofike numri në Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe në atë të Financave, por këtyre i bashkëngjiten edhe shumë ministri tjera.

Prandaj, ju lutem, edhe për shqyrtimet e ardhshme të ligjeve ministrinë duhet këtë ta kenë parasysh sepse nuk do të mund të vazhdojmë me zyra ose me agjencione të këtilla. Ju faleminderit.

Tani propozoj të bëjmë pushim deri në orën 13 dhe pastaj do të vazhdojmë punën.

(Vijoi pauza)

25.07.2005

KRYESUESI XHEZAIR MURATI:

Kolege poslanici da li smo spremni za nastavak rada.

Konstatujem da trenutno u sali je prisutno 74 poslanika i imamo kvorum za rad. Dok sačekamo predsednika Skupštine, ja ću kratko voditi sednicu i najavljujem sledeću tačku dnevnog reda.

Na dnevnom redu je razmatranje Nacrt zakona o centralnom grejanju.

Tekst je dostavljen poslanicima 6 jula ove godine, što podrazumeva da su ispunjeni svi uslovi za njegovo prvo razmatranje. Poziva se predsednik Komisije za trgovinu i industriju, kolega Fatmir Rexhepi da obrazloži ovaj Nacrt zakona pred poslanicima Skupštine. Izvolite g. Rexhepi govornica je vaša. Izvinite to je zamenik Ibush Jonuzi.

DEPUTETI IBUSH JONUZI

Inderuari Z. Kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra, kryesi, deputetë të nderuar dhe të gjithë të pranishmit e tjerë.

Më lejoni që me rastin e paraqitjes së ekspozesë së shkurtër në lidhje me hartimin e Projektligjit për Ngrohje Qëndrore të tërheq vëmendjen tuaj në rrethanat që shtruan nevojën për hartimin e tij, si dhe për efektet që priten të arrihen me aplikimin e tij.

Projektligji për ngrohje Qëndrore është pjesa e katër e një pakoje të legjislationit për energji, të cilën e ka iniciuar komisioni i Kuvendit për Tregti dhe Industri, në mandatin e kaluar, kurse tani është Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Miniera, Transport dhe Telekomunikacion . Ligjet e kësaj pakoje, të cilat veçse janë miratuar nga Kuvendi, vendosin parimet e përgjithshme të një strategjie për energjinë, themelojnë një

organ të pavarur autonom për rregullimin e sektorit të energjisë dhe krijojnë kushte për kryerjen e aktiviteteve që kanë të bëjnë me energjinë elektrike. Ndërsa Projektligji për Ngrohje Qendrore ka të bëjë me kushtet për kryerjen e aktiviteteve në sektorin e Energjisë termike, gjegjësisht ngrohjes qendrore. Synimi i përgjithshëm i këtij projektligji është sigurimi i furnizimit me ngrohje që është i sigurt, i qëndrueshëm, efikas dhe me çmim të arsyeshëm gjatë sezonit të ngrohjes. Njëkohësisht të sigurohet edhe furnizimi i vazhdueshëm me ujë të ngrohtë sanitar gjatë tërë vitit.

Sikurse edhe në vendet tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore, edhe në Kosovë, ngrohja qendrore përbën një pjesë të rëndësishme të sektorit të energjisë në ekonomi, duke kërkuar që përqindja më e madhe e ndërtesave në zonat urbane të furnizohen me ngrohje qendrore dhe ujë të ngrohtë. Për momentin këto ndërtesa janë duke konsumuar një sasi të madhe të energjisë primare, përkatësisht të rrymës, për qëllime të ngrohjes. Edhe pse synimet e këtij projektligji janë impresionante, megjithatë, problemet që ekzistojnë në industrinë e ngrohjes janë të bollshme.

Si për shembull: humbja e energjisë termike gjatë prodhimit dhe distribuimit të sajë, pajisjet të cilave ju ka skadue afati, si dhe rrjetet e stërzgjeruara. Pastaj bëhet subvencionimi ndërmjet prodhimit, distribuimit dhe furnizimit, dhe konsumatorët ngarkohen me shuma të larta joreale dhe detyrohen të paguajnë edhe kur nuk janë furnizuar me ngrohje, kurse kontestet zgjidhen vetëm ad-hok.

Hap i parë për zgjedhjen e këtyre çështjeve është hartimi i një komize ligjore që është moderne dhe stabile. Ky projektligji të cilin ne ju paraqesim sot i vendosë kushtet dhe standardet për ushtrimin e veprimtarive të prodhimit, distribuimit dhe furnizimit me energji termike; menaxhimin e stabilimenteve, të energjisë termike dhe qasjen në rrjetet e ngrohjes. I vendosë edhe kushtet e licencimit për të gjitha subjektet që merren me aktivitete të ngrohjes qendrore, kurse kushtet për furnizimin e shfrytëzuesve të fundit, matjes dhe inkasimit, janë qartë të definuara në këtë projektligj dhe në aktet përcjellëse nënligjore. Po ashtu ofrohet edhe një përkrahje e fortë për iniciativat e prodhimit të energjisë se ripërtitshme termike, kogjenerimit (bashkëprodhimit) të energjisë elektrike dhe asaj termike dhe përmirësimeve të efikasitetit.

Përgjegjësia për zbatimin e këtij ligji, në një masë të madhe bie mbi zyrën e rregullatorit të energjisë që nuk është praktikë sikurse u dha vërejtja më herët në projektligjet e shumta që bëhen agjencione të veçanta për çdo Projektligj. Përrjashtimisht, zyra e rregullatorit për energji do t'u lëshojë licenca ndërmarrjeve të cilat merren me prodhim, distribuim dhe furnizim me ngrohje qendrore. Kjo zyre po ashtu ka autorizimin dhe përgjegjësin për të shqyrtuar dhe aprovuar tarifat për furnizim që matet me aparatet matëse. Në mesë tjerash, siguron edhe ndarjen në mesë të prodhuesve dhe distributorëve, si dhe kyçjen e palëve të treta në rrjetin e distribuimit.

Ministria e Energjetikës dhe Minierave ka përgjegjësinë më të madhe në planifikimin e strategjive në sektorin e ngrohjes. Ministria po ashtu do të përcakton kushtet dhe stimulimet e blerjes së burimeve të energjisë së ripërtitshme dhe asaj të bashkëprodhuar. Komunitat janë të detyruara që të zhvillojnë politikat e energjisë lokale. Këto politika duhet të koordinohen me ndërmarrjet për ngrohje dhe me Ministrin e Energjetikës dhe Minierave, me qëllim që sistemet e ngrohjes qendrore të jenë efikase, të mos e dëmtojnë ambientin, dhe të ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për popullatën lokale.

Në përfundim, dua të cekë që Unioni Evropian nuk ka direktiva të cilat drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me sistemin e ngrohjes qendrore. Për këtë arsye, ne jemi detyruar të

bazohemi kryesisht në legjislacionin dhe përvojën e shteteve të cilat kohëve të fundit janë bërë pjesë e Unionit Evropian, si për shembull Lituania, Estonia Hungaria. Këto shtete e kanë të zhvilluar mire sistemin e ngrohjes qendrore dhe si rrjedhojë politikat dhe përvojën e tyre e kemi inkorporuar në këtë Projektligj në mënyrë që të jetë në përputhshmëri me politikat dhe standardet e Unionit Evropian.

I nderuari Kryetar të nderuar deputet, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjietikë dhe Miniera, Transport dhe Telekomunikacion së bashku me grupin punues pas hartimit të Projektligjit në fjalë ka organizuar Dëgjimin publik, me të cilin rast Projektligji është mbështetur nga të pranishmit dhe ekspertët vendor dhe ndërkombëtar.

Me këtë rast me lejoni ta përshëndes vendimin e Kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit që të marrin rolin udhëheqës për hartimin e këtij Projektligji si dhe vendimin e Kryetarit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetik dhe Miniera, Transport dhe Telekomunikacion për procedim të mëtejshëm.

Duke ju falënderuar ju për besimin dhe mbështetjen e dhënë, në emër të grupit punues, i falënderojmë të gjithë ata që na mbështetën, kurse ju deputet të nderuar ju thërras që në parim ta mbështetni Projektligjin në fjalë. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI:

Hvala vam Jonuzi, pozivaju se šefovi ili predstavnici parlamentarnih grupa za komentar Zakona, u ime LDK-a se prijavljue g. Fatmir Rexhepi

DEPUTETI FATMIR REXHEPI

Faleminderit z. Kryesues, i nderuar kryeministër, të nderuar deputet.

Pas ekspozesë që u bë në emër të Komisionit parlamentar, unë do t'i shtoj Projektligjit për Ngrohje Qendrore vlerësimin se do të ndihmon aktivitetin në këtë fushë, i cili do të përcakton kushtet dhe standardet për energjinë termike për ngrohje në të tri sferat, nga prodhimi, distribuimi e deri te konsumatori i fundit. Do të mundëson organizimin e tregut të ngrohjes, një konkurrencë për prodhues të shumtë që do të paraqiten ncsër dhe do të kyçen në këtë fushë, përcakton drejt detyrimet e subjekteve ndaj konsumatorëve, kushtet dhe të drejtat e këtyre të fundit në shfrytëzimin e energjisë termike. Projektligji në strukturën e tij përmban: Çështjet kryesore për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e ngrohjes, mënyrën e organizimit dhe kushtet për licencim, mbikëqyrjen, shërbimet dhe aktivitetet e tjera në këtë fushë. Po ashtu ka një pjesë të veçantë ku ka të bëjë me kushtet lidhur me furnizimin e konsumatorit të privilegjuar sikur që janë: Spitalet, çerdhet, shkollat etj në rrethana të caktuara, si dhe marrëveshjet për shitblerjen e energjisë.

Në fund Projektligji ka edhe kodin dhe rregullat për mënyrën e matjes së energjisë termike të cilat do të jenë në të mirën e konsumatorit. Por kjo ka të bëjë me qendrat urbane aty ku kemi ngrohje qendrore, nëpër qytete, pra përfshin vetëm një pjesë të organizimit të kësaj sfere. Unë po e bëj një degresion të vogël për arsye se mendoj se edhe Komisioni dhe është në interesin e të gjithë qytetarëve që përveç këtij sektori ku kemi të planifikuar ngrohjen qendrore. Do të ishte mirë të mendohej edhe Qeveria edhe Këshilli Ekonomik Fiskal që të ndihmoj edhe për ngrohjet individuale, një sektor shumë i rëndësishëm për ekonominë familjare. Në Kosovë ku do të kishin mundësi që për mesë lejimit të importit dhe vajit për djegie i cili është shumë më lirë se sa nafta që tani silllet

ndoshta rreth 1€ për liter e ajo është shumë më lirë, ndoshta 20-25% të këtij çmimi do të mundësonte që kostoja e ngrohjeve për familje të jetë shumë më e ulët dhe do të ketë një standard shumë më të mirë për qytetarët, do të kemi një ambient më të pasur dhe do të kemi një shpenzim të energjisë elektrike shumë shumë më të vogël se sa që e kemi tash. Prandaj, mendoj se duhet të mendohet edhe për këtë sektor të shikohet mundësia e importit të vajit për djegie që është shumë më lirë, kjo nuk i prishë punë asgjë Qeverisë, por unë mendoj se kjo ka rëndësi që të bëhet në sezonet dimërore për qytetarët e Kosovës.

Duke e mbështetur në parim ne do të punojmë edhe më tutje në përgatitjen edhe më të mirë të këtij Projektligji. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI:

Hvala vam gospodine Rexhepi, u ime PDK-a prijavila se poslanica Hatixhe Hoxha.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA

I nderuari kryesues, të nderuar deputet.

Më vjen mirë që kemi arritur që si Grup i punës të përfundojmë punën dhe sot para jush të sjellim këtë projektligj, kështu pakos së ligjeve t'i shtohet edhe një Ligj i ri e ky është Ligji për Ngrohjen Qendrore i cili u hartua nga grupi i punës në kuadër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në bashkëpunim me ekspert. Pas vërejtjeve të marra nga dëgjimi publik. Me këtë Ligj pretendohet të normohet kjo fushë e energjisë termike për ngrohje dhe me këtë krijohen parakushte për prodhimin, shpërndarjen, furnizim me energji termike për ngrohje, sipas standardeve, por gjithsesi duke i pasur parasysh specifikat e Kosovës, për faktin se aktet paraprake të jenë në kundërshtim me parimet e ekonomisë së tregut të lirë. Me Projektligjin për Ngrohjen Qendrore, përcaktohen të drejtat, obligimet si dhe përgjegjësitë e prodhuesit të energjisë termike. Përfshihen rregullat që përcaktojnë tregun e energjisë termike, furnizimin e konsumatorit përgjegjësitë dhe të drejtat e furnizuesit publik, si dhe të drejtat dhe obligimet e konsumatorit në raport me furnizuesin, si dhe procedurat dhe rrethanat e pezullimit nga sistemi i ngrohjes. Duke qenë të vetëdijshëm dhe përkundër faktit apo dëshirës sonë që në Kuvend të sjellim një Projektligj sa më mirë të përgatitur, mendoj se edhe lëshimet eventuale që kanë mundur të përvidhen gjatë hartimit të këtij Projektligji do të arrijmë t'i eliminojmë dhe t'i plotësojmë. Projektligjin me vërejtjet e dhëna në seancë dhe në fazën e amendamentimit.

Po të kontrollohet edhe në aspektin gjuhësor shihet se edhe në këtë Projektligj janë lëshuar gabime gjuhësore të cilat do të korrigjohen në faza të tjera. Më duket me interes të ndalem dhe të jap disa sqarime të nenit 25 në të cilin kemi pasur disa rezerva edhe si Grup i punës gjatë fazës së hartimit të këtij Projektligji. Neni 25.3 paragrafi a/ dhe b/ ku flitet për pezullimin e shërbimeve nga ana e furnizuesit. Neni 25.3 paragrafi a/ thuhet se: "Nëse pezullimi i energjisë termike është shkaktuar me fajin e konsumatorit dhe nuk evitohet brenda 15 ditësh, atëherë furnizuesi do të zvogëloj furnizimin me energji termike. Për të mbajtur temperaturën e brendshme jo më pak se 12 C°", ndërsa në paragrafin b/ thuhet se: "Shkaku nuk është evituar dhe pas 15 ditësh atëherë furnizuesi do të ndërpres furnizimin me kusht që temperatura e brendshme të mos bjer nën 7 C°" dhe këtë e kemi bërë duke e pasur parasysh faktin se kjo do t'u lejohej vetëm një kategorie të

konsumatorëve dhe atë spitaleve, çerdheve dhe shkollave. Në ato kushte të sezonës së dimrit temperaturat jashtë mund të jenë shumë të ulta dhe për shkak të pezullimit të shërbimit të furnizimit do të pësonin më së shumti pacientët në spitale apo fëmijët në çerdhe e shkolla.

Në nenin 26, gjegjësisht në nenin 26.1 e kemi theksuar se Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit do të përpilojnë ndaras listën e institucioneve që kanë të drejtë të furnizohen pa ndërpre me ngrohje. Mendoj se është në interes të theksohet këtu edhe një fakt se deri sa në Projektligj theksohen obligimet dhe përgjegjësitë ndaj konsumatorit, ne kemi menduar se është me interes këtu të theksohet dhe të precizohen në nene të veçanta edhe të drejtat e konsumatorit. P.sh si të veprohet kur konsumatori kryen të gjitha detyrimet e tija me rregull dhe pa fajin e tij nuk furnizohet me ngrohje, atëherë kemi kërkuar që konsumatorit t'i kompensohet dëmi i shkaktuar. Prandaj në nenin 25.8 thuhet se: "Në këtë rast konsumatorit i kompensohet sipas faktit përkatës". Duke pasur parasysh faktin se ky Projektligj është me shumë interes për qytetarët e Kosovës Grupi parlamentar i partisë demokratike e mbështet në parim dhe kërkon të procedohet mëtej. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI:

Hvala predstavniku PDK -a. Reç u ime Aleanse ima kolega Ymer Halimi a neka se priprema Teuta Sahatçia.

DEPUTETI YMER HALIMI

Ju faleminderit z. Kryesues. Të nderuar të pranishëm.

Grupi parlamentar i AAK-së e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për Ngrrohje qendrore për qendra urbane dhe në parim e mbështet për procedim të mëtutjeshëm në Kuvend, sepse do të përmbush një boshllëk ligjor që ka munguar deri më sot tek ne. Projektligji për ngrohje qendrore parasheh të rregullon në mënyrë të normuar marrëdhëniet e prodhuesit për energjinë për ngrohje dhe ujit sanitar si dhe raportin në mes të shpërndarësit dhe shfrytëzuesit në mënyrë të veçantë. Ligji është shkruar jo me kujdesin e duhur sepse ka ca nene që u mungon kuptimi i duhur. Është ngarkuar për së tepërmi me terma të gjuhëve të huaja të cilat mund të zëvendësohen me ato shqip shumë lehtë. Edhe pse ka raste të mjaftueshme për t'i ilustruar, kësaj radhe kam vendosur që të mos u bezdis me këto gjëra. Këto dobësi që i ka projektligji Komisioni funksional besoj se të gjitha do t'i eliminoj, prandaj Grupi parlamentar i AAK-së. Besoj se me punën e vetë do të kontribuoj mjaft që çdo gjë që është e dëmshme për këtë Ligj ta përmirësoj, prandaj ju falënderoj dhe besoj se ne do të japim kontributin maksimal.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI:

Hvala kolega Halimi, u ime parlamentarne grupe Ora poslanica Teuta Sahatçia, a neka se pripremi Mahir Jakdžilar.

DEPUTETJA TEUTA SAHATÇIA

Faleminderit z. Kryesues, i nderuari z. Kryeministër, ministra të nderuar dhe deputet.

Projektligjin për ngrohje e mirëpresim sepse është një ndër ligjet të cilat do ta plotësojnë legjislacionin tonë. Ky Projektligj është punuar në kuadër të Komisionit duke u

konsultuar me ekspert dhe rregullon me ligj prodhimin, distribuimin, furnizimin e konsumatorëve me energji termike për ngrohje sipas standardeve. Duke i respektuar specifikat vendore, krijon kushte për krijimin e kushteve për ngrohtore, licencimin, ndarjen në mes të distribuimit dhe prodhimit. Përcakton të drejtat dhe detyrimet e të gjitha palëve, prandaj si i tillë dhe duke pasur parasysh të gjitha ato që janë marrë gjatë debatit publik në si Grup parlamentar e mbështesim këtë Projektligj dhe apelojmë në parim miratimin e tij. Të metat eventuale dhe plotësimet do të mundohemi që në kuadër të Komisionit t'i japim. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI :

Hvala poslanice Sahatqija. Reč ima šef parlamentarne Grupe 6+ Mahir Jakdžilar.

DEPUTETI MAHIR JAKXHILLAR

Merkezi Isitma Sistemine ait yasa

6+ Grubu, Merkezi Isitma Sistemine ait Yasayı prensipsel olarak destekliyor.

Biz kentlerdeki Isitma sistemi ile ilgili varolan sorunların çözümlenmesine bu yasanın yardımcı olacağına inanıyoruz. Aynı zamanda bu Yasanın, kentlerdeki konutlar için de büyük önem taşıdığına inanıyor ve dolayısıyla ısıtma sisteminde düzenin sağlanılacağına güveniyoruz. Yasa tasarısının hazırlanması süresinde ben komisyon üyesi olarak katkımı sundum, bu yüzden bu konuda daha uzun bir yorum getirmek istemiyorum.

Dikkatinize teşekkür.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI :

Hvala poslaniku Jakdžilaru. Pošto su sve parlamentarne grupe načelno podržali ovaj Nacrt zakona onda prelazimo na njegovom izglasavanju. Obaveštavamo vas da pristupimo elektronskom glasanju i režija neka se pripremi, ako smo spremni glasanje počinje sada:

Monitor nam je dao konačne rezultate tako da je 76 poslanika su za, tako da konstatujem da zakon danas izglasani, I da vas obaveštavam da 2 poslanika bila protiv ovog zakona.

Glasali su 81 poslanik još jednom konstatujem da u načelno Nacrt zakona o centralnom grejanju usvojen u ovoj Skupštini tako da se zadužuje Komisija za ekonomiju, trgovinu, industriju, energetiku, transport i telekomunikaciju da pristupi u dalnoj proceduri, kao i kKomisija Ustavnog okvira, Komisija za budžet i Komisija za prava i interesa zajednica. Ovim smo okončali proceduri oko ovog zakona i sada prelazimo na sledeću tačku dnevnog reda.

Sledeća tačka dnevnog reda je: Prvo razmatranje Nacrta zakona o kulturnom nasledstvu.

Uvodne napomene ovog Nacrta zakona o kulturnom nasledstvu poslanicima je dostavljen 30 juna ove godine, to podrazumeva da su ispunjeni svi zakonski uslovi za njegovo razmatranje.

Poziva se zamenik ministra Anđelina Krasnići da obrazloži predlog ovog zakona.

ZËVENDËSMINISTRESHA ANGJELINA KRASNIQI

I nderuari kryesues, I nderuari kryeministër, të nderuar deputetë.

Trashëgimia Kulturore e Kosovës është një prej preokupimeve kryesore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente. Në këtë drejtim plotësimi i infrastrukturës ligjore të kësaj lëmie, ka qenë angazhimi ynë kryesor gjatë muajve të fundit të punës në këtë Ministrisë. Hartimi i Projektligjit për Trashëgiminë kulturore si dhe masat mbrojtëse për ruajtjen dhe mbrojtjen e Trashëgimisë kulturore, siç dihet është edhe një prej standardeve prioritare që Ministria jonë është e obliguar ta realizojë.

Projektligji për Trashëgiminë kulturore përcakton parimet themelore për ruajtjen, mbrojtjen, konservimin, restaurimin dhe propagandimin e monumenteve të Trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Me këtë Projektligj vihen në mbrojtje të gjitha monumentet e Trashëgimisë kulturore pa dallim përkatësie etnike apo religjioze.

Siç e keni vërejtur edhe ju, në kapitullin e dispozitave të përgjithshme, janë përcaktuar parimet dhe qëllimet me të cilat mendohet të arrihen me anë të këtij Projektligji në fushën e Trashëgimisë.

Me anë të këtij Projektligji janë përcaktuar marrëdhëniet ndërmjet pronarëve të Trashëgimisë kulturore, individëve apo bashkësive e autoriteteve publike të ngarkuara me vlerësimin e Trashëgimisë. Projektligji përcakton qartë përgjegjësitë e personave private dhe të institucioneve publike lidhur me Trashëgiminë kulturore.

Duke u bazuar në kriteret profesionale dhe bashkëkohore, në këtë Projektligj është bërë edhe përkufizimi i nocioneve që kanë të bëjnë me Trashëgiminë kulturore. Mbi këto kriterë është vënë në mbrojtje Trashëgimia Arkeologjike, Trashëgimia Arkitekture, Trashëgimia e Luajtshme si dhe Trashëgimia shpirtërore.

Porcesi i inventarizimit, dokumentimit si dhe masat mbrojtëse ligjore të Trashëgimisë kulturore zënë një vend të veçantë në këtë Projektligj. Pas hyrjes në fuqi të këtij Projektligji, të gjithë personat private dhe juridik janë të obliguar që të mbrojnë trashëgiminë kulturore, qoftë ajo prone private apo prone publike. Personat të cilët dëmtojnë trashëgiminë kulturore të Kosovës do të dënohen penalisht në bazë të Ligjit për kundërvajtje dhe kodit penal të Kosovës.

Në këtë Projektligj është paraparë edhe formimi i Këshillit të Trashëgimisë kulturore të Kosovës. Ky Këshill profesional në përbërje prej 9 anëtarëve dhe do të jetë në përputhje me përbërjen etnike të Kosovës. Anëtarët e Këshillit do të propozohen nga Ministria dhe do të votohen nga Kuvendi i Kosovës.

Të nderuar deputetë!

Gjatë hartimit të këtij Projektligji, grupi punues i ngritur nga Ministria jonë ka pasur parasysh specifikat e realitetit të Trashëgimisë kulturore në Kosovë, si dhe janë marrë në konsiderim edhe dokumentet relevante të vendeve evropiane që merren me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në hartimin e këtij Projektligji kanë marrë pjesë ekspertë vendorë, ndërkombëtarë si dhe përfaqësues të të gjitha përkatësive etnike që jetojnë në Kosovë. Me këtë rast vlen të veçohet ndihma e madhe që kanë dhënë ekspertët e Këshillit të Evropës, të cilët me vërejtjet dhe sugjerimet e tyre kanë ndihmuar shumë punën tonë në hartimin e këtij Projektligji.

Shpresoj se ky Projektligj, sot do të marrë miratimin tuaj, ndërkaq me vërejtjet e juaja sigurisht se do të plotësohet dhe të marrë një formë më të lartë profesionale e juridike. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI:

Hvala vam zamenice ministra na vašim napomenama. A mi sada prelazimo na komentare shefova parlamentarnih grupa. Za sada imam ovde prijavljen iz LDK-a, poslanika Nimon Alimusaj, a neka se pripremi u ime PDK-a Drita Statovci.

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ

I nderuari z. Kryesues, i nderuari kryeministër dhe ministra, të nderuar kolegë deputetë. Rëndësinë e madhe të një ligji të këtillë e kuptoj më mirë se kushdo tjetër në Kosovë, sepse ne në Kosovë për një periudhë të gjatë në të kaluarën e kemi provuar se çdo të thotë që të mos mbrohet me ligj trashëgimia kulturore. Kosova është një ndër trevat më të pasura me pasuri dhe trashëgimi kulturore, mirëpo, ajo është varfëruar nga mungesa e mbrojtjes me ligj të sajë. P. Sh. le të na kujtohet si u mbulua me beton një pjesë e qytetit antik të Pejës në regjimin e kaluar dhe jo vetëm që ajo trashëgimi është shkatërruar dhe nuk është mbrojtur me Ligj, por edhe ata që e kundërshtuan një akt të tillë u rrezikuan të dënohen me Ligj. Domosdoshmëria e nxjerrjes së një Ligji të tillë tash u sforcua edhe nga një kërkesë tjetër, faktori ndërkombëtar atë e ka kushtëzuar duke e konsideruar si njërin ndër standardet që duhet të plotësohet.

Propozuesi i këtij Ligji e ka kuptuar rëndësinë e tij, së pari si nevojë, por edhe si kushtëzim dhe fillimisht pat angazhuar një ekip që dukej serioze për hartimin e këtij Ligji, por at version Grupi ynë parlamentar nuk e vlerësoi si të mirë. Prandaj, ne atëherë patëm kërkuar që t'i kthehet për përmirësim sponsoruesit dhe ashtu u bë.

Kësaj radhe i njëjti sponsorues ka paraqitur jo një version të përmirësuar, por një version krejtësisht të ri i cili krahasuar me të parin, për Grupin tonë parlamentar është shumë më i mirë. Vlera e parë që e dallon për të mirë këtë në krahasim me të parin ishte edhe versioni i parë. P.sh as në këtë version të këtij Projektligji nuk është përfshirë në mënyrë të barabartë tërë sfera e asaj që konsiderohet trashëgimi kulturore. Ky Projektligj të metat kryesore i ka në strukturën e tij. Shumica e neneve janë të ngarkuara me aline dhe pika madje që për mua është absurde. Kemi nene që ka hiq më pak se 84 aline, kjo ka bërë që një element tepër i rëndësishëm i strukturës së tekstit ligjor siç është referenca dhe gjetja e saj me përpjekjen më të vogël, kërkesë kjo e rëndësishme e tekstit ligjor, të mos jetë shumëherë e mundëshme. Neni 6.2 i referohet nenit 3 dhe 4 i pari ka 9 pika kurse i dyti 21 pikë. Merreni me mend se sa e lehtë është gjetja e parë e referencës. Po ashtu edhe sanksionet në kapitullin e fundit titulluar kundërvajtjet, nuk e di sa është adekuat ky titull, janë dhënë disa sanksione që për rëndësinë e këtij ligji më duket janë tepër simbolike dhe absurde. Ky tekst kërkon një dorë të mirë të juristëve jo aq në përmirësimin e përmbajtjes së tij sa në strukturën dhe formën e tij. Ky Projektligj meriton të aprovohet në parim dhe Grupi ynë e miraton me gatishmërinë që të kontribuoj për përmirësimin e tij në procedurën e mëtejshme. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI:

Hvala poslaniçe Alimusaj. U ime Demokratske Partije Kosova poslanica Drita Statovci a neka se priprema Myrvete Dreshaj – Baliu.

DEPUTETJA DRITA STATOVCI

I nderuari z. Kryesues. I nderuari kryeministër, ministra, të nderuar kolegë deputetë, zonja dhe zotërinj të pranishëm.

Shikuar parimisht Projektligji për Trashëgiminë Kulturore të Kosovës do të duhej ta rregulloj në mënyrë të qëndrueshme dhe të pranueshme një problematikë tejet të gjërë jo vetëm kulturore, por të prëfshirë në formulimin trashëgimi kulturore. Dëshiroj të besoj se kjo përpjekje meriton respekt. Puna e rezultuar në Projektligj ne tani na obligon për shqyrtim dhe për miratim. Çfarë komunikon ky Projektligj? Pjesa e përgjithshme formale ose të themi ndryshe universale e Projektligjit e rregullon materien e vetë duke e shtrirë dhe duke e arsyetuar brenda 9 kapitujve 12 neneve e shumë alineve të tjera. Me disa sugjerime plotësuese mund të thuhet se struktura dhe pjesa universale e Projektligjit është e pranueshme, mirëpo pjesa thelbësore ose autentike e Projektligjit do të duhej të rezultonte, të komunikonte dhe të dëshmonte për realitetin për të cilin është hartuar, përkatësisht trashëgiminë kulturore të Kosovës, por në plotësinë e vetë. Është e habitshme se Projektligji komunikon favorizime përzgjedhje ose mospërfillje në përfshirje dhe në trajtimin e trashëgimisë kulturore ose të institucioneve që ushtrojnë veprimtari dhe kompetencë në këtë fushë. Nuk dëshiroj të ju lodhi me imtësime profesionale ndoshta të lodhshme për këtë auditorium, por dëshiroj të shtroj diçka që nuk do të duhej të anashkalohej. Projektligji lypset të jetë në pajtueshmëri me realitetin e kohës së dhënë, por edhe me tekstin e strukturës së vetë.

Në nenin 1 Projektligji decidivisht sanksionon, po citoj: "Objekt i këtij ligji janë vlerat e trashëgimisë kulturore në territorin e Kosovës të krijuara prej të gjitha etnive në shekuj" dhe përfundon alineja. Vlera historike kulturore e kësaj trashëgimie është pasuri e mbarë popullit të Kosovës. Është e njohur se që moti kemi kompleksin e lidhjes së Prizrenit që funksionon në kuadër të institutit për mbrojtjen e monumenteve në Prizren, por çuditërisht Projektligji për Trashëgiminë Kulturore e harron në thojza ta sanksionon në mënyrë e duhur. Tani në kohën e re kemi një realitet tjetër të ri në sferën e trashëgimisë. Në shtator të vitit 2004 Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin për shpalljen e Kompleksit përkujtimor "Adem Jashari" në Prekaz me interes të veçantë nacional.

Në nenin 5 të këtij Ligji sanksionohet Kompleksi përkujtimor "Adem Jashari" në Prekaz mbikëqyret dhe mirëmbahet nga ana e institucioneve të Kosovës dhe organeve të pushtetit lokal.

Shikuar parimësinë e Projektligjit për trashëgiminë kulturore dhe elementet plotësisht përmbushëse të Kompleksit përkujtimor "Adem Jashari" shtrohet pyetja? Pse nuk pati vend në Projektligjin për Trashëgiminë Kulturore që në mënyrë meritore të përfshihet ky kompleks memorial dhe ta gëzoj mbrojtjen dhe rregullimin ligjor si një pasuri kulturore dhe si trashëgimi me rëndësi të veçantë historike e shoqërore. Është rast i mirë që kjo çështje të rregullohet në procedimin e mëtutjeshëm të Projektligjit në fjalë.

Mendoj se anakronizmi dhe shoqëria që ndërton demokraci moderne, nuk mund të qëndrojnë në një rrafsh të njëjtë, pak sqarim: Ç'do respekt pjesëtarëve të Trupave

Mbrojtëse të Kosovës që bëjnë roje nderi në varrezat e Kompleksit "Adem Jashari", por shtrohet çështja se edhe sa kohë do ta vëzhgojmë me indiferencë të pakuptimtë dhe vështirë të shpjegueshme, formën tradicionale në raporte familjare, të përkujdesjes për një trashëgimi tepër domethënëse dhe për një trashëgimi të shpallur ligjësish si kompleks me interes nacional. Ky abstënim ndoshta elegat në thojza, në dukje, komoton thellë në shkeljen institucionale të vlerave kulmore të Kosovës.

I një rëndësie të madhe dhe me simbolizëm të një aspekti tjetër është edhe Kompleksi përkujtimor i masakrës, përkatësisht i viktimize civile të Reçakut i cili po ashtu fare nuk përfshihet në Projektligjin për Trashëgiminë Kulturore. Pozitivisht është e njohur se edhe për këtë kompleks janë ndërmarrë aktivitete që të mbrohet dhe të mbikëqyret institucionalisht, mirëpo sot e gjithë ditën nga e tërë përfshirja dhe mbrojtja në thojza ligjore. Kompleksi i Reçakut gëzon vetëm një rrethojë të thjeshtë të varrezave dhe një projekt ideor. Është mirë të bëjmë krahasime, ta matim në thojza fuqinë tonë me të tjerët dhe të arrijmë kompaktibilitetin edhe kur hartojmë ligje, konkretisht Projektligjin për trashëgiminë kulturore, por është e patolerueshme ikja nga vetvetja, ikja nga identiteti dhe injorimi i trashëgimisë tonë deri në mospërfillje. Komplekset memoriale mbajnë kohën në vete dhe komunikojnë identitet, komunikojnë filozofi njerëzore, komunikojnë vlera historike dhe shoqërore dhe janë pjesë e trashëgimisë tonë dhe njihërit janë pjesë e historisë së njerëzimit, andaj na përkujtojnë për përkujdesje institucionale dhe na obligojnë për pjekuri politike. Duke përfunduar dëshiroj të them se Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës mbështet në parim Projektligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe do të bëjë përpjekje që në procedurë të mëtutjeshme të ndihmoj për begatimin dhe për përkryerjen e tij. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI:

Hvala na vašem komentaru koleginice Statovci. U ime parlamentarne Grupe Alianse za budućnost Kosova reč ima poslanik odnosno poslanica Myrvete Dreshaj – Baliu a neka se priremi Genc Gorani.

DEPUTETJA MYRVETE DRESHAJ – BALIU

Faleminderit z. Kryesues. I nderuar kryeministër, ministra dhe ju deputetë. Nxjerrja e këtij Projektligji paraqet një të arritur në fushën e mbrojtjes dhe të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Prezentimi i këtyre vlerave botës së civilizuar i bën me dije lashtësinë e jetesës së popullit tonë në këto troje, prandaj ruajtjen, mbrojtjen dhe prezentimin e tyre po e dëshmojmë se populli ynë e ka një traditë. Projektligji është një sintezë e mirë atyre përbërësve që e bëjnë ligjin e arsyeshëm për aprovim, si temat, nocionet, kufizimi i trashëgimisë së Kosovës, çështja e rregullimit të trashëgimisë kulturore arkeologjike. Qasja publike në trashëgiminë arkeologjike, trashëgimia shpirtërore, koleksionet, përgjegjësia e Ministrisë së Kulturës etj. Grupi parlamentar i AAK-së lidhur me këtë Projektligj ka këto vërejtje parimore dhe propozime: Në kapitullin e inventarizimit, dokumentimi dhe mbrojtja e përkohshme e trashëgimisë kulturore neni 3.5 përmendet akti nënligjor i veçantë lidhur me inventarizimin që i referohet neni 3.2, ndërsa pikërisht në këtë nen mungon subjekti shprehimisht i thënë: "Institucioni i cili i nxjerr këto akte" si dhe përkufizimi se cili është ai akt a është

udhëzim administrativ a është rregullore, vendim etj. Kurse te ndarja, këshilli i trashëgimisë kulturore i nenit 4.7 i mungon sqarimi dhe emërtimi i 4 fushave të trashëgimisë kulturore që i bën kompetent personat për pjesëmarrje në këtë këshill. Si Grup parlamentar i AAK-së propozojmë që në këtë Projektligj të shtohet një kapitull i veçantë i cili do t'i prejudizonte vlerat e trashëgimisë kulturore, p.sh si vlerat trashëgimore të periudhës antike, periudhës së mesjetës dhe periudhës së re, ndarje e cila është me rëndësi të veçantë në fushën e gjurmimeve dhe arkivimeve. Mendojmë se ndarja në këto periudha kohore është e një rëndësie të veçantë duke thksuar se deri më tani nuk kemi pasur një përkujdesje të mirëfilltë institucionale për vlerat trashëgimore të kulturës sonë.

Shembull: Në periudhën antike për të cilën është hulumtuar dhe investuar fare pak, pastaj kjo do të ishte e rëndësishme edhe për përfitimin dhe ndarjen e fondeve sipas rëndësisë periodike dhe nevojave për gjurmime në trashëgiminë kulturore të trojeve ku shtrihet Kosova.

Vërejtje tjetër në kapitullin 6 është emërtimi: "Trashëgimia kulturore shpirtërore" pasi që këtu mungon një definim i qartë i përcaktimit të këtyre vlerave, por është thënë vetëm i përgjithësuar, për këtë propozojmë një nen i cili shprehimisht do të qartësonte se Ministria e Kulturës për këtë qëllim do të nxjerrë një udhëzim administrativ i cili më në detaje do t'i përcaktoj vlerat shpirtërore të trashëgimisë sonë. P.sh këngët, zakonet e rralla, vlerat tjera shpirtërore etj. Mendojmë se mospecificimi i këtyre propozimeve lë disa mungesa dhe përgjithësime të cilat gjatë implementimit nga institucionet, organet dhe subjektet e ndryshme krijojnë mundësinë e keqinterpretimit në mungesë të qartësisë. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI :

Hvala na vašem doprinosu poslanice Drešaj. U ime Parlamentarne grupe Ora poslanik Genc Gorani, a neka se pripremi poslanica Nuran Malta.

DEPUTETI GENC GORANI

Faleminderit z. Kryesues. I nderuari z. Kryeministër, anëtar të Qeverisë, zonja dhe zotërinj deputet.

Edhe Grupi parlamentar Ora e përkrah në parim Projektligjin për trashëgiminë Kulturore të Kosovës. Vërejtjet dhe plotësimet tona do t'i paraqesim në Komisionin funksional. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI

Hvala vam. Za reč se javila u ime parlamentarne grupe 6+ Nuran Malta, a neka se pripremi poslanica Flora Brovina.

DEPUTETJA NURAN MALTA

Görüşmekte olduğumuz Yasa Tasarısı Kosova Uygulama Planı'nın önemli parçasını oluşturmaktadır. Söz konusu tasarı, Kosovadaki kültürel mirasıve zenginliği oluşturan,

bütün tarihi eserleri koruma altına almayı tasarlamaktadır. İnsanlığın kültürel devamının bir bölümü (parçası) olan Kosovanın, dil, din, milliyeti ırk farklılığı gözetmek, sizin

buradaki etnik grupların birbirlerine saygı ve güveni için önemli bir adım oluşturmaktadır.

Tasarı, Kosova kültürünün devamı ve korunması için gerekli olduğunu bilerek biz 6+ grubu olarak prensipte bu Tasarıyı destekliyoruz, ancak bazı maddelerin değiştirilmesi kanısındayız. Mesela, 6,15,8,11. Bu önergelerimizi ilerideki komisyon çalışmalarında vereceğiz.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Edhe krejt në fund Flora Brovnia

DEPUTETJA FLORA BROVINA

Një ligj i tillë për Mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, gjithsesi i duhet Kosovës. Ky është i domosdoshëm për të shprehur nivelin institucional në mbrojtjen dhe ruajtjen e kësaj trashëgimie nacionale të Kosovës. Mirëpo, mendoj se paraprakisht Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport duhet të jepte një vlerësim të dëmeve të trashëgimisë nacionale të zhdukura, të dëmtuara apo të vjedhura gjatë periudhës së luftës. Pa këto vlerësime është shumë vështirë të fillojmë edhe implementimin e çfarëdo ligji për trashëgiminë kulturore të Kosovës. Mendoj se gjithashtu në ligj është dashur të thuhet një fjali ose një pasus për institucionet e ndërtuara gjatë periudhës së regjimit të Millosheviqit, kur shumë objekte janë shkatërruar dhe të përgjigjet kjo Ministri ose të rregullohet me ligj, se a do të përfshihen këto objekte me Ligjin, gjithsesi nuk duhet të përfshihen, prandaj duhet të thuhet kjo fjali: Projektligji thuhet se është ndërtuar në bazë të një kompromisi të shumë ligjeve që janë propozuar në grupin punues, kjo edhe shihet në ligj, sepse ka aq shumë mish-mash sa nuk mund të nxirret një përfundim, d.m.th nuk i ngjan një ligji që funksionon në tërësi. Znj. Zëvendësministre tha: Departamenti për Kulturë, Rini dhe Sport i ka kushtuar një rëndësi të veçantë kulturës dhe trashëgimisë kulturore edhe kjo nuk qëndron. Pikërisht gjatë kësaj periudhe kjo Ministri tregoj se fare nuk ka lidhje me kulturë dhe trashëgimi kulturore ose ruajtjen e kësaj trashëgimie, sepse ju përkushtua kësaj dhe e dimë se ajo më shumë u përqëndrua në organizimin e festivaleve, organizimin e zgjedhjeve së miseve dhe sportit, se sa që u përkujdes për trashëgiminë nacionale ose ruajtjen e kësaj pasurie.

Ajo edhe vetë në këtë Projektligj, në preambul thekson se: Kjo Ministri e ka shumë të vështirë, pra heq dorë nga aplikimi i ligjit dhe po të aprovohet i mungon buxheti dhe një ligj pa buxhet nuk mund të hyjë në përdorim. Ajo theksohet në këtë Projektligj se implementimi i ligjit mund të fillojë në vitin 2006 -2008, pra kjo Ministri në këtë mandat heq dorë nga implementim i këtij Ligji.

Sa ju përket çështjeve veç e veç, unë do të përmendja vetëm edhe një. P.sh në preambul mungon shpjegimi: Çka është institucioni kompetent, në tekst ekziston kjo, ka këso të meta shumë në ligj dhe personalisht nuk do ta votoj ligjin.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Lus regjin që të përgatitemi për vendimmarrje, ju ftoj që të deklarohe mi për aprovim të Projektligjit në shqyrtim. Bëhemi gati për votim dhe votojmë tani:

67 deputetë kanë votuar për

7 janë kundër

Prandaj konsideroj që Projektligji në shqyrtimin e parë kalon.

Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Radiotelevizionin e Kosovës.

Si konstatime hyrëse janë: 1/ Projektligji u është shpërndarë deputetëve me 30 qershor 2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

2/ Vërejtjet parimore do t'i referohen për shqyrtim Komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftohet zëvendëskryeministri Adem Salihaj që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantoj Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ADEM SALIHAJ:

I nderuari z. Kryetar, të nderuar deputet.

Kompletimi i infrastrukturës së nevojshme ligjore për rregullimin e të gjitha sferave të jetës në Kosovë përbën jo vetëm epiqendrën e angazhimit tonë por edhe njëherit edhe një nga sfidat më të mëdha për institucionet e Kosovës. Kjo për fatin se një mori ligjesh të aplikueshme në Kosovë nuk u përgjigjen rrethanave dhe kërkesave të reja si dhe standardeve të legjislacionit evropian. Kjo shtron nevojën imedijate të rregullimit të këtyre raporteve shoqërore me dispozita ligjore. Me qëllim të promovimit të një shoqërie tolerante dhe demokratike në Kosovë me anë të mediave publike të pavarura dhe të angazhuara për arritjen e standardeve më të larta profesionale. Radio Televizioni i Kosovës duhet si i vetmi transmetues publik të implementoj këto standarde dhe duhet të garantoj në programet e tij përputhshmërinë në praktikën më të mirë evropiane, me standarde ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe të lirisë së shprehjes siç parashihen në nenin 19 dhe 29 të Deklaratës universale të të drejtave të njeriut si dhe në nenin 6, 8, 9 dhe 10 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, si dhe protokolleve të saj për parandalimin e gjuhës së fyerjes dhe të urrejtjes.

Këto janë arsytet që të shtrojmë para jush për shqyrtim dhe aprovim Projektligjin për Radiotelevizionin e Kosovës. Ky Projektligj është aprovuar nga ana e Qeverisë në mbledhjen e mbajtur më 21.06.2005 dhe sipas procedurës së përcaktuar paraqitet sot para

jush për miratim. Me këtë ligj rregullohet në tërësi themelimi, mënyra e organizimit dhe funksionimi i RTK-së. Projektligji është i strukturuar në 10 kapituj.

Në kapitullin e parë në Projektligj parashihen dispozitat mbi përkufizimet e nocioneve të përgjithshme, emërtimi dhe statusi.

Në kapitullin e dytë përfshihen dispozitat për veprimtari dhe parimet programore të RTKK-së, strukturën dhe programin, standardet programore, e drejta për reagim, mbulimi i territorit dhe popullatës, përdorimi i produksionit të pavarur, ngjarjet e veçanta, njoftimet urgjente, programet religjioze, mbulimi i fushatës zgjedhore, reklamimi, rregullimi i përmbajtjes programore, përmbajtja e programeve audio – vizuele evropiane, efikasiteti teknik dhe veprimtaritë tjera.

Në kapitullin e tretë përfshihen dispozitat për çështjet e financimit të RTK-së si dhe burimet e financimit.

Në kapitullin e katërt përfshihen dispozitat për organet drejtuese dhe menagjuese të RTK-së

Në kapitullin e pestë përfshihen dispozitat për bordin e RTK-së, zgjedhjen e anëtarëve të bordit, pamundësinë për të qenë anëtar i bordit, shkarkimin e tyre etj.

Në kapitullin e gjashtë përfshihen dispozitat, kompetencat e bordit të RTK-së,

Në kapitullin e shtatë përfshihen dispozitat për procedurat e bordit të RTK-së,

Në kapitullin e tetë përfshihen dispozitat për drejtorin e përgjithshëm, kushtet për zgjedhje dhe shkarkim, kompetencat e drejtorit të përgjithshëm, zgjedhjen e menagmentit të lartë, emërimin e grupit këshillues të publikut, monitorimin e punës së RTK-së si dhe transparencën e RTK-së.

Në kapitullin e nëntë përfshihen dispozitat për nxjerrjen e statusit të RTK-së dhe çështjet që rregullohen me të.

Në kapitullin e dhjetë përfshihen dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Siç keni mundur ta vëreni Projektligji parashih një vazhdimësi të mediumit publik RTP – RTK me që rast parashihet edhe vazhdimësia e çështjes së pronës dhe punësimit të punëtorëve. Këto janë çështje të rëndësishme të cilat janë diskutuar me AKM-në dhe UNMIK-un. Duhet theksuar se rregulloret e UNMIK-ut kanë paraparë procedurat e komplikuar lidhur me çështjen e definimit të titullarit të pronës. Sipas vlerësimit të Qeverisë aprovimi i këtij Projektligji përbën një hap përpara në rregullimin ligjor të Radio-televizionit të Kosovës si i vetmi televizion publik në Kosovë, prandaj ju propozoj që ta aprovoni këtë Projektligj në mënyrë që Radio-televizioni i Kosovës të vëhet në suaza të Kornizës ligjore adekuate. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DADI:

Zëvendëskryeministër ju faleminderit. Hapim debatin në parim, Lulzim Zeneli në emër të LDK-së.

DEPUTETI LULZIM ZENELI

Z. kryetar, të nderuar deputet, kryeministër dhe anëtarë të kabinetit qeveritar.

Është fat i mirë që pas një angazhimi të gjatë u arritë që të procedohet për miratim në Kuvendin e Kosovës Projektligji për Radiotelevizionin e Kosovës. Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës konsideron se rregullimi i bazës ligjore për funksionimin e mediave paraqet një komponentë të rëndësishme të demokracisë funksionale në vendin tonë dhe shqyrtimi i sotëm për miratim i këtij Projektligji është një hap i madh në përgjithësi në fushën mediale. Puna dhe funksionim i RTK-së si televizion publik që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës, për një informim të drejtë, cilësor dhe korrekt është me interes jetik i konsolidimit të mëtejshëm të demokracisë në vend.

Ky Projektligj që sot po e shqyrtojmë synon që përgjegjësia dhe obligimet janë të precizuara dhe të përcaktuara qartë, andaj miratimi i këtij Projektligji paraqet një hap që do ta qonte këtë medium drejt funksionalitetit dhe efikasitetit më të madh. Institucionet e vendit, por edhe menagjmenti i RTK-së me këtë Projektligj do të kenë përgjegjësi të dyfishtë dhe të ndërsjellët, për të garantuar një medium me fokus informimin e drejtë dhe të shpejtë të qytetarëve të Kosovës. Të nderuar deputet, Projektligji në fjalë parasheh rregullimin e drejtë dhe ligjor të të gjitha mekanizmave veprues të RTK-së, duke filluar nga menagjmenti e deri te programet speciale e edhe në raste emergjente dhe të krizave. Vënia e funksionimit të RTK-së në kornizë ligjore assesi nuk duhet të keq propagandohet, kinse si tendencë për të vënë monopol ose ndonjë kontroll mbi RTK-në, përkundrazi me këtë Projektligj fushëveprimtaria e RTK-së bëhet edhe më e qartë dhe më afër interesave të qytetarëve dhe të vendit, natyrisht gjithmonë nën vëzhgimin dhe përkrahjen e institucioneve të vendit siç është me këtë rast Kuvendi i Kosovës. RTK-ja gjatë këtyre viteve të veprimtarisë së vetë një pjesë të madhe të buxhetit e ka mbuluar nga buxheti i Kosovës si dhe nga parapagimet e qytetarëve të vendit, madje edhe atje ku ky medium nuk ka pasur shtrirje të valëve transmetuese, prandaj ky është edhe një argument më shumë se miratimi i këtij ligji, do ta vente në binarë të drejtë zhvillimin dhe avancimin e RTK-së, shtimin e ndihmës dhe të përkrahjes dhe agjërimit të kapaciteteve transmetuese në gjithë territorin e Kosovës.

Institucionet e Kosovës duhet të jenë vëzhguese dhe të kujdesshme për punën dhe transmetimin e RTK-së e kjo në asnjë mënyrë të mos kuptohet si ndërhyrje në politikat redaktuese dhe programore të këtij mediumi.

Të nderuar deputet. Ky Projektligj në draftin që na është proceduar nuk është i përkryer dhe pa të meta, ka mangësi por në punën e komisioneve do të mund të evitoheshin. Ka mangësi dhe zbrazësi juridike ose dilema në mënyrën e përzgjedhjes së bordit dhe strukturave tjera menagjuese të RTK-së, ose këto formulime janë bërë asi soji sa që krijojnë huti dhe paqartësi në kuptim. Në këtë Projektligj do të duhej të ishin precizuar më qartë edhe disa aspekte të përgjegjësive dhe të detyrave të menagjmentit të RTK-së dhe në rolin e këtij menagjmenti në zhvillimin dhe avancimin e mëtejshëm të shërbimeve të RTK-së. Projektligji për mendimin tonë garanton një përfaqësim dhe një qasje adekuate të grupeve etnike dhe kjo është një përparësi e madhe.

Z. kryetar. Me të gjitha vërejtjet që mund të dalin gjatë këtij shqyrtimi dhe gjatë procedurës së amendamentimit. Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim Projektligjin për RTK-në dhe i ftoj deputetët që ta votojnë në parim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Lulzim ju faleminderit. Z. Fehmi Mujota në emër të PDK-së, kurse le të përgatitet Zylfije Hundozi.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA

Z. Kryetar. Z. Kryeministër, ministra dhe kolegë deputet.

Që në fillim dua të them se për hir të korrektësisë dhe për hir të parimeve të punës së Komisionit funksional për Shërbimet Publike, Administratë Lokale dhe Media, dua të sqaroj për deputetët edhe disa elemente plotësuese që mendoj se ka qenë udhës që t'i bëj në fillim të debatit me që në mungesë të kryetares të Komisionit znj. Nekibe Kelmendi më takon që në rolin e zëvendëskryetarit të Komisionit të bëj këto sqarime.

Mbi bazën e një shkrese dërguar nga këshilltari ligjor i UNMIK-ut në adresë të zyrës së kryeministrit për të mos e vënë në rend dite çështjen e shqyrtimit të Ligjit të RTK-së për çështje pronësore të parregulluara në mes të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit të Qeverisë, përkatësisht të RTK-së dhe RTP-së. Ishte një adresim i cili e ka shtyrë Komisionin funksional të mbaj mbledhjen e vetë me datën 19 korrik 2005 dhe për të nxjerrë një vendim një zëri si Komision funksional. Për t'i shmangur të gjitha keqkuptimet e AKM-së, Qeverisë dhe pronës së RTK-së dhe për të mundësuar një debat të mirëfillt, natyrisht për të mundësuar edhe një punë më efektive të Komisionit funksional dhe për të mundësuar që Parlamenti të marrë vendime të drejta dhe ligjet t'i bëjë të zbatueshme, të mos kemi debate të gjera në të ardhmen ose më mirë të them pas shqyrtimit të ligjeve në mënyrë të tillë. Komisioni ka nxjerrë një rekomandim me datën 19 korrik, që çështja e këtij ligji të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen tjetër deri sa të zgjidhen këto konteste të përmendura edhe nga referuesi, përkatësisht zëvendëskryeministri në këtë rast. Me që ligji ka hyr në procedurë dhe tash kemi edhe diskutimet e para në shqyrtimin e parë, jemi vënë në një konfuzion të madh dhe çfarë të bëjmë, të shtyjme mëtej diskutimin dhe të marrim përgjegjësinë e çështjes së parregulluar të pronës si Komision funksional, nuk ka mundësi. Parlamenti po ashtu nuk është në mundësinë që të marrë vendim për të arsytuar vendimin jo të drejtë ose procedurat jo të drejta në mes të Qeverisë dhe atyre që hartuan ligjin, duke mos qenë të rregulluara të gjitha çështjet kontestimore, prandaj në qoftë se i referohemi vendimit të Komisionit funksional dhe vendimit të marrë njëzëri të Komisionit, ky ligj nuk është dashur të shqyrtohet dhe të aprovohet në parim, por të shtyhet për mbledhjen tjetër deri sa Qeveria të rregullojë këtë çështje, me që kemi hyrë në procedurë sigurisht që tani do të ndodh edhe aprovimi në parim, por të jemi shumë të sigurt se kështu do të bëjmë një praktikë jo të mirë që Qeveria të na sjell çështje jo të rregulluara si duhet në Komision dhe Parlamentin ta vejë në dilema ose të aprovojë ligje të cilat vështirë që do të ishin të zbatueshme. Me që mendimi i Komisionit ishte ky dhe nuk është larguar nga rendi i ditës shqyrtimi i ligjit, me që kolegu nga Lidhja Demokratike e Kosovës jep mendimin për aprovim në parim besoj se ka qenë i konsultuar me kryetarin e Komisionit dhe po të ishte

i konsultuar si duhet do të përmbante mendimin tonë dhe të Komisionit që ligji të shtyhej për shqyrtim të mëvonshëm. Andaj, neve na mbetet vetëm që të japim një sqarim të vogël që të mos ndodh një konfuzion në mes grupeve parlamentare. Qëndrimi i Komisionit ka qenë shumë i qartë, e drejta ka qenë në anën e Komisionit, problemet për të cilat kemi folur nuk janë zgjidhur akoma, por me që kemi hyr në shqyrtim ne do të japim vizën që të shkoj më tutje me kusht që problemet për të cilat po flasim të mos jenë të përsëritura në shqyrtimin e Komisionit parlamentar. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Sa për sqarim. Është krejtësisht e saktë ajo që thatë ju, e kamë pasur edhe unë këtë kërkesë, por në ndërkohë përgatitjet janë bërë pas mbledhjes së Komisionit, kanë treguar se shumë nga këto çështje nga ana e Qeverisë janë në zgjidhje apo janë zgjidhur, por unë pajtohem me ju që pas shqyrtimit të parë, në qoftë se do të merr notën pozitive, në qoftë se ka probleme të kësaj natyre ne mund ta shtyjmë shqyrtimin e dytë, prandaj tani kemi hyr në procedurë, Komisioni nuk ka kërkuar atë ditë që të hiqet nga rendi i ditës, pas sqarimeve që janë bër dhe ne duhet të vazhdojmë sipas procedurës.

Zulfije Hundozi dhe le të përgaditet Nazim Jashari.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI

Z. kryetar. Z. Kryeministër, ministra dhe kolegë deputet.

Grupi parlamentar i AAK-së e përkrah në parim miratimin e këtij Projektligji, duke marrë parasysh rëndësinë e ekzistimit dhe funksionimit të mirëfilltë të mediave publike për Kosovën. Kemi edhe disa vërejtje të cilat shpresojmë se në Komisionin përgjegjës do të përmirësohen. Njëra prej vërejtjeve është: Në kapitullin e tretë neni 19 ku flitet për financimin e RTK-së në pikën 1 thuhet se: Qeveria e Kosovës do të siguroj një kornizë financiare të përshtatshme përfshirë mbështetjen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Në preambulë thuhet: RTK-ja është medium i pavarur, a mund të jetë i pavarur nëse paguhet nga Qeveria, logjikisht ishte dashur të anoj kah ata që e paguajnë, por shpresojmë që financimi përmes parapagimit në të ardhmen do të funksionoj si duhet dhe nuk do të ketë nevojë të financohet nga buxheti i Kosovës dhe atëherë me të vërtetë mund të thuhet se RTK-ja është medium i pavarur. Nën dy, i janë dhënë kompetenca të tepruara drejtorit të përgjithshëm. Në kapitullin për kompetencat e bordit të RTK-së në pikën 5 thuhet: Bordi e emëron dhe i shkarkon redaktorët përgjegjës, por sipas propozimit të drejtorit të përgjithshëm, ngjashëm është edhe në pikën 9 në nenin 30 pika 1. Nën tre, në kapitullin 5 neni 6 në pikën 6 thuhet: Se RTK-ja në krijimin dhe përgatitjen e programit të saj posaçërisht do të jetë në interes të grupeve të caktuara të shikuesve dhe të dëgjuesve dhe të ju mundësoj atyre qasje në programin e saj. Në cilat grupe të caktuara mendohet, nuk mund të kuptohet as nga pika paraprake e as nga pika që vjen pas saj dhe nga konteksti i kapitullit në përgjithësi. Ky tekst i formuluar kështu jep hapësirë për manipulime dhe përjashtime nga ligji.

Anëtarët e Grupit parlamentar për Ardhmërinë e Kosovës, në komisionet përkatëse do të japin kontributin e vetë për begatimin e këtij Projektligji. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, fjalën e ka Nazim Jashari, kurse se të përgatitet Xhezair Murati.

DEPUTETI NAZIM JASHARI

I nderuari kryetar, të nderuar kolegë deputet, i nderuar kryeministër dhe ju ministra.

Më duhet të konstatoj një shkelje në punën e këtij Kuvendi dhe që nuk është hera e parë që po na paraqitet. Ne kishim një mocion procedural nga ana e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media. Në takimin e mbajtur më 19 korrik 2005 dhe i cili decidivisht thotë: "Projektligji për RTK-në të hiqet nga rendi i ditës", rekomandimi ka mbështetjen në letrën e UNMIK-ut të datës 24 qershor 2005 dërguar Qeverisë e kështu me radhë. Kështu ishte një mocion për ta hequr nga rendi i ditë një pikë e cila ka qenë e parapare në rendin e ditës.

Në rregulloren e punës të miratuar në këtë Kuvend thuhet: "Mocioni për të shtyrë debatin për një pikë të rendit të ditës, bëhet votimi pa debat". Ne nuk pamë që këtu u votua për të hequr ose mos hequr këtë pikë nga rendi i ditës, por këtu u procedura sikur të mos kishte mocion fare dhe është dashur që ky Kuvend të vendos që të vazhdojë apo të mos vazhdoj, por vendosi kryetari në emër të Kuvendit si gjithmonë deri më tash.

Sidoqoftë më duhet të them se është një ligj i cili është shumë i rëndësishëm për funksionimin normal të shoqërisë kosovare, sepse informimi dhe mediat janë funksionimi normal i shoqërisë Kosovare, sepse informimi dhe mediat janë aspekti vendimtar i funksionimit të demokracisë në një shoqëri, prandaj si i tillë ky ligj meriton një vëmendje të posaçme. Mirëpo, duke marrur parasysh konfuzionin që përmendi kolegu Mujota dhe paqartësinë që e ka shkaktuar kontesti në aspektin pronësor. Mospasja e një ligji i cili definojnë qartë këto raporte në shoqërinë tonë dhe duke pasur parasysh vërejtjet që kanë ardhur nga zyra ligjore e UNMIK-ut, mendoj se rekomandimi i Komisionit ka qenë vendim shumë me vend që të hiqen këto dilema, të shmangen të gjitha paqartësitë dhe më pastaj të vazhdohet me procedimin e këtij ligji në Kuvendin e Kosovës. Prandaj duke i pasur parasysh këto konfuzione dhe këto paqartësi, Grupi Parlamentar Ora nuk i jep përkrahjen shqyrtimit të këtij ligji dhe shkeljes procedurale që është bërë nga ana e kryetarit të Kuvendit, nuk i jep përkrahjen për të vazhduar në shqyrtim në Kuvend. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Fjalën e ka deputeti Xhezair Murati, kurse le të përgatitet prof. Sabri Hamiti.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI

Poštovani predsjedniče, premijeru, ministri i kolege mi smo takode ovim dilemama dovedeni u jednu dosta nezgodnu situaciju, jer smo prvoga dana na osnovu razgovora u grupi bili zajedničkog mišljenja da će odlaganje analize ovog Nacrta zakona dovesti nas u priliku da se bolje pripremimo i damo adekvatnije primedbe za njegove nedostatke. Međutim, evo kao što su rekli i kolege i kolega Mujota i ostali, mi smo u situaciji kada ne želimo da kočimo dalje njegovo procesuiranje, ali smatramo da je dosta nejasnoća kada su u pitanju odredbe ovog zakona, mada da ne bi sve crno bilo, zaista ovo predlaganje nezavisnog Borda koji bi imao za cilj jedan etnički balans, jeste to korak napred kada su u pitanju manjinske zajednice. Međutim ako se dalje analizira tekst ovog zakona mi ćemo

videti da se predvida procenat od 10 -15 % finansiranja za programe etničkih zajednica i isti toliki procenat programa podrazumeva vremenskog programa koji će biti poklonjen zajednicama, manje brojnim zajednicama. Međutim, sadašnja situacija neodražava ovaj procenat i pogotovu kada se govori u članu 8 o pokrivanju teritorije Kosova sa prenosom signala RTK-a na teritoriji od 90 %. Mislim da kada se uzme u obzir pokrivenost krajeva gde žive pripadnici bošnjačke zajednice je obrnuti odnos, 90% teritorije nije pokriven signalom RTK-a . Zatim kada se govori o satelitskom programu i prenosu, mi smo imali programe sa sadržajima etničkih zajednica samo u vremenu predizborne kampanje, dakle, kada je ona prošla ponovo nema satelitski program, a mi imamo takođe veoma brojnu zajednicu u diaspori i oni nisu u mogućnosti da prate programe na jezicima manjina tako da zaista naš je cilj, odnosno naša je želja da ne budemo kočnica njegovom daljem procesuiranju, ali smo dosta ne spremni, s obzirom na ovako unete nejasnoće, počev od prvog dana zasedanja Parlamenta do danas. Mislili smo da ćemo biti spremniji u koliko odložimo ovo razmatranje. Međutim u načelu mi prihvatamo sada kao grupa da se to procesuiri, ali drugo čitanje ćemo morati dočekati spremniji sa manje propusta, koji su sada evidentni kada su u pitanju specifičnosti manjinskih zajednica, ako već želimo da napravimo korak kako je rekao i gospodin Zenelji. Znači u načelu ga prihvatamo, ali imamo dosta velikih primedbi. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, fjalën e ka Sabri Hamiti, kurse le të përgaditet Selvije Halimi

DEPUTETI SABRI HAMITI

Ju faleminderit z. Kryetar i Kuvendit.

Nuk dëshiroj të bisedoj shumë për procedura, sepse janë bërë si llastik këto interpretime. Unë vetëm po ju informoj se si njeri i përgjegjshëm i këtij Parlamenti, kur e kamë marrë mocionin e Komisionit i jam drejtuar zonjës Nekibe Kelmendit se çka do të thotë kjo, znj. Nekibe Kelmendi si shefe e Komisionit ton. Ky mocion është i vonuar në kohë dhe është i paobjekt. Komisioni e dinë, nuk dua të hyj më tutje. Ky ligj ka mbetur në rend dite për shkak se mocioni i Komisionit është shpallur i pa objekt sepse është i vonuar.

Unë mendoj se ligji është i ndjeshëm, një ligj shumë i rëndësishëm dhe një ligj i cili duhet të vej rregull në transmetuesin më të rëndësishëm elektronik të Kosovës. Për këtë qëllim jam përpjekur që ta lexoj me shumë kujdes dhe të përpiqem t'i jap mendimet e mija rreth mënyrës së tyre. Presionit për kthimin në vende të tyre të punës dhe për rishqyrtimin e trashëgimisë së këtij Televizioni, them kështu sepse ne të dyja këto probleme i kemi brenda këtij ligji vetëm se janë të pa artikuluar mirë. Unë do të thosha me shumë pikëpyetje, mirë që janë këtu, mirëpo në punën e amendamentimit do të ketë punë të jashtëzakonshme. Unë mendoj se puna e madhe ka mbetur të bëhet në leximin tjetër që të zgjidhen këto probleme. Nisur nga këto dy çështje, problemi i punëtorëve të RTP-së që mendojnë se duhet të kthehen në Televizionin publik, në këtë rast nëse e ka emrin RTK, shihet në nenin 29.3, ku thuhet: Drejtori i përgjithshëm përmes një komisioni ekspertësh të themeluar nga bordi obligohet që brenda 90 dite nga emërtimi të udhëheq dhe të

kompletoj një vlerësim lidhur me kualifikimet e të gjithë personelit ekzistues RTK-së, kjo ka të bëjë me punëtorët që i ka tash dhe vazhdon fjalia e dytë: Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi duhet të krijohet hapësirë punësimi të gjithë personelit të RTP-së që aktualisht është i pa punësuar dhe plotëson kushtet e përgjithshme për themelimin e marrëveshjes së punës sipas ligjeve në fuqi. Ne kemi një komunikim publik të zëvendës kryeministrit me këta njerëz e sidomos me ata që bëjshin grevë dhe thoin që ata e kanë lënë grevën sepse zëvendëskryeministri i ka bindur që këta do të hyjnë në punë. Unë po ju them atyre dhe zëvendëskryeministrit që ky formulim nuk i shtin ata në punë, ju jep shans vetëm e nuk i shtin në punë, le të jetë e qartë. Kurse neni tjetër, në faqen 35 të Projektligjit ishte ky, kurse tjetri në faqen 35 b dhe c: Ky ka të bëjë me problemin më famoz të trashëgimisë, është e çuditshme se si mund të bëhet ky ligj me këto nene kaq të shkurtra dhe thotë: Vazhdimësi e RTP-së i ka tri aline. E para, RTK-ja vazhdon të veproj si institucion publik me autorizime të përcaktuara me ligj. Nën b, RTK është bartës i të gjitha të drejtave dhe obligimeve të ligjshme të RTP-së, qo do të thotë i merr pasuritë e tij dhe nën c/ deri në hyrje në fuqi të këtij ligji nëse me marrëveshje të veçantë AKM, RTK nuk parashihet ndryshe. RTK-ja merr përsipër respektimin e të gjitha obligimeve që rrjedhin nga kontrata që AKM i ka lidhur me partnerët tjerë për çështjet që kanë të bëjnë me lëshimin me qira të objekteve të RTK-së. Ju e shihni se ka një tendencë që preken problemet në ligj, kjo nuk funksionon hiq, kjo është ambicie. Për t'u rregulluar këto probleme sepse ka probleme të hatashme që duhet të zgjidhen para leximit të dytë.

Mbas analizës së nenit 19 ku jepet se si do të financohet ky Radiotelevizion, mbas analizës së nenit 23d, 29.3 dhe 24.4, unë mendoj se ky ligj është një ligj i cili pretendon se një Televizion të shpallur publik ta bëjë si Televizion shtetëror dhe kjo duhet të thuhet haptas, qartas. Le të bëhet si të donë njerëzit, por fundi i fundit është mirë që ky Televizion që ka qen i UNMIK-ut le të bëhet Televizion i Kosovës si e ka edhe emrin, se po ju them që deri më tash në asnjë aspekt, as të menagjimit as të programimit, nuk ka qen Televizion i Kosovës, ka qen televizion me emër RTK, por ka qen Televizion i UNMIK-ut sepse edhe në mënyrën e organizimit edhe me rregullore që është ndërtuar ka qen i tyre dhe unë mendoj se dujrt të koncentrohet në një ligj të Kosovës dhe të bëhet Televizion publik. Pse po them publik, sepse mënyra e funksionimit të këtij Televizioni në qoftë se donë dikush ta pranoj drejt ose nuk don, ka funksionuar në kuptimin e pjesëve informative shumë më shumë si Televizion që përcjell protokollet e udhëheqësve të Kosovës se sa si Televizion që informon, kjo duhet të thuhet në këtë Kuvend.

Televizioni publik, natyrisht që i nxjerr eksponentët udhëheqës në Televizion, por Televizioni i vërtetë publik nuk duhet të jetë instrument i regjistrimeve të protokolleve se kjo nuk bëhet askund, aq më tepër nëse kërkohet që të ketë burime financimi, parapagimi në rrjetin e gjerë të njerëzve dhe e dyta që do të ketë edhe ndihmesë të Qeverisë për programe që quhen të minoriteteve, diasporës, të mbajtjes së rrjetit dhe të kulturave shkencore. Mua më duket se roli i drejtorit të përgjithshëm është katastrofalisht i ngarkuar panatyrshëm, ku në një nen thuhet: Që ai e luan edhe rolin e kryeredaktorit, ndonëse ka edhe kryeredaktor që do të zgjidhet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Selviqe Halimi, kurse le të përgatitet Qibrije Hoxha.

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI

Ju faleminderit z. Kryetar, përshëndetje për kabinetin qeveritar dhe deputet.

E pashë të arsyeshme që të flas lidhur me këtë Projektligj duke u nisur nga fakti se jam anëtare e këtij Komisioni. Ajo pse Komisioni ka vendosur që të dërgoj një rekomandim që ky Ligj të hiqet nga rendi i ditës thirret në një letër të 24 qershorit 2005 të drejtuar nga Aleksandër Borg Olivier këshilltar ligjor i UNMIK-ut, këshilltarit ligjor të zyrës së kryeministrit, në të cilën letër thuhet: "Në mbledhjen e 122 me 14 qershor 2005 Qeveria ka rënë në dakord që ta shtyj miratimin e projektligjit për RTK-në për ta dërguar në miratim në Kuvendin e Kosovës". Thirrem në seksionin 8 pika 1 të Komizës kushtetuese, se kjo çështje është jashtë kompetencave legislative të Kuvendit. Unë me dëshirë kisha dashur ta dije nga kryeministri edhe pse sponzorimin për këtë Ligj e dha zëvendskryeministri, ndoshta këta i kanë ndarë punët dhe detyrat e tyre me një autorizim, udhëzim. Unë nuk e di, por ne zakonisht në prezencën e kryeministrit apo zëvendëskryeministrit apo ministrave, zakonisht prezantimin e ndonjë ligji e bën kryeministri ose ministri, në mungesë të tyre janë zëvendësit. Kisha dashur të dije se cilat janë ato probleme për të cilat është filluar të diskutohet, apo ndoshta është bërë ndonjë kompetencë për të cilën ne si deputet nuk e dimë. Sa i përket çështjes së pronës së RTK-RTP-së apo pronë shoqërore e tash pronë e RTK-së dhe deri ku është arritur. Unë mendoj se rekomandimin për të cilin më vjen keq në qoftë se i është thënë kryetares së Komisionit se është rekomandim i vonuar ajo vetë e ka marrë iniciativën në mbledhje të komisionit që të dërgojmë një rekomandim Kryesisë së Kuvendit që të largohet ky Projektligj nga rendi i ditës dhe rekomandimi është marrë me 19 korrik 2005 duke pasur për bazë faktin se derisa kjo letër e këshilltarit ligjor të UNMIK-ut i është drejtuar Qeverisë. Sipas informatës që na ka dhënë kryetarja e Komisionit i është drejtuar edhe Kryesisë së Kuvendit, vetë Kryesia ta tërheq nga rendi i ditës dhe ne kemi pritur se a do të jetë në rend të ditës apo jo në mënyrë që të takohemi dhe të parashtrojmë këtë kërkesë apo rekomandim që të hiqet nga rendi i ditës. Unë mendoj se mënyra e procedimit të projektligjeve në Kuvend në këtë formë dhe duke shkelur rregulloret apo duke mos dhënë informata të sakta apo duke komunikuar dy tre vetë për interesa të caktuara është një lëksion shumë i keq për të gjitha institucionet që pasojnë pas Kuvendit të Kosovës qoftë e nivelit qendror apo lokal si dhe për qytetarët e Kosovës. Nga se në këtë mënyrë duke shkelur procedura, duke mos pasur transparencë ne vërtetë po shkojmë duke e thelluar të drejtën që të kërkojmë respektim ligji dhe transparencë nga dikush tjetër. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Deputete, asnjë kërkesë e Komisionit nuk ka arrit në mbledhje të Kryesisë deri në mbledhje të fundit dhe vetë fakti që edhe kryeministri dhe zëvendëskryeministri dhe ishim në shqyrtim të parë dhe unë po ju them faktografinë e ju konkludoni si të doni dhe është e drejtë e juaja që të përcaktoheni për mendimin tuaj, prandaj po ju lus që mos të kthehemi vazhdimisht në një kohë.

Fjalën e ka Qibrje Hoxha, kurse le të përgatitet Ramadan Musliu.

DEPUTETJA QIBRIJE HOXHA

Ju faleminderit i nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar pjesëmarrës të tjerë.

Projektligji i Qeverisë për Radiotelevizionin e Kosovës të cilin e kemi marrë në shqyrtim, konsideroj se duhet të pësoj ndryshime substanciale për arsyet që do t'i paraqes dhe që u janë të njohura të gjithë qytetarëve të Kosovës si dëshmitar dhe bashkudhëtar i udhës kohore, kur funksionojë RTP-ja.

Me këtë Projektligj prona e RTP-së i dhurohet RTK-së së tashme të cilën UNMIK-u e krijoi si nevojë emergjente të kohës në vitin 1999, duke mos e respektuar legjitimitetin dhe legalitetin që kishte RTP-ja. Radiotelevizioni i Prishtinës që nga viti 1974 e deri në ditët e pushtimit me Universitetin e Prishtinës dhe Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, ishte strumbullar dhe bartës i transformimit kulturor, arsimor dhe edukativ të përgjithshëm të Kosovës. Radiotelevizioni i Prishtinës që nga viti 1974 e deri në ditët e pushtimit nga qytetarët e Kosovës dhe nga punëtorët e saj u konsiderua si institucion shtetëror dhe kombëtar i Kosovës, së bashku me popullin që kanë krijuar parakushtet institucionale drejtë shtetësisë së Kosovës.

Punëtorët e Radiotelevizionit të Prishtinës dhe populli i Kosovës gjatë viteve të okupimit të RTP-së, kanë pasur bindjen se RTP-ja do të çlirohet atëherë kur Kosova do të jetë e lirë dhe kur prona e Kosovës do të kthehet në pronësi të qytetarëve të saj dhe të institucioneve legjitime të saj, kurse sot RTP-së me këtë Projektligj tentohet t'i bëhet padrejtësia e dytë që t'i tjetërsohet prona dhe t'i dhurohet RTK-së.

Tjetërsimi i pronës së Radiotelevizionit të Prishtinës të cilin e themeloi Kuvendi i Kosovës është njësoj sikur të nxirësh ligje për tjetërsimin e pronave, Universitetit të Prishtinës apo të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Një veprim i tillë do të ishte i kundërllogjikshëm dhe i kundërligjshëm dhe si i tillë me plotë të drejtë kur nuk do të pranohej as nga institucionet në fjalë e as nga qytetarët e Kosovës.

Radiotelevizioni i Prishtinës është institucion legal dhe i krijuar nga një Kuvend i Kosovës dhe ky Kuvend i sotëm i Kosovës duhet të marrë veprime të nevojshme për ridefinimin e statusit të RTP-së dhe prona e RTP-së nuk është pronësi private e askujt, por është pronësi e Kosovës dhe e popullit të saj. Prandaj, me plotë të drejtë punëtorët e RTP-së janë kundër aktit që prona e RTP-së t'i dhurohet RTK-së. Simbas qëndrimeve të punëtorëve të RTP-së, ata kanë pritur 15 vjet dhe janë të gatshëm të presin deri sa të realizohet pavarësia e Kosovës.

Duke u nisur nga ajo që thash më lartë propozoj:

Të ndryshoj emërtimi i Projektligjit në fjalë në Projektligjin mbi RTP-në dhe këto ndryshime të përcillen në të gjithë tekstin. E dyta, t'ju mundësohet kthimi në vende të punës të gjithë punëtorëve të larguar në mënyrë që të bëhet sistemimi i tyre i mëtejshëm, si dhe të përcaktohet vazhdimësia e RTP-së si i vetmi medium i Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Ramadan Musliu, kurse le të përgatitet Bajrush Xhemajli

DEPUTETI RAMADAN MUSLIU

I nderuari kryetar, i nderuari z. Kryeministër, të nderuar anëtar të kabinetit qeveritar, të nderuar kolegë deputet.

Mendoj se Ligji për RTK-në për dallim nga shumë ligje tjera është një ligj i punuar me kujdes, një ligj i saktë, shumë konkret dhe që përcakton shumë përgjegjësi. Për kundër kësaj, mendoj se ky ligj është dashur të jetë pjesë e ligjit të përgjithshëm për Radiotelevizionin, të jetë një aneks i tij ku do të klasifikoheshin anët rregullative të kësaj fushëveprimtarie, pjesë e së cilës është edhe RTK-ja. Mirëpo që ligjin e kemi kështu si është, unë mendoj se janë tri probleme të cilat disa u theksuan në një mënyrë e disa në mënyrën tjetër. Problemi i parë është problemi i pronësisë, jemi të njoftuar së paku nga mediat se ekziston një marrëveshje në mes zëvendëskryeministrit dhe grevistëve në lidhje me problemet e RTP-së dhe kontekstit me RTK-në. Nuk dimë se cilat janë modalitetet e kësaj marrëveshje, mirëpo nëse ekziston një marrëveshje e tillë unë besoj se ajo do të ndikoj edhe në ristrukturimin e RTK-së. Çdo parregullsi që mund t'u bëhet punëtorëve të RTP-së në Radiotelevizionin e Kosovës unë besoj se do të ndikoj në një ristrukturim të thellë, për shkak se një numër kaç i madh i punëtorëve duhet të risistemohet dhe të krijohen vende të reja të punës, mbase ndoshta mund të krijohet edhe një program i dytë ose edhe diçka të ngjashme dhe mendoj se duhet të sanksionohet me ligj. E dyta, mendoj se ka pasur nevojë të qartësohet edhe një problem: Se edhe një pjesë e madhe e punëtorëve të RTP-së kanë qenë të angazhuar në pjesën teknike në antena, repetitor etj, e që duhet të sqarohet se në kompetenca të kujt do të mbeten ato, se a duhet të mbeten në kompetenca të autoritetit rregullativ të Telekomunikacionit apo do të vazhdoj njëjtë. Këtë problem e kemi pasur edhe kur ishte puna e Projektligjit për Komisionin e pavarur të mediave dhe që ka mbet një nga problemet e pa definuar deri më tani.

Si problem i dytë, është problemi i financimit. Këtu u përmend se ekzistojnë dy binare të financimit, e dimë se nga buxheti të cilin e kemi shqyrtuar në një nga seancat e këtij Kuvendi se 1 milion euro ndahen për financimin e RTK-së, në anën tjetër ekziston financimi përmes parapagimit, 3,50 jepen në formë të parapagimit dhe vilet përmes pagesës së energjisë elektrike. Unë mendoj se: Kur të bëhet ashtu sikur që përmendet në Projektligj një rregullativ në lidhje me financimin duhet të merret parasysh se është një parapagim, do të thosha katastrofale për rrogat buxhetore e dihet se pjesa më e madhe e rrogave të të punësuarve janë rroga buxhetore dhe një parapagim i tillë i bie diku 3% të rrogave të arsimtarëve e që në një farë mënyre vazhdon ajo gjorbitja tradicionale e 3% që është dhënë vite me radhë. Nëse merret parasysh edhe fakti tjetër se kjo shumë në raport me rrogat e pensionistëve bie diku afër 9%. Ekziston një nen me të cilin përjashtohen disa kategori sociale, por nëse marrim parasysh punën e pensionistëve një pjesë e të cilëve janë po ashtu në gjendje të keqe shëndetësore, një pjesë e madhe nuk merren me rregullimin e dokumentacionit për të dëshmuar se janë kategori e tillë, atëherë bie që ata të vazhdojnë ta paguajnë 9% e pensionit të tyre.

Po ashtu sa i përket problemit të tretë që thash, këtu nuk precizohen saktë pavarësia editoriale. E përmendi edhe Sabriu kur tha se: Ka të drejtë drejtori ta ushtroj detyrën e kryeredaktorit, kryeredaktori e ka politikën editoriale të institucionit. Unë mendoj se në se kërkohet një pavarësi më e madhe e institucionit duhet të qartësohet pavarësia editoriale. Ka edhe shumë probleme të tjera të cilat mund të përmenden. Unë e ndjej si mungesë mos përfshirjen e definicionit të problemit të ritransmetimit, kur dihet se një pjesë e madhe e programit mbulohet me ritransmetim, po ashtu duhet të përfshihet edhe problemi i prodhimit vetjak në televizion. Nëse një televizion publik e që kjo vlen edhe

për të gjitha televizionet nuk e ka prodhimin vetjak që është primare për Televizionin, atëherë nuk e ushtron funksionin themelor të vetin. Derisa Ligji merret me anët rregullative të institucionit, ndërkaq institucioni ka punë me qytetarët dhe me njerëzit e përditshëm e q më shumë me njerëzit e jetës publike, nuk ekziston një mekanizëm me të cilin do të mbrohet ai qytetar ose ai subjekt i cili shpesh mund të jetë i atakuar. Unë mendoj se duhet të futet edhe e drejta e demantit që ta bëjmë pakë dinjitetin e njeriut tonë për shkak se në mjetet e informimit e shohim se qytetari ynë është një objekt jo i talljeve dhe i fyerjeve dhe i cenimit të rënd të dinjitetit. Unë e kamë parasysh të drejtën e informimit të lirë, mirëpo e drejta e informimit të lirë është funksionale te shoqëritë e emancipuara, kurse ne ende jemi në prag të atyre shoqërive e nuk jemi brenda. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Bajrush Xhemajli, kurse le të përgatitet Teuta Sahatçiu

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI

Ju faleminderit z. Kryetar dhe ju përhëndes të gjithëve.

Unë nuk e kamë pasur ndërmend të diskutoj por dua ta sqaroj pozicionin tim, pse nuk do të votoj për këtë Projektligj dhe njëkohësisht të sinjalizoj diçka. Unë mendoj që nuk është materie në kompetencë të Kuvendit, materia që ka hyrë në këtë Projektligj. Komisioni ka vepruar jashtëzakonisht drejt kur ka marrë një vendim të tillë, për shkak se ne shumë letë mund t'ia qesim Komisionit në kompetencë por nëse nuk është në kompetencë as të Kuvendit e lëre ma të Komisionit, kompetent për materien e pronës dhe të tjera që këtu shumë theksohet është AKM-ja dhe deri sa nuk sqarohet një çështje e tillë dhe jo të mbetet tash përmes ligjit të sqarohet, nuk është çështje që përmes këtij Ligji mund të sqarohet se e kujt është prona.

Unë mendoj që ky Projektligj siç ndodh nganjëherë me disa projektligje do ta pësoj po atë fat dhe të mbetet në sirtar të Kuvendit dhe kush e di se kur do të del në shqyrtimin e dytë. Ne po i japim një punë Komisionit që unë mendoj se nuk e meriton për këtë arsye do ta votoj kundër. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, dhe në fund Teuta Sahatçija

DEPUTETJA TEUTA SAHATÇIJA

Ju faleminderit z. Kryetar.

Rekomandimin e Komisionit e kemi marrë të protokollar me datën 19 dhe e ka marrë secili deputet. Mendoj edhe ju z. Kryetar dhe secili prej nesh e kemi marrë këtë. Duke pasur parasysh që Komisioni do të punon në këtë Projektligj edhe duke i pasur parasysh problemet të cilat dalin prej këtij Projektligji të cilat të gjithë deputetët i cekën, problemin e pronës, problem shumë i nxehtë i punëtorëve të RTP-së të cilin çdokush e din. Atëherë të mos mundohemi ne që me krijimin e një problemi tjetër ta zgjidhim problemin e parë, se nuk do të zgjidhet problemi i parë, e do të krijohet edhe problemi i dytë. Ky rekomandim më shtyu t'ju lexoj mocionin procedural, sepse ky është njëfarë mocioni procedural. Në qoftë se nuk ka qen në mbledhje të Kryesisë si mocion mund të paraqitet

kur do në Kuvend. Në rregullën 30 për mocionet procedurale nën I thuhet: Në çdo seancë plenare të Kuvendit deputetët i jepet e drejta t'i propozoj këto mocione procedurale, mocionin për shtyrje debati etj, mos t'i numëroj. Prandaj puna e mos informimit në qoftë se Komisioni në krye me kryetaren e cila e ka nënshkruar këtë rekomandim dhe rekomandon që kjo të hiqet nga rendi i ditës, ndërsa kjo nuk hiqet dhe krijon një situatë jo të mirë për Kuvendin e qet në pozitë jashtëzakonisht të keqe, po ashtu të gjithë deputetët, sepse ne po diskutojmë për diçka që nuk do të zgjidhet, e cila do të krijoj edhe një problem tjetër, prandaj ne propozojmë pasi që hymë në këtë procedurë që nuk u ndal në fillim atëherë propozojmë që ky Projektligj të kthehet te sponzoruesi. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Teuta ju faleminderit, ju faleminderit edhe për një sqarim që ja dhatë edhe Komisionit edhe deputetëve. Është protokollar me 19 korrik, kërkesa e Komisionit, kurse ne me 20 kemi filluar seancën plenare, pas konsultimeve se çka të bëhet me këtë sepse çdo komision funksional gëzon një respekt në Kuvend. Është arritur një përfundim, sepse edhe vetë kryetarja e Komisionit u tha në debat se është e drejtë e çdo deputeti të votoj sipas konceptit dhe botëkuptimit të vetë, prandaj unë ju ftoj që të deklarohemi, i dëgjuam të gjitha diskutimet, i dëgjuam mendimet e Komisioneve parlamentare, regjia të përgatitemi për votim, votojmë tani.

53 deputetë kanë votuar për

33 deputetë kundër

Prandaj konsideroj se ky ligj ka kaluar në shqyrtimin e parë. E besoj se 33 vota kundër janë vërejtje e mirë për Qeverinë, udhëzim për komisionin që të punohet ngadalë, të punohet me cilësi dhe me përgjegjësi. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën e radhës.

Përgjigja gojore e ministrit Qemajl Ahmeti në pyetjen e deputetit Gazmend Muhaxheri lidhur me zbatimin e Ligjit për rrugët

Konstatimet hyrëse: Në pajtim me rregullën 26.4 të Rregullores së punës së Kuvendit deputeti Gazmend Muhaxheri, anëtar i Kryesisë, përmes zyrës për propozime i është drejtuar me pyetje për përgjigje gojore ministrit për Transport dhe Telekomunikacion z. Qemajl Ahmetit, prandaj e ftoj ministrin pasi që është përgjigje me gojë që ta marrë fjalën. Urdhëroni.

MINISTRI QEMAJL AHMETI

I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar deputet dhe i nderuari deputet në veçanti Gazmend Muhaxheri.

Dëshiroj që para jush t'i jap disa elemente të pyetjes suaj edhe pse u jam përgjigjur edhe me shkrim, prandaj për të mos u marrë kohë shumë pyetja ka të bëjë: Çka ka ndërmarrë ministria për të siguruar zbatueshmërinë e këtij ligji. Ju e dini që për të zbatuar një ligj përgjegjës janë të gjithë, pra edhe qytetarët në veçanti përpos ministrisë së Transportit,

Ministria e Transportit ju them se e ka departamentin e infrastrukturës rrugore, ka Drejtorinë e Rrugëve e cila e mbikëqyr procedurat i mirëmban dhe sheh se kush praktikisht e then ligjin, njëkohësisht në kuadër të Ministrisë së Transportit është inspekcioni i cili evidenton elementet që preken në kuadër të këtij Ligji dhe ngrit fletëparaqitje, kallëzime penale dhe elemente tjera juridike, pra këtë është duke e bërë, natyrisht në që masë mund të shihet në terren. Unë nuk do t'ju them sa kallëzime penale, sa fletëparaqitje, sa inspektime janë bërë sepse këtu është një shifër teknike që deputeti mund t'i merr kurdo që ka kohë në Ministrinë e Transportit. Sa i përket pyetjes së dytë: Sa dënime janë shqiptuar dhe sa mjete janë derdhur në buxhetin e konsoliduar të Kosovës për zbatimin e ligjit për rrugët që parashihet në nenin 36. T'ju them të drejtën neni 36 nuk është shumë i qartësuar për ata që nuk janë jurist, por megjithatë unë mendoj se është i adresuar keq me që dënimet nuk i shqipton Ministria, por gjykatat përkatëse, prandaj nuk kisha dashur që t'ju lodhi më tepër.

Nëse më lejohet unë e kisha bërë një digresion jashtë kësaj pyetje.

Në mbledhjen e fundit të Kuvendit ku është shqyrtuar çështja ekonomike, ish ministri Zef Morina e ka thënë një të pavërtetë të cilën ju deputet e keni miratuar buxhetin e Kosovës ku thuhet se buxheti i Ministrisë së Transportit është 2 milion më i madh, mendohet në buxhetin e 2005 në krahasim me 2004, dëshiroj ta informoj opinionin publik se jo juve se veç e keni miratuar. Buxheti i Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit këtë vit krahasuar me vitin paraprak është më i vogël për 8 milion e 100.00 mijë që është më i vogël për 30% ose 35%. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër ju faleminderit, Gazmend keni të drejtë në pyetje shtesë i keni 2 minuta.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI

Ministria është e detyruar që të bëjë mbrojtjen e rrugëve magjistrale dhe rrugëve regionale. Ministri nuk dha asnjë përgjigje se çka ka ndërmarë për t'i mbrojt këto ndërtime ilegale. Qytetarët e Kosovës janë dëshmitarë të ndërtimeve të ç'do ditshme brenda brezit të mbrojtur. Ministria është e obliguar që gjykatave t'ju dorëzoj me emra ata njerëz që e bëjnë shkeljen e këtij ligji e masë andej vjen Gjykata që merr vendime në bazë të fletëparaqitja që i ka bërë Ministria, nuk del Gjykata të bëj dënime pa shkuar inspektorati i Ministrisë së rrugëve me i bë këto denoncime. Kam dashur me vu në theks se Ministria nuk po e kryen punën e vetë dhe nuk po ju dërgon qytetarëve vërejtjet për ndërtimet ilegale, sepse dënimet që parashihen janë me të vërtetë dënime të mëdha. Kush do që e din se duhet të paguaj 100.000 € për ndërtim buzë rrugës magjistrale do të ndalej dhe nuk do të bënte.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ministër a keni të shtoni.

MINISTRI QEMAJL AHMETI

Duhet të dallohet ndërtim dhe uzurpim, çfarëdo ndërtimi që bëhet në rrugë leja merret prej Kuvendeve Komunale që nuk është përgjegjësi e Ministrisë, kurse Ministria e Transportit jep pëlqim se ku duhet të ndërtohet dhe dokumenti i Ministrisë është njëri prej

shumë dokumenteve që i nevojitet Kuvendit Komunal. Më shkurtimisht brezet e rrugëve i mbrojnë Kuvendet Komunale. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Para se të kalojmë në pyetjen tjetër unë lus seancën se a jeni për një pauzë gjysmë orëshe apo ta vazhdojmë menjëherë, mirë pra vazhdojmë.

Pika në vijim është shqyrtimi i interpelancës lidhur me punën e Qeverisë

Konstatimet hyrëse: Në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit, Grupi parlamentar i PDK-së ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që të ftohet në interpelancë kryeministri i Kosovës z. Bajram Kosumi lidhur me Çështjet që janë lëndë e interpelancës. Me që konfirmimi në përgjigje në interpelancë ka arritur pas caktimit të rendit të ditës të kësaj seance plenare, atëherë konform rregullës 25 pika 5 interpelanca është vënë si pikë e fundit të rendit të ditës të seancës plenare që është duke u zhvilluar.

Udhëzime procedurale: Në fillim të debatit përfaqësuesi i autorizuar që parashtrori interpelancë, ka të drejtë ta arsyetoj atë në lidhje me kërkesën. Kryeministri ose ministrit të cilit i parashtrohet interpelanca ka për detyrë ta paraqes dhe ta arsyetoj qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjen e shtruar në interpelancë. Urdhëroni përfaqësuesi i kërkesës z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

Z. kryetar. Z. Kryeministër, zonja dhe zotërinj deputet.

Partia Demokratike e Kosovës dhe Grupi parlamentar i saj që nga fillimi i kësaj legjislature, problemeve të qeverisjes i janë qasur me seriozitet dhe përkushtim me qëllimin e vetëm që në Kosovë të kemi një qeverisje të mirë, të përgjegjshme për proceset politike në zhvillim, të aftë dhe të zonjën për t'u përballur me sfida të shumta të kohës, sfida që nuk janë të lehta, janë më shumë se të vështira, prandaj kemi qenë të përcaktuar për një qeverisje tjetër më të përgjegjshme, më intelektuale dhe më profesionale, më transparente dhe më demokratike, më të vendosur dhe më kohezive. Tash 4 muaj të parë të qeverisjes së keqe, të pa aftë, jo profesionale të inkriminuar dhe të korruptuar. Qeveri që nuk respekton ligje dhe procedura, Qeveri që nuk ofron asnjë zgjidhje përveç diferencimit, tenderomanisë e keqmenaxhimit të financave dhe të pozitave politike të fituara mbi bazën e grupeve mafioze, të afrive miqësore dhe fafëfisnore e jo të ligjeve e përgatitjeve profesionale apo të organeve të institucioneve vendimmarrëse. Duke i parë këto dukuri më shumë se negative, duke parë jo vetëm falimentimin e kësaj Qeverie, por edhe të Kosovës dhe të të gjitha proceseve demokratike që do të duheshin të zhvilloheshin në Kosovë, morëm vendim që ta thërrasim kryeministrin Kosumi në një interpelancë për të shfletuar atë që mund të shfletohet në këto rrethana të vështira përcaktuese për të ardhmen e vendit tonë.

Për këto dhe shumë arsye tjera ne kemi bërë një varg pyetjesh që janë shumë konkrete e në këtë rast dua t'i konkretizoj edhe më shumë me qëllim që t'i krijoj lehtësi kryeministrit Kosumi të përgjigjet më lehtë, më shpejtë dhe më konkretisht.

Po vazhdojë me disa pyetje që kryeministri duhet të sqaroj Parlamentin dhe opinionin e Kosovës që me zile në vesh i pret përgjigjet dhe përgjegjësinë e Qeverisë së tij.

Z. Kryeministër:

1. Mbi bazë të cilit ligj apo procedurë, mbi bazën e të cilave kritere dhe kush ka bërë emërimin e 4 sekretarëve të përhershëm të këtyre ministrive, cili organ i Qeverisë ka bërë emërimin e tyre, sekretarin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Komuniteteve, të Energjetikës dhe të sekretarit permanent të Shërbimeve Publike.
2. Mbi cilën bazë ligjore është bërë ndërrimi i 4 zëvendës drejtorëve të Departamentit të Tatimeve që është një punë mjaft profesionale.
3. Gjatë periudhës 200 ditore të qeverisjes suaj, sa është shfrytëzuar konkursi si institucion për emërimet në postet e larta të administratës shtetërore.
4. Cila është shkalla e nepotizmit dhe çka keni ndërmarrë që ta luftoni këtë praktikë mafioze të sundimit antiligjor.
5. Cilën bazë dhe a ka pasur të drejtë Qeveria të marrë vendim për moszbatimin e ligjit për lojërat e fatit, Suis Loto mbi bazë të cilit ligj në fuqi është regjistruar.
6. Çka keni bërë për të ndriçuar kalimin e më tepër se 1 milion eurove nga Ministria e Shërbimeve Publike në buxhetin e presidentit.
7. Sa mjete financiare deri më tani ka humbur buxheti i konsoliduar i Kosovës rreth ndërtesës së pallatit të Rilindjes të shpallur nga UNMIK-u ndërtesë qeveritare, statusi i së cilës nuk ndërron nga shumë objekte tjera qeveritare.
8. Pse u bë ndërhyrje në ndërtesën e Bankosit dhe sa i kushtuan buxhetit të konsoliduar të Kosovës ato ndërhyrje, ndërhyrjet ishin profesionale apo të qejfeve arkaike.
9. Sa mjete buxhetore harxhoi kabineti qeveritar për rimeremetimin dhe rimobilimin e kabineteve të ministrave kur dihet se nuk ishte shumë kohë që ato ishin meremetuar dhe mobiluar.
10. Sa mjete buxhetore janë harxhuar për projektet e paplanifikuara dhe sa të planifikuara janë mbetur pa u financuar.
11. Si kryeministër që jeni, a keni kërkuar ndonjë sqarim si u harxhuan mbi 170 milion euro në dhjetorin e vitit 2004.
12. Si janë bërë tenderimet për projektin ideor për pallatin presidencial dhe pallatit administrativ të Parlamentit në Parkun Nacional "Gërmia", për këtë të fundit duhet të përgjigjet edhe kryetari dhe Kryesia e Parlamentit tonë.

I nderuari z. Kryeministër, pamvarsisht nga përgjigjet tuaja ne do të kemi materialin e mjaftushëm për të konkretizuar të gjitha shkeljet që edhe janë bërë pyetjet. Ne disponojmë material të bollshëm për të treguar se kabineti qeveritar dhe jo vetëm ai, por edhe institucionet e tjera të dalura nga votat e zgjedhjeve të fundit kanë shkelur ligjin për shërbyes civil, kanë bërë shkelje të rënda të ligjit të Prokurimit Publik dhe kanë bërë shkelje të rënda të menagjimit të financave publike.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Fjala është e juaja z. Kryeministër

KRYEMINISTRI BAJRAM KOSUMI

I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar kolegë ministra, deputet, zonja dhe zotërinj. Fillimisht e falënderoj Grupin parlamentar të PDK-së për interpelancën e bërë dhe të them se jam i gatshëm të përgjigjem detajisht në të gjitha pyetjet që më janë shtruar dhe të jap argumente detaje të bollshme, të shumta në mënyrën se si më janë bërë pyetjet. Pyetjet që i shtroj tash z. Krasniqi janë të reja, nuk janë bërë në interpelancë, janë pyetje të reja të shtruara këtu dhe unë e inkurajoj z. Krasniqi që t'i bëjë në mënyrën e duhur dhe në procedurën e duhur dhe do t'u përgjigjem edhe atyre si u jam përgjigjur këtyre pyetjeve që i kamë sot këtu. Unë kamë marrë në procedurë 5 pyetje, do t'i lexoj pyetjet një nga një dhe do të jap përgjigje për secilën pyetje dhe pastaj jam i gatshëm të debatojmë edhe rreth çështjeve tjera.

Pyetja e parë (1):

Çfarë ka bërë Kryeministri në mandatin 100 ditor për të implementuar dhe mbrojtur ligjin për shërbimin publik dhe institucionin e konkursit? Sa është numri i punëtorëve të punësuar pa konkurs? Sa punësime janë bërë me ndërhyrjen e kryeministrit?

Përgjigje:

Në mandatin 100 ditor është treguar një kujdes i veçantë në respektimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore. Veçanërisht, kujdes i veçantë është shprehur në zbatimin dhe mbrojtjen e ligjit për shërbime publike dhe për institucionin e konkursit.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në shërbimin civil në Zyrën e Kryeministrit deri më 30.06.2005 është 150. Nga data 23 mars 2005 në ZKM janë punësuar 12 nëpunës civilë me kontrata të përkohshme. Pas 23 marsit të vitit 2005 janë shpallur 2 konkurse (njëri për 10 vende pune për punësimin e minoriteteve dhe tjetri për 10 vende të rregullta të punës). Konkursët janë shpallur në mediat e shkruara në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Përveç në media të shkruara, konkursi për minoritete është shpallur edhe në disa gjuhë të komuniteteve, të cilat janë transmetuar edhe në mediat elektronike në gjuhën e komuniteteve.

Në organizimin e ri të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale janë përcaktuar vendet për minoritete prej 14.3 %, kurse 41 % për gjininë femërore. Janë shpallë konkurse për minoritete dhe për nevoja tjera në këtë ministri. Janë pranuar 23 punëtorë, ndërsa janë larguar, për arsye të ndryshme, 10 sish. Janë pranuar 6 vërejtje me shkrim, të shqiptuara për punëtorë të caktuar.

Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal, nga Ministria e Shërbimeve Publike, i është bartur Departamenti i Administrimit Lokal me 26 punëtorë. Gjithsej të punësuar në këtë ministri janë 41 punëtorë. Ministria ka shpallur 3 konkurse. Me konkursin e parë

janë pranuar 6 punëtorë, me kontratë afatshkurtër janë angazhuar 5 punëtorë, ndërsa 4 persona përbëjnë stafin politik në këtë ministri.

Në këtë ministri ekziston një konkurs i hapur për minoritete për 3 poste. Konkursi ka qenë i shpallur në mjetet e informimit në gjuhën serbe. Përzgjedhja nuk është bërë për shkak se këto tri poste kanë qenë të lidhura me emërimin e zëvendësministrit serb në këtë Ministri. Gjithashtu, edhe një konkurs është i hapur për 15 poste, për të cilat kanë konkurruar 660 kandidatë. Seleksionimi i kandidatëve këto ditë do të bëhet.

Në Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, deri më tani, nuk është punësuar asnjë nëpunës civil.

Në Ministrinë e Shërbimeve Publike prej 612 të punësuarve, 60 janë minoritarë. Gjatë 100 ditëve të mandatit të kësaj Qeverie, kjo Ministri ka shpallur 7 konkurse për 31 punonjës civilë, 12 prej të cilëve minoritarë. Janë pranuar 7 punonjës, prej tyre 5 shqiptarë dhe 2 minoritarë. Nuk është pranuar asnjë punonjës për kohë të caktuar, gjegjësisht pa konkurs. Në këtë ministri nuk është bërë ndonjë analizë apo hulumtim rreth afërsisë së punonjësve.

Në Ministrinë e Shëndetësisë janë të punësuar 154 punëtorë. Përqindje të strukturës gjinore është: 65 femra, ose 42,20 %; 89 meshkuj ose 57,79 %. Nga numri i të punësuarve, 14, ose 9.09 % iu përkasin minoriteteve. Në të gjitha rastet e pranimit të stafit civil është respektuar procedura e paraparë. Asnjë punonjës nuk është pranuar me kontratë afatshkurtër.

Prej gjithsejtë 162 të punësuarve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, 8 prej tyre janë minoritarë. Gjatë tre muajve të fundit nuk ka pasur punësim në këtë ministri.

Në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është respektuar plotësisht institucioni i konkursit.

Në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, që nënkupton edhe zyrat e saja rajonale, prej 1 marsit e deri më 05.07.2005, sipas konkursit të rregullt, janë pranuar 14 punëtor.

Numri i të punësuarve në Ministrinë e Energjetikës dhe Minierave arrin në 83, prej të cilëve 13 me kontrata shërbimi. Kjo është bërë pasi që deri më sot nuk është shpallur konkursi nga ana e Komisionit për Emërimet të Larta për Sekretar të Përhershëm. Për kontratat tjera arsyeja qëndron te kufizimi që ka ekzistuar deri para disa javësh për numrin e punëtorëve në këtë Ministri. Mu për këtë, ende nuk janë shpallur konkurset për t'i plotësuar vendet e punës me procedurë të rregullt.

Në Ministrinë për Komunitete dhe Kthime, përmes konkursit dhe me kontrata, janë punësuar gjithsej 193 veta, duke përfshirë edhe pjesëtarët e kabinetit. Në kabinetin e ministrit, bashkë me të emëruarit politikë, janë gjithsej 17, ndërsa në atë të zëvendësministrit 9 veta. Si ministri e re, në këtë periudhë është në konsolidim e sipër administrata.

Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente në katër muajt e fundit janë punësuar gjithsej 12 shërbyes civilë, që të gjithë pjesëtarë të minoriteteve. Punësimi i tyre është bërë sipas rregulloreve të caktuara dhe duke respektuar institucionin e konkursit.

Sa i përket pyetjes së grupit parlamentar të PDK-së, se sa punësime janë bërë me ndërhyrjen e kryeministrit, dua të theksoj se Kryeministri, dhe askush nga stafi i ZKM-së, nuk kanë ndërhyrë dhe nuk bëjnë ndërhyrje në asnjë rast gjatë procedurës së pranimit të punonjësve nëpër ministri dhe ZKM.

Pyetja e dytë (2):

Çfarë ka bërë Kryeministri dhe Qeveria për të penguar nepotizmin në Qeverinë e Kosovës?

Angazhimi kundër nepotizmit dhe korrupsionit është pjesë esenciale e qeverisjes së mirë, dhe është një sfidë e madhe për qeveritë në tërë botën. Shpesh, në vendet në tranzicion, nepotizmi dhe korrupsioni shfaqet si një fenomen i zakonshëm në jetën e qytetarëve. Kjo paraqet pengesë serioze për funksionimin e institucioneve publike.

Në Kosovë, korrupsioni dhe nepotizmi nuk kanë depërtuar dhe nuk janë rrënjësuar aq thellë sa t'i bëjë të kota përpjekjet tona kundër këtyre dy fenomeneve. Edhe hulumtimet e bëra tregojnë se qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike ose statusi socioekonomik, përgjithësisht mendojnë se korrupsioni është një sjellje e papranueshme në shoqëri.

Ndonëse faktorët historikë dhe kulturorë e fusin Kosovën në një grup të rrezikuar nga korrupsioni dhe nepotizmi, përpjekjet e kohëve të fundit të Qeverisë së Kosovës të medias dhe organizatave të shoqërisë civile, kanë demonstruar vullnet politik për t'u ballafaquar me problemin e korrupsionit dhe të nepotizmit në mënyrën e duhur.

Luftimi dhe kundërvënja ndaj korrupsionit dhe nepotizmit përbejnë një nga prioritetet e programit të Qeverisë që unë udhëheq. Gjithashtu, politikisht është e domosdoshme për Qeverinë që të ndalojë korrupsionin si një hap i rëndësishëm drejt arritjes së implementimit të "Standardeve për Kosovën".

Në këtë mënyrë, Qeveria e Kosovës më politikën e saj të luftimit të korrupsionit, dhe parandalimit të tij, i është qasur në disa drejtime:

- a. përmes krijimit të legjislacionit;
- b. edukimit (ngritjen e vetëdijesimit të opinionit publik) dhe
- c. krijimit të mekanizmave për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Në këtë kuadër tanimë janë krijuar disa mekanizma dhe janë ndërmarrë hapa konkret që do të mundësojnë një luftim adekuat të fenomenit të korrupsionit dhe të nepotizmit.

Grupi punues ndërministror kundër korrupsionit

Me vendimin e Qeverisë të datës 9.10.2003 është formuar grupi punues ndërministror kundër korrupsionit. Ky grup përfaqësohet nga të gjitha ministritë e Qeverisë, përfaqësuesit e Departamentin të Drejtësisë dhe Zyrës Ligjore të UNMIK-ut. Grupi punues ndërministror kundër korrupsionit ka mandat hartimin e politikave dhe strategjive kundër Korrupsionit. Ky grup vazhdon të jetë funksional edhe në kohën kur Ne po flasim.

Strategjia kundër korrupsionit

Qeveria e Kosovës, në mars të vitit 2004, ka aprovuar strategjinë kundër korrupsionit. Kjo strategji është hartuar nga grupi punues ndërministror në përbërje të të cilit kanë qenë edhe strukturat e UNMIK-ut, agjencitë ndërkombëtare, përfaqësues të shoqërisë civile, nën koordinimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit. Strategjia parasheh më se 150 masa parandaluese duke përfshirë fushën ekonomike, legjislacionin, administratën publike, politike, mediat, shoqërinë civile etj.

Ligji kundër korrupsionit

Ashtu siç parashihet në strategji, në kuadër të krijimit të legjislacionit të nevojshëm për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, Qeveria ka aprovuar projektligjin kundër korrupsionit. Ligji është miratuar nga ky Kuvend dhe është shpallur nga PSSP-ja më 12 maj 2005.

Ky ligj është hartuar nga ekspert vendorë dhe ndërkombëtarë, përfaqësues të institucioneve qeverisëse, sektorit joqeveritar, dhe është përkrahur nga agjencione të ndryshme ndërkombëtare si dhe agjencioni evropian, GTZ.

Ligji parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të strategjisë kundër korrupsionit. Veçanërisht masat parashihen në:

- fushën e hetimeve administrative të korrupsionit publik;
- eliminimin e shkaqeve të korrupsionit;
- papajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar;
- kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e punëve në detyrë;
- mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta;
- kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publikë duke kryer biznes me firmat ku personi zyrtari ose një person në marrëdhënie të afërt është i përfshirë me të.

Plani i veprimit kundër korrupsionit

Qeveria e Kosovës është në proces të hartimit të planit të veprimit kundër korrupsionit. Kjo bëhet në bashkëpunim me strukturat e UNMIK-ut, Këshillin e Evropës dhe përfaqësues nga Shoqëria Civile. Dhe, në këtë kuadër, deri më 22 shkurt 2005, në

bashkëpunim me projektin Paco Impact të Këshillit të Evropës, janë organizuar punëtoritë për zhvillimin e këtij Plani.

Plani i Veprimeve për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit, do të përfshijë masat specifike anti-korrupsion në tre elemente të Strategjisë:

1. Forcimi i Ligjit
2. Parandalimi
3. Pjesëmarrja dhe Edukimi i Publikut

Plani synon përfshirjen e masave që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Do të përcaktohen qartë përgjegjësia e aktorëve, afatet dhe treguesit e suksesit.

Fushata publike kundër korrupsionit

Zyra për Qeverisje të Mirë e Kryeministrit dhe partnerët e saj kanë lansuar një kampanjë të gjerë kundër korrupsionit që përforcon rolin e shërbyesve civilë dhe qytetarëve të zakonshëm në luftimin e korrupsionit. Fushata është një aspekt kyç i qasjes së shumanshme ndaj luftimit të korrupsionit. Fushata udhëhiqet nga një këshill drejtues nën udhëheqjen e ZQM/ZKM dhe një bashk-udhëheqës nga shoqëria civile.

Këshilli drejtues, paraqet një nivel të paraparë të bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm me interes të luftimit të korrupsionit në Kosovë, duke përfshirë liderët brenda qeverisë dhe shoqërisë civile. Fushata publike kundër korrupsionit ka për qëllim të ndihmojë në implementim e strategjisë kundër korrupsionit. Për këtë janë formuar nëngrupe për të dizajnuar dhe kryer aktivitete në fushat siç janë: avokimi, edukimi, në nivel komunal dhe atë qendror. Po ashtu, këto aktivitete përfshijnë fushat mediale të vetëdijesimit, trajnime me shërbyesit civilë, dhe forume në Komuna për të formuluar plane lokale të veprimit për të luftuar korrupsionin

Krijimi i mekanizmave të tjerë

Sa i përket krijimit të mekanizmave për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, Qeveria është duke punuar në themelimin e Agjencioni kundër Korrupsionit, i cili sipas ligjit kundër korrupsionit do të jetë një agjencion i pavarur që do të ketë një varg përgjegjësishë në këtë sferë. Pengesat buxhetore kanë prolonguar deri më tash formimin e këtij agjencioni, por besoj se brenda disa ditëve edhe kjo punë do të kryhet.

Rendësi e madhe i është kushtuar edhe zhvillimit dhe përsosjes së sistemeve për rritjen e transparencës, dhe llogaridhënies të institucioneve Qeveritare. Për rritjen e transparencës, si një ndër faktorët parandalues të korrupsionit, Qeveria ka aprovuar Ligjin Mbi Qasjen në Dokumentet Zyrtare.

Në përfundim mund të them se duke pasur parasysh se korrupsioni është një fenomen dinamik, që zhvillohet dhe ndryshon, reagon dhe transformohet sipas rrethanave që ndryshojnë. Qeveria e Kosovës mbetet thellë e përkushtuar në agjendën për luftimin e korrupsionit dhe do të vazhdojë të punojë me partnerët për të përmirësuar qeverisjen dhe forcimin e institucioneve publike në përkrahje të zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë.

Çrënjësja e korrupsionit në Kosovë do të përfshijë jo vetëm reformat institucionale dhe legjislative, por gjithashtu edhe një angazhim afatgjatë për të ndryshuar kulturën ndaj korrupsionit në Kosovë. Përpjekjet për të zvogëluar atë, do të jenë plotësisht të integruara në programet e Qeverisë së Kosovës përgjatë të gjithë sektorëve të saj.

Qeveria e Kosovës dhe kosovarët e kuptojnë se përpjekjet kundër korrupsionit duhet të përfshijnë shumë aktorë në marrjen e përgjegjësiive për të adresuar aspekte të veçanta të këtij problemi kompleks. Ndryshimet rrënjësore dhe të qëndrueshme të fushave të lartpërmendura, në përjasje dhe praktika, mund të krijohen vetëm nga një orientim koherent i reformave dhe nga një bashkëpunim real i të gjithë forcave të shoqërisë, si të sektorit publik, sektorit privat, shoqërisë civile dhe të gjithë aktorëve të tjerë të rëndësishëm.

Pyetja e tretë (3):

Çfarë ka bërë Kryeministri dhe Qeveria për të mbrojtur dhe aplikuar Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe Ligjin për Prokurimin Publik?

Përgjigje:

Neni 4 i Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe çështje Buxhetore qartëson rolin dhe qëllimin e Departamentit të Buxhetit. Po këtu qartësohen detyrat dhe përgjegjësitë.

Neni 10 definon çështjen e parasë publike në paragrafin 10.2 deri në pikën j. Përveç kësaj, Departamenti i Buxhetit është munduar që edhe të hyrat tjera, që janë të krijuara nga organizatat buxhetore, t'i futë nën ombrellën e llogarisë së BKK-së përmes memorandumeve të mirëkuptimit.

Në bazë të nenit 17, Departamenti i BKK nxjerr qarkoret dhe instruksionet buxhetore dhe i obligon agjencionet shpenzuese që t'i përgatisin format për ndarjet buxhetore në bazë të nevojave që ata kanë. Po ashtu, këto kërkesa analizohen nga Departamenti i BKK në bazë të kalendarëve. Analizën e krahasuar edhe me projeksionin e të hyrave e adreson në Zyrën për Çështje Fiskale dhe Komisionin për Buxhet. Pastaj, ky draft-propozim i përgatitur kalon në Qeveri, Kuvend dhe te PSSP për t'u nënshkruar.

Drafti i Buxhetit përgatitet në bazë të kornizës strategjike dhe prioritetëve të Qeverisë.

Neni 21 definon çështjet e përvetësimit në mungesë të një ligji vjetor. Nëse një ligj vjetor mbi përvetësimet për një vit fiskal nuk miratohet nga kuvendi, dhe nuk shpallet nga PSSP para fillimit të vitit fiskal, atëherë në bazë të këtij neni, Departamenti i Buxhetit përgatitë Rregulloren për zgjatje të afatit të përvetësimeve buxhetore për një muaj të vitit fiskal gjegjë, duke u bazuar në vitin e mëparshëm nga përvetësimet buxhetore. Mirëpo, nëse

përsëri nuk është nënshkruar Ligji i ri mbi përvetësimet, atëherë Departamenti i Buxhetit prapë përgatitë dokumentin për zgjatje të afatit të përvetësimeve për PSSP. Një situatë e tillë është përcjellë këtë vit në mungesë të ligjit mbi përvetësimet.

Neni 27 definon transferet që mund të bëhen me rekomandim të udhëheqësit të organizatës buxhetore me një arsytim të vlefshëm.

Ministri për ekonomi mund të bëjë një lëvizje të tillë deri në shumën 20 % të ndarjes buxhetore të përvetësimit të ndikuar negativisht.

Shuma nga 20 % deri në 40 % adresohet te Qeveria dhe te PSSP, ndërsa për shumën prej 40 % vendos Kuvendi dhe PSSP.

Ministri për Ekonomi dhe Financa, duke u mbështetur në nenin 41 të LMFP-së, ka përgatitur Raportin përfundimtar të buxhetit për vitin e kaluar. Ky raport i është dorëzuar Kuvendit dhe PSSP-së, dhe është publikuar.

Me qëllim të transparencës buxhetore, MEF përgatitë edhe raportet mujore dhe së paku në çdo tre muaj mbahen takime me mediat e shkruara dhe elektronike për zhvillimet buxhetore.

Revizioni nga jashtë i BKK bëhet në bazë të nenit 43, kështu që asnjë dispozitë e këtij ligji nuk e obligon dhe as nuk e ndalon pushtetin e rezervuar të PSSP-së që të bëjë angazhimet për një revizion të jashtëm dhe të pavarur të BKK. Mirëpo, një kontroll i tillë deri më tani nuk është bërë.

Në bazë të Rregullores nr. 2005/12 mbi Miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2005, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, në konsultim me Ministrin e Shërbimeve Publike, kanë autorizuar rritje të numrit të personelit të disa organizatave buxhetore, por pa ndryshim të ndarjeve buxhetore, si për shembull te ministrinë e reja.

Nga data 03.02.2005 ka filluar të funksionojë Komisioni i Rregullave i Prokurimit Publik (KRRPP), i cili punon në bazë të kompetencave të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës nr. 2003/17. Gjatë kësaj periudhe janë kryer këto aktivitete: Departamenti për Shqyrtimin e Ankesave ka shqyrtuar 65 ankesa për të cilat ka lëshuar 31 vendime për anulim tenderi, 19 vendime për aprovimin e kontratës, 6 vendime për kthimin e tenderit në rivlerësim dhe 9 vendime për refuzimin e ankesave si të pakompletuara.

Departamenti për Revizion dhe Monitorim ka bërë 4 revizione (në Ferizaj, në Vushtri, në Viti dhe në Gjilan), 10 inspektime gjatë procedurës së prokurimit dhe 30 vëzhgime të hapjeve publike të tenderëve.

Departamenti i Trajnimeve ka licencuar 330 zyrtarë të prokurimit, prej të cilëve 18 serbë, ndërsa vazhdon me trajnimin e 217 zyrtarëve të prokurimit, prej të cilëve 32 serbë. Gjithashtu, vazhdon kompletimi i dokumenteve për rregullat e Prokurimit Publik.

Agjencioni i Prokurimit Publik është në konstituim e sipër, dhe funksionon në bazë të kompetencave që parasheh Ligji i Prokurimit Publik. Për këtë qëllim Qeveria ka hartuar një listë me propozime prej pesë (5) anëtarëve për bord të agjencionit, që pritet të miratohet në Parlament.

Gjatë kësaj periudhe Agjencioni i Prokurimit Publik ka shqyrtuar 817 lëndë. Prej tyre, me procedura të negociuara, pa publikimin e njoftimit të kontratës, kanë qenë 303, kurse 224 të tjera kanë qenë lëndë për lejimin e procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës. Për 36 lëndë të tjera nuk janë lejuar procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës.

Në këtë fazë është bërë aprovimi i 32 lëndëve për lejimin e punëve shtesë që nuk e kalojnë 10 % të vlerës së kontratës. 10 lëndë janë aprovuar për lejimin e punëve shtesë, që kalojnë 10 % e vlerës së kontratës. Këto janë lëndë nga Komisioni Qendror Ndërmintor për ndërtimin e shtëpive të djegura gjatë trazirave të 17 dhe 18 marsit 2004.

Gjatë kësaj periudhe, në Njësinë Qendrore të Prokurimit kanë arritur 192 njoftime për dhënie të kontratave nga njësitë prokuroese; janë publikuar 161 njoftime për dhënie të kontratës nga njësitë prokuroese në Web-faqen e Agjencionit të Prokurimit Publik. Kanë ardhur 130 kërkesa për shkurtimin e afatit kohor për publikimin e tenderëve. Nga këto janë aprovuar 119 kërkesa për shkurtim të afatit, ndërsa 11 kërkesa nuk janë aprovuar.

Deri më tani në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës kanë arritur 169 ankesa. Prej tyre, 156 ose 92.3 % janë të nacionalitetit shqiptar, ndërkaq 10 ankesa, ose 5,9 % janë nga minoritetet.

Nga meshkujt janë paraqitur 134 ankesa, ose 79.2%, ndërsa nga femrat 32 ankesa, ose 18.9%.

Nga shuma e përgjithshme, 56 ankesa ose 33.1% janë të natyrës së ndërprerjes së kontratës. 53 ankesa ose 31.3% janë për shkelje të rregullave të procedurës së konkursit, 12 ose 7.1% për shkarkim nga posti, 10 ose 5.9% për degradim nga posti, dhe 10 ose 5.9 % për mos vazhdim të kontratës etj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës ende nuk ka filluar me shqyrtimin e ankesave në mungesë të Udhëzimit që rregullon procedurën e ankesave në këtë Këshill, në Sekretariatën e të cilit deri më 30 qershor janë paraqitur 78 ankesa, disa prej të cilave kanë të bëjnë për shkelje të rregullave procedurale të konkursit.

Në dy rastet Këshilli ka monitoruar procedurat e zgjedhjes së drejtorëve në Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit: në një rast ka patur shkelje të rregullave të konkursit (publikimi është bërë me vonesë, kushtet e konkursit), ndërsa në tjetrin rast ka patur rrespektim të plotë të rregullave të konkursit .

Këshilli ka bërë 46 vizita monitoruese në komuna dhe në ministri për vlerësimin e rrespektimit të Ligjit të Shërbimit Civil. Me qëllim të përmirësimit të punës dhe të ndërmarrjes së veprimeve për zbatim adekuat të ligjit, Këshilli ka lëshuar 25 rekomandime për komuna dhe për ministri. Nga këto, 10 rekomandime janë për përmirësim të veprimeve, për rrespektim të rregullave të konkursit (shpallje të konkursit dhe publikimin e konkursit në gjuhën serbe, me këto kanë të bëjnë vërejtjet. Nëpër disa ministri procedurat e afateve kohore dhe të përdorimit të gjuhëve zyrtare etj.

Me propozimin e Qeverisë së Kosovës, në mbledhjen e datës 04.01.2005, Kuvendi i Kosovës më 31.01.2005 ka emëruar Kryetarin e Komisionit të Rregullave të Prokurimit Publik, kurse ky komision nga data 03.02.2005 ka filluar të funksionojë në bazë të kompetencave të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës nr. 2003/17. Gjatë kësaj periudhe Komisioni, nëpërmes Departamentit për Shqyrtimin e Ankesave, në panel prej tre anëtarëve, ka shqyrtuar 65 ankesa për të cilat ka lëshuar 31 vendime për anulim tenderi, 19 vendime për aprovimin e kontratës, 6 vendime për kthimin e tenderit në rivlerësim dhe 9 vendime për refuzimin e ankesës si të pakompletuar. Nga Departamenti për Revizion dhe Monitorim janë kryer këto aktivitete: 3 revizione (në Kuvendin Komunal në Ferizaj, në Kuvendin Komunal në Vushtrri, në Kuvendin Komunal në Viti dhe në proces në Kuvendin Komunal në Gjilan). Gjatë procedurës së prokurimit janë bërë 10 inspektime dhe 30 vëzhgime të hapjeve publike të tenderëve. Departamenti i Trajnimeve ka licencuar 330 zyrtarë të prokurimit, ndërkaq trajnimet janë duke i vijuar 217 zyrtarë. Nga Departamenti për Rregulla janë aprovuar 3 formularë, janë draftuar 4 dosje të tenderit, janë draftuar 13 formularë standard shtesë të dosjes së tenderit, është draftuar procedura për kontrata minimale, si dhe është aprovuar Kodi i etikës.

Pyetja e katërt (4):

Çfarë masash janë ndërmarrë kundër atyre që kanë bërë bartje të paligjshme të mjeteve buxhetore nga Ministria e Shërbimeve Publike në Presidencë?

Shuma prej 1 milion Euro është ridestinuuar për blerjen e veturave për Presidencën. Është parë e arsyeshme për shkaqe sigurie që të bëhet ky ridestinim, e sidomos pas shpërthimeve të marsit që kanë ndodhur në Kosovë.

Duhet theksuar faktin se këto vetura nuk janë dedikuar për persona privat por për institucione dhe autoritetete të larta shtetërore.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka nxjerrë një dokument me të cilin bëhet evidentimi i pasurisë shtetërore dhe këto vetura prapë do të jenë pasuri shtetërore. Gjithashtu vlen të theksohet se MEF-ja ka rikthyer këtë shumë të parave Ministrisë së Shërbimeve Publike. Kjo është kompensuar nga rezervat e Ministrit në pajtim me ligjin për menagjimin e financave publike dhe është bërë edhe në pajtim me rekomandimet e zyrës së PSSP-së. Për këtë veprim ekzistojnë dëshmi dhe shkresa zyrtare.

Pyetja e pestë (5):

Mbi çfarë baze është lejuar ndërhyrja buxhetore për meremetimin e ndërtesës së Bankosit, dhe cili është implikimi i juaj dhe i paraardhësit tuaj në ndryshimet e projektit të meremetimit të këtij objekti?

Përgjigje:

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj të 30-të, të mbajtur më 20 nëntor 2002, ka vendosur që për nevojat e Qeverisë për hapësirë të punës të marrë objektin e ish- Bankës Popullore të Kosovës.

Më 22 korrik është bërë marrëveshja në mes Agjencionit Evropian për Rindërtim (AER) dhe UNMIK-ut mbi donacionin për avancimin e këtij projekti. Fjala është për një vlerë prej 6 milionë e 500 mijë Euro (6.500.000 Euro) e nënshkruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm z. Mihajl Shtajner dhe Adriano Martines nga Agjencioni Evropian për Rindërtim.

Më 11 nëntor 2002 është lidhur kontrata për zhveshjen e ndërtesës në mes të Agjencionit të Prokurimit Qendror, e nënshkruar nga z. Mihajl Dethlefsen, Shefi i Agjencionit të Prokurimit Qendror dhe kompanisë Polluzha nga Drenasi në vlerë prej 130.840 Euro.

Më 25 nëntor 2002, pas konkursit ndërkombëtar, është lidhur kontrata në mes të UNMIK-ut dhe kompanisë, konsulente teknike, Luisberger, e nënshkruar nga Shefi i Agjencionit të Prokurimit Qendror z. Mihajl Dethlefsen në vlerë prej 449.700 Euro.

Më 19 dhjetor 2002 është shpallur tenderi ndërkombëtar dhe pas përfundimit të procedurës, Shtylla e IV e UNMIK-ut, ka anuluar këtë tender.

Më 1 gusht 2003 është shpallur sërish tenderi. Pas vlerësimit të komisionit teknik, i përbërë nga përfaqësuesit e Agjencionit Evropian për Rindërtim, nga kompania konsulente Luis Berger dhe nga Ministria e Shërbimeve Publike, është propozuar t'i besohet kontrata kompanisë Unioninvest nga Sarajeva.

Kontrata në vlerë prej 8 milionë e 416.709,68 euro është nënshkruar më 27 nëntor 2003 nga përfaqësuesi i Shtyllës IV z. Nikolas Lamsdorf, nga përfaqësuesi i kompanisë Unioninvest z. Faruk Gabrella, dhe nga Ministri i atëhershëm i Ministrisë së Shërbimeve Publike, z. Jakup Krasniqi.

Meqenëse Agjencioni Evropian për Rindërtim nuk i ka bartur mjetet në shumë prej 975.000 Euro, është bërë zotimi nga Ministria e Shërbimeve Publike për këto mjete shtesë, që në shumën totale janë 3 milionë e 635.745,58 Euro. Më 9 tetor 2003 janë përfshirë edhe 975.000 Euro, të cilat janë paraparë t'i kthehen Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, pasi që AER-i t'i bartë këto mjete në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Më 10 gusht 2004 është bërë aneks-kontrata për financimin e taksave TVSH për pjesën e kontratës që financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në vlerë prej 597.508,43 euro. Kontrata është nënshkruar në emër të Agjencionit të Prokurimit Qendror nga z. Marjan Përlaskaj, për Ministrin e Ministrisë së Shërbimeve Publike ka nënshkruar këshilltari z. Xhelil Pajaziti. Për palën Unioninvest ka nënshkruar z. Mehmed Mahmutović.

Me kërkesën e Zyrës së Kryeministrit më 25 dhjetor 2004 është bërë ndryshimi i projektit të katit II, me vlerë të parafoguarit prej 66.606,01 Euro.

Më kërkesë të Zyrës së Kryeministrit më 20 prill 2005 është bërë ndryshimi i katit III, me vlerë parallogaritare prej 6.895,57 Euro. Është bërë edhe ndryshimi i sallës së Qeverisë në vlerë prej 25.111,40 Euro.

Ministria e Shërbimeve Publike ka kërkuar që për punët shtesë të mermerit të katit përdhes dhe B1 të sigurohen 84.090,60 euro.

Me kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të shkurtit 2005 është bërë ndryshimi i projektit për dhomën e serverëve, në vlerë parallogaritare prej 272.689,60 euro.

Me kërkesë të Kryeministrit, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është bërë projekti i mobileve për hapësirat e përbashkëta. Vlera e parallogarituar kap shumë prej 312.778 euro.

- Me vendimin e Qeverisë nr: 5/149 të datës 30 maj 2005, është vendosur që mjetet në vlerë prej 1 milion e 163.000 Euro, të parapara për Pallatin e Shtypit, të ridestinohen për përfundimin e punimeve në objektin qeveritar. Kjo është bërë me qëllim të kryerjes së punimeve shtesë (ndryshimi i katit II, katit III, sallës së Qeverisë, punimet e mermerit në përdhesë, B1, ndryshimet në dhomën e serverëve dhe mobilierin e hapësirave të përbashkëta, si dhe për shkak të mjeteve për pagesë që e përbëjnë shumicën 590.000 €.
- Duke u mbështetur në nenin 34 të Ligjit mbi Prokurimin Publik, pjesa e TVSH-së e cila kap vlerën 597.508 Euro, e që nuk ka qenë e paraparë në kontratën kryesore, ka bazë ligjore edhe pse është bërë me aneks kontratë në kohën e ministrit Krasniqi, kjo ka bazë ligjore dhe nuk është paraparë në kohën e duhur dhe do të paguajmë në tash.

Të nderuar deputet jam munduar të jap tërë aktivitetin e Qeverisë në të gjitha fushat që janë përmendur në këto 5 pyetje dhe me shumë nënpyetje, për të dhënë shifra, veprime, programe dhe punë tjera me të cilat Qeveria dhe ekipe të tëra të njerëzve të Qeverisë për çdo ditë punojnë dhe i kryejnë punët e tyre. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kryeministër ju faleminderit për fjalë tejet të detajizuara, përplot argumente. Unë jam i bindur që propozuesi i interpelancës ka marrë një përgjigje të dinjitetshme dhe të bazuar, megjithë atë konform rregullave duhet të hap debat për interpelancë. Do t'ju lutja që të mos flitni përmendësh, ata që nuk kanë informacione ta mendojnë mirë, debati është i hapur për të gjithë, urdhëroni. Z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

Z. kryeministër, pyetjet që i bëra sot nuk janë shtesë, janë pyetje që gjinden në 5 pyetjet e bëra me kohë, 4 pyetjet e para që unë i kamë lexuar sot gjinden të përfshira pothuajse kryesisht në pikën e parë dhe të dytë. Përgjigjet që i ndëgjuem në këto pyetje në fakt janë përgjigje në pyetje që si kamë bërë unë. Pyetjet e mia janë konkrete dhe po i lexoj jo nga ajo që i lexova sot por po e lexoj pyetjen e parë të interpelancës.

1. Çka ka bërë kryeministri në mandatin e tij 100 ditor për të implementuar dhe mbrojtur ligjin për Shërbimin Publik dhe institucionin e konkursit.

Këtu nuk e muarëm asnjë përgjigje,

Sa është numri i punësuar i punëtorëve pa konkurs.

Unë nuk kamë kërkuar numrin e punëtorëve të punësuar në Ministrinë e Shërbimeve Publike e as në ndonjë ministri tjetër. Unë kamë kërkuar nga kryeministri të na jep numrin e punëtorëve të punësuar gjatë mandatit të tij pa konkurs, nuk kamë kërkuar përgjigje në të punësuarit me konkurs, se konkursi është institucion që e respektoj edhe unë. Sa është numri i të punësuarave pa konkurs dhe sa punësime janë bërë me ndërhyrje të kryeministrit edhe këtë nuk e ka thënë.

Çka ka bërë kryeministri dhe Qeveria për të penguar nepotizmin në Qeverinë e Kosovës,

As këtu nuk kamë marrë asnjë përgjigje.

Z. kryeministër. Gjatë këtij mandati tuaj në Qeverinë e Kosovës janë shkëlur dy ligje, Ligji 2001 ose Rregullorja 2001/19 mbi të cilën janë të formuara institucionet dhe Rregullorja 2001/36 për Shërbyesit civil. Z. Kryeministër jeni kryesues i Këshillit të lartë për emërimë. Kush e ka bërë emërimin e 2 ministrave të ri në Ministrinë e Shërbimeve Publike, dy sekretarët e Shërbimeve Publike. Kush e ka bërë emërimin e sekretarit në Ministrinë e Pushtetit Lokal. Kush e ka bërë emërimin e sekretarit në Ministrinë për Komunitete dhe kush e ka bërë emërimin e sekretarit në Ministrinë për Energjetikë, mendoj se këshilli i lartë për emërimë nuk e ka bërë këtë.

Po ju lexoj nga Ligji i Shërbimeve Publike.

Për të ushtruar detyrën e sekretarit në rast të mungesës së sekretarit të përhershëm mund ta bëjë vetëm ndonjë shërbyes civil i nivelit të lartë brenda të njëjtës organizatë, kurse procedura për emërimin e sekretarëve është shumë e qartë në rregulloren 2001/19 nën pikën 2, ku thuhet qartë se i vetmi autoritet për emërim është këshilli për emërimë të larta publike dhe atë pas shpalljes së konkursit, rekomandimit të komisionit i cili interviston kandidatët dhe mandej është vendimi i këshillit të lartë për emërimë.

Z. kryeministër në ekspozenë tuaj nuk gjetëm përgjigje dhe nuk është dhënë asnjë përgjigje për zyrtarët më të lartë në administratën shtetërore në Qeverinë e Kosovës. Emërimi i kryeinspektorit të punës, apo i kryeshefit në ministrinë e punës si dhe drejtori i departamentit për çështje të invalidëve të luftës janë bërë pa e kaluar asnjë procedurë të domosdoshme ligjore të cilat u përmendën më lartë si p.sh procedura e shpalljes së konkursit, procedura e rekrutimit, e lidhjes së kontratës dhe etj. Janë çështje shumë konkrete z. Kryeministër dhe nuk je përgjigjur në këto çështje.

Aktualisht në të gjitha ministritë po pranohen shërbyes civil pa kaluar nëpër komisione, pa kaluar përmes konkursit dhe pa kontrata.

Z. kryeministër për këtë arsye dhe shkeljeve që ekzistojnë çështja është potencuar edhe në raportin e 23 majit të Këshillit të Sigurimit ku është ngritur shqetësimi për mosrespektimin e procedurave të Këshillit të lartë për emërimet. Kryesues i së cilës është Kryeministri i Kosovës, d.m.th vërejtjet kanë shkuar deri në Nju Jork për shkak se Këshilli i lartë për emërimet i ka shkelur të gjitha procedurat dhe të gjitha ligjet në fuqi që kanë të bëjnë me shërbyesit civil.

Shkarkimi i zyrtarëve të lartë, zëvendësrektorëve të administratës tatimore në kundërshtim me kontratat e punës dhe në kundërshtim me procedurën, për vlerësimin e punës, shkeljen e të gjitha parimeve të shërbimit civil që janë të parapara me Ligjin e shërbimit civil. Parimi i transparencës, tolerancës, bindjes politike, parimi profesional nuk janë parë dhe janë bërë këto shkelje. Këto janë shkelje që dihen dhe që janë bërë duke mos përfill asnjë procedurë dhe as Ligjin e Shërbimit civil z. Kryeministër dhe mendoj që dikush është dashur të merret në përgjegjësi dhe është dashur të jetë ndërhyrja e kryeministrit dhe e Qeverisë dhe kjo nuk ka ndodhur.

Z. kryeministër e keni pasur pyetjen e tretë,

Çka ka bërë kryeministri dhe Qeveria për ta mbrojtur dhe aplikuar ligjin e menagjimit të financave publike dhe ligjin për prokurimin publik.

Në këtë pyetje z. Kryeministër nuk është përgjigjur, e ka anashkaluar krejtësisht dhe ka folur çka ju ka tekur ose çka i ka servuar administrata e tij, por përgjigje në pyetje nuk ka. Pyetja e katërt është:

Çfarë masash janë ndërmarrë kundër atyre që kanë bërë bartjen e paligjshme të mjeteve buxhetore nga Ministria e Shërbimeve Publike në Presidencë.

Edhe këtu z. Kryeministër përgjegjësia është në tri nivele. Niveli i parë dhe do të duhej të dënohej me ligj është Ministria e Shërbimeve Publike. Niveli i dytë është administrata e presidencës dhe përgjegjësia e tretë është në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave e cila është e obliguar ta mbron Ligjin për menagjimin e financave publike, ajo nuk e ka bërë këtë, përkundrazi e ka shkelur ligjin. Dihet se deri në 250.000 euro për raste urgjente ministri i ekonomisë dhe financave në bazë të buxhetit të rezervuar ka të drejtë t'i jap pa e pyetur askend, por nëse shuma kalon 250.000 euro vendimin duhet ta marrë Qeveria në bashkëpunim me shefin e UNMIK-ut, kjo nuk ka ndodhur, është shkelje e rëndë e ligjit të menagjimit për të cilin ka edhe dënim me gjyq, jo vetëm dënim moral. Z. Kryeministër edhe nëse është bërë ajo forma e kthimit të mjeteve ne nuk kemi asnjë dokument se është bërë kthimi i atyre mjeteve, konsiderojmë se kjo është edhe një shkelje tjetër e ligjit për të cilën mendoj se do të flasim edhe tjerët dhe do të afrojmë dokumentacionin përkatës për të gjitha këto shkelje që janë bërë dhe në pyetjen e fundit.

Me çfarë baze është lejuar ndërhyrja buxhetore për meremetimin e ndërtesës së Bankosit dhe cili është implikimi juaj dhe i paraardhësit tuaj. Në kontratë shkruan se nga shuma e paraparë me tender mund të tejkalohet 10%. Në rastin tonë është tejkaluar 3 herë shuma për këtë objekt dhe gjithë kjo është pasojë e menagjimit të keq dhe shfrytëzimi i keq i buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Unë shpresoj z. Kryeministër se për të gjitha këto që i ngritëm diskutuesit në vazhdim do të ofrojnë fakte dhe dëshmi se këtu ka shkelje të mëdha të ligjeve në fuqi për të cilat vërtet ky kabinet qeveritar duhet të jep përgjegjësi e jo vetëm përgjegjësi morale. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DADI:

Ju faleminderit, fjalën e ka Safete Hadrgjonaj, kurse le të përgaditet Akil Koci.

DEPUTETJA SAFETE HADRGJONAJ

Ju faleminderit z. Kryetar. Z. Kryeministër.

Në mjetet e informimit por edhe kur i jeni drejtuar këtij Kuvendi, ju vazhdimisht thuani unë bëra, unë e provova, unë vendosa e pas takimit me Solanën ndoshta ishte i shqetësuar nga kritikën që murrët ju si kabinet qeveritar dhe si kryeministër për qeverisje të keqe, ju deklaruat se unë dhe Qeveria ime, unë dhe Qeveria ime . Pasi që Qeveria qenka e personifikuar në ty, atëherë keni përgjegjësi edhe më shumë të përgjigjeni në shumë gjëra që na shqetësojnë neve, por edhe të gjithë qytetarët e Kosovës të cilët duan Qeveri të Kosovës që punon për mirëqenien e tyre dhe jo qeveri të individëve që nuk dinë se çfarë do të thotë të jesh anëtar i kabinetit qeveritar. Qeveri që e orienton Kosovën kah një gjendje më e mirë ekonomike e jo një Qeveri që orienton nga një gjendje e vështirë ekonomike dhe politike. Kur nuk votuam për Qeveri ne nuk e bëmë thjeshtë se ishim opozitë, por për faktin se donim një Qeveri të fortë për t'i qar përpara proceset e jo Qeveri si kjo që çdo ditë e më shumë devalvohet për shkak të joprofesionalizmit, jo transparencës, korrupsionit joefikasitetit dhe autoritarizmit. Nuk donim struktura Qeveritare që donin të shtohet pushteti i individëve të dobësohet institucioni, sepse donim Qeveri që punon për institucione të forta të bazuara në ligje e kështu do të kufizohej pushteti abuziv individual, në asnjë ligj që është miratuar në këtë Parlament nuk thuhet se kryetari, kryetari i Kuvendit, kryeministri, ministrat janë mbi ligjin, të gjithë duhet ta respektoni ligjin. E sot jemi dëshmitar të një realiteti ku aq poshtë ka rënë ky kabinet qeveritar, aq shumë ua ka zënë sytë dhe veshët rënja pas parës sa që nuk pyesin për asgjë. Në të gjitha sferat e administrimit si në sferën e resurseve njerëzore, në menagjimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës, si dhe në politikën fiskale dhe doganore po vazhdon pa ndërprerje keqmenagjimi, heshtja dhe indiferentizmi juaj është i pajustificueshëm. Po thuaj se asnjë organizatë buxhetore nuk ka shpenzuar mjetet sipas planeve të shpenzimeve buxhetore, po përmend vetëm zyrën e kryetarit që në tre mujorin e parë ka shpenzuar 53% të mjeteve të përgjithshme që janë ndarë për këtë vit. Atëherë pyes z. Kryeministër. Si do të mbulohej shpenzimet e kësaj zyreje deri në fund të vitit? Çfarë masash janë marrë ndaj personit të paautorizuar siç thuani ju dhe kabinetit të juaj qeveritar që ka nënshkruar kontratën për pajisje zbuluese për presidencën në vlerë prej 2.800.000 €, a është e njoftuar Qeveria për ankesën zyrtare që firma amerikane Dekoteks ia ka dërguar gjykatës së përhershme të arbitrazhit në Hagë? A e di Qeveria se presidenca e ka buxhetin vetëm 2.274.884 € të miratuara në këtë Kuvend dhe në bazë të të dhënave që ju i keni sjellur në raportet buxhetore pothuajse gjysma e këtij buxheti është shpenzuar vetëm në 3 mujorin e parë. Atëherë ju pyes juve? Si do t'i siguroni 1.800.000€ për t'i kryer obligimet për kontratën e lidhur me firmën anonime Italiane për dizajnin dhe asistencën teknike të rezidencës së presidentit, apo duhet t'i paguajnë dëmshpërblimet në pamundësi për t'i përmbushur obligimet siç ka ndodhur gjatë qeverisjes suaj. A i ka shqyrtuar Qeveria raportet tre mujore dhe katër mujore të buxhetit ku janë përfshirë shpenzimet dhe të hyrat brenda kësaj periudhe. A e din Qeveria se sa janë shpenzimet e miratuara në buxhetin e konsoliduar për vitin 2005 dhe lejon që të na

ofrohen raporte mund të them edhe qesharake të cilat nuk u diskutuan kurrë në Kuvend, pasi që në asnjë raport shpenzimet e miratuara në Kuvend nuk përputhen. A ka qeveria ndonjë raport të revizionit financiar qoftë të zyrës së kryetarit, zyrës së kryeministrit, të Kuvendit apo të ministrive. Ju i përmendët disa raporte të revizionit financiar të cilat janë bërë në disa komuna, por për fat të keq Kuvendi nuk disponon me asnjë prej këtyre raporteve. Pse nuk implementohet neni 41.1 paragrafi b, neni 44, neni 52 i Ligjit për menagjimin e financave publike dhe përgjegjësi. Mungesa e kontrollit i hap rrugë vjedhjes së buxhetit të cilën ju e bëni për çdo ditë. Sa janë shpenzimet e telefonit, të karburanteve, të ushqimit apo të mëditjeve të famshme jashtë vendit të kabinetit qeveritar. Çka është marrë nga qeveria e juaj ndaj ministrave të cilët e kanë shkelur ligjet, rregulloret në fuqi. Për fjalën e lirë të thënë në Kuvend nga deputetët bazuar në fakte, nga qeveritarët ditën e parë të kësaj seance parlamentare dëgjuam edhe kërcënime se fjala juaj tërheq edhe përgjegjësi, po ju të nderuar qeveritar a keni përgjegjësi për veprimet e bëra. Ju pyes juve kryeministër, kush duhet të jap përgjegjësi për vendimin e juaj të cilin u përpoqët përciptazi ta arsyetoni, vendimi nr. 5/49 të datës 31.05.2005 të nënshkruar nga ju pa kurrfarë arsyeshmërie. Ja shihet vendimi se kurrfarë arsyeshmërie nuk keni dhënë në këtë vendim, ku mjetet prej 1.163.000 € të parapara për Pallatin e Shtypit të ridestinohen për ndryshimet e bëra në ish Bankën Popullore të Kosovës, plotësisht në kundërshtim me ligjin për menagjimin e financave publike dhe sidomos me Ligjin për prokurorimin publik neni 34. Nëse dikush duhet të bartë përgjegjësi për fjalën e thënë atëherë a duhet të bartin përgjegjësi ministrat për vendimet që i nënshkruajnë plotësisht në kundërshtim me legjislacionin në fuqi e që buxhetit të Kosovës i kushtojnë miliona euro.

Kush ka përgjegjësi për afro 3.000.000 € të hargjuara në 3 drejtime. Në pastrimin e Pallatit "Rilindja" për projektin ideor dhe për dëmshpërblimin që i është paguar firmës "Çlirimi" që ka kontraktuar punën.

Z. kryeministër çfarë masa keni marrë për vendimin e nënshkruar nga ministresha e Ministrisë së Shërbimeve Publike nr. 408 të datës 6.04.2005. Kush e ka autorizuar atë të nënshkruaj atë vendim e të formoj komisione sipas interesit të saj për të vlerësuar punën e ndërmarrjes "Çlirimi", e ky dëmshpërblim i kushton buxhetit të Kosovës hiq më pak se 765.084 €. Vendimi është plotësisht në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Z. Kryeministër ky është vendimi, ky vendim është plotësisht i paligjshëm, sepse ministresha nuk është mbi ligjet të cilat janë në fuqi dhe që është më e keqja dhe që është edhe qesharake bazohet në nenin 9.3.3. të Rregullores 2001/6, Rregulloren mbi shoqëritë tregtare dhe nenit 9.3.3. nuk ka në këtë rregullore siç shihet nga dokumentacionet.

Zotërinj qeveritar askush nuk po bën veprime të papresedant siç u tha ditën e parë të seancës ndaj Qeverisë, por vendimet e pamira të Qeverisë po bën Qeveria ndaj Qytetarëve të Kosovës duke abuzuar, duke vjedhur, duke keqpërdorur paranë publike, djersën dhe mundin e qytetarëve të Kosovës.

Ne do të donim që puna juaj vërtet do të ishte ashtu siç u përpoqët ta thuani edhe nuk thatë asnjë gjë sot dhe do të ishte ndoshta një tregim i mirë dhe unë do të kisha thënë një veprim i mirë për ju, por ju e dini se nga disa hulumtime që janë bërë në Kosovë se pakënaqësia e qytetarëve për gjendjen e keqe të ekonomive të tyre familjare është shumë më e madhe këta 6 muajt e fundit në krahasim me vitin e kaluar. Prandaj, ne kemi ngritur zërin sepse nuk duam që korrupsioni të bëhet pjesë e jetës së shoqërisë në vend që të konsiderohet si një rrezik që duhet zhdukur. Ne kemi ngritur zërin sepse nuk duam që kur

të diskutohet statusi i Kosovës në tryezë të jenë raportet për korrupsionin dhe krimin e organizuar të instaluar pikërisht në institucionet tona qeveritare dhe në institucionet e tjera të Kosovës. Edhe njëherë po e përsëris heshtja juaj z. Kryeministër, komoditeti juaj se gjëja se nuk po ndodh asgjë dhe gjithçka është në rregull është i pajustificueshëm. Kostoja e mosveprimit të juaj shumë shpejt e konsiderueshme dhe me pasoja shumë të rënda. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Gani Koci, kurse le të përgatitet Veton Surroi.

DEPUTETI GANI KOCI

Faleminderit z. Kryetar. I nderuari kryeministër.

Duke dëgjuar ekspozenë tënde, po e quaj ekspozë sepse nuk ishte përgjigje në interpelancë, por ishte një fjalë e bukur për ato qeveri që donë të inaugurohen për herë të parë në këtë Kuvend dhe bukur shumë i ngjasonte atij programi që e kemi pas dëgjuar shumë herë dhe që jeni vazhdues i tij. Por nuk do të ndalem në këtë çështje. Unë do të ndalem vetëm në atë që thatë se ju keni respektuar dhe vazhdoni të respektoni dhe të implementoni Ligjin mbi menagjimin e financave publike dhe se Qeveria juaj nuk ka bërë asnjë shkelje në këtë drejtim.

Do të dëshiroja që t'ju tërheq vëmendjen dhe dëgjoni nenin 11 të Ligjit mbi menagjimin e financave publike: Çdo organizatë buxhetore do të ketë drejtorin ekzekutiv, financiar dhe zyrtarin certifikues të cilët do të emërohen nga sekretari i përhershëm i Organizatës përkatëse buxhetore. Nëse organizata buxhetore nuk ka sekretar të përhershëm atëherë kjo bëhet nga përfaqësuesi ose drejtori ekzekutiv. Ministria e Shërbimeve Publike që është në kabinetin tuaj e then këtë rregull dhe në vend që me këtë çështje të merret sekretari i përhershëm ose drejtori ekzekutiv në të gjitha fletët certifikuese që i dërgon në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, në vend të sekretarit të përhershëm dhe drejtorit ekzekutiv e ven nënshkrimin e vetë. Ky është një vendim i datës 11.03.2005, a konsideroni se ka vepruar drejtë dhe në përputhje me ligjin dhe në qoftë se konsideroni se nuk ka përfunduar drejt dhe në përputhje me ligjin, atëherë cilat janë masat që ju i keni marrë si kryeministër qofshin ato të vërejtjeve, qofshin masa disiplinore ose edhe kërkesë për të dhënë dorëheqje dhe për të shkuar krejt nga ai sektor dhe ai post që e mban.

Ju deklaruar se Ligji mbi menagjimin e financave publike nuk është thyer asnjëherë, është respektuar në përpikëri dhe unë në këtë do t'ju bind juve, nëse doni të bindeni e jo vetëm në ato që ua shkruajnë dhe ua servojnë përpara. Neni 13.1 thotë: Asnjë organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk do të pranoj para publike përveç nëse autorizohet saktësisht nga ndonjë ligj ose ndonjë rregullore e UNMIK-ut. Çështja që u tha këtu rreth bartjes ose transferit të parave publike dhe përgjegjësia e trefishtë ose në tri nivele, tri institucione u munduat që të na shpjegoni dhe nuk na thatë asgjë dhe kjo i ra sikur njeriu del ta vras njeriun me paramendim, por rastësisht plumbi ik ose vetëm e prek dhe nuk e mbyt dhe ai nuk ka kryer vepër penale dhe nuk duhet të përgjigjet sipas përgjigjes suaj që e dhatë.

Neni 15 i këtij Ligji thotë: Paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike, ndërsa thyerja ekziston në nenin 27 të cilin ju e anashkaluat dhe nuk folët

atëherë kur folët për bartjen e mjeteve. Ministri i Ekonomisë dhe Financave nëse merr një arsyetim të vlefshëm që e harruat një pjesë gjatë leximit tuaj, nga një udhëheqës i një organizate buxhetore mund ta autorizoj transferin e një shume të caktuar nga përvetësim i asaj organizate buxhetore me një përvetësim tjetër të organizatës së njëjtë, ju e harruat këtë të organizatës së njëjtë dhe doli se prej Ministrisë së Shërbimeve Publike mjetet kanë shkuar në Presidencë dhe e arsyetuat me të drejtën e ministrit të Financave nga pjesa e rezervuar që është e dedikuar për raste të parapara dhe të cilën e shpjegoi edhe kryetari i Grupit parlamentar, nuk e arsyeton veprimin e ministrit të Ekonomisë dhe Financave, veprimin të cilin e ka marrë me këtë vendim që është nënshkruar nga drejtori i thesarit dhe nga drejtori i buxhetit me datën 27.04.2005 ku janë të caktuara edhe kodet se prej cilit kod në cilin kod janë bartë dhe kjo ka ndodhur pa autorizimin e Qeverisë. Ju si kryeministër as që keni ditur fare për këtë çështje. Kjo ka ndodhur pa e ditur edhe përfaqësuesi special, alokimet e tilla ose ndryshimet e linjave buxhetore mund të ndodhin vetëm gjatë rishikimit të buxhetit në 6 muaj që bëhet rishikimi i buxhetit dhe ato mund të bëhen në mënyrën se si është miratuar buxheti ose me ndërhyrjen e Petersenit. Ju e ngatërruat edhe përfaqësuesin special këtu, atëherë me siguri që përgjegjësia nuk qenka vetëm e Qeverisë suaj dhe e ministrit të Financave dhe Shërbimeve Publike, por qenka përgjegjësi edhe e Petersenit për të cilin në këtu nuk mund të kërkojmë llogari, por llogari ne mund të kërkojmë prej jush dhe ministrit të Ekonomisë dhe Financave se keni thyer nenin 27 të Ligjit mbi menagjimin e financave publike, ju keni bërë thyerje dhe ju mund të vazhdoni edhe me thyerje të tjera, por nëse dëshironi që të përmirësoni vetveten tuaj dhe Qeverinë tuaj atëherë do të duhej para nesh dhe para opinionit tonë të shihen masat që ju i ndërmerri për këtë çështje.

Nëse është konstatim i juaji se ligji nuk është thyer atëherë është konstatim që të vazhdojmë me agonin që të vazhdojmë në rrugë dhe në binar që nuk dimë se ku do të ndalemi. Shpresoj që edhe ju jeni i vetëdijshëm dhe nuk i besoni as atyre fjalëve që i keni thënë vetë, por do të duhej të ishte në ndërgjegjen tuaj që para Kuvendit i cili ju ka zgjedh këtu të thoni: Se ju jeni i pafuqishëm për të vepruar me këtë kabinet qeveritar, prandaj duhet ndryshime të thella në kabinetin qeveritar. Kështu do të mund ta arsyetoni vetveten tuaj, sepse jam i bindur që ju nuk i keni bërë këto shkelje, por heshtja juaj qon njësoj në faj sikur ata që e shkelin qëllimisht këtë ligj. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Veton Surroi, kurse le të përgatitet Gjergj Dedaj

DEPUTETI VETON SURROI

Të nderuar zonja dhe zotërinj. E kam përkrah edhe Grupi ynë parlamentar e ka përkrah iniciativën e Partisë Demokratike për interpelancë, si dhe e kemi përshëndetë dhe e përshëndesim gatishmërinë e kryeministrit që të jap përgjigje në interpelancë, këtë e konsiderojmë si pjesë të një kulture të re politike të cilën po e ndërtojmë në Kuvendin e Kosovës dhe të një kulture politike e cila duhet të ngrit standardin e vetë antikorraktiv. Standardin e vetë thelbësisht të respektimit dhe të sundimit të ligjit, të sundimit të rregullave dhe procedurave. Në tërësi debati ynë po zhvillohet gjithnjë në nivel të

parimësisë apo po përpiqemi që të jemi sa më parimor dhe siç pamë edhe në përgjigjen e kryeministrit edhe eksenziv edhe pa prekur çështjet për të cilat është shtruar pyetja.

Problemi i krijimit të një standardi të ri moral, një kulture të re politike, me gjithëate se a jemi të gatshëm ne si Kuvend i Kosovës për të ec në atë drejtim, a jemi të gatshëm për të hyp në një shkallë më të lartë në çështjen e kulturës sonë të përgjithshme antikorruptive. Në pikën e mëparshme atë të RTK-së u treguam se mund të shkelim parimësinë, mund t'i shkelim rregullat edhe mund të fusim në kontrabandë një ligj në procedurë parlamentare. Problemi nuk është vetëm i qeverisjes, problemi është se a ka kapacitet Kuvendi që të jetë digë për të penguar gabimet e Qeverisë, por siç pamë në ligjin e RTK-së ishte një kontrabandë e cila ishte pjesë e një kulture orientale, ishte pjesë e allashveresheve mes Qeverisë dhe kryetarit të Kuvendit apo Kryesisë nuk e di, por ishte pjesë e një kulture e cila shkon dikund në fund të shekullit XIX dhe instalohet si pjesë e kulturës e cila përfundimisht e rrënon perandorinë otomane.

Në instalim të një kulture të kontrabandës nuk keni nevojë që të gjeni kontrabandist në rrugë, nuk keni nevojë të gjeni njerëz të korrumpuar në kufij, korrupsioni, mentaliteti i korrupsionit ose fillon ose ndërpritet këtu ku jemi ne, në këtë Kuvend. Lehtësia me të cilën kryeministri i Kosovës shpjegoi pikën e blerjes së makinave apo transferit të parave nga Ministria e Shërbimeve Publike në Presidencë, për mua është indikativ dhe tregon së paku për tri apo katër probleme madhore në shoqërinë tonë në këtë Parlament dhe në këtë Qeveri. Së pari, mund të ketë qen gabim dhe nuk e përjashtoj, por ai gabim duhet të pranohet dhe duhet të thuhet se ka qen i tillë për ndryshe duhet të përsëritet.

Kryeministri thjesht e transmetoi si një akt të lëvizjeve prej xhirollogarive, prej njëres në tjetrën Ministri. Çështja e dytë është pak më serioze, këtu kemi të bëjmë me hetimet gjyqësore që po zhvillohen rreth kësaj çështje dhe kjo çështje mund të penalizoj një pjesë të Qeverisë dhe nëse ndodh kështu do të goditemi ne në tërësi e jo Qeveria, por ne si institucione dhe ky Parlament. Çështja e tretë është se këto para dhe dyshimet e bazuara se një pjesë e tyre janë keqpërdorur pa kurrfarë nevojë e dëmtojnë edhe imazhin e presidentit Rugova dhe kjo ju shkon në dëm institucioneve të Kosovës.

Përfundimisht përgjigja të cilën e morëm në mënyrë ekstensive, ku në çdo të tretën fjali na përshkruhej se sa minoritete janë punësuar në secilën ministri, kishte të bënte më shumë me një pjesë të një kulture mediokritete politike që për fat të keq nuk duhet të jetë e tillë në institucionet tona. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT Daci:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Gjergj Dedaj, kurse le të përgatitet Xhevat Bislimi

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ

Faleminderit shumë z. Kryetar. Z. kryeministër, ministra dhe deputet të nderuar.

Unë kësaj radhe dëshiroj që ta kursej kryeministrin prej shumë vërejtjeve tona, qytetarëve të Kosovës dhe mundem me than të gjithë neve. Kisha me i shkoqit vetëm dy pyetje nëse eventualisht kryeministri kishte me pas kurajo që të përgjigjet. E para, kryeministri aktual i Spanjës ju premtoj elektoratit se nëse votoni për forcën e tij politike do t'i tërheq trupat e tij nga Iraku dhe kjo ndodhi, elektorati votoj e rrëzoi ish kryeministrin Aznar dhe ai i tërhoqi edhe pse mjaft e dhimbshme për aleatin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i

tërhoqi trupat Spanjolle nga Iraku. Pra, forca aktuale në pushtet keni thënë dhe keni premtuar se gjatë vitit 2005 nëse voton elektorati për ju do ta finalizoni çështjen e pavarësisë së Kosovës, do të përfundoj zgjidhja e statusit final të Kosovës dhe pyetja konkrete është se: Deri më 31 dhjetor 2005 nuk do të ndodh kjo çfarë do të bëj kabineti i Qeverisë, a do të jep dorëheqje, a do të shpallen zgjedhjet e reja dhe së paku a do t'i kërkon falje elektoratit parazgjedhor.

Pyetja e dytë, z. Kryeministër shumë shpesh po ju dëgjoj duke thënë se: Për çështjen e statusit final të Kosovës nuk ka negociata me Beogradin, disa herë është përsëritur dhe a është ky vetëm një qëndrim ekuivok i kryeministrit sa për marketing politik, më vjen keq të them për mashtrim të opinionit, kur kryeministri është edhe anëtar i forumit politik të Kosovës, ku ai forum ka marrë detyrat të përgatis negociatat për statusin final politik të Kosovës dhe kryeministri thotë se është i gatshëm të takohet me kryeministrin Koshtunica në çdo kohë, a do të bisedoni aty për sport, karate, pishina, apo takimi i dy kryeministrave, takimi i dy presidentëve, dy shteteve kjo nuk mund të merret ndryshe vetëm si takim politik dhe kamë dëshirë që të sqarohet sinqerisht. z. Kryeministër, a do të ketë negociata për statusin final të Kosovës me Beogradin, kur dihet se Beogradi nuk mund të jetë palë për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, por kjo çështje është një çështje ekskluzive e qytetarëve të Kosovës dhe për çdo hap që duhet ta merrni ju si kryeministër dhe si Qeveri duhet ta merrni bekimin në institucionin që ju ka zgjedh, ju të gjithëve dhe presidentin, poashtu edhe kryeparlamentarin edhe ju si kryeministër e ky është Kuvendi i Kosovës që mendoj se nuk po e trajtoni ashtu siç duhet dhe siç e meriton. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Unë i lus diskutuesit e tjerë t'i përmbahen rendit të ditës, interpelancës për ndryshe do të jam i obliguar a nuk dëshiroj të ndërhyj, fjalën e ka Xhevat Bislimi, kurse le të përgatitet Fehmi Mujota.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI

Faleminderit z. Kryetar. I nderuari z. Kryeministër.

E dëgjuam me vëmendje fjalën tuaj dhe premtimet se ju zotoheni se do ta luftoni korrupsionin, nepotizmin, parregullsitë, keqpërdorimin e ligjit etj. Unë kamë para vetës një vendim të nënshkruar pikërisht nga dora juaj që më bën të dyshoj se ju dhe kabineti juaj qeveritar nuk e keni as vullnetin e as gatishmërinë ta luftoni korrupsionin, nepotizmin dhe shkeljen e ligjit ose shpërdorimin e ligjit. Unë në bazë të këtij vendimi që e kamë para vetes dhe që besoj se të këtillë ka shumë që i prezantuan edhe të tjerët, por sikur të bëhej një komision hetimor me siguri se do të dëshmoreshin shkelje më të rënda se kjo. Unë kamë përshtypjen dhe bindjen time personale se ky kabinet dhe ju vetë si kryeministër nuk mund ta luftoni korrupsionin sepse jeni vetë prodhues i tij, bile prodhuesi më i madh në të gjitha nivelet është kjo qeverisje dhe ky koalicion qeveritar. Ju pasi thirreni në nene, pika, rregullore të UNMIK-ut kemi marrë këtë vendim: Aprovohet marrëveshja këshilluese në vlerë mujore neto 60.800 funta Britanike, shpenzimet tjera sipas marrëveshjes të nenit 2 pika b që nënkupton 18.000 funta të tjera të arritura në mesë të institucioneve të Kosovës (Presidenca dhe Qeveria) në njërën anë dhe të shoqërisë

ALBANI në anën tjetër; është fjala për marrëveshjen në mes të Hazërllokut, Rugovës dhe atëherë kryeministrit paraardhës.

2. Pagesa për 3 muajt e parë do të bëhet sipas radhës nga Presidenca, kryeministria dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (nga Linja buxhetore e mallrave dhe e shërbimeve) një falsifikim plus.

3. Pas tre muajve do të rivlerësohet marrëveshja dhe në qoftë se vazhdon të jetë në fuqi do të paguhet sipas radhës nga të gjitha ministritë tjera të Qeverisë së Kosovës.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me 27.04.05 është bërë pagesa, ose shpërblimi i muajit të parë prej 89.306 €..

Z. Kryeministër drejtësia në Kosovë është zënë me ndjekjen e luftëtarëve të lirisë, prandaj nuk mund të ju ndjek juve dhe kabinetin tuaj, por të paktën nga aspekti moral ju pyes nëse keni bërë gati dorëheqjen dhe kur do ta publikoni. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Fehmi Mujota, kurse le të përgatitet Berat Luzha.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA

Z. kryetar, z. Kryeministër, të nderuar deputet.

Tema për të cilën po bisedojmë sigurisht që është e një rëndësie tepër të madhe dhe do të thoja se pritet me shqetësime në opinionin tonë dhe me siguri që përveç statusit të Kosovës, problemi më i mprehtë në këtë kohë dhe besoj se edhe në kohën e ardhshme do të jetë çështja se si do të qeverisim vendin, sigurisht që nënkupton si do të qeverisim me buxhetin e Kosovës dhe si do të zhvillojmë vendin mbi bazën e fuqisë që kemi në Kosovë dhe me donatorët që do të kemi.

Në këtë foltore po edhe në raste të tjera publike personalisht kamë ngritur shqetësimin jo vetëm timin dhe të PDK-së, por edhe shqetësimin e të gjithë qytetarëve të Kosovës në mos realizimin e projekteve të shumta në komunat e Kosovës. Fatkeqësisht shënimet tona të para ishin që tregonin për një shumë disa miliona që mund të jenë prej 1 deri 10 milion, por të dhënat e fundit që kemi, por edhe besoj se për këto të dhëna mund të flas edhe ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit në qoftë se nuk e ka informuar kryeministrin deri më tash, bëhet fjalë për një shumë të mjeteve rreth 13 milion euro dhe të kemi parasysh për 13 milion euro janë dëmtuar komunat e Kosovës, në tri aspekte. E para, në qoftë se nuk ka pasur mjete në momentin e aprovimit të këtyre projekteve sigurisht është bërë një mashtrim publik për hesape politike. Në qoftë se ka pasur mjete financiare dhe ato tani nuk po shfrytëzohen për realizimin e këtyre projekteve, me të drejtë qytetarët dhe ne këtu pyesim se ku kanë mbetur këto para, në cilin drejtim kanë shkuar ato, duhet të jepet një përgjigje e saktë. E treta, a do të jetë në gjendje Qeveria që në rastin e rishikimit të buxhetit saktësisht të kthej të gjitha këto mjete dhe të realizoj këto projekte në mënyrë që të mos marrin përparësi të tjera, projekte të cilat do të shfrytëzonin ndoshta këtë buxhet, prandaj Qeveria ka për obligim dhe kryeministri mbi bazën e informatave që duhet t'i sjellin ministrat të del me numrin e saktë të projekteve që kanë filluar dhe nuk janë përfunduar, me numrin e saktë të projekteve të cilat nuk kanë perspektiv për t'u realizuar fare dhe me numrin e projekteve të cilat ndoshta i kanë

shfrytëzuar punëkryesit para se të fillojnë ato. Andaj z. Kryeministër ndoshta do të ishte mirë dhe besoj se qytetarët kanë pritur që ju të jepni një porosi të qartë dhe një shpresë se vërtet mjetet e tyre do të kthehen atje ku edhe e kanë pasur destinacionin e tyre. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Berat Luzha, kurse le të përgatitet Nait Hasani

DEPUTETI BERAT LUZHA

Z. kryeministër qysh në dhjetorin e vitit të kaluar me fillimin e punës së Qeverisë së re u shkaktua një skandal rreth humbjes së 176 milion eurove apo shpenzimeve enorme të cilat ende nuk janë justifikuar se vërtet ku kanë shkuar ato mjete. Me shpenzimet e paarsyeshme janë marrë edhe vetë instancat ndërkombëtare financiare. Do të duhej që të kemi si Kuvend një raport të hollësishëm vërtetë se ku shkuan. U fol se janë la borxhet e Qeverisë së mëparshme, atëherë cilat borxhe janë la, në cilën shumë janë la ato borxhe dhe ku shkuan mjetet tjera të cilat kanë qenë të shpenzuara për 20 ditë të fillimit të Qeverisë së re.

Në vitin e kaluar Kuvendi i Kosovës e ka nxjerrë ligjin për lojërat e fatit i cili do të duhej të ishte i obliguar për Qeverinë që të zbatohej me përpikëri, por përkundrazi Qeveria e ka pezulluar ligjin në fjalë. Unë nuk e di se me çfarë kompetencash Qeveria apo kryeministri mund ta pezullon një ligj të nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës dhe të licencoj kompani të lojërave të fatit siç është Suis Loto dhe t'i anuloj kompanitë tjera të cilat kanë funksionuar deri në atë moment. Këtu nuk do mend se flitet për korrupsion dhe kryeministri do të duhej ta dinte se vërtetë kush e ka lejuar dhe ku kanë shkuar ato mjete. Me fillimin e punës së Qeverisë së re dhe kabinetit të ri kemi pasur fenomenin e rimobilimit të zyrave të hapësirave të Qeverisë dhe të ministrive, në një mënyrë është folur se është bërë edhe dezinfektimi i hapësirave nëpër ministri të ndryshme. Do të duhej të dihej vërtetë se sa kanë kushtuar ato mobile të reja edhe pse të vjetrat kanë qenë vetëm 2 vjet të vjetra dhe jo më shumë dhe pse u bënë ato harxhime të kota dhe ku shkuan pastaj mobilet e vjetra, kush i morri ato dhe a u tenderuan apo jo. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Nait Hasani, kurse le të përgaditet Haredin Kuçi.

DEPUTETI NAIT HASANI

I nderuar kryetar, i nderuari kryeministër me kabinetin, të nderuar deputet. Unë kam dy pyetje për kryeministrin. Pyetja e parë është: A ka fuqi kryeministri nëse ndonjë ministër ka bërë keqpërdorime të shkarkoj atë ministër nga detyra e kryeministrit. E dyta, jemi të njohur me rrethanat që janë krijuar në Universitetin e Prishtinës dhe unë e kam një arsye se gjendja në Universitetin e Prishtinës po shqetëson me të drejtë, jo vetëm studentët dhe profesorët e këtij Universiteti, por edhe opinionin e gjerë.

Konflikti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës me Universitetin e Prishtinës po vazhdon edhe pas vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës e cila e refuzoi akuzën për parregullsi në proceset zgjedhore në UP. Po ju përkujtoj z. Kryeministër se Opinioni i Kosovës më parë kishte dëgjuar premtimin publik të ish kryeministrit të z. Haradinaj dhe të ministrit aktual z. Veliu, se është i bindur se çfarëdo vendimi që sjell Gjykata Supreme do t'i japin fund konfliktit me UP-në. Mosbërjes së një vendimi meritore të Gjykatës, për Qeverinë e Kosovës është një sinjal i keq te qytetarët e Kosovës për përpjekjet e shtetit ligjor dhe seriozisht zbehen shpresat e qytetarëve të Kosovës në arritjen e këtij standardi. I nderuari z. Kryeministër. Arsimi i Lartë sipas kreut 5 të Komizës Kushtetuese paraqet një përgjegjësi të transferuar te institucionet vendore të cilat janë përgjegjëse për administrimin e të gjitha problemeve të arsimit. Duke mos qenë në gjendje të zgjidhni problemet në UP me një dialog akademik të drejtpërdrejtë të cilin disa herë e ka kërkuar Universiteti nga Qeveria e Kosovës që kanë demonstruar një akt të papërgjegjshëm, qyqar duke kërkuar involvimin e PSSP-së dhe UNMIK-ut në zgjidhjen e problemeve të cilat janë krijuar.

Z. kryeministër, ky akt nënkupton paaftësinë e Qeverisë dhe të MASHT-it për të ushtruar përgjegjësinë kushtetuese në kohën kur ju kërkonin bartjen e përgjegjësive të reja. A mendoni se për këtë çështje të kërkonin dorëheqjen e ministrit të MASHT-it dhe përgjegjësinë e tij. Ju si kryeministër për moszgjidhjen e konfliktit në Universitet dhe involvimin e PSSP-së në kohën kur Kosova po sfidon me probleme serioze politike, decentralizimin enklavizimin e Kosovës, korrupsionin, krimin e organizuar etj. A mos rastësisht kriza e krijuar në UP u përdor si alibi për shmangien e vëmendjes së opinionit vendor dhe ndërkombëtar nga problemet e rënda politike me të cilat po përballet Kosova dhe po tentohet shkatërrimi i UP-së me motive politike sikur më parë që është politizuar në ekstrem. Arsimi fillor dhe i mesëm, si dhe institucionet e tjera kulturore dhe shkencore.

I nderuari kryeministër. Universiteti i Prishtinës po përballet me sfida serioze në procesin e reformimit të tij, mendoj se Qeveria e Kosovës duhet të mbështes UP-në si Universitet publik që ka një të kaluar të lavdishme dhe që aktualisht duhet të reformohet. Studentët dhe profesorët e UP-së duhet të jenë ata që vendosin për UP-në, nuk duhet të lejoni trajtimin e UP-së si një organizatë joqeveritare ose si poligon për realizimin e interesave të ngushta të kujdoqoftë. I gjithë kabinetit qeveritarë kanë qenë student në këtë Universitet që i kanë kryer studimet dhe janë përgatitur. Për këtë qëllim ju lutem të na informoni për qëndrimin tuaj dhe të Qeverisë që ju drejtoni rreth mënyrës së tejkalimit të gjendjes, për të mënjeluar ndërhyrjet e njëanshme dhe të dhunshme të cilat mund të kenë pasoja të rënda jo vetëm për UP-në por edhe për tërë Kosovën. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI:

Hvala koelea Hasani, reč ima prof. Hajredin Kuçi, a neka se pripremi poslanik Bajrush Džemajli.

DEPUTETI HAJREDIN KUQI

Faleminderit z. Kryesues, i nderuari kryeministër, deputet, zonja dhe zotërinj.

Unë do t'i ngris 4 çështje këtu. Në radhë të parë do t'i ngris si deputet i Partisë Demokratike të Kosovës, por një perceptim i tillë do të jetë edhe si qytetar i Kosovës. Do të shtroj edhe komete të shkurtëra por në formë të pyetjes.

Dihet se Qeveria aktuale e Kosovës që në fillim është shquar se e ka mungesën e profesionalizmit në drejtimin e saj, natyrisht që aty ishte perceptimi me ndonjë përjashtim se kemi pasur emërime politike dhe këto deri diku janë të arsyeshme ndoshta edhe nga vetë fakti që koalicioni ishte i tillë, por çka ka marrë Qeveria juaj që ta plotësoj këtë mungesë të profesionalizmit në udhëheqje politike duke dhënë një ngjyrë më shumë me njerëzit përgjegjës apo kompetent për profesione të caktuara.

Çështja e dytë, krijohet përshtypja për Qeverinë tuaj z. Kryeministër se i mungon strategjia e zhvillimit, në radhë të parë mendoj se i mungon strategjia për statusin politik të Kosovës dhe strategjia për zhvillimin e ekonomisë. Këto mendoj se janë disa arsye. Por, do të përmendja edhe atë se sa i përket statusit ju jeni në një koalicion ku një pjesë e juaja e koalicionit ka proklamuar se kërkon vetëm njohjen e pavarësisë së Kosovës, ndërsa kohë më parë ju keni kërkuar shpalljen e pavarësisë së Kosovës në Kuvendin e Kosovës, besoj se i keni harmonizuar këto qëndrime dhe është mirë që qytetarët e Kosovës ta kenë të qartë këtë, po ashtu edhe strategjinë për zhvillimin ekonomik. Strategjia është e mirë mendoj për tërë Qeverinë, për qytetarët e Kosovës dhe të mos krijohet përshtypja se kjo Qeveri kryen vetëm detyrat që ia ofron UNMIK-u, si detyra të shtëpisë, por më shumë një strategji e cila len gjurmë për qytetarët, por besoj se edhe për ju personalisht, dihet se një kohë të gjatë keni ndjekur një koncept politik në mënyrë konsistente.

Natyrisht se ndoshta ai koncept është bashkëdyzuar me ndonjë koncept tjetër ose është vetmuar, por mbi të gjitha besoj se ka mbetur diçka nga ai koncept që mund të vazhdohet tash e tutje.

Çështja e tretë që do ta përmendja është perceptimi im personal, por besoj se edhe i qytetarëve të Kosovës për këtë Qeveri, apo për vendimet e kësaj Qeverie vendoset jashtë Qeverisë. Kur e them këtë e them me përgjegjësi në dy rrafshë. E para, mendoj se vendoset për njerëz, kur e them jashtë Qeverisë, në struktura të ngushta partiake dhe strukturat e tjera dhe në anën tjetër fitohet përshtypja që ka edhe grupe joformale që vendosin për këtë. Do ta bëj një digresion pak sa në shaka por dihet se në Kosovë ekziston një kabinet alternativ i qeverisjes së mirë për ju, por duket që ekziston edhe një tjetër që ne nuk e dimë dhe krejt në fund do ta përmendja edhe një detyrë që besoj se ju duhet të merrni hapa më shumë dhe besoj se keni ndërmarrë diçka. Prezantimi i Kosovës në marrëdhënie me jashtë. Këtë e them për dy arsye, sepse vetëdijësimi nacional tani më ka mbaruar në Kosovë dhe nuk ka nevojë që t'i bindim qytetarët e Kosovës për pavarësinë e Kosovës. Dhe e dyta, ka nevojë të marrim aktivitete të shtuara në marrëdhënie me jashtë, sidomos me qendrat e ndryshme të vendosjes. Ju ishit vetë dëshmitarë dhe protagonist i vizitës suaj në Gjermani e cila u përfol në forma të ndryshme për përkrahjen e pavarësisë së Kosovës, por si do që të jetë, kërkoj nga ju se çka keni ndërmarrë që prezantimi i vullnetit politik por edhe i sferave tjera ekonomike apo tjera të Kosovës, të bëhet sidomos në qendrat e vendosje në botë, siç është Brukseli Uashingtoni apo vendet tjera që janë me rëndësi për diasporën tonë. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI :

Hvala vam profesore Kuçi, mikrofon je vaš g. Bajruš Džemajli, a neka se priprema Ylber Hysa.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI

Z. kryesues, përshëndetje për z. Kryeministër, ministra dhe ju deputet.

Z. kryeministër unë jam lajmëruar pas ekspozesë tuaj, apo fjalës suaj dhe vetë mënyra se si i keni thënë gjërat dhe çka keni thënë më ka bërë që të diskutoj.

Ju z. Kryeministër në fjalën tuaj u munduat që të na bindni se jeni duke e zbatuar ligjin dhe duke e mbrojtur atë, por nuk jeni bindës para fakteve të cilat ju demantojnë çdo ditë, por mendoj se ishin të bollshme edhe këto në Kuvend. Ju faktikisht jeni edhe vetë shkelës i ligjit e lëre më të ndalni tjerët, të bëni një gjë të tillë. Ju si kryeministër jeni edhe kryesues i një komiteti tepër të rëndësishëm, atë për emërime të larta publike. Ju e dini se ky Komitet luan një rol të veçantë në shërbimin civil të zyrtarëve të lartë profesional dhe është një nga komponentët kyç në standardin aq shumë të thënë, funksionimi demokratik i institucioneve dhe ju në vend se të ushtroni ndikimin tuja që të menjahohen padrejtësitë e shumta në Qeverinë tuaj përmes këtij komiteti, ju e komplikoni edhe më shumë atë, duke toleruar shkarkimet të paligjshme, emërime të paligjshme, duke i dhënë krah nepotizmit me përnasa të rrezikshme etj, etj. Për natyrën tuaj të shkeljeve në marrjen e vendimeve kam veçuar një letër të z. Soren Jesen Petersen, të 11 prillit 2005 ku thotë se: Unë jam i shqetësuar që për momentin KEL nuk po përmbush mandatin dhe obligimet e tij dhe më pas vazhdon. Me shkeljet duke i konkretizuar ato, për të mos ju lodhur po veçoj një pasus.

Në sesionin e tij të datës 30 mars 2005 KEL-ti ka marrë një vendim për të shkarkuar z. Bahri Hysenin sekretar permanent në Shërbimet Publike. Ky vendim është përcjellur me disa lëshime të përmbledhura në shenime, i është bashkangjitur edhe ajo që të thirrmi një takim të ri të KEL-it të pashtyshëm për të shqyrtuar rastin e Bahri Hysenit në përputhje të plotë me rregulloret Relevante të UNMIK-ut dhe me instrumentet dhe rregullat plotësuese të procedurave. Unë dua të vë në pah se sekretari permanent z. Bahri Hyseni pa dyshim që edhe është vlerësuar nga faktorët relevant, ka qen njëri ndër më të sukseshmit prej sekretarëve permanent, ai e ka vetëm një gabim se nuk është në kualicionin qeverisës, kjo ishte e meta e tij dhe thjesht është diferencuar për këtë, në fakt procedura vazhdon dhe i shqetësuar z. Petersen në vend se të shqetësoheni ju. Z. Kryeministër KEL-t nëse dëshmohet i paafte që para fundit të prillit të zgjidhen këto çështje, unë do të jem i shtrenguar të ushtroj autoritetin tim që të qoj në vend dhe të rregulloj këtë të metë duke marrë një vendim.

Kjo do të thotë se ju keni shkelur ligjin për shërbim civil. Nga ajo që thatë ju se nuk keni shkelur ligjin, kjo do të thotë se nuk jeni engjull siç paraqiteshit ju dhe kabineti qeveritar nga ato që dëgjuam, nuk jeni engjull i zbatimit të ligjit, por duhet tjetërkush t'ju shtyj dhe t'ju bëj presion aq sa të qoni çështjet në vend. Për t'i evituar padrejtësitë e bëra, në fakt ju tjetër gjë veproni e tjetër gjë na keni thënë këtu, ju nuk bën të jeni kaq disonant në fjalët e juaja. E keqja më e madhe qëndron se ju jo vetëm në mbrojtjen e ligjit por edhe në planin politik po mundoheni të na qitni hi syve. Mendoj se vizita juaj në Gjermani tregonë shumë në këtë drejtim.

Unë po e vlerësoj si paraqitje të juajën në kuptim pak më të përgjithshëm. E kisha marrë fjalën e juaj si tragjiko-komike, ju lavdëroni Qeverinë në mënyrë shumë naive, kurse tragjikja se nuk ndiheni aspak i shqetësuar, nuk jeni i shqetësuar as për vjedhjet as për korrupsionin e as për keqëpërdorimet e shumta. Unë jam i shqetësuar se kah po shkon kjo Qeveri, natyrisht madje në një formë jam i shqetësuar edhe për ju në veçanti, për fatin se kabineti qeverisës nuk është duke e parë se korrupsioni është duke kaluar kufijtë e Kosovës dhe po lidhet me analet ndërkombëtare. Për këtë internacionalizim të korrupsionit tregon fakti se ofertuesi i parë në tenderin për Feronikelin, "Adenikelin" nuk ka pasur mirëkuptim që partisë suaj AAK-së z. Dugolli dhe ju t'ju jap nga 1 milion euro dhe ju e keni ndërruar me ofertuesin e dytë "Alferon". Jam në ngjarje dhe nuk i kamë krejt faktet relevante se si janë ofruar, ndoshta i ka "Adenikeli", por unë dua të dal dikund tjetër.

Kush është "Alferoni". Dokumentet tregojnë se kupola e "Alferonit" është Ruso Kazakistani, e kanë mbështjellë mirë, se ata janë mjeshtër të këtyre gjërave me një përfaqësi në Londër, por janë Ruso-Kazakistan, atyre të cilëve ju dhe Qeveria juaj ju ka bërë presion të veçantë sidomos z. Dugolli me AKM-në me një letër të tij që është tepër e qartë se duhet dhënë ofertuesit të dytë. A ju ka dhanë ai juve ata miliona apo jo spo hyj andej. Një dua të them se "Alferoni" përballet me gjyqet ndërkombëtare për dhënie të mitos, pra për korrupsion, kurse ne këtu mund të lavdërohemi nëse është lavd që ne po lidhemi me ata të cilët përballen me gjyqe të ndryshme, pikërisht për këto çështje për të cilat ne po flasim. Unë kisha apeluar që të mos jeni disenant nga ato që flisni dhe ato që bëhen sepse e vërteta del në sheh shumë shpejt. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI:

Hvala poslaniku Gjemajliu, reč ima Ylber Hysa, a neka se pripremi Sala Beriša –Šala

DEPUTETI YLBER HYSA

Unë nuk do ta zgjas shumë për faktin se jam shumë i dekurajuar të marrë pjesë në debate të tilla, marrë parasysh debatet tona ekstenzive që i kemi bërë për çështje shumë madhore, ku së paku ne si grup Ora kemi konsideruar që mund të gjejmë një gjuhë të përbashkët siç ka qenë decentralizimi, ekonomia, siguria dhe ato i kemi përfunduar duke folur kështu dhe duke mos arritur asgjë dhe me frikën se mund ta përsërisim këtë gjë dua të shtoj brengën time publikisht para kryeministrit, duke i thënë, se kjo çështje në fakt nuk është vetëm një inat në mes Qeverisë dhe opozitës, pse është kështu mund ta dëshmoj edhe me këtë letër. Është letra të cilën kontakt grupi ia ka dërguar kryeministrit të cilën ai e mban në konfidencë dhe nuk e bën publike, është e nënshkruar nga drejtori politik Xhon Saves në emër të Grupit të kontaktit dhe e cila fillon në mënyrë të qartë me një dëshprim të shprehur dhe me trendin në rënje të progresit që nuk po arrin kjo Qeveri dhe përfundon me shpresën që Qeveria do t'i dyfishoj masat e saja, në mënyrë që në këtë kohë të shkurtër para rishqyrtimit të standardeve dhe hapjes së mundshme të bisedave për statusin final, të bëjë diçka në mënyrë që të na ndihmoj të gjithëve, por edhe t'i ndihmoj vetvetes. Në këtë aspekt un dua ta ftoj kryeministrin konform rregullës 25 pikës 9 e cila thotë se: Interpelanca të këtilla duhet të përfundojnë disi dhe siç u tha këtu kjo është me rëndësi jo vetëm për kulturën politike, e ftoj se nëse ndihet kaq i sigurt dhe këtu jemi

dëshmitar që ka një diskrepancë të madhe në mes atyre që kanë ngritur këtë interpelancë dhe kryeministrit dhe kabinetit të tij që ndihet kaq i sigurt në paraqitjen e tij ekstenzive, atëherë nëse nuk e ka bërë një gjë të tillë kur kemi debatuar për çështje si decentralizimi, siguria, ekonomia, atëherë le të urdhëroj që ta bëjmë një komision qoftë mikst, qoftë të pavarur për të cilin do të pajtohemi dhe ta bëj një lloj auditimi për të gjitha ato që kryeministri pretendon se ka argumente dhe nuk frikësohet. Unë konsideroj se ky është një lloj testi për të tejkaluar probleme kaq të rëndësishme, sidomos pasi që po hyjmë në një fazë kaq të rëndësishme, jo vetëm për kryeministrin dhe për mua, por edhe për Kosovën, në mënyrë që të tejkalojmë një hendek i cili po ndërtohet në Parlament. Për ndryshe ky hendek do të na bind që këtu nuk është vendi për t'u zgjedhur problemet, por këtu është vendi vetëm për të mbajtur fjalime dhe punët do të shkojnë ashtu siç do të shkojnë, ju ftoj që ta merrni seriozisht këtë propozim, për ndryshe besoj se ne vazhdimisht do të bindemi që këtu nuk zgjidhen problemet.

KRYESUESI XHEZAIR MURATI :

Hvala poslaniku Ylberu Hysaj, reč ima Sala Beriša-Šala, a neka se pripremi poslanik Hydajet Hyseni.

DEPUTETJA SALA BERISHA-SHALA

I nderuari z. Kryeministër.

Ju në diskutimin tuaj më herët brenda 3 – 4 minutave e përmendët më shumë se 15 herë shprehjen korrupsion. Do të kisha dashur që të mos jetë dhe të jetë sipas thënies së popullit se ku të dhemb dhëmbi të shkon gjuha. Nuk do të mirrem shumë me këtë virus kancerogjen për Qeverinë, por dua t'ju përkujtoj z. Kryeministër se mangësia dhe dobësitë e programit qeverisës, ku asnjë rresht nuk i është kushtuar minierave dhe mineraleve po përcillen edhe tani në përmasa të mëdha. Qasja e gabuar e Qeverisë në këtë fushë po shihet çdo ditë. Kur punohet pa ndonjë strategji s'ka se si të mos gabohet, kështu që në mungesë të kësaj strategjie dhe në këtë vakum të infrastrukturës ligjore për miniera dhe minerale, Qeveria ngutet të privatizoj pasuritë me vlerë kombëtare dhe atë eksperimentimin e fillon pikërisht në Feronikel në Drenas. Jemi dëshmitar të shpërthimit të revoltave në atë pjesë të Kosovës, e si pasojë e kësaj që u tha është edhe qasja e gabuar nga ana e Qeverisë dhe qeveritarëve ndaj kësaj pjese dhe ndaj këtyre qytetarëve.

Rasti i Feronikelit u aktualizua në përmasa të padëshirueshme, sidomos për qytetarët e Drenicës, përgjegjëse për shkallëzim të situatës është vetë Qeveria me qasjen e saj tepër të dyshimt në raport me atë pjesë të Kosovës. Për 6 vite ajo ishte zona më e qetë sa i përket sigurisë, ky fakt për dikë ishte jo i favorshëm. Qytetarët e Drenicës nuk kanë pritur se dikush tani do të ketë një qasje të tillë siç e pat pushtuesi me shekuj e sidomos ndaj kësaj pjese të Kosovës që sprovuj lloj-lloj projektesh e elaborate për ta ndëshkuar vetëm ekonomiksht. Askund në bot nuk ndodh të mbetet në një prapambeturi të këtillë ekonomike, qendra e një vendi siç është rasti me Drencisën. Vëni re në aspektin gjeografik, Drenica është qendra e Kosovës, në aspektin kombëtar, tradicionalisht ka qenë forcë shtytëse për çlirim, në aspektin e zhvillimit ekonomik është pjesa më e varfër në

Kosovë, pjesa më e harruar, pjesa më e lënë pas dore. Të nderuar deputet, i nderuari z. kryeministër dikush po mundohet t'i praqes revoltat si manipulim politik më tepër për t'i fshehur gjurmët e veta të krimit ekonomik dhe politik, pas këtij kualifikimi me plotë përgjegjësi ju them se gaboheni në vlersime të tilla, mos nxitoni t'i thyni ata njerëz me vlersime të këtij lloji, na përkujtoni fjalorin e politikanëve të një kohe famkeqe tani të perënduar. Analizoni ju se çfarë keni bërë si qeveritar për pjesën më të shkatërruar nga lufta e fundit, mos vazhdoni ta injoroni edhe ju tani, në të cilën gjë nuk dua të besoj, apo ndoshta ju të nderuar qeveritar dhe ju z. kryeministër, më tepër i përgjigjet fakti se për pozitat tuaja i keni dikujt borxh e këtë borxh e gjetët ta paguani në kurriz të qytetarëve të Drenicës. Kini parasysh 3 milion euro që është kërkuar me ofertuesit e parë me rastin e Feronikelit. Ne të gjithë i kemi dikujt borxh, borxh i kemi para së gjithash gjakut të dëshmorëve dhe amanetit të tyre. Si t'ju besojnë juve këta qytetar se nuk është ndonjë hile edhe në privatizimin e Feronikelit, ku asnjë projekt i rëndësisë jetike për atë zonë nuk është realizuar. Sa për ilustrim po marr disa shembuj e që janë të njohur edhe për opinionin e gjërë dhe ju pyes juve z. Kryeministër: Pse u ndërpre projekti i rrugës Skenderaj Vushtri që lidh 19 fshatra të Drenicës dhe ku janë mjetet e ndara për te. Pse u ndërpre projekti i rrugës Skenderaj Turiqevc dhe ku janë mjetet e ndara për te. Pse u ndërpre projekti i rrugës Bushat Caralevë që lidh fshatrat e tri komunave Drenas, Lipjan Shtime dhe ku janë mjetet e ndara për të dhe më skandalozja, pse bëni lojëra me privatizimin e Feronikelit. Pse Qeveria juaj këmbëngul ta shpall fituese një kompani prej 16 milion euro më të lirë, qoftë duke shkelur edhe rregulloret e privatizimit, pse tentohet t'i ipet një kompanie të dyshuar ku pjesëmarrësit e sajë kanë afëra ndërkombëtare për keqëpërdorim, kujt i intereson shihni në Veb faqen në internet të BBS-së periudha 2000-2001 dhe besoj se nuk ju duhet argument më i madh. Duke mos gjetur përgjigje për këto pyetje atëherë çka bëri Qeveria të cilën e drejtoni ju për këtë rajon përveç politikave ndëshkuese ekonomike të formave të ndryshme, por edhe gjatë ndarjes së buxhetit të financave publike duke mos marrë parasysh kriteret siç janë: Numri i popullsisë, zhvillimin ekonomik, shkatërrimin nga lufta etj. A jeni ju në dijeni për të gjitha këto dhe a janë bërë të gjitha këto shkelje edhe me betimin tuaj dhe krejt në fund ua përkujtoj z. Kryeministër se munda, sakrificat dhe vetëflijimi i Drenicës ua krijoj mundësinë të jeni edhe vetë në ato poste, andaj vazhdimi i ndëshkimit të Drenicës me prapambeturi ekonomike është më shumë se absurd. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Hydajet Hyseni, kurse le të përgatitet prof. Alush Gashi.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI

I nderuar kryetar, të nderuar deputet, të nderuar ministra, i nderuar kryeministër Kosumi. Për mua më shumë i nderuar si Bajram Kosumi siç e kam njohur se sa si kryeministër siç paraqitet sot këtu, dhe e them këtë jo rastësisht sepse besoj dhe dua të besoj dhe kur besoj dhe dua të besoj dua edhe të mos gabohem se ajo që përfaqëson Bajram Kosumi të cilin e njoh unë dhe brezi i tij nuk mund dhe nuk do të duhej të lejonte të bjer në bataqe që e dëmtojnë shumë Kosovën. Unë besoj dhe megjithatë pres që kjo të dëshmohet, po

kjo nuk mund të mos ma kujtoj një anekdotë që e keni dëgjuar kur thotë: Fliste një idealist me një matrapaz, natyrisht pas luftës dhe ky matrapazi po i thoshte çka doni tash, ju keni dashur lirinë tuaj, gzojeni, shijojeni lirinë, ngopuni liri, por ne kemi dashur diçka tjetër, ne kemi dashur para, ne kemi dashur fitime, prandaj na lironi ne që të përmbushim dëshirat tona.

Druaj z. Kryeministër se kjo po i ndodh Kosovës dhe atyre që e kanë sjellur Kosovën në këtë situatë dhe po i ndodh keq se kjo lukunia, babzia e sojit të profiterëve, matrapazëve nuk di të ngopur. Ato jo vetëm që marrin në mënyrë të paligjshme pemë në trupin e pemës së lirisë, por janë në gjendje edhe ta sakatojnë, t'i presin degët vetëm që t'i marrin pakë fruta për vete. E thonë se Kombi lind në stolicizëm por vdes në pikurizëm. Nuk është ky vetëm shqetësim i yni dhe i qytetarëve të Kosovës, por është shqetësim edhe i miqve tanë. Unë këto ditë kam dëgjuar një pyetje nga një mik që smë le të qetë, thoshte afërsisht kështu: A e mendoni rrezikun, përveç tjerash a e mendojnë edhe liderët tuaj rrezikun që pas ndonjë viti të shkruhet një libër me titullin: Si rrezikohet ose si humbet pavarësia gati e fituar, shembulli i Kosovës. Zonja dhe zotërinj, ajo që flitet sot në këtë sall, por ajo që flitet gjerësisht çdokund në Kosovë për fenomenet negative që kanë marrë përmasa të gjëra dhe të pandalshme, është kërcënim për të ardhmen tonë dhe kujt i takon më përpara se atyre që kanë sakrifikuar rini që të dalin të parët dhe t'i thonë ndal, prandaj pyetja ime dhe vërejtja ime e parë miku im Bajram Kosumi është: Pse tolerohen fenomene të tilla, nuk ka qen në natyrën e njerëzve si ti e të tjerët të bashkëjetojnë me abuzime të mëdha ku luhet me tenderë e milion, madje edhe me para të ndara për fatzinjtë si janë ata që janë dëmtuar nga tërmeti etj, ku luhet edhe me mushkrittë e Prishtinës e të Kosovës sepse gjithandej ndodhin fenomene të tilla dhe nuk dua të ndalem në to sepse ka shumë dhe ka çka flitet mjaft dhe u thanë mjaft.

Mos të harrojmë se çfarë e kemi gjendjen në popullin tonë, njerëzit tanë nuk kanë as buk për të ngrënë, kurse ne po i kalojmë me një letësi tmerruese lojrat me miliona e miliona. Mua më kanë brengosur edhe dy çështje në praktikën e deritashme e sidomos të kësaj Qeverie. Një përpjekje për ta bartur në mënyrë shumë të lehtë përgjegjësinë te Gjykata, për çkado që thuhet përgjigja del, drejtohuni gjykatave e dini fort mirë të gjithë se sa kanë mundësi gjykatat tona të bëjnë. Pajtohem zotëri, ka një rrugë që të qon në gjykata, por kjo nuk na amneston neve si institucion që ne të bëjmë punën tonë, përveç përgjegjësisë penale ka edhe një lloj tjetër të përgjegjësisë, përgjegjësia politike, përgjegjësia institucionale dhe ajo që kërkojmë ne këtu është pikërisht kjo e fundit, përgjegjësia politike dhe përgjegjësia institucionale. Nëse diçka është ashiqare shkelje dhe unë jam i bindur se edhe t'i si kryeministër, por edhe të tjerët e dini se është shkelje, pse nuk e merrni forcën e të thoni se është shkelje dhe unë nuk pajtohem me ate, e di që kjo sjell telashe, por për ate që i duhet Kosovës duhet të sakrifikojmë diçka, nuk po e shof në qoftë edhe në një segmentë këtë shpirt që e ka karakterizuar sidomos rininë e Kosovës, sepse unë ende të konsideroj të ri.

Dhe e dyta që flitet me të madhe që keqpërdoret është të mos i heqim petën lakrorit edhe kur ka fakte dhe argumente të dukshme, se ka shkelje sepse po e dëmtojmë imazhin e Kosovës, po e dëmtojnë interesin e Kosovës, shkruhen në gazeta artikuj, kryeartikuj dhe bëhet një demagogji që vërtetë është trulllosësh. Jo zotëri ne duhet ta sqarojmë qartë nëse ka fenomene negative dhe nëse ato dëmtojnë pikërisht imazhin e Kosovës, dëmtojnë të ardhmen e Kosovës pikërisht për shkak të imazhit të Kosovës, ne duhet t'u shpallim luftë atyre dhe t'i shpallim luftë pa kompromis me zero tolerancë dhe këtu duhet të jipet

shembulli se si bëhet ajo luftë. Nëse nuk e bëjmë në institucione ka për të dalë në rrugë dhe ju e dini se çka do të thotë kur të dilet në rrugë, prandaj mjaft më me atë demagogji. Nuk e dëmtojm imazhin e Kosovës nëse ne dëshmojmë se nuk jemi shoqëri perfekte, asnjëher nuk kemi thënë, çdokund ka fenomene, por ajo që duhet të na karakterizoj ne si shoqëri e re me një lëvizje shtetëformuese është vendosmëria e patundur për të luftuar çdo fenomen negativ, po ndërtojmë themelet e së ardhmes, duhet ta zgjedhim edhe farën e grurit kokërr për kokërr.

Për të mos e zgjatur dhe për të mos hyrë në replika me ata që qesin fjalë anash. Zonja dhe zotërinj deputet z. Kryeministër, thonë nuk del tym po nuk pati zjarr, ka hyrë e keqja në institucionet tona, ka hyrë e keqja edhe në këtë Kuvend dhe këtë nuk do të duhej ta lejonim, prandaj flesa ime do të ishte, në vend të apologjisë së së keqes le të shkundemi dhe t'i themi ndal atyre që duan për shkak të do përfitimeve të vogla po edhe të mëdha si thoni ju dhe keni të drejtë, por vetanake, grupe dhe janë në gjendje ta prejnë pemën e lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës, nuk e kemi këtë të drejtë ta lejojmë këtë çështje, na takon neve që guximshëm t'i themi jo. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka prof. Alush Gashi, kurse le të përgatitet Naser Osmani.

DEPUTETI ALUSH GASHI

I nderuari z. Kryetar. Ne kemi ardhur për të debatuar në bazë të kërkesës 02/527 të 27 qershorit 2005 që e ka bërë për interpelancë Grupi parlamentar i PDK-së dhe si dëgjuam sot e mbështetur edhe nga Ora. Në këtë kërkesë janë bërë 5 pyetje dhe në ato 5 pyetje kryeministri e dha përgjigjen në mënyrën e vetë dhe unë e kisha lutur që përgjigjet e kryeministrit dhe së bashku me pyetjet të PDK-së të na vijin si dokument zyrtar. Pas atyre përgjigjeve këtu duket që debati është duke u zhvilluar sikur të ishte debat për raportin e tërsishëm të Qeverisë jo interpelancë në këto pyetje. Grupi parlamentar i LDK-së ju lut që ta fokusoni debatin në bazë të kërkesës që e ka bërë Grupi parlamentar i PDK-së në këto 5 pyetje dhe ne kërkojmë nga Qeveria që të punoj zellshëm dhe me një transparencë. Kur ta përgatis raportin 6 mujor për të cilin kur të vijë koha ne do të debatojmë, nuk do të ishte mirë që gjatë debatit, që ky debat të ketë lidhje me interpelancë, që të jetë debat ku neve individët të na tregojnë letrat në formë të dokumenteve pa pasur mundësi që ne të gjithë t'i shohim sa janë autentike ato dokumente, prandaj ne e respektojmë kërkesën në bazë të Rregullores që është rregulla 25 për këtë interpelancë dhe insistojmë që të respektohet. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit edhe pak durim, fjalën e ka Naser Osmani, kurse le të përgatitet Sokol Bashota.

DEPUTETI NASER OSMANI

Faleminderit z. Kryetar. I nderuari kryeministër.

Kemi thjesht krizë morale, po e sulmojmë Qeverinë për shkak të tekeve personale që i kemi bërë dhe kemi bërë programe të pakjarta. Po ja veshim Kosovës korrupsionin dhe të gjitha të këqijat për arsye se nuk jemi vetë në qeverisje dhe thënia: Pas meje gur mbi gur të mos mbetet. Nuk jemi mjaft të ndërgjegjshëm, po përmendet gjithçka, duhet të them vetëm dy fakte. Jam munduar që të marrë shënime lidhur me at se a i kryejmë ne obligimet tona elementare. Në Amcrikë vlen një rregull, dy gjëra janë të sigurta, një që ke me vdek dhe që je i obliguar me pagu tatimin. Unë kam marrë në Komunën e Prishtinës të dhëna për kryerjen e obligimeve tatimore për z. Jakup Krasniqin. Nuk kanë mund të ma japin të saktë për shkak të adresës jo të saktë dhe mi kanë nxjerrur 10 Jakup Krasniqa, por asnjëri prej 10 nuk e ka paguar tatimin në pronë, ishalla ti je i 11, po ashtu me respekt që e respektoj shumë Veton Surroin, pronarin e Kohagrup që me të vërtetë është një biznesmen i mirë. Mirëpo, që 5 vite prej vitit 2000 deri në vitin 2005 ky ka punuar pa asnjë fitim. Kohagrup fitimin e ka 0.01%, qarkullimin vjetor e ka 1.700.000, mos të folim edhe për importet që ka bërë në vlerë prej 2.700.000 dhe kjo thjesht është një mshefje e tatimit në fitim. Krejt këtë po e them me qëllim që kemi kriza morale ne vetë, deri sa ne vetë nuk i kryejmë obligimet tona mos t'i gjuajmë gurë Qeverisë se Qeveria nuk ka pasur mundësi ende me ba asnjë tender të madh, të gjithë tenderët që janë bërë janë bërë në kohën e Qeverisë së mëhershme, në kohën e Ministrisë së Shërbimeve Publike, në kohën e Marian Polaskës dhe në kohën e firmës "Çlirimi".

KRYETARI I KUENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Sokol Bashota, kurse le të përgatitet Ragip Zekolli dhe i fundit Nazim Jashari.

DEPUTETI SOKOL BASHOTA

Faleminderit z. Kryetar. Të nderuar deputet. Unë i kam tri çështje të cilat dua t'ia drejtoj z. Kryeministër nga i cili më së paku do të dëshiroja të kërkoja përgjigje, por do të kërkoja një veprim konkret.

Z. kryeministër, pse nuk distancohesh dhe shkarkon anëtarët e kabinetit tuaj qeverisës si z. Salihaj, Termkolli, Agim Velin dhe Astrit Haraçia për të cilat ka dyshime të bazuara që janë të involvuar në krime të natyrës ordinere, si vrasje, kërcnime, shantazhe, krime ekonomike dhe vepra tjera antiligjore.

Z. kryeministër, pse nuk i sqaron lidhjet e mundëshme të akteve terroriste në Ferizaj në Qendrën Tregtare "Benaf" në organizatorin Adem Salihajn dhe lidhshmërinë me atentatin e organizuar kundër z. Ibrahim Rugova po nga grupi i Adem Salihajt.

Z. kryeministër, pse nuk sqaroni implikimin real të kabinetit tuaj qeveritar me strukturat paramilitare të "Sigurimit i Atdheut" i afërt me Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Në qoftë se nuk do të veprohet shumë shpejt dhe në mënyrë të ngutshme zor se do të mund të japësh një raport të suksesshëm për 100 ditëshin e ardhshëm. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Z. Jakup Krasniqi, ka kërkuar replik një minut, urdhëroni.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI

Ajo që u tha më herët, çështja e tatimit. Deputeti i LDK-së Naser Osmani nuk është e vërtetë, mund të formohet një komision dhe të jenë ata vetëm të LDK-së dhe le të shkojnë dhe le të shikojnë edhe në Komunë edhe në KEK dhe le të shihet se a i kryej obligimet qytetare apo jo.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit, Ragip Zekolli dhe pastaj Nazim Jashari.

DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI

Faleminderit z. Kryetar. I nderuari kryeministër, ministra dhe kolegë deputetë. Një pjesë të fjalës sime e mori kryetari i grupit parlamentar për arsye se ishte një çështje lidhur me pyetjen që kryeministri është në interpelancë dhe shpesh ne po bimë që në emër të asaj ta ngarkojmë rendin e ditës dhe të thuhet gjërat që vërtetë nuk janë morale dhe në natyrën e këtij Kuvendi duke paraqitur edhe çështje jashtë debatit. Unë dua ta sqaroj vetëm një çështje që mos t'u marrë ndoshta më shumë se dy minuta, por është një e vërtetë shumë e madhe për shkelje në Universitetin e Prishtinës e që u kërkua edhe dorëheqja e ministrit tash. Por ato shkelje janë të konstatuara, jo vetëm nga ministria, por edhe nga institucionet relevante, të cilat punojnë dhe veprojnë në Kosovë, duke përfshirë edhe bashkësinë e universiteteve, duke përfshirë edhe zyrat diplomatike, por çka është më e rëndësishmja, duke e përfshirë edhe vetë UNMIK-un, prandaj do të ishte mirë dhe në nderin tonë si deputet të mbajmë përgjegjësinë për fjalën e thënë dhe mos të ngarkojmë këtë Kuvend me çështje, të cilat vërtet nuk janë objekt i rendit të ditës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju faleminderit. Fjalën e ka Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI

I nderuari kryetar, të nderuar përfaqësues të Qeverisë, të nderuar kolegë deputetë. Interpelanca e ftuar nga PDK-ja dhe përgjigja e kryeministrit është një ngjarje me rëndësi për këtë Kuvend, është një ngjarje e re. Ky Kuvend me sa di unë edhe në mandatin e kaluar nuk ka ndodh të ftojë në interpelancë kryeministrin, prandaj pavarësisht efekteve që do të mund t'i prodhojë kjo interpelancë, unë mendoj se kjo është një risi dhe është një zhvillim pozitiv për punën e këtij Kuvendi. Sigurisht që niveli ynë i përgjegjshmërisë është akoma shumë larg nga e dëshiruara, sepse përsëritja e përfaqësuesve të koalicionit qeveritar nuk e garanton një qëndrim të unifikuar

të Kuvendit në raport me punën e Qeverisë. Sido qoftë vetë akti si akt dhe gatishmëria e kryeministrit është për t'u përshëndetur, pavarësisht mënyrës se si ai ju përgjigj këtyre çështjeve që u shtruan nga PDK-ja. Unë mendoj se është për t'u përshëndetur dhe sigurisht zhvillimet edhe në të ardhmen do të jenë të tilla dhe do të ketë kësi varshmërie, posaçërisht më duhet të potencoj se Qeveria e ka miratuar një raport 100 ditorë, së paku në media ishte informata e tillë dhe shpresoj që ky raport 100 ditorë i Qeverisë do të vjen para deputetëve të këtij Kuvendi dhe do të kemi mundësi që ta analizojmë atë raport të Qeverisë dhe do të debatojmë për atë dhe do të jetë një vazhdimësi e kësaj interpelance. Kam përgjithësuar dy çështje. E para: Komisioni për buxhet siç e dini me kornizë kushtetuese është i definuar si komision i cili ka përgjegjësi për të gjitha çështjet buxhetore që kanë të bëjnë me buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe më lejoni t'ju kujtoj, të nderuar kolegë, se ky Komision është i autorizuar që t'i analizojë raportet periodike që vijnë nga Qeveria dhe që pas analizës së këtyre raporteve rekomandimet e tija t'ia paraqes këtij Kuvendi dhe nuk ka ndodhur asnjëherë deri më sot që ky komision ta rumbullakoj ndonjë raport, analizë dhe t'ia parashtrojë këtij Kuvendi. Është indikative pse e kemi pasur raportin e marsit, kemi pasur raporte të veçanta për prill, maj, qershor dhe ja korriku po shkon dhe asnjë rekomandim nga ana e komisionit nuk ka ardhur në këtë Kuvend. Unë jam anëtar i atij komisioni dhe shpeshherë e kam pyetur veten se kryetari i Komisionit paska punë të tjera duke i përcjellur përfaqësuesit e opozitës se a po e paguajnë tatimin në pronë, se si po afarizon kompania "Koha" apo afarizon me plus apo minus. Është shumë pozitive të afarizosh në kohën e sodit në qeverisjen e Bajram Kosumit me 0, pra pa fitim, sepse ka shumë firma që afarizojnë me humbje zotëri, kështu që në këtë aspekt mendoj se do ta kryejë komisioni punën si duhet dhe do t'i analizojë punët e Qeverisë e jo punët e opozitës.

E dyta, rreth punësimit në Qeveri pa konkurs dhe e kam një shembull ilustrativ. Para një jave në zyrën ligjore të kryeministrit në resorin e tij ku është përgjegjës, është pranuar një djalë i ri i posa diplomuar 24 vjeçar si koordinator i zyrës ligjore, ai është një zyrtar i lartë i Aleancës i cili ka ardhur nga jashtë në atë zyrë dhe është zgjedhur ushtrues detyre i koordinatorit, konkurs nuk është shpallur, ka ardhur me dekret, dekretin e ka dhënë kushedi se kush, kryesorja është vendosur në krye të 12 zyrtarëve të tjerë ligjor dhe aty ushtron punën e vetë duke u mundur t'i mësoj aty zyrtarët ligjor në zyrën ligjore të kryeministrit dhe i cili ka shumë nevojë që të fitoj përvojë, është zhytur në ujë por ndoshta do të mësohet të notoj dhe të shpëtoj, ndërsa ata kolegët nuk do të kenë gjelozitë dhe do ta mësojnë se si bëhet puna edhe pse e kanë shef.

Një çështje tjetër që dua ta ngriti është se si po u qaset kompetencave Qeveria. Kompetenca të cilat po i kërkon vazhdimisht me ngulm nga UNMIK-u dhe kompetencat të cilat po ia delegon UNMIK-u kësaj Qeverie. Ne në këtë mandat e kemi emëruar një ministër për pushtet lokal i cili sipas logjikave të gjërave do të duhej të merrte mbi vete edhe kompetencat e organizimit të pushtetit lokal në Kosovë dhe mënyra se si insistoj Qeveria që të shkoj përpara procesi i decentralizimit le shumë për të dëshiruar se ne në një farë mënyre hoqëm vetë dorë nga kompetencat që i kërkuam dhe të cilat na u deleguan, sepse përgjërimi me të cilin zëdhënësi i Qeverisë dhe Qeveria vetë i bënin Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara për ta nxjerrë rregulloren për decentralizimin, apo për fillimin e procesit të decentralizimit flet vetë për veti në vend se ky Kuvend të shkoj përpara dhe të nxjerrë ligje për derisa e ka emëruar ministrin t'i nxjerrë edhe ligjet e nevojshme për decentralizimin. Qeveria e bëri një hap prapa duke e lutur Përfaqësuesin

Special që t'i marrë ato kompetenca përsëri në duar të veta dhe që ai ta shpall një rregullore me të cilën do të rregullohet ajo materje, pra ne në një anë kërkojmë kompetenca, kurse në anën tjetër nuk jemi të gatshëm t'i marrim ato, po ashtu përpiqemi që çështjet politike t'i shtyjme përpara duke u nxjerrur në shpinë të të tjerëve, është kjo një shej i keq dhe besoj që në të ardhmen edhe kjo Qeveri por edhe ky Kuvend do të jetë në nivel më të lartë të përgjegjësisë dhe do ta analizoj më mirë punën e Qeverisë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Kërkoj falje e fundit Gjylnaze Syla, ska replika, ska polemika.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

Ju faleminderit. I nderuari z. Kryetar, z. Kryeministër, anëtar të kabinetit qeveritar, deputet të nderuar.

Grupi parlamentar i AAK-së mirëpret dhe përshëndet iniciativën e Grupit parlamentar të PDK-së për interpelancë, gjithashtu të mbështetur nga Ora. Në të njëjtën kohë i falënderohemi edhe z. Kryeministër Bajram Kosumit për gatishmërinë dhe për përgjigjet e dhëna në mënyrë të saktë dhe të detajuar, por edhe gjithëpërfshirëse në të gjitha çështjet që u kërkuan nga ai dhe Qeveria. Edhe pse sipas rregullores për interpelancë shtrohet një çështje, nga Grupi parlamentar i PDK-së janë shtruar disa çështje dhe unë e falënderoj kryeministrin për përgjigjen në ato çështje në të cilat ai sipas rregullores nuk ka qenë i detyruar që të përgjigjet.

Grupi parlamentar i AAK-së mbështet edhe matje si gjithnjë iniciativat konstruktive dhe ofron bashkëpunimin për të gjitha angazhimet në interesin dhe në dobi të qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Në përfundim të seancës, Kryeministri i Kosovës Bajram Kosumi.

KRYEMINISTRI I KOSOVËS BAJRAM KOSUMI

Kryetar ju falënderoj dhe kisha dashur me të vërtetë për të mos humbur kohë më shumë, por vetëm të bëj disa konstatime.

Fillimisht jam përgatitur që të kem debat për çështjet e ngritura, po e them me mendjen më të mirë, me bindjen më të mirë dhe të fillojmë të krijojmë një praktikë të re në Kuvend që Qeveria me Kuvendin të debatoj çështje të veçanta. Jam i kënaqur edhe me këtë, por fatkeqësisht atë që dua ta shpreh u ngritën shumë probleme me dhjetëra çështje dhe nuk ka mundësi që të debatohet. Pati konstatime, paragjykime, vlerësime, rivlerësime që u përsëriteshin edhe nga dhjetë herë, por nuk ka debat për ato dhe kjo ishte ajo që unë tash nuk mund të debatoj dhe nuk mund të përgjigjem në ato çështje sepse janë jashtë procedurës dhe nuk mund të përgjigjem.

Unë kërkoj falje z. Krasniqi, por pyetjet e juaja i kamë të marrura prej Kuvendit, tash i morra me veti pyetjet e juaja, i kamë lexuar shumë herë, e kamë përgatitur përgjigjen,

janë 5 pyetje dhe në 5 pyetjet jam munduar të përgjigjem një nga një. Pyetjet që i shtruat si shtes, si p.sh për sekretarët permanent. Më lejoni të them se ministritë që i përmendët ju nuk kanë sekretar permanent, por janë pyetje jashtë interpelancës suaj. Unë mund të përgjigjem, por këtu askund nuk shkruan për sekretar të përhershëm, unë jam i gatshëm të përgjigjem në këto pyetje, bëni përsëri interpelanca, kërkoni çështje të veçanta, unë ju përgjigjem dhe është krejt në rregull.

Për hir të opinionit se nëse një fakt përsëritet 50 herë opinionin dëshiron ta dijë të vërtetën, ne mund ta dimë këtu, por qytetarët e përcjellin këtë debat. Unë dëshiroj të ndalem te ndërtesa e Qeverisë, u përmend shumë herë këtu dhe dëshiroj të jap një sqarim. Krejt revidimet që janë bërë duke përfshirë edhe aneks kontratën që e ka nënshkruar z. Krasniqi për TVSH-në nuk bëjnë as 10%, duke përfshirë edhe TVSH-në prej 600.000 euro që ne do të paguajmë tash prej buxhetit, ndërsa aneks kontrata e nënshkruar para një viti nuk bëjnë as 10% po të mblidhen të gjitha. E dyta, ndërtesa e Qeverisë është tenderuar sipas projektit "Projekto dhe Puno" kështu është e nënshkruar në kontratë d.m.th kur është bërë versioni i parë nuk e kanë ditë saktë se si do të jetë fundi dhe e kanë lënë "Projekto dhe ndërto" d.m.th që të bëhen ndryshime gjatë kohës dhe ato ndryshime sa për ta ditur ju. Për të shkuar te zyra e kryeministrit e që atje shkojnë vizitorët, duhet me ec diku 20 metra me një korridor të ngushtë 2,50, vjen cilido kryeministër i cilit do vend, rajon, ose të botës dhe duhet të ec nëpër një korridor 2,50 rreth 20 metra e ky është imazhi i burgut të Nishit, shoku im Hydajet dhe është dashur të ndryshohet kjo që të mos ketë asi imazhi si ndërtesë e Qeverisë.

Ndryshimet tjera nuk kanë të bëjnë me tekstin e kryeministrit apo të ministrave, por janë mangësi të projektit, p.sh në projekt nuk parashihet me pasur dritaret perde, ato kushtojnë para, nuk ka sall ku mban mbledhje Qeveria.

Ndalem te çështja e marrëdhënieve me jashtë që po ashtu u përmend shumë herë këtu. Vetëm sa për informim dhe do të kem përkrahjen e juaj në këtë çështje. Ne duhet të investojmë shumë më tepër se sa që kemi investuar deri më tash në marrëdhëniet me jashtë. Ne duhet të krijojmë ekipe tona, ekspert tanë, të huaj të gjitha lidhjet e mundshme t'i shfrytëzojmë për t'i aktivizuar tash në kohën kur po ofrohem statusin final të Kosovës dhe në Qeveri është duke u diskutuar një projekt i mundshëm tash, pas rishikimit buxhetor që do të financohet nga Qeveria për orientime të tilla, aktivitete të tilla të Qeverisë.

Sa ju përket komunave, se janë të dëmtuara me 13 milion, nuk e di përmendësh shifrën e saktë por e di se janë të dëmtuara, nuk janë të dëmtuara komunat partiakisht, por janë të dëmtuara të gjitha komunat, janë të dëmtuara të gjitha ministritë sepse në këtë vit ka shkurtesa të harxhimeve buxhetore. Në vitin 2004 dallimi në mes të hyrave buxhetore dhe shpenzimeve buxhetore e kamë thënë edhe në diskutimin për ekonomi ka qenë 150 milion euro dhe ato janë bërë gjatë një viti të tërë e jo në fund të vitit, në këtë vit Qeveria e Kosovës ka më pak 75 milion euro në buxhet, prandaj është dashur të bëhet reduktimi për çdo ministri, për çdo komunë, për çdo organizatë buxhetore janë reduktuar harxhimet.

Çështja e letrës së grupit të kontaktit që e përmendi z. Hysa. Unë jam deklaruar publikisht se janë disa vlerësime kohëve të fundit mbas takimit me z. Sollana ku thuhet se ka ngecje në dy çështje në Kosovë, në decentralizim dhe në standarde. Unë asnjëherë nuk jam pajtuar dhe nuk kpaftohem se ka ngadalsim në standarde, pavarsisht se kush i thotë ato, ato mund të kenë prapavija politike pse thuhet, në decentralizim ka pasur një zvarritje të procesit dhe ju e dini fortë mirë pse ka qenë zvarritja e procesit deri sa ne kemi debatuar

dhe i kemi par rrugët më të mira se si duhet të ecet përpara, por nuk ka ngadalësim të procesit në këto çështje. Në zhvillimet e përgjithshme dhe sidomos kjo nuk mund të lidhet me statusin final të Kosovës atë që deshë ta bëjë edhe z. Hyseni kur tha se këto zvarritje ose këto ngecje, këto dobësi po e rrezikojnë statusin final të Kosovës. Më lejoni që t'i përgjigjem znj. Sala Berisha – Shala, jo t'i përgjigjem por të jap mendimin e Qeverisë rreth çështjes që ngrihet rreth Feronikelit dhe moszhvillimin e Drenicës. Ne mund të pajtohemi me atë se Drenica është një prej pjesëve më të pazhvilluara, por besoj se edhe ju pajtoheni se nuk ka mund të zhvillohet Drenica me 100 ditët e qeverisjes sime dhe nuk është varfëruar për 100 ditët e qeverisjes sime. Dëshira e kësaj Qeverie ka qenë se unë nuk di kush është ofertuesi i dytë dhe kush qëndron aty, por e di sipas dokumenteve që ka dhënë AKM-ja se ofertuesi i parë mund të jetë shumë njeri i mirë, por i shkretë s'ka para me pagu atë shumë që e ka dhanë, se ska dokument për të dëshmuar se ka para dhe do të ishte gabim i madh me stopua dhe me politizua një proces të tillë në Drenicën e varfër ku mund të fillojnë të punojnë 1000 punëtor menjëherë dhe ku mund të investohen rreth 100 milion në Feronikel dhe rreth feronikelit. Është gabim dhe po ju lus që mos ta politizoni, të presim ekspertizat, unë nuk po dua ta prejudioj procesin, nuk po dua të paragjykoj se do të jetë kështu apo ashtu, pritni ekspertizat e AKM-së dhe të shofim se kush janë ofertuesit dhe çka janë ofertuesit.

Ju lutem edhe një fjali për z. Hyseni, unë jam i njëjti z. Hyseni, por nuk keni informata ose keni informata shumëpartiake, ose merreni me paragjykime më shumë, por me të vërtetë dëshiroj që në Kuvend të debatojmë çështjet një nga një, të kemi kohë, mundësi që të mund të kuptohemi më mirë në mes veti. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Më lejoni të përfundojmë ju lutem.

Interpelanca mund të përshëndetet sepse ka ngja në një Qeveri brenda 100 dite d.m.th përshëndetet edhe iniciuesi, gatishmëria e kryeministrit dhe e Qeverisë. Ajo që është njohuri e re për mua dhe besoj për Parlamentin. Kjo Qeveri qenka Qeveria më e përgatitur në botë në histori prej Krishtit e Hazreti Muhameti e deri sot, sepse për 100 ditë me i pas llogaritur akuzat e debatit individual kishte dalë që asnjë makineri e tërë nuk do të kishte mund me i bë këto. Konstatimi i tretë dhe i fundit. Konkluzat e nxjerrur nga propozuesi për interpelancë është jashtë rregullës 25, kërkon procedurë tjetër dhe është procedurë për shkarkim.

Këtu përfundon takimin e vetë të rregullt seanca plenare e Kuvendit të Kosovës.